Kingdom of the Netherlands

Instituti për Kontratën Shoqërore



MANUAL MBI DËNIMET ALTERNATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

DANIELA SULAJ
EDLIRA PETRI
FLORJAN KALAJA
ORNELA NAQELLARI
ROMEO MERRUKO



Kingdom of the Netherlands

Instituti për Kontratën Shoqërore

MANUAL
MBI DËNIMET ALTERNATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Daniela **SULAJ**
Edlira **PETRI**
Florjan **KALAJA**
Ornela **NAQELLARI**
Romeo **MERRUKO**

UETPRESS
Tiranë, maj 2020

Titulli i librit: **Manual mbi Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë**
Autorë: Daniela **SULAJ**,
Edlira **PETRI**,
Florjan **KALAJA**,
Ornela **NAQELLARI**,
Romeo **MERRUKO**
Redaktore: Suela **MINO**
Art grafik: Besnik **FRASHNI**

Libri është pjesë e kolanës **"ACTA SCIENTIARUM"**.

© 2021 Instituti për Kontratën Shoqërore. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës
Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.
uetpress@uet.edu.al
www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare
për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-320-40-7

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
"UET Press" është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, maj 2020

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit: "Alternativat e Dënimit - Alternativa për një jetë më të mirë", me mbështetjen financiare të Ministrisë së Jashtme të Hollandës nëpërmjet programit MATRA. Objektivat, zbatimi dhe rezultatet e këtij projekti, janë përgjegjësi e organizatës zbatuese "Instituti për Kontratën Shoqërore" - SCI. Çdo qëndrim apo opinion i prezantuar në këtë material, janë përgjegjësi e vetme e organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë qëndrime të Qeverisë Hollandeze.

PËRMBAJTJA

Hyrje 1
Përmbledhje ekzekutive 7

KAPITULLI I
Neni 58 i Kodit Penal - Gjysmëliria 9

1. Konsiderata të përgjithshme mbi gjysmëlirinë 9
2. Historiku i ligjit penal shqiptar mbi gjysmëlirinë 10
3. Standardet ndërkombëtare 11
4. Jurisprudencë ndërkombëtare 13
5. Regjimi juridik material 13
6. Aspektet procedurale të gjykimit 25
7. Ekzekutimi i dënimit alternativ 27
8. Konkluzione mbi praktikën gjyqësore 42
9. Konkluzione dhe sugjerime mbi rregullimin ligjor të dispozitës 45

KAPITULLI II
Neni 59 i Kodit Penal - Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë 47

1. Konsiderata të përgjithshme mbi nenin 59 të Kodit Penal 47
2. Historiku i ligjit penal shqiptar mbi nenin 59 të Kodit Penal 49
3. Standardet ndërkombëtare 52
4. Jurisprudencë ndërkombëtare 65
5. Regjimi juridik material 70
6. Aspektet procedurale të gjykimit 107
7. Ekzekutimi i dënimit alternativ 113
8. Konkluzione mbi praktikën gjyqësore 129
9. Konkluzione dhe sugjerime mbi rregullimin ligjor të dispozitës 134

KAPITULLI III
Neni 59/a i Kodit Penal - Qëndrimi në Shtëpi 137

1. Konsiderata të Përgjithshme 137
2. Historiku i ligjit penal shqiptar mbi lirimin me kusht 138
3. Standardet ndërkombëtare mbi aplikimin e masave alternative të dënimit me burgim, veçanërisht të "qëndrimit në shtëpi". 140

4. Regjimi juridik i "qëndrimit në shtëpi" sipas legjislacionit shqiptar.....146
5. Ekzekutimi i dënimit alternativ të "qëndrimit në shtëpi".....158
6. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore që kanë aplikuar masën alternative të "qëndrimit në shtëpi".....162
7. Statistikat e sistemit të drejtësisë për aplikimin e dënimit alernativ të "qëndrimit në shtëpi".....164
8. Konkluzione dhe vlerësime për efektshmërinë e dënimit alternativ "qëndrimi në shtëpi".....166

KAPITULLI IV
Neni 63 i Kodit Penal. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.....169

1. Konsiderata të përgjithshme mbi "Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryrjen e një pune në interes publik".....169
2. Historiku i ligjit penal shqiptar mbi "punën në interes publik".....170
3. Standardi ndërkombëtar përsa i përket "Dënimeve alternative të dënimit me burgim", ku përfshihet dhe puna në interes publik.....173
4. Jurisprudencë ndërkombëtare mbi "punën në interes publik".....177
5. Regjimi juridik material i "punës në interes publik".....178
6. Aspektet proceduriale të caktimit të "Pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik".....188
7. Ekzekutimi i "punës në interes publik".....188
8. Konkluzione mbi praktikën gjyqësore përsa i përket "punës në interes publik".....193
9. Konkluzione dhe sugjerime mbi rregullimin ligjor të "punës në interes publik".....195

KAPITULLI V
Neni 64 - Lirimi me kusht.....198

1. Konsiderata të përgjithshme mbi "lirimin me kusht".....198
2. Historiku i ligjit penal shqiptar mbi "lirimin me kusht".....201
3. Standarde të Këshillit të Evropës "mbi lirimin me kusht".....214
4. Jurisprudencë ndërkombëtare mbi rishqyrtimin e dënimit penal me burgim226
5. Regjimi juridik material i "lirimit me kusht".....234
6. Aspektet procedurale të gjykimit të kërkesës për "lirim me kusht".....304
7. Ekzekutimi i dënimit alternativ të "lirimit me kusht".....320
8. Konkluzione mbi praktikën gjyqësore të "lirimit me kusht".....333
9. Konkluzione dhe sugjerime mbi rregullimin ligjor të "lirimit me kusht"...339

HYRJE

Manuali për Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë është një dokument shumë i mirëpritur nga specialistë të fushave të ndryshme, puna e të cilëve lidhet me këto dënime. Ky Manual i shërben pasurimit të ideve, njohurive e praktikave që aplikojmë si profesionistë; transmetimit të dijeve tek ata që kanë nevojë për to; pasurimit të mëtejshëm të bibliotekës profesionale të gjithsecilit prej nesh, si dhe dokumentimit të dijeve dhe përvojës së specialistëve si mënyra më e mirë e prezantimit të veprimtarisë së tyre.

Ky Manual iu adresohet dhe do t'u shërbejë gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të praktikës, që të kuptojnë në mënyrë më të detajuar përmbajtjen e koncepteve mbi dënimet alternative dhe mënyrën se si ato duhen aplikuar në praktikë. Manuali, po ashtu, është një material shumë i vlefshëm për studentët pasuniversitarë dhe ata të Shkollës së Magjistraturës, jo vetëm si material studimi, por edhe si një udhëzues në praktikën e tyre të mëvonshme profesionale.

Kontaktin e parë me dënimet alternative e kam pasur në një seminar të organizuar nga Këshilli i Evropës, mbajtur në Pragë në vitin 1993. Në atë kohë bëja pjesë në grupin e punës për hartimin e Kodit të ri Penal dhe shumë prej rekomandimeve të Këshillit, të trajtuara edhe në seminarin në fjalë, u bënë pjesë e këtij Kodi, i cili u miratua në vitin 1995. Nenet lidhur me dënimet alternative ishin, mbase, një prej risive më të dukshme të atij ligji.

Që nga ajo kohë kam pasur një farë 'aferisie' profesionale me dënimin alternativ, edhe për arsyet e shumta që lidhen me epërsitë e tij përkundër dënimit penal. Ky i fundit, në mungesë të sistemit rigoroz të edukimit,

vlerësohet të ketë plot të meta, të cilat e ulin efektivitetin e tij për edukimin apo parandalimin e kriminalitetit. Po të llogarisësh edhe kostot e larta që ka sistemi institucional lidhur me dënimet penale, konstaton se dënimi penal nuk mund të jetë element kryesor në trajtimin e shkeljeve relativisht të vogla. Koncepti, se dënimi i lartë penal mundëson parandalimin e rritjes së kriminalitetit, është vjetëruar tashmë. Ka, po ashtu, një opinion se dënimet e larta dhe jo-efektive rivalizojnë me shkaqet thelbësore që nxisin kriminalitetin në vend. Zgjidhjen e kësaj sfide e shoh tek alternativat e dënimit penal.

Manuali për Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë ofron një trajtim shumë të arrirë të institucionit të dënimeve alternative. Ai reflekton dijen dhe përvojën e profesionistëve që kanë marrë pjesë në studimin dhe paraqitjen e problematikës lidhur me dënimet alternative. Për afro 25 vjet, eksperienca e fituar nga gjykatat e vendit për zbatimin e dënimeve alternative përbën një taban të sigurt për të nxjerrë konkluzione, edhe të karakterit shkencor, për mënyrën se si janë zbatuar në praktikë dënimet alternative dhe si vlerësohet efektiviteti i tyre përkundrejt dënimit kryesor që përmban ligji penal, burgimit.

Ky Manual është një instrument për të ndihmuar aktorët e përfshirë në proces në kuptimin, aplikimin dhe zbatimin më të drejtë të dënimeve alternative, duke pasqyruar problematikat dhe praktikat më të mira. Manuali ndahet në pesë kapituj, një për secilin nga dënimet alternative: (i) gjysmëlirinë, (ii) pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, (iii) qëndrimin në shtëpi, (iv) pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, dhe (v) lirimin para kohe me kusht.

Manuali i bën një trajtim të veçantë dhe të hollësishëm secilit lloj të dënimit alternativ duke ndjekur të njëjtën linjë. Kështu, për secilin dënim alternativ jepen fillimisht konsiderata të përgjithshme që ofrojnë kuptimin dhe qëllimin e aplikimit të këtij dënimi, si dhe efektet pozitive që ai sjell në praktikë.

Kapitulli mbi konsideratat e përgjithshme ndiqet nga një pasqyrim i historikut të ligjit penal shqiptar me momentet më domethënëse, ndryshimet e legjislacionit dhe qëllimet e këtyre ndryshimeve në një kontekst të caktuar.

Më pas, Manuali trajton në mënyrë të hollësishme standardet ndërkombëtare të përcaktuara në Rekomandimet, Rezolutat dhe Konventat e Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian, si dhe standardet e

Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), për dënimet alternative dhe garancitë minimale për personat që janë subjekt i tyre. Këto standarde venë theksin në riedukimin dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri, si edhe nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative për uljen e mbipopullimit të burgjeve. Ato përfshijnë edhe udhëzime për vendosjen dhe mirëfunksionimin e Shërbimit të Provës. Në vijim, Manuali trajton standardet e të drejtës penale ndërkombëtare dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Një vend të veçantë në Manual zë jurisprudenca e gjykatave kushtetuese në Evropë, për lirimin me kusht.

Kapitulli mbi regjimin juridik material, trajton kushtet dhe kriteret e aplikimit të secilit dënim alternativ, kushtet ndaluese, çështje të tjera; si ato të periudhës së provës apo kushtit, detyrimeve gjatë periudhës së provës apo kushtit, etj. Në këtë aspekt do të veçoja dhënien e pëlqimit dhe konsiderimin e dënimit të paqenë, në rastin e kryerjes së një pune me interes publik, trajtimin e lirimit me kusht të të dënuarve me burgim të përjetshëm në rastin e lirimit me kusht.

Trajtimi i çështjeve kryesore të regjimit juridik material bëhet nëpërmjet interpretimit të dispozitave ligjore, analizës së jurisprudencës së gjykatave shqiptare, nxjerrjes në pah dhe trajtimit të problematikave të hasura në praktikën gjyqësore, analizës së tyre në qasje dhe krahasim me standardet ndërkombëtare. Theksi është vënë në nevojën për një analizë të thelluar në vendimet gjyqësore, të kushteve ligjore për aplikimin e dënimit alternativ, veçanërisht qëndrimit në shtëpi.

Nuk është lënë jashtë vëmendjes edhe përshkrimi i rasteve konkrete të qëndrimeve të ndryshme të praktikës gjyqësore dhe identifikimi i nevojës për unifikimin e kësaj praktike. Edhe në rastet kur praktika gjyqësore është e unifikuar, Manuali vendos një theks të veçantë në analizën e përputhjes së saj me standardet ndërkombëtare dhe qëllimit ligjor të këtij dënimi alternativ. Në këtë drejtim, çështje me shumë interes janë: përllogaritja e afatit minimum të vuajtjes së dënimit me burgim, për efekte të zbatimit të lirimit me kusht; konsiderimi i rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit, si shkaqe të vetme të mjaftueshme për të rrëzuar kërkesën për caktimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht; dhe mënyra e vlerësimit nga gjykatat, të peshës faktike dhe juridike që masa disiplinore mund të ketë në rezultatin e riedukimit apo riintegrimit të të dënuarit.

Në vijim, në kapitullin 6 trajtohen aspektet procedurale kryesore të gjykimit, të cilat fokusohen në ritin e gjykimit, legjitimitetin e kërkuesit,

kompozimin e trupit gjykues, mënyrën e disponimit me vendim nga gjykatat, apo çështje që lidhen me kompetencën e gjykatës në shqyrtimin e kërkesave të natyrave të ndryshme, që lindin në kuadrin e aplikimit dhe ekzekutimit të dënimeve alternative.

Në kapitullin 7, për secilin dënim alternativ, trajtohen çështjet kryesore që lidhen me ekzekutimin e dënimit alternativ si: pamundësia e ekzekutimit të dënimit alternativ, ndryshimi i kushteve apo detyrimeve gjatë periudhës së provës, ndryshimi apo revokimi i dënimit alternativ, mbarimi i dënimit alternativ, si dhe mbikëqyrja elektronike e të liruarit me kusht apo gjatë qëndrimit në shtëpi. Këto çështje trajtohen në raport me përmbushjen e standardeve ndërkombëtare përkatëse.

Manuali nxjerr në pah çështjet më të diskutueshme të praktikës gjyqësore, si: përfundimi i dënimit alternativ përpara periudhës së përcaktuar; rastet kur i dënuari lejohet të largohet nga vendbanimi; përcaktimi i detyrimeve të përshtatshme dhe arsyeshme që i dënuari duhet të plotësojë gjatë periudhës së provës; problematika që sjell individualizimi në dispozitiv i veprimtarisë profesionale që do të ushtrojë i dënuari, apo edhe i punëdhënësit ku i dënuari do të punojë; revokimi i pezullimit për shkak të kryerjes së një vepre tjetër penale gjatë periudhës së provës, dhe kujdesi në arsyetimin e vendimit gjyqësor duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Një çështje interesante është ajo e afatit për kohëzgjatjen e kushtit më shumë sesa afati i dënimit të mbetur me burgim, e cila evidenton qëndrimin e mbajtur nga një pjesë e praktikës gjyqësore në kundërshtim me Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. 2/2015.

Manuali fokusohet më tej në rolin e Shërbimit të Provës, rolin e prokurorit dhe të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimit Penal në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndërveprimi mes tyre. Në Manual i është bërë një analizë e plotë gjithë kuadrit ligjor, ndërthurjes së parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale me ligjet e tjera, si Ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar; Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar; dhe identifikimit të nevojës konkrete për harmonizimin e dispozitave.

Në Manual analizohet i plotë roli i Shërbimit të Provës, jo vetëm në fazën e ekzekutimit të dënimit alternativ, por edhe në fazën e gjykimit nëpërmjet paraqitjes së raportit. Theksi vihet te një rol më aktiv i Shërbimit të Provës, që duhet të kryhet zakonisht pa patur nevojë për një ngjarje apo rrethanë të caktuar apo kërkesë nga ana e të dënuarit dhe jo vetëm në rast

mospërmbushjeje të detyrimeve. Në Manual rekomandohet që Shërbimi i Provës të luajë një rol më aktiv në ekzekutimin e dënimit alternativ, duke mos u mjaftuar vetëm me pasqyrimin e fakteve në relacion, por duke rekomanduar njëkohësisht alternativën më të përshtatshme për dënimin dhe argumentet konkrete në mbështetje të kërkesës për këtë dënim.

Përveç trajtimit të praktikës gjyqësore, Manuali analizon edhe praktikën administrative të institucioneve të përfshira në ekzekutimin e dënimeve alternative. Në këtë aspekt, vlen të theksohet problematika e konstatuar përsa i përket përcaktimit të vetëm një institucioni në Republikën e Shqipërisë për vuajtjen e dënimit me gjysmëliri, mungesa e rregullave të posaçme të regjistrimit dhe pranimit të të dënuarve me gjysmëliri në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP), nevoja në praktikë e trajnimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së Shërbimit të Provës, si dhe nevoja për bashkëpunim me institucionet e tjera për të bërë efektiv detyrimin e nënshtrimit ndaj një trajtimi, programi mjekësor, apo rehabilitimi, dhe mbikëqyrjen e detyrimeve si mosfrekuentimi i vendeve të caktuara, lokaleve që shërbejnë pije alkolike, etj.

Manuali sjell një vlerësim të kuadrit ligjor për dënimet alternative dhe aspektit praktik të zbatimit të tyre, duke u bazuar kryesisht, por jo vetëm, në vendimet gjyqësore në katër rrethe gjyqësore: Tiranë, Fier, Shkodër dhe Korçë, për periudhën 2018 - 2019. Në Manual bëhet analiza e praktikës gjyqësore në aspektet e regjimit material dhe të ekzekutimit të dënimeve alternative, si dhe në aspektin e përhapjes së këtyre dënimeve alternative në praktikë. Këtu është interesante analiza e shkaqeve të përhapjes së ulët të disa prej dënimeve alternative, si gjysmëliria dhe qëndrimi në shtëpi.

Në përfundim, për secilin dënim alternativ, në vijimësi të analizës së bërë, në Manual jepen konkluzione mbi çështjet më të rëndësishme të praktikës gjyqësore. Një rekomandim interesant dhe i vlefshëm është ai që orienton praktikën drejt një qasjeje të pahasur asnjëherë më parë, por tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, siç është iniciativa e prokurorit në paraqitjen e kërkesave për lirim para kohe me kusht. Një rekomandim i tillë ndryshon tërësisht konceptin që gjykatat dhe prokuroritë kanë për lirimin me kusht: nga koncepti se lirimi me kusht është përfitim dhe e drejtë subjektive e të dënuarit, në konceptimin e tij si çështje e interesit publik për miradministrimin e drejtësisë penale e të sistemit penitenciar, si dhe risocializimin e të dënuarve me burgim. Një rekomandim tjetër për praktikën gjyqësore është ai që ka të bëjë me procesin provues gjatë shqytimit

të lirimit me kusht, që tërheq vëmendjen e gjykatave në verifikimin, qoftë edhe kryesisht, të plotësimit të secilit prej kushteve dhe kritereve ligjore. Në Manual i vihet theksi edhe nevojës për unifikimin e praktikës gjyqësore për përcaktimin e momentit të fillimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit alternativ, atij me gjysmëliri, pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, apo kryerjen e punës me interes publik.

Një nga aspektet më domethënëse dhe të vlefshme të Manualit mbetet kapitulli mbi konkluzionet dhe sugjerimet mbi rregullimin ligjor të dispozitës. Në Manual janë dhënë sugjerime mbi rregullimin ligjor të dispozitës që gjysmëliria të gjejë aplikim më të gjerë në praktikë, dhe mbi ndryshimin e moshës të fëmijës së mitur, si një nga kriteret për aplikimin e qëndrimit në shtëpi. Një sugjerim tjetër ka të bëjë me rishikimin e zakonshëm të zbatimit të një dënimi apo mase alternative për pezullimin dhe vënien në provë, si dhe zgjerimin e diskrecionit të gjykatës për të vendosur afatin e periudhës së provës. Disa nga rekomandimet e Manualit për rregullimin ligjor të dispozitave për lirimin me kusht janë: heqja e ndalimit kategorik të zbatimit të lirimit para kohe me kusht për recidivistët e veprave penale të kryera me dashje; shfuqizimi i ndalesave kategorike të ligjit për mundësinë e rifitimit të lirisë nëpërmjet lirimit me kusht dhe rishikimi i periudhës së detyrueshme të dënimit me burgim të përjetshëm; si dhe parashikimi i një mekanizmi rikontrolli periodik dhe të vazhdueshëm mbi dënimet afatgjata apo dënimet me burgim të përjetshëm. Këto rekomandime shoqërohen me një analizë të detajuar të pasojave dhe ndikimit në zhvillimin e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe në respektimin e detyrimeve ndërkombëtare të të drejtave themelore të njeriut.

Në përfundim, dëshiroj të shpreh respektin për punën e autorëve, energjinë, përkushtimin dhe gadishmërinë e tyre, që kanë dhënë si rezultat vënien në dispozicion të praktikës juridike të këtij Manuali kaq të vyer. Për të gjitha këto, ju them: Faleminderit për kontributin tuaj!

Arben Rakipi

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Manuali për alternativat e dënimit me burgim është hartuar nga një grup autorësh, në dy faza. Faza e parë ka qenë analiza e praktikës gjyqësore në katër gjykata të Rrethit Gjyqësor dhe në tre gjykata Apeli, gjatë një harku kohor prej 2 vitesh. Në këtë mënyrë është analizuar vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Gjykata e Apelit Korçë, Tiranë dhe Shkodër, për vitet 2018 dhe 2019. Gjithashtu janë kryer takime me aktorë ligjorë, të përfshirë në ekzekutimin e dënimeve alternative të dhëna në vendimet gjyqësore. Konstatimet e fazës së parë janë përpunuar dhe kanë shërbyer si lënda e parë për fazën e dytë të hartimit të këtij Manuali, konkretisht të draftimit të tij.

Manuali është konceptuar në pesë kapituj, ku secili prej tyre i korrespondon një prej llojeve të dënimeve alternative që Kodi Penal njeh dhe rregullon. Kështu, Kapitulli I trajton nenin 58 të Kodit Penal, konkretisht dënimin alternativ të gjysmëlirisë. Kapitulli II trajton dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e të dënuarit, konkretisht nenit 59 e vijues të Kodit Penal. Kapitulli III trajton dënimin alternativ të qëndrimit në shtëpi, konkretisht nenin 59/a të Kodit Penal. Kapitulli IV i kushtohet dënimit alternativ të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimit të të dënuarit për kryerjen e një pune në interes publik, të rregulluar nga neni 63 i Kodit Penal. Kapitulli V trajton dënimin alternativ të lirimit me kusht, i rregulluar nga neni 64 e vijues i Kodit Penal.

Për secilin kapitull dhe lloj të dënimit alternativ të dënimit me burgim, është ndjekur një qasje e përbashkët e strukturimit të trajtimit dhe analizës ligjore. Fillimisht niset me trajtimin e konsideratave të përgjithshme, më

tej me historikun e ndryshimeve që Kodi Penal ka pësuar ndër vite në secilën dispozitë respektive, më tej analizohen standardet ndërkombëtare të secilit prej dënimeve alternative; trajtohet analiza ligjore e regjimit juridik material penal të secilit prej dënimeve alternative; trajtohet analiza ligjore e regjimit juridik procedural për secilin prej dënimeve alternative, për të konkluduar në fund të analizës edhe me regjimin juridik të ekzekutimit të secilit prej dënimeve alternative. Në fundin e çdo kapitulli janë përpunuar konkluzionet dhe sugjerimet respektive mbi praktikën gjyqësore dhe mbi përmirësimet e legjislacionit për secilin nga dënimet alternative.

Qëllimi i hartimit të këtij Manuali ka qenë krijimi i një materiali analitik dhe udhëzues mbi të gjithë aktorët shtetërorë që janë të përfshirë në procesin vendimmarrës dhe administrues të masave alternative të dënimit me burgim. Sigurisht, problemet e shumëllojshme që praktika e zbatimit të ligjit sjell, janë të pafundme dhe nuk mund të pretendohet që Manuali të synojë të japë përgjigje për secilin të interesuar dhe për secilën problematikë. Megjithatë, analiza shumëplanëshe e tij garanton secilin aktor shtetëror të përfshirë në këtë proces, se do të marrë përgjigje kuadër dhe parimore për çdo problem që lind. Padyshim, secili prej autorëve mirëpret kontributin e çdonjërit prej aktorëve që në të ardhmen ky punim të rishikohet dhe të pasurohet me analiza dhe informacion utilitar për këdo të interesuar.

Mbetemi besimplotë se secili nga ne ka diçka që duhet ta ndryshojë në mentalitet lidhur me zbatimin në praktikë të instituteve të së drejtës penale mbi alternativat e dënimit me burgim. Puna e gjithsecilit, dhe më së shumti bashkëpunimi, duhet të jenë të tillë që realisht dënimi me burgim të jetë një masë me karakter *ultima ratio* e shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Në këtë drejtim, Manuali le të jetë një shkëndijë e radhës për të orientuar dritën e duhur të vëmendjes së të gjithë aktorëve publikë mbi zbatimin si rregull të masave alternative të dënimit me burgim dhe zbatimin si përjashtim nga rregulli, të dënimit me burgim.

Autorët

KAPITULLI I

NENI 58 I KODIT PENAL - *GJYSMËLIRIA*

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI GJYSMËLIRINË

Dënimet alternative nënkuptojnë dënimet të cilat e mbajnë të dënuarin në komunitet dhe përshijnë disa kufizime të lirisë nëpërmjet vendosjes së kushteve ose/dhe detyrimeve. Dënimet alternative përbëjnë mënyra të rëndësishmë për të luftuar krimin dhe shmangin efektet negative të dënimit me burgim. Zbatimi i dënimeve alternative brenda komunitetit mund të ofrojë mbrojtje më të mirë për shoqërinë në periudhë afatgjatë, sesa një proces izolimi nga komuniteti.

Një nga dënimet alternative të përcaktuara në nenin 58 të Kodit Penal është gjysmëliria. Ky dënim alternativ i lejon të dënuarit të ushtrojë një aktivitet profesional, të ndjekë arsimim apo kualifikim profesional, të ushtrojë përgjegjësitë familjare apo të ndjekë një trajtim mjekësor gjatë ditës. I dënuari ka mundësinë që të shlyejë dënimin jashtë Institucionit të vuajtjes së dënimit me burgim, për kohën e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme. Në këtë mënyrë, dispozita ofron mundësi që të dënuarit, krahas vuajtjes së dënimit me burg, të mund të plotësojnë dhe detyrimet, apo nevojat e sipërshënuara.

Kjo alternativë e dënimit me burgim synon përqasjen me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe traditat më të mira të legjislacioneve penale të vendeve evropiane, ku drejtësia penale përpiqet të kufizojë, sa të jetë e mundur, burgimin. Termi "gjysmë-liria" është huazuar nga legjislacionet

evropiane, në të cilat përdoret "semi–liberty" (në anglisht), "semi-liberte" (në frëngjisht). Një terminologji dhe formulim i përafërt i tij përdoret edhe në Kodin Penal të Kosovës.

Ekziston mendimi se në thelbin e saj, gjysmëliria nuk përbën një alternativë të dënimit me burgim (e aq më pak një dënim alternativ në kuptimin e gjerë), por vetëm një alternativë të ekzekutimit të dënimit me burgim.[1]

2. HISTORIKU I LIGJIT PENAL SHQIPTAR MBI GJYSMËLIRINË

Për herë të parë, është parashikuar si dënim alternativ në Kodin Penal me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, neni 58 "Copëzimi i dënimit me burgim", ku parashikohej se: "*Për dënimet gjer në një vit burgim, gjykata, kur vëren rrethana të rënda familjare, mjekësore, profesionale apo shoqërore, vendos që dënimi të ekzekutohet me copëzime jo më të vogla se dy ditë në javë. Në çdo rast ekzekutimi i vendimit duhet të përfundojë brenda tre vjetëve. Kur këto rrethana nuk ekzistojnë më, ose kur i dënuari shkel detyrimet e caktuara në vendim, gjykata bën revokimin e vendimit të dhënë me copëzim*".

Në vitin 2008, neni 58 i Kodit Penal u ndryshua me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar", ku parashikohet se:

"*Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri.*

Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata. Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni, zbatohet neni 62 i këtij Kodi".

Me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, është rishikuar neni 58 i Kodit Penal "Copëzimi i dënimit me burgim", duke u parashikuar si alternativë e dënimit me burgim "Gjysmëliria". Me këtë rast, kushti për aplikimin e dënimit alternativ për dënime gjer në një vit burgim, mbeti i pandryshuar.

[1] *Aleks Nikolli, Dënimi penal mes populizmit penal dhe drejtësisë, Botimet Fishta, 2016, faqe 177.*

Ndërkohë, kushti për ekzistencën e *rrethanave të rënda familjare, mjekësore, profesionale apo shoqërore* u zëvendësua me ekzistencën e *detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo me nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor.* Formulimi i mëparshëm i dispozitës dhe kërkesa për ekzistencën e rrethanave të cilësuara si "të rënda", krijonte vështirësi në aplikimin e dënimit alternativ, duke përjashtuar një numër të lartë rastesh, në të cilat vërtetohet ekzistenca e detyrimeve të tilla, që e përligjin aplikimin e gjysmëlirisë dhe përmbushin njëkohësisht qëllimet e dënimit. Në këtë aspekt ndryshimi është pozitiv.

Po ashtu në vend të "*ekzekutimit të dënimit me copëzime jo më të vogla se dy ditë në javë, për një periudhë totale brenda tre vjetëve*" tashmë parashikohet "*detyrimi i të dënuarit të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata*". Pra, dispozita e re nuk përcakton afatin maksimal, brenda të cilit duhet të ekzekutohet alternativa, ndryshe nga dispozita e mëparshme që parashikonte shprehimisht se ekzekutimi i copëzimit të dënimit nuk duhet të kalonte tre vjet. Me këtë ndryshim i është lënë më shumë diskrecion gjykatës që të vlerësojë periudhën kohore rast pas rasti për t'ia përshtatur nevojave dhe detyrimeve konkrete të të dënuarit për shkak të punës, arsimit, kualifikimit ose aftësimit profesional, përgjegjësive thelbësore familjare apo nevojës për trajtim ose rehabilitim mjekësor. Në këtë mënyrë, aplikimi i këtij dënimi alternativ bëhet më efektiv në praktikë dhe përmbush më mirë qëllimet e dënimit penal.

3. STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Në "Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim" (Rregullat e Tokios, 1990), përcaktohet se, në mënyrë që të sigurohet një fleksibilitet më i madh në raport me natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës, me personalitetin e të pandehurit si dhe mbrojtjen e shoqërisë, dhe në mënyrë që të shmanget pëdorimi i papërshtatshëm i burgimit, sistemi i drejtësisë penale duhet të ofrojë një sërë masash dhe dënimesh alternative.

Rekomandimi (2000)22 i Komitetit të Ministrave për përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane mbi dënimet dhe masat komunitare,

duke bërë amendime në Rekomandimet e mëparshme, përcakton ndër të tjera se parashikime duhet të bëhen për një numër të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm masash dhe dënimesh komunitare të ndryshme, nga të cilat disa shembuj parashikohen në këtë Rekomandim (si vënia në provë pa vendosur dënimin me burgim, pezullimi i dënimit me burgim me vendosjen e kushteve të caktuara, punë në interes publik, kompensimi i viktimës/ndërmjetësimi, trajtimi mjekësor me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike, kufizimi i lirisë së lëvizjes etj). Parashikime ligjore duhet të bëhen për rishikimin e zakonshëm të zbatimit të një dënimi apo mase të tillë, nga një organ i pavarur dhe i ngarkuar nga ligji.

Rekomandimi nr.(92)16 i Komitetit të Ministrave mbi rregullat evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, përcakton ndër të tjera se: Kushtet dhe detyrimet e masave apo dënimeve alternative, ashtu si edhe pasojat në rast mospërmbushje të tyre, duhet të përcaktohen në dispozita ligjore të sakta dhe të qarta. Në ligj nuk duhet të ketë asnjë parashikim për konvertimin automatik të masës apo dënimit komunitar në burg, në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve. Asnjë masë apo dënim komunitar, nuk duhet të ketë kohëzgjatje të pacaktuar. Kohëzgjatja duhet të përcaktohet nga autoriteti kompetent për marrjen e vendimit, brenda afatit të përcaktuar në ligj. Lloji dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat personale të të dënuarit. Vendimi për të caktuar dhe revokuar një masë a dënim alternativ, duhet të merret nga një autoritet gjyqësor.

Rekomandimi (2017)3 mbi rregullat evropiane për dënimet dhe masat komunitare, i miratuar nga Komiteti i Ministrave në datë 22.03.2017, është një nga aktet më të rëndësishme që përcakton në mënyrë të plotë standardet për masat dhe dënimet komunitare. Rekomandimi (2017)3 zëvendëson Rekomandimin nr.(92)16 të Komitetit të Ministrave mbi rregullat evropiane të dënimeve dhe masave komunitare dhe Rekomandimin (2000)22 të Komitetit të Ministrave për përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane mbi dënimet dhe masat komunitare. Dënimet alternative për të rinjtë rregullohen nga Rekomandimi (2008)11 i Komitetit të Ministrave për rregullat evropiane për të rinjtë keqbërës, subjekt i masave apo dënimeve.

4. JURISPRUDENCË NDËRKOMBËTARE

4.1 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Neni 1, paragrafi 1, i Ligjit Themelor Gjerman, përcakton konceptin e thelbit të dënimit dhe raportin e fajit me dënimin, në kuptimin që çdo dënim duhet të jetë në një raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit *(vendimet BVerfGE 19,342; BVerfGE 88, 203; BVerfGE 45, 187 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane).*

Organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit dhe atë të sigurisë juridike. Ai duhet të marrë parasysh mjaftueshëm edhe konceptin e fajit në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës dhe, nëpërmjet formulimit të sanksionit, t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete *(vendimi BVerfGE 105, 135 të Gjykatës Kushtetuese Gjermane).*

5. REGJIMI JURIDIK MATERIAL

5.1 Vlerësimi i kushteve për aplikimin e gjysmëlirisë

Për aplikimin e gjysmëlirisë është i domosdoshëm plotësimi i dy kushteve në mënyrë kumulative:

1- *dhënia e një dënimi deri në një vit burgim,* dhe
2- *ekzistenca e rrethanave që tregojnë për detyrimet e personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor.*

Nëse një nga këto kushte nuk plotësohet, atëherë dënimi alternativ i gjysmëlirisë nuk duhet të aplikohet. Kushti i parë, dhënia e dënimit deri në një vit burgim, është objektiv dhe si i tillë nuk ka vend për t'u vlerësuar. Gjithsesi, këtu vlen të theksohet se në gjykimin e posacëm, atë të shkurtuar, praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin e referimit në masën e dënimit përfundimtar të caktuar prej saj, pas aplikimit të uljes së një të tretës së dënimit. Pra, edhe nëse i pandehuri është dënuar me një masë dënimi më

të lartë se 1 vit burgim, në rast se është aplikuar gjykimi i shkurtuar dhe pas uljes rezulton një dënim deri në një vit, atëherë konsiderohet i plotësuar ky kusht.

Rastet e përcaktuara në këtë dispozitë për aplikimin e këtij lloji dënimi alternativ, janë: *detyrimet e personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor.* Këto kushte janë alternative dhe jo kumulative. Mjafton edhe vërtetimi i njërit prej kushteve që lidhet me detyrimet e të dënuarit, për aplikimin e gjysmëlirisë.

Për vlerësimin e përmbushjes së kushtit të dytë është shumë i rëndësishëm analizimi i rrethanave konkrete personale, familjare dhe gjendjes shëndetësore, të lidhura me detyrimet sipas nenit 58 të Kodit Penal. Për shembull, në rastin e trajtimit mjekësor ose rehabilitues, sigurisht nuk mjafton verifikimi i vuajtjes nga një sëmundje, për vlerësimin si të plotësuar të këtij kushti. Kjo sëmundje duhet të jetë e tillë që trajtimi mjekësor i saj të vështirësohet, apo të bëhet i pamundur në kushtet e vuajtjes së zakonshme të dënimit me burgim, apo qëndrimi në burg të përkeqësojë ecurinë e kësaj sëmundje.

Në vështrim krahasues me Kodin Penal të Kosovës, neni 58, vërehet se parashikohet i njëjti marzh dënimi për aplikimin e gjysmëlirisë si dhe të njëjtat rrethana.

5.2 Rrethanat për aplikimin e gjysmëlirisë

5.2.1 Detyrimet e personit të dënuar për punën

E drejta e individit për punë shihet e lidhur ngushtë me të drejtat e tij themelore, që garantojnë jetën private dhe të drejtat e personalitetit (vetëvendosja, vetërealizimi, dinjiteti njerëzor). Nëpërmjet punës, individi jo vetëm arrin synimet e tij në jetë, por njëkohësisht ai përmbush më mirë edhe detyrimet e tij familjare, sikurse ky aspekt kontribuon edhe në marrëdhëniet ndërpersonale me indivdët e tjerë në shoqëri. Në një vështrim më të gjerë, punësimi i individit kontribuon edhe në zhvillimin e vetë shoqërisë, ku ai bën pjesë. Ky aspekt i jetës së individit, parë në këndvështrim të nenit 58 të Kodit Penal, lidhet me "detyrimet e personit të dënuar për punën". Kjo do të thotë se, në parim, dhënia e një dënimi me burgim, përligj izolimin total të të dënuarit, duke bërë të pamundur ushtrimin e aktiviteteve në botën e jashtme, përtej institucionit ku vuan dënimin.

Nga ana tjetër, alternativa e gjysmëlirisë, e dhënë për shkak të detyrimeve të të dënuarit për punën, mundëson, krahas vuajtjes së dënimit, edhe përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në këtë pikë, natyrshëm shtrohet pyetja, se cilat do të ishin ato detyrime për punën, që do të bindnin gjykatën, se është vendi që të aplikohet gjysmëliria, si alternativë e dënimit me burgim? Referuar formulimit të nenit 58, do të ishte në përputhje me qëllimin e dispozitës, sikurse edhe me interesin publik, që togfjalëshi "detyrimet e të dënuarit për punën", të mos interpretohej ngushtë, vetëm me detyrimet që do të kishte i dënuari si punëmarrës, ndaj punëdhënësit të vet. Përtej këtij rasti, detyrimet mund të lidhen edhe me angazhimin personal të të dënuarit, kur vetë ai mund të jetë punëdhënës i personave të tjerë dhe ekzkeutimi i dënimit me burgim, do të vinte në rrezik për punonjësit, marrëdhëniet e punës dhe përfitimet prej saj (p.sh. mund të jetë rasti kur, për shkak të dënimit me burgim, aktiviteti i të dënuarit të falimentojë dhe punonjësit e tij të mbeten pa punë). Lind nevoja që rast pas rasti, gjykata të peshojë interesat që vihen në lojë dhe "rrezikohen" nga një ekzekutim i mundshëm i dënimit me burgim, duke gjetur një balancë të drejtë mes dobisë publike të dënimit penal, si dhe të drejtave dhe interesave që eventualisht "dëmtohen" nga ekzekutimi i tij; nëse ky "cenim" i mundshëm, evitohet nëpërmjet dhënies si alternativë të dënimit, atë të gjysmëlirisë.

Në praktikën gjyqësore, aplikimi i gjysmëlirisë është arsyetuar me rrethana të tjera të përgjithshme të pa konkretizuara specifikisht, si për shembull: "*për shkak të detyrimeve të personit të dënuar, nevojave të punësimit*."[2], por në një rast, *në përmbajtje të arsyetimit të vendimit ka rezultuar edhe vështirësia ekonomike.*[3] *Këto rrethana shpesh herë janë vlerësuar në tërësi me rrethana të tjera*. si fakti i të qenit i padënuar më parë dhe qëndrimi pohues e pendues i të pandehurit.

Si përfundim, edhe në aspektin e nevojave të punësimit, është e rëndësishme që të analizohet konkretisht dhe në mënyrë të detajuar rëndësia e punësimit jo vetëm për të pandehurin, por edhe për komunitetin ose familjen e tij, në raport me gjendjen ekonomike. Në vendimet gjyqësore mungon pasqyrimi konkret i nevojës për punësim dhe analiza e rëndësisë së aplikimit të gjysmëlirisë për përmbushjen e kësaj nevoje.

---

[2] *Vendim nr.3486 datë 14.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.2200, datë 20.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[3] *Vendim nr.3486 datë 14.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

5.2.2 Detyrimet e personit të dënuar për arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional

E drejta për arsim është e garantuar nga neni 2 i Protokollit I të KEDNJ, si dhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 57), ndërsa shteti shqiptar përcakton si një ndër objektivat e tij socialë edhe arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe *të personave të pazënë me punë* (neni 59, shkronja "ç"). "Detyrimet e të dënuarit për arsimin", si një ndër shkaqet për të cilat mund të aplikohet gjysmëliria si alternativë e dënimit me burgim, obligon gjykatën që të interpretojë nëse rrethanat e çdo rasti individual, përputhen me qëllimin objektiv të dispozitës. Para së gjithash, duhet evidentuar se kjo normë nuk gjen zbatim tek subjektet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili përcakton norma të posaçme që garantojnë të drejtat e të miturve, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe edukimin e tyre. Në këto kushte, duhet interpretuar detyrimi i një personi madhor për arsimin, si kusht për aplikimin e gjysmëlirisë. E drejta për arsim dhe detyrimet që burojnë për të dënuarin që po merr arsimin përkatës, nuk janë absolute dhe si të tilla, ato mund të kufizohen edhe nëpërmjet dënimit penal me burgim. Është gjykata, ajo e cila vlerëson se detyrimi individual i të dënuarit, të përfshirë në një program arsimor, kualifikimi apo aftësimi profesional, është i tillë sa justifikon ligjërisht aplikimin e alternativës së dënimit me burgim.

Edhe në këtë rast, gjykata nuk mund të mos marrë në konsideratë përfitimet e shoqërisë nga arsimimi dhe kualifikimi i të dënuarit, përkundrejt pasojës së humbjes së kësaj mundësie si rrjedhojë e ekzekutimit të dënimit me burgim. Një individ i arsimuar dhe i kualifikuar i shërben një shoqërie demokratike dhe frymës së mirëkuptimit, tolerancës dhe bashkëjetesës në komunitet. Për rrjedhojë, kur rezultojnë rrethana të tilla që tregojnë ekzistencën e detyrimeve të të dënuarit për arsimin, kualifikimin a aftësimin e tij profesional, do të duhet që në analizë edhe me rrethanat e tjera ekonomike, sociale dhe familjare të të dënuarit, që tregojnë për rëndësinë e përmbushjes së këtyre detyrimeve, të arrijë në një konkluzion të drejtë lidhur me dobinë e aplikimit të gjysmëlirisë.

Nga rastet objekt studimi nuk është konstatuar aplikimi i gjysmëlirisë për shkak të nevojës së të dënuarit për arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor. Kryesisht, gjykatat në aplikimin e gjysmëlirisë mbështeten në rrezikshmërinë e ulët të veprës penale dhe të të pandehurit, si dhe rrethanat familjare dhe ekonomike.

5.2.3 Përgjegjësitë thelbësore familjare të të dënuarit

Detyrimet që burojnë nga e drejta familjare dhe posaçërisht "përgjegjësitë thelbësore" të të dënuarit, përligjin aplikimin e gjysmëlirisë. Janë disa detyrime familjare që burojnë nga ligji (Kodi i Familjes) dhe që garantojnë bazën e familjes, sikurse janë detyrimet midis bashkëshortëve dhe ato midis prindërve dhe fëmijëve. Duke qenë se në parim, çdo i dënuar me burgim mund të ketë një familje dhe për rrjedhojë ai mbart detyrime karshi saj, vetëm ekzistenca e këtyre detyrimeve, nuk mund të përbëjë shkak për të alternuar dënimin me burgim, me gjysmëlirinë. Fjalët e përzgjedhura nga ligjvënësi në togfjalëshin "përgjegjësitë thelbësore", tregojnë për qëllimin e përcaktimit të detyrimeve të veçanta, që janë thelbësore për vetë familjen ose pjesëtarët e saj. Mungesa e familjarit të dënuar me burgim, pavarësisht se bën të pamundur përmbushjen e detyrimeve familjare të tij që kërkojnë prezencën dhe angazhimin në veprimtari të caktuara, përbën një kufizim të arsyeshëm të të drejtave dhe pritshmërive të ligjshme të familjarëve. Kjo do të thotë se synimi i dispozitës konsiston në sigurimin e përmbushjes të atyre detyrimeve, që përbëjnë përgjegjësi thelbësore familjare. Këtu vlejnë të përmenden detyrimet prindërore ndaj fëmijëve dhe marrja e vendimeve në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Nëse rrethanat e çështjes konkrete, sjellin përpara gjykatës nevojën për të balancuar qëllimin për ekzekutimin e një dënimi me burgim, me të drejtat e të tretëve (familjarëve) që varen nga përmbushja e përgjegjësive thelbësore të të dënuarit, kjo analizë duhet të mbështetet në faktet konkrete të vërtetuara në gjykim.

Nga studimi i praktikës gjyqësore, numri i kufizuar i aplikimit të kësaj alternative identifikon si rrethanë justifikuese, qenien e të dënuarit si kryefamiljar, pasjen e fëmijëve të mitur dhe nevojën për të punuar e për të siguruar për ta ushqimin dhe nevojat për jetesë[4]. Po ashtu, konstatohet se në mbështetje të aplikimit të alternativës së dënimit me burgim, gjykata evidenton edhe rrethana të tjera, për të cilat i dënuari duhet të jetë në gjysmëliri, duke iu dhënë mundësia për të realizuar të ardhura që do të ndihmonin edhe në riparimin e pasojave të veprës penale, për të cilën është dënuar (i tillë është rasti kur gjykata vlerësoi se realizimi i të ardhurave, do të krijonte mundësinë për të dënuarin që të shlyente edhe detyrimin për energjinë elektrike të vjedhur, për çka ai u dënua). Ndonëse rrethanat e evidentuara nga gjykata mund të qëndrojnë, sikurse nuk mund të

[4] *Shih vendimin nr. 607, datë 02.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe vendimin nr. 1343, datë 03.05.2018, të po kësaj gjykate.*

kundërshtohet arsyetimi mbi dobitë që sjell për të dënuarin gjysmëliria, vlen të evidentohet se aplikimi i saj lidhet ngushtësisht me rrethanat e përcaktuara në nenin 58 dhe që konsiderohen se e justifikojnë atë ligjërisht.

Po ashtu, edhe në këndvështrim të përgjegjësive familjare të të pandehurit, një rol të rëndësishëm luajnë rrethana të tilla si: kujdesi për fëmijë të mitur apo persona të paaftë apo në gjendje shëndetësore të keqe në ngarkim, pamundësia e familjarëve të tjerë për përkujdesje, rëndësia e të ardhurave nga punësimi i të pandehurit për jetesën e familjes, etj. Ndërkohë, *në vendimet gjyqësore konstatohen formulime standar*de, si qenia kryefamiljar dhe me fëmijë. Këto rrethana janë pasqyruar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk janë analizuar në mënyrë të veçantë në raport me detyrimet e të pandehurit dhe për rrjedhim kohës së qëndrimit në institucion. Prandaj, është e rëndësishme që rrethana të tilla jo thjesht të citohen në vendimin gjyqësor, por edhe të analizohen në raport me detyrimet dhe nevojat e të dënuarit për përmbushjen e kësaj përgjegjësie.

5.2.4 Nevoja për trajtim ose rehabilitim mjekësor

Neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njeh të drejtën e shtetasve për kujdes shëndetësor, ndërsa në nenin 59, standardi më i lartë shëndetësor, fizik e mendor, i mundshëm, përbën një nga objektivat socialë të shtetit shqiptar, krahas objektivti për riaftësimin shëndetësor dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve. E drejta për shëndet gëzon mbrojtje edhe nga neni 25 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut[5], si dhe neni 12 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR)[6]. Kjo e drejtë, në vetvete shihet e lidhur ngushtë edhe me gëzimin e të drejtave të tjera themelore, ndaj shteti ka detyrimin pozitiv që ta garantojë atë. Për të garantuar të drejtën për shëndet, individi duhet të jetë në gjendje që të përfitojë nga të gjitha terapitë dhe trajtimet shkencore mjekësore, për t'u kuruar apo për të përmirësuar gjendjen e tij shëndetësore.

[5] *Çdokush ka të drejtë për një nivel jetese që siguron shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale …*

[6] *1. Shtetet palë të këtij Pakti e njohin të drejtën e çdo personi për të gëzuar standardin sa më të lartë të gjendjes shëndetësore fizike dhe mentale. 2. Masat që Shtetet palë të këtij Pakti duhet t'i marrin për të siguruar ushtrimin e plotë të kësaj të drejte, duke përfshirë ato masa të cilat janë të domosdoshme për të siguruar: a. Zvogëlimin e vdekshmërisë te të porsalindurit dhe vdekshmërinë e foshnjeve, si dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës; b. Përmirësimin e të gjitha aspekteve të higjienës së mjedisit dhe të higjienës industriale; c. Parandalimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe sëmundjeve të tjera; d. Krijimin e kushteve të cilat në rast të sëmundjeve do t'u siguronin të gjithëve shërbime mjekësore dhe përkujdesje mjekësore.*

Në këtë këndvështrim, gjysmëliria si alternativë e dënimit me burgim shihet e mirëpritur, nëse aplikohet në rastet kur i dënuari ndjek një program rehabilitimi apo trajtimi mjekësor, që është i vështirë apo edhe i pamundur të realizohet në kushtet e izolimit total të institucionit të vuajtjes së dënimit. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për trajtimin bazë shëndetësor, që sigurisht është i detyrueshëm të ofrohet dhe sigurohet nga shteti edhe për kategorinë e të burgosurve, por për trajtime specifike, të veçanta, që objektivisht nuk mund të merren brenda institucioneve të vuajtjes së dënimit (qoftë kjo edhe për arsye financiare, sepse shërbime të kushtueshme shëndetësore nuk mund të përfshihen në detyrimin pozitiv të shtetit për garantimin e së drejtës për shëndet). Edhe në këtë rast, gjykata duhet të balancojë të drejtën e të dënuarit për të marrë trajtim mjekësor apo rehabilitues, me të drejtat e të tjerëve që garantohen nga e drejta e penale dhe për mbrojtjen e të cilave u dha dënimi penal. Për shembull, nëse i dënuari ka filluar apo është e sigurt se do të fillojë një program individual të rehabilitimit të tij si përdorues i drogave me karrierë, do të ishte e dobishme për shoqërinë, që ai të rehabilitohej, sidomos nëse vepra penale e kryer, ndikohet direkt ose indirekt nga të qenit përdorues i drogave.

5.3 Periudha kohore e qëndrimit në IEVP

Në nenin 58 të Kodit Penal, nuk parashikohet një periudhë kohore e caktuar e qëndrimit të të dënuarit në institucionin e vuajtjes së dënimit. Kjo zgjedhje është plotësisht në përputhje me qëllimin e aplikimit të gjysmëlirisë dhe nevojën për përshtatjen e periudhës kohore të qëndrimit në burgim, me detyrimet e të dënuarit në kuadër të punësimit, përgjegjësive familjare apo ndjekjes së trajtimit mjekësor ose rehabilitues. Për rrjedhim, është gjyqtari, ai i cili përcakton rast pas rasti periudhën e saktë kohore të paraqitjes dhe qëndrimit të të dënuarit në institucionin e vuajtjes së dënimit, duke analizuar pikërisht nevojat konkrete të sipërcituara.

Në të gjitha rastet, gjykata ka disponuar në pjesën urdhëruese të vendimit, për detyrimin e të pandehurit që të kthehet në burg në një orar të caktuar dhe të qëndrojë aty, po ashtu, deri në një orar të caktuar. Konkretisht, në disa raste gjykata ka disponuar për qëndrimin jashtë burgut për të punuar, me qëllim kryerjen e detyrimeve thelbësore ndaj familjes, nga ora 07:00 deri në orën 20:00 dhe kthimin dhe qëndrimin në burg nga ora 20:00 deri në orën 07:00 të ditës së nesërme. Në disa raste orari i përcaktuar për vuajtjen

e dënimit me gjysmëliri dhe qëndrimin në burg, nga ora 20:00 deri në orën 08:00. Në disa raste gjykata nuk ka disponuar për urdhërime të tjera, përveç përcaktimit të orës së qëndrimit në burg.[7] Ndërsa në disa raste, gjykata ka disponuar për detyrimin e Shërbimit të Provës që të mbikqyrë detyrimet e vendosura ndaj të pandehurit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që të përcaktojë vendin ku do të vendoset i pandehuri për të vuajtur këtë dënim.[8]

5.4 Periudha kohore e vuajtjes së dënimit alternativ me gjysmëliri

Lidhur me periudhën e përgjithshme të vuajtjes së dënimit alternativ, *në disa raste gjykata shprehet vetëm duke e cilësuar "për periudhën e mbetur të dënimit", ndërsa në disa raste të tjera e cilëson shprehimisht periudhën si "periudhën e mbetur të dënimit prej 1 viti"*[9]. Në rastet kur gjykata nuk e ka përcaktuar shprehimisht periudhën e saktë të vuajtjes së dënimit alternativ, por është shprehur në dispozitiv në mënyrë të përgjithshme "për pjesën e mbetur të dënimit", dhe kur kjo nuk del as nga pjesa arsyetuese e vendimit, Shërbimi i Provës ka pasur vështirësi në ekzekutim për shkak të mospërcaktimit të saktë të periudhës kohore. Në këto raste, përcaktimi i periudhës së mbetur të dënimit të pavuajtur është bërë nga ana e IEVP, e cila ndjekdinamikën e vuajtjes së dënimit për të dënuarin. IEVP ia *dërgon informacionin*, lidhur me periudhën e saktë të dënimit të mbetur pavuajtur, Shërbimit të Provës.

5.5 Momenti i fillimit të ekzekutimit të dënimit

Gjithashtu, problematikë kryesore në praktikë përbën edhe momenti i fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ të gjysmëlirisë. Në rastet e analizuara, rezulton se ka dy qëndrime të ndryshme në praktikë. Sipas qëndrimit të parë, ekzekutimi i gjysmëlirisë fillon nga dita e nesërme e dhënies së vendimit gjyqësor të shkallës së parë.[10] Pra, fillimi i ekzekutimit

[7] *Vendim nr.3486 datë 14.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,; Vendim nr.2200 datë 20.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[8] *Vendim nr.873 regj.them nr.446 datë 20.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[9] *Vendim nr.873 regj.them nr.446 datë 20.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[10] *Praktika e IEVP Vaqarr për ekzekutimin e vendimit nr.873 regj.them nr.446 datë 20.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili rezulton i ekzekutuar të nesërmen e dhënies së vendimit në shkallë të parë, në datë 21.02.2019.*

nuk është lidhur me marrjen e vendimit gjyqësor formë të prerë. Për pasojë, vendimi i dënimit është ekzekutuar ndaj një personi që ka ende cilësinë e të pandehurit dhe nuk konsiderohet i dënuar, përsa kohë nuk ka ende në këtë moment, një vendim gjyqësor të formës së prerë për dënimin e tij. Në praktikë ka patur rast kur i pandehuri ka qënë në paraburgim, dhe në datën e dhënies së vendimit të dënimit me gjysmëliri nga gjykata e shkallës së parë, vendimi është bërë menjëherë i ekzekutueshëm, duke u kaluar kështu i pandehuri nga paraburgimi në regjimin e hapur gjysmëliri.

Ndërsa sipas qëndrimit të dytë të mbajtur në praktikë, rezulton se është urdhëruar fillimi i ekzekutimit të dënimit pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë.[11]

Ndryshe nga formulimi në nenin 59/4 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim se "*Afati i provës fillon, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim.*", në nenin 58 të Kodit Penal nuk ka asnjë formulim të tillë. Po ashtu sipas nenit 21 të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", shtuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018, "Ekzekutimi i menjëhershëm", ndryshe nga pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, vendimi për gjysmëlirinë nuk është me ekzekutim të menjëhershëm. Konkretisht, dispozita parashikon se "*ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit, vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurim me arrest për shkak tjetër, si dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë*". Vendimi për aplikimin e gjysmëlirisë, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e përcaktuara në këtë dispozitë.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet parashikimi në nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale "Vendimet e ekzekutueshme" (Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017), që parashikon se: "*1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë. 2. Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes…*". Në referim të përmbajtjes së dispozitës, vendimi për caktimin e dënimit alternativ, sipas nenit 58 të

[11] *Praktika e IEVP Vaqarr për ekzekutimin e vendimit nr.2200 datë 20.07.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.510 datë 08.04.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Vendimit nr.3486 datë 14.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Kodit Penal, nuk mund të konsiderohet as vendim pafajësie dhe as vendim për pushimin e çështjes. Për rrjedhim, çështja e diskutueshme është nëse vendimi për gjysmëlirinë do të konsiderohet ose jo si vendim që e përjashton të gjykuarin nga dënimi. Ky vendim në thelb nuk e përjashton të gjykuarin nga dënimi, përkundrazi përbën një vendim dënimi (formë e veçantë e ekzekutimit të dënimit), duke qenë se vetëm e përjashton të gjykuarin nga qëndrimi gjithë kohën në institucionin e vuajtjes së dënimit me burgim.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet edhe përcaktimi sipas vendimit unifikues nr.2 datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë sipas të cilit: "*Prandaj, ekzekutueshmëria nuk mund të identifikohet plotësisht me të qenit final dhe për këtë arsye u konsiderua e domosdoshme që të përcaktohej karakteri i ekzekutueshëm i një vendimi si një kusht tjetër i ndarë nga të tjerët. ...Në legjislacionin procedural penal Shqiptar, me shprehjen "vendim i formës së prerë" do të kuptohet, sipas rastit, vendim që ka marrë formën e "gjësë së gjykuar", ose "vendim i ekzekutueshëm". Siç u sqarua në arsyetimin e mësipërm, vendimi i gjykatës së apelit, ndonëse nuk ka marrë ende statusin e "gjësë së gjykuar" është menjëherë i ekzekutueshëm. Kjo kuptohet edhe nga përmbajtja e nenit 417 të K.Pr.Penale (Pezullimi i ekzekutimit), i cili parashikon se "ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit*". Në përputhje me këtë përcaktim unifikues, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për aplikimin e dënimit të alternativ, nuk është as vendim i ekzekutueshëm dhe as nuk ka marrë formën e "gjësë së gjykuar", të nesërmen e shpalljes së tij.

Vendimi për gjysmëlirinë passjell rifitimin e lirisë personale të të pandehurit, vetëm në rast se ndaj tij është në fuqi, në momentin e shpalljes së vendimit, masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" (dhe në rastin e fundit me përkeqësim të pjessshëm të situatës). Në rastet e tjera, jemi para cënimit të lirisë së të pandehurit me vendim gjyqësor dënimi, që nuk është i formës së prerë.

Në këtë kuptim, qëndrimi i parë i mbajtur në praktikën gjyqësore duket se vjen në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë të garantuar në nenin 4 të K.Pr.Penale sipas të cilit: "*1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë*". Kjo, për arsye se, ndërkohë që i pandehuri prezumohet ende i pafajshëm, ndaj tij ekzekutohet një dënim i dhënë nga gjykata e shkallës së parë, pa marrë formën e prerë. Pra, për rrjedhim i pandehuri vuan një dënim penal edhe pse nuk konsiderohet i dënuar.

Gjithsesi, në praktikën gjyqësore nuk është konstatuar asnjë rast i aplikimit dhe ekzekutimit të gjysmëlirisë në bazë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe prishja më pas e këtij vendimi nga gjykata e apelit. Por, në rastin hipotetik të prishjes së një vendimi gjyqësor që ka aplikuar gjysmëlirinë dhe është ekzekutuar ndërkohë, jemi përpara cënimit të të drejtës për liri dhe siguri të të pandehurit. Mbajtja e qëndrimit të parë në praktikën gjyqësore passjell problematikë të theksuar. Kjo për arsye se i pandehuri vuan ndërkohë një dënim, pa qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prishja e vendimit gjyqësor të gjysmëlirisë nga gjykata e apelit, legjitimon të pandehurin të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar për shkak të vuajtjes së dënimit. Por, edhe në këtë aspekt rezulton një tjetër problematikë, duke qenë se ligji nr.9381, datë 28.04.2005, "Për kompensimin e burgimit të padrejtë", parashikon vetëm rastet e përfitimit të kompensimit për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi. Edhe pse ligji parashikon kompensimin për burgimin e padrejtë duke përcaktuar vlerën për ditë burgimi, në rastin konkret jemi përpara qëndrimit në orare të caktuara në IEVP dhe kufizimeve më të rënda në aspektin e kompensimit sesa reduktimi i vlerës në përpjestim me kohën e qëndrimit. Ky ligj nuk parashikon kompensim për rastin e detyrimeve apo kufizimeve të lindura si rezultat i dënimeve alternative. Edhe në nenin 57 të Kodit Penal nuk parashikohet periudha e provës, pavarësisht kufizimeve dhe detyrimeve që ajo sjell. Për rrjedhim, personat që deklarohen të pafajshëm me vendim gjyqësor të gjykatës së apelit, apo për të cilët caktohet një dënim tjetër i ndryshëm nga dënimi alternativ i ekzekutuar, nuk mund të përfitojnë kompensim sipas këtij ligji, megjithëse kanë pësuar kufizime.

Në praktikë, në rastin kur gjykata e apelit vendos lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për aplikimin e gjysmëlirisë dhe dënimi është ekzekutuar ndërkohë, konsiderohet për rrjedhim, si dënim i vuajtur. Pra, konsiderohet se i dënuari ka filluar vuajtjen e dënimit që në momentin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë edhe pse ky vendim nuk kishte marrë ende formë të prerë. Në këtë rast nuk mund të mos merret parasysh vuajtja faktike e dënimit me gjysmëliri nga i pandehuri, për efekt të llogaritjes së vuajtjes së dënimit të dhënë tashmë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga gjykata e apelit. Por, gjithsesi edhe ky qëndrim vjen në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe cënon të drejtën për liri dhe siguri, të garantuar nga nenet 5 dhe 6/2 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

5.6 Aplikimi i gjysmëlirisë si zëvendësim i dënimit të dhënë

Në një rast[12], gjysmëliria nuk është vendosur nga gjykata gjatë procesit gjyqësor për deklarimin fajtor të të pandehurit dhe caktimit të llojit të dënimit ndaj tij, por si masë e aplikuar pas revokimit të vendimit të pezullimit të dënimit me burgim, për shkak të shkeljes së detyrimeve nga ana e të dënuarit gjatë periudhës së provës. Kjo në referim të nenit 62 të Kodit Penal që parashikon se: "*Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit. Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit. Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg*". Në parim, zëvendësimi i një dënimi alternativ me një dënim tjetër për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve gjatë periudhës së provës, është në përputhje me standardet ndërkombëtare, Rekomandimin nr.(2017)3 Kapitulli 1, pika 12, *që përcakton se ligji nuk duhet të përmbajë konvertimin automatik të dënimit alternativ, në dënim me burgim në rast të mospërmbushjes së ndonjë detyrimi apo kushti. Në varësi të ligjit të brendshëm dhe rrethanave të çështjes, autoriteti vendimarrës mund të disponojë për zgjatjen e afatit të dënimit alternativ, aplikimin e një dënimi tjetër alternativ dhe vetëm si zgjidhje të fundit dënimin me burgim.* Gjysmëliria sjell efekte më të rënda dhe kufizime më të mëdha për të dënuarin, *në krahasim me efektet dhe kufizimet që sjellin dënimet e tjera alternative, e në veç*anti pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim apo kryerja e një pune në interes publik. Për rrjedhim, *në rast të mospërmbushjes së detyrimeve apo kushteve gjatë periudhës së provës, sipas nenit 59 apo 63 të Kodit Penal, gjykata mund të vendosë në varësi të rrethanave zëv*endësimin e dënimit alternativ me atë të gjysmëlirisë, në mënyrë që vetëm si zgjidhje e fundit të aplikohet revokimi i pezullimit dhe vuajtja e pjesës së mbetur të dënimit me burgim.

[12] *Vendim nr.136, akti datë 18.06.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Konkretisht, me vendimin penal të formës së prerë nr.4556 datë 21.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi është deklaruar fajtor dhe dënuar me një vit burgim i pandehuri A.T, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e të pandehurit për një periudhë kohore 2 vjet. Gjatë periudhës së provës është konstatuar nga raporti i Shërbimit të Provës se i pandehuri në një datë të caktuar ka ndërprerë çdo kontakt me Shërbimin e Provës. Për rrjedhim, prokurori dhe gjykata kanë vlerësuar se i pandehuri nuk ka përmbushur detyrimet e caktuara nga gjykata për të mbajtur kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit *të Provës Tiranë, megjithëse ka patur dijeni për këtë detyrim. Për rrjedhim, prokurori i është drejtuar me kërkesë gjykatës për revokimin e vendimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Për më tepër gjatë gjykimit ka rezultuar se i pandehuri nuk e ka zbatuar vendimin gjyqësor për shkak të dënimit dhe vuajtjes së dënimit për një vepër tjetër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.136 akti datë 18.06.2019 ka vendosur të pranojë vetëm pjesërisht kërkesën e Prokurorisë duke revokuar vendimin e pezullimit sipas nenit 59 të Kodit Penal*, duke disponuar për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit për të dënuarin në gjysmëliri. Edhe pse në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor citohet përmbajtja e nenit 58 të Kodit Penal, nuk analizohet plotësimi i kushteve të kësaj dispozite në raport me rrethanat e të dënuarit. Gjithashtu nuk është arsyetuar se përse zëvendësimi i dënimit të dhënë sipas 59 të Kodit Penal me aplikimin e dënimit tjetër alternativ sipas nenit 58 të Kodit Penal, është disponimi më i përshtatshëm në raport me masat e tjera të parashikuara nga neni 62 i Kodit Penal. Të tilla janë, ndryshimi ose shtimi i detyrimeve të tjera, zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, zëvendësimi i tyre me një sanksion tjetër, ose revokimi i vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtja e pjesës së mbetur të dënimit në burg.

6. ASPEKTET PROCEDURALE TË GJYKIMIT

Gjysmëliria, në ndryshim nga lirimi me kusht (neni 64 i Kodit Penal) dhe qëndrimi në shtëpi (neni 59/a i Kodit Penal), zbatohet krahas caktimit të dënimit kryesor në momentin kur gjykata shpall vendimin përfundimtar të dënimit. Nga vetë formulimi i dispozitës, por edhe nga masa relativisht e ulët e dënimit me burgim, ligji shqiptar, nuk parashikon mundësinë e një kërkese të të dënuarit, për të përfituar këtë alternativë të dënimit gjatë fazës së

ekzekutimit të dënimit penal (një mundësi e tillë parashikohet për shembull nga ligji francez). Ky dënim alternativ, si rregull, nuk zbatohet gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit me burgim. Për rrjedhim rregullat procedurale për kompetencën e gjykatës, ritin e gjykimit dhe vendimmarrjen e gjykatës nga ana procedurale, përcaktohen në rregullimet ligjore që normojnë fazën e gjykimit dhe atë të rigjykimit. Nuk janë të aplikueshme në këtë rast, dispozitat që normojnë fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kompozimi i trupit gjykues dhe kompetenca përcaktohet në rregullimet ligjore që normojnë fazën e gjykimit dhe atë të rigjykimit në nenet 13, 74, 75/a dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale. Kompozimi i trupit gjykues përcaktohet sipas rregullit në nenin 13/3 të Kodit të Procedurës Penale, në varësi të dënimit të parashikuar për veprën penale. Kompetenca lëndore për gjykimin e çështjes i takon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, kur vepra penale nuk përfshihet në kompetencën lëndore të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Rregullat për përcaktimin e kompetencës tokësore për gjykimin e çështjes, duke filluar nga vendi ku është kryer vepra penale, parashikohen në nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata aplikon gjysmëlirinë si dënim alternativ edhe kryesisht, pa kërkesë të palëve, në rast se vlerëson se plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 58 të Kodit Penal. I pandehuri mund të kërkojë aplikimin e gjysmëlirisë si dënim alternativ gjatë gjithë gjykimit, deri në deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor. Kërkesa e të pandehurit nuk është kusht i domosdoshëm për aplikimin e gjysmëlirisë. Por nga ana tjetër, paraqitja e rrethanave dhe akteve provuese për nevojat dhe detyrimet e të pandehurit (për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare, apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor), është shumë e rëndësishme për vendimarrjen e gjykatës. Gjithsesi, gykata mund të aplikojë gjysmëlirinë edhe në rastin kur i pandehuri nuk e kërkon apo mban qëndrim mohues lidhur me veprën penale, por nga provat vlerësohet se plotësohen kushtet e nenit 58 të Kodit Penal.

Gjykata me vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor të të pandehurit, me caktimin e dënimit deri në një vit burgim, disponon për gjysmëlirinë. Gjykata në këtë disponim përcakton periudhën kohore gjatë së cilës personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, si dhe detyrimet konkrete jashtë burgut. Mosaplikimi i nenit 58 të Kodit Penal nga ana e gjykatës, përbën motiv për të paraqitur ankim kundër vendimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit.

Ekziston një përjashtim, kur gjysmëliria mund të vendoset në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Konkretisht në një rast[13], gjysmëliria nuk është vendosur nga gjykata gjatë procesit gjyqësor për deklarimin fajtor të të pandehurit dhe caktimit të llojit të dënimit ndaj tij, por si masë e aplikuar pas revokimit të vendimit të pezullimit të dënimit me burgim, për shkak të shkeljes së detyrimeve nga ana e të dënuarit gjatë periudhës së provës. Kjo në referim të nenit 62 të Kodit Penal, *që parashikon se "nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër.*". Neni 13, pika 2, shkronja "dh" e Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar përbërje monokratike të çdo gjykimi në fazën e ekzekutimit të dënimit penal. Për rrjedhim, kjo përbërje aplikohet për kompozimin e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër (në këtë rast gjysmëlirinë). Kjo do të thotë se trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës do të jetë me një gjyqtar, pavarësisht sanksionit të dhënë nga gjykata në vendimin e dënimit me burgim.

Për kompetencën tokësore aplikohet neni 470 i K.pr.Penale, që parashikon se: "*Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.*". Dispozitat e ligjit nr. 8331/1998, nuk kanë përcaktuar rregulla për kompetencën tokësore dhe funksionale për gjykimin e kërkesës penale të mësipërme.

Kërkesa për zëvendësimin e dënimit të parë alternativ me një dënim tjetër (në këtë rast gjysmëlirinë), paraqitet nga prokurori, duke qenë se ky dënim alternativ është më i rëndë në raport me dënimet e tjera alternative, por mund të vendoset edhe kryesisht nga gjykata, në rastin kur prokurori ka kërkuar revokimin e pezullimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burgim, dhe kjo e fundit vlerësohet si e papërshtatshme.

7. EKZEKUTIMI I DËNIMIT ALTERNATIV

7.1.1 Vendi i vuajtjes së dënimit me gjysmëliri

Në praktikë, vuajtja e dënimit gjatë kohës që i dënuari duhet të qëndrojë në institucion, kërkon pasjen e qendrave, sektorëve apo ambienteve të veçantë, në mënyrë që një i dënuar me gjysmëliri të mos qëndrojë me të dënuar të tjerë me burgim. Një nga problematikat e hasura në praktikë

[13] *Vendim nr.136, akti datë 18.06.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

gjatë aplikimit të gjysmëlirisë si dënim alternativ, lidhet me përcaktimin e Institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, në të cilin do të vuhet dënimi. Konkretisht, me Urdhrin nr. 8927/1, datë 27.09.2018, të Ministrit të Drejtësisë është përcaktuar Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr, si i vetmi institucion i klasifikuar me seksion burg i hapur për të dënuarit me vendim gjykate (gjysmëliri). Ky urdhër ka hyrë në fuqi menjëherë dhe ka qenë i zbatueshëm prej datës 27.09.2018. Për rrjedhim, në bazë të këtij urdhri në asnjë institucion tjetër të vuajtjes së dënimeve penale nuk është e mundur të zbatohet dhe kryhet dënimi alternativ me gjysmëliri. Përveçse i vetmi insitucion i përcaktuar sipas kategorisë burg i hapur, sipas një rekomandimi të Avokatit të Popullit, pas inspektimit të kryer për vitin 2018, konstatohet mbipopullim i tij me kategori të tjera (të dënuar dhe të paraburgosur).[14]

Kjo në realitet përkthehet në inefektivitet të parashikimit ligjor, për shkak të vështirësisë dhe pamundësisë praktike, në zbatimin me korrektësi të këtij dënimi alternativ në të gjitha rastet kur plotësohen kushtet për caktimin e tij. Kështu për shembull në drejtim të respektimit të orareve të paraqitjes në IEVP, veçanërisht, për të dënuar që kanë vendbanimin dhe punën në një qytet të largët si Korçë, Tropojë etj., përveç kohës për udhëtim, problematikë përbëjnë edhe shpenzimet e shtuara për vuajtjen e këtij dënimi. Problematika theksohet më tej në rastin e nevojës për trajtim apo rehabilitim mjekësor, apo të përmbushjes së përgjegjësive thelbësore familjare, duke ardhur kështu në një situatë që bie ndesh me vetë qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e kësaj alternative. Për vetë natyrën dhe qëllimin e këtij dënimi alternativ është e domosdoshme që vuajtja e dënimit me gjysmëliri të kryhet sa më afër vendbanimit, vendit të punës apo atij të trajtimit mjekësor/rehabilitues të të dënuarit. Në rastet kur vendbanimi i të dënuarit është shumë larg Tiranës, ky dënim alternativ e humb tërësisht qëllimin e aplikimit të tij.

Në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, në nenin 29 parashikohet shprehimisht se: "*Administrata e burgjeve dhe shërbimi i provës, në bazë të vendit të kryerjes së detyrimeve nga personi i dënuar, përcakton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri, bazuar në detyrimet që ai duhet të përmbushë*". Pra sipas ligjit, është administrata e burgjeve dhe Shërbimi i Provës që përcaktojnë institucionin

[14] *Shih Rekomandim për inspektimin e kryer në IEVP Vaqarr, Tiranë në www.avokatipopullit.gov.al.*

e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri. Ky përcaktim bëhet rast pas rasti dhe *në bazë të vendit të kryerjes së detyrimeve nga personi i dënuar* si dhe *bazuar në detyrimet që ai duhet të përmbushë*. Kjo nënkupton se ligjvënësi ka synuar ngritjen dhe ekzistencën e disa institucioneve të vuajtjes së këtij dënimi alternativ, në mënyrë që të sigurohet afërsia me vendbanimin e të dënuarve, dhe për rrjedhim përmbushja e detyrimeve për punën, arsimin, trajtimin apo rehabilitimin mjekësor apo për përgjegjësinë familjare.

Krahasuar me këtë objektiv ligjor, dukshëm institucionet kanë dështuar në krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ta bërë efektive alternativën e dënimit me burgim, për të gjithë të dënuarit në Republikën e Shqipërisë, që plotësojnë kushtet për të përfituar nga ligji.

7.1.2 Regjistrimi i pranimit të të dënuarve me gjysmëliri në IEVP

Problematikë gjatë zbatimit të gjysmëlirisë ka pasur edhe përsa i përket mënyrës së regjistrimit të të dënuarit në IEVP, duke qenë se nuk ka rregulla të posaçme të përcaktuara për këtë dënim alternativ në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Sipas rregullores, institucioni ku kryejnë dënimin personat e dënuar me gjysmëliri, cilësohet si "regjim i hapur". E vetmja dispozitë që parashikon kushtet dhe rregullat e pranimit të të dënuarve, është neni 10 i Rregullores[15] që parashikon rregulla tërësisht të aplikueshme vetëm për ekzekutimin e dënimit me burgim. Ndërsa, përsa i përket ekzekutimit të dënimit alternativ të gjysmëlirisë nuk ka një parashikim

[15] *Neni 10, "Kushtet e pranimit të të dënuarve": "1. Pranimi i të dënuarve në IEVP bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, pasi të jetë lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin e gjykatës. 2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin e pranimit brenda një afati prej 3 ditësh, nga dita e ardhjes së urdhrit të ekzekutimit për vendimin e gjykatës. 3. I dënuari duhet të jetë i shoqëruar me dosjen e tij personale, e cila përmban:*

a) vendimin e formës së prerë të gjykatës që cakton dënimin me burgim;
b) urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e këtij vendimi;
c) vendimin e arrestit;
ç) procesverbalin e ndalimit;
d) procesverbalin e kontrollit personal;
dh) formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
e) kartelën personale të të dënuarit;
ë) kartelën e gjendjes shëndetësore;
f) dosjen psiko-sociale (për transferimet nga një IEVP në një IEVP tjetër);

4. Kur mungon urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm dhe dokumentet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c","ç", "d" dhe "dh", të këtij neni, IEVP-ja nuk e pranon të dënuarin. Në rast se mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjat e tjera të këtij neni, i dënuari mund të pranohet në IEVP. Institucioni duhet të marrë masat për plotësimin e dosjes personale të të dënuarit me dokumentet që mungojnë brenda një afati prej 15 ditësh nga data e pranimit të tij.

të posaçëm. Për rrjedhim, disa nga rregullat e parashikuara nuk janë të zbatueshme për gjysmëlirinë.

Aktet e përcaktuara në nenin 10 të Rregullores për pranimin në IEVP të të dënuarit janë: *vendimi i formës së prerë, urdhri i ekzekutimit; procesverbali i arrestit; procesverbali i kontrollit personal; formulari i identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve, kartela shëndetësore, procesverbali i dorëzimit (marrjes në dorëzim).* Nga këto akte që kërkohen sipas rregullores për pranimin e të dënuarit, disa janë të papërshtatshme dhe mungojnë për gjysmëlirinë si: *vendimi i arrestit; procesverbali i ndalimit; procesverbali i kontrollit personal; dhe formulari i identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve.* Vendim arresti dhe procesverbal ndalimi nuk ka në rastin e gjysmëlirisë. Edhe procesverbali i kontrollit personal është një akt procedural që nuk kryhet nga punonjësit e IEVP, por nga ana e punonjësve të Komisariatit të Policisë. Edhe aktet e tjera, formulari i identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve, nuk mund të kryhen në IEVP por vetëm në Komisariatin e Policisë. Ndërkohë mungesa e disa prej këtyre akteve, ka si pasojë mospranimin e të dënuarit në IEVP. Nga praktikat e IEVP Vaqarr, rezulton se janë pjesë e dosjes së të dënuarit procesverbali i arrestit dhe ndalimit, të mbajtura nga punonjësit e Komisariatit të Policisë. Këto akte duket se janë kryer me qëllim të vetëm respektimin e rregullit formal të përcaktuar në nenin 10 të Rregullores. Në këto raste është proceduar me arrestimin, ndalimin apo mbajtjen e procesverbalit të ekzekutimit të vendimit penal nga ana e Komisariatit të Policisë dhe më pas është proceduar me transferimin e të dënuarit në IEVP Vaqarr, së bashku me dosjen e të dënuarit ku përfshihen aktet e mësipërme. Nëpërmjet kryerjes së kësaj procedure është realizuar edhe identifikimi i personit të dënuar sipas përcaktimeve të rregullores, duke proceduar me marrjen e gjurmëve të gishtave.

Mungesa e rregullimit të posaçëm për gjysmëlirinë në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ka sjellë vështirësi në pranimin e të dënuarve me gjysmëliri në IEVP. Në praktikën e IEVP Vaqarr ka patur raste, në të cilat nuk është bërë i mundur ekzekutimi i gjysmëlirisë, për arsye se nga ana e prokurorit është ngarkuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, duke mos përfshirë Drejtorinë e Policisë respektive. Mospërfshirja në ekzekutim e Drejtorisë së Policisë e bën vendimin e paekzekutueshëm, pasi bëhet i pamundur plotësimi i dosjes penale sipas parashikimit të nenit 10 të Rregullores së Përgjithshme

të Burgjeve. Kjo për arsye se Drejtoria e Policisë është i vetmi autoritet që bën të mundur formularin e gjurmëve të gishtave, procesverbalin e arrestit mbi ekzekutimin e vendimt penal, procesverbalin e kontrollit, kartelën shëndetësore si dhe procesverbalin e dorëzimit.

7.1.3 Të drejtat dhe detyrat e të dënuarve gjatë qëndrimit në IEVP

Në kuadër të zbatimit në praktikë të dënimit alternativ të gjysmëlirisë, vlen të theksohet se në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, nuk ka gjithashtu një dispozitë të posaçme për gjysmëlirinë. Pra, nuk ka rregulla të parashikuara posaçërisht për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me gjysmëliri. Për rrjedhim, mbeten të aplikueshme dispozitat e përgjithshme për aq sa ato janë të zbatueshme.

Një nga dispozitat që aplikohet në këtë rast nga institucionet e vuajtjes së dënimit është neni 67 për lirimin e të dënuarve, i cili përcakton lirimin e të dënuarve kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim dhe detyrat e institucionit përkundrejt të liruarit, në rastet e pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, për pajisjen me dokumentacion, etj.

Në aspektin e gëzimit të të drejtave të të dënuarve me burgim sipas ligjit nr.8328, datë 16.04.1998, lind pyetja nëse i dënuari me gjysmëliri mund të përfitojë të njëjtat të drejta, si për shembull ulje dënimi sipas nenit të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar (por në raport me kohën e vuajtur të dënimit)? Apo për shkak të kohës së vuajtjes të dënimit që është deri në një vit burgim, dhe vuajtjes së dënimit me gjysmëliri, e drejta për ulje dënimi nuk është e aplikueshme? Në praktikën gjyqësore nuk ka patur raste të paraqitjes së kërkesave për ulje dënimi nga të dënuarit me gjysmëliri.

Sa më sipër, duke pasur parasysh edhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, lidhur me të drejtat, detyrat dhe edukimin e të dënuarve me qëllim rehabilitimi, duket se kjo është e pamundur apo praktikisht e vështirë të aplikohet në rastet e gjysmëlirisë. Kryesisht kjo vjen për shkak të orarit të caktuar nga gjykata për qëndrimin në burg, përgjithësisht nga ora 20:00 deri në orën 07:00 ose 08:00 të ditës së nesërme. Në këtë orar të hyrjes dhe qëndrimit të të dënuarit në IEVP, nuk ka personel të tillë si edukatorë, etj.; për rrjedhim nuk kryhet në praktikë në mënyrë efektive njohja e të dënuarit me rregullat dhe detyrat e tij gjatë qëndrimit në IEVP dhe rehabilitimi në aspektin edukativ, si një

nga qëllimet e dënimit penal. Për shembull, e nevojshme do të ishte njohja me të drejtat dhe detyrat kryesore për hyrjen dhe qëndrimin në institucion, veçanërisht me letër me shkrim të të drejtave. Në të njëjtën kohë, edhe në mënyrë verbale, i dënuari duhet të njihet me disa nga rregullat apo detyrat, si p.sh. mosparaqitja e tij në institucion në gjendje të dehur etj. Kjo praktikë do të evitonte problematikat e lindura në rast të një eventualiteti të tillë dhe do të përkufizonte qëndrimin konkret që duhet të mbahet nga ana e institucionit.

Ndërkohë, ajo që konstatohet nga praktikat e IEVP është njohja e të dënuarit me letrën e të drejtave të personit nën hetim. Ky dokument është gjetur në dosjen penale të të dënuarit, kur në fillim ka pasur statusin e të paraburgosurit. Edhe pas dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, letra e të drejtave ka qenë në dosjen penale që në momentin e arrestimit si i dyshuar për kryerjen e veprës penale. Kjo praktikë është tërësisht formale, jo efektive, dhe nuk i shërben qëllimit të aplikimit të dënimit alternativ të gjysmëlirisë.

Në Projektligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", në nenin 21 parashikohet se institucioni i hapur është institucioni ku ekzekutohen dënimet ndaj të dënuarve me gjysmëliri. Në nenin 52, të ligjit "Normat e sjelljes së të paraburgosurve dhe të dënuarve", parashikohet se me rastin e pranimit në institucion dhe gjatë vuajtjes së dënimit, të paraburgosurit dhe të dënuarit janë të detyruar të njohin dhe të respektojnë rregullat e brendshme, dispozitat që lidhen me të drejtat dhe detyrat e tyre, të trajtimit dhe të disiplinës. Për rrjedhim, për aq sa janë të zbatueshme, këto rregulla duhet të zbatohen edhe ndaj të dënuarve me gjysmëliri, edhe pse qëndrojnë në orare të caktuara në IEVP.

7.2 Mbikëqyrja e ekzekutimit të gjysmëlirisë

Në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008, janë përcaktuar rregulla të veçanta për ekzekutimin e vendimit në gjysmëliri, përkatësisht në nenin 29 dhe 30. Këto dispozita detajojnë kryesisht detyrat dhe përgjegjësitë e IEVP dhe Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të gjysmëlirisë, duke e vënë theksin më shumë kur i dënuari ndodhet jashtë IEVP-së; ose masat në rast të moskthimit në institucion.

Në praktikë nuk janë konstatuar raste të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e të dënuarit lidhur me ushtrimin e aktivitetit profesional, ndjekjen e arsimit

apo kualifikimit profesional, ushtrimin e përgjegjësisë familjare apo ndjekjen e një trajtimi mjekësor. Ndërsa janë evidentuar disa raste të mosparaqitjes në IEVP të të dënuarit, në orarin e caktuar në vendimin gjyqësor.

Përsa i përket mosparaqitjes në IEVP të të dënuarit në orarin e caktuar në vendimin gjyqësor, ka pasur diskutime dhe vështirësi në përcaktimin e pasojave. Sipas nenit 58 të Kodit Penal, personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, *është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata.* Në raste të tilla kur i dënuari nuk është paraqitur në orarin e caktuar në IEVP, nga ana e institucionit janë marrë si masa: njoftimi i prokurorit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe shërbimit të provës. Mosparaqitja në orarin e caktuar e të dënuarit për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij, a duhet të konsiderohet si "Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit". Në praktikë ka patur raste të tilla dhe megjithë diskutimet, nuk është konsideruar si "Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit"[16]. Për rrjedhim, nuk është proceduar me kryerje të veprimeve procedurale dhe referimin e veprës penale te prokurori. Ky qëndrim gjen mbështetje në nenin 58 të Kodit Penal që përcakton se: "*Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni, zbatohet neni 62 i këtij Kodi";* referenca në nenin 62[17] "Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës, përcakton se: "*Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit".*

Më tej, sipas të njëjtës dispozitë rëndësi paraqet klasifikimi apo cilësimi i shkeljes së detyrimeve, nëse do të cilësohet si shkelje e lehtë apo e rëndë. Në këtë aspekt merren parasysh arsyet dhe rrethanat e mosrespektimit të detyrimit (si largësia e vendbanimit, rrethanat familjare apo shëndetësore, si dhe rrethana të tjera), në raport me përsëritjen apo shpeshtësinë e shkeljes së detyrimeve. Neni 62 i Kodit Penal, parashikon se për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg.

---

[16] *Neni 323 i Kodit Penal, "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit": "Largimi i të ndaluarit, arrestuarit apo të dënuarit me burgim nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm ose gjatë transportimit të tij nga një vend në tjetrin, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.".*

[17] *Ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, neni 7.*

Edhe në nenin 30 të ligjit, parashikohet raportimi menjëherë prokurorit, dhe kur është e nevojshme, edhe drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi. Gjithashtu është parashikuar dhe detyrimi i drejtorit të Institucionit në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, për të informuar menjëherë prokurorin, në rast të moskthimit në institucion të të dënuarit me gjysmëliri, pas verifikimit të fakteve dhe rrethanave që lidhen me moskthimin e tij.

Nga praktika aktuale rezulton se ka pasur raste të verifikimit të shkeljeve të lehta, që janë shoqëruar me paralajmërim dhe regjistrim në dosjen personale të të dënuarit. Në asnjë rast nuk është konstatuar shkelje e rëndë dhe për rrjedhim nuk i është kërkuar gjykatës shtimi i detyrimeve të tjera, zëvendësimi me një sanksion tjetër, apo revokimi i vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg.

7.2.1 Roli i Shërbimit të Provës në ekzekutimin e gjysmëlirisë

Në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008, janë përcaktuar rregulla të veçanta për ekzekutimin e vendimit në gjysmëliri, përkatësisht në nenin 29[18] dhe 30. Ndër të tjera, në nenin 29 dhe 30 të ligjit parashikohen detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Provës si:

- hartimi i programit ditor që duhet të zbatojë personi i dënuar, për periudhën kohore që ai ndodhet jashtë institucionit;
- mbikqyrja e personit të dënuar në gjysmëliri, kur ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale;
- raportimi menjëherë prokurorit, dhe kur është e nevojshme, edhe drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi.

Neni 30[19] përcakton edhe detyrimin për drejtuesin e Institucionit, që kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në IEVP, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat për moskthimin e tij, të njoftojë menjëherë

[18] *Neni 29: "Kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorit për ekzekutim…".*

[19] *Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008, ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018.*

prokurorin dhe Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës, pasi verifikon faktet dhe rrethanat, përgatit raport vlerësimi për gjykatën dhe prokurorin.

Nga detyrat dhe përgjegjësitë, del se Shërbimi i Provës ka rol përcaktues në mbikëqyrjen e zbatimit/ekzekutimit të vendimit të dënimit alternativ me gjysmëliri. Ky rol përcaktohet më qartë në përcaktimet e Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", miratuar me vendimin nr. 302, datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave. Në kreun VII, në nenet 35 dhe 36, Rregullorja parashikon mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve me "gjysmëliri". Konkretisht, në nenin 35 parashikohet përgjegjësia e Shërbimit të Provës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që me urdhër të përbashkët të përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri. Ky parashikim është plotësisht në përputhje me ligjin nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008, nenin 29.

Rregullorja parashikon edhe dy kriteret që vlerësohen në këtë përcaktim, të cilat janë:

1. shkaku për të cilin gjykata ka caktuar masën alternative të gjysmëlirisë dhe
2. vendin ku duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut.
   Në këtë rast, Ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Drejtorit të Shërbimit të Provës, miraton modelin e urdhrit.

Shërbimi i Provës ndërton programin individual të trajtimit të të dënuarit, në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Programi individual i trajtimit të të dënuarit, diskutohet me të dënuarin dhe mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së të dënuarit. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, për qartësimin e nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetin e të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Po ashtu, Shërbimi i Provës merr parasysh edhe të dhënat personale, familjare e shoqërore, masën e dënimit. Rëndësi paraqet në këtë drejtim, që punonjësi i Shërbimit të Provës t'i paraqesë dhe shpjegojë të dënuarit, përmbajtjen e programit individual.

Në nenin 36 të Rregullores, parashikohen të gjithë elementët që duhet të përmbajë programi individual si:

a) gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës, emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;
b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave;
c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre.
ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;
d) metodat e propozuara të ndërhyrjes, për të plotësuar nevojat e identifikuara dhe për të reduktuar rrezikun;
dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit, që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes. Është e rëndësishme që mbikëqyrja të dokumentohet nga ana e Shërbimit të Provës. Kur ndodhin ndryshime që mund të ndikojnë tek nevojat dhe rreziqet e identifikuara, plani i mbikëqyrjes mund të rishikohet nëpërmjet anekseve që i shtohen atij.

Në praktikën e Shërbimit të Provës, sipas intervistave të kryera rezulton se ka pasur vështirësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me gjysmëliri. Rast i ekzekutimit të suksesshëm të gjysmëlirisë, ka qenë ai i vendimit nr.873 regj.them nr.446 datë 20.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim është ekzekutuar në mënyrë të suksesshme si përsa i përket paraqitjes dhe qëndrimit në IEVP Vaqarr, ashtu edhe përsa i përket përmbushjes së detyrimeve për të cilat është aplikuar gjysmëliria. Duke qenë se vendimi nr.446, datë 20.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dhënë për veprën penale të "Dhunës në familje", nga ana e Shërbimit të Provës është verifikuar dhe më pas konstatuar rivendosja e marrëdhënieve familjare ndërmjet bashkëshortëve. Ndërsa në raste të tjera, përsa i përket detyrimeve për të cilat është dhënë vendimi si p.sh. për arsye

pune, Shërbimi i Provës kryen verifikime dhe administron dokumentacion, si vërtetim apo kontratë pune.

Ndërsa në raste të tjera, ka patur vështirësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me gjysmëliri si përsa i përket mospërcaktimit të periudhës së mbetur të dënimit (për rrjedhim periudhës që vuhet dënimi me gjysmëliri), edhe mos dërgimit të vendimit gjyqësor pranë Shërbimit të Provës të nesërmen e shpalljes. Problematikë në këtë aspekt, përbën depozitimi me vonesë i vendimit gjyqësor pranë Shërbimit të Provës. Por, në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008 dhe me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018, në nenin 29 parashikohet se kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë shkurtimin e vendimit prokurorit për ekzekutim.

7.3 Përhapja e aplikimit të gjysmëlirisë

Në praktikën gjyqësore, rastet e aplikimit të gjysmëlirisë si dënim alternativ, janë të pakta. Gjysmëliria, sipas statistikave gjyqësore dhe Shërbimit të Provës, është një nga dënimet alternative më pak të aplikuara.

Konkretisht sipas statistikës së Shërbimit të Provës dhe Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2018, rezulton se ka pasur vetëm 14 të dënuar me gjysmëliri, që përfaqësojnë 0.04 % të të dënuarve me dënime alternative, për periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2018. Për rrjedhim, gjysmëliria është dënimi alternativ më pak i aplikuar në raport me dënimet e tjera alternative si: pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë (80.79 %); pezullimi i dënimit dhe kryerja e një pune në interes publik (13.80 %); lirimi me kusht (3.89 %); dhe qëndrimi në shtëpi (1.48 %).

Informacion statistikor për vitet 2009 – 2018:

Nr.	APLIKIMI SIPAS LLOJIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE [VITI 2009 - 2018]	Kodi Penal	Të dënuar	Të dënuar në %
1	Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në periudhë prove	Neni 59	31074	80.79
2	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e nje pune në interes publik	Neni 63	5306	13.80
3	Lirimi me kusht	Neni 64	1498	3.89
4	Qëndrimi në shtëpi	Neni 59/a	570	1.48
5	Gjysmëliria	Neni 58	14	0.04
-	Total	-	30934	100%

LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Totali
Neni 59 i KP, Pezullimi	571	1441	1616	2166	1758	3189	4798	4460	4904	6171	31074
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	6	37	68	34	36	56	92	74	85	82	570
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	76	207	206	188	146	64	84	101	172	254	1498
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	52	162	226	214	145	694	974	938	884	1017	5306
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	0	0	1	0	0	0	4	4	1	4	14
TOTALI	705	1847	2117	2602	2085	4003	5952	5577	6046	7528	38462

Informacion statistikor për periudhën janar – gusht 2019.

Lloji i dënimeve alternative	Jan '19	Shk '19	Mars '19	Pri '19	Maj '19	Qer '19	Korr '19	Gus '19	Totali 2019
Neni 59 i KP, Pezullimi	480	528	429	507	578	432	546	161	3661
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	3	7	3	5	6	5	9	1	39
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	21	32	19	30	31	29	41	8	211
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	108	95	85	85	131	111	89	45	749
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	0			0		0	1		1
TOTALI	612	662	536	627	746	577	686	215	4661

7.3.1 Shkaqet e përhapjes së ulët të gjysmëlirisë

Së pari, kjo lidhet kryesisht dhe vjen për shkak të detyrimeve që i lindin të dënuarit gjatë aplikimit të këtij dënimi alternativ, në krahasim me dënimet alternative të tjera si: pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, apo detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik. Konkretisht, gjatë aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënies në provë, i dënuari përgjithësisht nuk ka detyrime të tjera përveç atij që të mos kryejë vepër tjetër penale, të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës, dhe një ose disa nga masat e përcaktuara

në nenin 60 të Kodit Penal. Pra, i dënuari në këtë rast nuk ka detyrimin që të vuajë për një periudhë të caktuar kohore dënimin me burgim, pra të qëndrojë një pjesë të kohës në burgim. Po ashtu, edhe në krahasim me pezullimin e vendimit me burgim, me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, ky dënim alternativ është më pak i aplikuar për shkak se me përfundimin e punës në interes publik, personi konsiderohet i padënuar më parë. Ky është një përfitim ligjor që e bën këtë lloj dënimi alternativ më të kërkuar nga të pandehurit, në një tërësi rrethanash të caktuara, siç janë ato që lidhen me mundësinë e punësimit në një sektor të caktuar në të ardhmen. Në këtë aspekt, me aplikimin e gjysmëlirisë, i dënuari konsiderohet si i tillë deri në plotësimin e afatit dhe kushteve të rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Së dyti, një nga arsyet e tjera të mosaplikimit gjerësisht në praktikë të gjysmëlirisë si dënim alternativ, është marzhi i dënimit të përcaktuar deri në një vit burgim nga neni 58 i Kodit Penal. Kjo e ngushton rrethin e rasteve në të cilat mund të aplikohet ky dënim alternativ. Sidomos në krahasim me dënimin alternativ të pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies në provë, që ka aplikimin më të madh në praktikën gjyqësore, vërehet një diferencë e madhe në marzhin e dënimit të parashikuar. Konkretisht, pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë aplikohet për dënime të dhëna deri në 5 vjet burgim, çka për rrjedhim e bën këtë dënim alternativ më shpesh të aplikueshëm. Por, nga ana tjetër kjo duhet parë në raport me dënimin tjetër alternativ; atë të pezullimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik (neni 63 i Kodit Penal), që ka të njëjtin marzh dënimi për aplikim, caktimin e një dënimi deri në një vit burgim. Në këtë këndvështrim, përfitimet dhe detyrimet e të dënuarit janë ato që ndikojnë në kërkimin dhe aplikimin e një dënimi alternativ të caktuar. Për shkak të përfitimit të të dënuarit sipas nenit 63 të Kodit Penal, që parashikon se: "*Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë*.", të pandehurit priren të kërkojnë më shumë detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, sesa gjysmëlirinë.

Së treti, një nga shkaqet e tjera lidhet me kushtet ligjore të përcaktuara për aplikimin e kësaj dispozite, sikurse *puna, arsimi, kualifikimi ose aftësimi profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo nevoja për trajtim ose rehabilitim mjekësor.* Rrethana të tilla nuk janë të parashikuara dhe nuk kërkohen domosdoshmërisht në aplikimin e nenit 63 të Kodit Penal, detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik. Në këtë rast gjykata

vlerëson vetëm rrezikshmërinë e pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale. Këto rrethana janë më gjerësisht të konstatuara në praktikë, sesa ato të përcaktuara në nenin 58 të Kodit Penal. Po ashtu edhe rrethanat e përcaktuara në nenin 59 të Kodit Penal[20], për aplikimin e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit, janë më të gjera dhe më shpesh të konstatuara në praktikë.

7.3.2 Veprat penale për të cilat është aplikuar gjysmëliria

Në analizë, studimi i kryer ka pasur si objekt praktikën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vitin 2018 dhe 2019.

Gjysmëliria si dënim alternativ është aplikuar vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vihet re se në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk ka raste të aplikimit të gjysmëlirisë.

Nga analiza e vendimeve gjyqësore[21] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që kanë disponuar për gjysmëlirinë, rezulton se veprat penale për të cilat është aplikuar ky dënim alternativ janë: "Dhunë në familje", parashikuar nga neni 130/a/1, dhe në dy raste të tjera nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Pra, edhe për shkak të sanksionit penal të përcaktuar në nenin 58 të Kodit Penal (deri në një vit burgim), veprat penale për të cilat është aplikuar gjysmëliria nuk kanë patur rrezikshmëri shoqërore të lartë.

7.4 Revokimi i dënimit alternativ

Kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, drejtuesi i Institucionit, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat për moskthimin e tij, njofton menjëherë prokurorin dhe Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës, pasi verifikon faktet dhe rrethanat, përgatit raport vlerësimi për gjykatën dhe prokurorin. Sipas nenit 58 të Kodit Penal, personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri,

---

[20] *Neni 59 i Kodit Penal: "…shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale…'.*

[21] *Vendim nr.873 regj.them nr.446 datë 20.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.3486 datë 14.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,*

është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata. Pra, i dënuari duhet të përmbushë detyrimin për t'u kthyer dhe qëndruar në IEVP në oraret e përcaktuara nga gjykata. Në rast të kundërt, sipas nenit 58 të Kodit Penal, kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni, zbatohet neni 62 i Kodit[22]. Gjykata ka diskrecion që në përputhje me nenin 62 të Kodit Penal, të mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit. Në rastin e gjysmëlirisë kjo nënkupton ndryshimin e detyrimit nëpërmjet vendosjes së orareve dhe frekuencave të tjera të qëndrimit në IEVP, shtimin e detyrimeve të përshtatshme si ato që lidhen me kontaktet me Shërbimin e Provës dhe marrjen e pëlqimit për ndryshimin e vendbanimit etj., zëvendësimin me një dënim alternativ tjetër, si dhe revokimin e këtij dënimi alternativ. Ky parashikim ligjor vjen në përputhje me standardet ndërkombëtare, sipas të cilave zëvendësimi i dënimit alternativ me dënimin me burgim, duhet të jetë zgjidhje e fundit, vetëm kur çdo mundësi tjetër është e papërshtatshme. Ndryshe parashikohet në nenin 58/3 të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me rastin kur personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara nga paragrafi 1. i nenit (për gjysmëlirinë). Në këtë rast gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg.

Zëvendësimi i dënimit alternativ me një dënim tjetër, si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve apo kushteve gjatë periudhës së provës, nënkupton aplikimin e një dënimi me efekt më të rëndë, në kushtet kur, referuar nenit 62 të Kodit Penal kjo ndodh nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale apo kryen shkelje të rënda e të përsëritura. Ky rregull do të kishte kuptim për rrjedhim, në rastin e zëvendësimit të pezullimit të dënimit me bugim apo kryerjes së punës me interes publik me dënimin alternativ të gjysmëlirisë. Por në rast të mospërmbushjes së

[22] *Nenin 62 i Kodit Penal "Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së proves" parashikon se*: "*Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit. Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit. Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg*".

detyrimeve të përcaktuara në vendimin për aplikimin e gjysmëlirisë, duket se ky parashikim ligjor nuk gjen zbatim përsa dënimi me efekte më të rënda është dënimi me burgim. Për pasojë do të ishim përpara revokimit të dënimit alternativ dhe vuajtjes së pjesës së mbetur të dënimit në burg, dhe jo përpara zëvendësimit të dënimit me një dënim tjetër.

Neni 62 i Kodit Penal, nuk rregullon pasoja të ndryshme në rast të mospërmbushjes së detyrimeve për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit, pra në rast se rezultojnë pengesa të ligjshme dhe rrethana objektive që e kanë vështirësuar apo bërë të pamundur paraqitjen e të dënuarit në orarin e caktuar në IEVP, mbajtjen e kontaktit dhe njoftimin e IEVP. Kjo dispozitë parashikon vetëm tre rrethana të mospërmbushjes: së pari kur i dënuari kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së provës; *së dyti kur kryen shkelje të lehta dhe për herë të parë*; dhe së treti, kur kryen shkelje të rënda ose të përsëritura, duke përcaktuar mënyrën e disponimit për secilin rast. Por, në vështrim të standardeve ndërkombëtare, është e domosdoshme që në kushtet e pengesave objektive, si p.sh. pamundësia e paraqitjes së të dënuarit në orarin e caktuar në IEVP, *për shkak të largësisë së madhe të vendbanimit nga IEVP dhe kushteve ekonomike e familjare, gjykata të ketë mundësi të aplikojë si një nga pasojat, atë të* zëvendësimit të dënimit alternativ me një dënim alternativ tjetër, me efekte më pak kufizues.

Në çdo rast, gjykata merr parasysh mënyrën dhe shkallën e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari si dhe shkaqet e mospërmbushjes, për të vlerësuar në mënyrë proporcionale dhe aplikuar pasojën më të përshtatshme, të përcaktuar nga neni 62. Në këtë aspekt, lidhur me mosparaqitjen e të dënuarit në orarin e përcaktuar në IEVP, gjykata merr parasysh vonesën konkrete në paraqitje apo shmangien e paraqitjes në ditë të caktuara, shpeshtësinë, arsyet e mosparaqitjes, nëse ekzistojnë pengesa të ligjshme dhe rrethana objektive që e kanë vështirësuar apo bërë të pamundur paraqitjen e të dënuarit në orarin e caktuar në IEVP, mbajtjen e kontaktit dhe njoftimin e IEVP, etj.

8. KONKLUZIONE MBI PRAKTIKËN GJYQËSORE

1. Përsa i përket momentit të fillimit të ekzekutimit të vendimit me gjysmëliri, duke qenë se ka qëndrime të ndryshme në praktikë, është e domosdoshme të bëhet unifikimi i praktikës. Ekzekutimi i dënimit

duhet të fillojë vetëm pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë. Nuk mund të ekzekutohet vendimi i dënimit me gjysmëliri ndaj një personi që ka cilësinë e të pandehurit dhe nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në të kundërt, ekzekutimi i dënimit ndaj të pandehurit cënon rëndë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën për liri dhe siguri. Ndryshe nga rasti i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, (që ishte *çështje e* formulimit të ligjit - neni 59 i K.Penal për fillimin e periudhës së provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit gjyqësor dhe ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, në rastin e gjysmëlirisë), kjo nuk është çështje e formulimit të ligjit por e zbatimit nga praktika gjyqësore. As në nenin 58 të Kodit Penal, dhe as në dispozitat e ligjit "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*", nuk parashikohet që vendimi për gjysmëlirinë është me ekzekutim të menjëhershëm. Kjo problematikë sjell pasoja mbi të pandehurin, dhe prandaj, duke pasur parasysh pasojat e ardhura, është e nevojshme të unifikohet praktika në këtë drejtim, në përputhje me nenin 6 të KEDNJ që garanton prezumimin e pafajësisë, si element të procesit të rregullt ligjor.

2. Gjykatat, në aplikimin e gjysmëlirisë si dënim alternativ, duhet të mbajnë parasysh standardin ndërkombëtar të përcaktuar në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave mbi rregullat evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, që përcakton se çdo kusht apo detyrim që i vendoset të dyshuarit apo të dënuarit, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh njëkohësisht nevojat individuale që janë të rëndësishme për zbatimin, mundësitë e tij dhe të drejtat, ashtu edhe përgjegjësitë sociale. Nevojat individuale duhet të merren parasysh edhe në përcaktimin konkret të orareve për të qëndruar i dënuari në IEVP dhe detyrimet që duhet të përmbushen prej tij.
3. Në arsyetimin e vendimeve gjyqësore vërehen formulime standarde dhe rrethana të tjera të përgjithshme, *të pa konkretizuara specifikisht. Për rrjedhim*, gjykatat duhet të kryejnë një analizë të thelluar të rrethanave konkrete të përcaktuara në ligj, *në raport me detyrimet dhe nevojat e të dënuarit për përmbushjen e kësaj përgjegjë*sie.
4. Gjithashtu, në përzgjedhjen e aplikimit të këtij dënimi alternativ rekomandohen gjykatat që të vlerësojnë pse ky dënim është më i përshtatshëm për t'u aplikuar në raport me dënimet e tjera alternative në rrethanat e rastit konkret, duke pasur parasysh edhe efektet negative e më kufizuese që sjell ky dënim krahasuar me dënimet e tjera alternative.

5. Nisur nga problematika e konstatuar sa i përket përcaktimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë të vetëm një institucioni për vuajtjen e dënimit me gjysmëliri, është e domosdoshme që vuajtja e dënimit me gjysmëliri të kryhet sa më afër vendbanimit, vendit të punës apo të trajtimit mjekësor/ rehabilitues të të dënuarit. Për rrjedhim, duhet të përcaktohen dhe të merren masat për krijimin e kushteve të vuajtjes së dënimit me gjysmëliri në disa institucione të vuajtjes së dënimit, sa më afër vendbanimit të të dënuarve. Në të gjitha këto institucione duhet të sigurohet vuajtja e dënimit në qendra, sektorë apo ambiente të veçantë, në mënyrë që një i dënuar me gjysmëliri të mos qëndrojë me të dënuar të tjerë me burgim. Ministria e Drejtësisë duhet të përcaktojë sa më shumë institucione të hapura për vuajtjen e dënimit me gjysmëliri, në mënyrë që të shmangen pengesat për aplikimin dhe ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.
6. Gjykatat rekomandohen të mos e aplikojnë këtë dënim alternativ nëse distanca e vendbanimit të të dënuarit nga vendi i vuajtjes së dënimit, është ë tillë që shkakton një barrë të rëndë dhe cenon përmbushjen e nevojave për të cilat neni 58 i Kodit Penal parashikon dënimin alternativ me gjysmëliri.
7. Në rastin e aplikimit të gjysmëlirisë si zëvendësim i dënimit tjetër alternativ të përcaktuar nga gjykata për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve gjatë periudhës së provës, duhet të mbahet parasysh natyra dhe efektet kufizuese të këtij dënimi alternativ. Për rrjedhim gjysëmliria rekomandohet të aplikohet vetëm në rast se çdo masë tjetër, si shtimi apo ndryshimi i detyrimeve, etj., (me përjashtim të dënimit me burgim), do të ishte e papërshtatshme. Ky dënim alternativ duhet të aplikohet sipas nenit 62 të K.Penal, si zëvendësim i dënimit alternativ për shkak mospërmbushjeje detyrimi, si masa e fundit përpara se gjykata të aplikojë revokimin e dënimit alternativ dhe vuajtjen e pjesës së mbetur me burgim.
8. Gjatë zbatimit të dënimit me gjysmëliri, në rast të konstatimit së mospërmbushjes së detyrimeve apo kushteve të vendosura, Shërbimi i Provës duhet të luajë një rol më aktiv në drejtim të përcaktimit të plotë të rrethanave dhe shkaqeve të mospërmbushjes dhe të rekomandojë pasojën më të përshtatshme për t'u aplikuar në rastin konkret. Në këtë aspekt, edhe Prokuroria në praktikën e saj, duhet të veprojë në përputhje me standardet e përcaktuara në Rekomandimin (2017)3, duke e trajtuar revokimin e dënimit alternativ me dënimin me burgim si zgjidhje të fundit dhe në kërkesën e saj të shqyrtojë përshtatshmërinë e masave të tjera të përcaktuara në nenin 62, si shtimi apo ndryshimi i detyrimeve etj.

9. KONKLUZIONE DHE SUGJERIME MBI RREGULLIMIN LIGJOR TË DISPOZITËS

1. Në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, nevojiten shtesa dhe ndryshime në mënyrë që të parashikohen rregulla të posaçme për gjysmëlirinë. Mungesa e rregullave të parashikuara, posaçërisht për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me gjysmëliri, krijon vështirësi në praktikë dhe sjell mosnjohjen e të dënuarit me rregullat dhe detyrat e tij gjatë qëndrimit në IEVP dhe mos rehabilitimin në aspektin edukativ.
2. Edhe sa i përket mënyrës së regjistrimit dhe pranimit të të dënuarve me gjysmëliri në IEVP, duke qenë se nuk ka rregulla të posaçme të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nevojiten ndryshime. Në Rregullore duhet të përcaktohen aktet që duhet të plotësohen në dosje për pranimin e të dënuarve me gjysmëliri, duke përjashtuar aktet e parashikuara tashmë të cilat nuk janë të aplikueshme.
3. Gjysmëliria nuk ka gjetur zbatim në praktikën gjyqësore për shkak të vështirësive praktike në ekzekutimin e tij dhe mungesën e një justifikimi logjik të kënaqshëm për aplikimin e tij, në raport me dënimet e tjera alternative. Gjysmëliria mbart të njëjtën anë negative dhe problematike për të dënuarin, sikurse dënimi me burgim. Ana pozitive, që ndërkohë i dënuari ka mundësi të plotësojë nevojat (familjare, shëndetësore etj.) jashtë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, nuk është e mjaftueshme për të shfaqur interes për këtë alternativë dënimi. Kjo për arsye se, ky aspekt pozitiv cenohet rëndë nga vështirësitë në ekzekutimin e dënimit për shkak të distancave ndërmjet vendbanimit, IEVP dhe vendeve si spital, shkollë etj., dhe kohës së shpenzuar për këtë. Në këto kushte, është shumë më e përshtatshme dhe me interes për të dënuarin, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe puna në interes publik. Prandaj, gjysmëliria si institut i të drejtës penale duhet të reformohet, ose të shfuqizohet.
4. Në mënyrë që gjysmëliria të gjejë aplikim më të gjerë në praktikë, është e domosdoshme të ndryshohet marzhi i dënimit, i përcaktuar deri në një vit burgim në nenin 58 të Kodit Penal. Ky ndryshim ligjor do të sjellë zgjerimin e rasteve në të cilat mund të aplikohet ky dënim alternativ. Rritja e marzhit të dënimit është e përshtatshme sidomos në krahasim me dënimin alternativ të pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies

në provë, që aplikohet për vepra penale deri në 5 vjet burgim dhe nuk përmban detyrim të tillë sikurse vuajtja fizike e dënimit me burgim për një hapësirë kohore të caktuar. Parashikimi i të njëjtit përfitim (sikurse për dënimin alternativ për kryerjen e një punë në interes publik), atij të konsiderimit të padënuar me vuajtjen e dënimit, mund të përbëjë një faktor për aplikimin më të gjerë në praktikë. Gjithashtu është shumë e rëndësishme njëkohësisht, edhe shmangia e pengesave praktike në ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.

5. Neni 58 i Kodit Penal, referon në rregullimin e nenit 62 të po këtij Kodi, në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e të dënuarit me gjysmëliri. Ligjvënësi duhet të rregullojë se si mund të zëvendësohet dënimi alternativ i gjysmëlirisë, me një dënim tjetër. Në këtë aspekt dispozitat aktuale janë praktikisht të pazbatueshme, duke qenë se gjysmëliria është dënim alternativ me efektet më negative, në raport me dënimet e tjera alternative. Nenet 58 dhe 62 të Kodit Penal, duhet të riformulohen dhe të kenë një përcaktim dhe rregullim më të qartë dhe të saktë të pasojave, në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve apo kushteve gjatë zbatimit të dënimit alternativ të gjysmëlirisë, duke i dhënë gjykatës diskrecionin e nevojshëm në përputhje me standartet ndërkombëtare.
6. Ligjvënësi duhet të parashikojë e rregullojë edhe rastin kur dënimi alternativ i gjysmëlirisë nuk mund të ekzekutohet për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit, deri në zhdukjen e pengesës objektive, si edhe kur ndaj të dënuarit caktohet një masë sigurimi personal. Neni 31/9 i ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ka rregulluar këtë situatë për dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, duke parashikuar se gjykata mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të dënimit alternativ, dhe për rrjedhim është e nevojshme që një rregullim i tillë të aplikohet edhe për gjysmëlirinë.

KAPITULLI II

NENI 59 I KODIT PENAL - *PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM DHE VËNIA NË PROVË*

PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM DHE VËNIA NË PROVË

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI NENIN 59 TË KODIT PENAL

Një nga dënimet alternative të përcaktuara në Kodin Penal është "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë", e parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal. Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë në jurisprudencën e tyre, tashmë të konsoliduar, kanë afirmuar se përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio,* vetëm kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Ky qëndrim mbështetet edhe në angazhimet e shtetit shqiptar si anëtar i Këshillit të Evropës, për të marrë masa për uljen e mbipopullimit të burgjeve dhe për përmirësimin e aplikimit të dënimeve alternative. Fryma e këtyre rekomandimeve dhe rezolutave të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, u kërkon shteteve anëtare që burgimi të zbatohet si masë, vetëm "kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës", dhe të bëjnë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria e të zbatohen më shumë ato masa të cilat nuk e bëjnë këtë.

Dënimi alternativ është një institut i të drejtës penale me rëndësi të madhe dhe përhapje të gjerë, që përfaqëson një mundësi për të kufizuar efektet negative të procesit penal. Aplikimi i dënimit alternativ bëhet në bazë të një vlerësimi diskrecional nga ana e gjyqtarit, që merr parasysh si pendimin e të pandehurit, ashtu edhe rrezikshmërinë e veprës penale. Për rrjedhim, ai ndjek të dy qëllimet e dënimit; atë të parandalimit të përgjithshëm, në mënyrë që të mos kryhen vepra të tjera penale në të ardhmen, dhe atë të parandalimit të posaçëm, në mënyrë që dënimi alternativ të nxisë pendimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, nuk duhet të trajtohet si një cedim i gabuar nga ashpërsia e reagimit penal, por si një zgjidhje për të rritur efektivitetin e dënimit penal. Ai nënkupton dhënien e një mundësie që i dënuari të përmirësohet në liri, pasi, nëse ai gjatë periudhës së gjatë të kushtit shkel detyrimet e vëna ndaj tij, apo kryen një vepër të re penale, vendimi i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim mund të revokohet dhe ai detyrohet të vuajë të plotë dënimin e caktuar, bashkë me dënimin për veprën e re.

Alternativat e dënimit me burgim nuk janë dënime të reja, pasi dënimi në rastin konkret është vetëm një, konkretisht, dënimi me burgim. Këto alternativa të vuajtjes së dënimit me burgim, janë vetëm forma apo mënyra të veçanta të vuajtjes së dënimit me burgim. Dënimet alternative përshkrohen edhe nga fleksibiliteti (për t`iu përshtatur nevojave të një rasti konkret), si në vendimin e caktimit të tyre (nisur nga lloji i detyrimeve që cakton Gjykata), ashtu edhe në drejtim të metodës me të cilën realizohen (programet e ofruara nga Shërbimi i Provës). Qëllimi i masave alternative është të reduktojë dëmin e ardhur nga vepra penale dhe të reduktojë përfshirjen e individit në sistemin e drejtësisë penale, duke i shërbyer sa më mirë asaj që quhet drejtësia restauruese, e cila në thelb nënkupton vendosjen e një ekuilibri ndërmjet interesave të shoqërisë për t`u mbrojtur nga kriminaliteti, si edhe interesave të autorit të veprës penale që është në konflikt me ligjin. Aplikimi i alternativave të dënimit me burgim, lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me ekzistencën e vetë dënimit (Parimi "Nulla poena sine lege"), si dhe me parashikimin ligjor të tyre. Pra, ashtu sikundër nuk mund të zbatohet një dënim penal që nuk është parashikuar në ligj, nuk mund të aplikohet një alternativë (sanksion në interes të komunitetit), e paparashikuar në ligj.[23]

[23] *Vendim nr.2679 datë 29.06.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

2. HISTORIKU I LIGJIT PENAL SHQIPTAR MBI NENIN 59 TË KODIT PENAL

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim apo dënimi me kusht, është aplikuar gjerësisht në drejtësinë penale dhe ka qeënë parashikuar që në Kodin Penal të vitit 1977. Dënimi me kusht nuk është përjashtim nga dënimi. Në dënimin me kusht gjykata cakton masën e dënimit sipas rregullave të përgjithshme, veçse vuajtjen e tij nga fajtori e kushtëzon me qëndrimin e këtij në të ardhmen. Neni 38 i Kodit Penal, parashikonte se dënimi me kusht jepet nga gjykata kur ajo "çmon se shkalla e rrezikshmërisë së veprës dhe të dënuarit të jetë e tillë sa nuk ka nevojë për veçimin ose për të vuajtur dënimin me riedukim nëpërmjet punës".[24] Në Udhëzimin e Pleniumit të Gjykatës së Lartë nr.4 datë 31.10.1952, përcaktohej se: "Për të konstatuar kur i dënuari paraqitet një shkallë rrezikshmërie të tillë saqë nuk ka nevojë për vuajtjen e dënimit, gjykata duhet të marrë parasysh:

a) rrethanat e kryerjes së veprës,
b) vetitë e të dënuarit,
c) qëndrimin e të dënuarit pas kryerjes së veprës dhe shkallën e pendimit të tij, dhe
ç) të dhënat që vërtetojnë se shpallja e vendimit mjafton për edukimin e të dënuarit."

Në Udhëzimin Nr. 5, datë 15.5.1979, të Plenumit të Gjykatës së Lartë "Mbi dënimin me kusht", thuhet se: "…një nga kriteret nga i cili duhet të udhëhiqet gjykata në vënien në provë, është dhe konkretizimi i saktë i rrezikshmërisë shoqërore që paraqet subjekti i veprës penale. Kështu, në radhë të parë duhet të dalë pesonaliteti i të pandehurit: origjina e tij, gjendja shoqërore, profesioni, arsimi, qëndrimi ndaj punës, gjendja familjare, qëndrimi ndaj shoqërisë e familjes, gjendja shëndetësore (të gjitha tiparet e karakterit të tij).".

Gjykata duhet të ketë parasysh se dënimi me kusht është në vetvete dënim dhe si i tillë mund të zbatohet vetëm në pajtim me qëllimet që plotëson dënimi. Sipas nenit 50 të Kodit Penal, dënimi me kusht mund të zbatohet në llojin e dënimit me burgim, pavarësisht nga masa e dënimit të caktuar nga ligji ose gjykata. Nga kjo nuk duhet kuptuar se, edhe në dënime

[24] *E drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.*

të rënda mund të zbatohet kurdoherë dënimi me kusht. Prandaj, nuk duhet të lejohet zbatimi i dënimit me kusht për krime të rënda ose për dënime të caktuara në një masë të madhe, përveç kur jashtëzakonisht kondita të posaçme imponojnë zbatimit e nenit 50 të Kodit Penal.[25]

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, është parashikuar si dënim alternativ në Kodin Penal me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, neni 59: "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim". Në këtë dispozitë parashikohej se: "*Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burgim gjer në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Afati i provës është tetëmbëdhjetë muaj gjer në pesë vjet".*

Me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar" është ndryshuar neni 59 i Kodit Penal, duke u parashikuar si vijon: "*Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shume detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.".*

Ndryshimet e bëra në vitin 2008 janë pozitive dhe përcaktojnë më mirë kushtet e aplikimit të këtij dënimi alternativ. Konkretisht, ndërsa para ndryshimeve, kushtet e aplikimit të dënimit alternativ ishin vetëm *rrezikshmëria e pakët e personit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale,* me ndryshimet në vitin 2008, janë përcaktuar si rrethana edhe *mosha, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe nevojat, veçanërisht*

[25] *Revista nr.6 viti 1952, Drejtësia Popullore, faqe 47-49.*

ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale. Ndërsa para ndryshimeve, gjatë periudhës së provës ishte *kusht që i dënuari gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë*, me ndryshimet në vitin 2008, përcaktohet si *kusht që gjatë kohës së provës i dënuari të mos kryejë vepër tjetër penale.* Kjo nënkupton, që i dënuari nuk duhet të kryejë asnjë vepër tjetër penale, qoftë edhe me të lehtë se ajo për të cilën vuan dënimin.

Me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017, janë bërë shtesa e ndryshime si më poshtë: "Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje: "*3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata*.". Paragrafi 3 numërtohet paragrafi 4 dhe ndryshohet si më poshtë: "*4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet,* në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.". Paragrafi 4 numërtohet paragrafi 5. Në këtë mënyrë, janë bërë ndryshime pozitive përsa i përket periudhës së provës dhe përshtatjes së ekzekutimit të dënimit alternativ me kushtet personale të të dënuarit. Shkurtimi i afatit të periudhës së provës, në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndërsa përcaktimi me ligj i afatit të periudhës së provës si afat fiks në bazë të përllogaritjes si dyfishi i masës së dënimit të dhënë, nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare, pikat 21 dhe 22 të Rekomandimit (2017)3.

Aktualisht, në nenin 59 të Kodit Penal, ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, si dhe ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar", parashikohet se:

"*1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë*¸ që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë

vepër tjetër penale. 2. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë *detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. 3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata. 4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf. 5. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit"*.

Në këtë mënyrë, përveç rrethanave që duhet të plotësohen për aplikimin e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, janë parashikuar dhe rregulluar edhe detyrimet gjatë periudhës së provës, kohëzgjatja e periudhës së provës dhe afati i fillimit të saj, mundësia dhe kushtet e shkurtimit apo zgjatjes së periudhës së provës dhe pasojat në rast të mos përmbushjes së detyrimeve nga ana e të dënuarit.

3. STANDARDET NDËRKOMBËTARE

3.1 Standardet Ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) (1948), Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit, 1985), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990), dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit, 1990) venë theksin në riedukimin dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri.

Standardet për dënimet alternative, ku përfshihet edhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, janë përcaktuar në Rregullat Standarde

Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios, 1990). Standardet minimale ofrojnë parimet themelore për nxitjen e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim, dhe garancitë minimale për personat që janë subjekt i këtyre masave. Një nga këto rregulla është se nuk duhet të ketë diskriminim në zbatimin e masave alternative. Në mënyrë që të sigurohet një fleksibilitet më i madh në raport me natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës, me personalitetin e të pandehurit si dhe mbrojtjen e shoqërisë, dhe në mënyrë që të shmanget pëdorimi i papërshtatshëm i burgimit, sistemi i drejtësisë penale duhet të ofrojë një sërë masash dhe dënimesh alternative. Pra, theksi vihet te shmangia sa më shumë nga dënimi me burgim në rastet e panevojshme. Prandaj, autoritetet kompetente duhet të kenë në dispozicion një sërë dënimesh alternative, në mënyrë që të shmanget burgimi dhe të sigurohet asistimi i të dënuarve për riintegrimin e tyre në shoqëri. Akti përcakton garancitë dhe rregullat minimale në fazën e hetimit dhe gjykimit, si edhe pas dhënies së vendimit të dënimit. Paraburgimi duhet të përdoret si mjeti i fundit, duke patur parasysh nevojat e hetimit dhe mbrojtjen e shoqërisë dhe viktimës.

Gjithashtu janë përcaktuar rregulla për mbikëqyrjen e masave alternative,me qëllim reduktimin e ripërsëritjes së veprave penale dhe asistimin në procesin e integrimit në shoqëri të të dënuarit. Mbikëqyrja dhe trajtimi duhet të përcaktohen për çdo rast, të rishikohen në mënyrë periodike, dhe të përshtaten nëse është e nevojshme. Përsa i përket procesit të trajtimit, kur është e përshtatshme, skema të ndryshme (si puna, terapia në grup, programet rezidenciale, dhe trajtimi i specializuar i kategorive të caktuara të të dënuarve), duhet të zhvillohen për të përmbushur nevojat e të dënuarit në mënyrë më efektive. Në rregullat minimale për shkeljen e kushteve, parashikohet si pasojë, ndryshimi apo revokimi i masave alternative. Kjo duhet të bëhet nga autoriteti kompetent, dhe vetëm pas shqyrtimit me kujdes të fakteve të parashtruara nga mbikëqyrësi dhe i dënuari. Mospërmbushja e masës alternative (shkelja e detyrimeve), nuk duhet të sjellë automatikisht vendosjen e masës, apo dënimit me burgim. Në rast të ndryshimit apo revokimit të masës, autoriteti kompetent duhet të vendosë një alternativë të përshtatshme mase apo dënimi. Dënimi me burgim duhet të vendoset vetëm në mungesë të një alternative tjetër të përshtatshme.

Rregulla minimale përcaktohen edhe për rekrutimin dhe trajnimin e stafit përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe dënimeve alternative, për pjesëmarrjen e publikut dhe bashkëpunimin me

institucionet, sektorin privat dhe publikun, si dhe përfshirjen e komunitetit dhe vullnetarëve.

3.2 Standardet Ndërkombëtare të Këshillit të Evropës

Standardet ndërkombëtare për dënimet alternative janë përcaktuar në një sërë aktesh të Këshillit të Evropës si:

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollet nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;
- Karta Sociale Evropiane (e ndryshuar);
- Konventa Evropiane "Për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues" dhe Protokollet nr. 1 dhe 2;
- Konventa Evropiane "Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht", ratifikuar me ligjin nr.8724 datë 26.12.2000;
- Konventa e Këshillit të Evropës "Për transferimin e personave të dënuar", ratifikuar me ligjin nr.8499 datë 10.06.1999;
- Konventa e Këshillit të Evropës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale", ratifikuar me ligjin nr.8498 datë 10.06.1999;
- Konventa e Këshillit të Evropës "Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale", ratifikuar me ligjin nr.9068 datë 15.05.2003;
- Konventa e Këshillit të Evropës "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale", ratifikuar me ligjin nr.8497 datë 10.06.1999.

Konventa e Këshillit të Evropës për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht, është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000 "*Për ratifikimin e "Konventës Europiane për mbikqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht*", dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2000. Kjo Konventë ka bërë realitet ndërmjet shteteve të Këshillit të Evropës, që të mundësohet ekzekutimi i dy prej dënimeve alternative të dënimit me burgim, konkretisht vënia në provë e të dënuarit nëpërmjet pezullimit të dënimit me burgim, dhe lirimi me kusht. Kjo Konventë ka parashikuar se, nëse individi ka deklaruar si vendbanim apo si rezidencë një adresë jashtë territorit të shtetit ku ai është dënuar, atëherë mundet të lejohet që ekzekutimi i dënimit alternativ të ekzekutohet nga shteti ku ai ka rezidencën. Konventa ka parashikuar se në këto raste autoritetet gjyqësore të shtetit ku do të ekzekutohet dënimi alternativ, duhet ta konvertojnë atë duke e përshtatur

me parashikimet ligjore të brendshme, respektive dhe relevante të tyre. Shteti ku dënimi alternativ ekzekutohet, nuk mundet të rëndojë dënimin, qoftë nëpërmjet shtimit të masave, apo kohëzgjatjes së provës, apo kushtit. Megjithatë, në rast se i dënuari gjatë kohës së lirisë së kushtëzuar shkel detyrimet ligjore apo gjyqësore apo kryen vepër penale, atëherë autoritetet kompetente të shtetit ku ekzekutohet dënimi kanë kompetencë të plotë për të ndryshuar dënimin alternativ, apo për ta revokuar atë kur është rasti.

Në kuadër të Këshillit të Evropës janë miratuar një sërë instrumentash për përcaktimin e standardeve mbi dënimet alternative si:

- Rekomandimi nr.(92)16 i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat Evropiane të dënimeve dhe masave komunitare;
- Rekomandimi nr.(92)17 i Komitetit të Ministrave, lidhur me njëtrajtshmërinë në dënime;
- Rekomandimi nr.(97)12 i Komitetit të Ministrave, për stafin që merret me zbatimin e dënimeve dhe masave;
- Rekomandimi nr.(99)19 i Komitetit të Ministrave, për ndërmjetësimin në çështjet penale;
- Rekomandimi nr.(99)22 i Komitetit të Ministrave, lidhur me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë në burgje;
- Rekomandimi (2000)22 i Komitetit të Ministrave, për përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane mbi dënimet dhe masat komunitare;
- Rekomandimi (2003)22 i Komitetit të Ministrave, për lirimin me kusht (parole);
- Rekomandimi (2008)11 i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat Evropiane për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave;
- Rekomandimi (2010)1 i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat e vënies në provë të Këshillit Evropian dhe Rekomandimi (2014)4, për mbikëqyrjen elektronike; si dhe:
- Rezoluta (65)1, lidhur me pezullimin e dënimit, vënien në provë dhe alternativat e tjera të dënimit;
- Rezoluta (70)1, lidhur me organizimin praktik të masave për mbikëqyrjen dhe kujdesin e mëpasshëm të të dënuarve apo liruarve me kusht;
- Rezoluta (76)2, lidhur me trajtimin e të dënuarve me afate të gjata burgimi;
- Rezoluta (76)10, lidhur me disa masa alternative ndaj dënimit me burgim.

Disa nga aktet e mësipërme që përcaktojnë rekomandime, standarde dhe rregulla për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim si dënim alternativ:

Rekomandimi nr.(92)16 i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat Evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, përcakton ndër të tjera se: Kushtet dhe detyrimet e masave apo dënimeve alternative, ashtu si edhe pasojat në rast mospërmbushje të tyre, duhet të përcaktohen në dispozita ligjore të sakta dhe të qarta. Në ligj nuk duhet të ketë asnjë parashikim për konvertimin automatik të masës apo dënimit komunitar në burg, në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve. Asnjë masë apo dënim komunitar, nuk duhet të ketë kohëzgjatje të pacaktuar. Kohëzgjatja duhet të përcaktohet nga autoriteti kompetent për marrjen e vendimit brenda afatit të përcaktuar në ligj. Lloji dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat personale të të dënuarit. Vendimi për të caktuar dhe revokuar një masë a dënim alternativ, duhet të merret nga një autoritet gjyqësor. I pandehuri duhet të ketë të drejtën e ankimit ndaj një vendimi të tillë. Çdo kusht apo detyrim që i vendoset të dyshuarit apo të dënuarit, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh njëkohësisht nevojat individuale që janë të rëndësishme për zbatimin, mundësitë e tij dhe të drejtat, ashtu edhe përgjegjësitë sociale. Rekomandimi përcakton rregulla edhe për garancitë gjyqësore dhe procedurën e ankimit, respektimin e të drejtave të njeriut, bashkëpunimin dhe pëlqimin e të dënuarit, burimet njerëzore dhe financiare, aspekte të menaxhimit të masave dhe dënimeve komunitare.

Rekomandimi nr.(92)17 i Komitetit të Ministrave, lidhur me njëtrajtshmërinë në dënime, përcakton si një ndër rekomandimet, rivlerësimin kritik të praktikës gjyqësore të dënimeve, në mënyrë që të shmanget ashpërisa e panevojshme. Në kërkimin dhe dhënien e dënimit, duhet të merret parasysh efekti i mundshëm i dënimit te i dënuari, me qëllim shmangien e vuajtjes së pazakontë dhe moscenimin e rehabilitimit të mundshëm të të dënuarit. Dënimi me burgim duhet të konsiderohet si zgjidhje e fundit dhe për rrjedhim duhet të vendoset vetëm në rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat e rëndësishme, rrezikshmërinë e veprës, çdo dënim tjetër është qartësisht i papërshtatshëm. Në rastet kur i dënuari shkel detyrimet e pezullimit të dënimit me burgim, është e rëndësishme që të sigurohet diskrecion, në kushtet e zbatimit të plotë, të pjesshëm, apo mundësive të tjera. Edhe pse në caktimin e dënimit merren parasysh dënimet e mëparshme të të pandehurit, përsëri dënimi duhet të caktohet në proporcion me rrezikshmërinë e veprës. Efekti i të qenit i dënuar

më parë, duhet të varet nga karakteristikat e rekordeve kriminale. Efekti duhet të reduktohet, ose nuk duhet të merret parasysh, në rastet kur ka patur një periudhë domethënëse pa kriminalitet, i pandehuri është i mitur, apo ka qënë i tillë në kohën e kryerjes së veprës, i pandehuri është ende i ri. Në caktimin e dënimit, në parim, koha e paraburgimit duhet të merret parasysh.

Rekomandimi nr.(97)12 i Komitetit të Ministrave, për stafin që merret me zbatimin e dënimeve dhe masave, përcakton domosdoshmërinë e vendosjes së një politike të qartë për stafin përgjegjës për zbatimin e masave dhe dënimeve në një dokument formal, që mbulon të gjitha aspektet e rekrutimit dhe përzgjedhjes, trajnimit, statusit, menaxhimit të përgjegjësive, kushteve të punës dhe lëvizshmërisë. Stafi duhet të ketë mjaftueshëm burime për të kryer me efektivitet detyrat e ndryshme. Në këtë akt përcaktohet rekomandime lidhur me rekrutimin dhe përzgjedhjen, trajnimin, kushtet e punës dhe menaxhimin e përgjegjësive, lëvizshmërinë dhe kërkesat etike në përgjithësi, dhe në raport me të dyshuarit dhe të dënuarit.

Rekomandimi nr.(99)22 i Komitetit të Ministrave, lidhur me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë në burgje, rithekson si parim themelor se dënimi me burgim duhet të konsiderohet si zgjidhje e fundit dhe për rrjedhim duhet të vendoset vetëm në rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat e rëndësishme, rrezikshmërinë e veprës, çdo dënim tjetër është qartësisht i papërshtatshëm. Prokurorët dhe gjyqtarët duhet të nxiten t'i përdorin dënimet alternative sa më shumë të jetë e mundur. Në ofrimin e dënimeve apo masave komunitare, duhet të konsiderohen ndër të tjera edhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me kushte të caktuara. Në mënyrë që dënimet komunitare të jenë alternativa të besueshme, zbatimi efektiv i tyre duhet të sigurohet, në veçanti nëpërmjet:

- infrastrukturës për zbatimin dhe monitorimin e dënimeve komunitare, me qëllim që gjyqtarët dhe prokurorët të besojnë në efektivitetin e tyre, dhe
- zhvillimit dhe përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe parashikueshmërisë së besueshme të riskut dhe zhvillimit e përdorimit të strategjive për mbikëqyrjen, duke identifikuar rrezikun e të dënuarit për ripërsëritje dhe për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë publike.

Në paragrafin 1 të Rekomandimit parashikohet se burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm "kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të

papërshtatshme për rëndësinë e veprës", dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria, dhe të zbatohen më shumë masat të cilat nuk e bëjnë këtë. Në paragrafi 14, parashikohet se duhet inkurajuar përdorimi i masave të cilat nuk e privojnë personin nga liria, sa herë të jetë e mundur, pasi këto po konsiderohen gjithnjë e më shumë si mjete më efektive për trajtimin e shkelësve në shoqëri, duke përfituar në këtë mënyrë edhe shkelësi dhe shoqëria.

Rekomandimi (2000)22 i Komitetit të Ministrave, për përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane mbi dënimet dhe masat komunitare, duke bërë amendime në Rekomandimet e mëparshme, përcakton ndër të tjera parimet orientuese për të arritur një zbatim më të gjerë dhe efektiv të masave dhe dënimeve komunitare; kërkesat themelore për zbatimin efektiv të tyre, përmirësimin e besueshmërisë së tyre; ndërtimin e programeve efektive. Si rregull, asnjë dënim apo masë komunitare, nuk duhet të jetë me kohëzgjatje të papërcaktuar. Përjashtimisht, një dënim apo masë komunitare e papërcaktuar mund të vendoset për të pandehur të cilët, për shkak të një vepre penale të mëparshme apo aktuale, në tërësi me karakteristikat personave specifike, paraqesin haptazi një rrezik të vazhdueshëm për kërcënimin e jetës, shëndetit dhe sigurisë në komunitet. Parashikime ligjore duhet të bëhen për rishikimin e zakonshëm të zbatimit të një dënimi apo mase të tillë, nga një organ i pavarur dhe i ngarkuar nga ligji. Kohëzgjatja e dënimit apo masës komunitare, duhet të përcaktohet nga autoriteti që ka përgjegjësine për vendimarrje brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara në ligj. Parashikime duhet të bëhen për një numër të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm masash dhe dënimesh komunitare të ndryshme, nga të cilat disa shembuj parashikohen në këtë Rekomandim (si: vënia në provë pa vendosur dënimin me burgim, pezullimi i dënimit me burgim me vendosjen e kushteve të caktuara, punë në interes publik, kompensimi i viktimës/ ndërmjetësimi, trajtimi mjekësor me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike, kufizimi i lirisë së lëvizjes, etj.).

Në Rekomandim janë parashikuar disa kërkesa themelore për zbatimin efektiv të masave dhe dënimeve komunitare lidhur me shërbimet përgjegjëse për zbatimin, burimet e mjaftueshme që duhet të kenë në dispozicion, rekrutimin, trajnimin e stafit, etj. Një rëndësi të veçantë në këtë Rekomandim ka vendosja e programeve dhe ndërhyrjeve efektive. Programet dhe ndërhyrjet për riintegrimin e të dënuarve në shoqëri, duhet të bazohen në një shumëllojshmëri metodash. Në përcaktimin e programit

apo ndërhyrjes, në kuadër të dënimeve dhe masave komunitare, një kujdes i veçantë duhet t'i jepet efektit të të dënuarit, në veçanti lidhur me: - aftësitë bazike, (si: zgjidhja e përgjithshme e problemeve, trajtimin e marrëdhënieve personale dhe familjare, sjellja pro-sociale):

- situatat e edukimit dhe punësimit;
- varësinë e mundshme me drogën, alkoolin, trajtimin mjekësor.

Rekomandimi (2010)1 i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat e vënies në provë të Këshillit Evropian, përcakton udhëzime për vendosjen dhe mirëfunksionimin e Shërbimit të Provës. Në pjesën e parë parashikohen parimet themelore si:

- Shërbimi i Provës duhet të ketë qëllim reduktimin e rikryerjes së veprave penale, duke ndërtuar marrëdhënie me të dënuarit duke i mbikëqyrur (përfshirë kontrollin, kur është e nevojshme), udhëhequr dhe asistuar ata, dhe duke nxitur riintegrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri. Shërbimi i Provës duhet të respektojë të drejtat e të pandehurve/të dënuarve, duke pasur vëmendjen e duhur në dinjitetin, shëndetin, sigurinë dhe mirëqënien e tyre. Në rastet e lidhura me viktimat e veprës penale, Shërbimi i Provës duhet të respektojë të drejtat dhe nevojat e tyre. Shërbimi i Provës duhet të marrë parasysh karakteristikat individuale, rrethanat dhe nevojat e të dënuarit, në mënyrë që çdo rast të trajtohet në mënyrën e duhur dhe me drejtësi. Detyrat e Shërbimit të Provës duhet të përmbushen pa diskriminim. Në zbatimin e dënimeve dhe sanksioneve, Shërbimi i Provës nuk mund të vendosë kufizime apo barrë më të rëndë se ajo e përcaktuar në vendimin gjyqësor. Për aq sa është e mundur, Shërbimi i Provës duhet të ketë pëlqimin e informuar dhe bashkëpunimin e të dënuarit, në lidhje me ndërhyrjet që i prekin ata. Çdo ndërhyrje, përpara se i pandehuri të dënohet me vendim të formës së prerë, duhet të ketë pëlqimin e informuar dhe nuk duhet të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Provës, ashtu sikurse marrëdhëniet me autoritetet publike dhe organizmat e tjerë, duhet të përcaktohen në ligj. Vënia në provë duhet të jetë përgjegjësi e autoritetit publik, edhe në rastet kur shërbimet ofrohen nga agjenci të tjera apo vullnetarë. Shërbimi i Provës duhet të ketë burime të përshtatshme. Çdo aktivitet i ndërmarrë nga Shërbimi i Provës, duhet të jetë në përputhje me standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare, etike dhe profesionale. Shtetet duhet të garantojnë procedura ankimimi

të aksesueshme, të paanshme dhe efektive. Shërbimi i Provës duhet të jetë objekt i kontrollit të rregullt dhe/ose monitorimit të pavarur. Shërbimi i Provës duhet të bashkëpunojë me autoritetet publike, organizatat dhe komunitetin lokal, për të nxitur riintegrimin e të dënuarve në shoqëri.

Në pjesën e dytë, përcaktohen rregulla dhe standarde për organizimin dhe stafin e Shërbimit të Provës. Në pjesën e tretë, përcaktohen rregullat për llogaridhënien dhe marrëdhëniet me agjencitë e tjera. Në pjesën e katërt, përcaktohen standarde për punën, detyrat e Shërbimit të Provës. Raporti i Shërbimit të Provës para dhënies së vendimit gjyqësor, përgatitet për të ndihmuar, aty ku është e aplikueshme, autoritetin gjyqësor në vendimarrjen për përzgjedhjen e masës apo dënimit më të përshtatshëm. Ky raport duhet të mbështetet në një informacion të përcaktuar qartë, dhe për aq sa është e mundur, të verifikohet dhe përditësohet gjatë ecurisë së procesit. Të pandehurit duhet t'i jepet mundësia e përfshirjes në përgatitjen e raportit, dhe mendimi i tyre duhet të pasqyrohet në raport, si dhe përmbajtja t'u komunikohet atyre ose përfaqësuesve ligjorë.

Në pjesën e pestë, përcaktohen rregullat e procesit të mbikëqyrjes, lidhur me vlerësimin, planifikimin, ndëhyrjet, ekzekutimin dhe përmbushjen e detyrimeve, regjistrimin, informimin dhe konfidencialitetin. Në pjesë e gjashtë, përcaktohen detyra të tjera të Shërbimit të Provës si, puna me viktimat, drejtësia restauruese, parandalimi i krimit. Në pjesën e shtatë, përcaktohen rregullat për procedurën e ankimit dhe monitorimin e Shërbimit të Provës, ndërsa në pjesën e tetë përcaktohen rregullat për kërkimin dhe vlerësimin, marrëdhëniet me median dhe publikun.

Rezoluta (70)1, lidhur me organizimin praktik të masave për mbikëqyrjen dhe kujdesin e mëpasshëm të të dënuarve apo liruarve me kusht, përcakton standarde për:

- shqyrtimin e rekomandimit për parashikimin, zhvillimin dhe përmirësimin e formave të ndryshme të dënimit me kusht dhe masave alternative, dhe rregullimin e metodave për zbatimin e këtyre masave;
- rishikimin e legjislacionit me qëllim: shqyrtimin e mundësisë së reduktimit të kufizimeve të aplikimit të masave alternative (për kategori veprash penale apo të dënuarve), që pengojnë individualizimin e dënimit;
- të theksuar, për aq sa është e mundur, se një hetim para dhënies së vendimit, që ofron informacion të nevojshëm për karakterin e të

pandehurit dhe rrethanat shoqërore të tij, duhet të urdhërohet çdo herë që merret në shqyrtim vënia në provë, apo masa alternative që kërkojnë mbikëqyrje;
- të siguruar arritjen e trajtimit individual më efektiv, duke garantuar njëkohësisht respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personit,
- të siguruar ndryshimin e detyrimeve të përcaktuara në dënimin me kusht, që të jenë të mundshme në rast të ndryshimit të nevojave apo rrethanave,
- të konsideruar legjislacionin dhe praktikën, në mënyrë që në rast mospërmbushje të detyrimeve (pa kryer vepër tjetër penale), në përcaktimin e sanksionit të mos merret parasysh vetëm shkelja e detyrimeve të vendosura, por edhe sjellja e përgjithshme e të dënuarit dhe nevojat e tij për trajtim.

Gjithashtu, në këtë Rezolutë përcaktohet rekomandimi që shtetet të konsiderojnë legjislacionin dhe praktikën, në mënyrë që në rast të kryerjes së një tjetër vepre penale, të ketë mundësi zgjedhje të:

1) vendosjes së një dënimi të pakushtëzuar për të dyja veprat penale, veprën e re dhe atë për të cilën ishte dhënë dënim me kusht,
2) duke ruajtur masën me kusht të vendosur më parë, por mundësisht me ndryshim të detyrimeve, dhe vendosjen e një dënimi të pakushtëzuar të dytë në raport me veprën penale të re, dhe
3) duke vendosur një dënim të dytë me kusht, por për të dyja veprat penale.

Rregulla të tjera janë përcaktuar për rekrutimin dhe trajnimin e stafit të Shërbimit të Provës, pjesëmarrjes dhe përfshirjes së vullnetarëve, kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dënimit dhe lirimit me kusht, ruajtjen e të dhënave etj.

3.3 Standardet Ndërkombëtare të Bashkimit Evropian

Një instrument i rëndësishëm është Vendimi i Këshillit të BE-së 2008/947/JHA, datë 27 nëntor 2008, "Për zbatimin e parimit të njohjes reciproke të gjykimeve dhe vendimeve për vënien në provë me qëllim mbikëqyrjen

e masave për vënien në provë dhe sanksioneve alternative". Ky vendim përcakton llojet e masave dhe dënimeve alternative, kriteret për njohjen reciproke të gjykimeve dhe vendimeve për vënien në provë. Autoriteti kompetent i shtetit kërkues përcjell kërkesën për njohjen e gjykimit dhe, kur është e aplikueshme, të dënimit me vënie në provë, autoritetit kompetet të shtetit anëtar, në të cilin i gjykuari apo i dënuari është ligjërisht dhe zakonisht rezident, në rastet kur i gjykuari është kthyer apo kërkon të rikthehet në atë shtet. Vendimi përcakton gjithashtu, procedurën për njohjen reciproke, si dhe për pasojat në shtetin kërkues, vendimarrjen e shtetit zbatues, përshtatjen e masave dhe dënimeve alternative dhe kushtet për refuzimin e njohjes dhe mbikëqyrjes. Autoriteti kompetent i shtetit zbatues, duhet të ketë juridiksion për marrjen e vendimeve lidhur me pezullimin e dënimit, lirimin me kusht, dënimin me kusht dhe masat alternative, në veçanti në rast të mospërmbushjes së detyrimeve apo kryerjes së një vepre të re penale. Në këtë vendim përcaktohen edhe vendimet që merren për pasojë, në rast mospërmbushje të detyrimeve. Gjithashtu në këtë vendim rregullohet mënyra e informimit nga shteti zbatues dhe mbarimi i juridiksionit të këtij shteti.

Rekomandimi (2017)3, mbi Rregullat Evropiane për dënimet dhe masat komunitare, i miratuar nga Komiteti i Ministrave në datë 22.03.2017, është një nga aktet më të rëndësishme që përcakton në mënyrë të plotë standardet për masat dhe dënimet komunitare, përfshirë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim. Rekomandimi (2017)3, **zëv**endëson Rekomandimin nr.(92)16 të Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat Evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, dhe Rekomandimin (2000)22 të Komitetit të Ministrave, për përmirësimin e zbatimit të Rregullave Evropiane mbi dënimet dhe masat komunitare. Në këtë Rekomandim përcaktohen rregulla lidhur me:

I. **Parimet themelore** - Sanksionet dhe dënimet komunitare (alternative ndaj atyre me burgim), mund të ofrojnë mbik**ë**qyrje, udhëheqje dhe asistim të drejtë dhe efektiv të të dyshuarit apo dënuarit, pa privimin nga liria, duke forcuar perspektivën e përfshirjes në shoqëri, nga e cila varet zakonisht distancimi nga krimi. Natyra dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat individuale. Masat dhe dënimet komunitare duhet të jenë të aplikueshme edhe për të dyshuarit dhe të dënuarit me shtetësi të huaj, dhe të zbatohen në mënyrë të drejtë e në përputhje me këto Rregulla, duke

patur parasysh ndryshimet e rëndësishme të rrethanave. Pra, nuk duhet të këtë parashikim në ligj apo praktikë, që të mohojë aplikimin e masave dhe dënimeve komunitare për shtetasit e huaj. Gjithashtu, nuk duhet të këtë parashikim në ligj për konvertimin automatik të dënimit alternativ komunitar në atë me burgim, në rastin e mospërmbushjes dhe shkeljes të detyrimeve apo kushteve të përcaktuara, me përjashtim të lirimit me kusht.

II. Korniza ligjore - Përdorimi, llojet, kohëzgjatja dhe mënyrat e zbatimit të masave apo dënimeve komunitare, duhet të përcaktohen në ligj. Kushtet dhe detyrimet e masës apo dënimit alternativ, si dhe pasojat në rast mospërmbushje të tyre, duhet të përcaktohen në dispozita të qarta dhe eksplicite. Në ligj duhet të parashikohen edhe autoritetet përgjegjëse për vendosjen, ndryshimin, revokimin dhe zbatimin e masave dhe dënimeve komunitare, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Çdo pengesë formale, përfshirë pengesë ligjore, që parandalon aplikimin e masave apo dënimeve komunitare për të dënuar përsëritës apo me rrezikshmëri, për kategori të caktuara veprash apo cdo kufizim tjetër ligjor, duhet të rishikohet dhe të hiqet, për aq sa është e përshtatshme. Çdo kufizim i tillë ligjor (sikurse mund të jetë aplikimi vetëm për të miturit, të padënuarit me parë, apo të rinjtë), duhet të rishikohet, në mënyrë që masat apo dënimet komunitare të jenë një mundësi ligjore për t'u konsideruar në sa më shumë raste të jetë e mundur.

Kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të përcaktohet nga autoriteti i ngarkuar sipas ligjit, për të vendosur aplikimin e këtij dënimi. Natyra dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e veprës, dëmin e shkaktuar viktimës, dhe duhet të marrë parasysh çdo rrezik të vlerësuar si edhe nevojat e rrethanat. Si rregull, masa apo dënimi komunitar, duhet të përcaktohet nga autoriteti vendimarrës me kohëzgjatje fikse. Si përjashtim, kur ligji parashikon se kohëzgjatja mund të zgjatet, duhet të bëhet shqyrtimi nga autoriteti vendimarrës, për të vendosur nëse ky përjashtim duhet të aplikohet apo nëse jo, të përfundohet masa apo dënimi komunitar.

III. Zbatimi dhe metodat - Zbatimi i masave dhe dënimeve komunitare, duhet të arrijë të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit për komunitetin. Prandaj, masat dhe dënimet duhet të jenë sa më kuptimplota për të dyshuarin/të dënuarin, dhe të kontribuojnë për zhvillimin e tyre personal dhe social. Vendimet për zbatimin e masave dhe dënimeve komunitare, duhet t'u shpjegohen qartë të dyshuarve apo të dënuarve,

në gjuhën që ata kuptojnë, dhe udhëzimet duhet të jenë praktike dhe të sakta. Metodat e zbatimit duhet të përshtaten me rrethanat e çdo rasti dhe autoritetet dhe stafi përgjegjës për zbatimin, duhet të ketë një shkallë diskrecioni për ta bërë të mundur këtë. Në këtë aspekt janë përcaktuar edhe rregullat për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave, garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

IV. Pëlqimi, bashkëpunimi dhe zbatimi - Po ashtu, janë përcaktuar rregulla minimale edhe për pjesëmarrjen e komunitetit, pëlqimin e të dyshuarit apo të dënuarit, bashkëpunimin dhe zbatimin. Masa apo dënimi komunitar, duhet të vendoset vetëm kur kushtet dhe detyrimet e përshtatshme janë vendosur, dhe dihet se i dyshuari apo i dënuari do të bashkëpunojë dhe do t'i përmbushë ato. Jo të gjitha shtetet kanë të përcaktuar si rregull dhënien e pëlqimit nga ana e të pandehurit për të aplikuar masat apo dënimet alternative, por kur ky është përcaktuar si parakusht ligjor, personi duhet ta japë pëlqimin duke patur informacionin e plotë për atë që po jep pëlqimin.

V. Mospërmbushja dhe revokimi - Me fillimin e zbatimit të masës apo dënimit komunitar, i dyshuari apo i dënuari duhet të informohet për përmbajtjen e masës apo dënimit dhe se çfarë pritet prej tij, për pasojat në rast mospërmbushje të detyrimeve dhe kushteve të vendosura, si dhe për rrethanat të cilat i parashtrohen autoritetit vendimarrës në kuadër të mospërmbushjes. Çdo dështim domethënës, për të përmbushur kushtet dhe detyrimet e vendosura në masën apo dënimin alternativ, duhet t'i raportohet sa më shpejt me shkrim autoritetit vendimarrës, nga ana e autoritetit zbatues. Ky raport duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar dhe objektiv të mënyrës si ka ndodhur mospërmbushja dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur. Vendimi për të revokuar një masë apo dënim komunitar, nuk duhet domosdoshmërisht të çojë në një vendim mase apo dënimi me burgim. Një rast i tillë mund të jetë kur, mospërmbushja ndodh në fund të periudhës së provës dhe sjellja gjatë periudhës së provës deri në këtë moment, ka qenë e kënaqshme. Kur vendos për ndryshimin apo revokimin e pjesshëm apo të plotë të masës apo dënimit komunitar, autoriteti vendimarrës duhet të sigurojë që i dyshuari apo i dënuari të ketë mundësinë e shqyrtimit të dokumentacionit dhe të parashtrojë mbrojtjen, duke gëzuar edhe të drejtën për ndihmë juridike. Në këtë aspekt, autoriteti vendimarrës duhet të shqyrtojë si aspektet negative, ashtu edhe ato pozitive. Autoriteti vendimarrës, në përputhje me ligjin, duhet të jetë në gjendje të

përfundojë një masë apo dënim alternativ përpara periudhës së përcaktuar, kur vlerësohet se i dyshuari apo i dënuari ka përmbushur kushtet dhe detyrimet, dhe nuk është më i nevojshëm vazhdimi i tyre për arritjen e qëllimit të masës apo dënimit. Kërkesa mund të paraqitet nga i dyshuari, i dënuari apo autoriteti zbatues.

VI. Organizimi, stafi dhe burimet - Këto rregulla theksojnë domosdoshmërinë e bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese, tek rekrutimi, profesionalizmi dhe trajnimi i stafit përgjegjës, përfshirja e vullnetarëve, mosdiskriminimi etj. Struktura, statusi dhe burimet e agjencive zbatuese, duhet t'i përgjigjen volumit dhe kompleksitetit të detyrave dhe përgjegjësive dhe duhet të reflektojnë rëndësinë e shërbimit që ofrohet.

VII. Inspektimi, monitorimi dhe procedurat ankimuese - Autoritetet zbatuese duhet të jenë subjekt inspektimi dhe monitorimi. Një procedurë ankimuese e drejtë, e thjeshtë dhe e paanshme duhet të garantohet përsa i përket vendimeve të autoritetit zbatues, apo mosmarrjes së vendimit, apo në përgjithësi, për efektet e masës apo dënimit.

VIII. Kërkimi, vlerësimi dhe puna me median dhe publikun - Kërkimet për masat dhe dënimet komunitare, duhet të nxiten dhe të vlerësohen rregullisht. Këto rregulla parashikojnë domosdoshmërinë e përcaktimit të standardeve dhe treguesve të vlerësimit të performancës për programet e zbatimit; rëndësinë e informimit për llojet, natyrën, përmbajtjen dhe mënyrat e zbatimit të masave dhe dënimeve alternative.

4. JURISPRUDENCË NDËRKOMBËTARE

4.1 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.47 datë 26.07.2012, ka theksuar se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si *"ultima ratio"*, Gjykata çmon se ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr.12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ligjvënësi, për arritjen e qëllimeve të tij, ka parashikuar në legjislacionin penal, krahas dënimeve kryesore dhe atyre plotësuese dhe, në kuadër të karakterit demokratik të Kodit Penal, si edhe në shprehje të parimit të humanizmit që e karakterizon, edhe dënimet alternative të dënimit me burgim (nenet 58-65 të KP-së).

Në vendimin nr.19 datë 01.06.2011, Gjykata Kushtetuese është shprehur se konvertimi i dënimit, kur personi është në pamundësi objektive, çka do të thotë se burgimi nuk varet nga ana subjektive e autorit, por nga kushtet ekonomike të të dënuarit, do të shkaktonte një trajtim të diferencuar vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës.

4.2 Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

4.2.1 Revokimi i pezullimit të dënimit me burgim për shkak të kryerjes së një vepre penale dhe parimi i prezumimit të pafajësisë

Në çështjen *Böhmer kundër Gjermanisë*, 37568/97, 3 Tetor 2002, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se në përputhje me seksionin 56 të Kodit Penal, ekzekutimi i dënimit me burgim pezullohet, nëse vlerësohet se vendimi do t'i shërbejë të dënuarit si lajmërim dhe ai nuk do të kryejë vepër tjetër penale në të ardhmen, madje pa ndikimin që vjen nga vuajtja e dënimit me burgim. Në bërjen e kësaj prognoze, gjykata vlerëson personalitetin e personit të dënuar, precedentët penalë, rrethanat e veprës penale, sjelljen pas kryerjes së veprës penale, rrethanat personale dhe efektet që mund të priten si rezultat i pezullimit të dënimit. Seksioni 56f (1) i Kodit Penal, kërkon që gjykata të bazojë vendimin për revokimin e pezullimit, në faktin që personi ka kryer një vepër tjetër penale gjatë periudhës së provës. Në këtë situatë ligjore, arsyetimi në vendimin e Gjykatës së Apelit nuk kufizohej te vlerësimi për personalitetin e kërkuesit apo përshkrimin e dyshimit se kërkuesi kishte kryer vepër penale gjatë periudhës së provës. GJEDNJ theksoi se Gjykata e Apelit, duke vepruar si gjykatë që kontrollon ekzekutimin e vendimit, ka marrë rolin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (Hamburgut), gjykatës kompetente, dhe ka deklaruar pa mëdyshje se kërkuesi ishte fajtor për veprën penale. Kjo rezulton nga formulimi i qartë se, me siguri kërkuesi kishte kryer veprën penale të mashtrimit. Ky përfundim mbështetet nga faktet, për të cilat Gjykata e Apelit mori prova sipas seksionit 308 të Kodit të Procedurës Penale dhe procedoi me vlerësimin substancial për fuqinë

provuese të thënieve të dëshmitarëve. Në këto rrethana, Gjykata arriti në përfundimin se arsyetimi në vendimin e 14 Tetor, 1996, i Gjykatës së Apelit në Hamburg, ceënonte prezumimin e pafajësisë, si element të procesit të rregullt ligjor dhe kishte shkelje të nenit 6/2 të KEDNJ.

Në çështjen *El Kaada kundër Gjermanisë*, 2130/10, GJEDNJ theksoi se vendimi për revokimin e pezullimit të dënimit me burgim të një vendimi të mëparshëm, përpara dënimit të të dyshuarit në procedimin e ri penal, cenon prezumimin e pafajësisë. GJEDNJ arsyetoi se në veçanti gjykatat gjermane deklaruan bindjen e tyre të plotë se, kërkuesi El Kaasa kishte kryer përsëri vepër penale gjatë periudhës së provës. Gjetjet e tyre kishin arritur në një deklaratë të qartë se ai ishte fajtor për veprën penale, përpara se të dënohej për të nga gjykata kompetente me vendim përfundimtar, në përputhje me ligjin. GJEDNJ theksoi se gjykatat gjermane e kishin bazuar vendimin e tyre për revokimin e pezullimit, vecanërisht në faktin se kërkuesi fillimisht kishte pohuar fajësinë përpara gjyqtarit të hetimeve paraprake. Gjykatat gjermane e kishin konsideruar pohimin e kërkuesit si të besueshëm, duke e bazuar vlerësimin e tyre në llogaritë e dëshmitarëve, edhe pse në kohën e revokimit të pezullimit të dënimit, kërkuesi e kishte tërhequr pohimin.

Edhe në çështjen e mëparshme *Böhmer kundër Gjermanisë,* GJEDNJ vlerësoi se kishte shkelje të nenit 6/2 të KEDNJ, në vendimin gjyqësor për revokimin e pezullimit të dënimit me burgim për kryerje të një vepre tjetër penale gjatë periudhës së provës, i cili çoi në një vlerësim për fajësinë, përpara se kërkuesi të dënohej në një proces penal nga gjykata kompetente. Vendimi në atë rast mbështetej në dispozitat e Kodit Penal gjerman, të aplikueshme për personat madhorë, pothuaj identike me dispozitat e seksionit për të rinjtë, të aplikuara në rastin konkret. Në rastin e parë, GJEDNJ theksoi se Qeveria kishte deklaruar qëllimin për të shqyrtuar nëse, ndryshimi i dispozitave të Kodit Penal ishte i nevojshëm për të siguruar që revokimi i pezullimit në të tilla rrethana si në këtë rast, të mos cenonte prezumimin e pafajësisë, garantuar nga neni 6/2 i KEDNJ. Gjithsesi, nuk ishin bërë ndryshime në ligj dhe procedurat në rastin e *El Kaada kundër Gjermanisë,* treguan se interpretimi i seksionit për të rinjtë nuk ishte në përputhje me nenin 6/2 të KEDNJ. GJEDNJ arriti në përfundimin se arsyetimi i gjykatave gjermane për të revokuar pezullimin e dënimit me burgim për z. *El Kaada,* kishte cënuar prezumimin e pafajësisë dhe shkelur nenin 6/2 të KEDNJ.

Jurisprudenca e mësipërme e GJEDNJ, paraqet një rëndësi të madhe për shqyrtimin e revokimit të pezullimit të dënimit me burgim, për shkak të

kryerjes së një vepre tjetër penale nga i dënuari gjatë periudhës së provës. Në këto raste, gjykatat duhet të tregohen të kujdesshme në arsyetim dhe të shmangin formulimet dhe vlerësimet për fajësinë, përpara se kërkuesi të deklarohet fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprën penale të re, nga gjykata kompetente që shqyrton në themel akuzën në ngarkim të tij. Por, nga ana tjetër, thjesht ekzistenca e të dhënave dhe dyshimit se i dënuari ka kryer një vepër tjetër penale gjatë periudhës së provës, është e mjaftueshme për revokimin e pezullimit apo aplikimin e pasojave të tjera të përcaktuara në ligj.

4.2.2 Kushtet shëndetësore

Një nga elementët që shqyrtohen nga gjykata në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, është kushtet shëndetësore të të pandehurit. GJEDNJ ka një jurisprudencë të pasur për shqyrtimin e rasteve të të burgosurve me probleme shëndetësore specifike, në aspektin e nenit 3 të KEDNJ. Dënimi me burg i personave të sëmurë mund të çojë në shkelje të nenit 3 të Konventës, kur kushtet nuk iu përshtaten nevojave të tyre specifike.[26] Gjyqtari, në mendimin e tij paralel, në çështjen *Price kundër Mbretërisë së Bashkuar*[27], theksoi se trajtimi që nuk do të mund të konsiderohej as çnjerëzor, as degradues për një person të aftë fizikisht, mund të konsiderohej i tillë për një person me nevoja të veçanta. Prandaj, shqyrtimi i kushteve shëndetësore specifike të të pandehurit paraqet një rëndësi të madhe. Në këtë aspekt, duhet të mbahen në konsideratë edhe standardet e tjera ndërkombëtare. Paragrafi 1 i Rekomandimit të Komitetit të Ministrave Nr. R (87) 3, në lidhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve, përcakton se "privimi i lirisë duhet të kryhet në kushte të tilla materiale dhe morale që respektojnë dinjitetin njerëzor dhe janë në përputhje me këto rregulla". Edhe në çështjen *Dybeku kundër Shqipërisë*[28], Gjykata e Strasburgut vendosi se në rastin e një të burgosuri me probleme shëndetësore specifike, masa të përshtatshme duhet të merren nga autoritetet shqiptare, që të mos ketë shkelje të nenit 3, dhe masa të tilla duhet të parashikohen për të gjithë të burgosurit në situata të ngjashme.[29] Nëse masa të tilla të përshtatshme nuk merren nga ana e autoriteteve kompetente, kjo situatë mund të çojë në shkelje të nenit

[26] *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Botimi i katërt, Ledi Bianku, Odeta Kumbaro, Tiranë 2017, faqe 257.*

[27] *Price kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 33394/96, datë 10 Korrik 2001.*

[28] *Kërkesa nr. 41153/06, datë 18 dhjetor, 2007.*

[29] *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Botimi i katërt, Ledi Bianku, Odeta Kumbaro, Tiranë 2017, faqe 198.*

3, të KEDNJ. Kjo e bën shumë të rëndësishëm shqyrtimin me kujdes nga gjykata të kushteve shëndetësore të të pandehurit, që në fazën e gjykimit dhe përcaktimit të llojit të dënimit.

4.2.3 Rreziku për kryerjen e një vepre tjetër penale

Kusht tjetër ligjor, për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, është rrezikshmëria e pakët e personit dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale. Këto kushte janë të lidhura ngushtë me rrezikun e kryerjes së një vepre penale tjetër nga i pandehuri, në të ardhmen. Rekomandimi nr.(99)22 i Komitetit të Ministrave, lidhur me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë në burgje, thekson se në mënyrë që dënimet komunitare të jenë alternativa të besueshme, zbatimi efektiv i tyre duhet të sigurohet, në veçanti nëpërmjet zhvillimit dhe përdorimit të teknikave të vlerësimit të riskut dhe parashikueshmërisë së besueshme të riskut, duke identifikuar rrezikun e të dënuarit për ripërsëritje dhe për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë publike. Dënimi alternativ është mundësi potenciale për personat, që për shkak të rrezikshmërisë së pakët shoqërore, të reflektuara edhe në sjelljen e mëparshme ose pas kryerjes së vepres penale, krijojnë garanci për rehabilitimin e tyre dhe moskryerjen e veprave penale në të ardhmen. Prandaj, në këtë aspekt, gjatë shqyrtimit të mundësisë së aplikimit të dënimit alternativ, rëndësi paraqet analiza e rrethanave konkrete për të arritur në një përfundim të tillë.

Në çështjen *Aleksandr Makarov v. Russia*, 15217/07, 12 March 2009, GJEDNJ parashtroi se në një numër urdhër-ndalimesh, gjykatat vendase citonin mundësinë që kërkuesi të kryente përsëri vepër penale, si arsye për vazhdimin e paraburgimit. GJEDNJ theksoi se autoritetet gjyqësore nuk përmendën ndonjë fakt specifik, në mbështetje të vlerësimit mbi rrezikun e kryerjes së një vepre penale nga ana e kërkuesit. Prandaj, GJEDNJ nuk ndante të njëjtin qëndrim me autoritetet vendase se, në një situatë kur të gjitha akuzat në ngarkim të kërkuesit, me përjashtim të njërës, i atribuoheshin për shkak të veprimeve të tij si kryetar bashkie dhe ai ishte pezulluar nga kjo detyrë, ekzistonte një rrezik real për kryerjen e një vepre të re penale. Në çështjen *Muller kundër Francës*,[30] GJEDNJ theksoi se përsa i përket rrezikut për rikryerjen e një vepre penale, referimi të precedentët e mëparshëm të personit, nuk mjafton për të justifikuar refuzimin e lirimit të tij. Ndërsa në çështjen *N.C kundër Italisë*[31], GJEDNJ theksoi se gjyqtari i hetimeve

[30] *Kërkesa 21802/93, datë 17 Mars 1997.*

[31] *Kërkesa 24952/94, 11 January 2001.*

paraprake e bazoi vendimin e tij, përveç se në provat për fajësinë, edhe në faktin se kërkuesi kishte ende pozicionin si drejtor teknik në shoqërinë X, dhe ishte kështu në pozitë për kryerjen e veprave penale të tjera të ngjashme. Duke iu referuar vendimit, GJEDNJ theksoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Brindizit ishte mbështetur përsëri në ekzistencën e provave për fajësinë dhe shpjegoi ekzistencën e rrezikut të rikryerjes së veprave penale, duke iu referuar faktit se "si ai ia kishte arritur në kundërshtim me ligjin të merrte përfitimet ekonomike të identifikuara". GJEDNJ nuk e vlerësoi si arbitrar përfundimin e autoriteteve vendase se kishte një rrezik të mirëfilltë që kërkuesi të rikryente vepër penale në të ardhmen.

5. REGJIMI JURIDIK MATERIAL

5.1 Vlerësimi i kushteve të nenit 59 të Kodit Penal

Duke pasur parasysh veçoritë e secilit rast, duhet thënë se vetëm gjyqtari është në gjendje të gjykojë, siç duhet, përshtatshmërinë e masës konkrete të dënimit. Prej kësaj, jo vetëm që vijon se përmbajtja e veprës dhe masa e dënimit, të vlerësuara me drejtësi, duhet t'i korrespondojnë njëra-tjetrës, por edhe që dënimi i dhënë në secilin rast të veçantë, duhet të jetë detyrimisht në një raport të drejtë me peshën e veprës dhe me shkallën e fajit të autorit. Duke qenë se veprat penale rregullisht janë të ndryshme për sa i takon shkallës së fajit dhe masës së rrezikshmërisë, parimisht i duhet lënë gjyqtarit mundësia që dënimin që ai jep, t'ua përshtasë këtyre dallimeve. Dënimet, kur është e nevojshme, duhen interpretuar konform Kushtetutës, me qëllim që të garantohet, edhe në rastet ekstreme, të mos jepen dënime të cilat nuk janë në raport të drejtë me rrezikshmërinë shoqërore dhe shkallën e fajit.[32]

Për aplikimin e dënimit alternativ: "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove", është i domosdoshëme plotësimi i kushteve të mëposhtme:

1- *dënimi i të pandehurit deri në pesë vjet burgim,* dhe
2- *rrezikshmërisë së paktë të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale;*

[32] *Vendime të Përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, botim jubilar, Prof. em. Dr. Jürgen Schëabe, 2010 Fondacioni Konrad-Adenauer e.V, faqe 626, 627.*

3- *moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, si dhe*
4- *të sjelljes pas kryerjes së veprës penale.*

Nëse kushti i parë, që lidhet me marzhin e dënimit të caktuar, nuk plotësohet, atëherë dënimi alternativ nuk duhet të aplikohet. Ndërsa, vlen të theksohet se, shqyrtimi dhe vlerësimi i kushteve të "*rrezikshmërisë së paktë të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale*", bëhet në tërësi. Nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore, vërehet se këto rrethana shqyrtohen në tërësi dhe gjykata bën një vlerësim të tyre, duke përfshirë rrezikshmërinë e personit dhe të veprës penale, sjelljes pas kryerjes së veprës penale dhe rrethanat shëndetësore, familjare etj. Pra, nuk mjafton vetëm ekzistenca e rrethanës shëndetësore apo familjare, për të aplikuar nenin 59 të K.Penal, nëse nga rrezikshmëria e personit apo nga rrethanat e veprës penale, del se dënimi alternativ nuk është i përshtatshëm për t'u aplikuar.

Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal, rezulton se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Në vendimin Nr. 151, datë 18.06.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera përcaktohet se: "Nga interpretimi logjik e literal i kësaj dispozite, së pari evidentohet se zbatimi i nenit 59 të K.Penal është në diskrecion të gjykatës, e cila nëse çmon se plotësohet një ose disa nga kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë, vendos aplikimin e saj. Nga ana tjetër, në mënyrë që të aplikohet kjo dispozitë nga gjykata, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si më poshtë vijon: Së pari: Të ekzistojë një prej kushteve të renditur në pjesën e parë të paragrafit të parë të kësaj dispozite, si rrezikshmëria e pakët e personit, autorit të veprës, mosha e të gjykuarit, kushtet shëndetësore apo mendore të tij, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, të cilët janë kushte alternativë jo kumulativë. Pra, mjafton të evidentohet se ekziston njëri prej tyre së bashku me kushtin tjetër, të poshtërenditur; Së dyti: Gjykata të ketë dhënë ndaj të pandehurit, në përfundim të gjykimit, një dënim jo më të lartë se pesë vjet burgim. Pra, ligjvënësi e ka lidhur zbatimin e nenit 59 me masën e dënimit të dhënë nga gjykata (kur jep dënim me burg deri në pesë vjet), dhe jo me

atë të parashikuar nga dispozita konkrete e pjesës së posaçme të K.Penal, për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri. Nga sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, në mënyrë që të aplikohet në çdo rast konkret neni 59 i K.Penal, duhet të evidentohet ekzistenca e njërit prej kushteve alternative të renditur në pjesën e parë të fjalisë së parë të këtij neni dhe gjykata të ketë caktuar një dënim deri në pesë vjet burgim.".

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër[33] vërehet qëndrimi i mbajtur se: "Arrihet në këtë konkluzion duke pasur parasysh vetë qëllimin e nenit 59 të K.Penal "ratio legis", aplikimi i të cilit lidhet pikërisht me qëllimin riedukues të dënimit penal, i cili në disa raste çmohet se realizohet pa qenë e nevojshme që individi të izolohet nga shoqëria. Prandaj kjo dispozitë, veç të tjerash, vendos si kriter edhe dhënien e një dënimi deri në pesë vjet burgim duke pasur parasysh llojet e veprave për të cilat gjykata mund të caktojë një dënim të tillë, rrezikshmërinë relativisht të ulët të autorit dhe të veprës, të cilat prezumohet të jenë çmuar një herë nga gjykata për caktimin e dënimit në bazë të fakteve dhe rrethanave të secilës çështje konkrete, të cilat, nga ana tjetër janë të njëjtat fakte dhe rrethana që mbahen parasysh prej saj edhe për aplikimin e nenit 59 të K.Penal."

Ndërsa në vendimin nr.189 datë 26.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është mbajtur qëndrimi se: *"Mundësia ligjore e zbatimit të nenit 59 të Kodit Penal, kufizohet vetëm brenda kritereve të parashikuara nga kjo dispozitë, të cilat në thelb lejojnë këtë alternative dënimi vetëm për shkaqe të posaçme, të lidhura me personalitetin e autorit të veprës penale, moshën e tij, kushtet shëndetësore e mendore, nevojat familjare, ato të punës dhe të shkollimit. Rrethanat e lartpërmendura nuk diktojnë domosdoshmërinë e edukimit të autorit të veprës penale jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit, për të garantuar përmbushjen e nevojave të tij familjare, dhe së dyti vlerësohet si një mundësi potenciale vetëm për personat që, për shkak të rrezikshmërisë së pakët shoqërore, të reflektuara në mënyrën e kryerjes së vepres penale, sjelljen e mëparshme ose pas kryerjes së veprës penale, krijojnë garanci për rehabilitimin e tij edhe brenda mjedisit familjar e shoqëror dhe nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës".*

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Apelit Shkodër, vërehet se arsyetohet në mënyrë të hollësishme jo vetëm përmbushja e kushteve ligjore, por trajtohet edhe qëllimi i dënimit alternativ, standardet ndërkombëtare për aplikimin e dënimit alternativ dhe pasojat

[33] *Vendim nr.51 datë 19.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

në rast mospërmbushje të detyrimeve. Në disa raste, kur këto rrethana janë pasqyruar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk janë analizuar në mënyrë të veçantë nga gjykata e Shkallës së Parë, kjo ka sjellë si pasojë një disponim të ndryshëm nga gjykata e Apelit.

Në aspekt jo vetëm të interpretimit dhe qëllimit të zbatimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim si dënim alternativ, por edhe të analizës së rrethanave në të cilat aplikohet, vlen të theksohet vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër datë 12.06.2019, ndaj të pandehurit B.B për veprat penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", që parashikohen nga neni 278/1 dhe 278/2 i Kodit Penal. Në këtë vendim gjykata ka arsyetuar hollësisht jo vetëm kushtet e aplikimit të dënimit alternativ, por edhe kuptimin e qëllimin e aplikimit. Në këtë vendim, Gjykata ka arsyetuar se: "*Aplikimi i dënimeve alternative për vepra me rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore, në rastet kur i pandehuri paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore, duhet të jetë rregull dhe jo përjashtim. Përjashtim duhet të përbëjë ekzekutimi i dënimit me burgim për vepra jo të rënda, i cili duhet të rezervohet vetëm për atë kategori personash të cilët me sjelljen e tyre krijojnë bindjen tek gjykata se,* dënimet alternative nuk janë një mundësi efektive dhe e përshtatshme për të arritur qëllimet e dënimit penal. Në rastin në shqyrtim, për shkak të rrezikshmërisë së ulët të të pandehurit, rezulton *i panevojshëm vijimi i mbajtjes së tij në burgim, ndërkohë që vënia e tij në provë ofron mundësinë e riedukimit të tij në liri (duke mos përjashtuar përsëri vuajtjen e plotë të dënimit me burgim,* në rast abuzimi me këtë mundësi të dhënë nga ligji)".[34]

[34] Ndërsa përsa i përket vlerësimit të rrethanave, gjykata në këtë vendim ka arsyetuar se: "*Si rrethana që krijojnë bindjen se pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim është zgjidhja më e drejtë ligjore për të pandehurin B.B në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit mban në konsideratë faktin se ai është i padënuar më parë, qëndrimin pohues të tij ndaj veprave të kryera dhe shfaqjen e pendimit të thellë para gjykatës, faktin se e ka vuajtur një pjesë të konsiderueshme të dënimit të dhënë nga gjykata, gjendjen e tij problematike dhe kronike shëndetësore (me fraktura të kockave të nofullave dhe dhëmbëve, me komplikacione të vazhdueshme të infeksioneve dhe fistula në to nga sinuset maksilare, të shoqëruara me zmadhim të nyjeve limfatike dhe dhimbje të shumta gjatë përtypjes, dëmtime për të cilat trajtohet me një pagesë invaliditeti të përhershme nga shteti italian ku dhe është aksidentuar në vitin 2002), si dhe faktin se megjithë këtë problematikë shëndetësore për të cilën ka nevojë për trajtime të specializuara, ai ka detyrime thelbësore ndaj familjes së tij, pasi jeton vetëm me babain e sëmurë dhe në moshë të thyer (thuajse 82 vjeç). Gjykata e Apelit konstaton se megjithëse në vendimin e shkallës së parë është pranuar se vepra e kryer nga i pandehuri nuk paraqet ndonjë rrezikshmëri veçanërisht të lartë shoqërore; i pandehuri B. B ka pasur sjellje të mirë gjatë gjithë procesit gjyqësor, duke pranuar faktin që i atribuohet dhe duke shfaqur pendesë të thellë për veprën e kryer; duke pranuar se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar ndonjëherë më parë; duke pranuar se nuk konstatohet asnjë rrethanë rënduese në ngarkim të tij dhe duke pranuar se i pandehuri nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore të tillë, e cila e bën të nevojshme dhe të domosdoshme që gjykata të japë një*

Në praktikën e Gjykatës së Apelit Shkodër, del në pah qëndrimi lidhur me detyrimin për arsyetimin nga gjykata e Shkallës së Parë të arsyeve të mosaplikimit të dënimit alternativ. Konkretisht, në vendim arsyetohet se: *"Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vepruar gabim duke u shprehur vetëm për llojin dhe masën e dënimit ndaj këtij të pandehuri dhe duke mos shqyrtuar fare mundësinë e dënimeve alternative (madje duke mos dhënë asnjë arsye përse e rrëzon një kërkim të shprehur të mbrojtjes dhe të pandehurit), sikurse është pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë.".*

Nga studimi i vendimeve gjyqësore, duket se një rëndësi të veçantë ka rrezikshmëria e personit, nëse ka qënë i padënuar më parë. Rrethanat që gjykata ka marrë, vlerësuar në mënyrë të veçantë në këto raste, *për aplikimi*n *e pezullimi*t të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, janë të ndryshme por lidhen kryesisht, sipas shpeshtësisë, me rrethanat familjare, ekonomike, shëndetësore, nevojat për arsimim dhe punësim.

Një rrethanë tjetër e vlerësuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, për aplikimin e pezullimit të dënimit me burgim, e cila nuk parashikohet shprehimisht në nenin 59 të Kodit Penal, është edhe koha e vuajtur në paraburgim nga i pandehuri. "*Koha e vuajtur në paraburgim nga i pandehuri së bashku me mbajtjen e tij në provë për një kohë të gjatë janë premisa më të shëndosha se vijimi i burgimit,* për të mbështetur funksionin edukues të dënimit penal në rastin konkret".

5.2 Kushtet për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal

5.2.1 Masa e dënimit të aplikuar për të pandehurin

Kushti i parë është objektiv, pra dhënia e dënimit deri në pesë vjet burgim. Dispozita referon në dënimin e caktuar nga gjykata, dhe jo në dënimin që parashikon dispozita penale në këtë rast. Praktika gjyqësore ka mbajtur

masë dënimi me burgim të rëndë ndaj tij, në mënyrë kontradiktore ka vendosur vuajtjen e plotë të dënimit me burgim të caktuar prej tij. Në rastin në shqyrtim, megjithëse veprat abstrakte të kryera nga i pandehuri parimisht paraqesin një rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore, veprat konkrete të kryera nga ai nuk paraqesin një rrezikshmëri veçanërisht të lartë shoqërore, të tillë që të nxirrnin në hije rrethanat e tjera të forta të përmendura më lart në favor të aplikimit të një dënimi alternativ. Kështu, megjithëse i pandehuri B. B ka mbajtur një armë zjarri pa leje, lloji i armës së mbajtur (pistoletë Zastava), vendi i mbajtjes së saj (në një lokal nën administrimin e tij), si dhe mospasja e asnjë konflikti dhe mospërdorimi i saj, janë tregues të një rrezikshmërie jo të lartë të kësaj lloj vepre penale. Po njësoj, mbajtja e një sasie fishekësh në banesë, pa pasur një armë zjarri për përdorimin e tyre, nuk tregon për ndonjë rrezikshmëri shumë të lartë të kësaj vepre konkrete"

qëndrimin e referimit në masën e dënimit përfundimtar të caktuar prej saj, pas aplikimit të uljes së dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar. Pra, edhe nëse i pandehuri është dënuar me një masë dënimi më të lartë se 5 vjet burgim, në rast se është aplikuar gjykimi i shkurtuar dhe pas uljes rezulton një dënim deri në pesë vjet, atëherë konsiderohet i plotësuar ky kusht.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të vitit 2018, 2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Korçë, Shkodër dhe Fier, si dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Tiranë, vërehet se në të gjitha rastet është respektuar marzhi i dënimit, i parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal, për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë. Në rastet kur është aplikuar gjykimi i shkurtuar, ky kriter ligjor është shqyrtuar në referim të masës së dënimit përfundimtar të caktuar nga gjykata, pas llogaritjes dhe zbritjes së 1/3 ulje të dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, sipas nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale.

5.2.2 Rrezikshmëria e personit

Qenia ose jo i dënuar më parë, është elementi kryesor në të cilin gjykatat mbështeten në vlerësimin e rrezikshmërisë së të pandehurit. Në rastet kur personi ka qenë i dënuar më parë, merren parasysh edhe elementë të tjerë të rëndësishëm si, lloji dhe rrethanat e veprës penale për të cilën ka qenë i dënuar më parë, koha e kaluar prej kryerjes së veprës penale të mëparshme, si dhe ana subjektive e veprës penale, nëse vepra penale e mëparshme është kryer me dashje apo nga pakujdesia.

Në vlerësimin e rrezikshmërisë së personit, nga studimi i vendimeve gjyqësore është konstatuar se, pothuaj në të gjitha rastet, i pandehuri ka qenë i padënuar më parë. Rastet kur i pandehuri ka qenë i dënuar, janë të pakta. Përgjithësisht mungon një arsyetim më i hollësishëm lidhur me llojin e veprës penale për të cilën ka qenë i dënuar më parë dhe kohën e kaluar nga vepra penale e mëparshme. Në këto raste, gjykata mjaftohet vetëm me vlerësimin si rrethanë rënduese të qenies së të pandehurit i dënuar më parë.

Konkretisht, nga studimi i 472 vendimeve gjyqësore të vitit 2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilat është aplikuar dënimi alternativ i përcaktuar në nenin 59 të Kodit Penal, rezulton se vetëm në pak raste personi ka qenë i dënuar më parë. Nga të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të studiuara,[35] në të cilat personat kanë

[35] *Vendimi nr.688, datë 08.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të Vjedhjes, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. Megjithëse personi ka qenë i dënuar më parë, është marrë parasysh një sërë rrethanash si, pendimi i thellë, sëmundja mendore, kryerja e veprës penale nën*

qenë të dënuar më parë, veprat penale kanë qenë me rrezikshmëri të ulët. Ndërsa në një rast tjetër,[36] për veprën penale të "Përndjekjes", parashikuar nga neni 121/a/2, megjithëse personi ka qenë i dënuar më parë, është marrë parasysh prania e një sërë rethanash në aplikimin e nenit 59 të K.Penal, të tilla si: qenia i martuar me fëmijë, pendimi i thellë dhe normalizimi i marrëdhënieve me viktimën dhe mos shmangia ndaj procedimit penal. Gjithsesi, edhe në këtë rast periudha e provës ka qenë relativisht e lartë, përkatësisht 16 muaj. Edhe nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vërehet se rastet e aplikimit të dënimit alternativ kur personi ka qenë i dënuar më parë, janë të rralla. Në këtë aspekt, duhet të zbatohet një nga rekomandimet në aktet ndërkombëtare, se efekti i të qenit i dënuar më parë duhet të varet nga karakteristikat e rekordeve kriminale dhe duhet të reduktohet, ose nuk duhet të merret parasysh, në rastet kur ka pasur një periudhë domethënëse pa kriminalitet, i pandehuri është i mitur, apo ka qënë i tillë në kohën e kryerjes së veprës, i pandehuri është ende i ri. Prandaj, rekomandohet që gjykatat, përveç administrimit të certifikatës së gjendjes gjyqësore ku pasqyrohet nëse i pandehuri ka qenë i dënuar më parë, në rastet kur ka qenë i dënuar, të administrojnë edhe vendimin gjyqësor për shqyrtimin e elementëve të mësipërm.

Por, rrezikshmëria e personit nuk del vetëm nga fakti i të qenit ose jo, i dënuar më parë. Në shumicën e vendimeve të gjykatave të Rrethit Gjyqësor Tiranë, Korçë, Shkodër dhe Fier, nga gjykata arsyetohet mungesa e rrezikshmërisë për shkak të qëndrimit pohues dhe pendues të mbajtur në gjykim, si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale. Në këtë aspekt, vlen të theksohen disa qëndrime në praktikën gjyqësore, lidhur me vlerësimin e rrezikshmërisë së personit si të ulët. Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitin 2018, rezultojnë një tërësi rrethanash të vlerësuara nga gjykata në aspektin e rrezikshmërisë së ulët të personit. Në një rast, gjykata ka marrë parasysh si rrethanë për vlerësimin e rrezikshmërisë së ulët të personit, mentalitetin e tij[37]. Në një rast tjetër[38], gjykata ka marrë parasysh vlerësimin në Raportin e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës

ndikimin e alkoolit, vlera e vogël e sendit të vjedhur dhe riparimi i dëmit civil, mosshmangia ndaj procedimit.

[36] *Vendimi nr.1490, datë 18.05.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[37] *Vendimi nr.1634 datë 31.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të Dhunës në familje, parashikuar nga neni 130/a/ të K.Penal.*

[38] *Vendimi nr.952 datë 29.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të "Prodhimin dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake", parashikuar nga neni 278/1 të K.Penal.*

Tiranë, të paraqitur gjatë gjykimit për të vlerësuar rrezikshmërinë e ulët të personit. Për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, gjykata[39] ka marrë parasysh kryerjen e veprës nga pakujdesia, qëndrimin e të pandehurit në vendngjarje dhe respektimin e masës së sigurimit personal dhe normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarit. Për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", në formën e mbajtjes, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, gjykata[40] me të drejtë ka marrë parasysh qenien përdorues të lëndëve narkotike nga ana e të pandehurit, sasinë dhe llojin e lëndës narkotike, përveç qëndrimit ndaj veprës penale.

5.2.3 Sjellja pas kryerjes së veprës penale

Sjellja pas kryerjes së veprës penale lidhet si fillim me qëndrimin e të pandehurit ndaj veprës penale, por pa u kufizuar vetëm te kjo. Sa i përket sjelljes pas kryerjes së veprës penale, ka pasur qëndrime të ndryshme në praktikën gjyqësore, përsa i përket vlerësimit të saj si kusht. Sipas qëndrimit të parë, sjellja pas kryerjes së veprës penale nënkupton pranimin e kryerjes së veprës penale nga ana e të pandehurit dhe shprehjen e pendimit të thellë. Ndërsa sipas qëndrimit të dytë, sjellja nuk nënkupton domosdoshmërisht pranimin e fajësisë dhe shprehjen e pendimit, për arsye se interpretimi i kundërt do të cenonte të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit. Kjo do të kushtëzonte aplikimin e dënimit alternativ me pranimin e fajësisë, edhe kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal. Në këtë aspekt, gjykata, në vlerësimin e sjelljes pas kryerjes së veprës penale, merr parasysh qëndrimin e të pandehurit pas veprës penale duke vlerësuar elementët si:

- largimin e tij apo paraqitjen në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale;
- qëndrimin e mbajtur në raport me respektimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj tij;
- normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarin;
- nëse ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale, ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale.

[39] *Vendimi nr.383 datë 08.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
[40] *Vendimi nr.969 datë 30.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Gjykata e Apelit Shkodër, *në disa raste*, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së Shkallës së Parë që kishte aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, duke arsyetuar në mënyrë të hollësishme elementë, si: faktin që i pandehuri *rezulton të jetë i dënuar për kryerjen e dy veprave penale të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi parashikojnë një dënim relativisht të lartë; qëndrimin e të pandehurit, faktin që i është shmangur gjykimit, duke mos u paraqitur në këtë gjykim duke bërë që gjykimi ndaj tij të zhvillohet në mungesë.*

Nga studimi i 472 vendimeve gjyqësore të vitit 2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se vetëm në 32 raste është konstatuar aplikimi i nenit 59 të K.Penal, për të pandehur që kanë mbajtur qëndrim mohues ndaj kryerjes së veprës penale, duke kërkuar pafajësi, pushimin e çështjes, ndërsa në një rast i pandehuri ka qenë në mungesë në gjykim.

Nga studimi i 26 vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilat është aplikuar neni 59 i K.Penal, rezulton se i pandehuri ka mbajtur qëndrim pohues ndaj veprës penale.

Nga studimi i 194 vendimeve gjyqësore të vitit 2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në të cilat është aplikuar neni 59 i K.Penal rezulton se vetëm në 2 raste i pandehuri nuk ka pranuar akuzën.

Ndërsa në 49 vendimet e vitit 2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në të cilat është aplikuar neni 59 i K.Penal, rezulton se në të gjitha rastet të pandehurit kanë qenë të pranishëm në gjykim dhe kanë mbajtur qëndrim pohues ndaj veprës penale dhe/ose kanë kërkuar gjykim të shkurtuar.

Pra, përfundimi i arritur nga studimi i praktikës gjyqësore është se, kryesisht dënimi alternativ i përcaktuar nga neni 59 i K.Penal, është dhënë ndaj të pandehurve që kanë mbajtur qëndrim pohues dhe pendues ndaj veprës penale. Përqindja e aplikimit të nenit 59 të K.Penal, ndaj të pandehurve që kanë mbajtur qëndrim pohues dhe pendues, është shumë e lartë në raport me rastet kur, të pandehurit kanë kërkuar pafajësi apo pushim të çështjes, apo kanë qenë në mungesë. Për rrjedhim, qëndrimi i të pandehurit ndaj veprës penale, është element shumë i rëndësishëm që merret parasysh nga gjykata, por nuk është kriter përjashtues për aplikimin e nenit 59 të K.Penal. Prandaj, pranimi i kryerjes së veprës penale dhe shprehja e pendimit të thellë vlerësohet pozitivisht në aspektin e sjelljes pas kryerjes së veprës penale, por e kundërta, mospranimi i fajësisë, nuk përbën shkak të vetëm dhe të mjaftueshëm për të mos aplikuar këtë dënim alternativ. Në këtë aspekt, rëndësi merr shqyrtimi i elementëve të tjerë të sjelljes pas veprës penale, të përmendur më sipër.

5.2.4 Rrethanat e veprës penale

Në rrethanat e veprës penale, nga studimi i vendimeve gjyqësore, rezulton se kanë mbizotëruar elementë të tillë si, objekti material i veprës penale, pasoja konkrete e ardhur, qëllimi apo kryerja e veprës nën ndikimin e kushteve të caktuara (si alkooli, sëmundja mendore etj.).

Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitin 2018, rezultojnë për veprën penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/1 apo 134/2 të Kodit Penal, rrethana të tilla si: lloji dhe vlera e sendeve të vjedhura, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, kryerja e veprës penale nën ndikimin e alkoolit, dhe në ulje të ekulibrit mendor për shkak të sëmundjes mendore, riparimi i dëmit civil të shkaktuar.[41] Në një rast tjetër,[42] janë patur parasysh rrethana të kryerjes së veprës penale si, mbetja në tentativë e veprës dhe mosardhja e pasojave të mëdha. Për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike", parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, gjykata[43] ka marrë parasysh rrethana të kryerjes së veprës penale si: qëllim i përdorimit të energjisë elektrike për konsum familjar, pra jo për qëllim biznesi; koha e shkurtër e përdorimit; mospasja e detyrimeve ndaj OSHEE sh.a..

Analiza e hollësishme e rrethanave të veprës penale është e rëndësishme, sepse ndihmon në përcaktimin e rrezikshmërisë së personit dhe për rrjedhim në arritjen e një përfundimi më të saktë, mbi mundësinë e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal.

5.2.5 Mosha e të pandehurit

Mosha përbën një rrethanë të rëndësishme, në drejtim të shqyrtimit të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë. Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se, në disa raste mosha si rrethanë personale përmendet thjesht si rrethanë, ndërsa në disa të tjera ajo konkretizohet si moshë e re, ose e vjetër mbi 60 vjeç. Ndërsa, nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përsa i përket moshës si rrethanë pozitive, është vlerësuar mosha e re deri në 21 vjec dhe mosha e vjetër mbi 60 vjeç. Referuar legjislacionit italian, nenit 163 të Kodit Penal, mosha e të pandehurit është përcaktuese për masën e dënimit, për të cilën lejohet aplikimi i pezullimit

[41] *Vendim nr.32 datë 15.01.2018, dhe nr.688 datë 08.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[42] *Vendim nr.598 datë 01.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

[43] *Vendim nr.270 datë 31.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

të ekzekutimit të dënimit me burgim. Kështu, për të rinjtë (personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, por nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç), dënimi i dhënë për të cilin mund të aplikohet pezullimi, është deri në dy vjet. Për personat mbi 70 vjeç, pezullimi mund të aplikohet për dënime të dhëna deri në 2 vjet e 6 muaj burgim, ndërsa për të miturit, pezullimi mund të aplikohet për dënime të dhëna me një marzh më të lartë, deri në 3 vjet burgim.

5.2.6 Kushtet e tjera

Për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të tjera është shumë i rëndësishëm analizimi në mënyrë të detajuar dhe konkrete, dhe jo me formulime të përgjithshme dhe standarde, i *kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën,* sipas nenit 59 të Kodit Penal. Këto kushte janë alternative dhe jo kumulative, pra vlerësohen në tërësi.

Në një numër të konsiderueshëm rastesh, konstatohet se rrethanat e mësipërme pasqyrohen dhe analizohen me formulime të përgjithshme dhe standarde. Ndërsa në raste të tjera, pasqyrohen rrethanat konkrete specifike, nevojat që sjellin ato në drejtim të aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal.

Si përfundim, nga studimi i vendimeve gjyqësore rezulton se respektohet standardi ndërkombëtar se përdorimi i dënimit me burgim duhet të jetë një extrema ratio, pra zgjidhje e fundit e aplikueshme kur dënimi alternativ vlerësohet i papërshtatshëm, udhëhequr kjo edhe nga parimi i humanizmit. Pra, gjykatat nuk aplikojnë nenin 59 të Kodit Penal vetëm dhe eskluzivisht kur vërtetohen rrethana specifike nga ato të parashikuara shprehimisht në nenin 59 të Kodit Penal, që lidhen me nevojat familjare, shëndetësore, të punësimit, arsimimit etj.. Gjykatat analizojnë në tërësi të gjitha kushtet e nenit 59 të Kodit Penal si, rrezikshmëria e personit dhe rrethanat e veprës, sjellja pas kryerjes së veprës penale dhe rrethanat që lidhen me nevojat e mësipërme, sipas arsyetimit nëse ato e bëjnë të papërshtatshëm dënimin me burgim. Një arsyetim i tillë, në mënyrë të shprehur, është pasqyruar nga gjykatat në disa vendime gjyqësore.[44]

Shqyrtimi i rrethanave konkrete dhe nevojave që lidhen me familjen etj., në drejtim të vlerësimit të kushteve të nenit 59 të Kodit Penal, paraqet një rëndësi të veçantë. Përsa i përket rrethanave familjare, nuk është e

[44] *Vendimet nr.2140 datë 16.07.2018, nr.1197 datë 19.04.2018, nr.227 datë 29.01.2018, nr.229 datë 29.01.2018 dhe nr.233 datë 29.01.2018.*

mjaftueshme thjesht përbërja familjare, por duhet të vërtetohen nevojat që lindin për shkak të rrethanës familjare. Konkretisht, në një rast Gjykata e Apelit Shkodër arsyeton se: "Është e vërtetë që sipas certifikatës familjare rezulton që ai bashkëjeton me nënën, motrën dhe vëllain, *por po sipas kësaj certifikate provohet fakti se si motra ashtu dhe vëllai i tij janë në moshë madhore,* të tillë që *mund të kujdesen vetë për veten e tyre si dhe për nënën e tyre*". Në një rast tjetër, me vendimin e datës 10.06.2019, Gjykata e Apelit Shkodër, ka arsyetuar ndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke vendosur aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike", parashikuar nga neni 137/1/2 i Kodit Penal, me arsyetimin se: "*1) rrezikshmëria e pakët e personit, ku në rastin konkret në shqyrtim, subjekt i veprës penale është një person i padënuar më parë; 2) i pandehuri është një K/Familjar me fëmijë, për të cilin duhet të kujdeset, që do të thotë se ka përgjegjësi në lidhje me plotësimin e nevojave familjare për fëmijën e tij; 3) Që nga momenti i konstatimit e deri në momentin e gjykimit në Apel ka kaluar 1 vit e gjysmë; 4) I pandehuri e ka pranuar fajësinë duke kërkuar mëshirë nga gjykata; 4) masa e dënimit të dhënë është nën pesë vjet. Në këto rrethana aplikimi i nenit 59 K.Penal është në përputhje me ligjin dhe provat, pasi vendosja në provë e të pandehurit do të kryente më së miri qëllimin e dënimit duke bërë të mundur që i pandehuri të qëndronte nën trysninë e dënimit penal deri në përfundim të kohës së kushtit.*".

Në shumicën e rasteve, vërehet prania e rrethanave familjare të tilla si, qenia kryefamiljar me fëmijë, dhe veçanërisht fëmijët e mitur në ngarkim. Në disa raste të tjera, parashtrohet pasja në ngarkim e personave të tjerë të afërt.

Kushtet shëndetësore lidhen jo vetëm me të pandehurin, por edhe me personat e afërt familjarë të tij ose personat në ngarkim. Në disa raste, gjykatat kanë arsyetuar nevojat për shkollimin, me ndjekjen e arsimit të lartë[45], dhe nevojat e punësimit, me qenien i punësuar ose pasjen e një kontrate punësimi.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vërehet se arsyetimi lidhur me plotësimin e kushteve ligjore dhe analizën e rrethanave personale, familjare etj., është përgjithësisht jo i hollësishëm, në raport me nevojat. Kryesisht, gjykatat në aplikimin e dënimit alternativ nisen nga rrezikshmëria e ulët e veprës penale dhe të pandehurit. Në raste të

[45] *Vendimet nr.2488 datë 27.09.2018 dhe nr.3274 datë 13.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë arsyetuar si rrethana mosha relativisht e re dhe vazhdimi i arsimit të lartë.*

tjera arsyetohen kushtet e rënda ekonomike, kushtet shëndetësore, rrethanat familjare të tilla si, pasja e fëmijëve të mitur në ngarkim.

Në shqyrtimin e rrethanave dhe aplikimin e dënimit alternativ, nuk duhet të ketë diskriminim në bazë gjinie, moshe, origjinë etnike etj. Gjykata duhet të mbajë parasysh diversitetin dhe nevojat e veçanta individuale të të pandehurit. Në komentarin e Rekomandimit (2017)3, vlen të theksohet në këtë drejtim se, diskriminimi shpesh aplikohet në mënyrë të paqëllimshme dhe mund të jetë rezultat i një procedure rutinë, që shndërrohet në të "institucionalizuar". Kështu për shembull, praktikat mund të ndahen për burrat, që mund të përbëjnë shumicën e të dënuarve, dhe nuk duhet thjesht të prezumohen si të përshtatshme për gratë. Në disa raste, rrethanat e individit (qenia i pastrehë), mund të ndikojnë në papërshtatshmërinë e një dënimi alternativ të veçantë. Por, një alternativë duhet të shqyrtohet në këtë rast, në mënyrë që të parandalohet dënimi i panevojshëm me burgim.

5.3 Aplikimi i dënimit alternativ për shtetasit e huaj

"Konventa e Këshillit të Evropës për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht", e ratifikuar me Ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000, bën të mundur që të lejohet, që dënimi alternativ të ekzekutohet nga shteti ku individi ka rezidencën, kur ai ka deklaruar si vendbanim apo si rezidencë një adresë jashtë territorit të shtetit ku ai është dënuar. Kjo Konventë mundëson ekzekutimin e dënimeve alternative të dënimit me burgim, konkretisht vënien në provë, ndërmjet shteteve të Këshillit të Evropës. Në këto raste, sipas intervistave të realizuara me Shërbimin e Provës, ndiqet kjo praktikë: fillimisht Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës referojnë rastin në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, dhe më pas kjo e fundit i kërkon Ministrisë së Drejtësisë që të kërkohet njohja dhe ekzekutimi me shtetin tjetër (nëse përfshihet në shtetet e Konventës së Këshillit të Evropës). Deri aktualisht, nuk ka patur raste të tilla.

Përsa i përket shtetasve kosovarë, në praktikë ka patur raste që Prokuroria ka përcaktuar Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit alternativ. Kjo shpesh sjell problematikë, për shkak të largësisë së vendbanimit të të dënuarit nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Tiranë. Në rastet e shtetasve të huaj kosovarë, është e rëndësishme që gjykata të marrë mendimin e të pandehurit lidhur me përcaktimin e Zyrës konkrete të Shërbimit të Provës, duke konsideruar vendin e banimit,

të punës etj. të të pandehurit. Kjo praktikë shmang shkeljen e kushtit të mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme me Shërbimin e Provës, dhe eviton një barrë të rëndë e të panevojshme për të dënuarin. Për shembull, përcaktimi i Zyrës Vendore të Shërbimit Kukës në këto raste, do të ishte më i përshtatshëm.

5.4 Detyrimet që përmbushen gjatë periudhës së provës

Neni 59 i Kodit Penal, parashikon se: *"…2. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shume detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi"*. Në nenin 60 të Kodit Penal parashikohen detyrimet konkrete që përmbushen gjatë periudhës së provës: "*I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:*

1. *Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.*
2. *Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.*
3. *Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.*
4. *Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.*
5. *Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.*
6. *Të mos frekuentojë vende të caktuara.*
7. *Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.*
8. *Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.*
9. *Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.*
10. *Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.*
11. *Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.*
12. *T'i nënshtrohet një trajtimi, apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike.*

Qëndrimi mbizotërues në praktikën gjyqësore është që, detyrimet e mësipërme nuk janë të detyrueshme për t'u aplikuar në çdo rast. Nga studimi i vendimeve gjyqësore vërehet se, në shumicën prej tyre gjykatat nuk kanë

përcaktuar asnjë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal. Ky qëndrim vjen në përputhje me nenin 60 të Kodit Penal, që parashikon shprehimisht se "*I dënuari i vënë në provë, mund* të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve". Për rrjedhim, gjykata vendos aplikimin e një apo më tepër detyrimeve, kur ato janë të përshtatshme në raport me veprën penale.

Problematikë në praktikën gjyqësore, në disa raste, përbën aplikimi formal i detyrimeve të mësipërme, edhe kur këto haptazi duken të papërshtatshme. Raste të tilla në praktikën gjyqësore janë kryesisht, aplikimi i detyrimit që i pandehuri "*Të mos shoqërohet me persona të caktuar*" dhe "*Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë*", për vepra penale të tilla si: "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt", "Vjedhja e energjisë elektrike", "Shpërdorimi i detyrës" etj. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se detyrimet duhet të jenë të nevojshme dhe të përshtatshme, në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale. Në rastin kur, asnjë nga detyrimet e mësipërme nuk janë të përshtatshme, gjykata nuk duhet të vendosë aplikimin e tyre. Por edhe në këtë rast, gjykatat duhet të shprehen në vendimin gjyqësor që këto detyrime janë të papërshtatshme për t'u aplikuar, pra duhet të marrin në shqyrtim mundësinë e aplikimit të tyre. Nga studimi i vendimeve gjyqësore, nuk rezulton që gjykatat të shprehen lidhur me këtë në arsyetim, por thjesht mjaftohen me mospërcaktimin e këtyre detyrimeve.

Pra, në përcaktimin e detyrimit apo disa detyrimeve të mësipërme, gjykata duhet të arsyetojë në vendim se përse ky detyrim është i përshtatshëm në raport me motivin dhe rrethanat e veprës penale dhe rrethanat e tjera personale, familjare etj., të të pandehurit. Ky qëndrim vjen në përputhje me parashikimin në nenin 60 të Kodit Penal, se: "*Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre.*". Nga studimi i vendimeve gjyqësore, në pjesën dërrmuese të rasteve konstatohet se detyrimet thjesht përcaktohen në vendim, pa u arsyetuar përshtatshmëria e tyre dhe përcaktimi i detyrimit konkret në raport me rrethanat e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal.

Detyrimet më të aplikuara në praktikën gjyqësore janë ato të: "*të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara; të ushtrojë një veprimtari profesionale*

ose të marrë një arsim apo formim profesional; të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike; të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale dhe të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë".

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të vitit 2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, rezulton se në një rast të veprës penale të "Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt", në gjendje të dehur, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, gjykata[46] ka caktuar si detyrim atë të mos frekuentimit të lokaleve ku shërbehen pije alkoolike gjatë periudhës së provës. Një detyrim i tillë është aplikuar shpesh nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë[47] edhe për veprën penale të dhunës në familje. Në një sërë vendimesh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, - me nr.1489 datë 18.05.2018; nr.1000, datë 04.04.2018; nr.689 datë 08.03.2018; dhe nr.682 datë 08.03.2018, - është përcaktuar aplikimi i nenit 60, pika 7 të Kodit Penal, duke urdhëruar që i pandehuri gjatë periudhës së provës të mos frekuentojë lokale që shërbëjnë pije alkoolike.

Në disa raste, gjykata arsyeton se kjo për faktin se, ka qënë pikërisht alkooli ai që ka çuar atë në këtë sjellje, edhe pse pretendohet se ka një kohë që nuk e konsumon, gjithsesi çmohet si masë parandaluese e nevojshme në rastin konkret. Kështu edhe në vendimin nr.1462 datë 16.05.2018, Gjykata shprehet në arsyetimin e vendimit se shfaqen shenja xhelozie si edhe te konsumit të alkoolit prej të pandehurit, rrethana dhe shqetësime këto, të cilat kanë prodhuar konflikte në familjen e tyre, për veprën penale të "Dhunë në familje" dhe për këtë arsye aplikon detyrimin që i pandehuri të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.

Aplikimi i disa detyrimeve njëkohësisht, është më i rrallë në praktikë. Vlen të theksohet, vendimi nr.1004 datë 23.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka përcaktuar dy detyrime; atë të mos shoqërimit me të pandehurin tjetër, dhe përfundimin e shkollës së mesme, në vazhdim të të cilës i pandehuri është. Në këtë rast, të dyja detyrimet janë plotësisht të përshtatshme dhe të nevojshme për shkak të veprës penale për të cilën janë aplikuar, atë të "Vjedhjes në bashkëpunim", parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Detyrimi që i pandehuri të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale, është aplikuar

[46] *Vendim nr.1770 datë 05.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*

[47] *Vendim nr.3217 datë 04.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*

nga gjykatat në rastet e veprave penale të "Vjedhjes" kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve". Ndërsa në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të vitit 2018 dhe 2019, vërehet një aplikim shumë i gjerë i këtij detyrimi, për vepra penale të ndryshme si: "Dhunë në familje", "Vjedhje" e kryer në bashkëpunim, "Vjedhje e energjisë elektrike", "Fshehja e të ardhurave" etj. Detyrimi i të pandehurit për të mos u shoqëruar me persona të dënuar, është detyrimi më i aplikuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo që konstatohet në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është se detyrimi për të mos u shoqëruar me persona të dënuar, është detyrim që aplikohet shpesh për vepra penale si "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt[48], "Vjedhja e energjisë elektrike"[49], "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, "Dhuna në familje", dhe ndërkohë, në disa raste, nuk aplikohet për vepra penale si: "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve sportive dhe të gjuetisë"[50]. Madje, për veprën penale të "Vjedhja e energjisë elektrike", gjykata në një rast ka disponuar në vendim se, në zbatim të nenit 60 pika 9 e K.Penal, i pandehuri detyrohet të mos shoqërohet me persona të dënuar dhe me bashkëpunëtorë të veprës penale.[51]

Ndërsa, përsa i përket detyrimeve që *"Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara."* dhe *"Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari"*, shpesh këto gjejnë aplikim si dënim plotësues, duke qenë se parashikohen si të tilla. Në një sërë vendimesh gjyqësore, ky ndalim gjendet i përcaktuar si dënim plotësues dhe jo si detyrim referuar nenit 60 të Kodit Penal[52]. Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të vitit 2018 dhe 2019, vërehet se ndalimi i drejtimit të automjeteve përcaktohet si dënim plotësues dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar si detyrim referuar nenit 60 të Kodit Penal.[53] Në ndryshim nga detyrimi referuar nenit 60 të Kodit Penal, i cili apikohet edhe për një periudhë të shkurtër kohore brenda periudhës së provës, dënimi plotësues "Ndalimi për të drejtuar automjete" sipas nenit 37 të Kodit Penal, jepet nga gjykata për një kohë nga një, gjer në pesë vjet. Ndërsa për dënimin

[48] *Vendim nr.192 datë 26.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
[49] *Vendim nr.229 datë 29.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
[50] *Vendim nr.1412 datë 10.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
[51] *Vendim nr.215 datë 26.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi nr.894 datë 26.03.2018* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
[52] *Vendim nr.481 datë 09.02.2018, nr.487 datë 12.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, etj.*
[53] *Vendim nr.1770 datë 05.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

plotësues "Heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni", neni 39 i Kodit Penal përcakton një marzh më të gjerë dënimi, për një kohë nga një muaj deri në pesë vjet.

Në nenin 59 të Kodit Penal parashikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit, duke u referuar në dënimin me burgim. Në asnjë dispozitë nuk parashikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit plotësues, njëkohësisht me pezullimin e ekzekutimit të dënimit. Në vështrim krahasues, në nenin 166/1 të Kodit Penal parashikohet se pezullimi i dënimit shtrihet edhe në dënimet plotësuese, por për veprat penale të përcaktuara në këtë dispozitë, gjyqtari mund të vendosë që pezullimi të mos i shtrijë efektet të dënimi plotësues për ndalimin e ushtrimit të funksionit publik dhe lidhjes së kontratave me administratën publike.

Në një rast që i përket vendimit nr.41 datë 15.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është përcaktuar si detyrim në dispozitivin e vendimit gjyqësor: *"ndjekje të programeve rehabilituese të iniciuara nga vetë ky shërbim në përputhje me rrethanat e rastit konkret penalizues dhe nevojën e të dënuarit për këtë qëllim procesi"*. Edhe pse nuk citohet në vendim, ky detyrim parashikohet në pikën *11* të nenit 60 të Kodit Penal: "*Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program* të trajtimit, mjekësor apo *rehabilitues"*. Sipas intervistave të kryera me Shërbimin e Provës, në këtë aspekt paraqet vështirësi ekzekutimi, për shkak të mungesës së programeve rehabilituese të realizuara nga vetë Shërbimi i Provës apo në bashkëpunim me organizata të tjera.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vërehet se rastet e përcaktimit të detyrimeve nga ato në nenin 60 të Kodit Penal janë të rralla, gjithsej 2 raste në të gjitha vendimet gjyqësore.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të vitit 2019, vërehet se rastet e përcaktimit të detyrimeve nga ato në nenin 60 të Kodit Penal janë të rralla, gjithsej 1 rast[54] në të gjitha vendimet gjyqësore. Në këtë rast, lidhur me një nga detyrimet, atë të mosshoqërimit me persona të dënuar, duket se nuk del qartë nevoja e përcaktimit të këtij detyrimi në raport me veprën penale konkrete. Ndërsa në vitin 2018, ka patur një rast të përcaktimit të detyrimeve të tjera, siç është detyrimi për të mos u shoqëruar me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo

[54] *Vendim nr.444 datë 02.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për veprën penale të "Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në të cilin janë përcaktuar si detyrime ato që të mos shoqërohet me persona të caktuar kryesisht të dënuar dhe të ushtrojë një veprimtari profesionale.*

bashkëpunëtorët e veprës penale,[55] për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të vitit 2018 dhe 2019, rezulton se gjykata në një numër të lartë rastesh përcakton detyrime nga ato të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, si "detyrimi për të mos u shoqëruar me persona të dënuar apo bashkëpunëtorë të veprës penale"; për vepra penale si, "Dhunë në familje"[56], "Vjedhje të energjisë elektrike"[57], "Mosdhënia e mjeteve për jetesë"[58], "Ndërtimit të paligjshëm"[59] dhe "Shfrytëzim prostitucioni".

5.4.1 Riparimi i dëmit civil

Problematikë në praktikë paraqet mosaplikimi në masën e duhur, edhe pse shpeshherë është detyrimi më i përshtatshëm për t'u aplikuar, *riparimi i dëmit civil të shkaktuar.* Rastet e përshtatshmërisë së aplikimit të këtij detyrimi janë të shumta, veçanërisht në veprat penale që element të anës objektive kanë shkaktimin e dëmit (pasuror dhe jopasuror) ndaj viktimës. Aplikimi i nenit 59 dhe 60/3 të Kodit Penal, nuk është në masën e nevojshme të kërkuar për nxitjen e shpërblimit të dëmit viktimave, për shkak të problematikës që paraqet: paragjykimit të çështjes në orientimin e shqyrtimit gjyqësor në përcaktimin e vlerës së dëmit civil të shkaktuar; mungesës së hetimit të plotë për përcaktimin e saktë të vlerës së dëmit; mungesës së informimit të viktimave për dëmshpërblimin në procesin penal; paaftësia paguese e të pandehurit etj. Arsye tjetër është fakti se, në shumicën e çështjeve penale, procesi zhvillohet me ritin e gjykimit të shkurtuar dhe për rrjedhim moshetimi dhe mospërcaktimi gjatë hetimit paraprak, i vlerës konkrete të dëmit civil të shkaktuar, përbën pengesë për mosaplikimin e këtij detyrimi. Duke pasur parasysh se praktikat e zbatimit të padisë civile në procesin penal, janë të pakta dhe përgjithësisht jofunksionale, riparimi i dëmit civil të shkaktuar mbetet një çështje që kërkon një zgjidhje efektive. Është shumë e rëndësishme që ky detyrim të ketë aplikim më të gjerë në praktikë. Në nenin 16, të Direktivës 2012/29 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 25.10.2012 e Bashkimit Evropian, që vendosi standardet minimale të të drejtave, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit, parashikohet e drejta e viktimës për të marrë vendim për dëmshpërblim prej të

[55] *Vendim nr.855 datë 16.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*
[56] *Vendim nr.3502 datë 28.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
[57] *Vendim nr.3439 datë 21.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
[58] *Vendim nr.3122 datë 21.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
[59] *Vendim nr.3118 datë 21.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*

pandehurit, brenda një afati të arsyeshëm në procesin penal, me përjashtim kur ligji parashikon që një vendim i tillë merret në një proces tjetër ligjor, si p.sh. në procesin civil. Shtetet duhet të marrin masa për të inkurajuar autorët, që të paguajnë dëmshpërblimin për viktimat. Riparimi i dëmit civil i vendosur nga gjykata në procesin penal, konsiderohet si mënyrë e mirë për të përshpejtuar procesin e dëmshpërblimit në vend të dëmshpërblimit në procesin civil, në të cilin viktima ka barrën e provës, edhe për të paguar shpenzimet gjyqësore.

Në praktikë, kur vlera e dëmit ka qenë e përcaktuar, ka pasur raste të mosriparimit të dëmit civil për shkak të pretendimit për paaftësi paguese. Shërbimi i Provës ka verifikuar paaftësinë paguese, kryesisht referuar faktit nëse i dënuari është në marrëdhënie pune, pa kryer verifikime të tjera. Gjithsesi nuk ka asnjë rast të raportuar nga Shërbimi i Provës për revokimin e dënimit alternativ për shkak të mosriparimit të dëmit civil.

Si rregull, në caktimin e detyrimit për riparimin e dëmit civil, gjyqtari nuk kushtëzohet nga kryerja paraprakisht e një hetimit gjyqësor lidhur me rrethanat ekonomike dhe aftësinë paguese të të pandehurit. Një qëndrim i tillë është mbajtur në jurisprudencën italiane[60], duke pranuar si përjashtim rastin kur në gjykim dalin apo paraqiten nga pala e interesuar rrethana të cilat tregojnë paaftësinë paguese të të pandehurit, nisur nga fakti se në fazën e ekzekutimit lejohet për të dënuarin që të vërtetojë përkeqësimin eventual të gjendjes së tij ekonomike.

Në nenin 31/9 të ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", parashikohet mundësia që Shërbimi i Provës t'i paraqesë raport prokurorit, mbi ndryshimin e kushteve të detyrimeve për ekzekutimin e dënimit, pasi të verifikojë faktet dhe rrethanat e mospërmbushjes. Kur detyrimi nuk mund të ekzekutohet për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit, pra për pamundësi objektive, gjykata mund të shtyjë fillimin e ekzekutimit të dënimit ose të ndryshojë detyrimin.

Nga intervistat me Shërbimin e Provës rezultoi se, ka patur vështirësi dhe pamundësi në ekzekutimin e këtij detyrimi për shkak të mos përcaktimit të vlerës së dëmit në vendimin gjyqësor (jo vetëm në dispozitiv, por dhe kur vlera e dëmit nuk del as nga pjesa arsyetuese e vendimit). Në këto raste, Shërbimi i Provës i ka kërkuar informacion institucionit (si p.sh. Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për veprën penale të mashtrimit në sigurime apo OSHEE sh.a. për veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike), kur dëmi duhet të paguhej në favor të një institucioni të përcaktuar, ose ka proceduar

[60] *Vendim nr.50028 datë 31.10.2017 i Kolegjit Penal, Seksioni IV i Gjykatës së Kasacionit.*

me kërkesë për informacion Prokurorisë. Gjithsesi, në këto raste, kur është konstatuar mosriparimi i dëmit civil, Shërbimi i Provës e ka tejkaluar dhe nuk e ka konsideruar si shkelje të detyrimit. Në relacionin përkatës është pasqyruar një fakt i tillë.

Në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet aplikimi më i shpeshtë i detyrimit për riparimin e dëmit civil pa përcaktuar vlerën e tij, sidomos në rastet e veprës penale të "Mashtrimit në sigurime", parashikuar nga neni 145 i K.Penal[61]. Edhe në vendimin nr.1345 datë 03.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike, nuk përcaktohet nëse vlera e dëmit është vlera e detyrimit para rilidhjes së energjisë apo vlera e konsumuar pas rilidhjes së paligjshme të energjisë elektrike dhe si përcaktohet kjo, në kushtet kur pas rilidhjes së energjisë nuk është bërë kalimi i saj në matës.

Edhe në vendimet nr.1073 datë 10.04.2018, nr.793 datë 16.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të "Vjedhje e energjisë elektrike" parashikuar nga neni 137 pg.1 i Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, me kusht që e pandehura për një periudhë prove prej 4 (katër) muaj të mos kryejë vepër tjetër penale, të riparojë dëmin civil të shkaktuar, ndërkohë që, as nga dispozitivi, as nga arsyetimi i vendimit, nuk del vlera e dëmit civil që duhet të riparohet.

Vetëm në një rast, vlera e dëmit civil që duhet të riparohet del nga arsyetimi i vendimit nr.924 datë 28.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të "Vjedhje duke shpërdoruar detyrën" të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal dhe "Fallsifikim i dokumentave" të parashikuar nga neni 186 pg.3, të Kodit Penal.

Nga ana tjetër, në praktikën e kësaj gjykate vërehet se tek vepra penale e "Vjedhjes" ka më shumë detyrimin për të mos u shoqëruar me persona të dënuar, sesa detyrim për riparimin e dëmit civil të shkaktuar.

5.4.2 Ushtrimi i veprimtarisë profesionale, marrja e një arsimi apo formimi profesional

Ka një numër të konsiderueshëm rastesh kur gjykata ka vendosur si detyrim, në referim të nenit 60 të K.Penal, që i dënuari *të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim, apo formim profesional.*

Në këtë aspekt, vlen të theksohet vendimi nr.254 datë 31.01.2018 i

[61] *Në vendimin nr.217 datë 29.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për këtë vepër penale janë aplikuar detyrimet që i pandehuri "Të mos shoqërohet me persona të dënuar" dhe "Të vazhdojë riparimin e dëmit civil të shkaktuar Dr.S.Sh".*

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të "Plagosje e rëndë me dashje", e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 88/2 e 25 të Kodit Penal, ku në bazë të nenit 60/9 të Kodit Penal, është përcaktuar që i pandehuri të mos shoqërohet me persona të dënuar, kryesisht për të njëjtën vepër penale si dhe të vijojë procesin e arsimimit të tij. Në vendimin nr.1233 datë 23.04.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të "Vjedhjes" kryer në bashkëpunim, shprehet për detyrimin që i pandehuri të ushtrojë një veprimtari profesionale, po në mënyrë të përgjithshme.

Në këto raste, Shërbimi i Provës kryen verifikimet e përmbushjes së këtij detyrimi nga i dënuari në dy mënyra: administron dokumentin që vërteton ushtrimin e veprimtarisë profesionale apo ndjekjes e arsimit/formimit profesional, dhe merr kontakt me punëdhënësin ose institucionin e ndjekjes së arsimit apo formimit profesional. Në praktikë, përgjithësisht, gjykata e parashikon në mënyrë të përgjithshme detyrimin për ushtrimin e veprimtarisë profesionale apo ndjekjen e arsimit apo formimit profesional, pa specifikuar një veprimtari të caktuar sipas kontratës apo duke përcaktuar shoqërinë/institucionin. Kjo praktikë gjyqësore shmang problematikat apo vështirësitë që mund të sjellë gjatë zbatimit vendimi gjyqësor që e individualizon veprimtarinë konkrete profesionale, në rast të zgjidhjes së kontratës apo ndryshimit të veprimtarisë profesionale.

Në vitin 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik nr.1, Tiranë. Marrëveshja ka si objekt trajnimin profesional të të dënuarve të mitur dhe madhorë të rinj, me dënime alternative si dhe edukimin e tyre për njohjen dhe respektimin e ligjeve. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional siguron trajtimin profesional të të dënuarve të mitur dhe madhorë të rinj deri në 21 vjeç, me dënime alternative, edukimin e tyre për respektimin e ligjit, zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj komunitetit dhe viktimës tek të dënuarit.

Lidhja e një marrëveshje me shkrim, me organizatat që ofrojnë një veprimtari profesionale, formim profesional apo trajtim mjekësor etj., ku të përcaktohet natyra e detyrave dhe detyrimeve, është në përputhje me standardet ndërkombëtare, pikën 55 të Rekomandimit (2017)3.

5.4.3 Detyrimet për mjekim, trajtim apo rehabilitim mjekësor

Nga të gjitha detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, *detyrimet e parashikuara në pikat 11 dhe 12, të paragrafit 1, të këtij neni, caktohen*

vetëm me pëlqimin e të dënuarit.[62] Pra, mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit mjekësor apo rehabilitues dhe nënshtrimi ndaj një trajtimi apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike, kërkon detyrimisht pëlqimin e të pandehurit. Mungesa e një hetimi të plotë në drejtim të vërtetimit të varësisë ndaj alkoolit ose lëndëve narkotike të të pandehurit, së bashku me mosdhënien e pëlqimit nga ana e të pandehurit, janë shkaqet kryesore të mosaplikimit në praktikën gjyqësore të këtij detyrimi.

Në rastet e ekzistencës së elementëve të mësipërm, është i aplikueshëm neni 60/a i Kodit Penal, "Detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës", që parashikon se: "*Gjykata, ndaj të dënuarit të vënë në provë, i cili është në kushtet e varësisë kronike ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike, vendos detyrimin për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës. Trajtimi mjekësor për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës,* bëhet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, në bazë të kërkesës së shërbimit të provës. Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimin e vendosur sipas parashikimeve të nenit 60 të këtij Kodi".

Në këtë aspekt, vlen të theksohet vendimi nr.652 datë 06.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", neni 283/1 i Kodit Penal, në të cilin gjykata ka përcaktuar si detyrime që duhet të përmbushen gjatë periudhës së provës: të ushtrojë një veprimtari profesionale, të mos shoqërohet me persona të caktuar kryesisht me të dënuar, si dhe të heqë dorë nga përdorimi i drogës. Në pjesën arsyetuese të vendimit përcaktohet edhe qëllimi i aplikimit të detyrimeve në përputhje me qëllimin e dënimit alternativ: "*Në funksion të këtij qëllimi, gjykata e gjen me vend që ndaj të pandehurit të zbatojë edhe Nenin 60 të Kodit Penal, konkretisht disa dënime alternative në lidhje me detyrimin e tij për të hequr dorë nga përdorimi i drogës, si edhe mosshoqërimin e tij me persona të caktuar me precedentë penal, apo edhe punësimin e tij, siç do të përcaktohet në dispozitivin e këtij vendimi*".

Detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit, parashikuar nga neni 60/12 i Kodit Penal, vërehet i aplikuar veçanërisht në praktikën e

[62] *Neni 60 i Kodit Penal*

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier,[63] në rastet e veprës penale të "Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt", në gjendje të dehur.

Në këtë aspekt, në vështrim krahasues vlen të theksohet neni 54 i Kodit Penal të Kosovës, i cili parashikon në mënyrë të detajuar kriteret për dënimin me kusht, me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues. Këto kritere, të përcaktuara në Kod për aplikimin e dënimit alternativ, me këtë detyrim janë: "*në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konsideron se faktori kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale*". Këto kritere ndihmojnë gjykatën në vlerësimin e përshtatshmërisë së aplikimit të detyrimit për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Nga përmbajtja e neneve 60 dhe 60/a të Kodit Penal, del se nuk është përcaktuar një afat specifik për ndjekjen e trajtimit mjekësor për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës. Për rrjedhim, ky detyrim përmbushet gjatë afatit të periudhës së provës, *të përcaktuar nga gjykata.* Ndryshe ndodh në Kodin Penal të Kosovës, ku periudha e trajtimit të detyrueshëm është përcaktuar se nuk mund të jetë më pak se tre (3) muaj, apo më tepër se dymbëdhjetë (12) muaj.

Lidhur me detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të K.Penal: "*Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues*"*;* dhe "*T'i nënshtrohet një trajtimi, apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike*"*,* Shërbimi i Provës ka pasur vështirësi në ekzekutimin e tyre. Ndërmjet Shërbimit të Provës dhe QSUT Tiranë, ka pasur marrëveshje për programet e trajtimit mjekësor rehabilitues, dhe fillimisht kjo marrëveshje është ekzekutuar. Personat merrnin trajtimin mjekësor pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, pranë të cilës funksionon Klinika e Trajtimit të Varësisë Alkoologjike (Shërbimi adiktiv i Alkoologjisë).

Për disa vite, Shërbimi i Provës ka patur marrëveshje edhe me shoqata, për ofrimin e shërbimit të rehabilitimit pa pagesë. Në vitin 2010, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të

[63] *Vendimi nr.62-2018-3499 datë 27.06.2018; nr.62-2018-1010/78 datë 26.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier*

Shërbimit të Provës dhe shoqatës "Aksion Plus". Qëllimi i memorandumit të bashkëpunimit ka qenë mbështetja psiko-sociale, këshillimi dhe trajtimi me anën e sensibilizimit dhe marrjen e masave për parandalimin e substancave narkotike dhe psikotrope të ofruar nga psikologët e qendrës, me programe terapeutike apo të kujdesit, duke ndihmuar në riintegrimin social dhe përmbushjen e nevojave shoqërore. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi sigurohej trajtimi i personave të dënuar përdorues të lëndëve narkotike, për ekzekutimin e masave alternative të dënimit. Në vitin 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka lidhur memorandum bashkëpunimi me "Komunitetin Emanuel". Në këtë marrëveshje përcaktohen detyrimet e organizatës jofitimprurëse, ku ndër të tjera përfshihen edhe dëgjim e këshillim për të rinjtë dhe familjarët e tyre me probleme narkotike, të alkooltoksikopendencave, formim profesional dhe riintegrim në shoqëri, qendër krize dhe orientimi, terapi individuale dhe në grup, riaftësim dhe shoqërim psikopedagogjik etj. për të dënuarit, për të siguruar ekzekutimin e dënimit alternativ.

Për shkak të domosdoshmërisë së pagesës në ndjekjen e këtij trajtimi, në vijim ka pasur vështirësi në ekzekutim, dhe rastet kanë qenë të rralla. Duke qenë se ky shërbim mjekësor është me pagesë, dhe një pagesë e tillë nuk mund t'i ngarkohet të dënuarit, për rrjedhim nuk ka vazhduar bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit të Provës dhe QSUT Tiranë, si dhe organizatave jofitimprurëse të mësipërme. Prandaj, në këtë aspekt është e rëndësishme që të merren masa për sigurimin e shërbimit mjekësor nga një numër më i madh institucionesh shëndetësore, nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëveshjeve, në mënyrë që të mbulohen të gjitha rastet e përmbushjes së një detyrimi të tillë. Duke qenë se pagesa nuk mund t'i ngarkohet të dënuarit, në rastet kur është konstatuar mospërmbushja e këtyre detyrimeve, nga ana e Shërbimit të Provës nuk është konsideruar si mosekzekutim i vendimit. Në këto raste, Shërbimi i Provës është kufizuar vetëm me pasqyrimin në raport të faktit të mosekzekutimit të detyrimit. Sipas Rekomandimit (2017)3, kostot e ardhura drejtpërdrejtë nga zbatimi i dënimit alternativ nuk duhet normalisht të rëndojnë mbi të dënuarin. Në komentarin shoqërues, shpjegohet se sipas parimit të përgjithshëm, i dënuari nuk duhet të paguajë kostot e nevojshme për aplikimin e dënimit alternativ. Aty ku ligji i brendshëm lejon një kontribut të tillë financiar, maksimumi i shumës duhet të përcaktohet në ligj, dhe aftësia e të dënuarit për të paguar duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të tij dhe impaktit

të kësaj kostoje. Autoriteti zbatues duhet të minimizojë kostot dhe, kur shpenzime domethënëse janë bërë nga i dënuari në zbatim të dënimit alternativ, autoriteti zbatues duhet të konsiderojë rimbursimin në raste të përshtatshme. Paaftësia e të dënuarit për të paguar koston, nuk duhet të konsiderohet si arsye për të mohuar aplikimin e dënimit alternativ. Shumë persona, subjekt të dënimeve alternative, kanë mjete të kufizuara financiare dhe një barrë e panevojshme financare jo vetëm që do të ishte e padrejtë, por edhe do ta bënte rehabilitimin më të vështirë.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të një trajtimi apo programi mjekësor, Shërbimi i Provës duhet të marrë masa që të sigurojë, që organizatat që ofrojnë trajtimin apo programin të jenë të përgjegjshme dhe të besueshme, si dhe të respektojnë konfidencialitetin dhe të drejtat e të dënuarit.

5.4.4 Detyrimet e tjera

Shërbimi i Provës ka pasur vështirësi në mbikëqyrjen e ekzekutimit të disa prej detyrimeve të përcaktuara në nenin 60 të K.penal, si: "*6. Të mos frekuentojë vende të caktuara. 7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike. 8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara. 9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale. 10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.*".

Për të gjitha këto detyrime, Shërbimi i Provës e ka konsideruar marrjen e informacionit nga Komisariatet e Policisë, si të vetmen mënyrë për verifikimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve nga i dënuari. Sipas intervistave të kryera me Shërbimin e Provës, rezulton se në praktikë i është kërkuar informacion me shkrim komisariateve të Policisë lidhur me shkelje të detyrimit nga ana e të dënuarit. Asnjëherë komisariatet e Policisë nuk kanë kthyer përgjigje dhe dërguar informacion për përmbushjen ose jo të detyrimeve të mësipërme nga i dënuari. Për rrjedhim, ekzekutimi i këtyre detyrimeve mbetet praktikisht i pambikëqyrur nga ana e Shërbimit të Provës, duke qenë se komisariatet e Policisë nuk kanë dhënë në asnjë rast informacion lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në këto raste, Shërbimi i Provës mjaftohet me pasqyrimin e një fakti të tillë në relacion. Por, kjo situatë nuk është vlerësuar dhe nuk konsiderohet si mospërmbushje detyrimi, përsa nuk ka informacion.

Çështje e diskutueshme në praktikë është nëse gjykata mund të përcaktojë një detyrim tjetër nga ato të parashikuara në këtë dispozitë, kur e vlerëson të përshtatshme. Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin se mund të

aplikohen vetëm një, apo disa nga detyrimet e parashikuara shprehimisht në nenin 60 të Kodit Penal. Në asnjë rast, në praktikën gjyqësore nuk është konstatuar aplikimi i ndonjë detyrimi tjetër të paparashikuar shprehimisht në ligj. Ky qëndrim është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

5.4.5 Detyrimet për mbajtjen e kontakteve dhe ndryshimin e vendbanimit

Përveç një apo disa detyrimeve të mësipërme që mund të caktohen nga gjykata, i dënuari gjatë periudhës së provës, ka edhe dy detyrime të tjera të aplikueshme në çdo rast. Këto detyrime përcaktohen në nenin 61 të Kodit Penal, "Detyrimet e të dënuarit gjatë kohës së provës": "*Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar: a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata; b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit*".

Detyrimi i parë shihet ngushtë me përcaktimin në nenin 59 të Kodit Penal, *që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës*. Pra kusht kryesor dhe i përgjithshëm (i aplikueshëm në çdo rast nga gjykata), përveç atij të moskryerjes së veprave të tjera penale, është mbajtja e kontakteve me Shërbimin e Provës. Nga studimi i vendimeve gjyqësore vërehet se, gjykatat pothuaj gjithmonë shprehen për detyrimin e të pandehurit për mbajtjen e kontakteve me Zyrën e Shërbimit të Provës së vendbanimit të tij. Ndërsa, në rastet e aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim për shtetas të huaj, është përcaktuar zyra e Shërbimit të Provës më afër shtetit të shtetësisë së të pandehurit, ose Zyra e Shërbimit të Provës në juridiksionin e gjykatës që ka dhënë vendimin gjyqësor.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore, konstatohet se gjykatat nuk i përcaktojnë detyrimet e mësipërme në vendim. Rastet, kur gjykata shprehet për detyrimet e parashikuara nga neni 61 të Kodit Penal, janë të pakta, sikurse vendimi nr.523 datë 14.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Përgjithësisht, gjykatat kur shprehen për detyrimin e të pandehurit që të mbajë kontakte të rregullta apo kontakte të vazhdueshme me Shërbimin e Provës, e bëjnë pa përcaktuar frekuencën konkrete. Kjo praktikë krijon mundësinë për Shërbimin e Provës, që të përcaktojë një frekuencë kohore që i përshtatet më mirë rrethanave specifike konkrete, si dhe mundësinë për ndryshimin e saj në varësi të ndryshimit të rrethanave apo kushteve të të dënuarit. Gjithsesi, edhe përcaktimi nga gjykata i frekuencës konkrete të

paraqitjes së të dënuarit pranë Shërbimit të Provës, nuk përbën pengesë për paraqitjen e të dënuarit pranë Shërbimit të Provës edhe kur ka nevojë për kryerje të verifikimeve, përtej datave dhe orareve të përcaktuara.

Nga vendimet gjyqësore të vitit 2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se në një numër të lartë vendimesh gjykata shprehet vetëm për detyrimin e të pandehurit që të mos kryejë vepër tjetër penale. Në këto vendime nuk parashikohet, as detyrimi për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës, dhe as detyrime të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal. Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vërehet se në disa raste gjykata është shprehur për frekuencën konkrete të paraqitjes së të pandehurit në Shërbimin e Provës. Në këto vendime,[64] përveç detyrimit të moskryerjes së një vepre tjetër penale, parashikohet detyrimi për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës të vendbanimit të tij, të hënën e javës së parë të çdo muaji ose detyrimi i të pandehurit për t'u paraqitur një herë në muaj pranë Shërbimit të Provës[65]. Po ashtu, edhe në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, vërehet se përcaktohet gjithmonë detyrimi për të mos kryer vepër tjetër penale dhe për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. Rastet, kur përcaktohet frekuenca konkrete e paraqitjes pranë Shërbimit të Provës të vendbanimit, janë të rralla.

Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se gjithmonë përcaktohen detyrimet për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës të vendbanimit, dhe të moskryerjes së veprës penale. Po ashtu, ndryshe nga praktikat e gjykatave të tjera, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë vërehen një numër i konsiderueshëm rastesh[66] ku gjykata përcakton si detyrim atë të parashikuar nga neni 61 i Kodit Penal, që i pandehuri të detyrohet të marrë pëlqimin nga Zyra e Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendbanimit.[67]

5.5 Afati i periudhës së provës

Afati i periudhës së provës rregullohet në nenin 59 të Kodit Penal, që parashikon se: *"3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të*

[64] *Vendim nr.3680 datë 09.02.2019, vendimi nr.51 datë 21.01.2019, nr.1481 datë 24.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

[65] *Vendimi nr.5042 datë 26.11.2018 dhe nr.3929 datë 09.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*

[66] *Vendim nr.3439 datë 21.12.2018, nr.3435 datë 21.12.2018, nr.3434 datë 21.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*

[67] *Vendim nr.205 datë 26.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*

dhënë nga gjykata. 4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet. në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës *dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf".*

Nga studimi i vendimeve gjyqësore vërehet se, në rastet kur dënimi i dhënë është deri në 2 vjet burgim, të gjitha gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shkodër, Korçë dhe Fier, aplikojnë në mënyrë rigoroze si afat të periudhës së provës, dyfishin e kohës së dënimit me burgim të dhënë referuar paragrafit 3 të nenit 59. Ky formulim ligjor, në praktikën gjyqësore krijon problematikë për masa të ulëta dënimi, si p.sh. 10 ditë, 20 ditë etj. Në këto raste, në referim të nenit 59/3 të Kodit Penal, afati i periudhës së provës duhet të jetë përkatësisht 20 ditë, 40 ditë etj. Një periudhë prove prej 20 ditë apo 40 ditë, është shumë e shkurtër dhe nuk plotëson qëllimin e efektivitetit të dënimit. Gjykata nuk ka diskrecion në këtë pikë për të vendosur një periudhë prove më të gjatë, si p.sh. 6 muaj për një dënim me 20 ditë burgim, edhe pse kjo do t'i shërbente më mirë qëllimit të dënimit. Dispozita, në mënyrën sesi është formuluar, ndalon përcaktimin e një periudhe prove më të lartë se dyfishi i masës së dënimit të caktuar. Rekomandimi nr.(2017)3 i Komitetit të Ministrave "Mbi Rregullat Evropiane të dënimeve dhe masave komunitare", përcakton ndër të tjera, se: Kohëzgjatja duhet të përcaktohet nga autoriteti kompetent për marrjen e vendimit brenda afatit të përcaktuar në ligj, dhe lloji e kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës, vlerësimin e rrezikut, dhe nevojat e rrethanat personale të të dënuarit. Parimi i ligjshmërisë nënkupton që gjykata (autoriteti vendimarrës), të mos tejkalojë afatin maksimal, apo afati të mos jetë nën minimumin e përcaktuar në ligj. Por dënimi komunitar, edhe në aspektin e kohëzgjatjes, duhet të përmbushë kërkesën që të jetë në proporcion me veprën e kryer, dhe të lejojë individualizimin duke pasur parasysh situatën personale, rrethanat familjare, materiale, sociale, nevojat dhe rekordet kriminale. Gjykata në këtë rast, ndryshe nga standardi ndërkombëtar, e përcakton kohëzgjatjen e dënimit alternativ (afatin e periudhës së provës) automatikisht, duke përllogaritur dyfishin e masës së dënimit të caktuar, pa pasur mundësi të marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat personale të të dënuarit.

Ndërsa, përsa i përket afatit të periudhës së provës për dënimet mbi 2 vjet burgim, nga studimi i vendimeve gjyqësore rezulton se, përgjithësisht, caktohet i njëjti afat me atë të dënimit ose më i gjatë. Por, ka edhe raste[68] kur gjykata cakton një afat më të shkurtër të periudhës së provës.

Problematikë përbën rasti, kur gjykata shprehet se periudha e provës është e barabartë me pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit kur i pandehuri ka qenë në paraburgim, ndërkohë që nuk shprehet dhe nuk rezulton as nga arsyetimi i vendimit, kjo periudhë. Për rrjedhim i lind detyrimi prokurorit që të bëjë përllogaritjen dhe përcaktimin e afatit të periudhës së provës. Por ka edhe raste të tjera, në të cilat afati rezulton nga arsyetimi i vendimit. Në vendimin nr.238 datë 30.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të 'Plagosja e rëndë me dashje", parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, përcaktohet se: "*në baze të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të pjesës së mbetur pavuajtur të* këtij dë*nimi (i pandehuri ka qëndruar me masë sigurimi arrest në burg nga data 18.07.2017, dita e arrestimit të tij, deri në datën 02.08.2017, si dhe me masë sigurimi arrest në shtëpi nga data 02.08.2017, deri ditën e sotme), për një kohe prove prej 3 (tre) vjetësh, e cila fillon nga e nesërmja e shpalljes së* këtij vendimi".


Ndërkohë nga vendimet gjyqësore, objekt i këtij studimi, nuk janë konstatuar raste të shkurtimit apo zgjatjes së afatit të periudhës së provës, në dhënien e vendimit përfundimtar për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim. Vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur 1 rast të shkurtimit të afatit të periudhës së provës.

Afati i përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, përgjithësisht, është i njëjtë me atë të periudhës së provës. Në raste të detyrimeve të caktuara si, riparimi i dëmit civil etj., ky afat mund të jetë më i shkurtër në raport me afatin e periudhës së provës. Në nenin 60 të Kodit Penal, përcaktohet qartë se: "*Periudha për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet nga gjykata brenda periudhës së* caktuar të provës".

Nga vendimet gjyqësore për personat në mbikëqyrje, periudha e provës që është dhënë për të dënuarit nga gjykata, për periudhën 2014 - 2018, lëviz nga 18 muaj deri në 5 vjet. Në më të shumtën e rasteve gjykata ka vendosur si periudhë prove periudhën nga 18 muaj deri në 3 vjet, e cila përbën **75.5%** të rasteve.

---

[68] *Vendim nr.3265 datë 13.12.2018, nr.3226 datë 05.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që për dënimin 3 vjet dhe 4 muaj burgim ka përcaktuar afat të periudhës së provës 3 vjet.*



		< 18 muaj	18 muaj-3 vjet	3 vjet	4 vjet	5 vjet	Totali
1.	Nr. i të dënuarve 2014	42	2867	317	33	20	3309
	% e të dënuarve	2.18 %	86.64 %	8.58 %	0.99 %	0.61 %	100%
2.	Nr. i të dënuarve 2015	97	4.495	286	52	48	3309
	% e të dënuarve	1.6 %	75.5%	4.8 %	1.1 %	1 %	100%
3.	Nr. i të dënuarve 2016	179	4206	201	31	22	4639
	% e të dënuarve	3.9 %	91%	4.3 %	0.7 %	0.5 %	100%
4.	Nr. i të dënuarve 2017	1600	3136	291	77	58	5162
	% e të dënuarve	31 %	61%	6 %	1.5 %	1.5 %	100%
5.	Nr. i të dënuarve 2018	4929	1094	260	151	77	6511
	% e të dënuarve	75.7 %	16.8 %	4.3 %	4 %	1.2 %	100%

5.5.1 Fillimi i afatit të periudhës së provës; ekzekutueshmëria e vendimit

Përcaktimi në nenin 59/4 të Kodit Penal se: "*Afati i provës fillon, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim.*", në mënyrën se si është formuluar, nënkupton fillimin e afatit të provës që nga dhënia e vendimit të shkallës së parë, në rastin kur pezullimi i dënimit me burgim vendoset që në këtë shkallë. Ky parashikim ka sjellë në praktikë qëndrime të ndryshme përsa i përket momentit të fillimit të periudhës së provës, për rrjedhim fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ. Sipas formulimit të nenit 59/4 të Kodit Penal, afati i provës fillon edhe nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për pezullimin e dënimit me burgim në shkallë të parë. Për rrjedhim, i pandehuri, edhe

pse nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, vendoset në periudhë prove dhe detyrohet që nga ky moment të përmbushë detyrimet e përcaktuara nga gjykata në nenin 60 dhe 61 të Kodit Penal.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë vërehet se përgjithësisht përcaktohet afati i fillimit të ekzekutimit nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, pra në shkallë të parë. Nga studimi i vendimeve gjyqësore të vitit 2018, dhe 139 vendime për vitin 2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vërehet se ndryshe nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përgjithësisht nuk përcaktohet afati i fillimit të periudhës së provës. Vetëm në pak raste[69] përcaktohet se periudha e provës fillon nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit. Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se, kryesisht përcaktohet në dispozitivin e vendimit se afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier vërehet se, në një asnjë rast nuk është përcaktuar në dispozitiv momenti i fillimit të periudhës së provës.

Në rastet e analizuara rezulton se ka dy qëndrime të ndryshme në praktikë. Sipas qëndrimit të parë, ekzekutimi fillon nga dita e nesërme e dhënies së vendimit gjyqësor të shkallës së parë dhe nuk është lidhur me marrjen e vendimit gjyqësor formë të prerë. Për pasojë, vendimi i dënimit është ekzekutuar ndaj një personi që ka ende cilësinë e të pandehurit, dhe nuk konsiderohet i dënuar, përderisa nuk ka ende në këtë moment një vendim gjyqësor të formës së prerë për dënimin e tij. Ndërsa sipas qëndrimit të dytë të mbajtur në praktikë, është urdhëruar fillimi i periudhës së provës (ekzekutimit të dënimit), pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë ose në dispozitivin e vendimit nuk është përcaktuar momenti i fillimit të periudhës së provës.

Qëndrimi i parë i mbajtur në praktikën gjyqësore, përveç se mbështetet në formulimin e nenit 59/4 të Kodit Penal, nëpërmjet interpretimit literal, duket se mbështetet edhe në nenin 21 të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", shtuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018, "Ekzekutimi i menjëhershëm", që parashikon se: "*ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit, vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e*

[69] *Vendim nr.2744 datë 28.06.2019; nr.3961 datë 09.03.2019; nr.2802 datë 28.06.2019; nr.4049 datë 09.03.2019; nr.3917 datë 09.02.2019; nr.5423 datë 26.01.2018; nr.180 datë 23.02.2018 etj., i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

gjykimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurimi me arrest për shkak tjetër, si dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë". Po ashtu në nenin 31/5 të ligjit që rregullon "Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë", parashikohet se: "*kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit*" dhe në nenin 31/9, dy paragrafet e para, parashikohet se: "*Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, i dërgon menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit për ekzekutimin e dënimit alternativ. Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata ia dërgon një kopje të vendimit edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale ku mbahet i dënuari, për lirimin e tij*".

Lidhur me ekzekutueshmërinë e disponimeve gjyqësore mbi pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë, rezulton se ky disponim passjell rifitimin e lirisë personale të të pandehurit vetëm në rast se ndaj tij është në fuqi, në momentin e shpalljes së vendimit, masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi". Por në këtë aspekt, është neni 389 i K.Pr. Penale, i cili përcakton si pasojë heqjen e masës së sigurimit dhe lirimin e të pandehurit të paraburgosur. Konkretisht, në nenin 389 të K.Pr.Penale përcaktohet se: "*1. Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit*". Pra, kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit jemi përpara heqjes së masës së sigurimit personal dhe për rrjedhim lirimit të të pandehurit, por kjo nuk nënkupton se jemi para ekzekutimit të menjëhershëm të vendimit të dënimit. Disponimi në vendimin gjyqësor mbi heqjen e masës së sigurimit, ashtu sikurse universalisht të gjitha vendimet e gjykatës penale që disponojnë urdhërimin e lirimit nga masat penale që kufizojnë lirinë personale të të pandehurit apo të dënuarit, edhe pse nuk kanë marrë formë të prerë, janë menjëherë të ekzekutueshme. Ankimi eventual ndaj tyre nuk mundet të pezullojë apo të prekë ekzekutueshmërinë e menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë të tyre.

Qëndrimi i parë i mbajtur në praktikën gjyqësore vjen në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, të garantuar në nenin 4 të K.Pr.Penale,

sipas të cilit: "*1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë*". Kjo për arsye se, ndërkohë që i pandehuri prezumohet ende i pafajshëm, ndaj tij ekzekutohet një dënim i dhënë nga gjykata e shkallës së parë, pa marrë formën e prerë. Pra për rrjedhim, i pandehuri vuan një dënim penal edhe pse nuk konsiderohet i dënuar. Vlen të theksohet edhe në këtë pikë se, dënimet alternative janë forma apo mënyra të veçanta të vuajtjes së dënimit me burgim.

Edhe në referim të jurisprudencës së GJEDNJ[70], në përputhje me nenin 6/2 të KEDNJ, arsyetimi në vendimet e gjykatave, me vlerësime për fajësinë përpara se personi të deklarohet fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprën penale, cenojnë parimin e prezumimit të pafajësisë si element i procesit të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, duke ndjekur të njëjtën logjikë, edhe urdhërimi për ekzekutimin e një vendimi dënimi që nuk ka marrë formë të prerë, pra ndërkohë që personi prezumohet i pafajshëm, del se cenon procesin e rregullt ligjor.

Në nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale,[71] "Vendimet e ekzekutueshme", parashikohet se: "*1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë. 2. Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes…*". Sipas përmbajtjes të dispozitës, vendimi për caktimin e dënimit alternativ sipas nenit 59 të Kodit Penal, nuk mund të konsiderohet as vendimi pafajësie dhe as vendim për pushimin e çështjes. Për rrjedhim, çështja e diskutueshme është nëse vendimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e të pandehurit, do të konsiderohet ose jo si vendim që e përjashton të gjykuarin nga dënimi. Por edhe në këtë aspekt, vendimi për aplikimin e dënimit alternativ në thelb nuk e përjashton të gjykuarin nga dënimi, përkundrazi përbën një vendim dënimi. Veçantia e këtij vendimi është vetëm forma e vuajtjes së dënimit, e tillë që e përjashton të gjykuarin nga ekzekutimi i menjëhershëm i dënimit me burgim, duke e zëvendësuar këtë me vënien në provë.

Qëndrimi i dytë gjen mbështetje edhe në përcaktimin në vendimin unifikues nr.2 datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: "*Prandaj, ekzekutueshmëria nuk mund të identifikohet plotësisht me të qenit final dhe për këtë arsye u konsiderua e domosdoshme që të përcaktohej karakteri i ekzekutueshëm i një vendimi si një kusht tjetër*

[70] *Böhmer kundër Gjermanisë* dhe *El Kaada kundër Gjermanisë.*

[71] *Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.*

i ndarë nga të tjerët. ...Në legjislacionin procedural penal shqiptar, me shprehjen "vendim i formës së prerë" do të kuptohet, sipas rastit, vendimi që ka marrë formën e "gjësë së gjykuar", ose "vendim i ekzekutueshëm". Siç u sqarua në arsyetimin e mësipërm, vendimi i gjykatës së Apelit, ndonëse nuk ka marrë ende statusin e "gjësë së gjykuar", është menjëherë i ekzekutueshëm. Kjo kuptohet edhe nga përmbajtja e nenit 417 të K.Pr.Penale (Pezullimi i ekzekutimit), i cili parashikon se "ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e Apelit". Në përputhje me këtë përcaktim unifikues, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për aplikimin e dënimit alternativ, nuk është as vendim i ekzekutueshëm dhe as nuk ka marrë formën e "gjësë së gjykuar", të nesërmen e shpalljes së tij.

Në vështrim krahasues, një parashikim i tillë si ai në nenin 59/4 të Kodit Penal, se: "*Afati i provës fillon, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim",* nuk konstatohet as në Kodin Penal Italian dhe as në Kodin Penal të Kosovës. Sipas jurisprudencës italiane, afati i periudhës së provës fillon nga momenti që vendimi gjyqësor bëhet përfundimtar (gjë e gjykuar), që nënkupton përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Kasacionit, me përjashtim të rastit kur i pandehuri nuk paraqet ankim ndaj vendimit gjyqësor. Në këtë rast, afati fillon nga përfundimi i gjykimit në shkallë të parë, pas kalimit të afatit të ankimit.

5.5.2 Problematika e shkaktuar nga fillimi i ekzekutimit të dënimit alternativ

Një nga problematikat e hasura në praktikë gjatë aplikimit të "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë" si dënim alternativ, lidhet me momentin e fillimit të ekzekutimit të tij.

Në praktikën gjyqësore janë konstatuar raste të aplikimit dhe ekzekutimit të dënimit alternativ sipas nenit 59 të Kodit Penal, në bazë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe prishja më pas e këtij vendimi nga gjykata e Apelit. Më pas me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit, i dënuari ka filluar të vuajë dënimin me burgim, edhe pse më parë ka qënë në periudhë prove dhe ka përmbushur detyrimet e vendosura për këtë qëllim. Po ashtu ka patur rast në praktikë, kur Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit gjyqësor të shkallës së parë duke aplikuar punën në interes publik, në vend të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë sipas nenit 59 të K.Penal, siç kishte disponuar gjykata e shkallës së parë. Në këtë

rast, i dënuari i ka vuajtur të dyja dënimet alternative. Pasi ka përmbushur detyrimet dhe kufizimet sipas nenit 59 të K.Penal, ka vijuar me kryerjen e punës në interes publik, sipas nenit 63 të K.Penal.

Prandaj, mbajtja e qëndrimit të parë në praktikën gjyqësore passjell problematikë të theksuar. Kjo, *për arsye se i pandehuri vuan ndërkohë një dënim pa q*enë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prishja e vendimit gjyqësor nga gjykata e Apelit dhe aplikimi i dënimit me burgim në Apel, legjitimon të pandehurin të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Por në praktikë edhe në këtë aspekt rezulton një tjetër problematikë, duke qenë se ligji nr.9381, datë 28.04.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë", parashikon si raste të përfitimit të kompensimit për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi. Ky ligj nuk parashikon kompensim për rastin e detyrimeve, apo kufizimeve, *të lindura si rezultat i dënimeve alternative. Edhe në nenin 57 të Kodit Penal, në llogaritjen e paraburgimit nuk parashikohet periudha e provës, pavarësisht kufizimeve dhe detyrimeve që ajo sjell. Për rrjedhim, personat që deklarohen të pafajshëm me vendim gjyqësor të* Gjykatës së Apelit, apo për të cilët caktohet një dënim tjetër i ndryshëm nga dënimi alternativ i ekzekutuar, nuk mund të përfitojnë kompensim sipas këtij ligji, megjithëse kanë pësuar kufizime dhe praktikisht kanë vuajtur dënimin alternativ.

Në praktikë, në rastin kur Gjykata e Apelit vendos lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, dhe dënimi alternativ është ekzekutuar ndërkohë, konsiderohet për rrjedhim si dënim i vuajtur. Pra, i dënuari ka filluar vuajtjen e dënimit, *që në momentin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*, edhe pse ky vendim nuk kishte marrë ende formë të prerë. Për rrjedhim, vendimi i Gjykatës së Apelit mbetet i paekzekutueshëm, duke qenë se është ekzekutuar tashmë vendimi i gjykatës së shkallës së parë, jo i formës së prerë.

Sipas intervistave me Shërbimin e Provës Tiranë, dënimi alternativ i pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim sipas nenit 59 të K.Penal, ekzekutohet menjëherë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Fillimisht, në Shërbimin e Provës paraqitet Urdhëri i Ekzekutimit të prokurorit për vendimin e shkallës së parë, dhe më pas paraqitet Urdhëri i dytë i Ekzekutimit për vendimin e Gjykatës së Apelit të formës së prerë. Një nga sugjerimet për ndryshimin e ligjit ka qenë pikërisht ekzekutimi i menjëhershëm me vendim gjyqësor, pa patur nevojë për Urdhër Ekzekutimi të prokurorit, për të lehtësuar zbatimin e dënimit alternativ.

Në një rast, Shërbimi i Provës e ka konsideruar të plotësuar periudhën e provës referuar si datë fillimi atë të marrjes së vendimit formë të prerë, ndërsa nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier është kërkuar zgjatja e afatit me 4 muaj duke konsideruar fillimin nga data e kontaktit të parë me Shërbimin e Provës.

5.5.3 Përfundimi i periudhës së provës para përfundimit të afatit

Kur i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë, Shërbimi i Provës paraqet përpara prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes[72]. Prokurori nxjerr vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ. Gjykata mund të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ, me propozimin e prokurorit, në të cilin vërtetohet se i dënuari ka kryer detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Kërkesa e prokurorit për përfundimin para afatit përmban të dhëna për precedentët penale të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit dhe progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit, si edhe arsyet e paraqitjes së kërkesës. Kërkesa për përfundimin para afatit të dënimit alternativ, paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, për rendin publik apo palët e treta.

Nga intervistat me Shërbimin e Provës rezulton se, shkurtimi i afatit të periudhës së provës duhet të ketë një aplikim më të gjerë, veëanërisht në ato raste kur është përcaktuar një periudhë prove shumë e gjatë për vepra penale të një rrezikshmërie të ulët, duke patur parasysh edhe rrethanat. Për shembull, për vepra penale si "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt", afati i periudhës së provës prej 1 vit apo 1 vit e 6 muaj apo më shumë, është plotësisht e përshtatshme që të shkurtohet.

Në nenin 59/4 të K.Penal, parashikohet se afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf. Pra, edhe në nenin 59/4 të K.Penal përcaktohet shkurtimi i afatit të periudhës së provës, por me kufizimin e moscenimit të afatit minimal.

Nga vendimet gjyqësore të studiuara, vlen të theksohet vendimi nr.461, regj. them. datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka

[72] *Sipas nenit 31/11 të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008.*

shqyrtuar kërkesën e Prokurorisë për shkurtim të afatit të dënimit alternativ. Në këtë vendim gjyqësor, lidhur me afatin minimal dhe maksimal të provës (i cili nuk duhet të cenohet nga zgjatja apo shkurtimi i afatit të provës), arsyetohet se: "*Në një interpretim harmonik të kësaj dispozite, rezulton se për dënime deri në dy vite burgim afati i kohës së provës është sa dyfishi i dënimit të caktuar, pra nuk ka një parashikim minimal apo maksimal të kohës së provës për dënime nën dy vite. Ndërsa për dënime nga 2 deri në 5 vite burgim afati minimal i kohës së provës është 24 muaj, ndërsa ai maksimal është 5 vite. Gjë e cila do të thotë se shprehja "pa cënuar afatin minimal dhe maksimal", gjen zbatim vetëm për dënime nga 2 deri në 5 vite burgim, përsa kohë që legjislatori për dënimet deri në dy vite burgim nuk ka parashikuar afat minimal dhe maksimal të kohës së provës*". Në këtë rast, gjykata pas vlerësimit të përmbushjes së të gjitha detyrimeve nga ana e të dënuarës si dhe vlerësimit të kushteve personale si qenia shtetase e huaj dhe pasja e një oferte pune në këtë shtet ku jeton dhe i ati i saj, përfundimin e arsimit, pendimin dhe moshën e re, ka vendosur shkurtimin e afatit të periudhës së provës nga 2 vjet në 1 vit.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore rezulton se, në asnjë rast tjetër nuk është kërkuar apo aplikuar shkurtimi i afatit të periudhës së provës, edhe pse rishikimi i zakonshëm i zbatimit të një dënimi apo mase alternative është standard ndërkombëtar i përcaktuar në Rekomandimin (2000)22 të Komitetit të Ministrave "Për përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane mbi dënimet dhe masat komunitare", që përcakton se parashikime ligjore duhet të bëhen për rishikimin e zakonshëm të zbatimit të një dënimi apo mase të tillë, nga një organ i pavarur dhe i ngarkuar nga ligji.

6. ASPEKTET PROCEDURALE TË GJYKIMIT

6.1 Riti i gjykimit

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim (neni 59 i Kodit Penal), zbatohet krahas caktimit të dënimit kryesor në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar të dënimit të gjykatës. Ky dënim alternativ nuk zbatohet gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit me burgim. Pra, të dënuarit nuk mund të paraqesin kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Për rrjedhim, rregullat procedurale

për kompetencën e gjykatës, ritin e gjykimit dhe vendimmarrjen e gjykatës nga ana procedurale, përcaktohen në rregullimet ligjore që normojnë fazën e gjykimit dhe atë të rigjykimit. Nuk janë të aplikueshme në këtë rast, dispozitat që normojnë fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjykata e aplikon këtë dënim alternativ edhe kryesisht, pa kërkesë të palëve, në rast se vlerëson se plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 59 të Kodit Penal. Kërkesa e të pandehurit nuk është kusht i domosdoshëm për aplikimin e dënimit alternativ. Por nga ana tjetër, paraqitja e rrethanave dhe akteve provuese për rrethanat e përcaktuara në këtë dispozitë, është shumë e rëndësishme për vendimarrjen e gjykatës. Gjithsesi, gjykata mund të aplikojë nenin 59 të Kodit Penal, edhe në rastin kur i pandehuri nuk e kërkon apo mban qëndrim mohues lidhur me veprën penale, por nga provat vlerësohet se plotësohen kushtet ligjore.

Për shqyrtimin e kërkesës për shkurtimin, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, ndryshimin e detyrimeve të vendosura, përfundimin para afatit të dënimit alternativ dhe revokimin, tërësisht ose pjesërisht, të vendimit të pezullimit, janë të aplikueshme dispozitat që normojnë fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Lidhur me ritin e gjykimit, neni 471 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar se, kur nuk deklaron papranueshmërinë, gjykata i shqyrton kërkesat duke caktuar seancën gjyqësore dhe duke lajmëruar për këtë qëllim palët dhe mbrojtësit, të paktën dhjetë ditë para seancës. Seanca gjyqësore zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi.

Ligji nr.8331/1998, në nenin 31/9 të tij ka parashikuar edhe rregulla procedurale për gjykimin e kërkesës për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ, deri në zhdukjen e pengesës objektive. Në nenin 31/10, ligji ka parashikuar rregullat për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, dhe në nenin 31/11 ka përcaktuar rregullat për përfundimin e periudhës së provës. Kështu gjykata, sipas nenit 31/10, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e pjesshëm a të plotë, të dënimit alternativ. Gjatë periudhës që shqyrton masën e revokimit të dënimit alternativ, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e tij dhe të urdhërojë që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjykata, pasi dëgjon prokurorin, të dënuarin, mbrojtësin e tij dhe provat e kërkuara prej tyre, merr vendim

brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit. Vendimi i njoftohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, Shërbimit të Provës dhe prokurorit. Ndaj vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Sipas nenit 31/11, gjykata mund të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ, me propozimin e prokurorit. Kërkesa e prokurorit për përfundimin para afatit, përmban të dhëna për precedentët penalë të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit,progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit dhe arsyet e paraqitjes së kërkesës. Kërkesa për përfundimin para afatit të dënimit alternativ, paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, për rendin publik apo palët e treta.

6.2 Kompozimi i trupit gjykues

Kompozimi i trupit gjykues dhe kompetenca, përcaktohet në rregullimet ligjore që normojnë fazën e gjykimit dhe atë të rigjykimit në nenet 13, 74, 75/a dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale. Kompozimi i trupit gjykues përcaktohet sipas rregullit në nenin 13/3 të Kodit të Procedurës Penale, në varësi të dënimit të parashikuar për veprën penale. Kompetenca lëndore për gjykimin e çështjes i takon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, kur vepra penale nuk përfshihet në kompetencën lëndore të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Rregullat për përcaktimin e kompetencës tokësore për gjykimin e çështjes, duke filluar nga vendi ku është kryer vepra penale, parashikohen në nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13, pika 2, shkronja "dh" e Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar përbërje monokratike të çdo gjykimi në fazën e ekzekutimit të dënimit penal. Për rrjedhim, kjo përbërje aplikohet për kompozimin e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës për shkurtimin, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, ndryshimin e detyrimeve të vendosura, përfundimin para afatit të dënimit alternativ dhe revokimin, tërësisht ose pjesërisht, të vendimit të pezullimit. Kjo do të thotë se, trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës do të jetë me një gjyqtar, pavarësisht sanksionit të dhënë nga gjykata në vendimin e dënimit me burgim.

Për kompetenncën tokësore aplikohet neni 470 i K.Pr.Penale që parashikon se: "*Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për*

shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.". Dispozitat e Ligjit nr. 8331/1998, nuk kanë përcaktuar rregulla për kompetencën tokësore dhe funksionale për gjykimin e kërkesave penale të mësipërme.

6.3 Legjitimiteti i kërkuesit

Kërkesat penale për shkurtimin, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës, zëvendësimi i dënimit të parë me një dënim tjetër, ndryshimin e detyrimeve të vendosura, përfundimin para afatit të dënimit alternativ dhe revokimin, tërësisht ose pjesërisht, të vendimit të pezullimit, janë kërkesa që i përkasin fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Për rrjedhojë, rregullat procedurale për kompetencën e gjykatës, për mënyrën se si ushtrohet kërkesa, rregullat mbi ritin e gjykimit dhe vendimmarrjen, nga ana procedurale përcaktohen në rregullimet ligjore që normojnë fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Përgjithësisht kuadri ligjor procedural në këtë drejtim përbëhet nga rregullimet e Kodit të Procedurës Penale mbi ekzekutimin e vendimeve penale të dënimit dhe Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998, "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*", i ndryshuar.

Kërkesat për shkurtimin e afatit të mbikëqyrjes, përfundimin para afatit të dënimit alternativ dhe ndryshimin e detyrimeve të vendosura kryesisht nëpërmjet heqjes së një detyrimit, përveç se nga ana e prokurorit, mund të ushtrohen dhe nga i dënuari. Në praktikën gjyqësore është konstatuar vetëm një rast, kur kërkesa për shkurtimin e afatit të mbikëqyrjes është ushtruar nga prokurori. Ky qëndrim i prokurorit vjen në përputhje me Rekomandimin (2000)22 të Komitetit të Ministrave, për rishikimin e zakonshëm të zbatimit të një dënimi apo mase të tillë nga një organ i pavarur dhe i ngarkuar nga ligji. Ndërsa, **kërkesat për** zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, zëvendësimi i dënimit të parë me një dënim tjetër, ndryshimin e detyrimeve të vendosura dhe revokimin, tërësisht ose pjesërisht, të vendimit të pezullimit, ushtrohen nga ana e prokurorit.

6.4 Disponimet gjyqësore

Gjykata, me vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor të të pandehurit me caktimin e dënimit me burgim, disponon për pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke përcaktuar periudhën e provës, kushtet dhe detyrimet që

duhet të përmbushen nga i dënuari gjatë periudhës së provës. Mosaplikimi i nenit 59 të Kodit Penal nga ana e gjykatës, përbën motiv për të paraqitur ankim kundër vendimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore, rezulton se ka patur një numër të konsiderueshëm dhe në rritje të kërkesave për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë. Për rrjedhim, numri i rasteve kur gjykata, duke vendosur miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, ka vendosur të aplikojë nenin 59 të K.Penal, është i konsiderueshëm dhe në rritje. Nga studimi i vendimeve të mësipërme rezulton se në një numër të lartë çështjesh gjyqësore, dënimi alternativ i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, është dënimi i përcaktuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Në këto raste, gjykata ka miratuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, sipas përcaktimit të rënë dakort, pa ndryshuar kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, të tilla si periudhën e provës dhe detyrimet.

Me aplikimin e dënimit alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë nga gjykata e shkallës së parë, edhe pse vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë, vjen si pasojë heqja e masave të sigurimit dhe lirimi i të pandehurit të paraburgosur. Në nenin 389 të K.Pr.Penale, përcaktohet se: "*1. Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit*". Në praktikën gjyqësore vërehet se, përgjithësisht gjykatat shprehen në dispozitivin e vendimit për disponimin mbi masën e sigurimit personal (heqjen e tyre) dhe lirimin e të pandehurit të paraburgosur, kur aplikohet neni 59 i Kodit Penal. Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Shkodër, vërehet se gjykatat përgjithësisht shprehen për heqjen e masës së sigurimit personal të caktuar dhe në fuqi ndaj të pandehurit. Nga studimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier, konstatohet se gjykata gjithmonë kur rezulton e caktuar masë sigurimi personal, disponon për shuarjen apo heqjen e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit.

Disponimet gjyqësore në fazën e ekzekutimit të vendimit të dënimit alternativ, janë të ndryshme si: shkurtimi apo zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës; shtyrja e ekzekutimit të vendimit; zëvendësimi i dënimit të parë me një dënim tjetër; ndryshimi i detyrimeve të vendosura (duke hequr, ndryshuar apo shtuar kushte dhe detyrime); përfundimin

para afatit të dënimit alternativ si dhe revokimin, tërësisht ose pjesërisht, të vendimit të pezullimit. Në rastet kur gjykata vlerëson se, kërkesat me objektin e mësipërm nuk janë të bazuara në ligj dhe në prova, vendos rrëzimin e kërkesës penale. Në rastin kur gjykata vendos rrëzimin e kërkesës penale për revokimin e pezullimit, mund të disponojë me një nga alternativat e tjera të mësipërme si: zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës; shtyrja e ekzekutimit të vendimit; zëvendësimi i dënimit të parë me një dënim tjetër; dhe ndryshimi i detyrimeve të vendosura.

Në rastet kur gjykata nuk e shqyrton kërkesën në themel, por gjendet para një kushti që pengon shqyrtimin, sipas nenit 471 të Kodit të Procedurës Penale disponon për deklarimin e papranueshëm të kërkesës penale. Rastet e parashikuara në nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale, kur gjykata e deklaron të papranueshme kërkesën, janë:

- nëse kërkuesi nuk paraqitet në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse ka dijeni rregullisht për datën dhe orën e saj,
- heq dorë nga kërkesa, ose ndryshon objektin e saj;
- kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkese të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe.

6.5 Ekzekutueshmëria e disponimeve

Përsa i përket ekzekutueshmërisë së disponimit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, *në praktikën gjyqësore ka qëndrime të ndryshme, të analizuara në pikën* 5.5.1 "Fillimi i afatit të periudhës së provës" të këtij Manuali.

Nga ana tjetër, kur gjykata vendos revokimin e dënimit alternativ të pezullimit të dënimit me burgim, vendimi gjyqësor që urdhëron revokimin dhe vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burgim deri më parë të pezulluar, nuk ekzekutohet menjëherë. Në të njëjtën mënyrë aplikohet edhe për shtimin e detyrimeve, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes dhe zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër. Që këto vendime gjyqësore të jenë të ekzekutueshme, do të duhet që të marrin formë të prerë sipas rregullave të zakonshme ligjore, konkretisht sipas nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se, në bazë dhe për zbatim të pikës 1 të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale, ankimi i vendimit të revokimit të pezullimit të dënimit me burgim, pezullon ekzekutimin e tij deri në marrjen formë të prerë të vendimit. Në këtë drejtim, praktika gjyqësore ka qenë e unifikuar.

7. EKZEKUTIMI I DËNIMIT ALTERNATIV

7.1 Vonesat në dorëzimin e vendimit gjyqësor

Shërbimi i Provës ka patur vështirësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me dënim alternativ sipas nenit 59 të K.Penal, për shkak të mosdërgimit të vendimit gjyqësor pranë Shërbimit të Provës, në një afat të shkurtër pas shpalljes së vendimit. Depozitimi me vonesë i vendimit gjyqësor pranë Shërbimit të Provës, sjell vështirësi dhe problematikë lidhur me përllogaritjen e periudhës së provës. Kjo për arsye se, edhe pse në vendimin gjyqësor përcaktohet fillimi i periudhës së provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit gjyqësor, në kushtet e mos komunikimit të vendimit, ky përcaktim bëhet i pazbatueshëm në këtë moment.

Në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligj nr.80/2018, përcaktohet se, kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit.

Sipas intervistave të kyera me Shërbimin e Provës, kryesisht Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, ka njoftuar Shërbimin e Provës për vazhdimin e periudhës së provës duke mos e konsideruar atë të përfunduar, ndryshe nga sa ishte vlerësuar nga Shërbimi i Provës. Në këto raste, është mbajtur qëndrimi i llogaritjes së fillimit të afatit të periudhës së provës nga kontakti i parë i të pandehurit me Shërbimin e Provës. Për rrjedhim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka llogaritur si periudhë prove, periudhën e kaluar nga shpallja e vendimit deri te kontakti i parë i të pandehurit me Shërbimin e Provës. Ky qëndrim i Prokurorisë gjen mbështetje në nenin 31/9, paragrafi 3, i ligjit nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligj nr.80/2018, që parashikon se në rastin kur i dënuari nuk paraqitet të nesërmen e shpalljes së vendimit, afati i ekzekutimit të dënimit alternativ fillon në momentin e kontaktit të parë të personit të vendosur në provë, me Shërbimin e Provës.

Gjithashtu nga intervistat me Shërbimin e Provës, rezulton se, edhe pse vendimi gjyqësor paraqitet me vonesë nga Prokuroria në Shërbimin e Provës referuar datës së shpalljes së vendimit, është konsideruar e papërfunduar periudha e provës edhe për një afat të shkurtër si 15 ditë.

7.2 Roli i Shërbimit të Provës në ekzekutimin e dënimit alternativ "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë"

Në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008, janë përcaktuar rregulla të veçanta për ekzekutimin e vendimit me burgim, përkatësisht në nenin 31/5. Në nenin 31/5 të ligjit, parashikohet detyrimi i gjykatës që t'i dërgojë vendimin gjyqësor (që ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë), prokurorit dhe institucioneve të ekzekutimit të vendimit penal. Nga ana tjetër, parashikohet edhe detyrimi i të dënuarit të vënë në provë, që gjatë kohës së provës të raportojë rregullisht te Shërbimi i Provës, i cili duhet të informojë rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit. Përveç detyrimit për informim të Policisë, Shërbimi i Provës ka edhe detyrimin e mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe raportimit menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk mban kontakte me këtë Shërbim, apo nuk përmbush detyrimin e vendosur. Në këtë mënyrë, ky ligj përcakton kuadrin e funksionimit të Shërbimit të Provës, si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj dënimit me burgim.

Në nenin 31/7 dhe 31/9, përcaktohet roli i Shërbimit të Provës që konsiston kryesisht në:

- mbikëqyrjen e zbatimit të dënimit alternativ; nëpërmjet paraqitjes së informacionit dhe raporteve para prokurorit ose gjykatës;
- informon pa vonesë prokurorin për pamundësinë e ekzekutimit për shkaqe objektive dhe i propozon prokurorit për të ndryshuar, sipas ligjit, kushtet dhe detyrimet për të dënuarin, pasi verifikon faktet dhe rrethanat e mospërmbushjes së tyre nga i dënuari;
- ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ; nëpërmjet bashkëpunimit me OJF dhe shërbimin e ndërmjetësimit;
- asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në integrimin social të tij;
- ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social, duke vendosur kontakte me familjen, me OJF dhe individët dhe

- bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe 13 institucione të tjera të drejtësisë penale, gjatë pranimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të rrezikshmërisë dhe nevojave të të dënuarve me dënime alternative me burgim.

7.2.1 Roli i Shërbimit të Provës para dhënies së vendimit gjyqësor

Roli i Shërbimit të Provës nuk konsiston vetëm në fazën e ekzekutimit të vendimit të pezullimit të dënimit me burgim, por edhe në fazën e hetimeve paraprake dhe gjykimit, përpara dhënies së vendimit gjyqësor përfundimtar. Konkretisht, në nenin 31/8 të ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024 datë 27.11.2008 dhe 80/2018, rregullohet raporti i Shërbimit të Provës para vendimit. Sipas kësaj dispozite, Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit, paraqet një raport për vlerësimin e rrethanave shoqërore, për të ndihmuar marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake ose të gjykimit. Raporti duhet të përmbajë informacion dhe të dhëna për personalitetin e shkelësit të ligjit, punësimin e mëparshëm, sjelljen e nivelin arsimor, dhe faktorët që ndikojnë apo mund të ndikojnë në sjelljen e tij, me qëllim që të ndihmojë gjykatën në vlerësimin e duhur të dënimit alternativ. Raporti mbështetet në fakte, duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv, si dhe të dërgohet brenda kohës së caktuar nga gjykata. Raporti duhet të përmbajë edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës për dënimin e përshtatshëm alternativ për personin, për integrimin e tij në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

Sipas intervistave me Shërbimin e Provës, një praktikë e tillë vërehet kryesisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe lidhet veçanërisht me çështjet me të mitur ose për vepra penale të caktuara, si "Dhuna në familje". Këto raste gjithsesi janë të pakta, dhe përgjithësisht, në praktikë gjykatat nuk kërkojnë hartimin e raportit nga Shërbimi i Provës përpara dhënies së vendimit.

Në këtë aspekt, vlen të theksohen standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Rekomandimi (2010)1 i Komitetit të Ministrave, mbi "Rregullat e vënies në provë" të Këshillit Evropian, sipas të cilave raporti i Shërbimit të Provës, para dhënies së vendimit gjyqësor, duhet të mbështetet në një informacion të përcaktuar qartë, dhe për aq sa është e mundur të verifikohet dhe përditësohet gjatë ecurisë së procesit. Të pandehurit duhet t'i jepet mundësia e përfshirjes në përgatitjen e raportit, dhe mendimi i tyre

duhet të pasqyrohet në raport, si dhe përmbajtja t'u komunikohet atyre ose përfaqësuesve ligjorë.


7.3 Përhapja e aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim

"Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë", sipas statistikave gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit të Provës, është dënimi alternativ më shumë i aplikuar në praktikën gjyqësore. Konkretisht, sipas statistikës së Shërbimit të Provës për periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2018, rezulton se ka patur vetëm 31074 të dënuar sipas nenit 59 të Kodit Penal, që përfaqësojnë 80.79 % të të dënuarve. Për rrjedhim, "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove", është dënimi alternativ më i aplikuar në raport me dënimet e tjera alternative si: pezullimi i dënimit dhe kryerja e një pune në interes publik (13.80 %); lirimi me kusht (3.89 %); qëndrimi në shtëpi (1.48 %); apo gjysmëliria (0.04 %).

Nr.	APLIKIMI SIPAS LLOJIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE [VITI 2009 - 2018]	Kodi Penal	Të dënuar	Të dënuar në %
1	Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në periudhë prove	Neni 59	31074	80.79
2	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e nje pune në interes publik	Neni 63	5306	13.80
3	Lirimi me kusht	Neni 64	1498	3.89
4	Qëndrimi në shtëpi	Neni 59/a	570	1.48
5	Gjysmëliria	Neni 58	14	0.04
-	Total	-	30934	100%

Lloji i dënimit alternativ	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Neni 59 i K.P., Pezullimi	3.189	4.798	4.460	4.904	6.171
Neni 59/a i K.P., Qëndrimi në shtëpi	56	92	74	85	82
Neni 64 i K.P., Lirimi me kusht	64	84	101	172	254
Neni 63 i K.P., Punë në interes publik	694	974	938	884	1.017
Neni 58 i K.P., Gjysmëliria	0	4	4	1	4
Totali	4.003	5.952	5.577	6.046	7528

Në mënyrë grafike, të dhënat statistikore për vitin 2018 në shkallë vendi, janë:



Aplikimi më i shpeshtë i këtij dënimi alternativ, në raport me dënimet e tjera alternative, ndodh për këto arsye:

Së pari, kryesisht kjo vjen për shkak të marzhit të lartë të dënimit penal, të parashikuar nga neni 59 i K.Penal. Konkretisht, pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë, aplikohet për dënime të dhëna deri në 5 vjet burgim, çka për rrjedhim e bën këtë dënim alternativ me shpesh të aplikueshëm për një kategori më të gjerë veprash penale. Sidomos, parë kjo në raport me dy dënimet e tjera alternative; pezullimi i dënimit dhe kryerja e një pune në interes publik dhe gjysmëliria, për të cilat ligji parashikon si marzh dënimi atë të, deri në një vit burgim.

Së dyti, kjo vjen për shkak të llojit të detyrimeve që i lindin të dënuarit gjatë aplikimit të këtij dënimi alternativ, në krahasim me dënimet alternative të tjera. Pra në këtë rast, i dënuari nuk është i detyruar, as për kryerjen e një pune në interes publik, dhe as detyrimin që të vuajë për një periudhë të caktuar kohore dënimin me burgim, pra të qëndrojë një pjesë të kohës në burgim. Konkretisht, gjatë aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënies në provë, i dënuari përgjithësisht nuk ka detyrime të tjera përveç atij që të mos kryejë vepër tjetër penale, të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës dhe, një ose disa, nga masat e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal. Këto të fundit, janë më pak të aplikuara në praktikën gjyqësore dhe duke patur parasysh detyrimet më të aplikuara, del se ato nuk sjellin barrë domethënëse për të dënuarit.

Nga ana tjetër, ky dënim alternativ nuk ka përfitimin e të dënuarit për t'u konsideruar i padënuar më parë pas përfundimit të periudhës së provës, ndryshe nga sa parashikohet në nenin 63 të Kodit Penal për pezullimin e vendimit me burgim me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik. Gjithsesi, duket se edhe ky përfitim nuk ka ndikuar në mënyrë domethënëse në numrin e rasteve të aplikimit në praktikë të këtyre dy dënimeve alternative. Në këtë aspekt, me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë, i dënuari konsiderohet si i tillë deri në plotësimin e afatit dhe kushteve të rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Së treti, një nga shkaqet e tjera lidhet me kushtet ligjore të përcaktuara për aplikimin e kësaj dispozite, sikurse janë ato të *moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën.* Pra, rrethanat e përcaktuara në nenin 59 të Kodit Penal[73], për aplikimin e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit, janë më të gjera dhe më shpesh të konstatuara në praktikë.


Duke qenë se, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim aplikohet për dënime deri në 5 vjet burgim, aplikimi i këtij dënimi alternativ në raport me numrin e të dënuarve deri në 5 vjet burgim, në shkallë vendi dhe për vitet e fundit, është si vijon:

Viti	2018	2017	2016	2015
Numri i të dënuarve deri në 5 vjet	9.423	8.613	11.090	12.061
Aplikuar neni 59 i K.Penal	6171	4.904	4460	4798
Në përqindje	82 %	57 %	30.2 %	37.8 %

Pra, nga të dhënat statistikore vërehet një rritje e konsiderueshme vitet e fundit e aplikimit të pezullimit të dënimit me burgim.

[73] Neni 59 i Kodit Penal: "*…shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale…*'.

Në aspektin e krahasimit të numrit të kërkesave të Prokurorisë për aplikimin e nenit 59 të K.Penal, në vitet e fundit në shkallë vendi, rezulton si vijon:



Për vitin 2018, në shkallë vendi, Prokuroria ka paraqitur në total 4814 kërkesa për aplikimin e nenit 59 të K.Penal, ndërsa gjykatat kanë aplikuar nenin 59 të K.Penal, në 4904 raste. Pra vërehet një përqindje shumë e lartë, rreth 98%, e pranimit të kërkesave të Prokurorisë.

Në analizë, studimi i kryer ka pasur si objekt praktikën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vitin 2018 dhe 2019.

Në praktikën gjyqësore të të gjitha gjykatave, vërehet se ka raste të shumta të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, dhe ky dënim alternativ është më i përhapuri.

Numri i të dënuarve me dënime alternative të mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës, për vitin 2018, është si vijon:

Zyra e Shërbimit të Provës	Fier	Shkodër	Korçë	Tiranë
Personat në mbikëqyrje	397	736	299	2524

7.3.1 Veprat penale për të cilat është aplikuar neni 59 i K.Penal

Nga analiza e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Fier, Shkodër dhe Korçë, që kanë disponuar për "pezullimin e ekzekutimit

të vendimit me burgim dhe vënien në provë", rezulton se kategoria e veprave penale për të cilat është aplikuar ky dënim alternativ është shumë e gjerë, ku përfshihen: "Vjedhje e energjisë elektrike", parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal; "Ndërtim i paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; "Mashtrimi në sigurime", parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal; "Dhunë në familje", parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal; "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal; "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 dhe 283/2 i Kodit Penal; "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal; "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve", parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal; "Vjedhja", parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal; "Goditje për shkak të detyrës", parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal; "Kontrabanda me mallra te tjera", parashikuar nga neni 174/1 i Kodit Penal; "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të vitit 2018 dhe 2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vërehet se veprat penale për të cilat është aplikuar me shumë pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, sipas shpeshtësisë janë: "Vjedhje të energjisë elektrike", "Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt", "Ndërtimi i paligjshëm", ndërsa ka më pak raste të veprave penale si: "Dhunë në familje", "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror", "Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit", "Fshehjes së të ardhurave", etj.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të së njëjtës periudhë, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korëë, vërehet se përgjithësisht, aplikimi kryhet për vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, ku mbizotërojnë: "Vjedhja e energjisë elektrike", "Ndërtimi i paligjshëm", "Drejtimi i automjeteve", "Dhuna në familje" etj.

Ndërsa në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërehen më shumëllojshmëri veprash penale në të cilat aplikohet neni 59 i Kodit Penal, ku përveç veprave penale të mësipërme, konstatohen edhe vepra penale si: "Vetgjyqësia", "Falsifikimi i dokumentave", "Korrupsioni aktiv", "Plagosja e lehtë me dashje", "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik", "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve sportive dhe të gjuetisë" etj.

7.4 Mospërmbushjet e detyrimeve

Mospërmbushjet më të hasura në praktikë, sipas shpeshtësisë së përhapjes, janë:

1. Mosmbajtja e kontakteve me Shërbimin e Provës,
2. Kryerja e një vepre tjetër penale, dhe
3. Mospërmbushja e detyrimeve të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal.

Nga intervistat me Shërbimin e Provës rezulton se, konsiderohet shkelje nëse i dënuari nuk konfirmon marrjen dhe mbajtjen e kontakteve, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni. Shërbimi i Provës procedon me njoftimin e të dënuarit, nëpërmjet Prokurorisë ose Komisariatit të Policisë. Në ligj dhe akte nënligjore, nuk ka një afat të përcaktuar lidhur me pritjen e përgjigjes për njoftimin e të pandehurit. Gjithashtu, një afat i tillë nuk është i përcaktuar as për mbajtjen në proces të praktikës, nga ana e Shërbimit të Provës. Në praktikë ka raste kur, i dënuari megjithë përpjekjet për t'u njoftuar, nuk merr njoftim për shkak të mosgjetjes. Për rrjedhim, jo vetëm që është i domosdoshëm, pasqyrimi i saktë dhe i plotë i adresës dhe kontaktit të të dënuarit në vendimin gjyqësor, por edhe duhet të merren masa nga autoriteti procedues për njoftimin e të dënuarit, lidhur me detyrimin që ka për të njoftuar ndryshimin e adresës.

Nga intervistat me Shërbimin e Provës rezulton se, nuk është konsideruar si shkelje e detyrimeve mosmarrja e informacionit nga Komisariatet e Policisë, lidhur me respektimin e detyrimeve për të dënuarin që: të *mos frekuentojë vende të caktuara;* të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike*;* të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara*;* të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale*; dhe të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.* Mungesa totale e informacionit për respektimin e këtyre detyrimeve nuk është konsideruar shkelje, por është pasqyruar ky fakt në raport.

Po ashtu, nuk është konsideruar shkelje mosndjekja e trajtimeve mjekësore apo marrja e një formimi apo arsimi profesional, ushtrimi i një veprimtarie profesionale etj. nga ana e të dënuarit. Edhe në këto raste, Shërbimi i Provës është mjaftuar me pasqyrimin e këtij fakti në raport.

Problematika e mësipërme tregon mungesën e mbikëqyrjes efektive të Shërbimit të Provës mbi zbatimin nga i dënuari të dënimit alternativ. Kjo

praktikë nuk plotëson standardet e përcaktuara nga Rekomandimi nr.(99)22 i Komitetit të Ministrave lidhur me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë në burgje, sipas të cilit, në mënyrë që dënimet komunitare të jenë alternativa të besueshme, zbatimi efektiv i tyre duhet të sigurohet, në veçanti nëpërmjet infrastrukturës për zbatimin dhe monitorimin e dënimeve komunitare, me qëllim që gjyqtarët dhe prokurorët të besojnë në efektivitetin e tyre. Prandaj, rekomandohet që të ngrihet infrastruktura e nevojshme për monitorimin e zbatimit të këtyre detyrimeve.

7.5 Pasojat për mospërmbushje të detyrimeve

Pasojat, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e të dënuarit, parashikohen në nenin 59/*5* të Kodit Penal: *"Nëse i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit."* dhe nenin 62 të Kodit Penal, "Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës", që parashikon se: "*Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit. Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, Shërbimi i Provës i raporton menjëherë prokurorit. Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg*".

Nga studimi i vendimeve gjyqësore të vitit 2018 dhe 2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vërehet se shpesh pasqyrohen, në pjesën arsyetuese të vendimit, pasojat në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, sipas përcaktimit në nenin 62 të Kodit Penal.[74] Në vendimin nr.227 datë 29.01.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kur aplikon nenin 59 të Kodit Penal për veprën penale të "Vjedhja në bashkëpunim", shprehet në

[74] *Vendim nr.1478 datë 24.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*

arsyetimin e vendimit se: "*Nëse i pandehuri nuk përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata, atëherë ndaj tij do të veprohet sipas nenit 62 të Kodit Penal nën titullin "Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës", ku parashikohet shprehimisht…*".

7.5.1 Zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, ndryshimi i detyrimeve, zëvendësimi i dënimit dhe shtyrja e ekzekutimit të dënimit alternativ

Disponimet e gjykatës janë sipas rëndësisë së shkeljes apo mospërmbushjes, dhe nga studimi i rasteve në praktikën gjyqësore, vërehen sipas shpeshtësisë:

1. *zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës;*
2. *zëvendësimi i dënimit të parë me një dënim tjetër;*
3. *ndryshimi i detyrimeve të vendosura;*
4. *revokimi, tërësisht ose pjesërisht, i vendimit të pezullimit.*

Në zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, gjykatat kanë respektuar në çdo rast afatin maksimal të periudhës së provës, të përcaktuar në nenin 59 të Kodit Penal, pra 5 vjet. Nga studimi i rasteve vërehet se, zgjatja e afatit të mbikëqyrjes i referohet afatit të periudhës së provës të caktuar nga gjykata dhe kohës gjatë së cilës i dënuari nuk ka mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës.

Zëvendësimi i dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal me një dënim tjetër, nënkupton edhe me një dënim tjetër alternativ. Në praktikën gjyqësore është konstatuar vetëm një rast i zëvendësimit të dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal, me atë të gjysmëlirisë sipas nenit 58 të Kodit Penal. Nuk ka patur asnjë rast në praktikë të zëvendësimit të dënimit alternativ sipas nenit 59 të Kodit Penal, me dënim tjetër alternativ. Nuk jemi para zëvendësimit të dënimit të parë me dënim tjetër, atë të dënimit me burgim. Në këtë rast, konsiderohet se jemi para revokimit të vendimit të pezullimit.

Ndryshimi i kushteve dhe detyrimeve të vendosura, nënkupton vetëm detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal dhe nenin 61 të këtij Kodi. Ndryshimi i detyrimeve sipas nenit 62 të Kodit Penal, përfshin heqjen e detyrimeve, ndryshimin e detyrimeve me të tjerë apo edhe shtimin e detyrimeve. Në nenin 31/9 të ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", përcaktohet ndryshimi i kushteve dhe detyrimeve për ekzekutimin e dënimit, në rastin e pamundësisë së ekzekutimit për shkaqe objektive. Rezoluta (70)1, lidhur me organizimin praktik të masave për mbikëqyrjen

dhe kujdesin e mëpasshëm të të dënuarve apo liruarve me kusht, përcakton standarde për të siguruar që, ndryshimi i detyrimeve të përcaktuara në dënimin me kusht, të jetë i mundshëm në rast të ndryshimit të nevojave apo rrethanave. Në vështrim krahasues, neni 52 i Kodit Penal të Kosovës parashikon se, nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mundur ta përmbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përmbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës, të parashikuar në ligj.

Gjykata mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të dënimit alternativ në rastet kur dënimi alternativ nuk mund të ekzekutohet për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit, deri në zhdukjen e pengesës objektive, si edhe kur ndaj të dënuarit caktohet një masë sigurimi personal.

Nga vendimet gjyqësore objekt i këtij studimi, rezulton se rastet e kërkesave për zgjatje të afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës, *zëvendësimit të dënimit të parë me një dënim tjetër*, dhe ndryshimit të detyrimeve të vendosura, janë të rralla në praktikën gjyqësore.

Rëndësi thelbësore në drejtim të përcaktimit të pasojës konkrete, përbën përcaktimi i rëndësisë së shkeljes, nëse ajo do të konsiderohet e lehtë apo e rëndë. Në këtë aspekt, gjykatat në arsyetimin e vendimeve vetëm sa kanë kategorizuar rëndësinë, pa u ndalur në arsyet e këtij kategorizimi konkret, por përgjithësisht konstatohet i njëjti qëndrim në vlerësimin e rëndësisë së shkeljes. Ndërkohë që për shkeljet e rënda janë të aplikueshme disa pasoja të trajtuara më sipër, për shkeljet e lehta dhe për herë të parë të kushteve apo detyrimeve të vendosura, ka vetëm një pasojë, dhënia e paralajmërimit nga ana e prokurorit dhe regjistrimi i tij në dosjen personale të të dënuarit.

Sipas intervistave me Shërbimin e Provës, përgjithësisht në praktikë lihet në vlerësim të Prokurorisë pasoja që do kërkohet të aplikohet në rast të shkeljeve të kushteve dhe detyrimeve. Shërbimi i Provës thjesht e përmend mundësinë e zgjatjes së afatit apo zëvendësimit të dënimit. Në disa raste, Shërbimi i Provës ka kërkuar zgjatjen e afatit të periudhës së provës, ndërsa Prokuroria pothuaj gjithmonë ka kërkuar revokimin e dënimit alternativ. Nga ana tjetër, qëndrimi mbizotërues në praktikën gjyqësore është ai i zgjatjes së periudhës së provës.

7.5.2 Revokimi i dënimit alternativ

Revokimi tërësisht i vendimit të pezullimit, sjell gjithmonë për pasojë ekzekutimin e dënimit me burgim në masën e përcaktuar në vendim nga

gjykata. Edhe sipas standardeve ndërkombëtare, zëvendësimi i dënimit alternativ me dënimin me burgim, duhet të jetë zgjidhje e fundit, vetëm kur çdo mundësi tjetër është e papërshtatshme. Një përcaktim i tillë parashikohet edhe në nenin 31/10, paragrafi 3, i ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ndryshuar me ligjin nr.10024, datë 27.11.2008. Sipas kësaj dispozite, kur gjykata vendos ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, dënimi me burgim jepet në mungesë të dënimeve të tjera alternative të përshtatshme. Në çdo rast, gjykata merr parasysh mënyrën dhe shkallën e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari.

Nga vendimet gjyqësore, objekt i këtij studimi, rezulton se rastet e kërkesave për revokimin e pezullimit të dënimit me burgim, janë të rralla në praktikën gjyqësore.

Lidhur me revokimin e dënimit për shkak të mosmbajtjes së kontakteve me Shërbimin e Provës, vlen të theksohet vendimi nr. 41-2018-250 elektronik, datë 24.01.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Në këtë rast, prokurori kërkoi revokimin e pezullimit të dënimit me burgim, të caktuar për shkak të mosparaqitjes së të dënuarit në mënyrë të përsëritur dhe pa shkaqe të arsyeshme pranë Shërbimit të Provës, pavarësisht dijenisë së rregullt për vendimin gjyqësor dhe detyrimin për ndjekjen e programeve rehabilituese, si dhe paralajmërimin e Prokurorisë nëpërmjet inspektorit të policisë së zonës, duke i vlerësuar si shkelje të rënda. Gjykata konstatoi se njoftimet i ishin drejtuar të dënuarit të mitur dhe jo përfaqësuesit të tij ligjor, duke shkaktuar mosmarrjen dijeni efektivisht të rëndësisë së përmbajtjes së aktit. Po ashtu gjykata konstatoi mungesën në këtë procedurë të prindit, përfaqësuesit ligjor, kujdestarit ligjor, psikologut apo personit të besuar. Për rrjedhim, gjykata vendosi të mos revokojë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim, por zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes për të dënuarin.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet fakti se gjykata përcaktoi si fillim të afatit të provës, datën e nesërme të shpalljes së vendimit nga kjo gjykatë (pra gjykata e shkallës së parë), edhe pse ky vendim nuk konsiderohej i formës së prerë.

Lidhur me revokimin e dënimit për shkak të kryerjes së një vepre penale të re gjatë periudhës së provës, vlen të theksohet vendimi nr.41-2019-2174 elektronik, datë 14.06.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Në këtë rast, gjykata konstatoi se i dënuari gjatë periudhës së provës ka kryer një vepër tjetër penale, më të rëndë se ajo për të cilën ishte dënuar më parë.

Konkretisht, i dënuari gjatë periudhës së provës kishte ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortes, dhe ishte dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimi i gjykatës ishte lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë), për veprën penale të "Dhunës në familje". Në këto kushte, gjykata vendosi revokimin e pezullimit të dënimit me burgim, për shkak të kryerjes së një vepre tjetër penale.

Ky qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga GJEDNJ në çështjet *Böhmer kundër Gjermanisë* dhe *El Kaada kundër Gjermanisë*, sipas të cilit vendimi gjyqësor për revokimin e pezullimit të dënimit me burgim për kryerje të një vepre tjetër penale gjatë periudhës së provës, i cili çon në një vlerësim për fajësinë përpara se kërkuesi të dënohet në një proces penal nga gjykata kompetente, cenon prezumimin e pafajësisë garantuar nga neni 6/2 i KEDNJ. Në rastin konkret, i dënuari ishte deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjatë periudhës së provës, përpara dhënies së vendimit të revokimit të pezullimit të dënimit me burgim, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Prandaj, në këto rrethana interpretimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë i nenit 62 të Kodit Penal, në pjesën që parashikon se: "*Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur,…", është plotësisht në përputhje me standar*din e përcaktuar nga GJEDNJ, *për respektimin e prezumimit të pafajësisë si element i procesit të rregullt ligjor. Nga studimi i vendimeve*, nuk rezulton asnjë rast i revokimit të pezullimit për shkak të kryerjes së një vepre të re gjatë periudhës së provës, ndërkohë që lidhur me të, i dënuari nuk ishte deklaruar ende fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në nenin 62 të Kodit Penal "Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës", parashikohet shprehimisht se: "*Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale,…*".

Së pari, nga përmbajtja e dispozitës del se shkelja konsiston në kryerjen e çfarëdo vepre penale gjatë afatit të provës. Edhe pse, vendimi penal për deklarimin fajtor për veprën penale të kryer gjatë periudhës së provës, merret pas përfundimit të periudhës së provës, juridikisht kjo sjell pasoja në kuptim të nenit 62 të Kodit Penal.

Kodi Penal nuk bën diferencim në këtë aspekt në llojin e veprës penale, si p.sh., *të njëjtë apo më të rëndë se vepra penale për të cilën është aplikuar dënimi alternativ etj. Gjithsesi në varësi të natyrës dhe rrezishmërisë së veprës penale të kryer nga i dënuari gjatë periudhës së provës, gjykata ka diskrecion*

që, në përputhje me nenin 62 të Kodit Penal, të mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit.

Në vështrim krahasues, në nenin 168 të Kodit Penal Italian parashikohet si shkelje dhe shkak për revokimin e pezullimit, rasti kur i dënuari kryen një krim ose kundërvajtje penale të të njëjtës natyrë, për të cilën i jepet dënim me burgim. Në këtë mënyrë, në rastin kur gjatë periudhës së provës i dënuari kryen një vepër penale, kundërvajtje penale më të lehtë, për të cilën nuk caktohet dënim me burgim, nuk procedohet me revokimin e dënimit me burgim. Ndërsa në nenin 50 të Kodit Penal të Kosovës, parashikohet revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës së re penale, nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale, për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet. Gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht, nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy (2) vjet ose dënimi me gjobë, pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera, si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale.

Së dyti, nga përmbajtja e dispozitës së nenit 62 të Kodit Penal, del se parashikohet vetëm rasti kur i dënuari kryen vepër penale tjetër gjatë afatit të provës. Nuk parashikohet, as në këtë dispozitë dhe as në dispozitat e tjera, rasti kur i dënuari ka kryer një vepër penale përpara fillimit të periudhës së provës, por dënohet me vendim të formës së prerë gjatë periudhës së provës. Në vështrim krahasues me Kodin Penal të Kosovës, *vërehet se sipas* nenit 51, gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me aktgjykim të plotfuqishëm konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht, dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër penale. Në këtë rast zbatohen dispozitat e paragrafit 3, të nenit 50 të këtij Kodi, dhe gjykata cakton një dënim të vetëm për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, dhe trajton dënimin e revokuar me kusht, si të përcaktuar.

Ndërsa në nenin 168 të Kodit Penal Italian vërehet se, kur i dënuari ka kryer një vepër tjetër penale përpara dënimit me kusht, dhe masa e dënimit me kusht e mbledhur me masën e dënimit tjetër tejkalon limitin e lejuar nga ligji për aplikimin e dënimit alternativ, gjykata procedon me revokimin

e pezullimit. Në këtë rast, duhet që vendimi për dënimin për veprën e re, *të bëhet përfundimtar (gjë e gjykuar) pas vendimit të dënimit me kusht dhe përpara përfundimit të afatit të provës (si rregull 5 vjet për krimet dhe 2 vjet për kundërvajtjet). Kjo nënkupton që afati 5 vjet i pezullimit, duhet të fillojë nga momenti që vendimi për dënimin me kusht bëhet përfundimtar (gjë e gjykuar).*

Në këtë aspekt theksohet qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në vendimin nr.778-62-2018-2221, datë 26.04.2018, *për bashkimin e dënimeve penale. I dënuari ishte deklaruar fajtor me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që kishte marrë formë të prerë në datë 01.12.2017*, me 8 muaj burgim, duke u pezulluar dënimi dhe vënë në provë për 16 muaj. Gjatë periudhës së provës, në datë 06.03.2018, i dënuari deklarohet fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër tjetër nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me 6 muaj burgim duke u pezulluar dënimi dhe vënë në provë për 12 muaj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka analizuar ligjin e zbatueshëm, ka bashkuar dënimet e mësipërme në një dënim të vetëm prej 12 muaj, duke e vënë në provë të dënuarin për një periudhë 2 vjet.

7.6 Mbarimi i dënimit alternativ

Sipas nenit 62 të Kodit Penal, gjykata vendos revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg apo pasojat e tjera të përcaktuara në nenin 62, vetëm gjatë periudhës së provës. Me përfundimin e përiudhës së provës, si rregull, dënimi alternativ penal konsiderohet i vuajtur dhe për rrjedhim nuk mund të procedohet më me revokimin e tij. Përfundimi i periudhës së provës rregullohet edhe në nenin 31/11 të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, sipas të cilit kur i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë, Shërbimi i Provës paraqet përpara prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Prokurori nxjerr vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ.

Ndërsa si përjashtim, gjykata mund të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ, me propozimin e prokurorit, në të cilin vërtetohet se i dënuari ka kryer detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Kërkesa e prokurorit për përfundimin para afatit, përmban të dhëna për precedentët

penalë të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit, progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit, dhe arsyet e paraqitjes së kërkesës. Kërkesa për përfundimin para afatit të dënimit alternativ, paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, për rendin publik apo palët e treta.

8. KONKLUZIONE MBI PRAKTIKËN GJYQËSORE

i. Aplikimi i dënimit alternativ - Qëndrimi mbizotërues në praktikën gjyqësore, sipas të cilit dënimi me burgim duhet të konsiderohet si zgjidhje e fundit dhe për rrjedhim duhet të vendoset vetëm në rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat e rëndësishme, çdo dënim tjetër është qartësisht i papërshtatshëm, është tërësisht në përputhje me standardin ndërkombëtar. Por në këtë aspekt, rekomandohet nevoja për unifikimin e qëndrimit në mënyrë që mundësia e aplikimit të dënimit alternativ, të shqyrtohet dhe arsyetohet kryesisht nga gjykata, edhe kur nuk kërkohet, edhe kur nuk vërtetohet ndonjë nga rrethanat specifike të përcaktuara në nenin 59 të K.Penal (si ato që lidhen me gjendjen shëndetësore, moshën, familjen etj.). Vetëm në këtë mënyrë, dënimi me burgim do të konsiderohet si zgjidhje e fundit dhe për rrjedhim të vendoset në rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat e rëndësishme, rrezikshmërinë e veprës, çdo dënim tjetër është qartësisht i papërshtatshëm.

Praktika gjyqësore ka ecur në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke bërë që dënimet alternative të jenë të aplikueshme edhe për të dënuarit me shtetësi të huaj. Nga ana tjetër, përsa i përket zbatimit në mënyrë të drejtë, nevojitet kujdes në përcaktimin e detyrimeve dhe kushteve, përfshirë dhe përcaktimin e zyrës konkrete të Shërbimit të Provës, që nuk krijon barrë të panevojshme për të dënuarin. Po ashtu, duhet të aplikohet rishikimi i zakonshëm i detyrimeve gjatë zbatimit, duke pasur parasysh ndryshimet e rëndësishme të rrethanave.

ii. Vlerësimi i kushteve për caktimin e dënimit alternativ - Një nga standardet ndërkombëtare është edhe rishikimi i legjislacionit për shqyrtimin e mundësisë së reduktimit të kufizimeve të aplikimit të masave alternative (për kategori veprash penale apo të dënuarve), që pengojnë individualizimin e dënimit. Duke pasur parasysh masën e dënimit të përcaktuar deri në 5 vjet

burgim, dhe rrethanat e tjera, duket në parim se ligji është në përputhje me standardet. Por, në praktikë, në raste të veprave penale të caktuara (si p.sh. neni 283/2, 324/a të K.Penal etj.), për të cilat parashikohet një dënim në minimum shumë i lartë, dhe edhe pse rrezikshmëria e veprës penale nisur nga rrethanat konkrete dhe e të pandehurit rezulton e ulët, bëhet i pamundur aplikimi i dënimit alternativ vetëm për këtë shkak.

Nga studimi i vendimeve vërehet se, rastet e aplikimit të dënimit alternativ kur i pandehuri ka qenë i dënuar më parë, janë shumë të rralla. Edhe pse në caktimin e dënimit merren parasysh dënimet e mëparshme të të pandehurit, përsëri dënimi duhet të caktohet në proporcion me rrezikshmërinë e veprës. Sipas standardeve ndërkombëtare, efekti i të qenit i dënuar më parë duhet të varet nga karakteristikat e rekordeve kriminale. Efekti duhet të reduktohet ose nuk duhet të merret parasysh, në rastet kur ka patur një periudhë domethënëse pa kriminalitet, i pandehuri është i mitur, apo ka qenë i tillë në kohën e kryerjes së veprës, i pandehuri është ende i ri. Përgjithësisht këto elementë nuk analizohen me hollësi, por gjykata mjaftohet në konstatimin e qenies së të pandehurit i dënuar më parë.

Prandaj, praktika gjyqësore duhet të orientohet drejt standardit se, **ç**do pengesë formale, që parandalon aplikimin e dënimit alternativ për të dënuar përsëritës apo me rrezikshmëri, duhet të hiqet për aq sa është e përshtatshme. **Ç**do kufizim i tillë, sikurse mund të jetë aplikimi vetëm për të padënuarit më parë, duhet të rishikohet në mënyrë që dënimet alternative të jenë një mundësi ligjore për t'u konsideruar, në sa më shumë raste të jetë e mundur.

iii. Kohëzgjatja e periudhës së provës - Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin që në çdo rast të përcaktojë në vendimin përfundimtar edhe kohëzgjatjen e dënimit alternativ, të periudhës së provës. Ky qëndrim vjen në përputhje me standardin ndërkombëtar se, si rregull, asnjë dënim apo masë komunitare nuk duhet të jetë me kohëzgjatje të papërcaktuar, dhe se kohëzgjatja duhet të përcaktohet nga autoriteti kompetent për marrjen e vendimit brenda afatit të përcaktuar në ligj. Neni 59 i K.Penal ka parashikuar mënyrën e përcaktimit të kohëzgjatjes së dënimit alternativ, në raport me masën e dënimit të caktuar. Edhe pse, sipas standardit ndërkombëtar, kohëzgjatja duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat personale të të dënuarit, rezulton se përsa masa e dënimit caktohet në raport me këto elementë, për rrjedhim këto elementë ndikojnë edhe në kohëzgjatjen e periudhës së provës. Gjithsesi, përcaktimi

i afatit të periudhës së provës nga ana e gjyqtarit, bazuar në elementët e mësipërm, dhe jo si përllogaritje automatike e dyfishit të masës së dënimit me burgim të caktuar (për masa dënimi më pak se 2 vjet burgim), apo e barabartë me masën e dënimit (për masa dënimi mbi 2 vjet burgim), do të ishte zgjidhja që i përafrohet më shumë standardit ndërkombëtar. Kjo bëhet më evidente, veçanërisht në masat e ulëta të dënimeve me burgim, dhe për rrjedhim përcaktimit të një periudhe prove më të vogël se 2 muaj.

Edhe pse ligji e jep një mundësi të tillë, në praktikë, vetëm në raste shumë të rralla (vetëm në një rast nga vendimet objekt studimi), konstatohet përfundimi i dënimit alternativ përpara periudhës së përcaktuar. Sipas standardit ndërkombëtar, autoriteti vendimmarrës, në përputhje me ligjin, duhet të jetë në gjendje të përfundojë një masë apo dënim alternativ përpara periudhës së përcaktuar, kur vlerësohet se i dyshuari apo i dënuari ka përmbushur kushtet dhe detyrimet dhe nuk është më e nevojshme vazhdimi i tyre për arritjen e qëllimit të masës apo dënimit. Për rrjedhim, një rol më aktiv i Shërbimit të Provës, ndërgjegjësimi i të dënuarve, dhe një qasje ndryshe e praktikës është e nevojshme në këtë drejtim.

Me qëllim shmangien e problematikave në ekzekutimin e dënimit alternativ, në rastet kur i pandehuri ka qenë në paraburgim, është e nevojshme që gjykatat të përcaktojnë periudhën e saktë të provës, apo periudhën e mbetur pa vuajtur nga dënimi me burgim.

iv. Kushtet dhe detyrimet - Nga studimi i vendimeve gjyqësore konstatohet problematikë, përsa i përket përzgjedhjes së detyrimit konkret që duhet të përmbushen gjatë periudhës së provës. Detyrimet, në një numër të konsiderueshëm rastesh, nuk janë të përshtatshme në raport me veprën penale dhe rrezikshmërinë, nuk janë të mundura për t'u zbatuar në praktikë apo sjellin barrë të rëndë e të panevojshme për të dënuarin dhe caktohen formalisht, me qëllimin e vetëm për zbatimin e nenit 60, të K.Penal. Në këtë aspekt, praktika gjyqësore duhet të orientohet drejt zbatimit të standardit ndërkombëtar se, çdo kusht apo detyrim që i vendoset të dyshuarit apo të dënuarit, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh njëkohësisht nevojat individuale që janë të rëndësishme për zbatimin, mundësitë e tij dhe të drejtat, ashtu edhe përgjegjësitë sociale. Gjykata, në raport me veprën penale dhe elementët e mësipërm, duhet të përzgjedhë detyrimin që është i përshtatshëm dhe i shërben qëllimit të dënimit.

Në rast se gjykata vlerëson se, asnjë nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të K.Penal nuk është i tillë, atëherë duhet të kufizohet vetëm në

përcaktimin e kushteve, për të aplikuar njëkohësisht detyrimet, mundësi kjo që është parashikuar në ligj. Në këtë aspekt, është e rëndësishme që gjykatat të përcaktojnë në çdo rast, kushtet që duhet të përmbushen gjatë periudhës së provës, sepse shpesh konstatohet që ato nuk përcaktohen (me përjashtim të mbajtjes së kontakteve me Shërbimin e Provës). Kjo praktikë do të sillte përmirësimin e zbatimit të dënimit alternativ.

Nisur nga problematika e konstatuar në praktikë sa i përket detyrimit të nënshtrimit ndaj një trajtimi apo programi mjekësor apo rehabilitimi, është i nevojshëm bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me institucione apo organizata, me qëllim ofrimin e këtij trajtimi pa pagesë. Sipas Rekomandimit (2017)3, kostot e ardhura drejtpërdrejtë nga zbatimi i dënimit alternativ, nuk duhet normalisht të rëndojnë mbi të dënuarin. Prandaj Shërbimi i Provës, nga njëra anë, duhet të sigurojë përfshirjen e institucioneve apo organizatave për sigurimin e këtij trajtimi, dhe nga ana tjetër, duhet të minimizojë kostot. Paaftësia e të dënuarit për të paguar koston e një trajtimi të tillë, nuk duhet të konsiderohet as si arsye, për të mohuar aplikimin e dënimit alternativ. Në këtë aspekt, pjesëmarrja e organizatave nuk duhet asnjëherë të bëhet për arsye përfitimi, dhe nuk duhet të jetë ky qëllimi i përfshirjes së organizatave në zbatimin e dënimit alternativ.

Praktika duhet të përmirësohet edhe përsa i përket mbikëqyrjes së detyrimeve, si: mosfrekuentimi i vendeve të caktuara, lokaleve që shërbejnë pije alkolike etj.. Është i domosdoshëm bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me Komisariatet e Policisë për realizimin efektiv të mbikëqyrjes, në mënyrë që këto detyrime të mos mbeten thjesht formale.

Detyrimi për riparimin e dëmit civil, duhet të ketë një aplikim më të shpeshtë në praktikën gjyqësore, veçanërisht në vepra penale të caktuara. Në këtë aspekt, gjykatat duhet të tregojnë kujdes në rastet e aplikimit, dhe si dhe në përcaktimin e vlerës së dëmit që duhet të riparohet.

Kujdes duhet të tregohet në aplikimin e shpeshtë të detyrimit për të mos u shoqëruar me persona të dënuar apo bashkëpunëtorë të veprës penale, kur ky detyrim nuk është i nevojshëm dhe i përshtatshëm në raport me veprën penale dhe rekomandohet të aplikohet më shpesh në vepra penale të tilla si ato që kryhen në bashkëpunim.

Pra si përfundim, gjykatat duhet të shqyrtojnë dhe arsyetojnë dhe përshtatshmërinë e detyrimit të caktuar, në raport me rrethanat e veprës penale dhe rrezikshmërinë e të pandehurit, dhe për rrjedhim të caktojnë detyrime që janë kuptimplota.

v. Mospërmbushja dhe revokimi - Nga studimi i praktikës gjyqësore, qëndrimit të mbajtur nga ana e gjykatave, rezulton se është zbatuar standardi ndërkombëtar se mospërmbushja e masës alternative (shkelja e detyrimeve), nuk duhet të sjellë automatikisht vendosjen e masës apo dënimit me burgim. E kundërta ndodh, përsa i përket qëndrimit të mbajtur nga ana e Prokurorisë, duke qenë se në rastet e konstatuara, prokuroria kërkon, si rregull, revokimin e dënimit alternativ dhe vazhdimin e dënimit me burgim. Gjykatat kanë mbajtur qëndrimin, ashtu sikurse standardi ndërkombëtar, se dënimi me burgim duhet të vendoset vetëm në mungesë të një alternative tjetër të përshtatshme dhe kanë shqyrtuar dhe disponuar për aplikimin e mundësive të tjera, si zgjatja e afatit të periudhës së provës etj. Prandaj, është e rëndësishme që edhe praktika e Prokurorisë të ndjekë qëllimin e standardit ndërkombëtar dhe të orientohet drejt vlerësimit të aspekteve pozitive dhe negative të mospërmbushjes në drejtim të aplikimit të një mundësie tjetër, dhe jo të jetë automatikisht për vendosjen e dënimit me burgim. Edhe Shërbimi i Provës, rekomandohet të luajë një rol aktiv në këtë drejtim, duke mos u mjaftuar vetëm me pasqyrimin e fakteve në relacion, por duke rekomanduar njëkohësisht alternativën më të përshtatshme dhe argumentet konkrete në mbështetje të saj.

Në rast mospërmbushje të detyrimeve (pa kryer vepër tjetër penale), në përcaktimin e sanksionit të mos merret parasysh vetëm shkelja e detyrimeve të vendosura, por edhe sjellja e përgjithshme e të dënuarit dhe nevojat e tij për trajtim. Në rast të kryerjes së një tjetër vepre penale gjatë periudhës së provës, duhet të ketë mundësi zgjedhje të vendosjes së një dënimi të pakushtëzuar për të dyja veprat penale, veprën e re dhe atë për të cilën ishte dhënë dënim me kusht; duke ruajtur masën me kusht të vendosur më parë, por mundësisht me ndryshim të detyrimeve dhe vendosjen e një dënimi të pakushtëzuar të dytë në raport me veprën penale të re, dhe duke vendosur një dënim të dytë me kusht, por për të dyja veprat penale. Një qëndrim i tillë është mbajtur me të drejtë në praktikën gjyqësore.

Në shqyrtimin e kërkesës për revokimin e pezullimit për shkak të kryerjes së një vepre tjetër penale gjatë periudhës së provës, gjykatat duhet të tregohen të kujdesshme në formulimet dhe arsyetimin e vendimit, duke respektuar edhe në këtë rast parimin e prezumimit të pafajësisë, nëse i dënuari nuk është deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprën tjetër.

Rekomandohet rritja e rolit të Shërbimit të Provës në fazën e hetimeve paraprake dhe gjykimit, përpara dhënies së vendimit gjyqësor përfundimtar, nëpërmjet paraqitjes së një raporti për vlerësimin e rrethanave shoqërore. Një praktikë e tillë vërehet kryesisht vetëm në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vetëm lidhur me çështjet me të mitur, ose për vepra penale të caktuara si "Dhuna në familje". Prandaj, për të ndihmuar marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake ose në gjykim, është e nevojshme që kjo praktikë të aplikohet në më shumë raste dhe nga të gjitha Prokuroritë.

9. KONKLUZIONE DHE SUGJERIME MBI RREGULLIMIN LIGJOR TË DISPOZITËS

1. Përsa i përket legjislacionit, arrihet në përfundimin se ai është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për arsye se përdorimi, llojet, kohëzgjatja dhe mënyrat e zbatimit të dënimeve alternative, janë të përcaktuara në ligj. Kushtet dhe detyrimet e dënimit alternativ, pezullimit të dënimit me burgim, si dhe pasojat në rast mospërmbushje të tyre, janë të përcaktuara në dispozita të qarta dhe eksplicite. Po ashtu, janë të parashikuara edhe autoritetet përgjegjëse për vendosjen, ndryshimin, revokimin dhe zbatimin e dënimeve alternative, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

2. Rekomandohet ndryshimi i afatit të periudhës së provës në nenin 59/3 të Kodit Penal, që parashikon se: *"3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata."*. Afati i periudhës së provës është fiks, pra është automatikisht sa dyfishi i masës së dënimit. Për masa të ulëta dënimi si p.sh. 10 ditë, 20 ditë burgim etj., ky afat nuk plotëson qëllimin e efektivitetit të dënimit dhe kushtin që të jetë sa më kuptimplot për të dënuarin. Gjykata nuk ka diskrecion për të vendosur një periudhë prove më të gjatë, edhe pse kjo do t'i shërbente më mirë qëllimit të dënimit. Prandaj, formulimi duhet të ndryshojë duke përcaktuar hapësirë vlerësimi, në mënyrë që gjykata të marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat personale të të dënuarit, në përcaktimin e kohëzgjatjes, në përputhje me Rekomandimin nr.(2017)3, të Komitetit të Ministrave, që përcakton se kohëzgjatja e dënimit komunitar duhet të përcaktohet nga

autoriteti kompetent për marrjen e vendimit siç përcaktohet në ligj, dhe lloji dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe dëmin e shkaktuar viktimës, dhe duhet të mbajë parasysh vlerësimin e riskut dhe nevojat e rrethanat personale të të dënuarit.

3. Ligji është në përputhje me standardet edhe përsa i përket shtetasve të huaj, për arsye se nuk mohon aplikimin e dënimeve alternative për shtetasit e huaj.

4. Ekzekutueshmëria e dënimit alternativ - Problematikë në praktikë, ka shkaktuar formulimi i nenit 59 të K.Penal, për fillimin e periudhës së provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit gjyqësor. Ky formulim është interpretuar përgjithësisht nga gjykatat, se i referohet vendimit të gjykatës të shkallës së parë. Kjo, mbështetur edhe në nenin 21 të ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", që parashikojnë se vendimi për pezullimin e dënimit me burgim, është me ekzekutim të menjëhershëm. Për rrjedhim, në praktikë dënimi alternativ fillon të ekzekutohet ndaj të pandehurit, para se të deklarohet fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kjo problematikë sjell pasoja mbi të pandehurin, veçanërisht në rastet e prishjes apo ndryshimit të vendimit gjyqësor nga gjykata më e lartë, duke qenë se i pandehuri vuan një dënim alternativ ndërkohë që deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, apo detyrohet të vuajë një dënim tjetër nga ai i vuajtur, në bazë të vendimit të formës së prerë. Prandaj, duke pasur parasysh pasojat e ardhura, është e nevojshme të shqyrtohet pajtueshmëria e dispozitave të mësipërme ligjore me nenin 6 të KEDNJ, që garanton prezumimin e pafajësisë si element të procesit të rregullt ligjor, si dhe rekomandohet të unifikohet praktika në këtë drejtim.

5. Rishikimi i zakonshëm i zbatimit të dënimit alternativ - Kodi Penal parashikon vetëm që afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet, në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, duke mosparashikuar mundësinë e revokimit të njërit ose disa prej detyrimeve dhe kushteve (për shkaqe që nuk lidhen me shkeljet). Më tej, ligji parashikon që ndryshimi i detyrimit alternativ (kushteve dhe detyrimeve) gjatë ekzekutimit, është i mundur vetëm në raste të caktuara. Në këtë aspekt, rekomandohet ndryshimi i dispozitës në përqasje me standardin ndërkombëtar, sipas të cilit parashikime ligjore duhet të bëhen për rishikimin e zakonshëm të zbatimit të një dënimi apo mase alternative nga një organ i pavarur dhe i ngarkuar nga ligji. Shërbimi i Provës,

gjatë ecurisë së ekzekutimit, duhet të ketë rol më aktiv dhe t'i sugjerojë prokurorit, përvec shkurtimit të afatit të periudhës së provës edhe heqjen e një, apo disa detyrimeve apo kushteve. Kjo praktikë duhet të kryhet zakonisht, dhe te merret në shqyrtim kryesisht nga Shërbimi i Provës, pa patur nevojë për një ngjarje apo rrethanë të caktuar, apo kërkesë nga ana e të dënuarit, dhe jo vetëm në rast mospërmbushjeje. Në këtë mënyrë, në bazë të informacionit të Shërbimit të Provës dhe kërkesës së prokurorit, gjykata do të ketë mundësi të rishikojë dënimin alternativ (masat dhe detyrimet), jo vetëm kur janë shkelur detyrimet, por edhe kur kanë rezultuar rrethana të cilat tregojnë se këto detyrime janë të pamundura, të papërshtatshme apo të panevojshme. Është shumë e rëndësishme, që të sigurohet ndryshimi i detyrimeve të përcaktuara në dënimin me kusht, dhe këto ndryshime të jenë të mundshme në rast të ndryshimit të nevojave apo rrethanave.

6. Nenet 59 dhe 62 të K.Penal, parashikojnë disa mundësi të tjera në rast të shkeljes së detyrimeve, si: *zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës; zëvendësimi i dënimit të parë me një dënim tjetër; ndryshimi i detyrimeve të vendosura; revokimi, tërësisht ose pjesërisht, i vendimit të pezullimit.* Po ashtu, neni 31/9 i ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", parashikon mundësinë e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ, në rast të mospërmbushjes për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit. Në këtë aspekt, këto dispozita janë në përputhje me standardin ndërkombëtar sipas të cilit, në ligj nuk duhet të ketë asnjë parashikim për konvertimin automatik të masës apo dënimit komunitar në burg, në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve. Ligji është në përputhje me standardet ndërkombëtare, edhe përsa i përket ushtrimit të diskrecionit nga ana e autoritetit gjyqësor.

KAPITULLI III

NENI 59/A I KODIT PENAL - *QËNDRIMI NË SHTËPI*

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Qëndrimi në shtëpi, si një tjetër mënyrë alternative e dënimit me burgim, parashikohet në nenin 59/a të Kodit të Penal. Sipas nenit 31/4, të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i ndryshuar, ekzekutimi i vendimit për qëndrimin në shtëpi mbikëqyret nga Shërbimi i Provës, organ i cili duhet të bashkëpunojë me autoritetet vendore, shërbimet sociale, policinë e shtetit dhe çdo ent tjetër, privat apo publik, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me qëllim mbikëqyrjen e të dënuarit përsa i përket respektimit nga ky i fundit të vendimit të gjykatës.

Ky dënim alternativ prezantoi një risi në ligjin penal shqiptar, atë të një vendi alternativ të vuajtjes së dënimit krahas institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (burgjet). Ndryshe nga masat e tjera të dënimeve alternative, qëndrimi në shtëpi është në vetvete një masë për heqjen e lirisë së personit ose e thënë ndryshe një kufizim i lirisë së personit, por vuajtja e dënimit bëhet në një ambient apo mjedis më të lehtë psikologjikisht për të dënuarin, dhe sigurisht që shteti përfiton ekonomikisht nga kjo masë, për arsye se nuk mban barrën ekonomike të mbajtjes dhe kujdesjes së të dënuarit.

2. HISTORIKU I LIGJIT PENAL SHQIPTAR MBI LIRIMIN ME KUSHT

Prej vitit 1965, Këshilli i Evropës ka rekomanduar me forcë vendet anëtare që të aplikojnë vendimin penal me burgim si një masë në kushtet më të rënda, dhe njëkohësisht të favorizojnë masa të tjera si p.sh. mbikëqyrja në shtëpi ose marrja e masës personale të ndalimit për t'u larguar nga një vend, pa lejen e gjykatës (Rezoluta (65)11, e miratuar më 9 Prill 1965 nga Komiteti i Ministrave, Neni 1(b) dhe 1(g)). Në versionin fillestar, Kodi Penal parashikonte vetëm katër lloje alternativash të dënimeve me burgim:

i. copëzimin e dënimit me burgim (neni 58);
ii. pezullimin e dënimit me burgim dhe vënia në provë – i njohur si dënimi me kusht (neni 59);
iii. pezullimin e ekzekutimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (neni 63); dhe
iv. lirimi para kohe me kusht (neni 64).

Mbi bazën e legjislacioneve penale më të mira dhe rekomandimeve të dhëna nga Këshilli i Evropës, me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"", u prezantua një alternativë e re e dënimit me burgim, e quajtur ***"Qëndrimi në shtëpi"*** (neni 59/a). Nga përmbajtja e dispozitës kuptojmë se zbatimi i saj mund të jetë një ndihmë e madhe për personat e familjeve me probleme të rënda sociale. Në mënyrë të veçantë, ligji ka dashur të orientojë organet e drejtësisë, për të përzgjedhur llojin dhe mënyrën e trajtimit të një personi, që është gjetur fajtor për kryerjen e një vepre penale, në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë pasoja të rënda sociale tek fëmijët e tij, apo dhe për shëndetin e vetë personit fajtor.

Alternativë e dënimit me burg, "Qëndrimi në Shtëpi" është prezantuar për herë të parë me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 ""Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"'

Pas nenit 59 të Kodit Penal, u shtua neni 59/a me këtë përmbajtje:

"Neni 59/a.- Qëndrimi në shtëpi

Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi,

gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.

b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.

c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.

ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.

d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord.

Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohet neni 62 i këtij Kodi.".

Vihet re se kjo masë alternative e dënimit me burgim, fillimisht ishte e aplikueshme për të gjitha figurat e veprave penale, përsa kohë plotësoheshin kushtet ligjore të aplikimit të saj. Me ligjin 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal", i ndryshuar", në nenin 59/a të Kodit Penal, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Gjykata, në rrethanat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrim në shtëpi, të dënuarve që kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij."

Me këtë ndryshim, u përjashtuan nga mundësia e aplikimit të kësaj mase alternative të dënimit, të gjitha gratë shtatzëna ose nënat me fëmijë deri në 10 vjeç dhe të gjithë baballarët që kanë përgjegjësi prindërore ekskluzive për fëmijët deri në 10 vjeç, në rastet kur plotësohen kumulativisht dy kushte e mësipërme.

3. STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI APLIKIMIN E MASAVE ALTERNATIVE TË DËNIMIT ME BURGIM, VEÇANËRISHT TË "QËNDRIMIT NË SHTËPI".

3.1 Standardet ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Më 14 Dhjetor 1990, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 45/110, mbi "Standardet Minimale të aplikimit të Masave të Dënimeve Alternative" (Rregullat e Tokjos). Standardet minimale ofrojnë parimet themelore për aplikimin e masave alternative të dënimit me burgim, dhe garancitë minimale për personat që janë subjekt i këtyre masave. Një nga këto rregulla është se, nuk duhet të ketë diskriminim në zbatimin e masave alternative. Në mënyrë që të sigurohet një fleksibilitet më i madh në raport me natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës, me personalitetin e të pandehurit si dhe mbrojtjen e shoqërisë, dhe në mënyrë që të shmanget përdorimi i papërshtatshëm i burgimit, sistemi i drejtësisë penale duhet të ofrojë një sërë masash dhe dënimesh alternative. Pra, theksi vihet te shmangia sa më shumë nga dënimi me burgim në rastet e panevojshme.

Sipas këtyre standardeve, masat alternative të dënimit me burgim duhet të paraqiten në mënyrë të shprehur në ligj. Zgjedhja e masës alternative të dënimit me burgim duhet bërë bazuar në një vlerësim të kritereve të përcaktuara, duke marrë në konsideratë natyrën dhe rëndësinë e veprës penale, personalitetin e subjektit të veprës penale, qëllimin e dënimit, dhe të drejtat e viktimës. Çdo vendim për vendosjen e masave alternative të dënimit me burgim, do t'i nënshtrohen rishikimit nga një autoritet gjyqësor ose një autoriteti tjetër të pavarur kompetent, me kërkesë të shkelësit. Shkelësi ka të drejtë të bëjë një kërkesë ose ankesë, tek një gjykatës ose një autoritet tjetër kompetent dhe i pavarur, për çështje që prekin të drejtat e tij /saj individuale në zbatimin e masave alternative.

Shtetet kombëtare duhet të sigurojnë instrumentet dhe mjetet efektive për të ankimuar vendimin për vendosjen e masave alternative, dhe nëse është e mundur të kompensojnë çdo ankesë të bazuar, në lidhje me mosrespektimin e të drejtave të njeriut. Masat alternative të dënimit me burgim nuk duhet të përfshijnë eksperimente mjekësore ose psikologjike, ose të panevojshme, nga të cilat rrezikohet dëmtimi fizik ose mendor i kundërvajtësit. Dinjiteti i

kundërvajtësit, i cili i nënshtrohet një mase alternative dënimi me burgim, mbrohet në çdo kohë.

Në zbatimin e masave alternative të dënimit me burgim, të drejtat e kundërvajtësit nuk do të kufizohen më tej sesa është vendosur nga autoriteti kompetent që ka dhënë vendimin përkatës. Gjatë zbatimit të masave alternative të dënimit, respektohet e drejta e privatësisë e kundërvajtësit dhe familjes së tij. Regjistrimet personale të kundërvajtësit duhet të mbahen rreptësisht konfidenciale dhe të mbyllura për palët e treta. Qasja në regjistrime të tilla do të kufizohet tek personat që merren direkt me disponimin me çështjen e kundërvajtësit.

Gjatë procedurave të gjykimit, Rregullat e Tokjos parashikojnë se nëse ekziston mundësia e raporteve të hetimit social, autoriteti gjyqësor mund të përdorë një raport të përgatitur nga një zyrtar ose agjenci kompetente e autorizuar. Raporti duhet të përmbajë informacione sociale për kundërvajtësin e veprës penale, gjithashtu duhet të përmbajë informacione dhe rekomandime që janë të rëndësishme për dhënien e dënimit. Raporti duhet të jetë i bazuar në fakte, objektiv dhe i paanshëm, me mendim të shprehur qartë.

Për dhënien e masës së dënimit alternativ më të përshtatshëm, autoriteti gjyqësor, duke pasur në dispozicion një varg masash alternative, duhet të marrë parasysh nevojat rehabilituese të kundërvajtësit, mbrojtjen e shoqërisë dhe interesat e viktimës, të cilët duhet të konsultohen kur të jetë e përshtatshme.

Për sa i përket rregullave të mbikëqyrjes, Rregullat e Tokjos përcaktojnë se qëllimi i mbikëqyrjes është të ndihmojë integrimin e kundërvajtësit në shoqëri, në një mënyrë që minimizon mundësinë e kthimit në krim. Nëse një dënim alternativ kërkon mbikëqyrje, kjo e fundit kryhet nga një autoritet kompetent, nën kushtet specifike të përcaktuara me ligj. Lloji më i përshtatshëm i mbikëqyrjes dhe trajtimi, duhet të përcaktohet për secilin rast individualisht dhe synon të ndihmojë kundërvajtësin për t'u ndërgjegjësuar për veprimet e tij. Mbikëqyrja duhet të rishikohet dhe të përshtatet periodikisht, si të jetë e nevojshme. Kur është e nevojshme, kundërvajtësve duhet t'u sigurohet ndihmë psikologjike, sociale dhe materiale dhe me mundësi për të forcuar lidhjet me komunitetin dhe për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Kohëzgjatja e një mase alternative të dënimit me burgim, nuk duhet të kalojë periudhën e përcaktuar nga autoriteti kompetent në përputhje me

ligjin. Por, shtetet kombëtare mund të parashikojnë rastet për ndërprerjen e parakohshme të masës alternative të dënimit me burgim, nëse kundërvajtësi është dakord me këtë.

Së fundi, në rast se kundërvajtësi shkel kushtet e vendimit të autoritetit kompetent që vendosi masën e dënimit alternativ, mund të rezultojë në një modifikim ose revokimin të masës alternative të dënimit. Modifikimi ose revokimi i masës alternative të dënimit me burgim, bëhet nga autoriteti kompetent dhe vetëm pas një ekzaminimi të kujdesshëm të fakteve të paraqitura nga oficeri mbikëqyrës dhe kundërvajtësi. Dështimi i arritjes së qëllimit nga një masë alternative e dënimit me burgim, nuk duhet të çojë domosdoshmërisht në vendosjen e dënimit me burgim. Në rast të një modifikimi ose revokimi të masës alternative të dënimit, autoriteti kompetent do të përpiqet të krijojë një masë të përshtatshme alternative të dënimit me burgim. Një vendim dënimi me burgim, duhet të merret vetëm në mungesë të alternativave të tjera të përshtatshme. Ligji duhet të parashikojë kushtet dhe kriteret për të arrestuar dhe ndaluar kundërvajtësin nën mbikëqyrje, në rastet kur ka shkelje të tij. Pas modifikimit ose revokimit të masës alternative të dënimit, kryesi i veprës penale duhet të ketë të drejtë të apelojë vendimin tek një gjykatë ose një autoritet tjetër i pavarur kompetent.

3.2 Standardet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës

Në kuadër të Këshillit të Evropës, janë miratuar një sërë instrumentash për përcaktimin e standardeve mbi dënimet alternative, si:

Rekomandimi nr.(92)16, i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat evropiane të dënimeve dhe masave komunitare, përcakton ndër të tjera se kriteret e aplikimit të dënimeve alternative, ashtu si edhe pasojat në rast mospërmbushje të tyre, duhet të përcaktohen në dispozita ligjore të sakta dhe të qarta. Në ligj nuk duhet të ketë asnjë parashikim për konvertimin automatik të masës apo dënimit komunitar në burg, në rast të mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve. Asnjë masë apo dënim komunitar, nuk duhet të ketë kohëzgjatje të pacaktuar. Lloji dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit komunitar, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat personale të të dënuarit. Vendimi për të caktuar dhe revokuar një masë a dënim alternativ, duhet të merret

nga një autoritet gjyqësor. I pandehuri duhet të ketë të drejtën e ankimit ndaj një vendimi të tillë.

Rekomandimi nr.(92)17, i Komitetit të Ministrave, lidhur me njëtrajtshmërinë në dënime, sugjeron që të shmanget ashpërisa e panevojshme. Dënimi me burgim duhet të konsiderohet si zgjidhje e fundit dhe për rrjedhim duhet të vendoset vetëm në rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat e rëndësishme, rrezikshmërinë e veprës, çdo dënim tjetër është qartësisht i papërshtatshëm. Edhe pse në caktimin e dënimit merren parasysh dënimet e mëparshme të të pandehurit, përsëri dënimi duhet të caktohet në proporcion me rrezikshmërinë e veprës. Efekti i të qenit i dënuar më parë, duhet të varet nga karakteristikat e rekordeve kriminale. Efekti duhet të reduktohet, ose nuk duhet të merret parasysh, në rastet kur ka patur një periudhë domethënëse pa kriminalitet, i pandehuri është i mitur apo ka qënë i tillë në kohën e kryerjes së veprës, i pandehuri është ende i ri. Në caktimin e dënimit, në parim, koha e paraburgimit duhet të merret parasysh.

Rekomandimi nr.(97)12, i Komitetit të Ministrave, për stafin që merret me zbatimin e dënimeve dhe masave, përcakton domosdoshmërinë e vendosjes së një politike të qartë për stafin përgjegjës për zbatimin e masave dhe dënimeve në një dokument formal, që mbulon të gjitha aspektet e rekrutimit dhe përzgjedhjes, trajnimit, statusit, menaxhimit të përgjegjësive, kushteve të punës dhe lëvizshmërisë. Stafi duhet të ketë mjaftueshëm burime, për të kryer me efektivitet detyrat e ndryshme. Në këtë akt përcaktohen rekomandime lidhur me rekrutimin dhe përzgjedhjen, trajnimin, kushtet e punës dhe menaxhimin e përgjegjësive, lëvizshmërinë dhe kërkesat etike, në përgjithësi, dhe në raport me të dyshuarit dhe të dënuarit.

Rekomandimi nr.(99)22, i Komitetit të Ministrave, lidhur me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë në burgje, rithekson si parim themelor se dënimi me burgim duhet të konsiderohet si zgjidhje e fundit dhe për rrjedhim duhet të vendoset vetëm në rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat e rëndësishme, rrezikshmërinë e veprës, çdo dënim tjetër është qartësisht i papërshtatshëm. Prokurorët dhe gjyqtarët duhet të nxiten t'i përdorin dënimet alternative sa më shumë të jetë e mundur.

Rekomandimi (2010)1, i Komitetit të Ministrave, mbi Rregullat e vënies në provë të Këshillit Evropian, përcakton udhëzime për vendosjen dhe mirëfunksionimin e Shërbimit të Provës. - Shërbimi i Provës duhet

të ketë qëllim reduktimin e rikryerjes së veprave penale, duke ndërtuar marrëdhënie me të dënuarit, duke i mbikëqyrur (përfshirë kontrollin, kur është e nevojshme), udhëhequr dhe asistuar ata, dhe duke nxitur riintegrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri.

Në rastet e lidhura me viktimat e veprës penale, Shërbimi i Provës duhet të respektojë të drejtat dhe nevojat e tyre. Shërbimi i Pprovës duhet të marrë parasysh karakteristikat individuale, rrethanat dhe nevojat e të dënuarit, në mënyrë që çdo rast të trajtohet në mënyrën e duhur dhe me drejtësi. Për aq sa është e mundur, Shërbimi i Provës duhet të ketë pëlqimin e informuar dhe bashkëpunimin e të dënuarit në lidhje me ndërhyrjet që i prekin ata. Çdo ndërhyrje, përpara se i pandehuri të dënohet me vendim të formës së prerë, duhet të ketë pëlqimin e informuar dhe nuk duhet të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë. Shërbimi i Provës duhet të jetë objekt i kontrollit të rregullt dhe/ose monitorimit të pavarur. Shërbimi i Provës duhet të bashkëpunojë me autoritetet publike, organizatat dhe komunitetin lokal, për të nxitur riintegrimin e të dënuarve në shoqëri.

Në pjesën e dytë, përcaktohen rregulla dhe standarde për organizimin dhe stafin e Shërbimit të Provës. Në pjesën e tretë, përcaktohen rregullat për llogaridhënien dhe marrëdhëniet me agjencitë e tjera. Në pjesën e katërt, përcaktohen standarde për punën, detyrat e Shërbimit të Provës. Raporti i Shërbimit të Provës para dhënies së vendimit gjyqësor, përgatitet për të ndihmuar, aty ku është e aplikueshme, autoritetin gjyqësor në vendimarrjen për përzgjedhjen e masës apo dënimit më të përshtatshëm. Ky raport duhet të mbështetet në një informacion të përcaktuar qartë dhe, për aq sa është e mundur, të verifikohet dhe përditësohet gjatë ecurisë së procesit. Të pandehurit duhet t'i jepet mundësia e përfshirjes në përgatitjen e raportit, dhe mendimi i tyre duhet të pasqyrohet në raport, si dhe përmbajtja t'u komunikohet atyre ose përfaqësuesve ligjorë.

Në pjesën e pestë, përcaktohen rregullat e procesit të mbikëqyrjes, lidhur me vlerësimin, planifikimin, ndëhyrjet, ekzekutimin dhe përmbushjen e detyrimeve, regjistrimin, informimin dhe konfidencialitetin. Në pjesë e gjashtë, përcaktohen detyra të tjera të Shërbimit të Provës, si: puna me viktimat, drejtësia restauruese, parandalimi i krimit. Në pjesën e shtatë, përcaktohen rregullat për procedurën e ankimit dhe monitorimin e Shërbimit të Pprovës, ndërsa në pjesën e tetë, përcaktohen rregullat për kërkimin dhe vlerësimin, marrëdhëniet me median dhe publikun.

3.3 Standardet ndërkombëtare të Bashkimit Evropian

Rekomandimi (2017)3, "Mbi Rregullat evropiane për dënimet dhe masat komunitare", i miratuar nga Komiteti i Ministrave në datë 22.03.2017, është një nga aktet më të rëndësishme që përcakton në mënyrë të plotë standardet për masat dhe dënimet komunitare Në këtë Rekomandim përcaktohen rregulla lidhur me:

I. Dënimet alternative mund të ofrojnë mbikëqyrje, udhëheqje dhe asistim të drejtë dhe efektiv të të dyshuarit apo dënuarit, pa privimin nga liria, duke forcuar prespektivën e përfshirjes në shoqëri. Natyra dhe kohëzgjatja e masës apo dënimit alternativ, duhet të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e veprës dhe rrethanat individuale. Nuk duhet të këtë parashikim në ligj për konvertimin automatik të dënimit alternativ komunitar, në atë me burgim në rastin e mospërmbushjes dhe shkeljes të detyrimeve apo kushteve të përcaktuara, me përjashtim të lirimit me kusht.

II. Përdorimi, llojet, kohëzgjatja dhe mënyrat e zbatimit të masave apo dënimeve komunitare, duhet të përcaktohen në ligj. Kushtet dhe detyrimet e masës apo dënimit alternativ, si dhe pasojat në rast mospërmbushje të tyre, duhet të përcaktohen në dispozita të qarta dhe eksplicite. Në ligj, duhet të parashikohen edhe autoritetet përgjegjëse për vendosjen, ndryshimin, revokimin dhe zbatimin e masave dhe dënimeve komunitare, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Çdo pengesë formale, përfshirë pengesë ligjore, që parandalon aplikimin e masave apo dënimeve komunitare për të dënuar përsëritës apo me rrezikshmëri, për kategori të caktuar veprash apo çdo kufizim tjetër ligjor, duhet të rishikohet dhe të hiqet për aq sa është e përshtatshme. Çdo kufizim i tillë ligjor (sikurse mund të jetë aplikimi vetëm për të miturit, të padënuarit me parë, apo të rinjtë), duhet të rishikohet në mënyrë që, masat apo dënimet komunitare të jenë një mundësi ligjore për t'u konsideruar në sa më shumë raste të jetë e mundur.

Si rregull, masa apo dënimi komunitar duhet të përcaktohet me kohëzgjatje fikse. Si përjashtim, kur ligji parashikon se kohëzgjatja mund të zgjatet, duhet të bëhet shqyrtimi nga autoriteti vendimmarrës, për të vendosur nëse ky përjashtim duhet të aplikohet apo nëse jo, të përfundohet masa apo dënimi komunitar.

III. Pëlqimi, bashkëpunimi dhe zbatimi; Po ashtu janë përcaktuar rregulla minimale edhe për pjesëmarrjen e komunitetit, pëlqimin e të dyshuarit apo

të dënuarit, bashkëpunimin dhe zbatimin. Masa apo dënimi komunitar duhet të vendoset vetëm kur, kushtet dhe detyrimet e përshtatshme janë vendosur dhe dihet se i dyshuari apo i dënuari do të bashkëpunojë dhe do t'i përmbushë ato. Jo të gjitha shtetet kanë të përcaktuar si rregull, dhënien e pëlqimit nga ana e të pandehurit për të aplikuar masat apo dënimet alternative, por kur ky është përcaktuar si parakusht ligjor, personi duhet ta japë pëlqimin duke patur informacionin e plotë për atë që po jep pëlqimin.

IV. Me fillimin e zbatimit të masës apo dënimit komunitar, i dyshuari apo i dënuari duhet të informohet për përmbajtjen e masës apo dënimit dhe se çfarë pritet prej tij, për pasojat në rast mospërmbushje të detyrimeve dhe kushteve të vendosura, si dhe për rrethanat të cilat i parashtrohen autoritetit vendimmarrës në kuadër të mospërmbushjes. Vendimi për të revokuar një masë apo dënim komunitar, nuk duhet domosdoshmërisht të çojë në një vendim mase apo dënimi me burgim. Një rast i tillë mund të jetë kur, mospërmbushja ndodh në fund të periudhës së provës dhe sjellja gjatë periudhës së provës, deri në këtë moment, ka qenë e kënaqshme. Kur vendos për ndryshimin apo revokimin e pjesshëm apo të plotë të masës apo dënimit komunitar, autoriteti vendimmarrës duhet të sigurojë që i dyshuari apo i dënuari, të ketë mundësinë e shqyrtimit të dokumentacionit dhe të parashtrojë mbrojtjen, duke gëzuar edhe të drejtën për ndihmë juridike.

V. Struktura, statusi dhe burimet e agjencive zbatuese, duhet t'i përgjigjen volumit dhe kompleksitetit të detyrave dhe përgjegjësive, dhe duhet të reflektojnë rëndësinë e shërbimit që ofrohet.

VI. Inspektimi, monitorimi dhe procedurat ankimuese; Autoritetet zbatuese duhet të jenë subjekt inspektimi dhe monitorimi. Një procedurë ankimuese e drejtë, e thjeshtë dhe e paanshme, duhet të garantohet përsa i përket vendimeve të autoritetit zbatues, apo mosmarrjes së vendimit, apo në përgjithësi, për efektet e masës apo dënimit.

4. REGJIMI JURIDIK I "QËNDRIMIT NË SHTËPI" SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

Neni 59/a i Kodit Penal

(Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008; shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

"Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e

mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.

b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.

c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.

ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.

d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Gjykata, në rrethanat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrim në shtëpi, të dënuarve që kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord.

Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohet neni 62 i këtij Kodi."

4.1 Regjimi juridik material i "qëndrimit në shtëpi"

4.1.1 Kushtet ndaluese

Me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar", është shtuar një kusht ndalues absolut, për zbatimin e këtij dënimi alternativ. Kushti ndalues absolut është ndalimi i dhënies së këtij dënimi alternativ për gratë shtatzëna ose me fëmijë nën 10 vjeç, dhe për baballarët që kanë

përgjegjësinë prindërore për fëmijët nën 10 vjeç kur nëna e tij ka vdekur ose është e pazonja të kujdeset për të, kur këta persona janë shpallur fajtorë për krime ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij.

Për sa i përket kushtit ndalues të mësipërm, legjislatori ka vlerësuar apriori se për këtë kategori të të dënuarve, të cilët kanë kryer krime dhe viktimë e tyre ka qenë një pjesëtar i familjes së tyre, zbatimi i këtij dënimi alternativ do të ishte shumë i dëmshëm për viktimën e veprës penale, pasi autori do të bashkëjetonte në të njëjtë shtëpi me viktimën, fakt i cili do të rriste mundësinë e përsëritjes së veprës penale, si dhe nga ana tjetër do të shkelte të drejtën e viktimës për qetësi dhe siguri pas vuajtjeve së pasojës të një krimi. Këto kushte janë të një natyre objektive, pra të verifikueshme mbi bazën e të dhënave dokumentare, dhe nuk lidhen me qëndrime subjektive apo sjellje të të dënuarit. Kushti ndalues kërkon ekzistencën e dy rrethanave kumulative.

Së pari, subjekti të jetë i dënuar për një vepër penale, e cila sipas dispozitave të posaçme penale, të përbëjë një krim. Për të kuptuar se çfarë përfshihet në termin "krim", neni 1 i Kodit Penal parashikon se veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi. Pra, dispozitat përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, përcaktojnë nëse një vepër penale përbën krim apo kundërvajtje penale. Për sa i intereson kësaj teme, subjektet e përcaktuara më sipër përjashtohen nga mundësia për të përfituar nga kjo masë alternative e dënimit me burgim, nëse kryejnë një vepër penale të konsideruar si krim.

Së dyti, subjekti pasiv i krimit duhet të jetë bashkëshorti, bashkëjetuesi ose fëmija e të dënuarit. Pra, kuptohet se legjislatori kërkon të shmangë mundësinë që shkelësi penal dhe viktima e tij, të qëndrojnë në të njëjtën ambient për arsye të mbrojtjes së viktimës të veprës penale.

4.1.2 Kriteret Ligjore

Nisur nga interpretimi i kësaj dispozite arrijmë në përfundimin se, kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata, kur plotësohen dy kushte:

Së pari, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se dy vjet burgim, pavarësisht nëse i dënuari është ose jo, nën një masë sigurimi arresti, kur të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur jo më shumë se dy vjet burgim, sipas një vendimi të dhënë më parë, për një periudhë më të gjatë se dy vjet burgimi.

Së dyti, gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim; e pandehura/ e dënuara të jetë shtatzënë ose nënë me fëmijë nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të; i pandehuri/ i dënuari të jetë baba, të ketë përgjegjësi prindërore për fëmijën që jeton me të nën moshën 10 vjeç, kur nëna e fëmijës ka vdekur apo është e pazonja të kujdeset për të; i pandehuri/ i dënuari është në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut; i pandehuri/ i dënuari të jetë mbi 60 vjeç dhe të jetë i paaftë nga ana shëndetësore; i pandehuri/ i dënuari të jetë nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, profesionale apo përgjegjësi familjare.

Këto dy kushte duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë pra, janë kumulative, përndryshe gjykata nuk mund të aplikojë nenin 59/a të Kodit Penal. Është për t'u theksuar fakti se, në dënimin alternativ të qëndrimit në shtëpi, qenia e të dënuarit si përsëritës (recidivist), nuk përbën ndalesë për aplikimin e "qëndrimit në shtëpi". Në rastin e "qëndrimit në shtëpi", personi i dënuar duhet të mos largohet prej saj, me përjashtim të rasteve kur gjykata e autorizon të largohet, për aq kohë sa i duhet për të plotësuar nevojat e tyre themelore të jetesës apo për t'u angazhuar në aktivitete pune. Në këtë rast, gjykata përcakton masat që duhet të kryejë Shërbimi i Provës.

Kur nuk ekzistojnë më kushtet për të cilat është dhënë kjo alternativë ose nëse personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendi i banimit, apo shkel detyrimet e caktuara në vendim, atëherë gjykata revokon "qëndrimin në shtëpi" dhe personi duhet të vuajë pjesën tjetër të dënimit në burg. Më konkretisht, dënimi i dhënë sipas nenit 59/a, do të revokohet, tërësisht apo pjesërisht, ose do të zëvendësohet me një dënim tjetër, nëse:

- kalon gjendja e shtatzënisë së të dënuarës;
- fëmija e të dënuarës mbush moshën 10 vjeç;
- fëmija e të dënuarit, të cilit i ka vdekur bashkëshortja apo i është bërë e pazonja, mbush moshën 10 vjeç;
- gjendja shëndetësore e të dënuarit është përmirësuar, nuk është më e rëndë dhe nuk ka rrezik të përsëritet më;
- mundësohet kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm brenda burgut;
- i dënuari mbush moshën 21 vjeç pavarësisht se ekzistojnë ende nevojat e dokumentuara shëndetësore, studimore apo përgjegjësitë familjare;
- i dënuari nën 21 vjeç nuk ka më nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore apo përgjegjësi familjare.

Për të aplikuar ne mënyre sa më të drejtë nenin 59/a të Kodit Penal, gjykata ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në jetën e përditshme të të pandehurit apo të dëmtuarit. Gjykata e ka të domosdoshëm mendimin e specializuar të Shërbimit të Provës. Për rrjedhojë, nëse i pandehuri/ i dënuari apo prokurori, paraqet një kërkesë për aplikimin e nenit 59/a, gjykata është e detyruar që të thërrasë në gjykim një përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe t'i caktojë si detyrë kryerjen e raportit përkatës, i cili do të identifikojë në mënyrë të specializuar rrethanën e posaçme të pretenduar nga palët.

Në rastet kur gjykata pranon kërkesën për aplikimin e nenit 59/a, atëherë gjykata lejon që dënimi me burgim të ekzekutohet jo në një I.E.V.P., por:

- *në shtëpinë e të pandehurit/dënuarit;*
- *në një banesë tjetër;*
- *në një qendër të kujdesit dhe shëndetit publik.*

Referimi në një qendër të kujdesit dhe shëndetit publik, është një strukturë ku i pandehuri ose i dënuari qëndron gjatë gjithë periudhës së mbetur të dënimit, ose mund të alternohet duke kaluar ditën ne Qendër dhe duke u kthyer në shtëpi mbrëmjeve. Qendrat e kujdesit dhe shëndetit publik mund të sigurojnë një vend për një mori ndërhyrjesh terapeutike. Shumë të pandehur ose të dënuar kanë nevojë të konsiderueshme për terapi ose trajtim, me varësinë nga droga ose nevoja të tjera. Gjithashtu, qendra të tilla mund të ofrojnë një sërë shërbimesh, si ato të menaxhimit të zemërimit dhe deri te trajnimi i aftësive. Të pandehurit dhe të dënuarit kanë më shumë të ngjarë të reagojnë pozitivisht në programe të tilla, kur ato zhvillohen nën lirinë relative të qendrave të kujdesit dhe shëndetit publik, në krahasim me të njëjtin shërbim të ofruar në një burg. Përdorimi i qendrave të kujdesit dhe shëndetit publik nga gjykatat, supozon se shteti ka investuar në infrastrukturë duke siguruar ekzistencën e qendrave që ofrojnë gamën e programeve të nevojshme.

Për këtë qëllim, gjykatësit duhet të informohen rregullisht dhe azhurnohen sa i përket asaj që ofrojnë qendra të tilla, nëse programet kanë vende të lira të punës, kanë kapacitete, ose kanë lista të pritjes, si dhe çfarë mund të jetë e disponueshme në një komunitet të caktuar. Në fund, për të vendosur që një i pandehur ose i dënuar të marrë pjesë në një qendër të tillë, gjyqtarët kanë nevojë për informacion të veçantë për shkelësin dhe nevojat

e tij / saj, i cili mund të kërkojë një vlerësim mjekësor dhe / ose psikologjik, përveç një hetimi të historisë sociale të të pandehurit ose të dënuarit.[75]

Masa e qëndrimit në një shtëpi është një masë e ashpër, por është më pak sesa dënimi me burgim. Këtu duhet të merret në konsideratë fakti që shtëpitë e shkelësve ndryshojnë jashtëzakonisht shumë. Në disa raste, shumë jetojnë në rrugë, të tjerët në shtëpi tepër të mbipopulluara. Nëse gjykata do të vendoste masën e arrestit në shtëpi për 24 orët e plota të ditës, kjo të vendoste një barrë shumë të rëndë për bashkëjetuesit e tjerë të shtëpisë. Kjo do të thoshte gjithashtu se shtëpia e të pandehurit ose të dënuarit do të bëhej burgu i tij, përveç se, ndryshe nga burgu, ai do të ishte vetë përgjegjës për sigurimin e nevojave të tij jetësore. Mjete të ndryshme të monitorimit elektronik, mund të rrisin më tej shtypjen e të pandehurit gjatë dënimit me masën alternative të "qëndrimit në shtëpi".

Për të shmangur këto teprica, gjykata mund të kufizojë orët e të pandehurit ose të dënuarit, që duhet t'i kalojë në shtëpi. Për shembull, gjykata mund të lejojë që i pandehuri ose i dënuari të jetë i punësuar gjatë ditës, dhe të rrijë në shtëpi pas orarit të punës. Me sigurimin e një informacioni të mirë, gjykata duhet të jetë në gjendje të bëjë dallimin midis rasteve, kur qëndrimi në shtëpi nuk do të vendoste barrë shumë të rëndë në jetën e banorëve të tjerë të së njëjtës shtëpi. Masa e zbatimit duhet të përshtatet në përputhje me rrethanat.

Sipas formulimit të nenit 59/a të Kodit Penal dhe dispozitave të posaçme të ligjit "Për ekzekutimin e dënimeve penale", nr.10024, datë 27.11.2008, rezulton se në të tria këto vende të vuajtjes së dënimit, i dënuari është nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës, i cili i paraqet gjykatës raporte të detajuara për nevojat e ndryshme me karakter shëndetësor, profesional, familjar, arsimor, etj. që ka i dënuari, përmbushja e të cilave (nevojave) mund të kërkojnë largimin e tij nga vendbanimi. Në këto raste, pas referimit të fakteve nga i dënuari dhe pas marrjes së pëlqimit nga Shërbimi i Provës, gjykata mund të lejojë të dënuarin të largohet nga vendbanimi:

- për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare (përmbushja e detyrimeve familjare që lidhen me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, kujdesin ndaj prindërve, kujdesin ndaj personave në ngarkim, etj.);
- për t'u angazhuar në një veprimtari pune;

[75] *"Handbook of basic principles and promising practices on Alternatives to Imprisonment"* – United Nations Office on Drugs and Crime, faqe 38.

- për të marrë pjesë në një veprimtari edukuese ose për t'u arsimuar, veçanërisht në rastin e të dënuarve të mitur, ose të atyre nën 21 vjeç (ndjekja e shkollës apo kurseve të tjera profesionale dhe trajnuese);
- për të ndjekur një veprimtari rehabilituese, veçanërisht në rastet e të dënuarve që janë përdorues të lëndëve narkotike.

Pasi merr një nga vendimet e mësipërme, gjykata përcakton edhe masat që duhen marrë nga Shërbimi i Provës. Këto masa kanë të bëjnë me mënyrën e mbikëqyrjes së vendimit të gjykatës nga ana e Shërbimit të Provës. Nocioni "masë" i parashikuar në këtë dispozitë, nuk gjen ndonjë parashikim të veçantë në dispozitat e kreut të "Alternativave të dënimit me burgim". Megjithatë, këto masa mund të konsistojnë kryesisht në veprimet konkrete që duhet të kryejë Shërbimi i Provës, me qëllim monitorimin apo mbikëqyrjen e kësaj vendimmarrjeje të gjykatës. Kjo,që largimi i personit të dënuar nga vendbanimi, të jetë vetëm për plotësimin e atyre nevojave që gjykata ka përcaktuar në vendimin e saj.

Nga formulimi gramatikor i nenit 59/a të Kodit Penal, është e diskutueshme nëse gjykata në rastet kur vendos aplikimin e dënimit alternativ "qëndrim në shtëpi", është e detyruar ose jo që të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, apo gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Në praktikë hasen tre qëndrime lidhur me këtë çështje[76]:

- Gjykata nuk është e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe as të përmbushë një ndër detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal;
- Gjykata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal, por nuk mund të urdhërojë të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës;
- Gjykata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal, si dhe urdhëron të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës.

[76] *Alternativat e dënimit në Shqipëri. Vështrim krahasues me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës.*" Adrian Leka, fq 80.

Për të dhënë një mendim të saktë për çështjet e shtruara më sipër, duhet të shohim se çfarë parashikojnë konkretisht dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Sipas nenit 60 të Kodit Penal, parashikohet se:

"I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.
3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.
4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.
5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.
6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.
8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.
9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.
11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.
12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre."

Ndërsa ne nenin 61 të Kodit Penal parashikohet se:

"Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar:

a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit."

Nëse i referohemi legjislacionit penal në lidhje me dënimet alternative ndaj vendimit me burgim (Kodi Penal dhe Ligji nr.10024, datë 27.11.2008 "Për ekzekutimin e vendimeve penale"), shihet se sistemi ynë i dënimeve alternative me burgim është një përzierje e dy sistemeve botërore të këtyre dënimeve: a)sistemit kontinental, i cili vepron me pezullimin e dënimit me burgim duke i vënë si kusht të vetëm të dënuarit, moskryerjen e veprave të tjera penale dhe b) sistemit të mbikëqyrjes, ose i quajtur ndryshe "Probacioni". Ky sistem ka në thelb të tij nevojën për t'i vendosur të dënuarit një detyrim, i cili do të mbikëqyret edhe nga një person i specializuar, që sipas ligjit penal shqiptar është Shërbimi i Provës.

Sistemi shqiptar i dënimeve alternative është më i prirur drejt sistemit të mbikëqyrjes (Probacionit), duke iu larguar sistemit kontinental, por jo të shkëputet tërësisht prej tij.[77]

Pra, gjykata në vendimin e saj të dënimit me burgim, sipas neneve 59 dhe 59/a të Kodit Penal, mund të japë një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal në varësi të rrethanave të cilat vërtetohen gjatë gjykimit.

Me anë të ligjit nr.80/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" të ndryshuar, u parashikua procedura ligjore për ndryshimin e vendbanimit të personit të dënuar me vendim me "qëndrim në shtëpi". Sipas këtyre ndryshimeve, vetë personi i dënuar i drejtohet me kërkesë Gjykatës. Në këtë procedurë ligjore, spikat roli i qenësishëm i Shërbimit të Provës, i cili përveç se paraqet mendimin e tij për këtë kërkesë, është institucioni zbatues i vendimit të gjykatës që miraton kërkesën e të dënuarit. Ligji e ngarkon Shërbimin e Provës për të zbatuar të gjitha masat e përcaktuara nga gjykata, si dhe ka për detyrë që të njoftojë për ndryshimin e vendbanimit të të dënuarit, si organet vendore të Policisë së Shtetit, ashtu edhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

Një çështje e diskutueshme, është ngjashmëria e "qëndrimit në shtëpi" me "lirimin me kusht", e parashikuar nga neni 64 i këtij Kodi. Nisur nga përmbajtja e këtyre dispozitave, na rezulton se ka ndryshime të mëdha, të cilat konsistojnë në:

- Mospërputhjen e masës së dënimit të vuajtur nga përfituesit e "qëndrimit në shtëpi", dhe nga përfituesit e "lirimit me kusht";

[77] *Alternativat e dënimit në Shqipëri. Vështrim krahasues me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës."* Adrian Leka, fq 81.

- Kriteret ligjore të cilat duhet të plotësohen nga përfituesi i dënimit alternativ të "qëndrimit në shtëpi";
- Faktin e të qenit përsëritës ose jo i një krimi (recidivizmi).

Nisur nga këto ndryshime thelbësore, përforcohet mendimi se masa alternative e dënimit e "qëndrimit në shtëpi" përfitohet si nga i pandehuri, ashtu edhe nga të dënuarit, ndërkohë që "lirimi me kusht" përfitohet vetëm nga të dënuarit.[78]

Për situatat e parashikuara nga germat a) dhe b), të nenit 59/a të Kodit Penal, në bazë të të cilave masa alternative e dënimit me burgim, ajo e qëndrimit në shtëpi mund të jepet: a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të dhe b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të. Nuk është e kuptueshme pse legjislatori ka përcaktuar moshën 10 vjeçare për fëmijët të cilët kanë nevojën e prindit të tyre. Pra, nuk është e qartë përse fëmija mbi moshën 10 vjeç nuk ka të njëjtën nevojë për praninë e prindit të tij, si fëmija nën 10 vjeç.

Vlerësojmë se, nisur edhe nga mosha e lejuar nga Kodi i Punës[79], mosha e fëmijëve, parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, duhet të ishte 16 vjeç.

4.2 Regjimi juridik procedural

4.2.1 Legjitimiteti i kërkuesit

"Qëndrimi në shtëpi", mund të vendoset krahas caktimit të dënimit kryesor apo në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar të dënimit të gjykatës, ashtu edhe mund të vendoset gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit me burgim. Kjo rezulton nga formulimi i paragrafit të parë të nenit 59/a, i cili parashikon se gjykata mund të vendosë këtë dënim alternativ: *"Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi..."*. Kjo rezulton edhe nga përmbajtja e paragrafit të parë të nenit 31/4, të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar,

[78] *"Alternativat e dënimit në Shqipëri. Vështrim krahasues me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës."* Adrian Leka, fq 79.

[79] *Shih nenin 98 të Kodit të Punës, i cili parashikon se: "Ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet kur fëmijët nga mosha 15 vjeç deri në moshën 16 vjeç mund të punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta".*

ku parashikohet se gjykata i njofton vendimin e saj drejtorisë së Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, në rast se ai mbahet në një institucion të tillë.

"Qëndrimi në shtëpi" është një e drejtë e të dënuarit me burgim, por as rregullimi ligjor material i Kodit Penal, as rregullimi ligjor procedural i ligjit 8331/1998, nuk parashikojnë se iniciativa për ushtrimin e një kërkese të tillë t'i përkasë ekskluzivisht vetë të dënuarit me burgim. Kjo do të thotë se, kuadri ligjor shqiptar nuk ndalon që vetë Prokurori të bëjë një kërkesë të tillë për të dënuarin, kur vlerëson se janë kushtet e aplikimit të kësaj mase të dënimit alternativ, pasi kjo është edhe çështje e interesit publik për miradministrimin e drejtësisë penale dhe sistemit penitenciar dhe risocializimin e të dënuarve me burgim, për kthimin e tyre si anëtarë të shoqërisë.

Ndryshon legjitimiteti i kërkuesit, për ndryshimin apo revokimin e vendimit. Neni 31/4, i ligjit 8331/2018, parashikon se në rastet kur i dënuari duhet të ndryshojë vendbanimin e qëndrimit të tij, kërkohet që vetë i dënuari të investojë gjykatën me kërkesën përkatëse, e cila jep vendimin pasi dëgjon mendimin e Shërbimit të Provës.

Ndërsa në rastin kur ekzistojnë kushtet për revokimin e dënimit alternativ "qëndrim në shtëpi", paragrafi i fundit i nenit 31/4, të ligjit 8331, parashikon se është prokurori, i cili pasi njoftohet nga Shërbimi i Provës, i kërkon gjykatës revokimin e dënimit dhe zëvendësimin me një lloj tjetër dënimi.

Pra, në rastet e ndryshimit të vendimit të "Qëndrimit në Shtëpi" (ndryshimi i vendbanimit) dhe të revokimit e zëvendësimit të masës, ligji e ka kufizuar legjitimitetin e kërkuesit, respektivisht për të dënuarin me burgim dhe prokurorin.

4.2.2 Riti i Gjykimit

Lidhur me ritin e gjykimit, në rastet kur kërkesa për zbatimin e dënimit alternativ bëhet gjatë shqyrtimit në themel të përgjegjshmërisë penale të të akuzuarit, kjo kërkesë ndjek rregullat dhe procedurat përkatëse dhe bëhet pjesë e procedurës së shqyrtimit në themel të përgjegjësisë penale.

Ndërsa, kur kërkesa për zbatimin e këtij dënimi alternativ bëhet gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burgim, riti i gjykimit do të ndjekë procedurën e parashikuar nga neni 471 i Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës gjykata i shqyrton kërkesat për zbatimin e dënimeve alternative,

duke caktuar seancën gjyqësore dhe duke lajmëruar për këtë qëllim palët dhe mbrojtësit, të paktën dhjetë ditë para seancës. Pika 4 e kësaj dispozite ka parashikuar se, seanca gjyqësore zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me fletëporosi.

I njëjti rregull mbi ritin plenar të gjykimit (në bazë të nenit 471 të Kodit të Procedurës Penale), do të zbatohet edhe kur objekt gjykimi është kërkesa e të dënuarit për ndryshimin e vendbanimit të qëndrimit të tij dhe kërkesa e prokurorit për revokimin e lirimit me kusht. Në këto raste, neni 31/4, i ligjit 8331/1998, parashikon rolin aktiv të Shërbimit të Provës, institucion i cili në rastet e kërkesës së të dënuarit për ndryshim vendbanimi, i jep një mendim të arsyetuar gjykatës për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, ndërsa në rastin e kërkesës nga prokurori për revokimin e këtij dënimi alternativ, Shërbimi i Provës është institucioni përgjegjës i cili verifikon faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkeljen e kushteve të vendosura nga gjykata në vendimin e saj për zbatimin e dënimit alternativ "qëndrim në shtëpi".

4.2.3. Ekzekutueshmëria e disponimit të gjykatës për "qëndrim në shtëpi"

Lidhur me ekzekutueshmërinë e disponimeve gjyqësore mbi kërkesën për "qëndrim në shtëpi", duhet të kuptohet se pranimi i një kërkese të tillë nuk passjell rifitimin e lirisë personale të të dënuarit, por thjesht ndryshimin e vendit të vuajtjes së dënimit. Bazuar në nenin 417, pika 6 e Kodit të Procedurës Penale, ankimi kundër një vendimi për çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale nuk e pezullon ekzekutimin, përveçse kur gjykata që e ka dhënë vendos ndryshe. Pra, nga kjo dispozitë rezulton se është në vlerësimin e gjykatës që të vendosë nëse, ankimi ndaj vendimit të saj do të pezullojë apo jo efektet e vendimit. Gjithsesi, nëse në vendim nuk parashikohet shprehimisht që ankimi pezullon ekzekutimin e vendimit, atëherë konkludohet se vendimet gjyqësore përfundimtare, që disponojnë pranimin e caktimit të "Qëndrimit në Shtëpi" si dënim alternativ, janë menjëherë të ekzekutueshme.

Nga ana tjetër, kur gjykata vendos pranimin e kërkesës së prokurorit për revokimin e dënimit alternativ të "Qëndrimit në Shtëpi", vendimi gjyqësor që urdhëron revokimin, nuk ekzekutohet menjëherë. Përkundrazi, që këto vendime gjyqësore të jenë të ekzekutueshme, do të duhet që të marrin formë të prerë sipas rregullave të zakonshme ligjore, konkretisht sipas nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale.

5. EKZEKUTIMI I DËNIMIT ALTERNATIV TË "QËNDRIMIT NË SHTËPI"

5.1 Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të "qëndrimit në shtëpi", parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 45-47, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 25.03.2009, "Për miratimin e Rregullores për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative" dhe të ligjit nr.10494, datë 22.12.2011 "Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve i kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor".

Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, i cili ka vendosur "qëndrimin në shtëpi" të të dënuarit. Shërbimi i Provës kontakton institucionet lokale, shërbimin social, Policinë e Shtetit dhe çdo ent privat apo publik që mund të asistojë në ekzekutimin e dënimit me "qëndrim në shtëpi". Mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimit me "qëndrim në shtëpi" përfshin vizitat rutinë të lajmëruara dhe ato të pa lajmëruara, në shtëpinë e të dënuarit në provë ose në qendrat e kujdesit ku i dënuari vuan dënimin, si dhe mbajtjen e kontakteve me të dënuarin dhe familjen e tij. Gjithashtu, ky Shërbim verifikon dhe njofton prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtij vendimi dhe detyrimeve të tjera të vendosura nga gjykata në vendim.

Ligjvënësi i ka dhënë të drejtë Shërbimit të Provës që, nëse i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata për shkak të ndryshimit të rrethanave, t'i rishikojë këto detyrime, për të cilat i raporton menjëherë prokurorit. Mbetet e paqartë në praktikë mënyra se si i rishikon këto detyrime Shërbimi i Provës apo se çfarë vendimmarrjesh merr ky Shërbim në këtë drejtim, apo kufizohet vetëm në raportimin që i bën prokurorit. Kjo pasi, një detyrim i përcaktuar për t'u përmbushur në vendimin e gjykatës nuk mund të ndryshohet nga prokurori, dhe për më tepër nga ky Shërbim.

Në rastin kur nuk kanë ndryshuar rrethanat, por personi i cili vuan dënimin me *"qëndrim në shtëpi"* nuk respekton detyrimet e vendosura nga

gjykata. Shërbimi i Provës fillimisht verifikon faktet dhe më pas njofton prokurorin, i cili i kërkon gjykatës revokimin e dënimit dhe zëvendësimin me një lloj tjetër dënimi. Situata është e ndryshme në rastin kur, Shërbimi i Provës çmon se mospërmbushja e detyrimeve të të dënuarit ka ardhur si rezultat i pamundësive objektive. Në të tilla raste, ky Shërbim, duke qenë organi që monitoron përmbushjen e këtyre detyrimeve, i propozon prokurorit ndryshimin e këtyre detyrimeve në përputhje me mundësitë konkrete dhe nevojat e vetë të dënuarit.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimit me *"qëndrim në shtëpi"* nga ana e Shërbimit të Provës bëhet në disa forma, të cilat janë:

- vizita rutinë të lajmëruara;
- vizita rutinë të palajmëruara në shtëpinë e të dënuarit ose qendrat e kujdesit ku ai vuan dënimin;
- mbajtjen e kontakteve me të dënuarin;
- mbajtjen e kontakteve me familjen e të dënuarit; si dhe
- mbikëqyrja elektronike.

Sipas ligjit "Për mbikëqyrjen elektronike", Gjykata vendos përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, kryesisht ose me kërkesën e prokurorit, subjektit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës, apo prindërve ose kujdestarit të të miturit. Gjykata, përpara caktimit të masave shtrënguese, shpalljes së vendimit përfundimtar të gjykatës, apo lëshimit të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, pyet subjektin nëse jep pëlqimin për përdorimin e ME-së, dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj.

Shërbimi i Provës është organi përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes elektronike. Shërbimi i Provës është përgjegjës për vendosjen, heqjen dhe funksionimin e rregullt të pajisjes. Vendi, koha dhe rregullat për vendosjen dhe heqjen e pajisjes përcaktohen në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të nxjerrë nga prokurori ose gjykata, të cilët ia njoftojnë menjëherë subjektit dhe organit që realizon mbikëqyrjen elektronike. Shërbimi i Provës që realizon mbikëqyrjen elektronike, nëpërmjet sallës operative të ngritur prej tij, mbledh, përpunon dhe raporton të dhënat që vijnë nga pajisja.

Organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij duhet të ketë në konsideratë respektimin e rregullave të

përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Informacioni i siguruar për vendndodhjen e subjektit, është i ndaluar t'u jepet personave të tretë, apo agjencive ose organeve të paautorizuara nga ligji.

5.1.1 Avantazhet e Mbikëqyrjes Elektronike

Dënimit alternativ i "qëndrimit në shtëpi" dhe "mbikëqyrjes elektronike" tregon për kursime financiare, ulje të recidivizmit dhe aftësinë për të monitoruar dhe përcaktuar vendndodhjen e kundërvajtësit në kohë reale, si avantazhe të këtyre alternativave të dënimit. Sa i përket kursimeve financiare, si nga mbyllja në shtëpi ashtu edhe nga monitorimi elektronik, mund të kursejnë taksapaguesit.

Mundësia për të identifikuar vendndodhjen e kundërvajtësve në kohë reale është e mundur përmes pajisjeve të mbikëqyrjes elektronike që përdorin GPS. Në këtë mënyrë, personeli i zbatimit të ligjit është në gjendje të gjurmojë nëse kundërvajtësi i përmbahet kushteve të qëndrimit në shtëpi. Kjo i sjell dobi edhe kundërvajtësit, pasi mund të sigurojë një alibi nëse ai do të akuzohej për një krim shtesë, që ai ose ajo nuk e ka kryer.

5.1.2 Disavantazhet e Mbikëqyrjes Elektronike

Edhe pse përdorimi i mbikëqyrjes elektronike ka avantazhe për dënimin alternativ të qëndrimit në shtëpi, për këtë mënyrë vërehen gjithashtu edhe disavantazhet, të cilat mund të përfshijnë shkeljen e rregullave, rezultate te pasakta, rrezikun e largimit dhe efektet emocionale.

Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike, si me shumicën e pajisjeve elektronike, paraqet potencialin e të dhënave false, për shembull, në disa raste një pajisje e mbikëqyrjes elektronike do të dërgojë një njoftim që informon personelin se i pandehuri ose i dënuari ka shkelur kushtet (edhe pse i pandehuri ose shkelësi nuk ka bërë shkelje), sepse aparati nuk ka qenë ngarkuar siç duhet.

Për më tepër, ekzistojnë kufizime në aftësinë për të gjetur vendndodhjet e të pandehurit ose të dënuarit, nëse ata lënë zonat e tyre të paracaktuara, të projektuara. Për shembull, modelet me frekuencë radio mund të njoftojnë zyrtarët vetëm që i pandehuri ose i dënuari është larguar nga zona e caktuar, por ata nuk janë në gjendje të lokalizojnë vendndodhjen e tij. Për të ndjekur lëvizjen e një të pandehuri ose të dënuari në kohë reale, duhet të përdoret monitorimi GPS.

Së fundi, studiuesit gjithashtu tregojnë për ndikimin emocional të veshjes së një pajisje elektronike për monitorim, siç është stigma e shoqëruar me veshjen e një pajisje elektronike të dukshme të monitorimit.[80]

5.2 Raporti i mbikëqyrjes së të dënuarit me "qëndrim në shtëpi" (alternativa e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal)

Raportet që përpilohen përgjatë ekzekutimit të dënimit alternativ "qëndrim në shtëpi" përmenden në nenin 31/4 të ligjit nr. 8331/1998, në nenet 46 dhe 47 të VKM-së nr.302/2009, si dhe në mënyrë të tërthortë edhe në nenin 59/a të Kodit Penal. Nga analiza e këtyre normave, nxirret përfundimi që Shërbimi i Provës potencialisht mund të hartojë tre lloj raportesh gjatë mbikëqyrjes së dënimit alternativ "qëndrim në shtëpi", të cilat përmbajnë të dhëna dhe informacione mbi sjelljen e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ "qëndrim në shtëpi". Në këtë çështje duhet mbajtur në konsideratë që, pavarësisht se kjo alternativë dënimi emërtohet "qëndrim në shtëpi", në të vërtetë koncepti i shtëpisë së të dënuarit barazohet me atë të një shtëpie tjetër private (të një të treti), apo edhe me atë të një qendre të kujdesit dhe të shëndetit publik.

Për sa u takon burimeve të informacionit për përgatitjen e raporteve gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të kësaj alternative, Shërbimi i Provës bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore. Neni 31/4 i ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar, përcakton si të tilla edhe institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me "qëndrim në shtëpi". Ky përcaktim i veçantë për "qëndrimin në shtëpi" sigurisht që ka lidhje me thelbin e kësaj alternative, që detyron të dënuarin të rrijë në një ambient të izoluar, të ndryshëm nga I.E.V.P.-ja.

Tre llojet e raporteve që përpilohen dhe paraqiten nga Shërbimi i Provës për mbikëqyrjen e kësaj alternative janë:

a) Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e përgjithshme të të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet në përfundim të alternativës së dënimit me burgim "qëndrim në shtëpi" dhe i drejtohet prokurorit të ekzekutimit. Ky është i llojit raport përfundimtar, pra, përmban

[80] *"Home Confinement and Electronic Monitoring"*- Office of Juvenile Justice and Deliquency Prevention

të njëjtët elementë, ka të njëjtin qëllim, si dhe të njëjtën përmbajtje me raportin përfundimtar. Ai përmbyllet me analizën e Shërbimit të Provës mbi mundësinë e kryerjes së veprave penale nga i dënuari në të ardhmen, apo me rrezikun mbi një dëm të mundshëm të veprimeve të tij në të ardhmen, duke treguar edhe faktorët që determinojnë sjelljen e të dënuarit.

b) Raporti i menjëhershëm për mosekzekutimin e kushteve dhe detyrimeve nga i dënuari. Ky raport përpilohet menjëherë sapo Shërbimi i Provës konstaton mosekzekutimin e kushteve apo detyrimeve të të dënuarit, që përbëjnë thelbin e kësaj alternative. Ky raport është i natyrës vlerësuese mbi rrethanat, ka karakter informues dhe përpilohet menjëherë nga Shërbimi i Provës, me iniciativën e tij. Edhe përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative, mospërmbushja e detyrimeve mund të vijë si rezultat i shkaqeve të pavarura nga vullneti i të dënuarit. Kur Shërbimi i Provës konstaton se kushtet e parashikuara në nenin 59/a, paragrafi 1 të Kodit Penal, për të cilat gjykata ka caktuar masën alternative "qëndrim në shtëpi" nuk ekzistojnë më, raporton menjëherë tek prokurori me qëllim që t'i kërkohet gjykatës revokimi i masës alternative dhe zëvendësimin e saj me një tjetër.

c) Raporti i Shërbimit të Provës për të lejuar të dënuarin të dalë nga qëndrimi në shtëpi. Sipas nenit 59/a të Kodit Penal, gjykata mund të lejojë personat e dënuar me "qëndrim në shtëpi", të largohen nga vendbanimi për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat Shërbimi i Provës është dakord. Sigurisht që pëlqimi i Shërbimit të Provës jepet nëpërmjet raportit të vlerësimit, në të cilin përshkruhen dhe analizohen nevojat konkrete të të dënuarit dhe jepet rekomandimi konkret për gjykatën për dhënien e kësaj lejeje të dënuarit. Në këto raste, pas referimit të fakteve nga i dënuari dhe nga Shërbimi i Provës, gjykata përcakton edhe masat që duhen marrë nga Shërbimi i Provës.

6. ARSYETIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE QË KANË APLIKUAR MASËN ALTERNATIVE TË "QËNDRIMIT NË SHTËPI"

Vendimi gjyqësor është mjeti me të cilin shprehet gjykata për dhënien e drejtësisë. Ky akt ka rëndësi të veçantë si për subjektet e përfshira në gjykim, për organet që kanë detyrë të venë në ekzekutim këto akte, por edhe për

publikun e gjerë. Drejtësia jepet në bazë të ligjit e në emër të Republikës, prandaj ajo duhet të jetë e drejtë, por dhe duhet të duket si e tillë në sytë e opinionit shoqëror. Arsyetimi i plotë dhe i qartë i vendimit gjyqësor ndihmon për këtë qëllim. Në kuadër të këtij projekti, u shqyrtuan vendimet gjyqësore që përmbajnë masën alternative të "Qëndrimit në Shtëpi", të dhëna gjatë vitit 2018 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shkodër, Fier dhe Korçë.

Konstatohet se gjykata është e kujdesshme që, në arsyetimin e vendimeve gjyqësore t'u referohen me kujdes dispozitave ligjore ku janë bazuar për dhënien e vendimeve, si dhe të shprehen në lidhje me elementët e veprës penale, të trajtojnë provat që janë administruar, rrethanat rënduese, ose lehtësuese, kushtet dhe rrethanat e veçanta personale apo familjare të të pandehurit.

Megjithatë u konstatua gjithashtu se në lidhje me plotësimin e kushteve, apo rrethanave, që kërkohen në mënyrë eksplicite nga ligji për aplikimin e masës alternative të "Qëndrimit në Shtëpi", vendimet nuk kishin një arsyetim të plotë e të qartë. Ato janë tepër skematikë. Nuk shpjegohet se si është hetuar e arsyetuar rreth plotësimit të kushteve e rrethanave të parashikuara nga neni 59/a i KP -"Qëndrimi në Shtëpi", që gjykatat kanë vendosur të aplikojnë në këto raste.

Në arsyetimin e vendimit për aplikimin e masës alternative të dënimit të "Qëndrimit në Shtëpi", përveç kushteve të domosdoshme ligjore të përcaktuar në nenin 59-a të KP, gjykata trajton edhe kushte të tjera si p.sh.: rrezikshmërinë e ulët shoqërore, sjelljen e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale, qenien e të dënuarit përsëritës (recidivist). Gjykatat duhet të tregohen të kujdesshme që në rastet e vlerësimit të aplikimit të kësaj mase alternative të dënimit me burgim, të mos ndikohen nga kushtet e përmendura më sipër pasi të dënuarit mund t'i mohohet e drejta e aplikimit të kësaj mase, edhe pse i plotëson të gjitha kushtet ligjore për të përfituar nga kjo.

Ky konstatim tregon se gjykatat janë të paqarta në individualizimin e masës alternative të dënimit që duhet të zbatohet për rastin konkret. Rrethana e recidivizmit, si shkak për refuzimin e kërkesës për caktimin e dënimit alternativ, parashikon një ndalim kategorik për të përfituar nga lirimi me kusht. Por, në rastin e "Qëndrimit në Shtëpi", kjo masë alternative mund të aplikohet edhe në rastet kur i dënuari është përsëritës.

I njëjti arsyetim qëndron edhe për rrethanën e rrezikshmërisë së ulët shoqërore. Me prezantimin e kësaj masë alternative me burgim, me anë të

ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'", nuk u vlerësua e arsyeshme nga legjislacioni, kushtëzimi i saj me rrezikshmërinë e veprës apo autorit të veprës penale. Përjashtimi i vetëm i këtij rregulli u bë me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"" i ndryshuar, me anë të të cilit është shtuar shprehimisht që të ndalohet dhënia e këtij dënimi alternativ për gratë shtatzëna ose me fëmijë nën 10 vjeç, dhe për baballarët që kanë përgjegjësinë prindërore për fëmijët nën 10 vjeç, kur këta persona janë shpallur fajtorë për krime ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij. Pra, përsa i përket rrezikshmërisë së veprës penale, legjislatori nuk ia kaluar diskrecionit të gjyqtarit, por ka përcaktuar konkretisht, se për cilën vepër penale nuk do të lejohet zbatimi i masës së aplikimit të dënimit me burgim.

7. STATISTIKAT E SISTEMIT TË DREJTËSISË PËR APLIKIMIN E DËNIMIT ALTERNATIV TË "QËNDRIMIT NË SHTËPI"


"Qëndrimi në shtëpi", sipas statistikave gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit të Provës, është dënimi alternativ më pak i aplikuar në praktikën gjyqësore pas gjysëmlirisë. Konkretisht, sipas statistikës së Shërbimit të Provës, për periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2018, rezulton se ka pasur vetëm 570 të dënuar sipas nenit 59/a të Kodit Penal, që përfaqësojnë 1.48 % të të dënuarve. Për rrjedhim, "Qëndrimi në Shtëpi" është dënimi alternativ më pak i aplikuar në raport me dënimet e tjera alternative, si p.sh.: "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë" (80.79%); "Pezullimi i dënimit dhe kryerja e një pune në interes publik" (13.80 %); "Lirimi me kusht" (3.89 %), dhe më shumë se gjysmëliria (0.04 %).

Nr.	APLIKIMI SIPAS LLOJIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE [VITI 2009 - 2018]	Kodi Penal	Të dënuar	Të dënuar në %
1	Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në periudhë prove	Neni 59	31074	80.79
2	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e nje pune në interes publik	Neni 63	5306	13.80

3	Lirimi me kusht	Neni 64	1498	3.89
4	Qëndrimi në shtëpi	Neni 59/a	570	1.48
5	Gjysmëliria	Neni 58	14	0.04
-	Total	-	30934	100%

Lloji i dënimit alternativ	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Neni 59 i K.P, Pezullimi	3.189	4.798	4.460	4.904	6.171
Neni 59/a i K.P, Qëndrimi në shtëpi	56	92	74	85	82
Neni 64 i K.P, Lirimi me kusht	64	84	101	172	254
Neni 63 i K.P, Punë në interes publik	694	974	938	884	1.017
Neni 58 i K.P, Gjysmëliria	0	4	4	1	4
Totali	4.003	5.952	5.577	6.046	7528

Në mënyrë grafike të dhënat statistikore për vitin 2018, në shkallë vendi janë:



Aplikimi i rrallë i këtij dënimi alternativ në raport me dënimet e tjera alternative, mund të ndodhë për këto arsye:

Së pari, mund të vijë për shkak të kufirit të ulët të dënimit penal, të parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal. Konkretisht, dënimi alternativ i "qëndrimit në shtëpi" aplikohet vetëm për dënime deri në 2 vite burgim ose kur kjo kohë është pjesa e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, sidomos krahasuar me dënimin alternativ të pezullimit të dënimit dhe vënia në provë, i cili parashikon një marzh dënimi deri në pesë vite burgim.

Së dyti, është një dënim alternativ relativisht i ri në legjislacionin penal, i prezantuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'". Ndërkohë praktika gjyqësore ka krijuar një traditë të konsoliduar të aplikimit të pezullimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit ose të dënuarit në provë, nisur dhe nga fakti se shkaqet e përcaktuara për aplikimin e vënies së të dënuarit në provë, sikurse janë ato të *moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën,* janë të njëjta me dënimin alternativ të "qëndrimit në shtëpi".

Së treti, "qëndrimi në shtëpi" pavarësisht se është një dënim më i lehtë se dënimi me burgim, pasi i pandehuri ose i dënuar ka mundësi të rrijë me familjen e tij, gjithsesi mbetet një dënim që kufizon lirinë e personit dhe për këtë arsye, subjektet mund të preferojnë që t'i kërkojnë gjykatës të pezullojë vuajtjen e dënimit dhe të vihen në provë, pasi nuk ekziston një dallim i qartë i arsyeve të këtyre dy masave dhe me masën e dytë, i dënuari është i lirë dhe jo "i burgosur" në shtëpinë e tij. Pra, shkak i aplikimit të vogël të kësaj mase mund të jetë edhe numri i kufizuar i kërkesave nga vetë subjektet.

8. KONKLUZIONE DHE VLERËSIME PËR EFEKTSHMËRINË E DËNIMIT ALTERNATIV "QËNDRIMI NË SHTËPI"

Dënimi alternativ i "qëndrimit në shtëpi" duhet përdorur më shpesh. Edhe nëse garantohet zvogëlimi i shpenzimeve financiare, efikasiteti i kostos nuk duhet të jetë një zëvendësim i drejtësisë. Prandaj, gjyqtarët duhet të përshtatin me kujdes kushtet e qëndrimit në shtëpi për të siguruar që i shërben qëllimit rehabilitues dhe ndëshkues të autorit të veprës penale. "Qëndrimi në shtëpi" është një dënim alternativ që ka hyrë shumë vonë në sistemin juridik penal të Shqipërisë, dhe për këtë arsye është shumë shpejt për të nxjerrë konkluzione për suksesin apo dështimin e tij. As nuk është e qartë në mënyrë precize se, cilët indikatorë janë më të rëndësishmit për të vendosur nëse "qëndrimi në shtëpi" është dënimi penal më i përshtatshëm për t'u dhënë në një rast të caktuar. Ndërkohë që shpeshtia e recidivizmit ulet me dënimin alternativ të "qëndrimit në shtëpi" (krahasuar me dënimet e tjera më pak të rënda), kosto administrative nuk ulet. Megjithatë, edhe në këtë fazë të hershme të zhvillimit dhe zbatimit të dënimit alternativ

të "qëndrimit në shtëpi", mund të jepen disa vlerësime mbi sukseset dhe vështirësitë e këtij lloji dënimi alternativ.

A. Kursime të shpenzimeve dhe lehtësimi i mbipopullimit të burgjeve

Dënimi alternativ i "qëndrimit në shtëpi" siguron ulje të kostove administrative si një politikë penitenciare. Është e qartë se zvogëlimi i shpenzimeve është rezultat i pashmangshëm, në krahasim me kostot e strehimit të një kundërvajtësi në një institucion të vuajtjes së dënimit. Kursimet indirekte janë, gjithashtu, një faktor për të marrë parasysh kostot e qëndrimit në shtëpi. Një i dënuar, që ka autorizim për të lënë shtëpinë për punë, mund të mbështesë nevojat e tij të jetesës dhe të jetë në gjendje të paguajë taksat dhe kështu të parandalojë varësinë e tij dhe të familjes nga ndihma shtetërore.

Megjithatë, pavarësisht se kostoja e dënimit alternativ të "qëndrimit në shtëpi" është shumë herë më e vogël se dënimi me burgim, ajo kushton më shumë se masa e vënies së të pandehurit ose të dënuarit në provë, kështu që nëse ata që janë në shërbim prove do të vendoseshin në qëndrim në shtëpi, shpenzimet e përgjithshme të sistemit penal do të rriteshin.

Gjithashtu, dënimi alternativ i "qëndrimit në shtëpi" lehtëson edhe problemin e mbipopullimit të institucioneve të vuajtjes së dënimit. Megjithatë, kjo problematikë nuk është e thjeshtë pasi duhet përballur me problemet që sjell dërgimi i të dënuarit në shtëpi për rastet kur shqetëson anëtarët e tjerë të familjes, ose faktit kur i pandehuri ose i dënuari nuk ka një shtëpi ku të shkojë.

B. Recidivizmi

"Qëndrimi në shtëpi" është një masë efektive përsa i përket largimit të autorit të veprës penale nga mundësia për të përsëritur një shkelje tjetër penale. Kjo, për shkak se shmang kontaktin e të pandehurit me ambientin ku ai është më i mundshëm që të vazhdojë sjelljen e tij të dënueshme. Gjithashtu, ky dënim alternativ mban larg autorin e veprës penale nga viktima, duke minimizuar kështu çdo veprim të nxituar që do të merrej për motive hakmarrëse.

C. Mbikëqyrja

Edhe nëse Shërbimi i Provës do të kishte në dispozicion personel të mjaftueshëm, trajnimi i tyre në drejtim të specializuar për dënimin alternativ të "qëndrimit në shtëpi" është i domosdoshëm Mbikëqyrja e

dënimit alternativ të "qëndrimit në shtëpi", përfshin sigurimin e respektimit të rreptë të kufizimeve të mëdha të lirisë së lëvizjes së kundërvajtësit; kështu, mbikëqyrja e oficerëve të Shërbimit të Provës do të duhet të marrë një funksion më të madh policor nga sa i caktohet në një detyrë të zakonshme.

D. Rekomandime legjislative

Për situatat e parashikuara nga germat a) dhe b), të nenit 59/a të Kodit Penal, në bazë të të cilave masa alternative e dënimit me burgim e "qëndrimi në shtëpi", mund të jepen: a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të dhe b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të. Nuk është e kuptueshme për se legjislatori ka përcaktuar moshën 10 vjeçare për fëmijët të cilët kanë nevojën e prindit të tyre. Pra, nuk është e qartë përse fëmija mbi moshën 10 vjeç, nuk ka të njëjtën nevojë për praninë e prindit të tij si fëmija nën 10 vjeç.

Nisur edhe nga mosha e lejuar nga Kodi i Punës, neni 98 i të cilit parashikon se ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç, - bëjnë përjashtim rastet kur fëmijët nga mosha 15 vjeç deri në moshën 16 vjeç mund të punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të leha, - atëherë vlerësojme se mosha e fëmijëve të parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, duhet të ishte 16 vjeç.

KAPITULLI IV

NENI 63 I KODIT PENAL PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM DHE DETYRIMI PËR KRYERJEN E NJË PUNE NË INTERES PUBLIK

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI "PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM DHE DETYRIMIN PËR KRYRJEN E NJË PUNE NË INTERES PUBLIK"

Kodi Penal, në kreun VII të tij ka parashikuar "Alternativat e dënimit me burgim", një ndër të cilat është dhe "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryrjen e një pune në interes publik"[81]. Ky institut përfaqëson një alternativë të dënimit me burgim që e ve të dënuarin në pozitat e një personi që do të shërbejë në komunitet në kushtet e përcaktuara nga gjykata. Ky shërbim nënkupton kryerjen e një pune të caktuar, me pëlqimin e të dënuarit dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik. Qëllimi i këtij dënimi është ndër të tjera riintegrimi në komunitet, edukimi dhe rehabilitimi i këtij të dënuari. Puna dhe ambjenti konkret ku kryhet kjo punë është faktor i rëndësishëm në nxitjen e ndjenjave pozitive tek i dënuari, përsa i përket respektit për vete dhe të drejtave të të tjerëve. Shërbimi i provës[82] është një organ i specializuar që është krijuar në RSh pas

[81] *Më poshtë do të citohet shkurt "Punë në interes publik"*

[82] *Me Ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë*

vitit 2008 dhe që mbikëqyr zbatimin e kryerjes së punës në interes publik. Ky organ luan një rol thelbësor në drejtim të ndihmës që i jep të dënuarit në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Por gjithashtu, ky institucion duke përpiluar raportet për vlerësimin e rrethanave shoqërore, kulturore, familjare, të personalitetit të individit konkret, ndihmon dhe prokurorin dhe gjykatën që të identifikojnë llojin dhe masën më të përshtatshme të dënimit alternativ. Puna në interes publik në raport me dënimin me burgim, por dhe me alternativat e tjera të dënimit, ka disa avantazhe dobiprurëse jo vetëm për të dënuarin por edhe për shoqërinë, në kuptimin që:

- I dënuari nuk humb kontaktet me familjarët;
- Kontakti me një ambjent dhe shembuj pozitivë nxit edukimin e tij;
- Dhënia e kontributit real në komunitet nxit vetëvlerësimin e tij dhe ndjenjën e dashurisë për punën;
- Ka më pak risk për t'u bërë përsëritës;
- I dënuari ka mundësi për të zhdëmtuar dëmin;
- Ulje e kostove financiare për sistemin e burgjeve; [83]
- Shmangie e mbipopullimit në burgje.

2. HISTORIKU I LIGJIT PENAL SHQIPTAR MBI "PUNËN NË INTERES PUBLIK"

2.1 Puna në interes publik në Kodin Penal të vitit 1995

Prokurorët dhe gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë kanë pasur mundësi të aplikojnë këtë nen që në vitin 1995. Konkretisht, në ligjin nr.7895 dt. 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", në nenin 63, me titull: *"Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik*" parashikohej shprehimisht:

21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit. Shiko nenin 31/7 të këtij ligji.

[83] Nga të dhënat e DPB kostoja për mbajtjen e një të dënuari me burg është 976,375 lekë në vit.

"Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik

Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Puna në interes publik jepet për një kohë nga dyzet gjer në dyqind e dyzet orë dhe konsiston në kryerjen nga i dënuari të një pune pa shpërblim në favor të interesit publik apo shoqatës të caktuar në vendimin e gjykatës.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj gjykata cakton orët e punës, si dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo.

Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë.

Ky lloj pezullimi ndjek të gjitha rregullat që janë vendosur në nenet 61 e 62 të këtij Kodi."

Pavarësisht se kjo lloj alternative dënimi me burgim ka qenë e parashikuar që me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të vitit 1995, në praktikë në vitet 1995 – 2007, puna në interes publik zbatohej pak nga gjykata dhe shumë më pak kërkohej nga prokurorët. Kjo edhe për faktin se akoma nuk kishte një agjenci të specializuar të krijuar me ligj për mbikëqyrjen e dënimeve alternative. Për të berë të mundur zbatimin më tepër në praktikë të alternativave të dënimit, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në vitin 2008 ndryshimet në Kodin Penal si dhe ndryshimet në ligjin "Për ekzekutimin e vendimeve penale", përkatësisht:

1. Ligjin me nr, 10023, dt. 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin me nr. 7895, dt. 27.01.1995, Kodi Penal i R.Sh.
2. Ligji nr. 10024, dt. 27.11.2008, " Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin me nr. 8331, dt. 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale". Në këtë ligj është parashikuar për herë të parë ngritja dhe funksionimi i "Shërbimit të Provës".

   Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave me vendimin nr.302, dt. 25.03.2009, vendosi "Për miratimin e rregullores

për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative**".**

Me plotësimin e kuadrit ligjor të sipërcituar, me ngritjen e Shërbimit të Provës u sigurua minimalisht infrastruktura që masat alternative të dënimit, të cilat në Evropë e më tej ishin praktikuar në një masë të gjerë shumë më herët në kohë, të fillonin të aplikoheshin edhe në Republikën e Shqipërisë. Kryerja e trajnimeve të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, punonjësve të Shërbimit të Provës mbi alternativat e dënimit, avantazhet që këto alternativa paraqisnin në raport me dënimin me burgim, si dhe mbipopullimi i burgjeve nga ana tjetër, rritën ndërgjegjësimin tek prokurorët dhe gjyqtarët mbi efektshmërinë e alternativave të dënimit me burgim. Faktorët e sipërcituar nxitën përdorimin e dënimeve alternative.

Edhe "puna në interes publik", si një nga alternativat e dënimit me burgim, është caktuar gjithnjë e më shumë nga gjykata. Aplikimi i këtij dënimi është përdorur në progresion në rritje, dhe ky fakt vihet re edhe nga statistika e publikuar nga Ministria e Drejtësisë, për vitet 2014-2018[84].

Lloji i dënimit alternativ	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Neni 63 i K.Penal	694	974	938	884	1017

2.2 Ndryshimi që ka pësuar "puna në interes publik"

Neni 63 është një nga dispozitat e K.Penal që ka pësuar më pak ndryshime dhe konkretisht ka ndryshuar vetëm një herë, ndryshim i cili referohet në ligjin e sipërcituar me nr. 10023, dt. 27.11.2008. Ndryshimet konsistojnë konkretisht përsa i përket paragrafëve 2, 5 dhe të fundit.

- Në paragrafin 2 është shtuar vetëm fakti që ky dënim alternativ mund të jepet kur i dënuari jep pëlqimin e tij.
- Në paragrafin 5 është ndryshuar përmbajtja, duke parashikuar dhe kompetencat e Shërbimit të Provës. Ndonëse është gjykata ajo që vazhdon të përcaktojë numrin e orëve të punës, përcaktimet e tjera që kanë të bëjnë me llojin, vendin e punës, ditët e javës etj., do të jenë

[84] *Shih Raportin vjetor statistikor 2018 të Ministrisë së Drejtësisë.*

kompetencë e Shërbimit të Provës.

- Ndërsa në paragrafin e fundit është ndryshuar përmbajtja, duke përcaktuar se pasojat mbi të dënuarin që nuk zbaton detyrimet e vendosura nga gjykata, janë ato te parashikuara në nenin 62 të Kodit Penal.

3. STANDARDI NDËRKOMBËTAR PËRSA I PËRKET "DËNIMEVE ALTERNATIVE TË DËNIMIT ME BURGIM", KU PËRFSHIHET DHE PUNA NË INTERES PUBLIK

3.1 Standardet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi trajtimin e të dënuarve me burgim

- Konventa e OKB "Për të drejtat e fëmijës" 1989, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 shkurt 1999.
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), 1948.
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara "Për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur" (Rregullat e Pekinit, 1985).
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara "Për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria" (Rregullat e Havanës, 1990).
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara "Për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve" (Udhëzimet e Riadit, 1990).
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara "Për Masat Alternative të Dënimit me Burgim" (Rregullat e Tokios, 1990).

3.2 Standardet e Këshillit të Evropës

- KEDNJ, përmendim këtu të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5), dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3).
- Konventa Evropiane "Për Mbikëqyrjen e Personave të dënuar ose të liruar me kusht", ratifikuar me ligjin nr, 8724, dt. 26.12.2000.

Kjo konventë është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 8724, dt. 26.12.2000. Ndër parimet themelore të sanksinuara në këtë Konventë, për

të cilën kanë rënë dakord shtetet anëtare, në nenin 1 ka të bëjë me faktin se:

"Palët kontraktuese angazhohen të japin, konform dispozitave të mëposhtme, ndihmën e ndërsjellë për rehabilitimin shoqëror të keqbërësve të parashikuar nga neni 2. Kjo ndihmë përbëhet nga mbikëqyrja e keqbërsve që realizohet, nga njëra anë, me masat e përshtatshme për të lehtësuar përmirësimin dhe ripërshtatjen e tyre në jetën shoqërore dhe, nga ana tjetër, me kontrollin e sjelljes së tyre për të dhënë mundësi, kur është e nevojshme, që ose të shpallet sanksioni ose të vihet ai në ekzekutim. Palët kontraktuese do të vënë në ekzekutim, konform dispozitave të mëposhtme, dënimin ose masën e sigurimit me heqje të lirisë, të dhënë ndaj keqbërësit dhe për të cilin zbatimi është pezulluar".

Në vështrim të kësaj Konvente, shprehja "*keqbërës*" do të thotë çdo person që, në territorin e Palëve kontraktuese, është bërë objekt:

a) i një vendimi gjyqësor fajësie, i shoqëruar me pezullimin me kusht të vendimit të dënimit;

b) i një dënimi që ka sjellë heqjen e lirisë, dhënë me kusht ose ekzekutimi i të cilit është pezulluar me kusht, pjesërisht ose tërësisht, ose në çastin e dënimit ose më pas.

2. Në nenet e mëposhtme, termi "dënim" ka të bëjë me vendimet e marra, si në bazë të pikës a, ashtu edhe të pikës b, të paragrafit 1, të mësipërm.

Kjo Konventë është e zbatueshme vetëm për vendimet përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

- Konventa "PËR Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues" dhe Protokollet nr. 1 dhe 2.

3.2.1 Rekomandime

- **Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Rec (2017) 3, në lidhje me "Rregullat Evropiane për masat dhe sanksionet komunitare".**
  Ky rekomandim është ndër rekomandimet më të afërta në kohë dhe është një rekomandim i rëndësishëm pasi zëvendëson:
  - Rekomandimin Rec (2000)22, "Për përmirësimin e implementimit të Rregullave Evropiane për sanksionet dhe masat komunitare"; dhe
  - Rekomandimin Rec(92)16, "Mbi Rregullat Evropiane për sanksionet dhe masat komunitare".

Në këtë rekomandim përcaktohet se rregullat e parashikuara në tekstin e këtij rekomandimi kanë si qëllim:

- të përcaktojnë një grup standardesh që ndihmojnë ligjvënësit kombëtarë, autoritetet vendimmarrëse dhe zbatuese, të bëjnë një interpretim të drejtë dhe efektiv të sanksioneve dhe masave komunitare. **Zbatimi duhet të konsiderojë nevojën që të mbrojë shoqërinë dhe mirëmbajë rregullin ligjor dhe njëkohësisht të mbështesë rehabilitimin shoqëror, ndërsa gjithashtu mundëson shkelësit të riparojnë dëmin që kanë shkaktuar;**
- t'u japin shteteve anëtare udhëzime mbi prezantimin dhe përdorimin e sanksioneve dhe masave komunitare, që të shfrytëzojnë plotësisht dobitë e tyre dhe të mbrojnë të drejtat themelore të të gjitha palëve të përfshira. Njëlloj, është e rëndësishme për t'u mbrojtur ndaj çdo lloj abuzimi të tillë që mund të rezultojë për shembull nga përdorimi i tyre në dëm të grupeve shoqërore të caktuara. **Si rrjedhojë, nevojitet të konsiderohen plotësisht avantazhet dhe disavantazhet shoqërore, krahas rreziqeve të mundshme që rezultojnë ose mund të rezultojnë prej këtyre sanksioneve dhe masave.**

Ndër parimet bazë të përmendura në këtë rekomandim përsa i përket caktimit të sanksioneve dhe masave komunitare[85], janë dhe rregullat që:

1. Sanksionet dhe masat komunitare mund të sigurojnë mbikëqyrje të drejtë dhe efektive, udhëzim dhe asistencë për të dyshuarit ose shkelësit, pa përfunduar në heqjen e lirisë. Ato mund të rrisin përfshirjen e grupeve shoqërore, mbi të cilën zakonisht varet edhe distancimi nga krimi.
2. Ligji kombëtar duhet të parashikojë një numër të mjaftueshëm të sanksioneve dhe masave komunitare të ndryshme, dhe këto duhet të bëhen të disponueshme për t'u përdorur në praktikë.
3. Natyra dhe kohëzgjatja e sanksioneve dhe masave komunitare, duhet

[85] *According to the Council of Europe's Recommendation CM/Rec(2017)3, "the expression 'community sanctions and measures' means sanctions and measures which maintain suspects or offenders in the community and involve some restrictions on their liberty through the imposition of conditions and/or obligations. The term designates any sanction imposed by a judicial or administrative authority, and any measure taken before or instead of a decision on a sanction, as well as ways of enforcing a sentence of imprisonment outside a prison establishment." Community sanctions and measures are frequently referred to as alternatives to imprisonment and some of them are also referred to as diversionary measures.*

të jenë të dyja në proporcion me seriozitetin e shkeljes për të cilën ose nga e cila akuzohen personat, dhe duhet të konsiderojnë rrethanat individuale të tyre.

- **Rekomandimi CM Rec (2010) 1, që ka lidhje me rregullat e Shërbimit të Provës.** (Adopted by the Committee of Ministers on 20 January 2010 at the 1075th meeting of the Ministers' Deputies)

Duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e tjera të mëparshme që kanë lidhje me rregullat komunitare përsa i përket masave penale dhe mbipopullimit të burgjeve, [86] ky rekomandim përkufizon agjencinë e Shërbimit të Provës si një institucion që rregullohet me ligj dhe që ka për qëllim të kontribuojë në një proces të rregullt ligjor si dhe të kontribuojë në sigurinë publike nëpërmjet parandalimit dhe uljes së krimit. Gjithashtu ky rekomandim merr në konsideratë rolin ndikues në uljen e popullimit të burgjeve duke parashtruar parimet bazë mbi të cilat duhet të veprojë Shërbimi i Provës, roli dhe detyrat e punonjësve të Shërbimit të Provës, etj.

3.2.2 Rezoluta

- Rezoluta (65) 1, në lidhje me pezullimin e dënimit, vënien në provë dhe alternativave të tjera të dënimit me burgim;
- Rezoluta (70) 1, në lidhje me organizimin praktik të masave për

[86] *the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms (ETS No. 5);*
- the European Convention on the Supervision of Conditionally Sentenced or Conditionally Released Offenders (ETS No. 51);
- the European Convention on the International Validity of Criminal Judgments (ETS No. 70);
- Recommendation No. R (92) 16 on the European rules on community sanctions and measures;
- Recommendation No. R (97) 12 on staff concerned with the implementation of sanctions or measures; - Recommendation No. R (99) 19 concerning mediation in penal matters;
- Recommendation No. R (99) 22 concerning prison overcrowding and prison population inflation;
- Recommendation Rec(2000)22 on improving the implementation of the European rules on community sanctions and measures;
- Recommendation Rec(2003)22 on conditional release (parole);
- Recommendation Rec(2003)23 on the management by prison administrations of life sentence and other long-term prisoners;
- Recommendation Rec(2006)2 on the European Prison Rules;
- Recommendation Rec(2006)8 on assistance to crime victims;
Recommendation Rec(2006)13 on the use of remand in custody, the conditions in which it takes place and the provision of safeguards against abuse;
- The United Nations Standard Minimum Rules for Non-custodial Measures (The Tokyo Rules).

mbikëqyrjen dhe kujdesin e mëpasshëm të të dënuarve apo të liruarve me kusht;
- Rezoluta (76) 2 e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me trajtimin e të dënuarve me afate të gjata burgimi;
- Rezoluta (76) 10 e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me disa masa alternative ndaj dënimit me burgim.

3.3 E drejta e Bashkimit Evropian

Vendimi i Këshillit të BE-së 2008/947/JHA, **datë** 27 nëntor 2008 "Për zbatimin e parimit të njohjes reciproke të gjykimeve dhe vendimeve për vënien në provë me qëllim mbikëqyrjen e masave për vënien në provë dhe sanksioneve alternative.

4. JURISPRUDENCË NDËRKOMBËTARE MBI "PUNËN NË INTERES PUBLIK"

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

"Dhënia e pëlqimit" si parakusht për të caktuar dënimin alternativ të punës në interes publik, është në përputhje me nenin 26 të Kushtetutës së R.Sh:

"*Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve*".

Parimi i ndalimit të punës së detyruar mishërohet edhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 4 i Konventës parashikon ndër të tjera se:

"*Askujt nuk i kërkohet të bëjë punë të detyruar ose me shtrëngim*".

Në çështjen Van der Mussele vs Belgjikës, GJEDNJ sqaron konceptet e 'punës', të 'detyrimit' dhe 'dhunës' në lidhje me punën. Në këtë vendim, gjykata ndër të tjera shprehet:

"*Para së gjithash Gjykata detyrohet të theksojë se teksti i dispozitës së nenit 4 nuk shpjegon se çfarë kupton me "punë me dhunë ose me detyrim". Për këtë arsye ajo iu referua Konventave 29 dhe 105 të Organizatës Botërore të*

Punës, në të cilat ishin anëtare pothuajse të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë edhe Belgjikën. Sipas nenit 2 § 1 të Konventës 29, shprehja "punë me dhunë ose me detyrim" kupton "çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individi nën kërcënimin e ndonjë dënimi dhe për të cilën ai individ nuk është ofruar me dëshirën e tij të lirë". Pasur parasysh se në rastin e Z. Van der Mussele nuk kishte të bënte me shtrëngim fizik ose moral Gjykata vlerësoi se shërbimet e tij nuk mund të konsideroheshin si punë me dhunë sipas kuptimit të nenit 4. Për këtë arsye ajo kaloi në vlerësimin nëse kishte të bënte me punë me detyrim. Sipas Gjykatës rreziqet me të cilat përballej Z. Van der Mussele në rastin e një refuzimi përbënin vërtet kërcënimin e një dënimi. Duke mos e vlerësuar si përcaktues argumentin e përdorur nga qeveria belge dhe Komisioni – pëlqimin e dhënë nga vetë kërkuesi në momentin që ai kishte zgjedhur profesionin e avokatit, Gjykata e çmon të nevojshëm vlerësimin e tërësisë së rrethanave të çështjes nën dritën e interesave që luajnë rol në kuadrin e nenit 4 si karakteri normal i shërbimit, interesi i përgjithshëm dhe solidariteti social".

Dhënia formale e pëlqimit, përsa i përket "ofrimit të individit për të punuar me dëshirën e lirë të tij", nuk është përcaktuese. N çështjen Van der Mussele vs Belgjikës, gjykata merr parasysh, por nuk i jep "…peshë vendimtare elementit të pëlqimit paraprak".

Në çdo rast duhet të mbahen në konsideratë rrethana te tilla si mosha dhe aftësia e individitit për të kuptuar rëndësinë që ka puna apo shërbimi përkatës. Vetëm pas një analize të tillë mund të vlerësojmë nëse individi ka ofruar apo jo vullnet në kryerjen e punës apo shërbimit.

5. REGJIMI JURIDIK MATERIAL I "PUNËS NË INTERES PUBLIK"

Sikurse përmendëm më lart, neni 63 "punë në interes publik" ka ndryshuar vetëm një herë që kur ka hyrë në fuqi Kodi Penal në vitin 1995, dhe ky ndryshim ka ndodhur në vitin 2008. Sot, rregullimi ligjor i "punës në interes publik" përcaktohet në nenin 63 të K.Penal, si më poshtë:

Neni 63

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008)

Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi.

5.1 Aspekti material

Gjykata kur cakton dënimin i referohet dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal si dhe kufijve të dënimeve të parashikuara për veprën penale konkrete. Sipas parimit të përgjithshëm të saksionuar në nenin 47 të Kodit Penal, në caktimin e dënimit duhet të merren parasysh:

- Rrezikshmëria e vepres penale;
- Rrezikshmëria e autorit të vepres penale;
- Shkalla e fajit;
- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Në mënyrë eksplicite, referuar paragrafit të parë të kësaj dispozite,[87] legjislatori është shprehur se, kur gjykata vlerëson nevojën e caktimit të "pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryrjen e një pune në interes publik", merr parasysh njëkohësisht këto rrethana:

- Rrezikshmëri e pakët e personit;
- Rrezikshmëri e pakët përsa i përket rrethanave të veprës penale; 88
- Kur jepet një dënim me burgim deri në një vit.

Duke iu referuar kritereve ligjore të sipërcituara, duket sikur për këtë lloj alternative dënimi me burgim, ligjvënësi ka përmendur më pak kritere të shprehura sesa për alternativën e shprehur në nenin 59 të K.P, ku ka cituar shprehimisht rrethana të tilla si: moshën, kushtet shëndetësore, mendore etj[89]. Por në fakt, kjo alternativë dënimi zbatohet më pak se pezullimi i dënimit me burgim sipas nenit 59 edhe për faktin se kur dënimet janë mbi 1 vit, kjo alternativë nuk mund të zbatohet.

Një diskutim në praktikë ka lindur në lidhje me faktin, nëse prokurori mund të caktojë "kryerjen e një pune në interes publik" në rastin e "gjykimit me marrëveshje" të parashikuar nga neni 406/d e vijues të K.Proc.Penale.

A është caktimi i kësaj alternative dënimi vetëm atribuim i gjykatës, meqenëse ligji shprehet me termin "*Gjykata mund t*ë *vendos*ë*"?*

Sigurisht që parimi i përgjithshëm është që gjykata cakton dënimin, por ndryshimet e vitit 2017 parashikojnë institutin e "Gjykimit me marrëveshje", që do të thotë se, në rastin kur kemi të bëjmë me kryerjen e veprave penale për të cilat parashikohet një sanksion jo më shumë se shtatë vjet, prokurori në respektim dhe të kritereve të caktuara në nenin 406/d e vijues, mund ta caktojë këtë alternativë dënimi.

Më poshtë po pasqyrojmë një rast të praktikës ku prokurori ka caktuar këtë alternativë dënimi në marrëveshjen që ka përpiluar me të pandehurin, marrëveshje e cila është pranuar nga gjykata.

---

[87] *Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.*

[88] *Këto elemente përfshijnë:*
a) Objektin; b) Vendin; c) Kohën; d) Gjendjen në të cilën kryhet vepra penale; e) Nëse vepra penale është e përhapur në atë territor; f) Rrethanat që kanë ndikuar në kryerjen e saj.

[89] Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës,kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së vepres penale si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale.

Rast praktik:
Prokurori ndër të tjera ka parashtruar në marrëveshje sa më poshtë vijon:

Fakti i ndodhur

Më datë _____ në orën ___, në vendin e quajtur "____", është ndaluar nga shërbimet e policisë shtetasi ___ i cili ka qenë duke drejtuar automjetin me targë _____. Pas verifikimit me aparatin alkoltestues "Drager" ka rezultuar testi i parë në masën 0.36 mg/l, 057 mg/l dhe 0.53 mg/l.

Përsa i përket masës dhe llojit të dënimit, që duhet aplikuar në rastin konkret, autoriteti procedues ka mbajtur parasysh, përveç kërkesës së të pandehurit dhe kritereve ligjore të përcaktuara në lidhje me "Gjykimin me marrëveshje" (seksioni IV K.Proc.P.), edhe parashikimet ligjore të cilat përcaktojnë mënyrën e caktimit të dënimit (kreu VI I KP), si dhe "Alternativat e dënimit me burgim", një nga të cilat është dhe "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik".

Në lidhje me sa më sipër u morën parasysh këto rrethana konkrete në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit :

1. Rrezikshmëria e pakët e të pandehurit.

a. I pandehuri është i padënuar më parë;

b. Nivelin e tij arsimor dhe faktin që i pandehuri është në vazhdim të këtij procesi. I pandehuri aktualisht është student në vitin e dytë në fakultetin e shkencave sociale.

c. Sjelljen e tij para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale.

d. Shprehjen e pendimit të thellë për veprën e kryer.

2. Rrethanat e kryerjes së veprës penale.

a. Masa e alkoolit (masa e alkoolit në rastin konkret është 0.53-0.57 mg/l);

b. Fakti se i pandehuri nuk është i përfshirë në një aksident me pasojë dëmtimin në shëndetin e njerëzve të tjerë, apo me pasojë dëm material tek të tjerët.

Përsa i përket caktimit të "Pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin e të pandehurit për të kryer një punë në interes publik", organi procedues mbajti parasysh veçanërisht rrethanat e

sipërcituara, si dhe faktin se në rrethanat konkrete vendosja e këtij të pandehuri nën kushtet e mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit të Provës, si dhe krijimi i mundësisë që ai të mos ndërpresë procesin mësimor si student në vitin e dytë, i shërben më mirë edukimit dhe rehabilitimit të këtij të pandehuri, sesa vendosja e tij në kushte burgimi.

Edhe zëvendësimi i dënimit me burgim, me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit, nuk u konsiderua i përshtatshëm në rastin konkret për arsye se i pandehuri nuk është në marrëdhënie punësimi; ai është student dhe kjo masë nuk do t'i shërbente ndëshkimit të vetë të pandehurit, dhe aq më tepër edukimit dhe rehabilitimit të tij.

Marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit është si më poshtë:

1. *I pandehuri _____ deklarohet fajtor për kryerjen e krimit "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt", i parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.*
2. *I pandehuri ____ pranon dënimin e tij me 20 dite burgim, në bazë të nenit 291 të K.Penal;*

   Mbështetur në nenin 63 të Kodit Penal, pezullohet dënimi me burgim dhe caktohet i pandehuri që të kryejë 60 (gjashtëdhjetë) orë punë në interes publik, për një periudhe kohe prej gjashtë muajsh nga miratimi i kësaj marrëveshjeje prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

   Gjatë kësaj kohe i pandehuri të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës për t'i caktuar llojin e punës që do të kryejë, vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet puna në interes publik.
3. *Në aplikim të nenit 261 të K.Pr.Penale, shuarjen e masës së sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penal caktuar ndaj të pandehurit _____ me vendimin nr. ____dt _____ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
4. *Në bazë të nenit 190/1/ç të K.Pr.Penale, kthimin e provës materiale "_____" të pandehurit _____.*
5. *Shpenzimet procedurale hetimore në vlerën _____ lekë, në ngarkim të të pandehurit.*

Sigurisht që marrëveshja do të shqyrtohet nga Gjykata, me pasojë miratimin apo refuzimin e saj. Kodi i Procedures Penale nuk parashikon ndonjë ndalim

ligjor për prokurorin që të caktojë këtë alternativë dënimi, dhe madje caktimi në vetvete i kësaj alternative në perputhje me kriteret ligjore të përcakuara në prg.1 të nenit 63 të K.Penal, nuk përbën shkak ligjor që gjykata ta refuzojë marrëveshjen. Gjykata mund ta refuzojë marrëveshjen vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 406/ë. Në rastin konkret, gjykata vendos refuzimin kur kjo alternativë dënimi është e papërshtatshme në raport me veprën dhe personalitetin e të pandehurit, apo kur nuk është marrë paraprakisht pëlqimi i të dënuarit apo kur i pandehuri tërheq pëlqimin.

Ky qëndrim tashmë është i konsoliduar dhe vihet re se gjykata ka vendosur miratimin e marrëveshjeve dhe kur prokurori ka caktuar alternativën e dënimit për të kryer një punë në interes publik. Më poshtë po japim si shembull një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Rast praktik:

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në vendimin nr. 3146, dt. 23.11.2018 ka vendosur:

1. *Miratimin e Marrëveshjes së Fajësisë me të pandehurin B.N për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.*
2. *I pandehuri B.N, deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.*
3. *I pandehuri dënohet me tridhjetë ditë burgim.*

   1. Në zbatim të nenit 63 të K.Penal urdhërohet:

   A-Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim.

   B-Zëvendësimi i dënimit me burgim me detyrimin e të dënuarit B.N për të kryer një punë në interes publik, për një kohë prej 40(dyzet) orë.

   C-Detyrohet i dënuari B.N, të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës të vendbanimit të tij.
4. *Shpenzimet proceduriale në vlerën 700 lekë, do të paguhen nga i pandehuri B.N."*

Nga analiza e 77 vendimeve të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë veçojmë vendimet e poshtëcituara, në të cilat gjykata ka vendosur pranimin e marrëveshjes për caktimin e punës në interes publik.

- *Vendimin nr. 811, dt, 19.03.2018*
- *Vendimin nr. 2136, dt. 12.06.2018*
- *Vendimin nr. 2786, dt. 24.10.2018*

- *Vendimin nr. 1003, dt. 04.04.2018*

Këtë praktikë ka ndjekur dhe Gjykata e Shkodrës. Nga 15 vendime të studiuara në tre vendime Gjykata ka vendosur miratimin e marrëveshjes për caktimin e punës në interes publik dhe konkretisht :

- *Vendimin nr. 51-2018-2116, dt. 5/30/2018*
- *Vendimin nr. 51-2018-4311, dt. 10/8/2018*
- *Vendimin nr. 51-2018-4365, dt. 10/9/2018*

5.2 Përkufizimi i termit "punë në interes publik"

Referuar paragrafit të dytë të nenit 63, përcaktohet përkufizimi i termit "punë në interes publik", që në kuptim të kësaj dispozite nënkupton:

- një punë pa shpërblim;
- me pëlqim të të pandehurit;
- në favor të interesit publik apo një shoqate të caktuar në vendimin e gjykatës;
- për një kohe minimale 40 orë dhe maksimale 240 orë, por pa kaluar 8 orë në ditë;
- kryerjen e punës brenda afatit 6 mujor.

Nga studimi i vendimeve penale përsa i përket kësaj alternative dënimi, vihet re se pjesa më e madhe e praktikës gjyqësore, duke ju referuar dispozitivit të vendimeve, konsiston në punë në favor të interesit publik, dhe më pak në favor të ndonjë shoqate të përcaktuar.

Në praktikën aktuale vihet re se, Shërbimi i Provës mbështetet më tepër për gjetjen e vendeve të punës tek njësitë vendore të pushtetit lokal, dhe puna pa shpërblim konsiston kryesisht në fusha të tilla si: pastrim, gjelbërim, mirëmbajtje të ambjenteve të përbashkëta si parqet dhe lulishtet e qyteteve etj.

Gjykata pasi ka arsyetuar përzgjedhjen e alternativës së dënimit me punë në interes publik, ka detyrim të përcaktojë në vendim dy detyrime për të dënuarin dhe konkretisht:

1. orët e punës që i dënuari duhet të kryejë;
2. detyrimin që i dënuari duhet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

Kemi parasysh këtu diskrecionin që ka gjykata për të caktuar orët e punës në kufirin, nga 40 orë deri në 240 orë. Theksojmë se është e nevojshme që, sidomos kur gjykata jep minimumin apo maksimumin e orëve të punës, të arsyetojë përse ka zgjedhur minimumin dhe maksimumin e lejuar nga ligji.

Ky përcaktim vjen në përputhje dhe me Rekomandimet në kuadër të KE përsa i përket autoritetit që ka kompetencën për të vendosur këto masa dhe afatin e tyre. Rekomandimi CMRec (2017)3,[90] mbi Rregullat Evropiane përcakton se kohëzgjatja e sanksioneve dhe masave komunitare duhet të përcaktohet nga autoriteti që ka tagrin për vendimmarje sikurse parashikohet nga ligji. Natyra dhe kohëzgjatja e sanksioneve dhe masave komunitare duhet të jetë në proporcion me seriozitetin e shkeljes dhe dëmin e bërë tek viktimat, dhe duhet të konsiderojë çdo rrezik të vlerësuar si dhe nevojat dhe rrethanat e individit. Si rregull, një sanksion ose masë komunitare duhet të imponohet për një kohëzgjatje të përcaktuar. Në ato raste të veçanta, kur ligji parashikon që kohëzgjatja e sanksionit dhe masës komunitare mund të zgjatet, duhet të ketë rishikim periodik nga autoriteti vendimmarrës, për të vlerësuar nëse rrethanat e veçanta janë akoma të aplikueshme, dhe nëse jo, të përfundojnë sanksionin ose masën komunitare.

Ky Rekomandim thekson një kështillim për gjykatën ose prokurorin publik në lidhje me përgatitjen, imponimin ose zbatimin e një sanksioni ose mase komunitare që duhet të jepet vetëm nga stafi i një organizate që parashikohet me ligj.

Referuar statistikave të botuara nga Ministria e Drejtësisë[91], numri i të dënuarve me "punë në interes publik" të dhënë nga gjykata në të gjithë vendin, për vitin **2018** është **700**. Më poshtë pasqyrohet në mënyrë grafike numri i vendimeve gjyqësore në raport me numrin e orëve të punës në interes publik:

	Orë pune në interes publik	2018
1	40	132
2	45	2
3	48	3
4	50	37
5	55	1

[90] *Shih kapitullin II / Recommendation CM/Rec (2017) 3 on the European Rules on community sanctions and measures (Adopted by the Committee of Ministers on 22 March 2017 at the 1282nd meeting of the Ministers' Deputies)*

[91] *Shih Raportin vjetor statistikor për vitin 2018 të Ministrisë së Drejtësisë*

6	60	148
7	70	7
8	80	115
9	90	18
10	96	0
11	100	98
12	114	1
13	120	53
14	140	5
15	150	24
16	160	8
17	170	1
18	180	6
19	200	27
20	240	13
21	320	1
	Totali	700

Nga pasqyra e mësipërme vihet re se, numrin më të madh të vendimeve e zenë ato vendime për të cilat gjykata ka vendosur të caktojë detyrimin për të kryer një punë në interes publik në masën 60 orë.

Nga analiza e vendimeve të gjykatës së Tiranës, Korçës, Shkodrës dhe Fierit, vihet re se në pjesën më të madhe të këtyre vendimeve gjykata nuk ndalet në arsyetimin e vendimit se përse ka caktuar sasinë konkrete të orëve të punës. Në disa herë të tjera, gjykata shprehet në mënyrë të përgjithshme, sikurse është shprehur Gjykata e Rrethit Korçë në vendimin me nr. 41-2018-98, dt. 1/10/2018

- *Në lidhje me numrin e orëve të punës, gjykata duke marrë në analizë marzhin e caktimit të orëve në interes publik, që varion nga 40-240 orë, në funksion të përmbushjes së qëllimit të dënimit, e veçanërisht efektit parandalues, çmon se i pandehuri {xxx} duhet të kryejë pa shperblim, 60 (gjashtëdhjetë) orë punë, në interes publiK, duke e gjetur te drejte kerkimin e perfaqësuesit të prokurorisë, por dhe dakordësinë e shprehur nga vetë i pandehuri në lidhje dhe me numrin e orëve të punës. Gjatë kohës së kryerjes së punës në interes publik, ky i pandehur, duhet të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës,{xxx}, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendbanimi i tij.*

5.3 Caktimi i vendimit përsa i përket "punës në interes publik"

Referuar paragrafit 5,[92] përcaktohet se gjykata, në rast kur konkludon se qëllimi i dënimit mund të realizohet nëpërmjet alternativës së dënimit me punë në interes publik, ajo përcakton shprehimisht në dispozitiv të vendimit detyrimin e të dënuarit për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës. Duhet të kuptohet se, nuk janë punonjësit e Shërbimit të Provës ata që duhet të gjejnë dhe të kontaktojnë të pandehurin. Detyrimi i këtij institucioni është të përcatojë llojin e punës, vendin e kryerjes, kohën e kryerjes së punës, si dhe të monitorojë të pandehurin. është detyrim i të pandehurit të shkojë pranë Shërbimit të Provës, të vejë në dispozicion të tyre adresën dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për të kontaktuar me të, si dhe detyrimi i këtij institucioni të informojë të pandehurin në lidhje me mënyrën e kryerjes së këtij dënimi alternativ.

Në rast se i pandehuri nuk kontakton me Shërbimin e Provës, nuk kryen punën e caktuar, apo shkel detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata, Shërbimi i Provës njofton prokurorin dhe ky i fundit, në varësi të rëndësisë së shkeljes, ka të drejtë të japë paralajmërim të regjistruar në dosjen personale të të dënuarit ose t'i drejtohet gjykatës për të ndryshuar detyrimin, shtuar atë, ose për të revokuar dënimin alternativ. Faktet e konstatuara gjatë monitorimit të të dënuarit, punonjësit e Shërbimit të Provës i pasqyrojnë në raportet e vlerësimit të të dënuarit.

a. Dënimi "punë në interes publik" konsiderohet i paqenë

Paragrafi 6 i këtij neni parashikon se "pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë". Theksojme se kjo lloj mundësie që dënimi të konsiderohet i paqenë, është një mundësi e mirë për të dënuarin që dënimi të mos ndikojë në të ardhmen e tij, sidomos kur bëhet fjalë për të miturit dhe moshat e reja që vazhdojnë procesin arsimor edukativ.

Një diskutim në praktikë ka lindur në lidhje me termin e përdorur nga legjislatori "dënimi konsiderohet i paqenë".

Pra, legjislatori nuk ka përdorur termin "personi quhet i padënuar", term i përdorur përsa i përket institututit të "Rehabilitimit", në nenin 69, ku parashikohet se " Quhen të padënuar ata që ….".

---

[92] *Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.*

Në rastin konkret do të thotë që, pasi të kryhet puna në interes publik, në vërtetimin gjyqësor të të dënuarit ky dënim nuk do të shfaqet, gjë që do të ndikojë dhe në trajtimin e tij si jorecidivist në të ardhmen në qoftë se kryen një vepër tjetër penale.

6. ASPEKTET PROCEDURIALE TË CAKTIMIT TË "PEZULLIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE DETYRIMIN PËR KRYERJEN E NJË PUNE NË INTERES PUBLIK"

Aspekti procedurial i caktimit të kësaj mase

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik, është një nga alternativat e dënimit që gjen zbatim në momentin e shpalljes së vendimit, pasi gjykata ka vendosur shpalljen fajtor të të pandehurit dhe ka caktuar dënimin me burgim të këtij të pandehuri.

Ndonëse neni 31/8 i ligjit, parashikon se Shërbimi i Provës me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës paraqet një raport me qëllim që të ndihmojë gjykatën në vlerësimin e duhur të dënimit alternativ, në pjesën më të madhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Tiranës, përsa i përket caktimit të punës në interes publik për të dënuarit madhorë, nuk vihet re që prokurori ose gjykata të ketë kërkuar një raport të tillë.

Kjo ka lidhje dhe me mënyrën e gjykimit, pasi në rastet kur gjykimet bëhen me procedurë të shkurtuar, çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Dhe çështja që shtrohet për diskutim është, - a mundet gjykata të kërkojë raport vlerësimi nëse një raport i tillë nuk është i administruar në dosjen gjyqësore.

Ndërsa përsa i përket të miturve, vihet re një ndryshim i praktikës pasi edhe prokurori edhe gjykata kërkon raport vlerësimi, dhe këto raporte ndihmojnë efektivisht në caktimin e dënimit alternativ më të efektshëm në rastin konkret.

7. EKZEKUTIMI I "PUNËS NË INTERES PUBLIK"

Mënyra e ekzekutimit të dënimeve alternative sikurse është dhe "Ekzekutimi i vendimit me punë në interes publik", është e përcaktuar në ligjin "Për

ekzekutimin e vendimeve penale" nr. 8331, dt. 21.04.1998 i ndryshuar, dhe konkretisht në katër nene duke filluar nga neni 31 deri në 31/3, të këtij ligji.

Sigurisht që është prokurori organi që ve në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit përsa i përket punës në interes publik. Prokurori përpilon urdhrin për ekzekutimin e vendimit dhe e dërgon pranë Shërbimit të Provës.

Shërbimi i Provës është organi shtetëror që ve në zbatim dhe mbikëqyr punën në interes publik. Shërbimi i Provës, duke pasur parasysh aftësitë dhe formimin profesional të të dënuarit, harton dhe zhvillon një program individual për kryerjen e punës në interes publik. Në kuadër të kryerjes së kësaj veprimtarie, Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore qendrore dhe lokale, me organizata jofimprurëse etj., me qëllim identifikimin e vendit të punës më të përshtatshëm dhe më efektiv në drejtim të riintegrimit, shoqërizimit, rehabilitimit të të dënuarit konkret. Në shumë shtete të Evropës është kthyer në një kulturë pune përfshirja e vullnetarëve (individë ose grupe) ose mentorëve, për të ndihmuar Shërbimin e Provës në implementimin e programeve të caktuara. Përfshirja e vullnetarëve, në fakt rekomandohet dhe nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (shiko CM/Rec (2010) 1. Këtë praktikë pune mund ta ndjekë edhe Shërbimi i Provës në vendin tonë, gjë që do të ndikonte në shtimin e burimeve njerëzore. Sigurisht që vullnetarët duhet të kalojnë në një proces të përshtatshëm selektimi dhe t'u ofrohet ndihma e nevojshme nga stafi i specializuar i Shërbimit të Provës.

Gjatë mbikëqyrjes së të dënuarit që kryen një punë në interes publik, Shërbimi i Provës përpilon dhe i paraqet prokurorit të ekzekutimit, këto raporte:

- Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet në përfundim të dënimit të "punës në interes publik".
- Raporti i menjëhershëm për mospërmbushjen e detyrimeve. Ky raport hartohet menjëherë pasi konstatohen shkelje të detyrimeve nga i dënuari.
- Raporti për nevojën e pezullimit të punës në interes publik. Ky raport është i natyrës vlerësuese dhe hartohet nga Shërbimi i Provës pas verifikimit të situatës që pretendohet nga i dënuari, sikurse mund të jetë sëmundje e papritur, vdekje e një të afërmi, apo rrethana të tjera të jashtëzakonshme.

Përsa më sipër referuar, konfirmohet dhe nga të dhënat e publikuara nga Shërbimi i Provës, në tabelën e mëposhtme. Vihet re se numri total i dënimeve alternative të zbatuara për vitin 2017 ka qenë 6046, ndërsa kërkesa për raporte vlerësimi kanë qenë në total 522.

KËRKESA PËR RAPORT VLERËSIMI	Viti 2017	Viti 2018
Kërkesë për raport vlerësimi nga Gjykata	484	695
Kërkesë për raport vlerësimi nga Prokuroria	38	86
Total	522	781

7.1 Problematika të tjera të lindura gjatë fazës së ekzekutimit të "punës në interes publik"

Një diskutim në praktikë ka lindur në lidhje me faktin se, cila do të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesave që lidhen me ndryshimin apo revokimin e dënimit alternative?

Neni 470 i K.Proc.Penale, parashikon se "Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.

Po ne rastin kur gjykata urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që ndodhet në vendbanimin e të dënuarit, dhe kjo gjykatë nuk është gjykata që ka dhënë vendimin? Po në rastin kur kemi të bëjmë me një shtetas të huaj?

Ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ne nenin 52 rregullon kompetencën përsa i përket kontrollit procedurial për ekzekutimin e vendimeve. Gjykata që ka dhënë vendimin ose gjykata ku ekzekutohet dënimi, për çështjet në kompetencë të saj që dalin gjatë ekzekutimit, ka të drejtë të kërkojë njoftime nga prokurori dhe organi ku ekzekutohet vendimi, dhe kur e sheh me vend kontrollon drejtpërdrejt rregulluesin e ekzekutimit.

Përsa i përket shtetasit të huaj, Këshilli i Evropës,[93] rekomandon se masat dhe sanksionet komunitare duhet të zbatohen dhe ndaj shtetasit të huaj, dhe se lidhur me aplikimin e këtyre masave nuk duhet të ketë diskriminim mbi bazë nacionaliteti.

Por edhe referuar standardit të BE-së, shtetet nuk duhet të parashikojnë rregulla apo të zbatojnë në praktikë rregulla të tilla, të cilat përjashtojnë

[93] Rec CM/Rec (2017) 3, kap 1, pika 7

shtetasin e huaj nga aplikimi i këtyre masave[94]. Në referim të vendimit kuadër të Këshillit te BE 2008/947/JHA "Për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe dënimeve alternative (shërbim prove), në funksion të mbikëqyrjes së masave dhe sanksioneve alternative", lejohet tranferimi i sanksioneve komunitare midis shteteve, në mënyrë që një person që ka kryer një veper penale në një shtet, të mund të kryejë dënimin në një shtet tjetër (zakonisht në shtetin ku ka rezidencën), ku do të promovohet rehabilitimi social i tij.

Në rastin kur i dënuari ka pamundësi objektive për të kryer punën në mënyrë të rregullt, a ka ai mundësi proceduriale për të shmangur ndryshimin e detyrimit, apo në rastin më të keq revokimin e vendimit të pezullimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burg?

Kjo situatë është zgjidhur me ndryshimet që pësoi ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale" me Ligjin nr. 10024, dt. 27.11.2008[95].

Ekzekutimi i vendimit për "punë në interes publik" mund të pezullohet kur është e pranishme një nga rrethanat e poshtëcituara:

- të sëmundjes së papritur të personit të dënuar, për të cilën është i nevojshëm trajtimi mjekësor dhe e pengon atë të kryejë punën;
- të vdekjes së një anëtari të familjes, si pasojë e së cilës personi i dënuar duhet të veprojë si kujdestar për anëtarët e tjerë të familjes dhe e pengon atë për kryerjen e punës;
- të rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e vazhdueshme të të dënuarit dhe e pengojnë atë të kryejë punën.

Në këtë rast personi i dënuar paraqet tek prokurori kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punën me interes publik. Shërbimi i Provës verifikon ndryshimin e situatës, për të cilën i raporton prokurorit.

Detyrimi për të kryer punë me interes publik pezullohet deri kur gjykata të japë vendimin për kërkesën e paraqitur.

Gjykata, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës, merr vendimin për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë me interes publik, të cilin ia dërgon menjëherë prokurorit. Në vendim gjykata përcakton periudhën kohore të pezullimit.

---

[94] Vendimi Kuadër i Këshillit te BE 2008/947/JHA "Për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe dënimeve alternative (shërbim prove), në funksion të mbikëqyrjes së masave dhe sanksioneve alternative".

[95] Shih nenin 31/3 të Ligjit Nr. 8331, dt. 21.04.1998 "Per Ekzekutimin e vendimeve penale", të ndryshuar.

7.2 Të dhëna statistikore për "punën në interes publik"

Referuar të dhënave statitistikore të publikuara nga Shërbimi i Provës që prej fillimit të funksionimit të këtij Shërbimi në vitin 2009 e deri në fund të vitit 2018, numri i personave të cilët janë vendosur me vendim gjykate në njërën prej alternativave të dënimit me burgim është 38462, mbikëqyrja e të cilëve realizohet mbi bazën e programeve individuale të trajtimit. Siç rezulton nga të dhënat e publikuara nga Shërbimi i Provës, numri i personave për të cilët është aplikuar dënimi me punë në interes publik zë vendin e dytë sa i përket numrit të të dënuarve, dhe konkretisht janë 5306 të dënuar.

Nr.	APLIKIMI SIPAS LLOJIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE [VITI 2009 - 2018]	Kodi Penal	Të dënuar	Të dënuar në %
1	Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në periudhë prove	Neni 59	31074	80.79
2	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e nje pune në interes publik	Neni 63	5306	13.80
3	Lirimi me kusht	Neni 64	1498	3.89
4	Qëndrimi në shtëpi	Neni 59/a	570	1.48
5	Gjysmëliria	Neni 58	14	0.04
-	Total	-	30934	100%

Por dhe duke iu referuar të dhënave statistikore brenda vitit kalendarik 2018[96], përsëri numri i personave për të cilët është aplikuar dënimi me punë në interes publik, ze vendin e dytë sa i përket numrit të të dënuarve, dhe konkretisht janë 1017 të dënuar.

Lloji i dënimeve alternative	Viti 2018
Neni 59 i K.Penal, Pezullimi	6171
Neni 59/a i K.P, Qëndrimi në shtëpi	82
Neni 64 i K.P, Lirimi me kusht	254
Neni 63 i K.P, Punë në interes publik	1017
Neni 58 i K.P, Gjysmëliria	4
Totali	7528

[96] Shih raportin vjetor statistikor të publikuar nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2018.

8. KONKLUZIONE MBI PRAKTIKËN GJYQËSORE PËRSA I PËRKET "PUNËS NË INTERES PUBLIK"

Janë studiuar gjithsej 77 vendime të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë për vitin 2018, 15 vendime nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, 4 nga Fieri dhe 2 nga Korça.

- Referuar llojit të veprës penale, vihet re se "puna në interes publik" është aplikuar në vepra penale të ndryshme. Duke iu referuar 77 vendimeve të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, vihet re sa më poshtë:

  Nenit 134 të K.Penal i përkasin 8 vendime, nga këto 1 vendim i përket nenit 134/2.

  Nenit 121/a/1 dhe 121/a/2 "Përndjekja", i përkasin 2 vendime.

  Nenit 130/a "Dhuna në familje", i përkasin 9 vendime, nga këto 1 vendim i përket nenit 130/a /4.

  Nenit 137/1 "Vjedhje e energjisë elektrike ose impluseve telefonike", i përkasin 7 vendime.

  Nenit 143/1 "Mashtrim", i përket 1 vendim.

  Nenit 174 "Kontrabanda me mallra të tjera", i përket vetëm 1 vendim.

  Nenit 180/1 "Fshehja e të ardhurave", i përkasin 2 vendime, njëri është për nenin 180/1, 25.

  Nenit 186/1 i përket një vendim, ndërsa nenit 186/2, i përket 1 vendim.

  Nenit 199/a/1 "Ndërtim i paligjshëm", i përkasin 2 vendime.

  Neni 235/1 "Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore", i përket 1 vendim.

  Neni 236/2 "Kundërshtimi i punonjësit të Policisë së rendit publik", i përket 1 vendim.

  Neni 290/1 "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", i përket 1 vendim.

  Neni 291 "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt", i përkasin 33 vendime.

  Nenit 301 "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", i përket 1 vendim.

  Nenit 89 "Plagosje e lehtë me dashje", i përkasin 5 vendime.

  Nenit 90 "Dëmtime të tjera me dashje", i përket 1 vendim.

Rast praktik:

Nga vendimet e sipërcituara veçojmë Vendimin me nr. 3507, dt. 28.12.2018, për të kuptuar se si i ka vlerësuar gjykata rrezikshmërinë e të pandehurit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal.

Rrethanat e faktit :

Një zonjë dhe një vajzë jane futur në dyqan dhe kanë arritur të marrin një pulover gri dhe një këmishë me kuadrate për femra, dhe pasi kanë hequr etiketat dhe sensoret i kanë futur në çantë dhe kanë dashur të largohen nga dyqani. Në këto momente janë ndaluar nga punonjësit e dyqanit dhe i kanë gjetur rrobat e vjedhura në çantë, dhe këto veprime janë të filmuara nga kamerat e sigurisë të dyqanit.

Gjykata ka cituar ndër të tjera se:

Për sa i përket rastit konkret për të pandehurën me të re në moshë Gjykata çmon se zëvendësimi i këtij dënimi me punë në interes publik është më i drejtë dhe i përshtashem prandaj duhet aplikuar neni 63 i Kodit Penal, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e këtij dënimi me detyrimin që e pandehura të përmbushë nga 200 (dyqind) orë pune në interes publik dhe ky detyrim të përmbushet brenda 6 muajve pasi ky vendim të marre formë të prerë.

Gjykata konstaton se është në përputhje të plotë me kriteret e sanksonuar ne nenin 63 të Kodit Penal siç janë :

Masa e denimit është më e vogël se 1 vit burgim.

E pandehura ka dhënë pëlqimin e saj.

- Nga analiza e këtyre vendimeve vihet re se "Puna në interes publik" është caktuar më tepër për veprën penale të parashikuar nga neni 291 për "Drejtimin e automjetit në mënyrë të parregullt".
- Nga analiza e 77 vendimeve të Gjykatës së Tiranës vihet re se numri më i madh i të dënuarve janë meshkuj:
  Për meshkujt është caktuar "punë në interes publik", në 62 vendime
  Për femrat është caktuar "punë në interes publik", në 15 vendime.

- Përsa i përket gjendjes arsimore
  Për të dënuarit të cilët janë në vazhdim të procesit mësimor janë dhënë 14 vendime:
  Me arsim të Ulët - 1 vendim

Me arsim 9 klasë - 1 vendim
Me arsim të Mesëm - 15 vendime
Me arsim të Lartë të përfunduar - 36 vendime

- Përsa i përket gjendjes gjyqësore
  Nga studimi i vendimeve vihet re se "puna në interes publik" zbatohet në përgjithësi tek personat të cilët nuk janë dënuar më parë për ndonjë vepër penale, dhe kjo ka lidhje me kriterin e përcaktuar në ligj "rrezikshmërinë e pakët të autorit".
  Vetëm një vendim i përket një të dënuari më parë.
- Nga studimi i vendimeve vihet re se "puna në interes publik" caktohet atëherë kur i pandehuri është prezent në gjykim dhe jep pëlqimin. Vihet re se ky gjykim është bërë në mungesë në dy raste.
- Përsa i përket vendimeve të ankimuara, vihet re se ka tre vendime të tilla.

Duke pasur parasysh faktin se "puna në interes publik" caktohet vetëm kur i pandehuri jep pëlqimin, paraqet interes njohja me ankimet përkatëse për të kuptuar se në cilat raste këto vendime mund të bëhen objekt ankimimi nga i pandehuri dhe si është qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Apelit.

9. KONKLUZIONE DHE SUGJERIME MBI RREGULLIMIN LIGJOR TË "PUNËS NË INTERES PUBLIK"

Nga studimi i standardeve ndërkombëtare, legjislacionit të brendshëm, praktikës gjyqësore dhe problematikave që janë shfaqur gjatë caktimit dhe fazës së ekzekutimit të "punës në interes publik", konkludojmë dhe sugjerojmë si më poshtë:

1. Shërbimi i Provës, si institucion kyç që mbikëqyr zbatimin e "punës në interes publik", duhet të rregullohet me ligj të veçantë.[97] Ky është një rekomandim i dhënë që më herët nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. Parashikimi me ligj specifik i këtij organi kaq të rëndësishëm do t'i sigurojë këtij institucioni një status të posaçëm juridik, si dhe

[97] *Rec CM/Rec (2017) 3 on the Europian Rules on community sanction and measures Rec CM/Rec (2010) 1 on the Council of Europe Probation Rules.*

mbështetje infrastrukturore dhe financiare të përshtatshme; që në fakt do të ndikojë në rritjen e efektivitetit të punës së Shërbimit të Provës me pasojë uljen e numrit të të dënuarve me burgim, që përkthehet në reduktim të kostove financare për mbajtjen e tyre në institucionet e paraburgimit.

2. Është i nevojshëm harmonizimi i K.Proc.Penale dhe ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", përsa i përket momentit se kur duhet të ekzekutohet "puna në interes publik".
3. Në kuadër të harmonizimi të legjislacionit tonë me legjislacionin ndërkombëtar, është e nevojshme të parashikohet dhe mundësia e rekrutimit të vullnetarëve nga ana e Shërbimit të Provës, përfshirja e të cilëve do të rriste rolin e përfshirjes së komunitetit në implementimin e masave alternative të dënimit me burgim[98]. Në këtë kuadër është e nevojshme të parashikohen rregulla për të përcaktuar kriteret dhe proceduren për përzgjedhjen e tyre, duke përfshirë këtu dhe zhvillimin e trajnimeve të përshtatshme.
4. Me përfundimin e punës në interes publik, dënimi konsiderohet i paqenë. Është e nevojshme të rregullohet me akte ligjore e nënligjore procedura e ekzekutimit të këtij momenti dhe pasojat që sjell fakti se "dënimi është i paqenë", në drejtim të vlerësimit të rrethanave rënduese në qoftë se ky person në të ardhmen kryen një vepër tjetër penale.
5. "Puna në interes publik" caktohet vetëm kur i dënuari jep pëlqimin. Të plotësohet me dispozita proceduriale penale fakti se deri në çfarë momenti duhet t'i kërkohet të pandehurit dhënia e pëlqimit. Nevoja për këtë plotësim del në kushtet kur i pandehuri mund të bëjë ankim para gjykatës së Apelit duke u shprehur se ka ndryshuar qëndrim përsa i përket dhënies së pëlqimit për të kryer punën në interes publik.
6. Në kuadër të rritjes së efektivitetit të caktimit të dënimit të "punës në interes publik", është e nevojshme të bëhen trasparente të dhënat përsa i përket rasteve për të cilat puna në interes publik, nuk ka qenë efektive dhe si rrjedhim të dënuarit janë kthyer në botën e krimit. Për të kuptuar shkaqet që kanë ndikuar në dështimin e kësaj mase alternative është e nevojshme të organizohen analiza të përbashkëta si dhe trajnime të të gjithë aktorëve të cilët merren me propozimin, caktimin dhe mbikëqyrjen e dënimit me "punë në interes pubik".

[98] *Shih "Text of the Rec CM/Rec (2017) 3 accompanied by its commentary" pika 85 "Use of volunteers"*

7. Sikundër është e nevojshme ngritja e Shërbimit të Provës në nivelin e institucioneve simotra në vendet evropiane, po aq e nevojshme është edhe rritja e transparencës dhe aksesit në të dhënat e Shërbimit të Provës, përsa i përket llogaridhënies së këtij institucioni në lidhje me standardin që ai përdor në mbikëqyrjen e të gjithë të dënuarve pa dallim, si edhe në raportimin për shkelje të detyrimeve nga ana e të dënuarve. Në kuadër të arritjes së këtij qëllimi është i nevojshëm investimi në infrastrukturë përsa i përket krijimit të një sistemi kompjuterik me qëllim kryqëzimin e të dhënave midis prokurorisë, gjykatave dhe Shërbimit të Provës, si dhe sigurimit të statitistikave të sakta dhe të plota në lidhje me caktimin e dënimit alternativ "punë në interes publik".

KAPITULLI V

NENI 64 - LIRIMI ME KUSHT

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI LIRIMIN ME KUSHT

Dënimet alternative përbëjnë një zhvillim relativisht të ri të së drejtës penale dhe janë krijesë e reformave të vazhdueshme të kësaj disipline të së drejtës, duke u gjetur në to zgjidhje nga ana e legjislatorëve, për mangësitë shumëplanëshe që ka treguar dënimi me burgim. Nëpërmjet tyre, legjislacionet bashkëkohore penale janë përpjekur të zgjidhin problemet e paefektshmërisë dhe ashpërsisë së panevojshme të sanksioneve penale klasike me natyrë represive. Prezantimi dhe formësimi i tyre sikur shfaqen sot në legjislacionet penale materiale apo procedurale, është meritë edhe i studimeve kriminologjike, penalogjike, sociologjike dhe ekonomike të efekteve të dënimit me burgim.[99]

Dobia e prezantimit të dënimeve alternative në politikën penale është e shumëfishtë, sikurse është e tillë edhe në efikasitetin e mirëadmistrimit të drejtësisë penale. Në aspektin filozofik, dënimet alternative janë mënyra më e drejtë për t'i dhënë kuptim praktik idealit rehabilitues. Në aspektin penal dhe kriminologjik, dënimet alternative janë mënyra më efektive për të parandaluar recidivizmin dhe për të shmangur infektimin kriminal në burgje. Në aspektin social dhe psikologjik, dënimet alternative ndihmojnë të dënuarin për të mbajtur lidhjet me familjen, punën dhe ambientin shoqëror

[99] *Shih Aleks Nikolli, "Dënimi penal: mes populizmit penal dhe drejtësisë" (Monografi), Botimet Fishta, Lezhë, Gusht 2016, faqe 172.*

dhe për të shmangur traumën psikike që shkakton burgimi. Në aspektin ekonomik, dënimet alternative ulin barrën e shoqërisë për të mbajtur të burgosurit, duke i orientuar këto fonde drejt programeve të parandalimit, përmes edukimit, përkrahjes sociale, punësimit, mjekimit etj. Ndërkohë në planin njerëzor, dënimet alternative rrisin respektin për dinjitetin e njeriut dhe për patjetërsueshmërinë e kësaj të drejte themelore.[100]

"Lirimi me kusht", në Kodin Penal në fuqi në Shqipëri, përfaqëson një nga alternativat e dënimit penal me burgim. Ligji ka parashikuar kushtet dhe kriteret me plotësimin e të cilave gjykata mundet ta akordojë lirimin me kusht. Përgjithësisht regjimi juridik i dënimit alternativ të "lirimit me kusht", parashikohet në nenin 64, 65 dhe 65/a të Kodit Penal. Megjithatë rregullimet procedurale të tij, apo edhe rregullime të tjera materiale, janë parashikuar në mënyrë komplementare nga Kodi i Procedurës Penale dhe nga Ligji nr. 8331/1998 "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*".

"Lirimi me kusht" është një institut dhe dënim alternativ me karakter riedukues, human, dhe social.[101] Objektivi kryesor i "lirimit me kusht" është riedukimi i të dënuarit, me kusht plotësimin e kërkesave specifike, **të** parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal. Ndërkohë që dënimi penal në vetvete, përmban elemente të teorive ndëshkuese dhe parandaluese të krimit, orientimi i tanishëm në shumë legjislacione penale evropiane, sidomos në lidhje me periudhën e fundit të vuajtjes së dënimit, fokusohet në riedukimin (ose risocializimin) e të dënuarit.[102]

Në veçanti lirimi me kusht i të dënuarit me burgim, përbën një mundësi dhe përfitim që ligji penal i jep të dënuarit me burgim, pas ekzekutimit të një pjese të dënimit, kur vërtetohet se përgjatë vuajtjes së dënimit ai ka dhënë prova konstante të sjelljes së mirë[103] dhe të besueshmërisë se ai është gati të risocializohet. *Ratio* e këtij instituti është e dyfishtë: *S*ë pari, të shpërblejë të dënuarin që ka treguar pendim; *së dyti*, të nxisë të dënuarit e tjerë të ndjekin shembullin e tij.[104] Themeli i këtij instituti të së drejtës penale është

[100] *Shih Aleks Nikolli, "Dënimi penal: mes populizmit penal dhe drejtësisë" (Monografi), Botimet Fishta, Lezhë, Gusht 2016, faqe 172.*

[101] *Shih Piro Terpo, Xhevdet Beqo, "Disa çështje mbi institutin e lirimeve para kohe me kusht të të dënuarve", Revista "Drejtësia Popullore" nr. 2, viti 1964, faqe 31.*

[102] *Shih çështjen "Vinter dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar", Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ, Ap. nr. 66069/09, 130/10 dhe 3896/10, Vendim i datës 09.07.2013, par 115.*

[103] Shih Luigi Delpino (magistrate di cassazione), "*Diritto Penale*", II Edizione, Studi Superiori, Universita e Specializzazioni, Edizioni Giuridiche Simone, Gruppo Editoriale Esselibri – Simone, Mapoli, 2010, faqe 1023.

[104] Idem.

mundësia e rehabilitimit të brendshëm të të dënuarit me kalimin e kohës, dhe relativizmi në këtë mënyrë i rrezikshmërisë shoqërore të tij.[105]

Karakteri "human" i lirimit me kusht lidhet me shmangien e ndëshkimit të panevojshëm dhe është pasqyrim i drejtpërdrejtë i një prej parimeve të Kodit Penal, parashikuar shprehimisht në nenin 1/c të tij.[106] Siç u përmend pak më lart, edhe vetë elementi ndëshkues në teorinë e së drejtës penale nuk duhet të konsiderohet si një "hakmarrje" e shoqërisë kundrejt autorit të veprës penale, por më tepër si një shprehje e shpagimit së kësaj të fundit në lidhje me sjellje të patolerueshme për një shoqëri civile dhe demokratike.

Në kushtet e arritjes së qëllimit kryesor të dënimit penal, pra riedukimit të të dënuarit, si dhe plotësimit të kushteve objektive të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, vazhdimi i vuajtjes së mëtejshme të dënimit do të konsiderohej si i panevojshëm dhe i padobishëm për shoqërinë. Për më tepër, edhe vetë masa e dënimit penal, është në vetvete një "parashikim" nga ana e gjykatës i kohës që konsiderohet e mjaftueshme për të arritur në riedukimin e të dënuarit, në raport kjo me rrezikshmërinë e veprës së kryer dhe të autorit të saj. Kjo kohë e mjaftueshme, mund të jetë e ndryshme për persona të ndryshëm; dhe pikërisht për këtë arsye, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e lirimit me kusht për këtë kategori të dënuarish, të cilët, pasi kanë vuajtur një pjesë të konsiderueshme të dënimit të dhënë, janë riedukuar plotësisht dhe nuk ekziston më nevoja për t'i mbajtur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.[107]

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vlerësuar se efektet "sociale" të lirimit me kusht, që kanë të bëjnë jo vetëm me qëllimin e përgjithshëm të lirimit me kusht - duke shërbyer si shembull për të dënuarit e tjerë që me punë dhe sjellje të mirë mund të lirohen me kusht - por edhe me fenomenin e mbipopullimit të burgjeve, duke ulur sadopak edhe barrën financiare të taksapaguesve për sistemin penitenciar[108], natyrisht duke mos u sakrifikuar objektivi kryesor, që është siguria e komunitetit ndaj

[105] Shih Vendimin nr. 343, datë 19.03.1991 të Seksionit I Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë. Shih Luigi Alibrandi, "*Codice Penale*", Trentatreesima Edizione, Casa Editrice La Tribuna, 2013, faqe 628.

[106] Neni 1/c (Parimet e Kodit Penal): "*Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe të humanizmit (theksim i Kolegjeve). Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.*"

[107] Shih Vendimin Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

[108] Vlen këtu të përmendet edhe Rekomandimi nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve, sipas të cilit "lirimi me kusht duhet të konsiderohet si instrumenti më efektiv dhe konstruktiv, i cili jo vetëm ul kohën e burgimit, por edhe kontribuon në mënyrë thelbësore në riintegrimin e të dënuarit në komunitet".

personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe detyrat e legjislacionit penal dhe parimet e Kodit Penal, parashikuar nga nenet 1/b dhe 1/c të Kodit Penal. Në këtë kuptim, autoritetet shtetërore duhet të përpiqen që të arrijnë riedukimin e të dënuarve sa më shpejt të jetë e mundur, duke evituar masa dënimi me karakter thjesht ndëshkues. Studime të shumta kanë treguar se zbatimi i "lirimit me kusht" është një nga mënyrat më efektive në arritjen e qëllimit ndëshkues, parandalues dhe riedukativ të dënimit penal.[109]

Pikërisht pjesa përfundimtare e dënimit me burgim të mbetur për t'u vuajtur, nga ana e ligjit, nëpërmjet dënimit alternativ të "lirimit me kusht", vihet në funksion të risocializimit të të dënuarit. Kjo pjesë e mbetur e dënimit pezullohet, duke i dhënë të dënuarit një liri të kushtëzuar në shoqëri, nën kërcënimin se nëse vërtetohen rrethana të tilla që çojnë në konkluzionin e kundërt, atëherë gjykata aktivizon detyrimin shtrëngues penal për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit. Konkluzioni që gjykata arrin në këto raste, mbi pendimin apo jo të të dënuarit, apo mbi risocializimin e tij apo jo, nuk është përfundimtar. Përkundrazi, fakti që lirimi me kusht zgjat për pjesën e mbetur të dënimit është caktuar pikërisht nga ligji, që nëpërmjet kontrollit të lirisë së kushtëzuar të të dënuarit në këtë kohë, gjykata të bindet plotësisht nëse ai është penduar apo jo.[110] Kjo do të thotë se afati i kushtit në lirinë me kusht, shërben që të konkludohet përfundimisht mbi vërtetësinë e pendimit dhe të risocializimit të të dënuarit.

Ndryshe nga dënimet e tjera alternative, "lirimi me kusht" jepet gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit dhe se nuk gjen fushë zbatimi në të gjitha llojet e dënimeve kryesore, por vetëm dy të tilla, konkretisht dënimin me burgim dhe dënimin me burgim të përjetshëm.

2. HISTORIKU I LIGJIT PENAL SHQIPTAR MBI "LIRIMIN ME KUSHT"

2.1. "Lirimi me kusht" në Kodin Penal të vitit 1995

Për herë të parë, "lirimi me kusht" është prezantuar në ligjin penal shqiptar si dënim alternativ nga Kodi Penal i vitit 1995[111], fillimisht i emërtuar

[109] Shih Memorandumin Shpjegues të Rekomandimit Rec (2003)22 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Lirimin me Kusht, faqe 11.

[110] Shih Vendimin nr. 343, datë 19.03.1999 të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[111] Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*". Sipas nenit 335 të këtij ligji,

"*lirimi para kohe me kusht*". Kodi Penal i vitit 1995, ka hyrë në fuqi me datë 01.06.1995. Ky dënim alternativ rregullohej në nenin 64[112] dhe 65[113] të Kodit Penal.

Fillimisht, neni 64 i Kodit Penal parashikonte se i dënuari me burgim mundet të lirohet para kohe me kusht nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, kur ka vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit të dhënë dhe me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij. Sikurse vihet re në variantin e parë të dispozitës kuadër të rregullimit të këtij dënimi alternativ, masa e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim ishte më minimalja e kërkuar ndonjëherë nga ligji shqiptar, vetëm gjysma e dënimit përfundimtar të dhënë. Gjithashtu ajo që tërheq vëmendje në formulimin e kësaj dispozite është fakti se ligji nuk kërkonte shkaqe të tjera justifikuese për zbatimin e "lirimit para kohe me kusht", veç konkluzioneve të gjykatës se i dënuari me sjelljen dhe punën e tij ka treguar se dënimi i vuajtur e ka arritur qëllimin për edukimin e tij. Të dy këto rregullime kanë qenë objekt ndryshimesh ligjore më vonë, duke rënduar kushtet e aksesit të të dënuarit në këtë lloj dënimi alternativ që Kodi Penal në fuqi parashikon.

Ajo që nuk ka ndryshuar nga dispozita kuadër e rregullimit të "lirimit me kusht", është ndalimi ligjor që në dënimin e detyrueshëm me burgim për t'u vuajtur, të përllogaritet koha e përfituar me amnisti apo falje.

Në variantin fillestar të formulimit të nenit 64, parashikohej një ndalesë kategorike për zbatimin e "lirimit para kohe me kusht", si dënim alternativ. Kështu nuk lejohej apriori zbatimi i këtij dënimi alternativ për të dënuarit përsëritës në krime.

Paragrafi i fundit i kësaj dispozite parashikonte edhe shkaqet se pse mund të revokohej "lirimi para kohe me kusht", duke rregulluar se lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari gjatë kohës së

Kodi Penal ka hyrë në fuqi me datë 01.06.1995.

[112] Kjo dispozitë parashikonte se: "*I dënuari me burgim mund të lirohet para kohe nga vuajtja e mëtejshme e dënimit kur: Ka vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit të dhënë dhe me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij. Në gjysmën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarit përsëritës në krime. Lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari gjatë kohës së kushtit kryen një vepër tjetër penale po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.*".

[113] Kjo dispozitë parashikonte se: "*Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm. Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet para kohe me kusht kur: Ka vuajtur jo më pak se njëzetepesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.*"

kushtit kryen një vepër tjetër penale po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

Neni 65 i Kodit Penal, në variantin fillestar të tij, parashikonte se si rregull nuk lejohet lirimi para kohe me kusht, i të dënuarit me burgim të përjetshëm. Megjithatë si përjashtim nga rregulli, vetëm në raste të jashtëzakonshme, i dënuari mundet të lirohej para kohe me kusht kur ka vuajtur jo më pak se njëzetepesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se është arritur qëllimi i dënimit për edukimin e tij.

Kjo mënyrë rregullimi ligjor, ka qenë në fuqi në Shqipëri nga data 01.06.1995 e deri më datë 12.03.2001.

2.1.1. Ndryshimi i parë ligjor

Ndryshimi i parë në Kodin Penal, për sa i përket dënimit alternativ të "lirimit me kusht", ka ndodhur në vitin 2001[114], ndryshim i cili ka hyrë në fuqi me datë 12.03.2001 dhe ka vepruar deri me datë 14.01.2009, datë në të cilën kanë hyrë në fuqi ndryshimet e dyta ligjore të këtij dënimi alternativ.[115] Me ndryshimin e parë ligjor të pësuar u prek vetëm neni 64 i Kodit Penal.

Lirimit para kohe me kusht iu shtua një shkak ligjor justifikues me karakter ekskluziv, duke u parashikuar se i dënuari me burgim mund të lirohet para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij. Sakaq, veç arritjes së qëllimit të edukimit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, Kodi Penal nga data 12.03.2001 e deri më

[114] Shih Ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"*. Ligji është shpallur me Dekretin nr. 2899, datë 13.2.2001 të Presidentit të Republikës se Shqipërisë Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, faqe 100, datë 26.02.2001, që do të thotë se ka hyrë në fuqi me datë 12.03.2001.

[115] Nga data 12.03.2001 deri me datë 14.01.2009 neni 64 i Kodit Penal formulohej:
"*Lirimi para kohe me kusht*
I dënuari me burgim mund të lirohet para kohe me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:
- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.
Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.
Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.
Lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve."

sot, kërkon detyrimisht edhe arsye të veçanta që justifikojnë "lirimin me kusht" të një të dënuari me burgim.

Gjithashtu në nenin 64 të Kodit Penal u ndryshua edhe ndalesa kategorike e zbatimit të dënimit alternativ të "lirimit me kusht", konkretisht paragrafi i tretë i kësaj dispozite. Legjislatori e kufizoi ndalesën kategorike të përfitimit të lirimit para kohe me kusht, vetëm tek të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, dhe jo më edhe për krime me dy format e fajësisë së pakujdesisë.

Më tej, ky ndryshim i parë ligjor i dënimit alternativ të "lirimit me kusht", detajoi periudhën e detyrueshme të dënimit për t'u vuajtur, para se të lindë e drejta për të kërkuar lirimin para kohe me kusht. Kështu, sipas këtij formulimi ligjor i dënuari me burgim mundet të kërkonte lirimin para kohe me kusht, pasi të kishte vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzetepesë vjet burgim.

Gjithashtu, ndryshimet e para ligjore të Kodit Penal në pjesën e lirimit me kusht, ndryshuan paragrafin e fundit të nenit 64. Kështu ky dënim alternativ duhet të revokohej vetëm nëse i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para. Në këtë mënyrë, variantit fillestar të dispozitës iu ndryshua si faktor determinant elementi i fajësisë apo ana subjektive e të dënuarit. Nëse më parë për revokimin e lirimit me kusht si dënim alternativ, ligji mjaftohej me elementin e barazisë së rëndësisë të veprës së dytë me të parën, tashmë ligji i kufizoi shkaqet e revokimit të lirimit me kusht vetëm në veprat penale po aq të rënda apo më të rënda të kryera me dashje.

2.1.2. Ndryshimi i dytë ligjor

Ndryshimi i dytë që "lirimi para kohe me kusht" si dënim alternativ në Kodin Penal në fuqi ka pësuar, ka qenë ai i vitit 2008[116], ndryshime të cilat

[116] Me Ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*". Ky ligj është shpallur me Dekretin nr. 5976, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Hyrja në fuqi 15 ditë pas

kanë hyrë në fuqi me datë 14.01.2009. Me këto ndryshime u riemërtua dënimi alternativ, nga "*lirimi para kohe me kusht*" në "*lirimi me kusht*", duke u hequr togfjalëshi "*para kohe*", edhe në nenin 64 dhe 65 të Kodit Penal. Ndryshimi më i rëndësishëm që ky ligj solli ishte heqja nga paragrafi i fundit i nenit 64 të Kodit Penal të togfjalëshit "*po aq të rëndë ose më të rëndë se e para*". Në këtë mënyrë ligjvënësi rivlerësoi kushtin e revokimit të dënimit alternativ, duke konkluduar se çdo vepër penale e kryer për së dyti, pavarësisht rëndësisë, mjafton të jetë kryer me dashje, do të shërbejë si shkak ligjor për revokimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht.[117]

2.1.3. Ndryshimi i tretë ligjor

Ndryshimi i tretë i Kodit penal në fuqi në pjesën e dënimit alternativ të lirimit me kusht, ka ardhur në vitin 2012[118] dhe ka hyrë në fuqi me datë 11.04.2012. Për herë të parë në historinë e legjislacionit të së drejtës penale shqiptare, u prezantua në Kodin Penal një institut i quajtur "*Periudha e sigurisë*", nëpërmjet të cilit gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendoste një periudhë gjatë së cilës nuk do të lejohej zbatimi nga i ekzekutimit të

botimit në Fletoren Zyrtare. Fletore Zyrtare Nr. 190, Faqe 9395, datë 31.12.2008, që do të thotë se ka hyrë në fuqi me datë 14.01.2009.

[117] Nga data 14.01.2009 e deri me datë 04.06.2013 neni 64 i Kodit Penal formulohej:
"*Lirimi me kusht*
I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:
- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.
Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.
Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.
Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.".
Ndërkohë gjatë periudhës së individualizuar më lart, neni 65 i Kodit Penal në këtë periudhë formulohej:
"*Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.*
Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur: Ka vuajtur jo më pak se njëzetepesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.".

[118] Shih Ligjin nr. 23/2012 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*". Sipas Nenit 59 të këtij ligji, ai ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe është miratuar në datën 1.3.2012. Ligji është Shpallur me Dekretin nr. 7341, datë 20.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është botuar në Fletore Zyrtare nr. 26, datë 27.03.2012 dhe për rrjedhojë ka hyrë në fuqi me datë 11.04.2012.

nenit 64 të Kodit Penal, edhe pse kushtet kumulative të nenit 64 të Kodit Penal, mund të ekzistonin. Pikërisht kjo periudhë e caktuar paraprakisht nga gjykata në momentin e dhënies së vendimit të dënimit me burgim, u quajt nga neni 65/a i Kodit Penal, si periudha e sigurisë.[119] Në çdo rast periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata, deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.

Ky disponim i posaçëm i gjykatës së çështjes së themelit në vendimin përfundimtar të dënimit me burgim, vendoset në rastet kur ekziston një nga rrethanat e mëposhtme:

- vepra penale, masa e dënimit të së cilës është mbi pesë vjet;
- kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
- kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
- kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
- kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

2.1.4. Ndryshimi i katërt ligjor

Ndryshimi i katërt ligjor në Kodin Penal mbi dënimin alternativ të lirimit me kusht, është bërë në vitin 2013[120]. Ky ndryshim ka hyrë në fuqi me datë 04.06.2013.

---

[119] Pas nenit 65 të Kodit Penal u shtua neni 65/a, duke u formuluar se:
"*Neni 65/a*
Periudha e sigurisë
Gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:
a) vepra penale, masa e dënimit të së cilës është mbi pesë vjet;
b) kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
c) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
ç) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
d) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.
Periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.".

[120] Shih Ligjin nr. 144/2013 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*". Neni 49 i këtij ligji ka parashikuar se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji është miratuar në datën 2.5.2013, është shpallur me Dekretin nr. 8176, datë 14.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është botuar në Fletoren Zyrtare datë 20.05.2013 dhe ka hyrë në fuqi me datë 04.06.2013.

Ndryshimi më i rëndësishëm i vitit 2013 ishte ndërhyrja në paragrafin 3 të nenit 64 të Kodit Penal.

Nëpërmjet kësaj shtese ligjore u shtuan ndalimet absolute të zbatimit të dënimit alternativ të lirimit me kusht. Kështu, krahas ndalesës absolute të përfitimit të "lirimit para kohe me kusht" për të dënuarit recidivistë për krime të kryera me dashje, lirimi para kohe me kusht nuk mundet të zbatohej kategorikisht edhe për veprat penale të parashikuar nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, apo paragrafi i tretë i nenit 100.[121] Thënë ndryshe, ndryshimi i katërt i nenit 64 të Kodit Penal parashikoi se ndalohej kategorikisht zbatimi i dënimit alternativ të "lirimit me kusht" për të dënuarit për veprat penale:

- Vrasja për gjakmarrje[122];
- Vrasja e funksionarëve publikë[123];
- Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit[124];
- Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare[125];
- Marrëdhënie seksuale apo homoseksuale me të mitur[126].

[121] Neni 64 i Kodit Penal nga data 04.06.2013 e deri me datë 20.05.2017 formulohej:
"*I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:*
- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.
Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.
Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.
Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.".

[122] Neni 78/a i Kodit Penal parashikon se: "*Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[123] Neni 79/a i Kodit Penal parashikon se: "*Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[124] Neni 79/b i Kodit Penal parashikon se: "*Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[125] Neni 79/c i Kodit Penal parashikon se: "*Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[126] Neni 100 paragrafi i tretë i Kodit Penal parashikon se: "*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

2.1.5. Vendimi Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka nisur një gjykim unifikues mbi një nga dënimet alternative të parashikuara në Kodin Penal, konkretisht lirimi me kusht, duke qenë se ka pasur interpretime dhe zbatime të ndryshme të gjykatave mbi nenin 64 dhe 65 të Kodit Penal. Çështjet që u shtruan për t'u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara ishin:

a. *Në mungesë të një përkufizimi në Kodin Penal, çfarë do të kuptohet me shprehjen "arsye të veçanta" të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në procesin penal me objekt lirimin para kohe me kusht?*
b. *Në rastin kur pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, a duhet gjykata të caktojë gjithashtu një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë? Nëse po, sa duhet të jetë ky afat i mbajtjes në provë?*

Lidhur me çështjen e parë të shtruar për unifikim të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin unifikues, se:

"*Ligjvënësi duke përdorur shprehjen "arsye të veçanta" ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto "arsye të veçanta" nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit para kohe me kusht, i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe "arsyet e veçanta" nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal*, në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.".

Lidhur me çështjen e dytë të shtruar për unifikim të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në konkluzionin e unifikimit të praktikës gjyqësore, se:

"*Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale" ajo cakton një periudhë*

kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal.

Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.".

2.1.6. Konstatimet dhe objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë mbi lirimin me kusht

Në analizën e sistemit të drejtësisë, që i parapriu paketës kushtetuese dhe ligjore të ndryshimeve që solli reforma, është konkluduar se rritja e përdorimit të dënimit me burgim si për krimet serioze edhe për ato me rrezikshmëri të ulët, mund të sjellë që ky dënim të humbë vlerën reale të tij. Ligji penal duhet të jetë i ashpër për vepra penale të dhunshme, që cenojnë jetën/shëndetin, që drejtohen ndaj të miturve/grave, dhe duhet të jetë fleksibël për veprat e tjera të një rëndësie më të vogël, duke aplikuar edhe alternativat e dënimit me burgim. Kuadri ligjor për dënimet alternative nuk është përmirësuar për të garantuar zbatimin korrekt, shmangien e abuzimit dhe qëllimin edukativ të tyre.[127]

Lidhur me lirimin para kohe me kusht, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe më tej edhe Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, kanë vlerësuar se mbetet problematik lirimi para kohe me kusht, i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, për të cilin nuk është përfshirë edhe një kufizim sipas llojit të veprave penale përveçse sipas masës së dënimit të caktuar.[128]

Gjithashtu është vlerësuar me shqetësim edhe fakti që, në praktikën gjyqësore ekzistojnë rastet kur një dënim alternativ jepet për të gjykuarit dhe të dënuarit në mungesë. Me shqetësim është konstatuar fakti se, në ligj mungon një parashikim fiks për të përcaktuar limitin kohor se deri kur mundet të paraqitet kërkesa e prokurorit për revokimin e dënimit alternativ, dhe se gjithashtu nuk ka një parashikim fiks ligjor për të konkluduar se kur nis momenti i mbikëqyrjes në raport me kohëzgjatjen

[127] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 157.

[128] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 158.

e dënimit alternativ, dhe se këto të dy momente duhet të ishin parashikuar nga ligji si të përputhura në kohë.[129]

Lidhur me Shërbimin e Provës është konstatuar se nuk ka një rregullim të posaçëm ligjor si institucion, duke iu referuar edhe standardeve ndërkombëtare[130]; se pozita procedurale e Shërbimit të Provës nuk është e tipizuar dhe e qartësuar në rregullimet ligjore; se ligji nuk parashikon qartë rastet se kur është i detyrueshëm raporti i Shërbimit të Provës dhe nuk përcakton në asnjë vend se çfarë vlere kanë këto raporte në procesin penal.[131]

Lidhur me "mbikëqyrjen elektronike" është konstatuar se nuk ka kritere të qarta ligjore në lidhje me rastet e aplikimit të saj, në përputhje me standardet evropiane. Ndërkohë analiza ka konstatuar se Shërbimi i Provës, bazuar në nenin 60 të Kodit Penal, nuk kryen një kontroll dhe mbikëqyrje efektive të të gjithë detyrimeve që vendosen në dispozitivin e vendimit të gjykatës, duke qenë se në raportet e hartuara prej tij, në pjesën më të madhe të tyre, ka të dhëna të pasqyruara vetëm në evidentimin e kontakteve që ka mbajtur i dënuari me Shërbimin e Provës dhe se mungojnë të dhëna për sa i përket detyrimeve të tjera të vendosura nga gjykata, sikurse janë p.sh. detyrimi i të dënuarve për të marrë një formim profesional, apo detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës etj., për shkak të pamundësisë për t'i zbatuar ato si pasojë e mungesës së infrastrukturës, bashkëpunimit institucional, ashtu edhe për shkak të mosparashikimit të qartë ligjor të detyrimeve të Shërbimit të Provës në të tilla raste.[132]

Lidhur me dënimet alternative, në analizën e sistemit të drejtësisë është konstatuar se Kodi Penal nuk parashikon aktualisht marzhe dënimi për të cilat është i detyrueshëm zbatimi i dënimit alternativ nga gjykata, duke e parë si problematike situatën ligjore ku nuk parashikohet sistemi i zbatimit të detyrueshëm të një dënimi alternativ.[133]

---

[129] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 164 dhe 174.

[130] Shih "*Recommendation CM/Rec (2010) 1 of the Committee of Ministers to member states on the Council of Europe probation rules*".

[131] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 164 – 165.

[132] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 174.

[133] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i

Në këtë analizë është konstatuar me shqetësim fakti që, Kodi i Procedurës Penale nuk ka parashikuar rregullime për mënyrën se si gjykata realizon bashkimin e dënimeve të ndryshme, konkretisht një dënimi me burgim dhe një dënimi alternativ me kusht, duke sjellë në vëmendje edhe interpretimet e ndryshme të prokurorisë dhe gjykatës në këtë çështje.[134]

Lidhur me "burgimin e përjetshëm", në analizën e sistemit të drejtësisë e vetmja problematikë që u konstatua është fakti që në nenet 109 paragrafi 3, 109/b/ 3, 221 dhe 334/3, ky dënim ka mbetur si i vetëm si sanksion ligjor, duke sjellë në vëmendje kontrastin e këtyre parashikimeve ligjore me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese që ka konkluduar se dënimet fikse penale janë jokushtetuese.[135]

2.1.7. Ndryshimi i pestë ligjor

Ndryshimi i pestë i rregullimeve ligjore mbi dënimin alternativ të lirimit me kusht në Kodin Penal, është bërë në vitin 2017. Ky ndryshim u bë si pasojë e paketës ligjore të hartuar nga grupet e punës së ekspertëve në kuadrin e ndryshimeve normative të reformës së sistemin e drejtësisë. Ky ndryshim ligjor ka hyrë në fuqi me datë 20.05.2017.[136]

Në nenin 64 të Kodit Penal është ndryshuar nënparagrafi i tretë, duke u parashikuar se dënimi alternativ i "lirimit me kusht" mundet të kërkohet kur i dënuari ka vuajtur jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni. Nga ana tjetër, ndërhyrja e pestë e ligjvënësit në nenin 64 të Kodit Penal shtoi një paragraf të ri, si paragraf të pestë dhe të fundit të dispozitës, duke rregulluar në mënyrë edhe më të detajuar shkaqet e rishikimit apo të revokimit të dënimit alternativ të lirimit me kusht. Kështu në këtë paragraf të shtuar rishtazi në nenin 64 të Kodit Penal, u parashikua se gjykata e urdhëron të

Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 173.

134 Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 173.

135 Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 154 dhe 157.

136 Shih Ligjin nr. 36/2017 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*". Në Nenin 14 parashikohet se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare. Ligji është miratuar në datën 30.3.2017, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98, datë 05.05.2017, që do të thotë se ka hyrë në fuqi me datë 20.05.2017.

dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës, ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirimin para kohe me kusht.

Ndërhyrja e pestë ligjvënëse në dënimin alternativ të lirimit me kusht, preku edhe nenin 65 të Kodit Penal. Qëllimi i ligjvënësit ishte vendosja e koherencës ndërmjet parashikimeve të vetë Kodit Penal dhe përditësimi i kësaj dispozite me dispozitat e tjera. Fillimisht duhej që neni 65 i Kodit Penal, në periudhën minimale dhe të detyrueshme për vuajtjen e dënimit me burgim, me qëllim zbatimin e lirimit para kohe me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm, të përqasej me periudhën e maksimumit të dënimit me burgim, i cili që nga viti 2013, me ndryshimet e nenit 32 të Kodit Penal, ishte përcaktuar në masën 35 vjet. Nga ana tjetër, në vitin 2013 ishte ndërhyrë në paragrafin e tretë të nenit 64 të Kodit Penal, duke ndaluar kategorikisht mundësinë e zbatimit të lirimit me kusht për disa lloje veprash penale, dhe se kjo ndalesë nuk parashikohej në nenin 65 të Kodit Penal, aty ku rregullohej në mënyrë të posaçme aksesi i të dënuarve me burgim të përjetshëm tek dënimi alternativ i lirimit me kusht.

Për të mundësuar këto qëllime, ligjvënësi ndryshoi paragrafin e dytë të nenit 65 të Kodit Penal, duke parashikuar se për të kërkuar lirimin me kusht nga ana e të dënuarve me burgim të përjetshëm duhet që ato të kenë vuajtur jo më pak se 35 vjet burgim. Më tej, pas paragrafit të dytë është shtuar një paragraf i tretë, i cili parashikon se të dënuarit me burgim të përjetshëm për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100, ndalohen kategorikisht të përfitojnë nga burgimi i përjetshëm.

Ky është ndryshimi i fundit i bërë në Kodin Penal tek pjesa e rregullimeve ligjore mbi dënimin alternativ të lirimit me kusht.[137]

2.2. Rregullimi ligjor material në fuqi i lirimit me kusht

Me gjithë problematikat e konstatuara ndër vite dhe për të cilat ndërhynë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligjvënësi nuk e preku nenin 64

[137] Deri në momentin kur puna për këtë Manual po kryhej, Mars 2020.

të Kodit Penal për të parashikuar një afat për kohëzgjatjen e periudhës së kushtit. Ligjvënësi as nuk referoi në mënyrë eksplicite në nenin 59 të Kodit Penal për të plotësuar këtë boshësi ligjore që ka ekzistuar në ligjin penal shqiptar që nga viti 1952.

Sot baza ligjore e rregullimit normativ të dënimit alternativ të lirimit me kusht është fillimisht neni 64, i cili formulohet si vijon:

"*I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:*

- *jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;*
- *jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;*
- *jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.*

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirimin para kohe me kusht."

Sot neni 65 i Kodit Penal formulohet:

"*Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.*

Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur: Ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet

burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.

Nga ky rregull, përjashtohen të dënuarit për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100.".

Sot neni 65/a i Kodit Penal formulohet:

"*Gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:*

a) vepra penale, masa e dënimit të së cilës është mbi pesë vjet;
b) kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
c) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
ç) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
d) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale. Periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.".

3. STANDARDE TË KËSHILLIT TË EVROPËS MBI LIRIMIN ME KUSHT

3.1. Standardet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi trajtimin e të dënuarve me burgim

Neni 10 i Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike, i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ka parashikuar se të gjithë personat e privuar nga liria duhet të trajtohen me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin human. Më tej, pika 3 e kësaj dispozite parashikon se regjimi penitenciar duhet të jetë i tillë ku qëllimi kryesor të jetë ndryshimi dhe riklasifikimi i tyre social. Në Observacionin e Përgjithshëm nr. 21 (1992), Komiteti i të Drejtave të Njeriut i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka vlerësuar se asnjë sistem penitenciar nuk duhet të synojë vetëm ndëshkimin e të

dënuarve. Synimi thelbësor i tyre duhet të jetë riadresimi dhe ripërshtatja sociale e të dënuarve.[138]

Tërësia minimum e rregullave të vitit 1957, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të dënuarve, afirmojnë parimet e përgjithshme për trajtimin e të dënuarve duke njohur se qëllimi dhe justifikimi i dënimeve dhe masave provuese të lirisë është mbrojtja e shoqërisë kundër krimit. Por në të njëjtën kohë këto rregulla njohin nevojën e shtetit që mënyra e ekzekutimit të dënimit penal të jetë e tillë që, të mundësojë të dënuarin ta riintegrojë në shoqëri pas lirimit, duke përdorur të gjitha mjetet efektive, morale, shpirtërore, kurative dhe të gjitha mënyrat e asistencës për trajtimin e duhur dhe individual të të dënuarit që duhet të rikthehet në mënyrë progresive në shoqëri.

Në këtë mënyrë, administrata penintenciare duhet të ketë përgatitur dhe të ushtrojë projekte dhe një regjim përgatitor për të mundësuar fitimin e lirisë me kusht të të dënuarve, e cila fillimisht duhet të jetë një liri e kushtëzuar derisa të përgatiten kushtet për fitimin e lirisë së plotë. Ekzekutimi i dënimit, sipas këtyre standardeve, nuk duhet të synojë vetëm përjashtimin shoqëror të të dënuarit por përgatitjen e tij për risocializim. Ky trajtim duhet të jetë i tillë që të zhvillojë vullnetin dhe aftësitë profesionale të të dënuarit, në mënyrë që pas fitimit të lirisë ato të jetojnë me përgjegjësi, me nder dhe t'i përgjigjen nevojave të tyre me dinjitet. Ato sjellin në vëmendje metoda të tilla si: asistenca sociale dhe psikologjike individuale, këshilla relevante për punësimin, zhvillimi edukativ dhe fizik dhe të karakterit moral dhe edukim teologjik, sipas nevojave personale të çdo të dënuari, për t'i ofruar atyre perspektiva riklasifikimi.

3.2. Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht

Konventa e Këshillit të Evropës për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht është miratuar nga Kuvendi dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2000.[139] Kjo Konventë ka bërë realitet ndërmjet shteteve të Këshillit

[138] Shih paragrafin 10 në Observacionin e Përgjithshëm nr. 21 (1992) të Komitetit të të Drejtave të Njeriut i Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi nenin 10.

[139] Shih Ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000 "*Për ratifikimin e "Konventës Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht*", shpallur me Dekretin nr. 2859, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani. Shih në web: http://www.pp.gov.al/web/konventa_evropiane_për_mbikëqyrjen_e_personave_të_dënuar_ose_të_liruar_me_kusht_1374.pdf.

të Europës që, të mundësohet ekzekutimi i dy prej dënimeve alternative të dënimit me burgim, konkretisht venia në provë e të dënuarit nëpërmjet pezullimit të dënimit me burgim dhe lirimi me kusht. Kjo Konventë ka parashikuar se, nëse individi ka deklaruar si vendbanim apo si rezidencë një adresë jashtë territorit të shtetit ku ai është dënuar, atëherë mundet të lejohet që ekzekutimi i dënimit alternativ të ekzekutohet nga shteti ku ai ka rezidencën.[140]

Konventa ka parashikuar se në këto raste, autoritetet gjyqësore të shtetit ku do të ekzekutohet dënimi alternativ, duhet ta konvertojnë atë duke e përshtatur me parashikimet ligjore të brendshme, respektive dhe relevante të tyre. Shteti ku dënimi alternativ ekzekutohet, nuk mundet të rëndojë dënimin, qoftë nëpërmjet shtimit të masave apo kohëzgjatjes së provës apo kushtit. Megjithatë, në rast se i dënuari gjatë kohës së lirisë së kushtëzuar shkel detyrimet ligjore apo gjyqësore apo kryen vepër penale, atëherë autoritetet kompetente të shtetit ku ekzekutohet dënimi kanë kompetencë të plotë për të ndryshuar dënimin alternativ apo për ta revokuar atë kur është rasti.

Kur kërkesa për ekzekutimin e vendimit të dënimit alternativ të vënies në provë apo në kusht pranohet nga shteti i kërkuar, atëherë shteti i kërkuar pushon ekzekutimin e dënimit. Kërkesa për mbikëqyrje apo për ekzekutimin e dënimit alternativ të vënies në provë, shoqërohet me origjinalin ose me kopjen autentike të vendimit që përmban arsyet që kanë motivuar mbikëqyrjen dhe specifikon masat që i vihen të dënuarit. Ajo saktëson, me aq sa është e mundur, rrethanat e veprës penale që ka motivuar vendimin e mbikëqyrjes, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin ligjor të saj, dhe kur kjo është e nevojshme, kohëzgjatjen e sanksionit për ekzekutimin. Në kërkesë duhet të jepen të gjitha të dhënat për natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të mbikëqyrjes që kërkohen për t'u ekzekutuar. Kërkesa përmban referenca në dispozitat ligjore të zbatueshme dhe të dhënat e nevojshme mbi personalitetn e keqbërësit dhe mbi sjelljen e tij në shtetin kërkues, para dhe pas dhënies së vendimit për mbikëqyrje.

Shteti kërkues dhe Shteti i kërkuar informojnë, kur është e nevojshme, reciprokisht njëri-tjetrin për çdo rrethanë që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes në territorin e Shtetit të kërkuar, ose vënien në ekzekutim të dënimit në këtë Shtet. Gjithashtu Konventa ka parashikuar

[140] Neni 6 i kësaj Konvente parashikon se: "*Me kërkesë të Shtetit që ka dhënë dënimin, mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë, të përcaktuara nga neni i mëparshëm, përmbushen nga Shteti në territorin e të cilit keqbërësi ka caktuar vendbanimin e zakonshëm të tij.*".

se në këto raste Shteti i kërkuar njofton menjëherë Shtetin kërkues për vendimin që autoriteti kompetent disponon mbi kërkesën për ekzekutimin e dënimit alternative me mbikëqyrje.

3.3. Rekomandimi kuadër i Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht

Rekomandimi Rec (2003) 22 i Këshillit të Europës[141] përmban rregullat e përgjithshme dhe kuadër, të mënyrës se si legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës duhet ta regjojnë juridikisht lirimin me kusht. Qëllimi i këtij rekomandimi ka qenë vendosja e parimeve të përbashkëta Evropiane përsa i përket mënyrës se si do të ekzekutohen vendimet e dënimit me burgim në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi i shteteve në këtë fushë. Në pjesën e preambulës së këtij akti juridik, lirimi me kusht vlerësohet të jetë një nga mjetet më konstruktive për të planifikuar dhe për të promovuar riintegrimin e të dënuarit në shoqëri, duke vlerësuar se lirimi me kusht duhet të zbatohet në përputhje me rrethanat konkrete dhe me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë. Në preambul është mbajtur parasysh se, kosto financiare që shoqëria përballon për administrimin e sistemit penitenciar është e madhe dhe se burgimi nuk është i vetmi mjet që mundet të arrijë rehabilitimin e të dënuarve, duke dashur që çdo dënim me burgim të përfundojë sa më shpejt dhe para kohe, kur vlerësohet se dënimi ka arritur qëllimet e tij.

Në pjesën e parë të rekomandimit lirimi me kusht përkufizohet si lirimi para mbarimit të dënimit me burgim i të dënuarit nën masat e individualizuara të post-lirimit të kushtëzuar. As falja dhe as amnistia, nuk përfshihen në konceptin e Rekomandimit si forma të lirimit me kusht. Sipas këtij akti, lirimi me kusht duhet të synojë që të realizojë për të dënuarin një tranzicion nga jeta në burg në jetën e lirë në komunitet, nëpërmjet masave të post-lirimit dhe nën mbikëqyrjen e organeve kompetente, me qëllim që të kontribuohet në sigurinë publike dhe në reduktimin e krimit në komunitet.

Në pjesën e dytë, në pikën 4/a, Rekomandimi parashikon se lirimi me kusht duhet të jetë mundësi përfitimi për të gjithë të dënuarit, duke përfshirë edhe të dënuarit me burgim të përjetshëm. Ndërkohë në pikën 5 të kësaj pjese, Rekomandimi parashikon se që në nisjen e vuajtjes së dënimit me burgim, të dënuarit duhet të dinë nëse ato mundet të përfitojnë nga lirimi me kusht se dhe sa është periudha minimale e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me

[141] Shih në web: https://rm.coe.int/16800ccb5d.

burgim që ato duhet të kryejnë, në mënyrë që të kërkojnë lirimin me kusht. Pika 6 e kësaj pjese të Rekomandimit parashikon se periudha minimale dhe e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim, me qëllim lindjen e së drejtës për të kërkuar lirimin me kusht, nuk duhet të jetë shumë e gjatë sa që të pamundësohet arritja e qëllimit të vetë lirimit me kusht.

Lidhur me masat që mund të merren për të shmangur riskun e recidivizmit, pika 8 e pjesës së dytë të Rekomandimit parashikon se, mundet që i dënuari të ngarkohet me pagimin e një kompensimi ndaj viktimës, vendosjen e tij në një regjim trajtimi dhe rehabilitimi ndaj alkoolit apo drogës, pjesëmarrjes së tij në aktivitete edukative apo profesionale dhe në programe zhvilluese, apo duke e ndaluar atë të qëndrojë apo të vizitojë vende të caktuara. Në pikën 9 të Rekomandimit parashikohet se lirimi me kusht duhet të shoqërohet me mbikëqyrje që konsiston në ndihmë dhe kontroll dhe se kohëzgjatja dhe intensiteti i mbikëqyrjes duhet të përshtatet sipas çdo rasti, duke mundësuar ndryshime të kohës dhe të masave përgjatë periudhës së kohëzgjatjes së kushtit. Lidhur me kohëzgjatjen e kushtit, pika 10 e Rekomandimit parashikon se, ajo nuk mundet të jetë proporcionalisht më e madhe sesa pjesa e mbetur dhe e pezulluar e dënimit me burgim.

Lidhur me përgatitjen për lirim me kusht, pika 12 parashikon se punonjësit e institucionit të vuajtjes së dënimit dhe ato të mbikëqyrjes së post-lirimit, duhet të bashkëpunojnë ngushtë dhe se ato duhet të konkludojnë mbi të dënuarin para mbarimit të periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim dhe para periudhës së kohëzgjatjes së kushtit. Për përgatitjen e të dënuarve për lirim me kusht, pika 13 dhe 14 parashikon se mundet të zbatohet ndaj tyre regjimi i gjysmë-lirisë apo pjesëmarrja në trajnime për edukim, duke krijuar kushtet për mbajtjen e kontakteve me familjen apo të afërmit dhe duke promovuar mbajtjen e kontakteve me organizatat jofitimprurëse, duke ofruar mundësinë e dhënies së formave të ndryshme të lejeve nga burgu.

Pjesa IV e Rekomandimit njeh dy sisteme të lirimit me kusht, lirimi me kusht diskrecionar dhe lirimi me kusht i detyrueshëm. Lidhur me lirimin me kusht diskrecionar, Rekomandimi parashikon se periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim, me qëllim që të lindi e drejta e të dënuarit për të kërkuar lirimin me kusht, duhet të parashikohet në ligj dhe se autoritetet kompetente duhet të nisin procedurat e nevojshme për të mundësuar një vendim mbi lirimin me kusht sapo kjo periudhë të jetë plotësuar. Rekomandimi në pikën 18 kërkon që kriteret ligjore për

akordimin e lirimit me kusht duhet të jenë të qarta, eksplicite dhe realiste, duke qenë në përputhje me personalitetin e të dënuarit, jetën e tij sociale dhe rrethanat ekonomike, sikurse edhe duke pasur parasysh disponueshmërinë e programeve të risocializimit.

Pika 19 e Rekomandimit parashikon se mungesa e mundësisë së punësimit nuk mundet të shërbejë si shkak për refuzimin apo shtyrjen e lirimit me kusht dhe se duhet të bëhen përpjekje për të gjetur mënyra të tjera të përfshirjes së të dënuarit në aktivitete profesionale. Gjithashtu kjo pikë parashikon se edhe mungesa e një rezidence të rregullt akomodimi nuk mundet të përbëjë shkak refuzimi apo shtyrje për lirimin me kusht, pasi në këto raste, edhe akomodimi i përkohshëm dhe provizor mundet të konsiderohet i mjaftueshëm.

Pika 20 e Rekomandimit parashikon se gjykatat duhet të zbatojnë kriteret ligjore të lirimit me kusht në mënyrë të barabartë për të gjithë të dënuarit që vlerësohen se përmbushin nivelin minimum për të qenë qytetarë që respektojnë ligjin dhe se barra e provës për të provuar të kundërtën duhet të bjerë mbi autoritetet shtetërore. Pika 21 e Rekomandimit parashikon se, nëse autoriteti kompetent vendos të mos akordojë lirimin me kusht, duhet të caktojë një datë për të rivlerësuar nëse janë përmbushur apo jo kriteret ligjore, dhe se të burgosurit duhet të jenë në gjendje të ribëjnë kërkesën për lirim para kohe me kusht sa më shpejt të jetë e mundur, në raport me konkluzionin se situata e tyre ka ndryshuar pozitivisht dhe substancialisht.

Ndërkohë sistemi i detyrueshëm i lirimit me kusht, i rregulluar nga pika 22 – 24, parashikon se periudha minimale dhe e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim duhet të fiksohet në ligj dhe se vetëm në situata të jashtëzakonshme të përcaktuara nga ligji, mundet të shtyhet kjo datë. Shtyrja duhet të bëhet me vendim të organit kompetent, duke përcaktuar njëkohësisht një datë të re.

Pjesa e V e Rekomandimit rregullon vendosjen e kushteve apo masave, që i dënuari do të jetë i detyruar të respektojë gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Në pikën 25 parashikohet se në vlerësimin e kritereve ligjore të lirimit me kusht, për autoritetin kompetent vendimmarrës duhet të jenë të disponueshëm çdo relacion apo raport që ka dokumentuar sjelljen e të dënuarit me perspektivën e lirimit të tij. Autoriteti vendimmarrës duhet të sigurohet se i dënuari i kupton kushtet e vendosura në vendimin e lirimit me kusht dhe duhet t'i tregojë atij se çfarë pasojash do të ketë në rast se detyrimet nuk përmbushen gjatë kohës së kushtit.

Pjesa VI e Rekomandimit parashikon parimet që duhet të ndiqen gjatë ekzekutimit të vendimit të lirimit me kusht, ku përcaktohet se duhet të ekzistojë një organ mbikëqyrës dhe duhet të respektohen rregullat Evropiane mbi masat dhe sanksionet komunitare. Qëllimi i mbikëqyrjes duhet të jetë asistenca ndaj të dënuarit, orientimi i tij drejt risocializimit dhe rehabilitimit të plotë dhe parandalimi i rikthimit të tij në aktivitet të paligjshëm.

Pjesa VII e Rekomandimit parashikon rregullime të përgjithshme mbi masat që duhet të merren, kur konkludohet se i dënuari nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Në pikën 30 parashikohet se shkeljet e lehta të detyrimeve nga ana e të dënuarit duhet të marrin përgjigje me anë të këshillimit apo të paralajmërimeve nga organet që zhvillojnë mbikëqyrjen e të dënuarit. Ndërsa shkeljet serioze të detyrimeve duhet të raportohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme tek autoritetet kompetente, të cilat duhet të ndërmarrin masat respektive kundër të dënuarit proporcionalisht me rëndësinë e shkeljes, deri në revokimin e lirimit me kusht.

Pjesa VIII e Rekomandimit ka rregulluar në mënyrë të përgjithshme garancitë procedurale për shqyrtimin e kërkesave për lirim me kusht. Në pikën 32 parashikohet se vendimet e pranimit, shtyrjes apo të revokimit të lirimit me kusht, duhet të merren nga organet kompetente të parashikuara me ligj, sikurse edhe vendimet për shtimin e detyrimeve ndaj të dënuarit, duke ofruar gjatë shqyrtimit të kërkesave disa garanci procedurale, si:

- Garantimi i së drejtës për t'u dëgjuar personalisht për të dënuarit me burgim apo për t'u përfaqësuar sipas ligjit;
- Vlerësim dhe arsyetim i kujdesshëm i çdo rrethane që ndikon në vendimmarrjen mbi lirimin me kusht;
- Garantimin e eksesit të përshtatshëm mbi dosjen gjyqësore;
- Vendimet duhet të arsyetohen dhe të njoftohen;
- Kundër vendimeve që refuzojnë dhe revokojnë lirimin me kusht duhet të parashikohet e drejta e ankimit, qoftë për aspektin material dhe procedural të çështjes, në një organ të pavarur të parashikuar në ligj.

3.4. Rekomandimi mbi masat komunitare

Rekomandimi CM/Rec (2017) 3 i Këshillit të Evropës mbi rregullat Evropiane për dënimet dhe masat komunitare[142] ka njohur lirimin me kusht si një ndër

[142] Shih në web: https://rm.coe.int/168070c09b#:~:text=No%20community%20sanction%20or%20

masat dhe dënimet alternative dhe komunitare të dënimit me burgim dhe se nxit shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në zbatimin efektiv të kësaj forme të posaçme të vuajtjes së dënimit penal me qëllim riaftësimin social të individit të dënuar. Në pikën 2 të këtij akti është parashikuar se, shtetet kanë diskrecion për të prezantuar në legjislacionin e tyre penal material dhe procedural një shumëllojshmëri të masave dhe dënimeve komunitare, duke këmbëngulur në gjetjet e të gjitha mekanizmave të ndryshëm që eliminojnë kthimin apo vijimin e vuajtjes së dënimit me burgim. Në pikën 12 të këtij akti juridik parashikohet se, nuk duhet të ketë parashikime ligjore penale materiale apo procedurale që të urdhërojnë revokimin automatik të masave komunitare dhe konvertimin e tyre në dënime me burgim. Megjithatë, ky kufizim nuk ndalon ligjvënësit që të parashikojnë zbatimin e dënimit me burgim për të liruarit me kusht që nuk konformohen apo shkelin detyrimiet gjatë periudhës së kushtit.

3.5. Standardet e Këshillit të Evropës për dënimet afatgjata me burgim

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, duke nisur nga viti 1976 ka miratuar një seri rezolutash dhe rekomandimesh lidhur me të dënuarit që vuajnë dënime të gjata dhe të përhershme. Në Rezolutën nr. 76 (2), datë 17.02.1976, e para në këtë lëndë, Komiteti i Ministrave i rekomandoi shteteve anëtare që dënimet e përjetshme penale të shoqëroheshin me masa ligjore apo administrative të tilla që të favorizonin një trajtim të përshtatshëm të të dënuarve gjatë ekzekutimit të tyre. Gjithashtu Komiteti i Ministrave i kërkoi shteteve që të parashikonin mekanizma ligjorë që të mundësonin rishqyrtime të dënimeve penale të përjetshme sa më shpejt të jetë e përshtatshme dhe e nevojshme, në mënyrë që të konkludohej nëse është e mundur apo jo për të akorduar për të dënuarit, lirimin me kusht.[143]

Në këtë akt konkludohej se, vetëm një konsideratë ligjore e parandalimit të përgjithshëm dhe e interesit publik nuk mund të mjaftonte që ligji i secilit shtet të ndalonte mundësimin e lirimit me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm, dhe se secili shtet duhet të parashikonte kritere ligjore se si këto të dënuar të aksesonin një mundësi të tillë ligjore.[144] Në të njëjtën kohë, nëpërmjet këtij akti u rekomandua që dënimi me burgim të përjetshëm të kishte rregullim

measure,human%20rights%20of%20all%20concerned.

[143] Shih pikën 9 të Rekomandimit nr. 76 (2), datë 17.02.1976 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

[144] Idem, shih pikën 10.

të njëjtë sikurse ligji parashikon për dënimet e gjata.[145] Për më tepër, në pikën 12 të kësaj Rezolute rekomandohej që shtetet të siguronin një mekanizëm rikontrolli periodik dhe të vazhdueshëm mbi dënimet me burgim të përjetshëm, duke sugjeruar se pas 8 apo 14 vitesh të vuajtjes së dënimit me burgim, do të konsiderohej e përshtatshme aktivizimi i këtij mekanizmi ligjor rikontrolli.

3.6. Standardet e Këshillit të Evropës për administrimin penitenciar

Për më tepër, Rregullat Penitenciare Evropiane të vitit 2006, që përbëjnë një tekst thelbësor relevant në këtë fushë të Këshillit të Evropës, parashikojnë se çdo dënim penal duhet të administrohet në atë mënyrë që të ndihmojë risocializimin e të dënuarit në shoqëri në liri të plotë.[146] Kjo Rregullore parashikon se trajtimi i çdo të dënuari duhet të konceptohet nga autoritetet shtetërore në mënyrë të tillë që të dënuarit të realizojnë një jetë të përgjegjshme dhe larg krimit.[147]

Kjo Rregullore parashikon detyrimin e autoriteteve penitenciare që nga momenti i dorëzimit të të dënuarit të hartojnë një plan individual të vuajtjes së dënimit, duke përshkruar situatën personale, projektin e ekzekutimit të dënimit që rrjedh nga situata personale sociale dhe psikologjike dhe të përgatitet gjithashtu plani dhe projekti i ofrimit të lirisë. Në këtë rregullore parashikohet se shtetet duhet t'u kushtojnë një vëmendje të veçantë të dënuarve me afat të gjatë dhe me burgim të përjetshëm.[148] Më tej rregulli nr. 107 parashikon se, për të dënuarit me burgim të gjatë apo me burgim të përjetshëm duhet të merren masa për të garantuar një zhvillim progresiv në shoqëri dhe liri dhe se autoritet penitenciare duhet të punojnë ngushtë me të gjitha organizmat qeveritare dhe joqeveritare për ta bërë të mundur këtë.

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, me datë 09.10.2003, ka miratuar Rekomandimin 2003 (23) "Mbi administrimin penitenciar të të dënuarve me burgim të përjetshëm dhe për të dënuarit me periudha të gjata"[149], në të cilin preambula parashikon se miradministrimi penitenciar nënkupton arritjen e një ekuilibri të arsyeshëm mbi nevojën për ruajtjen

[145] Idem, shih pikën 11.
[146] Shih Rregullin nr. 6 të Rregullores Penintanciare Europiane.
[147] Idem, rregulli nr. 102.
[148] Idem, rregulli 103.
[149] Shih në web: https://www.ochrance.cz/fileadmin/user_upload/ochrana_osob/Umluvy/vezenstvi/R_2003_23_management_of_life_sentence_and_long-term_prisoners.pdf.

e sigurisë së institucioneve penintenciare dhe nga ana tjetër plotësimin e nevojës për të garantuar të dënuarit me një përgatitje konstruktive në funksion të risocializimit dhe rifitimit të lirisë. Më tej, pika 2 e Rekomandimit nxit shtetet që administrimi penitenciar të ofrojë kushtet për përmirësimin e mundësisë së këtyre të dënuarve për të fituar me kalimin e kohës lirinë dhe risocializimin në kushtet e një jete të respektueshme sipas ligjit.

Ky rekomandim nxit shtetet që të mbajnë parasysh se, aktet normative që rregullojnë sistemin penintenciar duhet të synojnë zbatimin e disa parimeve, si:

1) parimi i individualizimit, që nënkupton respektimin e secilit individualitet të të dënuarve dhe krijimin e planeve individuale të ecurisë së dënimit penal;
2) parimi i progresionit, që nënkupton garantimin e një trajtimi të tillë të secilit prej të dënuarve për të siguruar risocializimin dhe progresin në rehabilitim, me qëllim për të mundësuar një tranzitim të natyrshëm nga jeta në burg, në jetën në liri dhe në shoqëri.

Në pikën 10 të këtij Akti rekomandohet që faza e fundit e këtij plani të individualizuar dhe progresiv duhet të jetë rivendosja e të dënuarit në liri me kusht në shoqëri, ku masat e mbikëqyrjes të mundësojnë për të zhvillimin e një jete të virtytshme dhe dinjitare për të realizuar përshtatjen e tij me shoqërinë dhe jetën nën liri, pas mbarimit të periudhës së lirisë së kushtëzuar. Më tej, pika 16 risjell në vëmendje se rëndësia e krimit dhe parandalimi i përgjithshëm nuk mundet të jenë arsyet e vetme që të justifikojnë pamundësimin e fitimit të lirimit me kusht të këtyre të dënuarve, dhe se ato duhet të kenë mjete juridike që të kërkojnë periodikisht rishqyrtimin e dënimit penal. Këto konsiderata konkludohen edhe në paragrafet 33 dhe 34 të Rekomandimit, duke treguar edhe masat respektive që duhet të merren nga shtetet.

3.7. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës për dënimet me burgim të përjetshëm

Raporti CPT (2007) 55, datë 27.06.2007 i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës me titull "*Dënimet me burgim të përjetshëm*", konkludon ndër të tjera se nuk mundet që të dënuarit me burgim të përjetshëm të përjashtohen apriori nga e drejta për të rifituar në të ardhmen lirinë. Në raport arsyetohet se, nuk

mund të vlerësohet apriori se të dënuarit me burgim të përjetshëm do të mbesin gjithnjë të rrezikshëm për shoqërinë dhe se atyre nuk mundet t'i eliminohet çdo mundësi për të shpresuar për të rifituar lirinë, duke konkluduar se refuzimi i lirimit me kusht nga një organ shtetëror nuk duhet të jetë kurrë definitiv, por i rishikueshëm në procedura dhe kushte të qarta dhe të mirëpërcaktuara në ligj.

Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës ndaj Zvicrës[150], në kushtet kur ligji penal material i Federatës së Zvicrës parashikonte dënime me burgim të përjetshme pa të drejtë lirimi me kusht dhe si të tilla të parishqyrtueshme, solli në vëmendje rezerva serioze, duke vlerësuar se konsiderimi përgjithmonë dhe apriori i këtyre të dënuarve si të rrezikshëm dhe parashikimi i dënimeve me burgim të përjetshëm të pandryshueshëm, eliminojnë çdo shpresë tek të dënuarit për të pasur mundësinë e ardhshme të fitimit të lirisë dhe në këto kushte ato nuk kanë asnjë mundësi për të influencuar me sjelljen e tyre në rishikimin e dënimit penal. Për rrjedhojë, ky raport sjell në vëmendje mungesën e koherencës ndërmjet parashikimeve ligjore zviceriane dhe standardeve që kanë vendosur rekomandimet dhe rezolutat e Këshillit të Europës, si mbi sistemin penintenciar dhe lirimin me kusht, duke konkluduar se ky dënim penal është çnjerëzor dhe duke sugjeruar autoritetet kompetente zvicerane të rishikojnë kuadrin ligjor përkatës.

3.8. Standarde të së drejtës penale ndërkombëtare

3.8.1. Statuti i Romës

Statuti i Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare Penale, në nenin 77 e njeh mundësinë e dhënies së dënimit me burgim të përjetshëm. Por në të njëjtën kohë, në nenin 110 parashikon mundësinë e fitimit të lirisë me kusht për këto të dënuar, nën kushtet e kalimit paraprakisht dhe detyrimisht të një afati prej 25 vitesh burgim. Gjykata Ndërkombëtare Penale, pas kalimit të afatit 25 vjet të vuajtjes së dënimit me burgim, rishqyrton dënimin dhe vendos nëse duhet të akordohet apo jo lirimi me kusht. Në këtë dispozitë jepen edhe disa kritere në të cilat Gjykata Ndërkombëtare Penale mundet të akordojë lirimin me kusht, duke mbajtur parasysh ndryshimin e rrethanave objektive dhe individuale të të dënuarit, sjelljen e kontributeve të tij në zbulimin e rrethanave të reja të faktit penal apo edhe rregullimi i pasojave të ardhura nga vepra penale apo marrëdhëniet me viktimat.

[150] Shih Raportin CPT/Inf (2012) 26, datë 25.10.2012.

Rregullat e tjera të akordimit të lirimit me kusht janë të parashikuara në Rregulloren e Procedurës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Këto kërkesa të të dënuarve merren në shqyrtim nga një trupë gjykuese prej 3 gjyqtarësh, në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme çdo tre vjet nga momenti kur është dhënë vendimi. Trupa gjyqësore, sipas nenit 223 të Rregullores, vlerëson;

- kualitetin e sjelljes së të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit dhe nëse ka treguar ai me sjelljen e tij se i ka mohuar krimet nëpërmjet pendimit;
- mundësinë e risocializimit dhe të rikthimit të suksesshëm në shoqëri pa pasoja të mëdha sociale;
- perspektivën e lirisë së të dënuarit me kusht, në raport me pasojat që mundet të vijnë tek viktimat e veprës penale dhe veprimet e tij në raport me përmirësimin e marrëdhënies me viktimat e veprave penale;
- situatën personale të të dënuarit, duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore, mendore, morale apo moshën e tij të thyer.

3.8.2. Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë dhe për Sierra Leonen

Neni 27 i Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë parashikon se, vuajtja e dënimit për të dënuarit me burgim të përjetshëm do të bëhet në një institucion penitenciar të një shteti të zgjedhur nga vetë Tribunali, duke u zbatuar për fazën e ekzekutimit të vendimit penal, ligji i ekzekutimit i shtetit ku vuhet dënimi. Në këtë normë parashikohet se uljet e dënimit apo ndryshimet e dënimit penal, do të mundet të përfitohen nga i dënuari vetëm pasi të jetë njoftuar më parë Tribunali dhe pasi trupa gjykuese të ketë vlerësuar pozitivisht këtë ndryshim, sipas interesave të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Zgjidhje të ngjashme i gjejmë edhe në nenin 26 dhe 27 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për Ruandën, në nenin 22 dhe 23 të Statutit të Tribunalit Special për Sierra Leonen dhe në nenin 29 dhe 30 të Statutit të Tribunalit Special për Libanin.

3.8.3. E drejta e Bashkimit Evropian

Neni 5, pika 2, e Vendimit-Kuadër të Urdhërit të Arrestit Evropian dhe procedura e parashikuar nga shtetet anëtare dhe e adoptuar nga Komisioni i Bashkimit Evropian me datë 13.06.2002, parashikon se nëse vepra penale për të cilën është lëshuar urdhri i arrestit evropian dënohet me burgim

të përjetshëm, shteti urdhërdhënës duhet të ketë parashikuar në ligjin e brendshëm procedura rishqyrtimi të këtij dënimi të paktën pas kalimit të një afati prej 20 vjetësh të vuajtjes së dënimit me burgim, apo i dënuari duhet të ketë akses efektiv në masa të tjera procedurale që ulin dënimin e tij. Në këtë mënyrë, duket se realiteti juridik i Bashkimit Evropian ka mundësuar dhe ka kushtëzuar shtetet anëtare që të parashikojnë mekanizma proceduralë të rishqyrtimit periodik të dënimit me burgim të përjetshëm.

4. JURISPRUDENCË NDËRKOMBËTARE MBI RISHQYRTIMIN E DËNIMIT PENAL ME BURGIM

4.1. Jurisprudenca e GJEDNJ

GJEDNJ ka konkluduar gjithnjë se dënimi me burgim të përjetshëm nuk është i papajtueshëm në vetvete me nenin 3 të KEDNJ; se dënimi me burgim të përjetshëm përbën shkelje kur nuk ka asnjë mekanizën ndryshimi të rregulluar në ligj, nëpërmjet të cilit individit t'i jepet mundësia *de jure* dhe *de facto* të rifitojë lirinë gjatë vuajtjes së dënimit.[151] Ekzistenca e një mekanizmi të tillë ligjor, funksional si *de jure* dhe *de facto*, sipas GJEDNJ, bën që të konkludohet se nuk ka shkelje të nenit 3 të KEDNJ, në këtë lloj dënimi me burgim të përjetshëm.[152]

GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se edhe falja nga kryetari i shtetit mundet të përbëjë mjet efektiv për arritjen e qëllimit të garantimit të një mekanizmi të tillë ligjor për fitimin e lirisë për të dënuarit me burgim të përjetshëm, kur provohet se ky mekanizëm është *de facto* i aksesueshëm dhe që ka pasur raste kur të dënuar me burgim të përjetshëm janë falur nga kryetari i shtetit. GJEDNJ vlerësoi se çështjet e mënyrës funksionale dhe administrative të administrimit të drejtësisë penale, përsa i përket procedurës së shqyrtimit të kërkesave për lirim para kohe me kusht, nuk mundet të hyjnë në juridiksionin e vlerësimit të saj, pasi janë çështje që i përkasin marzhit të vlerësimit dhe lirisë sovrane të qeverisjes së çdo shteti.[153]

[151] Shih çështjen "*Hill v. the United Kingdom*" (dec.), Ap. no. 19365/02, Vendim i GJEDNJ, datë 18.03.2003.

[152] Shih çështjen "*Kafkaris v. Cyprus*"Ap. No. 21906/04, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ, datë 12.02.2008.

[153] Shih çështjen "*Kafkaris v. Cyprus*"Ap. No. 21906/04, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ, datë 12.02.2008. Shih gjithashtu çështjen "*Harakchiev et Tolumos c. Bulagie*", req. nr. 15018/11 et 61199/12, Vendim i Seksionit IV të GJEDNJ, datë 08.07.2014.

GJEDNJ ka vlerësuar se shtetet janë të lira që në raste të rënda të aplikojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe se ky dënim nuk mundet të konsiderohet që në vetvete vjen në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ, sikurse nuk vjen në kundërshtim me dispozita të tjera të KEDNJ, edhe sikur ajo të konsumohet tërësisht sikurse është dhënë nga gjykata, pasi KEDNJ i vendos detyra shteteve që të marrin masa për të mbrojtur publikun nga krimet e rënda.[154] Megjithatë GJEDNJ ka vlerësuar se një dënim penal i pandryshueshëm gjatë ekzekutimit të tij mundet të shfaqë probleme përputhshmërie me nenin 3 të KEDNJ.[155]

GJEDNJ ka vlerësuar se ka shumë arsye që edhe të dënuarve me burgim të përjetshëm duhet t'i ofrohet një mundësi lirie me kalimin e kohës dhe gjatë vuajtjes së dënimit, nëpërmjet rishqyrtimit të tij, pasi ekuilibri i nevojës për ndëshkim dhe risocializimit nuk mundet të prezumohet se mbetet i pandryshueshëm përjetësisht sikur në momentin e dhënies së dënimit me burgim të përjetshëm, dhe se këto ndryshime mundet të identifikohen rast pas rasti vetëm nëpërmjet procedurave të rishqyrtimit të dënimit.[156] GJEDNJ ka vlerësuar se, megjithëse në momentin e shqiptimit të dënimit, burgimi i përjetshëm mundet të ketë qenë plotësisht i nevojshëm dhe proporcional, rrethanat subjektive dhe objektive të ndryshuara gjatë viteve mundet ta shndërrojnë atë dënim si jo më të nevojshëm, të dëmshëm, shumë të rëndë dhe aspak proporcional.

GJEDNJ ka konkluduar se, që dënimet me burgim të përjetshëm të konsiderohen të pajtueshme me nenin 3 të KEDNJ, duhet që ligji i brendshëm të parashikojë mundësi që të lejojë autoritetet shtetërore t'i rishqyrtojnë ato përgjatë ekzekutimit, në mënyrë që të shqyrtohet progresi i arritur në rrugën e ndryshimit dhe të shqyrtohet nëse ka akoma motive të karakterit penalogjik që justifikojnë vijimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.[157]

Duke pasur parasysh marzhin e vlerësimit që i lejohet shteteve anëtare për administrimin e drejtësisë penale, GJEDNJ ka konkluduar se ajo nuk

[154] Shih affaire "*Vinter et autres c. Royaume-Uni*", Req. no. 66069/09, 130/10 et 3896/10, CEDH, d. 9 Juillet 2013, faqe 39, paragrafi 108. Shih gjithashtu çështjen "*Mastromatteo c. Italie*" , no. 37703/97, paragrafi 72, Grande Chambre CEDH 2002-VIII.

[155] Shih çështjen "*Nivette v. France*" (dec.), ap. no. 44190/98, Vendim i GJEDNJ, ECHR 2001VII; çështjen "*Stanford v. the United Kingdom*" (dec.), ap. no. 73299/01, Vendim i GJEDNJ, datë 12.12.2002; dhe çështjen "Ëynne v. the United Kingdom" (dec.), ap. no. 67385/01, Vendim i GJEDNJ, datë 22.05.2003.

[156] Idem, paragrafi 111.

[157] Idem, paragrafi 119.

mundet të arrijë në përfundime nëse një autoritet i tillë shtetëror duhet apo jo të jetë ekskluzivisht gjyqësor, apo mundet të jetë edhe administrativ. Në të njëjtën kohë GJEDNJ konkludoi se, për të njëjtat arsye, ajo nuk mundet të arrijë në përfundime se sa duhet të jetë koha kur një rishqyrtim i dënimit me burgim të përjetshëm duhet të realizohet. Megjithatë ajo solli në vëmendje se, një afat 25 vjeçar i detyrueshëm i vuajtjes së dënimit me burgim, pak a shumë, është i gjithëpranuar në rendin juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, njëkohësisht duke iu dhënë mundësia e ushtrimit të rishqyrtimit të dënimit në mënyrë periodike.[158]

GJEDNJ ka konkluduar se një i dënuar me burgim të përjetshëm ka të drejtë të dijë, që nga fillimi i vuajtjes së dënimit të dhënë, se çfarë duhet të bëjë ai në mënyrë që në një të ardhme të ketë mundësi të fitojë lirinë dhe të risocializohet, duke qenë në gjendje të dijë edhe kur mundet ta kërkojë lirinë dhe se si.[159] Në këtë mënyrë, GJEDNJ ka arritur në konkluzionin se, nëse një shtet nuk e parashikon në ligjin e brendshëm një mundësi të tillë rishqyrtimi për dënimin me burgim të përjetshëm, atëherë papajtueshmëria e dënimit të dhënë me nenin 3 të KEDNJ do të konkludohet se ekziston që nga momenti i dhënies së dënimit, dhe jo nga momenti kur kalon afati potencial për të kërkuar lirimin, apo jo nga momenti kur realisht i dënuari plotëson kushtet ideale për të përftuar lirinë me kusht.[160]

GJEDNJ ka vlerësuar se neni 3 i KEDNJ ka natyrë absolute dhe nga detyrimet e kësaj dispozite nuk mundet të cedohet, duke konfirmuar se shtetet anëtare kanë detyrë dhe përgjegjësi sipas kësaj dispozite, nëse lejojnë largimin e personave nga territori i tyre në një shtet tjetër ku mundet të shkelen standardet e nenit 3 të KEDNJ, pavarësisht nevojës së madhe dhe legjitime që shtetet kanë për të ndërmarrë masa për të parandaluar apo zbuluar veprat penale terroriste. Në këtë kuptim, këto detyrime shteti i ka pavarësisht formës juridike që mundet të përdoret për të larguar një individ nga territori i tij; qoftë ekstradim, qoftë dëbim apo ndonjë mekanizëm tjetër i parashikuar në ligj.[161] Për rrjedhojë GJEDNJ ka gjetur përgjegjësi për shkelje të nenit 3 të KEDNJ tek shteti anëtar i Këshillit të Evropës që

[158] Idem, paragrafi 120.

[159] Shih çështjen "*Harakchiev et Tolumos c. Bulagie*", req. nr. 15018/11 et 61199/12, Vendim i Seksionit IV të GJEDNJ, datë 08.07.2014

[160] Idem, paragrafi 122.

[161] Shih çështjen "*Harkins et Edëards c. Royaume Uni*", ap. nr. *9146/07 dhe 32650/07*, Seksioni IV i GJEDNJ, Vendim datë 17.01.2012. Shih gjithashtu çështjen "*Babar Ahmad c. Royaume Uni*", ap. nr. *24027/07, 11949/08, 36742/08, 66911/09 and 67354/09*, Seksioni IV i GJEDNJ, datë 10.04.2012.

vendos të ekstradojë një person edhe pse ka të dhëna që në shtetin kërkues ai do të jetë subjekt i shkeljeve të kësaj dispozite.[162]

GJEDNJ ka vlerësuar disa herë çështjen e lejueshmërisë së ekstradimit në raste kur, pas realizimit të kësaj procedure i gjykuari mundet të dënohej me burgim të përjetshëm dhe në të gjitha rastet ka marrë në analizë garancitë relevante diplomatike të dhëna nga shteti kërkues apo edhe parashikimet e ligjeve materiale apo procedurale të këtyre shteteve, për të konkluduar sakaq nëse ka mundësi reale dhe juridike që i dënuari me burgim të përjetshëm të kërkojë lirinë në të ardhmen apo rishqyrtim të dënimit me burgim.[163]

GJEDNJ më parë ka pranuar se momenti që duhet të vlerësohet si shkelje e nenit 3 të KEDNJ për dhënien e një dënimi me burgim të përjetshëm të pandryshueshëm, duhet të jetë pikërisht momenti kur dënimi shqiptohet.[164] Megjithatë GJEDNJ ka vlerësuar gjithashtu se ajo nuk mundet të ndjekë këtë qasje jurisprudenciale për zgjidhjen e problematikës së dënimeve të pandryshueshme me burgim të përjetshëm në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, e konkretisht në rastet e ekstradimit.

Kështu, kjo jurisprudencë ka vlerësuar se në rastet e ekstradimit do të duhet që qasja e vlerësimit të shkeljeve eventuale të nenit 3 të KEDNJ, të analizohet edhe para se të jepet dënimi apo edhe para se subjekti të gjykohet, duke dashur sakaq të mbahet një interpretim i tillë që të garantojë parandalimin e shkeljes së kësaj dispozite të KEDNJ, duke u kthyer tek filozofia e vlerësimit në jurisprudencën "*Soering c. Royaume Uni*". Ky vlerësim *ex ante* dhe jo *post facto,* sipas GJEDNJ duhet të jetë i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat dhe autoritetet administrative të shteteve të cilët shqyrtojnë dhe vendosin mbi kërkesën për ekstradim, me qëllim që të garantohet respektimi i nenit 3 të KEDNJ. Për rrjedhojë, është konkluduar se ekstradimi në këto kushte i shtetasit të kërkuar në një shtet ku dënimi me burgim të përjetshëm është i pandryshueshëm, do të cenonte nenin 3 të KEDNJ.[165]

---

[162] Shih çështjen "*Mamatkoulov et Askarov c. Tuquie*", ap. nr. 46827/99 nr. 46951/99, paragrafi 67, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ, viti 2005.

[163] Shih çështjen "*Nivette v. France*" (dec.), ap. no. 44190/98, ECHR 2001-VII; çështjen "*Einhorn v. France*" (dec.), ap. no. 71555/01, ECHR 2001-XI; çështjen "*Salem v. Portugal*" (dec.), ap. no. 26844/04, Vendim i GJEDNJ dat 9 Maj 2006; çështjen "*Olaechea Cahuas v. Spain*", ap. no. 24668/03, ECHR 2006-X; dhe çështjen "*Schuchter v. Italy*" (dec.), ap. no. 68476/10, Vendim i GJEDNJ, datë 11 Tetor 2011.

[164] Shih për shembull çështjen "*Harkins et Edëards c. Royaume Uni*", ap. nr. *9146/07 dhe 32650/07*, Seksioni IV i GJEDNJ, Vendim datë 17.01.2012. Shih gjithashtu çështjen "*Babar Ahmad c. Royaume Uni*", ap. nr. *24027/07, 11949/08, 36742/08, 66911/09 and 67354/09*, Seksioni IV i GJEDNJ, datë 10.04.2012. Gjithashtu shih çështjen "*Vinter et autres c. Royaume-Uni*", Req. no. 66069/09, 130/10 et 3896/10, CEDH, d. 9 Juillet 2013.

[165] Shih çështjen "*Trabelsi c. Belgique*", Req. N. 140/10, Seksioni V i GJEDNJ, Vendim datë 4 Shtator

GJEDNJ ka vlerësuar se shtetet kanë detyrimin pozitiv të ofrojnë mjetet dhe mekanizmat ligjorë se si mundet që të dënuarit me burgim të përjetshëm të rifitojnë lirinë nëpërmjet riedukimit dhe risocializimit të tyre, dhe nuk kanë detyrimin pozitiv lidhur me rezultatet që të dënuarit mundet të arrijnë gjatë vuajtjes së dënimit. Në këtë kuptim, GJEDNJ ka vlerësuar se kushtëzimi i lirisë me kusht *sine qua non* për të dënuarit me burgim të përjetshëm për bashkëpunimin me drejtësinë dhe me provimin e faktit se kanë shkëputur lidhjet me organizatat kriminale, nuk i heq karakteristikat e trajtimit çnjerëzor këtij dënimi penal dhe se vjen në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ. [166]

GJEDNJ ka vlerësuar se mbivlerësimi dhe kushtëzimi *sine qua non* i kushtit të bashkëpunimit me drejtësinë dhe shkëputjes së lidhjeve kriminale, sakrifikon deri në asimilim, riedukimin dhe risocializimin e të dënuarit, duke konkluduar se personaliteti i të dënuarit nuk mundet të prezumohet në ligj se mbetet i ngurtë përgjatë gjithë kohës së vuajtjes së dënimit, pasi personaliteti evoluon me kalimin e kohës, sikurse e koncepton funksioni legal i risocializimit së të dënuarit, dhe se për këtë qëllim risocializimi duhet të kushtëzohet me premisa të tilla që t'i përgjigjen kërkesave për riedukim dhe rikonstruktim të personalitetit, në mënyrë që i dënuari të dijë paraprakisht se çfarë kërkohet nga ai për të rifituar lirinë në të ardhmen.[167]

4.2. Jurisprudencë e gjykatave kushtetuese në Evropë

Në shtete të ndryshme të Europës ka pasur edhe jurisprudencë të gjykatave më autoritative mbi pajtueshmërinë me kushtetutën apo të drejtën ndërkombëtare të dënimit të pandryshueshëm me burgim të përjetshëm.

Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë ka arsyetuar se shteti nuk mundet ta shndërrojë individin në një shembull dhe objekt për të ndaluar kriminalitetin duke sakrifikuar në të njëjtën kohë të drejtat e tij kushtetuese të cilat janë garantuar sepse përfaqësojnë një vlerë të shoqërisë. Ajo ka vlerësuar se një dënim penal është çnjerëzor nëse nuk i ofrohet të dënuarit një mundësi konkrete dhe realiste për të rifituar në një të ardhme lirinë, duke vlerësuar se risocializimi i kujtdo të dënuari përbën një detyrim kushtetues kundrejt

2014 i shndërruar në vendim definitiv në datë 16 Shkurt 2015, paragrafi 130.

166 Shih çështjen "*Marcello Viola c. Italie N. 2*", Req. No. 77633/16, Seksioni I, Vendim i GJEDNJ, datë 13.06.2019.

167 Shih çështjen "*Marcello Viola c. Italie N. 2*", Req. No. 77633/16, Seksioni I, Vendim i GJEDNJ, datë 13.06.2019.

dinjitetit të individit. Sipas kësaj jurisprudence, nuk mundet që ecuria e dënimit të shkëputet nga analiza individuale e zhvillimit të personalitetit të të dënuarit, duke mbetur vetëm në vlerësimin dhe konsideratën e nxjerrë apriori dhe në mënyrë të përgjithshme mbi rrezikshmërinë e veprës dhe nevojën për të realizuar parandalimin e përgjithshëm. Gjykata Kushtetuese Gjermane ka vlerësuar se Kushtetuta nuk e përjashton apriori mundësinë e vuajtjes së një dënimi me burgim të përjetshëm, por kjo mundësi duhet të justifikohet rast pas rasti nga analiza e personalitetit dhe e sjelljes së të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit.[168]

Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë ka trajtuar nëpërmjet gjykimit incidental çështjen e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 211 të Kodit Penal të Republikës Federale të Gjermanisë, konkretisht të parashikimit ligjor të dënimit me vdekje.[169] Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se dënimi penal kërkon shkallën më të lartë të drejtësisë dhe se çdo dënim penal duhet të lidhet proporcionalisht me rrezikshmërinë e veprës penale. Shteti nuk mundet ta kthejë individin në një objekt të parandalimit të krimit, në dëm të së drejtës së tij kushtetuese për vlerësim dhe respekt social, duke mbrojtur prezumimet themelore që udhëheqin ekzistencën individuale dhe sociale të personit njerëzor. Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane ka vlerësuar se në ekzekutimin e dënimeve penale shtetit i kërkohet respektimi i dinjitetit njerëzor, që do të thotë respektimin e asaj ekzistence minimale të jetës së një qenieje njerëzore dhe se do të ishte e patolerueshme që shteti ta privonte forcërisht nga liria një person, pa i siguruar atij të paktën një mundësi reale për ta rifituar më vonë atë.

Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane ka konkluduar se shteti ka detyrë jo vetëm të burgosë por edhe të rehabilitojë të burgosurit, duke iu dhënë mundësia të dënuarit që ka paguar për krimin e tij për të rihyrë në shoqëri. Zbatimi human i burgimit të përjetshëm arrihet vetëm atëherë kur të burgosurit i jepet realisht një mundësi për rifitimin e lirisë dhe se mosdhënia e kësaj mundësie cenon dinjitetin njerëzor, pasi e zhvesh të burgosurin nga të gjitha shpresat për të fituar lirinë dhe se dispozitat ligjore që rregullojnë faljen e dënimit penal nuk e arrijnë këtë qëllim kushtetues. Mungesa e gjatë dhe e vazhdueshme e lirisë është një barrë e jashtëzakonshme fizike dhe psikologjike, që mund të rezultonte në një dëmtim substancial

[168] Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane 72 BVerfGE 105, viti 1986.

[169] Shih Vendimin 45 BVerfGE 187, viti 1977 të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

të personalitetit të të burgosurit dhe kjo është një arsye kushtetuese se pse duhet të njihet e drejta e lirimit.[170]

Ky debat kushtetues është zhvilluar edhe në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Italisë. Gjykata Kushtetuese Italiane la vlerësuar se nuk mundet të konkludohet se dënimi me burgim të përjetshëm është apriori në kundërshtim me Kushtetutën, por se ky dënim, nëse nuk shoqërohet me mundësi konkrete për të dënuarit për të rifituar lirinë në të ardhmen dhe nëse kjo mundësi nuk i atribuohet pushtetit gjyqësor dhe nën kushte të qarta dhe të aksesueshme, do të konsiderohet se është çnjerëzor dhe si i tillë jokushtetues.[171]

Gjykata Kushtetuese Italiane ka shfuqizuar edhe nenin 177 të Kodit Penal, i cili ndalonte kategorikisht mundësinë e zbatimit të lirisë me kusht për të dënuarin për së dyti gjatë kohës së kushtit. Kjo jurisprudencë ka vlerësuar se nuk mundet të jetë i pajtueshëm me Kushtetutën një dënim me burgim të përjetshëm që nuk lë asnjë mundësi për të dënuarin për të kërkuar lirimin në të ardhmen, duke vlerësuar se dënime të tilla janë çnjerëzore për sa kohë nuk ndjekin qëllimin e risocializimit të të dënuarit.[172]

Gjykata Kushtetuese e Italisë në jurisprudencën e saj, duke interpretuar nenin 27 të Kushtetutës, ka elaboruar raportin dhe ekuilibrin ndërmjet funksioneve të dënimit penal, duke argumentuar se dënimet penale nuk mundet të konsistojnë në trajtime që vijnë në kundërshtim me parimin e humanizmit dhe duhet të kenë si synim riedukimin e të dënuarit, duke qenë ky i fundit objektivi final i legjislatorit. Gjykata Kushtetuese Italiane ka vlerësuar se elementi i vuajtjes dhe i ndëshkimit në dënimin penal nuk mundet të kalojë pragun apo masën që mundet ta shndërrojë atë në një dënim çnjerëzor dhe se ligji për të ndaluar këtë fenomen duhet të parashikojë mjetet dhe mekanizmat e duhur ligjor për të pasur dënime penale të përputhshme me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se funksioni riedukues i dënimit penal ngrihet në rangun e parimeve kushtetuese.[173]

Gjykata Supreme e Kasacionit e Republikës së Italisë ka iniciuar një kontroll incidental mbi nenin 4 *bis* të ligjit për administrimin

[170] Donald P. Kommers, përkthyer nga Petrit Plloçi, "*Jurisprudencë Kushtetuese e Republikës Federale të Gjermanisë*", Botimet Maluka, Shkolla e Magjistraturës.

[171] Shih Vendimin nr. 264, datë 07.11.1974 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.

[172] Shih Vendimin nr. 161, datë 2-4 qershor 1997 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.

[173] Shih Vendimin nr. 12, datë 04.02.1966 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.

penintenciar, duke vlerësuar se kushtëzimi në mënyrë absolute i autorizimit ligjor për përfitimin e lirisë me kusht nga bashkëpunimi me drejtësinë, për të dënuarit sipas nenit 630 të Kodit Penal, e bën të pamundur risocializimin dhe riedukimin e të dënuarit, duke e shndërruar dënimin me burgim të përjetshëm në trajtim çnjerëzor dhe në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ.[174]

Me Vendimin nr. 188, datë 05.06.2019, Gjykata Kushtetuese Italiane ka deklaruar të pabazuar kërkesën për shfuqizimin e nenit 4 *bis* të ligjit për administrimin penintenciar të iniciuar nga Gjykata Supreme e Kasacionit, duke vlerësuar se rëndësia e veprave penale dhe aksesi i kushtëzuar ligjor në lirimin me kusht, nuk e shndërron këtë parashikim ligjor në dënim çnjerëzor dhe në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ.

Megjithatë, pas daljes së vendimit të GJEDNJ në çështjen "*Marcello Viola n. 2 c. Italie*", qasja e Gjykatës Kushtetuese Italiane ka ndryshuar. Pas kontrollit incidental të ushtruar sërisht mbi nenin 4 *bis,* pika 1, nga Gjykata Supreme e Kasacionit dhe Tribunalit të Periuxhias, Gjykata Kushtetuese Italiane ka vendosur deklarimin si jokushtetues të nenit 4 bis, pika 1 të ligjit për administrimin penintenciar, në pjesën që nuk parashikon lejimin e lirimit me kusht edhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm, për veprat penale terroste apo mafioze, në kushtet e mungesës së bashkëpunimit me drejtësinë, edhe kur nuk janë vërtetuar faktet që përjashtojnë lidhjet me organizatat kriminale të tyre.

Gjykata Kushtetuese Italiane, pasi ka sjellë në vëmendje standardet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ, ka vlerësuar se në çdo rast duhet që i dënuari të ketë dhënë provë të plotë të pjesëmarrjes me sukses në rrugëtimin edukativ gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese Italiane ka vlerësuar se nëpërmjet kësaj jurisprudence kushtetuese, prezumimi ligjor i rrezikshmërisë shoqërore i të dënuarve për këto krime, nuk është më absolut por relativ dhe për rrjedhojë duhet të vlerësohet nga gjyqtari i ekzekutimit, i cili gjatë vlerësimit rast pas rasti duhet të bazohet në të gjitha informacionet eventuale të disponueshme mbi sjelljen e të dënuarit.[175]

---

[174] Shih Ordonancën nr. 4474, datë 20.12.2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.

[175] Shih Vendimin nr. 253, datë 23.10.2019 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë. Shih në web: https://www.cortecostituzionale.it/documenti/comunicatistampa/CC_CS_20191023170305.pdf për të parë njoftimin për shtyp. Ndërkohë për të konsultuar vendimin shih në web: http://www.giurisprudenzapenale.com/wp-content/uploads/2019/12/Corte-Costituzionale-253-2019.pdf.

5. REGJIMI JURIDIK MATERIAL I LIRIMIT ME KUSHT

5.1. Kushtet ndaluese

Kodi Penal ka parashikuar disa kushte ndaluese absolute për zbatimin e lirimit me kusht. Këto kushte janë të lidhura ose me karakteristikat e një rrezikmërie të shtuar shoqërore të personit nga aktiviteti kriminal ose nga karakteristikat e veprës penale të kryer. Në këtë mënyrë legjislatori ka përdorur kushte ndaluese me karakter subjektiv dhe kushte ndaluese me karakter objektiv.

Kushti ndalues me karakter subjektiv, i përdorur nga neni 64 i Kodit Penal, është ndalimi absolut i autorit recidiv për krime të kryera me dashje. Ndërkohë neni 64 i Kodit Penal, ndër kushtet objektive ndaluese për zbatimin e lirimit me kusht ka përdorur llojin e veprës penale të kryer, duke parashikuar se për të dënuarit me burgim për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/a, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100 të Kodit Penal, nuk lejohet lirimi me kusht. Më tej, në nenin 65 të Kodit Penal, parashikohet se të dënuarit me burgim të përjetshëm për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/a, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100 të Kodit Penal, nuk lejohet lirimi me kusht.

Thënë ndryshe, legjislatori ka vlerësuar apriori se kjo kategori e të dënuarve me burgim për krime, nuk kanë mundësi të rehabilitohen gjatë vuajtjes së dënimit. Gjithashtu përdorimi i këtyre ndalesave ligjore absolute do të thotë se legjislatori, më shumë se sa kujdeset për rehabilitimin dhe risocializimin e të dënuarve, ka për qëllim ndëshkimin e tyre nëpërmjet vuajtjes së plotë të dënimit me burgim, pa ofruar asnjë mundësi të rishqyrtimit gjyqësor të tij gjatë ekzekutimit të vendimit penal.

5.1.1. Recidivizmi

Lirimi me kusht si dënim alternativ, sipas nenit 64 të Kodit Penal, nuk lejohet për të dënuarit për vepra penale që përbëjnë krime dhe që janë kryer me dashje.

Dispozita nuk parashikon dallime në nënformën a fajësisë së dashjes, duke pasur parasysh se neni 15 i Kodit Penal shquan dy lloje të fajësisë me dashje; konkretisht *dashjen direkte*, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre, ose *dashjen indirekte*, kur personi megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron pasojat, me ndërgjegje lejon

ardhjen e tyre. Kjo do të thotë se, ndalesa kategorike ligjore për zbatimin e lirimit me kusht si një nga dënimet alternative, vlen edhe për rastet kur të dy krimet janë kryer me dashje direkte dhe kur të dy krimet janë kryer me dashje indirekte dhe kur ato janë kryer me llojet e ndryshme të dashjes si formë fajësie.

Dispozita nuk parashikon si kusht se, çfarë dënimi penal do të duhet të jetë dënimi i parë i dhënë nga gjykata për autorin që ka kryer për së dyti një krim me dashje. Ajo që me siguri mundet të konkludohet është se çfarë do të duhet të jetë dënimi i dytë, konkretisht, dhe së paku ose dënim me burgim ose dënim me burgim të përjetshëm, pasi vetëm në rastet e dënimit me burgim e shtrin potencialisht fushën e zbatimit lirimi me kusht si dënim alternativ. Për rrjedhojë duhet të konkludohet se dënimi penal për krimin me dashje të kryer më parë, prej së cilës autori konsiderohet prej ligjit si recidivist, mundet të jetë cilido prej dënimeve kryesore apo edhe alternative.

Për qëllimet e zbatimit të drejtë të kësaj dispozite duhet të kuptohet se dënimi i parë i marrë për një krim të kryer me dashje duhet të jetë marrë, dhe ai të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë. Kjo do të thotë se nuk do të mundet të quhet përsëritës dhe recidivist një person që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për një krim të kryer me dashje, në momentin kur kryen krimin me dashje për së dyti, për të cilin dënimi i dhënë me burgim nuk mundet të pezullohet, pasi i dënuari nuk mundet të lirohet me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal.

Nëse ai ka kryer disa vepra penale, të cilat përbëjnë krime të kryera me dashje, për të cilat në një procedim të vetëm është dënuar me të paktën një dënim me burgim, nuk do të mundet të zbatohet neni 64 i Kodit Penal. Në këtë rast do të duhet të konkludohet se, personi e ka kryer krimin me dashje më shumë se një herë, nëse është rrethanë cilësuese e së njëjtës vepër, apo se ai ka kryer më shumë vepra penale.

Qëllimi i nenit 64 të Kodit Penal, në pjesën që ndalon autorin recidiv të dënuar për krime me dashje që të përfitojë nga lirimi me kusht, është që të privohet nga kjo mundësi e rifitimit të lirisë një subjekt për të cilin vuajtja e dënimit të mëparshëm ka treguar se nuk mundet ta risocializojë dhe njëkohësisht ka prezumuar në mënyrë të arsyeshme rrezikshmërinë e shtuar shoqërore të autorit përsëritës. Për rrjedhojë, duhet të konkludohet se për të zbatuar këtë ndalesë absolute të lirimit me kusht, duhet që autori i dënuar për së dyti për krim të kryer me dashje, të jetë dënuar më parë me vendim të formës së prerë.

Një çështje që mundet dhe duhet të meritojë vëmendje është nëse do të futet në pengesën e paragrafit të tretë të nenit 64 të Kodit Penal, një person i dënuar por i rehabilituar. Në literaturën shqiptare mbi dënimet alternative është argumentuar se personi i rehabilituar nuk mundet të konsiderohet më i dënuar, dhe se ai i ka rifituar të gjitha të drejtat dhe statusin të cilat i privoheshin pikërisht nga dënimi edhe pas vuajtjes së tij. Për rrjedhojë konkludohet se, kjo kategori personash nuk kanë asnjë pengesë ligjore që t'i drejtohen gjykatës.[176] Pajtohemi plotësisht me një zgjidhje të tillë dhe mbi të gjitha një interpretim të tillë konstruktiv mbi institutin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal. Personi i rehabilituar për shkak të ligjit konsiderohet i padënuar dhe për rrjedhojë nuk do të mundet të interpretohet sikur është recidivist. Kjo do të thotë se ky subjekt nuk ka ndalesë ligjore për të përfituar nga lirimi me kusht si dënim alternativ.

5.1.2. Ndalimi i lirimit me kusht për disa nga veprat penale

Një nga mënyrat se si neni 64 i Kodit Penal vendos ndalesë kategorike për zbatimin e lirimit me kusht si dënim alternativ, është edhe nëpërmjet përcaktimit të figurave dhe llojit të veprave penale të cilat përjashtojnë apriori mundësinë në kohë për të rishqyrtuar ekzekutimin e dënimit me burgim, apo për të rifituar lirinë para mbarimit të afatit në dënimin e individualizuar nga gjykata në vendimin përfundimtar. Ky rregull parashikohet në paragrafin e tretë të nenit 64 të Kodit Penal dhe u prezantua në ligjin penal shqiptar për herë të parë në vitin 2013.

Më tej ky rregull u përsërit edhe në paragrafin e fundit të nenit 65 të Kodit Penal nga ndërhyrjet ligjore të viti 2017. Kësaj rradhe konfirmimi i normimit penal erdhi si pasojë e një prej gjetjeve të analizës dhe studimit që parapriu reformën në sistemin e drejtësisë në vitin 2015, nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë i mandatuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar i Reformës në Sistemin e Drejtësisë.[177]

Në këtë mënyrë, në vitin 2013 dhe 2017, paragrafit të tretë të nenit 64 dhe paragrafit të fundit të nenit 65 të Kodit Penal, iu shtua edhe një ndalesë kategorike me natyrë objektive e lirimit me kusht si dënim alternativ, duke

[176] Shih "*Manual për aplikimin e alternativa të dënimit me burgim*", OSBE 2010, Arta Mandro Balili, Marsida Xhaferllari, Gerd Hoxha, Admir Belishta, faqe 73.

[177] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 158.

u parashikuar se ky dënim alternativ nuk mundet të jepet për veprat penale si më poshtë:

i) Neni 78/a i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "Vrasja për gjakmarrje"[178];
ii) Neni 79/a i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Vrajses së funksionarëve publikë*"[179];
iii) Neni 79/b i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit*"[180];
iv) Neni 79/c i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare*"[181];
v) Neni 100 paragrafi i tretë i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Marrësdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur*"[182].

Ky parashikim i nenit 64, paragrafi i tretë, i Kodit Penal, do të thotë se dënimi i individualizuar nga gjykata në vendimin përfundimtar të dënimit, nuk mundet të shqyrtohet gjatë gjithë fazës së ekzekutimit dhe se rrezikshmëria shoqërore e këtyre vepra penale është e tillë saqë nuk mundet të zbatohet dënimi alternativ i lirimit me kusht. Praktikisht dhe juridikisht, ndaj këtyre veprave penale ka vetëm dy lloje dënimesh kryesore, konkretisht dënimi me burgim dhe dënimi me burgim të përjetshëm dhe asnjë lloj dënimi tjetër kryesor apo alternativ nuk mundet të zbatohet.

5.2. Kriteret ligjore

Veç kushteve ndaluese ligjore, Kodi Penal në nenin 64 ka parashikuar edhe disa kritere të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që lirimi me kusht si

[178] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[179] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[180] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[181] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[182] Ky paragrafi i dispozitës parashikon se: "*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

dënim alternativ të akordohet nga gjyqtari i ekzekutimit të vendimit penal. Edhe kriteret ligjore që përdor neni 64 i Kodit Penal, kanë natyrë subjektive dhe objektive.

Kriteret ligjore me natyrë subjektive që determinojnë vendimmarrjen e gjyqtarit të ekzekutimit mbi lirimin apo jo me kusht, kanë të bëjnë me karakteristikat e veçanta të të dënuarit, qoftë kur ato lidhen me sjelljen e tij apo me rrethanat e tij ekonomike, shëndetësore, familjare, profesionale apo sociale. Nga ana tjetër, rrethanat me karakter objektiv janë ato që kanë të bëjnë me përllogaritjen e periudhës së detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim, në mënyrë që të lindë e drejta për të kërkuar lirimin me kusht.

Në çdo rast, në mënyrë që vendimi i gjykatës mbi kërkesën për lirimin me kusht të jetë pozitiv, do të duhet që edhe kriteret ligjore subjektve dhe objektive të bashkekzistojnë. Përndryshe kërkesa për lirim me kusht, edhe pse nuk ka kushte ligjore ndaluese, nuk do të ketë sukses. Kjo do të thotë se, kriteret ligjore objektive dhe subjektive kanë natyrë juridike kumulative dhe se janë të lidhura në mënyrë të kushtëzuar me njëri-tjetrin.

5.2.1. Periudha minimale e vuajtjes së dënimit

Neni 64 i Kodit Penal ka parashikuar një periudhë minimale të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim, para se të dënuarit t'i lindë e drejta që të kërkojë pezullimin e ekzekutimit të pjesës së dënimit të mbetur, duke e kushtëzuar pezullimin dhe kushtin e rifitimit të një lirie të kushtëzuar nga detyrimet ligjore dhe gjyqësore për një periudhë të caktuar. Ky është një ndër kriteret ma natyrë objektive që neni 64 i Kodit Penal përdor për aksesin e të dënuarit me burgim në dënimin alternativ të lirimit me kusht. Për lehtësi, më poshtë kësaj periudhe do t'i referohemi si "*periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim*".

Kjo do të thotë se, më parë sesa periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim i dënuari nuk mundet të kërkojë në gjykatë lirimin me kusht dhe se edhe nëse kërkohet, kërkesa do të rrëzohet si e pabazuar në ligj. Për rrjedhojë konkludojmë se, lirimi me kusht si dënim alternativ nuk mund të akordohet më parë sesa të jetë plotësuar periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim.

Nga kjo kuptojmë se nga legjislatori, dënimi penal i individualizuar nga gjykata në vendimin përfundimtar të dënimit, është konceptuar t'i shërbejë të paktën dy qëllimeve kryesore të politikës së përgjithshme penale.[183] Fillimisht, ndëshkimit të autorit dhe mbrojtjes shoqërore të të

[183] Shih Vendimin nr. 14, datë 13.02.1949 të Republikës Populllore të Shqipërisë.

mirave juridike dhe më tej, edhe risocializimin dhe riedukimin e autorit për ta kthyer denjësisht në shoqëri. Vlerësojmë se lirimi me kusht si dënim alternativ, dhe konkretisht parashikimi i mekanizmit ligjor të periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, është elementi më identifikues dhe kufi i konkretizimit të këtyre qëllimeve që ndjek dënimi penal.

Kjo do të thotë - thënë ndryshe - se periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim përfaqëson kryesisht instrumentin juridik të përdorur nga ligji për të ndëshkuar sjelljet kriminale, dhe nga ana tjetër, në pjesën e mbetur të dënimit penal ligji vendos si qëllim kryesor procesin risocializues dhe riintegrues të të dënuarit me burgim. Në këtë mënyrë arrihet të kuptohet edhe *ratio legis* e parashikimit të vetë institutit të lirimit me kusht dhe më tej edhe të detyrueshmërisë së vuajtjes së periudhës minimale të dënimit me burgim dhe mundësisë diskrecionare të gjykatës për të pezulluar pjesën e mbetur të dënimit dhe për të ofruar mundësinë për të dënuarit, të fitimit të lirisë së mbikëqyrur apo të kushtëzuar.

5.2.2. Përllogaritja e vuajtjes së dënimit

i) Konsiderata të përgjithshme

Kodi Penal, në paragrafin e parë të nenit 64, parashikon se periudha minimale e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim është:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji.

Kjo do të thotë se për veprat penale për të cilat dispozitat e posaçme kanë parashikuar dënime që shkojnë deri në dy vjet – e për rrjedhojë sipas paragrafit të dytë të nenit 32 të Kodit Penal janë kundravajtje penale, – periudha e detyrueshme dhe minimale e vuajtjes së dënimit me burgim do të jetë jo më pak se gjysma e dënimit të dhënë nga gjykata. Kjo do të thotë se ligji penal ka parashikuar mundësinë e pezullimit maksimumi të gjysmës së dënimit me burgim për kundravajtje penale të dhënë nga gjykata.

Duhet të mbahet parasysh se ka dy momente vlerësimi për zbatimin e saktë të këtij rregullimi ligjor. *Së pari*, duhet të dallohet se për efektet e përcaktimit të periudhës minimale të përgjithshme apo teorike të vuajtjes së dënimit me burgim, nuk do të merret masa e dënimit me burgim e dhënë nga gjykata në vendimin përfundimtar të dënimit. Përkundrazi, për këtë

kriter të zbatimit të premisës fillestare të hipotezës së normës (*praemisa majore*), do të merret marzhi maksimal i parashikuar apriori në ligj për veprën e kryer. Pasi konkludohet se kemi të bëjmë me kundravajtje penale, sikurse ka kualifikuar gjykata veprën në vendimin përfundimtar, atëherë mbi këtë dënim të individualizuar do të zbatohet periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim (*praemisa minor*).

Nga ana tjetër, për dënimet me burgim deri në 5 vjet, kërkesa për lirim me kusht nuk mundet të ushtrohet dhe se ky dënim alternativ mundet të jepet nga gjykata pasi të kenë kaluar jo më pak se dy të tretat e masës së dënimit me burgim të individualizuar në vendimin përfundimtar të gjykatës. Fillimisht duhet të mbahet parasysh se pika e dytë e këtij parashikimi ligjor ka të bëjë ekskluzivisht vetëm për dënimet me burgim të dhëna për krimet. Kundravajtjet penale janë të përjashtuara apriori nga pika e parë e rregullimit dhe nga fakti se maksimumi i dënimit me burgim për to shkon deri në dy vjet. Për rrjedhojë konkludojmë se, për krimet të cilat gjykata ka individualizuar një dënim nga 5 ditë deri në 5 vjet, pavarësisht llojit të figurës së veprës penale për të cilën autori është dënuar, periudha minimale e dënimit me burgim që duhet të vuhet në mënyrë që të aksesohet lirimi me kusht, është masa e dy të tretave të dënimit të individualizuar në vendimin e gjykatës.

ii) *Interpretimi i kufijve të ndërmjetëm*

Në praktikë mund të hapë debat fakti nëse një dënim me 5 vjet burgim duhet t'i nështrohet pikës së dytë, domethënë periudhës minimale prej dy të tretash të dënimit, apo pikës së tretë, e cila parashikon një periudhë minimale vuajtje të dënimit me burgim tre të kartëtat për dënime mbi pesë vjet. Nga interpretimi logjik dhe literal i pikës së dytë dhe pikës së tretë duhet të kuptohet se, dënimi i individualizuar nga gjykata në vendim përfundimtar prej 5 vjetësh duhet të shërbejë si kufiri maksimal i dënimit me burgim, i cili periudhën minimale të vuajtjes e ka dy të tretat e tij. Ndaj, pika dy e kësaj norme përdor shprehjen "*gjer në 5 vjet burgim*" dhe pika 3 e saj shprehet "*mbi 5 vjet*". Gjithashtu vlerësojmë se është e nevojshme të mbahet parasysh se dënimet deri në 5 vjet burgim nga ligjvënësi disa herë janë konceptuar si dënime të cilat jepen për vepra penale jo të rënda dhe për autorë që nuk kanë rrezikshmëri shoqërore të madhe, pasi janë sanksione që jepen potencialisht nga një gjyqtar[184] dhe të cilat potencialisht edhe mundet

[184] Shih nenin 13 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale.

të pezullohen së zbatuari që në fillim, pasi gjykata mundet të zbatojë që nga fillimi një nga dënimet e tjera alternative, sikurse është pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia e të dënuarit në provë, sipas nenit 59 të Kodit Penal.

Pika 3, e paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal, ka parashikuar se për dënimet për krimet mbi 5 vjet burgim periudha minimale e detyrueshme e vuajtjes, do të jetë jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë. Kjo pjesë e dispozitës zbatohet me karakter mbetës për të gjitha masat e dënimit me burgim mbi pesë vjet e deri në 35 vjet. Këtu nuk përfshihet dënimi me burgim të përjetshëm. Përsa i përket periudhës minimale të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim, për dënimin me burgim të përjetshëm ka rregullime të posaçme në nenin 65 të Kodit Penal.

iii) *Uljet e llogaritshme dhe të pallogaritshme të dënimit*

Në paragrafin e dytë të kësaj dispozite parashikohet se, në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. Nuk ka qenë gjithmonë kështu rregullimi i kësaj çështje në ligjin penal shqiptar. Në Kodin Penal të vitit 1952 lejohej që në përllogaritjen e dënimit, të përfshihej edhe falja edhe amnistia. Edhe Gjykata e Lartë në këtë konkluzion ka ardhur kur gjykatat më të ulëta nuk kanë përfshirë në përllogaritjen e periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim edhe kohën e përfituar nga i dënuari nga amnistia apo nga falja, duke konkluduar se në këtë mënyrë nuk është respektuar paragrafi i dytë i nenit 354 të Kodit të Procedurës Penale.[185]

Interpretuar *per a contrario,* kjo dispozitë bën të konkludohet se tek periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim, veç amnistisë dhe faljes së dënimit, do të llogaritet çdo periudhë tjetër e zbritshme e dënimit. Kjo do të thotë se në masën e dënimit të vuajtur do të llogaritet shumëfishi i ekuivalentimit ligjor të periudhës së paraburgimit, apo do të llogariten edhe uljet e dënimit të cilat parashikohen nga Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*". Ky konkluzion mbështetet edhe nga ratio e parashikimit ligjor eksplicit. Në këtë mënyrë ligji penal ka dashur të mos përfshijë në përllogaritjen e periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim vetëm ato periudha të cilat nuk kanë të bëjnë fare me sjelljen e të dënuarit. Për rrjedhojë, njëlloj konkludohet se nga ana tjetër ligjvënësi ka dashur të

[185] Shih Vendimin nr. 113, datë 02.05.1957 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vendimi është marrë nga "*Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë të R.P.SH. (përmbledhje)*", Botim i Gjykatës së Lartë të R.P.SH., Tiranë viti 1958.

llogarisë në periudhën minimale të vuajtjes çdo përfitim tjetër të ligjit që për shkak të vuajtjes apo për shkak të sjelljes së të dënuarit ndikon në mënyrën se si ekzekutohet dënimi penal me burgim.

iv) *Përllogaritja në rastet e bashkimit të dënimeve*

Një ndër problematikat që mundet të sjellë llogaritja e afatit të periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e zbatimit të lirimit me kusht, është përllogaritja e saj në rastet e bashkimit të dënimit. Kuptohet se përllogaritja e kësaj periudhe do të bëhet mbi dënimin e bashkuar dhe jo mbi dënimet veçmas të dhëna nga gjykata para bashkimit.

Kjo zgjidhje diktohet nga vetë nevoja ligjore për të bashkuar dënimet me qëllim që të caktohet qartë dënimi penal përfundimtar që do të duhet të ekzekutohet. Për rrjedhojë konkludojmë se, në rastet e dënimit të bashkuar do të jetë pikërisht ky dënim fundor që do të duhet të merret si referim për efektet e zbatimit të përllogaritjes së periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes për qëllimet e zbatimit të lirimit me kusht.

v) *Përllogaritja e përditësuar e periudhës së vuajtjes së dënimit me burgim*

Një çështje tjetër që mund shkaktojë diskutim është edhe pyetja nëse gjykata do të duhet ta përllogarisë periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim në momentin e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht në gjykatë, apo do të duhet të ushtrojnë një kontroll të përditësuar të kësaj periudhe edhe gjatë ekzekutimit dhe deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar mbi kërkuesën.

Jurisprudenca Italiane ka mbajtur qëndrimin se, për efekt të përllogaritjes së afatit minimal të dënimit me burgim që duhet të vuhet nga të dënuarit me burgim të përjetshëm, para se atyre t'u lindë e drejta të kërkojnë lirimin me kusht, gjykata do të duhet t'i referohet datës kur është paraqitur kërkesa dhe jo një date të mëvonshme.[186]

Megjithatë vlerësojmë se, një formalizëm i tillë, megjithëse është korrekt me shkronjën e ligjit, nuk i shërben as miradministrimit të drejtësisë penale, as vetë *ratio*-s së institutit, as gjykatës, as të dënuarit dhe aq më pak shoqërisë. Ndaj vlerësojmë se kërkesa, pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme se sa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës që - në rast se në momentin e shqyrtimit vlerëson

[186] *Shih Vendimin nr. 35648, datë 01.102001 të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

se afati është plotësuar – të vendosë pranimin e saj për shqyrtim dhe zgjidhjen në themel të kërkesës. Një qëndrim i tillë formal do të detyronte që minimumi edhe 6 muaj i dënuari të qëndrojë sërisht në burgim, vetëm për faktin se neni 477, pika 2, e Kodit të Procedurës Penale parashikon se kjo kërkesë nuk mundet të paraqitet pa kaluar një afat prej gjashtë muajsh nga momenti që vendimi i rrëzimit të kërkesës të ketë marrë formë të prerë. Sakaq konstatohet se kjo mënyrë formaliste interpretimi detyron vuajtjen e dënimit me burgim edhe me gjashtë muaj për një të dënuar që potencialisht nuk duhet të vuajë më dënim me burgim. Rezultati i këtij interpretimi është padyshim antikushtetues dhe i paligjshëm.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, të cilat janë studiuar për qëllimet e këtij studimi, është konstatuar se është pranuar në mënyrë konstante dhe të përgjithshme se afati i periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e akordimit të lirimit para kohe me kusht përllogaritet në mënyrë të përditësuar, deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar. Ndryshe ka qenë qëndrimi i prokurorisë në këto seanca gjyqësore, e cila ka kërkuar që gjykata të mbajë qëndrimin formal të përllogaritjes së plotësimit apo jo të kësaj periudhe sipas datës së dorëzimit në gjykatë të kërkesës. Sigurisht kjo mënyrë interpretimi shmang formalizmat e tepruara dhe garanton më shumë aksesin e të dënuarve tek ky lloj dënimi alternativ, duke i dhënë më shumë përparësi themelit të kushteve apo kritereve ligjore sesa aspekteve formale.

Për më tepër, në rastin e Shqipërisë këtë mënyrë vlerësimi të përditësuar të përllogaritjes së periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, e kushtëzon edhe sentenca e dytë nomofilatike e Vendimit Unifikues 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë pjesë të vendimit është unifikuar praktika gjyqësore duke vendosur se:

"Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale" ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal.

Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.".

Për rrjedhojë konkludojmë se gjykata e ka detyrë ligjore që të kontrollojë dhe të përllogarisë afatin e periudhës së vuajtur të dënimit në mënyrë të

përditësuar dhe deri në momentin e vendimmarrjes përfundimtare, pasi vetëm në këtë mënyrë ajo do të jetë në gjendje që të përcaktojë me saktësi se sa është periudha e mbetur e dënimit me burgim, e cila do të pezullohet dhe që do të shërbejë për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Për rrjedhojë konkludojmë se, gjykatat janë të detyruara të përllogarisin në mënyrë të përditësuar kohën e vuajtur dhe të mbetur të dënimit me burgim dhe se kjo përllogaritje do të duhet të bëhet deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar mbi kërkesën e lirimit me kusht.

vi) *Nisja e afatit të ekzekutimit të lirimit me kusht*

Në momentin e shpalljes së vendimit, gjykata është e detyruar që të përcaktojë dhe të individualizojë periudhën e kohëzgjatjes së lirimit me kusht si dënim alternativ, duke përcaktuar fillimisht datën e nisjes së ekzekutimit të këtij dënimi dhe duke përcaktuar më tej edhe datën e mbarimit. Kjo përllogaritje është një veprim mekanik, pasi si datë nisje do të jetë detyrimisht dita e shpalljes së vendimit të lirimit me kusht, duke qenë se, në bazë dhe për zbatim të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale, disponimet gjyqësore mbi lirinë personale kanë karakter ekzekutueshmërie të menjëhershëm. Për rrjedhojë konkludohet se, idealisht nuk ka asnjë moment shkëputje nga fundi i ekzekutimit të dënimit me burgim apo me burgim të përjetshëm dhe nisjes së ekzekutimit të lirimit me kusht për secilin prej tyre. Kjo do të thotë se, nuk ka një fazë tranzitore ndërmjet tyre dhe se tranzitimi është i përputhur dhe i menjëhershëm juridikisht. Nga ana tjetër fundi i ekzekutimit të lirimit me kusht, në vendimin që zbaton këtë dënim alternativ, do të jetë mbarimi i afatit të dënimit kryesor të pezulluar.

vii) *Verifikimi i periudhës së vuajtjes së dënimit me burgim nga gjykata*

Në praktikën gjyqësore konstatohet një qasje formale e gjykatës mbi mënyrën se si verifikon përmbushjen e periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim për efektet e akordimit të lirimit me kusht. Konkretisht, shtrohet për debat pyetja nëse gjykata e kontrollon aktin që vjen si provë shkresore nga institucioni i ekzekutimit të dënimit penal mbi dinamikën e vuajtjes së dënimit me burgim apo jo. Në praktikën gjyqësore është konstatuar se gjykata e merr të mirëqenë përmbajtjen e të dhënave që pasqyrohen në dinamikën e vuajtjes së dënimit me burgim, dhe akoma më shumë edhe ky akt nuk pasqyrohet i plotë me të gjitha të dhënat, duke u mjaftuar që në vendimin përfundimtar të citohet vetëm konkluzioni mbi

sasinë e vuajtjes së dënimit me burgim dhe asnjë informacion mbi cilësinë e kësaj periudhe.[187]

Vlerësojmë se kjo mënyrë e zbatimit të nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, është e gabuar. Akti i dinamikës së vuajtjes së dënimit me burgim nuk mundet të konsiderohet si provë me fuqi të plotë provuese, sikur gjykata civile zbaton nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile. Në procesin penal nuk mundet të ketë prova ligjore, pasi të gjitha provat i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor të lirë, qofshin ato edhe aktet zyrtare. Për rrjedhojë, gjykata e ka detyrë funksionale dhe ligjore të verifikojë dhe të përllogarisë në çdo rast, nëse afati i vuajtjes së dënimit plotëson apo jo kushtet sasiore dhe cilësore të parashikuara nga ligji. Kjo do të thotë se akti i institucionit të ekzekutimit të vendimit penal për dinamikën e dënimit me burgim nuk mundet të mjaftojë për arritjen e konkluzionit të gjykatës nëse është plotësuar afati për të akorduar lirimin me kusht.

Vetëm shqyrtimi gjyqësor do të mund të konkludojë nëse afatet e paraburgimit janë përllogaritur drejtë, nëse afatet e vuajtjes së dënimit me burgim në rastet e bashkimit të dënimeve janë përllogaritur drejtë, nëse janë përllogaritur në këto të dhëna periudhat e dënimit që janë amnistuar apo falur, apo nëse janë përllogaritur në këtë periudhë uljet shpërblyese të dënimit me burgim apo jo. Sigurisht që vetëm gjykatës i mbetet të konkludojë e fundit nëse janë plotësuar secili nga kushtet apo kriteret për akordimin e lirimit me kusht, pasi eksperti i ekspertëve (*peritum peritorus*) të ligjit është përfundimisht gjykata. Gjithashtu është në përgjegjësinë e plotë të gjykatës, çdo fakt i marrë i mirëqenë në vendimin e saj.

5.2.3. Arritja e qëllimeve penologjike të dënimit penal

Kriteri i dytë që neni 64 i Kodit Penal përdor për të konkluduar mbi ligjshmërinë e një kërkese për lirim me kusht dhe për zbatimin e këtij dënimi alternativ, ka natyrë subjektive. Ai lidhet drejtpërdrejtë me karakteristikat që ka treguar i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit me burgim apo me rrethanat e posaçme që ai ka apo i shfaqen gjatë kësaj kohe, dhe që si pasojë e të cilave bëhet i nevojshëm lirimi me kusht i të dënuarit.

---

[187] Shih për shembull Vendimin nr. 34-2020-50, datë 24.012.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në pjesën respektive të vendimit, aty ku duhet të konkludohet nga gjykata nëse është plotësuar apo jo periudha minimale dhe e detyrueshme prej 25 vitesh e vuajtjes së dënimit me burgim për të përfituar lirinë me kusht një i dënuar me burgim të përjetshëm, gjykata e shkallës së parë citon se: "*…nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale…sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit për të dënuarin…ka rezultuar se kërkuesi ka kryer gjithsej 25 vjet 6 muaj e 10 ditë burgim.*".

Neni 64 i Kodit Penal parashikon shprehimisht, se:

"*i dënuari me burgim mund të lihet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij*".

Në këtë mënyrë ligji kërkon dhe lidh lirimin me kusht vetëm me arsye të veçanta dhe së dyti kur të jetë provuar se dënimi ka arritur qëllimet penalogjike të tij tek riedukimi i të dënuarit me burgim.

Në praktikën gjyqësore pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, konkretisht pas shtesës që iu bë nenit 64, për vite me radhë nuk ka qenë e qartë se çfarë do të ishin arsyet e veçanta dhe se çfarë lidhje duhet të kenë ato me treguesit në sjelljen e të dënuarit të arritjes së qëllimit të dënimit me burgim. Akoma më shumë e vështirë ka qenë pajtimi i praktikës gjyqësore lidhur me çështjen nëse të dy këto kërkesa ligjore kanë natyrë kumulative apo jo dhe se si duhet të zbatoheshin në shqyrtimin e kërkesave për lirim me kusht rast pas rasti.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka nisur një gjykim unifikues mbi një nga dënimet alternative të parashikuara në Kodin Penal, konkretisht dënimi me kusht, duke qenë se ka pasur interpretime[188] dhe zbatime të ndryshme të gjykatave mbi nenin 64 dhe 65 të Kodit Penal[189]. Një nga çështjet që u shtrua

[188] Shih "*Manual për aplikimin e alternativave me burgim*", OSBE, viti 2010, faqe 69 dhe 73-74. Shih gjithashtu në web: https://www.osce.org/sq/albania/72037?download=true.

[189] Shih "*Manual për aplikimin e alternativave me burgim*", OSBE, viti 2010, faqe 69 dhe 73-74. Ndër të tjera pasqyrohet se:
"*Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë si "arsye të veçanta" mund të përmenden: "gjendja e vështirë social-ekonomike e familjes së të dënuarit; gjendja e vështirë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit dhe nevoja e tyre për ndihmë dhe asistencë mjekësore; vdekja apo ikja e familjarëve, nga të cilat lihen pa kujdes fëmijët e të dënuarit apo persona të tjerë që ai mund të ketë në ngarkim etj...*".
Më tej në faqen 73 pasqyrohet se:
"*Neni 64 në emërtimin e tij përdor formulimin "lirimi me kusht". Nisur nga ky formulim në praktikën gjyqësore ekzistojnë dy grupe studiuesish dhe praktucienësh, të cilët janë të ndarë në mendime në lidhje me faktin se sa do të jetë koha e kushtit. Vetë kjo dispozitë në lidhje me këtë moment nuk bën asnjë parashikim ligjor. Si rrjedhim, janë krijuar dy shkolla mendimi me argumentet përkatëse në lidhje me faktin se sa duhet të jetë kjo kohë kushti.*
Referuesit e njërës ide mendojnë se koha e kushtit duhet të jetë sa pjesa e pavuajtur e dënimit për të cilën i dënuari lirohet me vendim gjykate, pra, nëse një person ka vuajtur 3 vjet e gjysmë për një vepër penale për të cilën është dënuar 4 vjet burgim dhe më pas lirohet me kusht, koha e kushtit sipas këtyre përkrahësve do të jetë vetëm 6 muaj. Pra, përgjithësisht kohëzgjatja e kushtit për këta përkrahës nisur nga kriteri përcaktues që ata përdorin është një kohë relativisht e vogël.
Përkrahësit e idesë së dytë mendojnë dhe mbështesin idenë se koha e kushtit duhet të jetë sa koha (afati) i vënies në provë të personit. Këta përkrahës, duke njehsuar kohën e kushtit me kohën e provës, mendojnë se afati duhet të jetë 18 muaj deri në 5 vjet. Nga ana tjetër, vetë dispozita materiale (neni 64 i Kodit Penal) në asnjë parashikim të përmbajtjes së saj nuk përmend apo referon si kohë kushti kohën e vënies në provë që parashikon neni 59 i Kodit Penal.
Gjithashtu rezulton se ekziston dhe një mendim tjetër doktrinar jo shumë i përhapur, sipas të cilit koha e kushtit duhet të jetë sa afati i parashkrimit i veprës penale për të cilën është dënuar shtetasi.

për t'u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara ishte:

- Në mungesë të një përkufizimi në Kodin Penal, çfarë do të kuptohet me shprehjen "arsye të veçanta" të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në procesin penal me objekt lirimin para kohe me kusht?

Lidhur me këtë çështje të shtruar për njësim, prokuroria në këtë gjykim ka mbajtur qëndrimin se me "*arsye të veçanta*" duhet të kuptohet si një sinonim i togfjalëshit "*kur me punën dhe sjelljen e tij i dënuari tregon se i është arritur qëllimit të riedukimit*", duke nënkuptuar se rrethanat e vështirësive familjare dhe gjendja ekonomike apo shëndetësore nuk janë relevante për zbatimin e këtij dënimi alternativ. Me këtë pikëpamje u bashkua edhe mbrojtja e personit të gjykuar në këtë gjykim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vlerësuar se instituti i "lirimit me kusht" klasifikohet në Kodin Penal si një nga alternativat e dënimit me burgim dhe përbën një institut me karakter riedukues, human, dhe social. Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se karakteri "human" i lirimit me kusht lidhet me shmangien e ndëshkimit të panevojshëm dhe është pasqyrim i drejtpërdrejtë i një prej parimeve të Kodit Penal, parashikuar shprehimisht në nenin 1/c të tij.[190] Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se edhe elementi ndëshkues në teorinë e së drejtës penale konsiderohet si një "hakmarrje" e shoqërisë kundrejt autorit të veprës penale, por më tepër si një shprehje e shpagimit të kësaj të fundit në lidhje me sjellje të patolerueshme për një shoqëri civile dhe demokratike.

Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se në kushtet e arritjes së qëllimit kryesor të dënimit penal, pra riedukimit të të dënuarit, si dhe plotësimit të kushteve objektive të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, vazhdimi i vuajtjes së mëtejshme të dënimit do të konsiderohej si i panevojshëm dhe i padobishëm për shoqërinë. Për më tepër, edhe vetë masa e dënimit penal, është në vetvete një "parashikim" nga ana e gjykatës i kohës që konsiderohet e mjaftueshme për të arritur në riedukimin e të dënuarit, në raport kjo me rrezikshmërinë e veprës së kryer dhe të autorit të saj. Kjo kohë e mjaftueshme, mund të jetë e ndryshme për persona të ndryshëm; dhe pikërisht për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e lirimit me kusht për këtë kategori të dënuarish, të cilët, pasi kanë vuajtur një pjesë të konsiderueshme

Duke qenë se kjo ide i ve të gjithë të dënuarit e liruar me kusht në pozita jo të favorshme, ajo nuk ka gjetur mbështetje në praktikën gjyqësore.".

[190] Neni 1/c i Kodit Penal parashikon ndër të tjera se: "*Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe të humanizmit.*"

të dënimit të dhënë, janë riedukuar plotësisht dhe nuk ekziston më nevoja për t'i mbajtur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kolegjet e Bashkuara kanë mbajtur parasysh në arritjen e këtij konkluzioni edhe efektet "sociale" të lirimit me kusht, që kanë të bëjnë jo vetëm me qëllimin e përgjithshëm të lirimit me kusht - duke shërbyer si shembull për të dënuarit e tjerë që me punë dhe sjellje të mirë mund të lirohen me kusht, - por edhe me fenomenin e mbipopullimit të burgjeve, duke ulur sadopak edhe barrën financiare të taksapaguesve për sistemin penitenciar, natyrisht duke mos u sakrifikuar objektivi kryesor që është siguria e komunitetit ndaj personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe detyrat e legjislacionit penal dhe parimet e Kodit Penal, parashikuar nga nenet 1/b dhe 1/c të Kodit Penal. Në këtë kuptim, Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se, autoritetet shtetërore duhet të përpiqen që të arrijnë riedukimin e të dënuarve sa më shpejt të jetë e mundur, duke evituar masa dënimi me karakter thjeshtë ndëshkues.

Për rrjedhojë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se neni 64 i Kodit Penal, në tërësinë e tij - përfshirë këtu edhe "*arsyet e veçanta*" - duhet të interpretohet në përputhje me qëllimin e parashikuar nga ligjvënësi, që është riedukimi dhe riintegrimi i të dënuarit në shoqëri.

Për qëllimet e interpretimit të shprehjes "*arsye të veçanta*", Kolegjet e Bashkuara sollën në vëmendje dhe analizuan parashikimet ligjore respektive nga viti 1995 e deri në vitin 2013, dhe sollën në vëmendje se praktika gjyqësore, vazhdimisht gjykatat dhe prokuroritë, e kanë interpretuar kriterin e "*arsyeve të veçanta*" si një kriter shtesë dhe të jashtëm me cilësitë dhe personalitetin e të dënuarit, duke përfshirë këtu gjendjen familjare të rënduar të të dënuarit; sëmundjen e rëndë të prindërve apo e të afërmve të tjerë; apo qenien me fëmijë të mitur dhe me bashkëshortë në ngarkesë të të dënuarit.

Në Vendimin Unifikues 2/2015, Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se kjo qasje e praktikës gjyqësore është e papranueshme dhe e gabuar. Kolegjet e Bashkuara vlerësuan në këtë jurisprudencë se, në këtë mënyrë praktika gjyqësore e lidhte zbatimin e lirimit me kusht për shkaqe që nuk janë në varësi të zhvillimit të personalitetit të të dënuarit dhe mbi kritere jashtë kontrollit të të dënuarit, duke mohuar sakaq pa të drejtë mundësinë e lirimit me kusht të një të dënuari të riedukuar plotësisht vetëm për arsyen se familjarët e tij apo vetë ai nuk ndodhen në gjendje ekonomike apo shëndetësore të rënduar. Në këtë mënyrë u konkludua se "*arsyet e*

veçanta" duhet të shërbejnë si kriter vlerësimi dhe kontrolli më rigoroz nga ana e gjykatës dhe dhënia e arsyeve objektive, konkrete dhe specifike mbi rezultatin e sjelljes dhe punës së të dënuarit në drejtim të riedukimit dhe gatishmërinë e tij ose saj, për t'u risocializuar në shoqëri.

Për rrjedhojë, Kolegjet e Bashkuara vlerësuan të drejtë interpretimin e realizuar më parë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që vlerësonte se "*arsyet e veçanta*" nuk duhen nënkuptuar si një kusht shtesë, por si një kusht i vetëm, i përbërë nga fakte të cilat provojnë se është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai/ajo është i/e gatshëm të riintegrohet në shoqëri[191], duke rikonfirmuar se "*arsyet e veçanta*" nuk kanë të bëjnë me elementë apo faktorë të jashtëm nga puna dhe sjellja e të dënuarit, por me riedukimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Kolegjet e Bashkuara vlerësuan se rrethanat që kanë të bëjnë me familjarët e të dënuarit mund të merren parasysh nga ana e gjykatave, jo si kusht thelbësor, por si rrethanë që shkon në favor të kërkesës për lirim me kusht, në drejtim të analizës së gjykatës për riintegrimin e plotë të të dënuarit pas lirimit.

Për gjithçka u soll në vëmendje më lart, Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin unifikues se:

"*Ligjvënësi duke përdorur shprehjen "arsye të veçanta" ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto "arsye të veçanta" nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit para kohe me kush,t i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe "arsyet e veçanta" nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.*".

Në këtë vendim unifikues ka pasur edhe gjyqtarë të mbetur në pakicë të cilët kanë arsyetuar qëndrimin e tyre dhe shkaqet e mendimit ndryshe

[191] Shih Vendimin nr. 10, datë 10.01.2012; Vendimin nr. 72, datë 07.03.2012; Vendimi nr. 125, datë 02.05.2012; Vendimi nr. 155, datë 16.11.2011; Vendimi nr. 160, datë 08.06.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

për çështjet e shtruara për unifikim. Në të janë arsyetuar tre qëndrime të ndryshme të gjyqtarëve të mbetur në pakicë.[192]

[192] ***Qëndrimi i parë*** ka argumentuar se "*arsyet e veçanta*" dhe "*edukimi i të dënuarit*" si shkaqe të aplikimit të lirimit me kusht nuk janë një kategori shkaqesh të njëjta por janë shkaqe krejtësisht të pavarura nga njëra-tjetra, duke konkluduar se, që të akordohet lirimi me kusht duhet detyrimisht dhe kumulativisht të bashkekzistojnë edhe prova që tregojnë riedukimin e të dënuarit dhe rrethanat e veçanta të shëndetit apo sociale të tij apo të të afërmve të tij.

Qëndrimi i dytë në pakicë i gjyqtarëve ka vlerësuar se Pakica e dytë në këtë vendim unifikues përbëhet nga qëndrimi i dy gjyqtarëve, të cilët kanë vlerësuar se kushtet sociale, ekonomike dhe shëndetsore të të dënuarit nuk kanë lidhje fare me arsyet e veçanta që kërkon neni 64 i Kodit Penal, arsye të cilat lidhen ekskluzivisht me riedukimin e të dënuarit gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit me burgim. Për rrjedhojë gjyqtarët e mbetur në pakicë nuk kanë qenë dakord me konkluzionin se edhe këto rrethana duhet të merren parasysh në shqyrtimin e bazueshmërisë në ligj dhe në prova të kërkesës së lirimit me kusht.

Pakica e dytë ka sjellë në vëmendje dy momentet e vlerësimit të gjykatës, konkretisht për të konkluduar mbi rrezikshmërinë, rrethanat personale, qëllimin riedukues etj, fillimisht në momentin e caktimit të dënimit dhe më tej të vlerësimit që gjykata realizon në momentin e shqyrtimit të kërkesës me objekt lirimin me kusht të të dënuarit. Ky qëndrim ka mbajtur parasysh se, në rastin e parë, pra në momentin e caktimit të dënimit, gjykata mban parasysh nenet 47 e vijues të Kodit Penal, në mënyrë që të individualizohet dënimi duke i caktuar personit konkret dënimin më të përshtatshëm në funksion të arritjes së qëllimit final, riedukimit të tij. Ndërsa, në rastin e shqyrtimit të kërkesës me objekt lirimin me kusht, gjykata nuk është më e lidhur me rrethanat dhe kushtet e marra parasysh në caktimin e dënimit, por me sjelljen aktuale të të dënuarit dhe zbatimi i këtij instituti, në thelb, nënkupton se i dënuari, ndryshe nga çështë disponuar në vendimin e dënimit, nuk ka nevojë më të mbahet i izoluar nga shoqëria, pikërisht sepse me sjelljen dhe punën e tij tregon se dënimi i dhënë e ka arritur qëllimin përpara se të ekzekutohet plotësisht.

Qëndrimi i tretë i gjyqtarëve në pakicë përbëhet nga vlerësimi i katër gjyqtarëve, të cilët kanë arsyetuar se "*arsyet e veçanta*" nuk janë të pavarura dhe se duhet të vlerësohen njëkohësisht, së bashku me kushtin tjetër, atë të arritjes së qëllimit të edukimit të të dënuarit nëpërmjet vuajtjes së tij. Por, në dallim nga shumica e Kolegjeve, pakica e tretë e gjyqtarëve ka arsyetuar se "*arsyet e veçanta*" duhet të verifikohen nga gjykata si përmbushje ose jo të një kushti tjetër, të pavarur nga fakti nëse është arritur kushti i parë, pra ai i riedukimit të të dënuarit, për shkak se këto "*arsye të veçanta*" nuk janë element i vlerësimit të ekzistencës dhe pjesë e arritjes së kushtit të parë, atij të riedukimit të të dënuarit sipas sjelljes dhe qëndrimit të mbajtur prej tij gjatë vuajtjes së dënimit. Sipas këtij qëndrimi, i dënuari duhet të rezultojë ose jo i riedukuar, por nuk mund të ketë konkluzion për sjellje dhe punë që tregojnë riedukim "*vetëm*" "*të veçantë*" apo thjesht "*të zakonshëm*", të dënuar shumë të riedukuar apo mjaftueshmërisht të riedukuar, pasi ligji kërkon thjesht dhe qartë që, në këtë aspekt, të plotësohet kushti i parë, ai që i dënuari të vërtetohet se me sjelljen dhe punën e tij gjatë vuajtjes së dënimit është "*riedukuar*". Ato vijojnë se, ligjvënësi ka vendosur më shumë se një kusht që duhen të përmbushen njëkohësisht në mënyrë që gjykata të pranojë kërkesën e të dënuarit për lirim me kusht, ku kushti i parë është ai i arritjes së qëllimit të dënimit penal për edukimin e të dënuarit, të vërtetuar rast pas rasti nga sjellja dhe qëndrimet e tij gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit. Sipas këtij qëndrimi, ligjvënësi parashikon edhe të drejtën që ky i dënuar të kërkojë që gjykata të vlerësojë mundësinë, gjithsesi jo detyrimin e saj, për të zbatuar ndaj këtij të dënuari lirimin me kusht edhe përpara përfundimit të plotë të kohës së vuajtjes së dënimit dhe se ky interpretim, si një mundësi, e jo si një detyrim, për gjykatën rezulton nga vetë dispozita e nenit 64 të Kodit Penal, e cila, në paragrafin e parë, në fillim të tij, shprehet se "*i dënuari me burgim mund të lirohet me kusht...*".

Sipas gjyqtarëve të pakicës së tretë, në nenin 64 të Kodit Penal, ligjvënësi ka parashikuar qartazi edhe disa kushte të tjera, plotësimi i të cilave duhet të verifikohet njëkohësisht me kushtin e parë.

Këto kushte të tjera nuk kanë asnjë lidhje me arritjen e qëllimit për riedukimin e të dënuarit nga puna, sjellja dhe qëndrimet e tij gjatë pjesës së vuajtur të dënimit me burgim, pasi qëllimi i dënimit penal ka në themel të tij jo vetëm arritjen e riedukimit të të dënuarit dhe atë të parandalimit të posaçëm, por edhe arritjen e qëllimit të parandalimit të përgjithshëm në të gjitha dimensionet e tij, përfshirë edhe atë të domosdoshmërisë së "*ndëshkimit*" që duhet të vuajë i dënuari për veprën penale që ka kryer dhe pasojat që ajo ka sjellë.

Pakica e tretë e gjyqtarëve arsyeton se, "*arsyet e veçanta*" janë rrethana të tilla, të cilat, nga njëra anë, nuk kanë lidhje me arritjen e qëllimit të riedukimit të të dënuarit dhe, nga ana tjetër, duhet të verifikohen në gjykim rast pas rasti, për të çmuar nëse janë të tilla që jo vetëm nuk cenojnë respektimin e parimit të drejtësisë penale mbi parandalimin e përgjithshëm, por edhe janë të tilla që, mund të justifikojnë lirimin me kusht të një të dënuari tashmë të riedukuar dhe të gatshëm për riintegrim në shoqëri. Sipas këtij qëndrimi, ligjvënësi nuk tregon në mënyrë të shprehur se cilat janë këto "*arsye të veçanta*" nisur nga synimi i tij që gjykata, rast pas rasti, nëse vërtetohet që i dënuari është riedukuar, të verifikojë njëkohësisht edhe nëse vërtetohen kushtet, rrethanat e tjera të mundshme të posaçme e konkrete, që justifikojnë lirimin me kusht, duke u kujdesur që të respektohen dhe të mos cenohen parimet themeltare kushtetuese e ligjore të drejtësisë penale lidhur me parandalimin e përgjithshëm dhe atë të humanizmit. Kjo kategori rrethanash, të verifikueshme rast pas rasti, duhet të jenë "*vetëm*" të karakterit "*të veçantë*", pra jo të zakonshme, të tilla që e justifikojnë lirimin me kusht, por, gjithsesi, pa rënë ndesh me parimin e parandalimit të përgjithshëm.

Ky qëndrim i gjyqtarëve në pakicë vlerëson se, një aspekt tjetër i këtyre rrethanave është që ato të jenë "*të veçanta*" edhe në kuptimin e rrethanave të karakterit personal e familjar, me natyrë jo të zakonshme e përjashtimore, të tilla që, në rastin konkret, të justifikojnë lirimin me kusht para vuajtjes së plotë të dënimit nga i dënuari tashmë i riedukuar, nisur nga zbatimi i parimit të humanizimit të shtetit pikërisht ndaj këtij të dënuari dhe rrethanave të veçanta personale e familjare të tij. Këto arsye të veçanta, vërtet jo të zakonshme dhe përjashtimore, duhet të jenë rrethana të pavarura nga sjellja dhe qëndrimi i të dënuarit, e të tilla që të kenë lindur, të jenë rënduar dhe të ekzistojnë pas dhënies së vendimit të dënimit penal, kjo për shkakun se vetë ligji penal, në tërësinë e tij, është ndërtuar dhe rregulluar duke e respektuar parimin e humanizmit dhe gjykatat e dënimit e kanë pasur parasysh atë në kohën e gjykimit dhe të dhënies së vendimit të dënimit penal. Po kështu sipas këtij qëndrimi, këto "*arsye të veçanta*" mund të shërbejnë për të justifikuar lirimin me kusht nëse janë të kënaqshme dhe të justifikuara në varësi të shkallës së riedukimit, asaj të përgatitjes për të qenë i integruar në shoqëri, nevojës përjashtimore të pranisë personale të të dënuarit së bashku me zotërimin prej tij të personalitetit dhe të aftësive vetjake për të përballuar rrethanën e veçantë personale e familjare etj. Në këtë kuptim, nëse këto "*arsye të veçanta*", verifikohen dhe vërtetohen gjatë gjykimit, atëherë ato mund të justifikojnë lirimin me kusht të të dënuarit, në respektim të parimit të parandalimit të përgjithshëm dhe/ose atij të humanizmit, e njëkohësisht pa e cenuar zbatimin e drejtë të parimit tjetër themeltar, atij të barazisë para ligjit, përkundrejt të dënuarve të tjerë të riedukuar që nuk gjenden apo përballen me ndonjë prej këtyre rrethanave, arsyeve të veçanta.

Gjyqtarët në pakicë kanë arsyetuar se, në përmbushje të detyrimit të gjykatës për të interpretuar drejt ligjin dhe për ta bërë të zbatueshme normën sipas vullnetit dhe qëllimit të ligjvënësit, "*arsyet e veçanta*" duhet të kërkohen dhe të verifikohen në rrethana të tilla, përfshirë edhe ato që trajton shumica e Kolegjeve të Bashkuara në këtë vendim unifikues, të cilat mund të grupohen në:

- nevoja për të garantuar interesin dhe sigurinë publike nga sjelljet dhe veprat penale, nëpërmjet parandalimit dhe ndëshkimit të tyre, në kohën e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht;
- natyrën e veprës penale që ka kryer i dënuari, pasojat që ajo ka sjellë dhe qëndrimin që mban shoqëria ndaj këtyre sjelljeve kriminale, në kohën e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht;
- gjendjen e sigurisë publike dhe të kriminalitetit në kohën e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht, parashikimin e pritshmërisë së publikut ndaj lirimit me kusht të të dënuarit, si edhe efektet pozitive apo negative që mund të sjellë në shoqëri lirimi me kusht i tij përpara përfundimit të

E vlerësojmë të drejtë interpretimin nomofilatik të realizuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe konform standardeve ndërkombëtare të Këshillit të Evropës dhe praktikave më të mira dhe demokratike të legjislacioneve penale në fuqi në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian. Për më tepër shtojmë të sjellim në vëmendje se, ky konkluzion - mbi kuptimin e drejtë të kriterit subjektiv të arsyeve të veçanta dhe sjelljes riedukuese të të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit me burgim – del edhe nga interpretimi krahasues i kritereve subjektive që ligji penal ka vendosur për akordimin e lirimit me kusht për të dënuarin me burgim, në krahasim me atë që është i dënuar me burgim të përjetshëm.

Kështu në nenin 64 të Kodit Penal kërkohen kumulativisht edhe ekzistenca e arsyeve të veçanta dhe sjellja model riedukuese e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë paragrafi i dytë i nenit 65 të Kodit Penal në pjesën relevante formulohet:

"*gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.*".

Nëse pranohej e kundërta, apo ajo që një pjesë e praktikës gjyqësore dhe qëndrimi i parë në pakicë artikulojnë, do të krijohej një paradoks ligjor dhe një shkelje e nenit 18 të Kushtetutës, apo thënë ndryshe do të shkelej parimi i barazisë përpara ligjit. Pranimi i këtij konkluzioni do të çonte në situatën kur zbatimi i lirimit me kusht si dënim alternativ do të ishte nga ana subjektive vështirësisht më i aksesueshëm për të dënuarit me burgim sesa për të dënuarin me burgim të përjetshëm, duke qenë se për të parët nuk mjafton vetëm sjellja e tyre gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim por duhet edhe ekzistenca e arsyeve të veçanta, dhe se për të dytët do të mjaftonte vetëm sjellja model riedukuese. Sigurisht që ky interpretim është i papranueshëm dhe njëkohësisht edhe i papajtueshëm me nenin 18 të Kushtetutës.

Në mendimin juridik shqiptar ndër vite është konceptuar në të njëjtën mënyrë plotësimi i këtij kriteri subjektiv për akordimin e lirimit me kusht. Në këtë mënyrë është vlerësuar se të dhënat që duhet të vlerësohen para

vuajtjes së dënimit, veçanërisht nisur nga natyra e veprës dhe pasojave që ka shkaktuar;
- kryerja ose jo më parë e veprave penale nga i dënuari;
- personaliteti në tërësi që shfaq i dënuari, krahas arritjes së qëllimit për riedukimin e tij, si edhe aftësitë e tij profesionale dhe dobishmëria e tyre për shoqërinë nëse ai lirohet me kusht;
- historia e jetës së të dënuarit, gjendja dhe rrethanat e tij personale e familjare etj..

Në këtë mënyrë pakica e tretë e gjyqtarëve në këtë vendim unifikues ka konkluduar se "*arsyet e veçanta*" sipas nenit 64 të Kodit Penal shërbejnë si mbështetje për të disponuar pranimin ose jo të kërkesës për lirim me kusht atëherë kur kushtet e tjera ligjore janë përmbushur.

se të merret një vendim mbi kërkesën për lirim me kusht duhet të jenë të sakta, të qarta dhe të gjithanshme, duke konkluduar sakaq nëse i dënuari i ka respektuar në mënyrë të ndërgjegjshme rregullat e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, nëse ai ka marrë pjesë aktive me punë apo aktivitete sociale apo sportive gjatë vuajtjes së dënimit, nëse ka bërë përpjekje për të kompensuar dëmin e shkaktuar, nëse ka bërë përpjekje serioze gjatë kësaj kohe për ngritjen e nivelit edukativdhe profesional e të tjerë tregues të kësaj natyre. Vetëm një hetim serioz dhe efektiv i këtyre treguesve të sjelljes së të dënuarit mundet të çojë në konkluzione të drejta dhe të vërteta mbi shkallën e riedukimit të të dënuarit. Në këtë qëndrim vlerësohej se konkluzioni për pranimin apo jo nga gjykata të kërkesës për lirim me kusht duhet të bazohet ekskluzivisht mbi sjelljen e të dënuarit dhe jo mbi rrezikshmërinë e veprës, duke konkluduar se rrezikshmëria e veprës ka të bëjë me momentin e individualizimit të dënimit nga gjykata dhe se ajo ka më tej relevancë edhe mbi vlerësimin e ligjvënësit për përcaktimin e kohëzgjatjes së periudhës së detyrueshme dhe minimale të vuajtjes së dënimit me burgim para se të lindë e drejta për të kërkuar lirim me kusht. Si konkluzion i kësaj analize vlerësohet se, kusht i domosdoshëm për pranimin e një kërkese për lirim me kusht duhet të jetë përfundimi i gjykatës se i dënuari nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore dhe jep shpresa të plota se, duke u kthyer në shoqëri, do të jetojë dhe do të punojë ndershmërisht.[193]

Modelet ligjore të përdorura për të realizuar interpretimin krahasues të çështjeve të trajtuara në këtë punim ofrojnë formulime të ndryshme, të cilat mund të përdoren edhe si argumente interpretimi të ligjit penal në mënyrë që të arrihet në një interpretim sa më të drejtë. Kështu, neni 176 i Kodit Penal të Republikës së Italisë ka parashikuar se i dënuari me burgim mundet të lirohet me kusht, nëse ka mbajtur një sjellje të tillë nga e cila mundet të konkkludohet me siguri për pendimin e tij.

Neni 729, paragrafi i dytë, i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Francës ka parashikuar se një i dënuar me burgim mundet të lirohet me kusht nëse manifeston përpjekje serioze për riintegrim social dhe nëse justifikon:

- ose ushtrimin e një aktiviteti profesional, të një stazhi apo aktivizimin në një marrëdhënie pune;

[193] Shih Piro Terpo, Xhevdet Beqo, "*Disa çështje mbi institutin e lirimeve para kohe me kusht të të dënuarve*", Revista "*Drejtësia Popullore*" nr. 2, viti 1964, faqe 32 - 34.

- ose për të realizuar një pjesëmarrje të rëndësishme në jetën familjare;
- ose nga nevoja për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore;
- ose nga përpjekjet që janë bërë për të dëmshpërblyer viktimën;
- apo nga ndonjë përfshirje në ndonjë projekt serioz të riintegrimit në shoqëri.

Neni 86, i Kodit Penal të Konfederatës së Zvicrës ka parashikuar se mundet të lirohet me kusht një i dënuar me burgim nëse sjellja e tij gjatë ekzekutimit të vendimit nuk i kundërvihet apo nuk lë vend për të ushqyer frikë se ai do të përfshihet sërisht në aktivitet kriminal.

Nga sa u parashtrua më lart, duket qartë se edhe standardet ndërkombëtare, por edhe interpretimi krahasimor i ligjit penal bën që të arrihet në konkluzionin që kanë vendosur si standard të interpretimit të ligjit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr. 2/2015. Për rrjedhojë, të gjitha kriteret me karakter subjektiv që gjykata mundet ta kushtëzojë akordimin apo jo të lirimit me kusht duhet të jenë të tilla që të kenë lidhje vetëm me shkaqe që i dënuari i ka në kontrollin e tij dhe jo shkaqe që nuk varen nga ai.

5.2.4. Shkaqe të tjera që gjykata shqyrton

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr. 2/2015, kanë dhënë një ndihmë të madhe lidhur me hapësirën dhe mënyrën e ushtrimit të vlerësimit gjyqësor mbi kërkesat për lirim me kusht, me qëllim verifikimin e drejtë dhe efektiv të plotësimit të kritereve subjektive lidhur me arritjen apo jo të qëllimit të dënimit me burgim nga ana e të dënuarit. Sigurisht që ky vlerësim ushtrohet rast pas rasti dhe i lidhur ngushtë me të gjitha rrethanat objektive dhe subjektive që e karakterizojnë kontekstin e një çështjeje të caktuar. Megjithatë, në çdo rast, analiza e vendimeve gjyqësore dhe hapësira e shqyrtimit gjyqësor duhet të përfshijë disa tregues mbi aspektin subjektiv të çdo të dënuari.

Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar në Vendimin Unifikues nr. 2/2015, se gjykata e ekzekutimit kur shqyrton kërkesën për lirim me kusht duhet të mbajë parasysh natyrën e veprës penale të kryer, që është një ndër elementët më të rëndësishëm, pasi sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. Gjithashtu, sipas Kolegjeve të Bashkuara, edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, duhet të mbahen në konsideratë,

pasi një vepër penale e kryer në bashkëpunim, me paramendim, apo me dhunë tregon për një shkallë të lartë rrezikshmërie të të dënuarit, çka duhet të shtyjë gjykatën për të qenë veçanërisht e kujdesshme në pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, në këto raste, gjykata duhet të jetë pothuajse plotësisht e bindur, nëpërmjet fakteve dhe rrethanave konkrete, se i dënuari nuk do të jetë burim rreziku për shoqërinë nëse lirohet.

Megjithatë, konstatohet se në praktikën gjyqësore ka një keqkuptim të kësaj pjese të arsyetimit të Vendimit Unifikues nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Janë konstatuar raste kur kërkesa për lirim me kusht është rrëzuar me të vetmin arsyetim që vepra penale për të cilën kërkuesit janë dënuar, ka rrezikshmëri të madhe shoqërore. Në këto raste analizohen me konkluzione të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore që lejojnë akordimin e lirimit me kusht dhe, kur analizohet në pjesën arsyetuese pikërisht rrezikshmëria e veprës penale, nga gjykata konkludohet se rrezikshmëria është e madhe.[194] Për më tepër, në arsyetimin e rrezikshmërisë së veprës penale gjykata nuk mban parasysh dënimin me burgim të dhënë dhe të individualizuar tashmë, por sjell në vëmendje sanksionet ligjore në minimum dhe në maksimum që ligji ka parashikuar për atë vepër penale, duke konkluduar se megjithëse individi është rehabilituar, sërish vepra penale është e rrezikshme dhe se lirimi me kusht nuk mundet të pranohet.[195] Vlerësojmë se nuk është ky kuptimi i saktë i jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Rrezikshmëria e veprës penale dhe rrezikshmëria e autorit janë shkaqe të cilat shërbejnë në mënyrë determinante në momentin e caktimit të llojit dhe masës së dënimit. Ato nuk mundet të shërbejnë si shkaqe për të rrëzuar kërkesën për caktimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Rrezikshmëria e veprës penale dhe e autorit në gjykimin e kërkesës për lirim me kusht shërbejnë për të maturuar shqyrtimin gjyqësor të gjykatës dhe për

[194] Shih Vendimin nr. 51-2019-4415, datë 10.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dënuar për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike me dënimin 4 vjet dhe 8 muaj burgim. Shih gjithashtu Vendimin nr. 51-2019-4869, datë 08.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dënuar përfundimisht me 7 vjet e 4 muaj për veprën penale të vjedhjes me dhunë në bashkëpunim. Shih gjithashtu edhe Vendimin nr. 119 (2435), datë 13.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim për veprat penale të parashikuar nga neni 278/a/a dhe 282/a/1 të Kodit Penal.

[195] Shih Vendimin nr. 51-2019-4697, datë 08.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vepra penale objekt dënimi ka qenë armëmbajtja pa leje e parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal dhe dënimi përfundimtar me burgim ka qenë 8 vjet e 8 muaj.

të përcaktuar thellësinë e ushtrimit të tij. Për t'u pranuar apo jo kërkesa për lirim me kusht materialisht, kur ndalesat ligjore nuk ekzistojnë, duhet të jetë e kushtëzuar vetëm nga shkaqet subjektive që i përkasin të dënuarit. Kjo do të thotë se gjykatave i del detyrë që të konkludojnë vetëm nëse i dënuari është risocializuar, riedukuar dhe nëse mundet të riintegrohet në shoqëri apo jo. Çdo qëndrim tjetër mbi vlerësimin apo interpretimin e nenit 64 të Kodit Penal, do ta bënte të pamundur zbatimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht dhe vetë aksesin e të dënuarve në të.

Gjithashtu vlerësojmë se është i gabuar vlerësimi i përgjithshëm dhe jo konkret i gjykatave mbi rrezikshmërinë shoqërore të një vepre penale vetëm, duke u bazuar teorikisht nga marzhet ligjore të dënimit në rastet e shqyrtimit të kërkesave për caktimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Gjykata që shqyrton kërkesën për lirimin me kusht tashmë e ka të individualizuar dënimin nga një vendim gjykate jo vetëm i formës së prerë por edhe gjë të gjykuar, dhe se për rrjedhojë çdo shtim i rrezikshmërisë së veprës tej atij dënimi të caktuar sipas nenit 47 të Kodit Penal, do të jetë vlerësim i gabuar.

Kolegjet e Bashkuara në arsyetimin e Vendimit Unifikues nr. 2/2015, sjellin në vëmendje se sa më e madhe të jetë rrezikshmëria e veprës penale apo rëndësia e rrethanave të kryerjes së saj aq më i gjithanshëm dhe skrupuloz duhet të jetë shqyrtimi gjyqësor me qëllim që të vërtetohet se të dhënat e materialit provues paraqesin apo jo rezultate efektivisht të vërteta. Kjo pjesë e arsyetimit të vendimit unnifikues nuk mundet të interpretohet se, vetëm rrezikshmëria shoqërore e veprës penale e bën të pathemeltë kërkesën për lirim me kusht. Ky konkluzion është interpretim i gabuar i *ratio decidendi* të vendimit nomofilatik, pasi sentenca e parë unifikuese ka ardhur si pasojë e interpretimit se, të vetmet arsye që duhet të determinojnë bazueshmërinë në ligj të kërkesës për lirim me kusht, duhet të jenë arritja e qëllimeve penalogjike të dënimit penal në raport me sjelljen e të dënuarit dhe zhvillimin e personalitetit të tij gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim.

Duhet të mbahet parasysh se nuk duhet ngatërruar çmuarja e rrezikshmërisë, rrethanave personale, qëllimi riedukues dhe vlerësimi i bërë në momentin e caktimit të dënimit, me atë të bërë në momentin e shqyrtimit të kërkesës me objekt lirimin me kusht të të dënuarit. Në rastin e parë, pra në momentin e caktimit të dënimit, gjykata mban parasysh nenet 47 e vijues të Kodit Penal, në mënyrë që të individualizohet dënimi duke i caktuar personit konkret dënimin më të përshtatshëm në funksion të arritjes

së qëllimit final, riedukimit të tij. Ndërsa, në rastin e shqyrtimit të kërkesës me objekt lirimin me kusht, gjykata nuk është më e lidhur me rrethanat dhe kushtet e marra parasysh në caktimin e dënimit, por me sjelljen aktuale të të dënuarit dhe zbatimi i këtij instituti, në thelb, nënkupton se i dënuari, ndryshe nga ç'është disponuar në vendimin e dënimit, nuk ka nevojë më të mbahet i izoluar nga shoqëria, pikërisht sepse me sjelljen dhe punën e tij tregon se dënimi i dhënë e ka arritur qëllimin përpara se të ekzekutohet plotësisht.[196]

Në këtë pjesë të analizës duhet të mbahet parasysh edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Federale tëGjermanisë në çështjen "*War Criminal*"[197], ku i dënuari kishte qenë ish-anëtar SS dhe ishte dënuar për 50 vrasje, edhe të grave dhe fëmijëve në dhomat e gazit. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se e drejta e dinjitetit njerëzor nuk mund t'i mohohet një të dënuari, pavarësisht nga barbaria dhe rrezikshmëria e krimit të tij, duke vlerësuar se në moshën 89 vjeçare që i dënuari kishte arritur duhet t'i jepej më shumë peshë personalitetit, moshës, dhe dosjes personale të rrugëtimit të vuajtjes së dënimit me burgim.

Më tej, Kolegjet e Bashkuara arsyetuan se gjykata në vlerësimin e kërkesës për lirim me kusht duhet të mbajë parasysh qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, duke qenë se ky element është i dyti nga ato që ligji parashikon për t'u trajtuar në raportin e drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive dhe se nuk mund të mjaftojë vetëm deklarimi i të dënuarit para gjykatës që shpreh pendesë për veprën e kryer, por ky qëndrim pendues të ketë rezultuar edhe gjatë vuajtjes së dënimit, në raport me bashkëvuajtësit e tjerë, personelin e institutit penitenciar, me familjarët e tij, marrjen pjesë në aktivitete riedukuese, dëshirën për të punuar, etj. Kolegjet kanë vlerësuar se, për sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me viktimën/të dëmtuarin apo familjarët e tij, nëse rezulton të ketë ndodhur, gjykata duhet natyrisht ta marrë parasysh si element në favor të kërkuesit, duke vlerësuar se ndërsa në vetvete normalizimi i marrëdhënieve nuk është kusht i domosdoshëm për

[196] Shih qëndrimin në pakicë të gjyqtarëve në Vendimin Unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

[197] Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Republikës së Gjermanisë, nr. 67 BVerfGE 100, 129, e vitit 1984, cituar në faqe 416 dhe 417 të librit të Donald P. Kommers, përkthyer nga Petrit Plloçi, "*Jurisprudencë Kushtetuese e Republikës Federale të Gjermanisë*", Botimet Maluka, Shkolla e Magjistraturës.

pranimin e kërkesës për lirim me kusht, me rëndësi është të paktën tentativa e të dënuarit për të kërkuar faljen dhe normalizimin e marrëdhënieve me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, si dhe zëvendësimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose ndihma aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale.

Lidhur me pendimin e të dënuarit dhe me qëndrimin e tij kundrejt viktimës duhet sjellë në vëmendje edhe interpretimi krahasues i ligjeve penale të shteteve që janë studiuar për qëllimet e kryerjes së këtij studimi. Në këtë mënyrë paragrafi i fundit i nenit 176 i Kodit Penal të Republikës së Italisë ka parashikuar se lirimi para kohe me kusht mundet të shoqërohet me përmbushjen e detyrimeve civile që rrjedhin nga vepra penale, përveç rastit kur i dënuari provon se është në kushtet e pamundësisë për t'i përmbushur ato. Nga ana tjetër, neni 729, në pikën 4 të paragrafit të dytë, i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Francës ka parashikuar se një ndër kriteret e pranimit të kërkesës për lirim me kusht nga gjykata është pikërisht përpjekja serioze e të dënuarit për të dëmshpërblyer viktimën e veprës penale. Kuptohet se kjo rrethanë merr rëndësi themelore vetëm në veprat penale të cilat kanë viktimë një person fizik apo juridik.

Megjithatë jurisprudenca italiane ka vlerësuar se edhe në rastet e paaftësisë paguese të të dënuarit, ai do të duhet të ketë treguar se gjatë vuajtjes së dënimit ka treguar interes për viktimat dhe është kujdesur sa ka mundur për rehabilitimin e tyre, qoftë për situatën materiale dhe morale të tyre, duke u përpjekur në mundësitë e tij të riparojë dëmet dhe pasojat e veprës penale.[198]

Jurisprudenca kasacionale italiane ka vlerësuar se edhe falja si akt social i të dënuarit, e provuar se është kryer prej disa viktimave të veprës penale, nuk mund të konsiderohet se është faktor vendimtar për akordimin e lirimit me kusht.[199] Megjithatë falja nga ana e viktimave dhe normalizimi i marrëdhënieve me të dënuarin, shoqëruar me pendimin e tij dhe me veprimet dhe interesin e tij për një riparim të tillë të këtyre marrëdhënieve dhe nga ana tjetër edhe sjellja që ai ka mbajtur në burg gjatë vuajtjes së dënimit, janë faktorët e detyrueshëm që gjykata duhet t'i mbajë parasysh dhe të diktojnë vendimmarrjen e saj.[200] Kjo jurisprudencë kërkon që ndryshime

[198] Shih Vendimin nr. 7248, datë 10.02.2000 dhe Vendimin nr. 1541, datë 04.05.2000, të Seksionit Penal të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.

[199] Shih Vendimin nr. 2167, datë 29.07.1993, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[200] *Shih Vendimin nr. 9815, datë 04.03.2008, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

të tilla pozitive të personalitetit të të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit të provohen konkretisht dhe të materializohen së jashtmi dhe jo të mbeten vetëm konsiderata teorike dhe abstrakte.[201]

Një tjetër element që duhet të vlerësohet dhe shqyrtohet nga ana e gjykatës së ekzekutimit, sipas Kolegjeve të Bashkuara, është nëse i pandehuri ka kryer veprën e mëparshme penale, pasi në rast se i dënuari rezulton përsëritës për krime të kryera me dashje, gjykata, në bazë të nenit 64 të Kodit Penal, do të jetë e detyruar të rrëzojë kërkesën, pasi ky element konsiderohet si ndalues i dhënies së lirimit me kusht. Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se në rastet e tjera, hetimi mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit duhet të vlerësohet në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij.

Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se gjykata e ekzekutimit duhet të shqyrtojë gjendjen fizike dhe psikologjike të personit të dënuar, duke vlerësuar se, nëse i dënuari ka një gjendje të rënduar fizike apo moshë të madhe, kjo rrethanë do të konsiderohet në favor të të dënuarit, jo vetëm për arsye humanitare, por edhe pasi rrezikshmëria shoqërore në këtë rast do të cilësohet si më e ulët. Ndërkohë Kolegjet e Bashkuara vijojnë se, në qoftë se i dënuari gëzon gjendje të mirë fizike, kjo rrethanë do të konsiderohet si neutrale nga ana e gjykatës, por jo në disfavor të kërkuesit, pasi qëllimi i ligjvënësit nuk është neutralizimi i të dënuarit, por riintegrimi i tij në shoqëri.

Interesante është zgjidhja që bën paragrafi i gjashtë i nenit 729 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Francës. Në këtë pjesë të dispozitës parashikohet se, nëse i dënuari është më shumë se 70 vjeç, nuk zbatohen parashikimet e zakonshme të periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim. Në këto rast ai mundet të lirohet nga gjykata, sapo të konkludojë se qëllimi i dënimit është arritur. Në këto raste ligji francez vendos si kusht ndalues bindjen e gjykatës nëse liria me kusht e të moshuarit është apo jo rrezik i shtuar për përfshirjen në aktivitet kriminal sërish, apo nëse përbën ai apo jo rrezik për prishjen e rendit publik.

Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar në vendimin unifikues se, dinamika e sjelljes së të dënuarit në institucionin e ekzekutimit të dënimeve penale është, së fundmi, një element kyç në lidhje me provën e riedukimit të të dënuarit, pasi ai jo vetëm që është i detyruar për të zbatuar me korrektësinë maksimale rregulloren e brendshme të institucionit, por edhe të tregojë

[201] *Shih Vendimin nr. 18022, datë 10.05.2007, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

konkretisht, se gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, sjellja e tij ka qenë e tillë sa për të çuar drejt përfundimit se i dënuari vërtet ka treguar pendim, duke u sjellë me korrektesë me bashkëvuajtësit; autoritetet shtetërore; ka mbajtur (ose tentuar të mbajë) marrëdhënie të rregullta me familjaret e tij; ka normalizuar (ose tentuar t'i normalizojë) marrëdhëniet me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, si dhe ta zëvendësoje dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; si dhe ka marrë pjesë në aktivitete pune, trajnuese, kulturore dhe edukative.

Për rrjedhojë Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se, raporti i autoriteteve të ekzekutimit të dënimeve penale është me rëndësi për gjykatën për sa i përket analizës në lidhje me riedukimin e të dënuarit, duke vlerësuar se për t'u konsideruar si i riedukuar, i dënuari nuk duhet thjesht dhe vetëm të këtë respektuar rregulloren e institucionit të vuajtjes së dënimit, por të jetë aktivizuar duke marrë pjesë në aktivitete riedukuese, kulturore, trajnuese, punësimi, përmes të cilave të kuptohet pendimi i të dënuarit në raport me veprën e kryer dhe riedukimi i tij.

Kolegjet e Bashkuara kanë sjellë në vëmendje se një rol shumë të rëndësishëm ka edhe Shërbimi i Provës, pasi, përveç kontrollit nëse i dënuari është riedukuar apo jo, gjykata duhet të analizojë edhe mundësinë, nëse i dënuari do të riintegrohet me sukses në shoqëri dhe nuk do të rezultojë më përsëritës veprash penale. Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se, për këtë analizë, ndonëse të drejtuar drejt së ardhmes, gjykata ndihmohet nga raporti përkatës i Shërbimit të Provës, sipas nenit 31/6, pika 3 e ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 "*Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale*", në të cilin paraqiten të dhëna lidhur me kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit. Kolegjet e Bashkuara kanë theksuar se roli i Shërbimit të Provës nuk duhet të ngatërrohet me rolin e autoriteteve të institucionit të vuajtjes së dënimit penal, pasi ndërkohë që raporti i këtij të fundit i shërben gjykatës për të vendosur nëse vuajtja e dënimit ka arritur qëllimin e riedukimit të të dënuarit, raporti i Shërbimit të Provës, shërben vetëm për të ndihmuar gjykatën në një analizë të riskut të shmangies së recidivizmit dhe të mirëintegrimit të të dënuarit në shoqëri pas lirimit të tij.

Në lidhje me kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, Kolegjet e Bashkuara kanë theksuar se kushtet e vështira ekonomike apo gjendja e rëndë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit, ndërkohë që në

raste dhe rrethana të caktuara mund të merren në konsideratë si element potencial për efekt të uljes së rrezikut të recidivizmit, ato nuk duhet kurrsesi që të konsiderohen, në vetvete, si element në disfavor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

Për sa i përket planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit, Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se duhet të jenë sa më realiste, në raport me mundësitë efektive të të dënuarit, dhe duhet të shërbejnë për të bërë sa më të lehtë tranzicionin që i dënuari kalon në periudhën menjëherë pas lirimit. Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se në këtë aspekt roli i Shërbimit të Provës nuk duhet të jetë thjesht formal, por proaktiv në mbështetjen që i jepet gjykatës në marrjen e një vendimi sa më të drejtë.

Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se, vetëm pasi të kenë kaluar etapat e mësipërme, gjykata mund të vendosë për pranimin apo jo të kërkesës për lirim me kusht, duke sjellë në vëmendje se gjykata nuk është e detyruar të vendosë sipas konkluzionit të raportit të Shërbimit të Provës, dhe se në rast vlerësimi ndryshe duhet që gjykata të sqarojë arsyet konkrete se përse e konsideron të gabuar apo të pabazuar raportin.

Lidhur me përmbajtjen e raporteve të organeve administrative pjesëmarrëse në këtë proces vlerësimi, Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se është thelbësore për shqyrtimin e kërkesave të lirimit me kusht që të dy raportet që i paraqiten gjykatës, si ai i autoriteteve shtetërore të vuajtjes së dënimeve penale dhe ai i Shërbimit të Provës, duhet domosdoshmërisht të shmangin vlerësime me karakter abstrakt dhe përgjithësues, por të jenë specifikisht të individualizuara për të dënuarin konkret, ku të përshkruhet me hollësi sjellja e të dënuarit gjatë vuajtjes, apo kushtet familjare dhe planet e tij për të mundësuar riintegrimin në shoqëri.

Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se, në rast se rezulton e qartë se i dënuari është riedukuar dhe se ky i fundit është i gatshëm për t'u riintegruar në shoqëri, gjykata e ekzekutimit duhet, (që do të thotë se nuk ka diskrecion në vendimmarrje), që të pranojë kërkesën për lirim me kusht. Megjithatë, çdo vendimmarrje e gjykatës, duhet të bazohet në elementë objektivë dhe konkretë, duke përshkruar qartësisht hapat ligjore të sipërpërmendura, në mënyrë që të bëjë të mundur kontrollin gjyqësor të gjykatave më të larta.

Vlerësojmë të nevojshme dhe të domosdoshme të sillen në vëmendje disa nga standardet ndërkombëtare të pranuara të Këshillit të Evropës në këtë drejtim. Kështu, pika 20 e Rekomandimit kuadër të Këshillit të Evropës

mbi lirimin me kusht parashikon se, gjykatat duhet të zbatojnë kriteret ligjore të lirimit me kusht në mënyrë të barabartë për të gjithë të dënuarit që vlerësohen se përmbushin nivelin minimum për të qenë qytetarë që respektojnë ligjin dhe se barra e provës për të provuar të kundërtën duhet të bjerë mbi autoritetet shtetërore.

Pika 19 e këtij Rekomandimi parashikon se mungesa e mundësisë së punësimit nuk mundet të shërbejë si shkak i ligjshëm për refuzimin apo shtyrjen e lirimit me kusht dhe se duhet të bëhen përpjekje për të gjetur mënyra të tjera të përfshirjes së të dënuarit në aktivitete profesionale. Gjithashtu kjo pikë parashikon se, edhe mungesa e një rezidence të rregullt akomodimi nuk mundet të përbëjë shkak refuzimi apo shtyrje për lirimin me kusht, pasi në këto raste edhe akomodimi i përkohshëm dhe provizor mundet të konsiderohet i mjaftueshëm.

Në këtë linjë arsyetimi dhe vlerësimi ka ecur edhe jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë. Kjo gjykatë ka vlerësuar se është i paligjshëm një vendim gjyqësor që rrëzon kërkesën e lirimit para kohe me kusht vetëm për faktin se një i dënuar është i pastrehë dhe se e ka të pamundur sakaq të realizojë detyrimet që do t'i vendosen gjatë kohës së kushtit. Kjo jurisprudencë, pasi ka sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën e GJEDNJ mbi këtë çështje, ka vlerësuar se të pasurit e një rezidence nuk mundet të jetë ligjërisht kusht për akordimin apo jo të lirimit me kusht, duke qenë se kjo masë ligjore duhet të lidhet vetëm me rehabilitimin e të dënuarit dhe aftësinë e tij për t'u risocializuar.[202]

5.3. Lirimi me kusht i të dënuarve me burgim të përjetshëm

Më lart u trajtua rregullimi ligjor që Kodi Penal bën për lirimin me kusht të të dënuarve me një nga llojet e dënimit kryesor, konkretisht dënimin me burgim. Megjithatë, ky nuk është dënimi kryesor i vetëm, për të cilin ligji lejon zbatimin e lirimit me kusht. Neni 65 i Kodit Penal ka rregulluar dhe ka njohur mundësinë që lirimi me kusht si dënim alternativ të mundet të zbatohet edhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm. Kjo do të thotë se lirimi me kusht si dënim alternativ e shtrin fushën e zbatimit vetëm për dy dënime kryesore penale, konkretisht dënimin me burgim dhe dënimin me burgim të përjetshëm.

[202] *Shih Vendimin nr. 47781, datë 23.12.2008, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

Fakti që legjislatori ka zgjedhur të normojë në dy dispozita të veçanta zbatimin e lirimit me kusht si dënim alternativ për të dënuarit me burgim dhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm, tregon qartë për një vëmendje më të madhe që i ka kushtuar secilit nga rregullimet dhe një dallimi në mënyrën se si gjykata do të vlerësojë secilën nga dy llojet e kërkesave. Nga legjislacionet e hulumtuara për kryerjen e këtij studimi, nuk është konstatuar një teknikë legjislative e ngjashme. Edhe Kodi Penal i Republikës së Italisë, edhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Francës dhe Kodi Penal i Konfederatës së Zvicrës e rregullojnë në një dispozitë të vetme edhe lirimin me kusht për të dënuarin me burgim dhe për të dënuarin me burgim të përjetshëm.

Për më tepër kriteret subjektive që kanë të bëjnë me sjelljen e të dënuarit gjatë ekzekutimit të vendimit penal rregullohen universalisht nga i njëjti paragraf dhe pa bërë dallime ndërmjet këtyre kategorive të të dënuarve. Ajo që ndryshon është vetëm parashikimi ligjor në të njëjtën dispozitë për kohëzgjatjen e kushtit dhe për kohëzgjatjen e periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim, me qëllim që të lindë e drejta për të kërkuar lirimin me kusht.

Megjithatë vlerësojmë se fakti që legjislatori ka ofruar dy dispozita me rregullime të posaçme për lirimin me kusht të të dënuarve me burgim dhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm, nuk duhet të kuptohet se këto dispozita nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Përkundrazi, fillimisht sjellim në vëmendje se interpretimi dhe konkluzionet e secilës duhet të ruhen dhe të zbatohen edhe tek kuptimi i drejtë që i duhet t'i jepet tjetrës. Ato që mundet të jenë të pazbatueshme universalisht për të dy rregullimet, mundet të jenë rregullimet me natyrë ngushtësisht të posaçme, si për shembull afati i periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e lindjes së të drejtës për të kërkuar lirimin me kusht.

Nga ana tjetër gjatë zbatimit të tyre duhet të mbahet parasysh se, neni 64 i Kodit Penal përbën njëkohësisht dispozitë me natyrë të përgjithshme rregullimi dhe njëkohësisht edhe me natyrë të posaçme. Natyra e posaçme e rregullimit vihet re tek parashikimi i periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë parashikimet e tjera ligjore, konkretisht t**ë** mënyrës se si do të përllogaritet afati i vuajtjes dhe se kush do të përfshihet apo jo në këtë afat, apo edhe pamundësia e lirimit me kusht për recidivistët e krimeve të kryera me dashje si një ndër kushtet ndalues, kjo dispozitë ka karakter të përgjithshëm, që do të thotë se zbatohet universalisht qoftë për

të dënuarit me burgim dhe qoftë për të dënuarit me burgim të përjetshëm.

Nën të njëjtën logjikë sjellim në vëmendje se një karakter të përgjithshëm kishte i gjithë paragrafi i tretë, i nenit 64 të Kodit Penal që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve të vitit 2013 e deri në 2017, kur hynë në fuqi ndryshimet e paragrafit të dytë, të nenit 65 të Kodit Penal. Për rrjedhojë vlerësojmë se kjo duhet të jetë qasja që duhet të ketë gjykata në mënyrën se si duhet të zbatohen këto dy dispozita, qoftë në pjesën e parashikimeve të posaçme dhe në pjesën e parashikimeve komplementare.

5.3.1. Kriteret objektive dhe subjektive të lirimit me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm

5.3.1.1. Kriteri objektiv

Në paragrafin e parë të nenit 65 të Kodit Penal, parashikohet mesazhi i parë i ligjvënësit kundrejt gjyqtarit të ekzekutimit dhe vetë të dënuarve me burgim të përjetshëm. Kjo pjesë e dispozitës parashikon se nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm. Kjo pjesë e dispozitës, nën këtë formulim mohues, ka synuar të normojë në ligj rregullin e përgjithshëm, që do të thotë se si rregull të dënuarit me burgim të përjetshëm nuk mundet të lirohen me kusht. Pikërisht në këtë pjesë, merr edhe kuptim rregullimi i posaçëm ligjor i zbatimit të lirimit me kusht si dënim alternativ në dy dispozita, secila për një nga dënimet kryesore, konkretisht dënimin me burgim dhe dënimin me burgim të përjetshëm. Kjo do të thotë se, nga formulimi i posaçëm i paragrafit të parë të nenit 65 të Kodit Penal, merr kuptim edhe vetë neni 64 dhe neni 65 i Kodit. Kjo do të thotë se, zbatimi i lirimit me kusht për të dënuarit me burgim duhet të jetë një qëllim normal dhe rregull i përgjithshëm që organet ligjzbatuese duhet ta mundësojnë, dhe se për rrjedhojë duhet të jetë përjashtim nga rregulli moszbatimi i këtij dënimi alternativ. Nga ana tjetër, për të dënuarit me burgim të përjetshëm rregulli është se ato nuk mundet të përfitojnë nga lirimi me kusht dhe se përjashtimi nga ky rregull është zbatimi i këtij dënimi alternativ.

Paragrafi i dytë i dispozitës, nën të njëjtën logjikë të ndërtimit të normës dhe rregullit sikurse neni 64 i Kodit Penal, rregullon kriterin objektiv dhe subjektiv që duhet të ekzistojnë në mënyrë që një i dënuar të përfitojë nga lirimi me kusht. Ekzitenca e të dy kritereve edhe në këtë rast është kumulative, duke nënkuptuar se nëse një nga ato nuk plotësohet, kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar në ligj dhe si e tillë duhet të rrëzohet me vendim përfundimtar të gjykatës.

Paragrafi i dytë i nenit 65 të Kodit Penal formulohet si më poshtë:

"*Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur:*

Ka vuajtur jo më pak se tridhjetëepesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.".

Fillimisht në këtë paragraf rregullohet kriteri me natyrë objektive, që do të thotë periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim me qëllim që të lindë e drejta për të dënuarin me burgim të përjetshëm për të kërkuar lirimin me kusht. Fillimisht, që nga hyrja në fuqi e Kodit Penal e deri në momentin e ndërhyrjeve ligjore amenduese të vitit 2017 për shkak të reformës në sistemin e drejtësisë, periudha e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e zbatimit të lirimit me kusht ka qenë 25 vjet. Pas amendimit të Kodit Penal me Ligjin nr. 36/2017, periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim u rrit në masën 35 vjet. Në këtë mënyrë legjislatori i reformës në sistemin e drejtësisë, synoi që të unifikojë masën maksimale ligjore të dënimit me burgim me masën e periudhës minimale të vuajtjes së këtij dënimi për qëllimet e zbatimit të lirimit me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm.

Edhe pse neni 65 i Kodit Penal nuk parashikon se si do të përllogaritet periudha minimale dhe e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim prej 35 vjetësh, vlerësojmë se në këtë ometim ligjor gjykatat do të duhet të zbatojnë në mënyrë komplementare nenin 64 të Kodit Penal bashkë me interpretimet me karakter plotësues të rregullimit të kësaj dispozite. *Prima facie* mundet të jetë e vështirë të pranohet se si mundet të përllogaritet periudha e paraburgimit apo uljet e dënimit si shpërblim për sjelljen shembullore të të dënuarit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ndërkohë që dënimi që ai ka është burgimi i përjetshëm dhe si i tillë është i papërcaktuar në kohë, gjë që e bën matematikën zbritëse të pamundur objektivisht të funksionojë.

Për më tepër sjellim në vëmendje se në këtë linjë arsyetimi ka edhe praktikë gjyqësore nga gjykata e faktit. Në këtë praktikë gjyqësore arsyetohet se të dënuarit me burgim të përjetshëm nuk mund të përfitojnë ulje dënimi, pasi nuk mund t'u përllogaritet tek koha e mbetur për të vuajtur, pasqyruar kjo edhe tek dinamika e vuajtjes së dënimit.[203] Megjithatë vlerësojmë se

[203] *Shih për shembull Vendimin nr. 34-2018-1321, datë 23.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.*

ky interpretim është i papranueshëm pasi vjen në kundërshtim me nenin 17 dhe 18 të Kushtetutës dhe nuk është në përputhje me interpretimin sistematik që i duhet bërë nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal.

Sjellim në vëmendje se një çështje e tillë është shtruar për zgjidhje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Italisë nëpërmjet kontrollit incidental kushtetues, kundër një parashikimi ligjor që ndalonte zbatimin e përfitimit të uljes së dënimit për të dënuarit me burgim të përjetshëm, megjithëse ato gjatë vuajtjes së dënimit tregonin se plotësonin kushtet subjektive dhe objektive për përfitimin e këtij benefici ligjor. Gjykata Kushtetuese Italiane ka shfuqizuar normën ligjore që vendoste përjashtimin e aplikimit të uljeve të dënimit për të dënuarit me burgim të përjetshëm, duke konkluduar se një dispozitë e tillë është jokushtetuese, pasi ndalon për këtë kategori dënimesh arritjen e qëllimit kushtetues të risocializimit të të dënuarit.[204] Si përfundim legjislatori italian, duke u konfirmuar menjëherë me këtë jurisprudencë kushtetuese, parashikoi se ky përfitim do të zbatohet edhe për dënimet me burgim të përjetshëm, duke u aplikuar uljet e dënimit mbi periudhën e detyrueshme të burgimit që duhet të vuhet në mënyrë që të lindë e drejta për të kërkuar lirinë me kusht.

Duhet të mbahet parasysh se, qoftë ekuivalentimi me shumëfish i ditëve të vuajtura në paraburgim në ditë burgimi, dhe qoftë uljet e dënimit për sjellje shembullore në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale në rastin e të dënuarve me burgim përllogariten – për efekt të zbatimit të lirimit me kusht si dënim alternativ, – përllogariten mbi masën e periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim. Për rrjedhojë, edhe në rastin e të dënuarve me burgim të përjetshëm ekuivalentimi i paraburgimit me ditë burgimi dhe uljet e dënimit si shpërblim, do të duhet të përllogariten mbi masën e periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim.

Kjo do të thotë se, për hir të parimit të barazisë së trajtimit në ligj të secilës kategori që lejohet të përfitojë nga zbatimi i lirimit me kusht si dënim alternativ, do të duhet të mbahet i njëjti qëndrim mbi mënyrën e përllogaritjes së periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, pasi të njëjtat janë rrethanat e secilit rast. Ajo që ndryshon është rëndësia e dënimit dhe rrezikshmëria e autorit dhe e veprës. Por këto ndryshime nuk mundet të ndikojnë dhe të kenë relevancë juridike dhe faktike në mënyrën e përllogaritjes së periudhës minimale, pasi ajo duhet të jetë universalisht

[204] *Shih Vendimin nr. 274, datë 21.09.1983, të Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Italisë.*

e zbatueshme për çdo rast. Diferencimi në ligj për rrethanat e ndryshme që paraqet lirimi me kusht i të dënuarve me burgim dhe lirimi me kusht i të dënuarve me burgim të përjetshëm, është bërë në masën e periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim dhe se ky diferencim përputhet dhe justifikohet edhe nga qëllimi që ligjvënësi ka marrë, duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet qëllimit të synuar dhe mjeteve kufizuese të përdorura, sipas nenit 17 të Kushtetutës. Por pjesa tjetër, konkretisht mënyra e përllogaritjes së periudhës minimale, duhet të jetë e njëjtë për të gjithë kategoritë e të dënuarve, qoftë e atyre me burgim dhe qoftë e atyre me burgim të përjetshëm.

Fillimisht duhet të mbahet parasysh neni 63 i Ligjit nr. 8328/1998, i cili parashikon në nenin 63 se:

"*Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.*

Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit.".

Në këtë mënyrë nga leximi i dispozitës nuk rezulton të jetë përjashtuar asnjë kategori e të dënuarve. Për më tepër, ligjvënësi ka parashikuar se në këtë përfitim do të përfshihen edhe të dënuarit që vuajnë dënimin në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe në ato të sigurisë së lartë, që do të thotë se në këtë përfitim, titullar mundet të jenë edhe të dënuarit me burgim të përjetshëm.

Për rrjedhojë konkludojmë se, për efekt të zbatimit të drejtë të nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, ekuivalentimi i periudhës së paraburgimit dhe uljet e dënimit si shpërblim për të dënuarit me burgim apo me burgim të përjetshëm, do të përllogariten mbi periudhën minimale dhe të detyrueshme që ligji parashikon si kriter objektiv për lindjen e së drejtës për të kërkuar lirim me kusht si dënim alternativ. Nga ana tjetër, nën të njëjtën mënyrë arsyetimi, konkludojmë se as amnistia dhe as falja nuk do të mundet të përllogariten në periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim, qoftë për të dënuarit me burgim apo për ato me burgim të përjetshëm.

Ajo që mundet të shkaktojë diskutim është edhe pyetja nëse gjykata do të duhet ta përllogarisë periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes

së dënimit me burgim në momentin e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht në gjykatë, apo do të duhet të ushtrojnë një kontroll të përditësuar të kësaj periudhe edhe gjatë ekzekutimit dhe deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar mbi kërkuesën.

Jurisprudenca italiane ka mbajtur qëndrimin se, për efekt të përllogaritjes së afatit minimal të dënimit me burgim që duhet të vuhet nga të dënuarit me burgim të përjetshëm, para se atyre t'i lindë e drejta të kërkojnë lirimin me kusht, gjykata do të duhet t'i referohet datës kur është paraqitur kërkesa dhe jo një date të mëvonshme.[205]

Megjithatë vlerësojmë se një formalizëm i tillë, megjithëse është korrekt me shkronjën e ligjit, nuk i shërben as miradministrimit të drejtësisë penale, as vetë *ratio*-s së institutit, as gjykatës, as të dënuarit, dhe aq më pak shoqërisë. Ndaj vlerësojmë se kërkesa, pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme se sa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës që - në rast se në momentin e shqyrtimit vlerëson se afati është plotësuar – të vendosë pranimin e saj për shqyrtim dhe zgjidhjen në themel të kërkesës. Një qëndrim i tillë formal do të detyronte që minimumi edhe 6 muaj i dënuari të qëndrojë sërisht në burgim, vetëm për faktin se neni 477, pika 2, e Kodit të Procedurës Penale parashikon se kjo kërkesë nuk mundet të paraqitet pa kaluar një afat prej gjashtë muajsh nga momenti që vendimi i rrëzimit të kërkesës të ketë marrë formë të prerë. Sakaq konstatohet se kjo mënyrë formaliste interpretimi detyron vuajtjen e dënimit me burgim edhe me gjashtë muaj për një të dënuar që potencialisht nuk duhet të vuajë më dënim me burgim. Rezultati i këtij interpretimi është padyshim antikushtetues dhe i paligjshëm.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, të cilat janë studiuar për qëllimet e këtij studimi, është konstatuar se është pranuar në mënyrë konstante dhe të përgjithshme se afati i periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e akordimit të lirimit para kohe me kusht përllogaritet në mënyrë të përditësuar, deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar. Ndryshe ka qenë qëndrimi i prokurorisë në këto seanca gjyqësore, e cila ka kërkuar që gjykata të mbajë qëndrimin formal të përllogaritjes së plotësimit apo jo të kësaj periudhe sipas datës së dorëzimit në gjykatë të kërkesës. Sigurisht kjo mënyrë interpretimi shmang formalizmat e tepruara dhe garanton më shumë

[205] *Shih Vendimin nr. 35648, datë 01.102001, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

aksesin e të dënuarve tek ky lloj dënimi alternativ, duke i dhënë më shumë përparësi themelit të kushteve apo kritereve ligjore se sa aspekteve formale.

Për më tepër, në rastin e Shqipërisë këtë mënyrë vlerësimi të përditësuar të përllogaritjes së periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, e kushtëzon edhe sentenca e dytë nomofilatike e Vendimit Unifikues 2/2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë pjesë të vendimit është unifikuar praktika gjyqësore duke vendosur se:

"Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale" ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal.

Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.".

Për rrjedhojë konkludojmë se gjykata e ka detyrë ligjore që të kontrollojë dhe të përllogarisë afatin e periudhës së vuajtur të dënimit në mënyrë të përditësuar dhe deri në momentin e vendimmarrjes përfundimtare, pasi vetëm në këtë mënyrë ajo do të jetë në gjendje që të përcaktojë me saktësi se sa është periudha e mbetur e dënimit me burgim e cila do të pezullohet, dhe që do të shërbejë për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Për rrjedhojë konkludojmë se, gjykatat janë të detyruara të përllogarisin në mënyrë të përditësuar kohën e vuajtur dhe të mbetur të dënimit me burgim dhe se kjo përllogaritje do të duhet të bëhet deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar mbi kërkesën e lirimit me kusht.

Një ndër problematikat që mundet të sjellë llogaritja e afatit të periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e zbatimit të lirimit me kusht, është përllogaritja e saj në rastet e bashkimit të dënimit. Kuptohet se përllogaritja e kësaj periudhe do të bëhet mbi dënimin e bashkuar, dhe jo mbi dënimet veçmas të dhëna nga gjykata para bashkimit. Kjo zgjidhje diktohet nga vetë nevoja ligjore për të bashkuar dënimet me qëllim që të caktohet qartë dënimi penal përfundimtar që do të duhet të ekzekutohet. Për rrjedhojë konkludojmë se, në rastet e dënimit të bashkuar do të jetë pikërisht ky dënim fundor që do të duhet të merret si referim për efektet e zbatimit të përllogaritjes së periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes, për qëllimet e zbatimit të lirimit me kusht.

I debatueshëm mbetet edhe rasti kur dënimi i bashkuar lind nevoja sërish të bashkohet gjatë ekzekutimit të tij me një dënim tjetër që i dënuari merr për një vepër penale që kryehet gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, ose që mundet ta ketë kryer përpara dhe që nevoja për ta bashkuar lind më vonë se sa ekzekutueshmëria e vendimit të vënë tashmë në ekzekutim. Sipas nenit 64 të Kodit Penal, në rastet kur vepra penale e dytë është krim dhe është kryer me dashje nuk lejohet kategorikisht lirimi me kusht, e për rrjedhojë nuk shtrohet fare për diskutim përllogaritja e afatit minimal të vuajtjes së dënimit. Kjo do të thotë se kjo përllogaritje sipas kësaj problematike do të duhet të marrë zgjidhje për rastet e tjera.

Jurisprudenca kasacionale italiane mban qëndrimin se afati minimal dhe i detyrueshëm i vuajtjes së dënimit me burgim për të dënuarit me burgim të përjetshëm, për qëllimet që kësaj kategorie subjektesh t'u lindë e drejta për të kërkuar lirimin para kohe me kusht, është i pavarur dhe se duhet të llogaritet pavarësisht bashkimit të tij me dënimet e tjera me burgim më të lehta, të cilat kanë qenë duke u vuajtur më parë se të ndodhte bashkimi.[206] Kjo do të thotë se, nëse një i dënuari me burgim me një afat të caktuar po vuan dënimin dhe ndërkohë ai kryen një vepër penale tjetër gjatë kësaj kohe dhe për të dënohet me burgim të përjetshëm dhe gjykata sipas ligjit më tej bashkon dënimet, në mënyrë që atij t'i lindë e drejta të kërkojë lirimin para kohe me kusht, duhet të vuajë minimunim ligjor të kërkuar duke nisur ky afat nga dhënia e dënimit me burgim të përjetshëm dhe se nuk mundet të llogaritet nisja e këtij afati me momentin e nisjes së vuajtjes së dënimit me burgim me afat më të vogël.

Duke u bashkuar plotësisht me këtë linjë arsyetimi dhe me këtë zgjidhje ligjore, shtojmë se e njëjta zgjidhje do të duhet të jepet edhe kur vepra penale më e lehtë ndodh më pas nisjes së ekzekutimit të vendimit. Në këtë rast, nëse lejohet zbatimi i lirimit me kusht, atëherë periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim do të llogaritet mbi dënimin e bashkuar rishtazi.

Nga një vështrim krahasimor mbi periudhën minimale të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim për të dënuarit me burgim të përjetshëm në legjislacionin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, konstatohet se nuk ka një konsensus mbi një sasi të caktuar të kësaj periudhe. Nga analiza dhe hulumtimi i kryer vihet re se, ka nëntë shtete në Këshillin e Evropës që nuk e njohin dënimin me burgim të përjetshëm, konkretisht: Andora,

[206] *Shih Vendimin nr. 20981, datë 04.05.2004, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Spanja, Mali i Zi, Norvegjia, Portugalia, San-Marino dhe Serbia.

Nga ana tjetër, në shtete të tjera të Këshillit të Evropës, të cilat e njohin dënimin me burgim të përjetshëm, ekziston një mekanizëm i posaçëm për të rishqyrtuar dënimet, duke fiksuar në çdo rast një kohë të caktuar në ligj pas plotësimit të së cilës një rishqyrtim i tillë i dënimit mundet të bëhet. Shteti që ka periudhën më të vogëm minimale të vuajtjes së dënimit me burgim para se të lindë e drejta për të kërkuar lirim me kusht është Suedia, e cila e parashikon 10 vjet. Më tej vjen Danimarka dhe Qipro me 12 vjet. në Gjermani kjo periudhë është 15 vjet. Të njëjtin parashikim ka edhe neni 86 pika 5, i Kodit Penal të Konfederatës së Zvicrës. E njëjta zgjidhje ligjore është bërë n**ë** Austri, Monako, Luksemburg, Lihtenshtejn, apo në Belgjikë, e cila parashikon edhe një mundësi zgjatje deri në 19 apo 23 vjet për përsëritësit ligjorë. Franca këtë periudhë e parashikon 18 vjet dhe 22 vjet për përsëritësit legal, sipas nenit 729 paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale. Në Greqi, Armeni dhe në Bullgari periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim është 20 vjet. Hungaria e parashikon këtë periudhë si rregull 20 dhe i jep mundësinë gjyqtarit të vendosë ndryshe sipas karakteristikave të rastit objekt gjykimi. Më tej, në Letoni, Poloni, Rumani, Rusi, Slloveni, Azerbajxhan dhe Gjeorgji periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim është 25 vjet. Në Itali kjo periudhë është 26 vjet[207]. Në Moldavi kjo periudhë është 30 vjet. Në Turqi periudha minimale është 24 vjet, 30 vjet dhe në rastet e akumulimit të disa dënimeve dhe kur bashkohen disa dënime me burgim të përjetshëm periudha shkon në masën 36 vjet.[208]

Nga legjislacionet penale të studiuara për qëllimet e këtij studimi është konstatuar se, Kodi Penal më i ashpër në këtë drejtim është ai i Republikës së Kosovës.[209] Kështu në nenin 94 të këtij Kodi Penal, periudha minimale e

[207] Në Kodin Penal të Republikës së Italisë dënimi me burgim të përjetshëm rregullohet në nenin 22 ndërsa në nenin 176 dhe 177 t**ë** këtij Kodi rregullohet lirimi me kusht. Kështu neni 176 i Kodit Penal Italian parashikon se, nëse i dënuari me burgim, gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit, ka mbajtur një sjellje të tillë nga e cila konkludohet në mënyrë të sigurt pendimi i tij, mundet të lirohet me kusht, nëse ka konsumuar të paktën 30 muaj dhe detyrimisht gjysmën e dënimit të dhënë, kur dënimi i mbetur nuk kalon 5 vjet. Kjo dispozitë parashikon se për se i përket recidivistëve sipas ligjit, i dënuari, në mënyrë që të lirohet me kusht, duhet të vuajë 4 vjet dënim dhe jo më pak se ¾ e dënimit të dhënë. Paragrafi i tretë i kësaj norme parashikon se i dënuari me burgim të përjetshëm mundet të lirohet me kusht kur ka vuajtur të paktën 25 vjet të dënimit të dhënë.

[208] *Shih çështjen "Vinter et autres c. Royaume-Uni", Req. no. 66069/09, 130/10 et 3896/10, CEDH, d. 9 Juillet 2013, faqe 25 – 26.*

[209] *Shih në web: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834.*

detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim për të dënuarit me burgim të përjetshëm është parashikuar 40 vjet.

Në Mbretërinë e Bashkuar, konkretisht në Skoci, në momentin e dhënies së dënimit me burgim të përjetshëm gjyqtari duhet të përcaktojë një periudhë kohëzgjatje minimale të dënimit me burgim, kur gjasat janë që ky dënim mundet të kalojë numrin e viteve që i mbetet të dënuarit për të jetuar, nisur nga mosha e tij.[210] Në këtë mënyrë kjo zgjidhje ligjore i jep mundësi gjykatës që të jetë fleksibël në caktimin e dënimit sipas rrethanave të çështjes.

Ndërkohë në Angli, që nga abrogimi i dënimit me vdekje, vrasja si vepër penale dënohet me burgim të përjetshëm të detyrueshëm (*mandatory sentence of life imprisonment*), duke qenë të detyruara gjykatat që në dhënien e vendimit të caktojnë një periudhë minimale burgimi (*minimum term of imprisonment*), në funksion të rëndësisë së veprës së kryer, që do të duhet të kryhet për qëllimet e ndëshkimit që dënimi ndjek.[211] Pasi të jetë vuajtur kjo periudhë burgimi e caktuar nga gjykata, atëherë i dënuari mundet të kërkojë para komisionit të lirimit me kusht që ndaj tij të aplikohet lirimi me kusht. Megjithatë, në raste përjashtimore për nga natyra e veprës penale, gjykata mundet të caktojë edhe dënim me burgim të përjetshëm pa të drejtën e të dënuarit që të kërkojë rishqyrtimin e dënimit (ë*hole life order*).

I vetmi mjet që mbetet për këtë kategori të dënuarish është e drejta dhe kompetenca me natyrë diskrecionare e Ministrit të Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 30 të këtij ligji. Ky ligj parashikon se kjo kompetencë mundet të ushtrohet vetëm në raste përjashtimore për motive humanizmi, kur i dënuari është në momentet e fundit të jetës për shkak të sëmundjes apo shkaqe natyrore apo kur ai vuan nga një invaliditet i rëndë.[212]

Ndër shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, janë pesë prej tyre që nuk e parashikojnë mundësinë e ndryshimit të dënimit me burgim të përjetshëm. Kështu në Islandë, në Holandë, në Lituani, në Ukrahinë dhe në Maltë nuk ka parashikime ligjore që të lejojnë të ndryshohet dënimi me burgim të përjetshëm. Megjithatë ligjet e këtyre shteteve lejojnë që të dënuarit me burgim të përjetshëm të kërkojnë falje apo ndryshim të dënimit nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë apo kreut të shtetit. Në Islandë, megjithëse kjo mundësi parashikohet, nuk ka ndodhur që të zbatohet mbi këto të dënuar.[213]

[210] *Shih ligjin e vitit 2001 mbi respektimin e të drejtave të parashikuara në Konventë të Skocisë ("Convention Rights (Compliance)(Scotland) Act 2001").*

[211] *Shih Ligjin e vitit 2003, Criminal Act 2003, Aneksi 21.*

[212] *Shih parashikimet e Ordonancës mbi administrimin penitenciar të Anglisë nr. 4700.*

[213] *Shih çështjen "Vinter et autres c. Royaume-Uni", Req. no. 66069/09, 130/10 et 3896/10, CEDH, d. 9 Juillet 2013, faqe 26.*

Megjithatë ka edhe modele legjislacionesh që, megjithëse e njohin mundësinë e ndryshimit të dënimit me burgim të përjetshëm, njëherazi e përjashtojnë me ligj aksesin në këtë mundësi për disa vepra penale. Ndër këto shtete mund të sjellim në vëmendje: Bullgarinë, Anglia dhe Irlanda[214], Hungaria, Sllovakia, Turqia dhe Shqipëria.[215]

5.3.1.2. Kriteret subjektive

Lidhur me kriteret subjektive të lirimit me kusht të të dënuarve me burgim të përjetshëm, neni 65 i Kodit Penal ka parashikuar se ato duhet të kenë mbajtur sjellje shembullore gjatë vuajtjes së dënimit me burgim dhe njëkohësisht gjykata duhet të konkludojë se është arritur qëllimi i dënimit për edukimin dhe mundësinë e socializmit të të dënuarit. Vlerësojmë se për analogji do të duhet të vlejnë të gjitha vlerësimet dhe arsyetimet e dhëna më lart këtij punimi, në pjesën ku janë trajtuar arritja e qëllimeve penalogjike të dënimit penal për llogari të interpretimit të nenit 64 të Kodit Penal. Sikurse kanë konkluduar Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr. 2/2015, vlerësojmë se kriteret subjektive të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal do të vlejnë njëlloj edhe për kriteret subjektive të parashikuara nga neni 65 i Kodit Penal.

Magjithatë në praktikën e pakët gjyqësore që ka për zbatimin e nenit 65 të Kodit Penal, vihet re se togfjalëshi "*raste të jashtëzakonshme*" nuk interpretohet nën logjikën e jurisprudencës unifikuese. Raste të jashtëzakonshme në këtë linjë arsyetimi lidhen me shkaqe që nuk kanë të bëjnë me sjelljen e të dënuarit, por që lidhen me rrethanat shëndetësore të tij, të familjarëve të tij, me fatkeqësitë familjare, rrethanat sociale dhe ekonomike, duke kërkuar kështu detyrimisht ekzistencën e këtyre rrethanave për t'i ndërthurur edhe me sjelljen e të dënuarit.[216]

Vlerësojmë se një vlerësim i tillë është i gabuar. Sikurse është sqaruar më lart dhe sikurse Vendimi Unifikues nr. 2/2015 ka konkluduar, do të duhet të mbahet parasysh se gjithmonë lirimi me kusht lidhet vetëm me sjelljen e të dënuarit dhe se nuk mundet të konstituohen kushte apo kritere objektive të

[214] *Shih çështjen "Vinter et autres c. Royaume-Uni", Req. no. 66069/09, 130/10 et 3896/10, CEDH, d. 9 Juillet 2013, faqe 26.*

[215] *Shih çështjen "Vinter et autres c. Royaume-Uni", Req. no. 66069/09, 130/10 et 3896/10, CEDH, d. 9 Juillet 2013, faqe 25 – 26.*

[216] Shih Vendimin nr. 34-2020-50, datë 24.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në këtë vendim ndër të tjera arsyetohet se: *"…ekzistojnë "rastet e jashtëzakonshme" që lidhen pikërisht me gjendjen shëndetësore, familjare, shoqërore të të dënuarit…të ndërthurura me shkallën e tij të rehabilitimit dhe të mundësisë së integrimit në shoqëri.".*

tjera, veç atyre që ligji penal ka parashikuar shprehimisht. Rrethana të tilla, sikurse kjo praktikë gjyqësore e gabuar pranon, nuk janë determinante për të akorduar lirimin me kusht apo jo por kanë gjithmonë natyrë motivesh komplementare se pse gjykata krijon bindjen e brendshme për pranimin e kërkesës.

Në këtë mënyrë, togfjalëshi "*raste të jashtëzakonshme*" do të duhet të interpretohet brenda kritereve objektive dhe subjektive që ligji ka parashikuar shprehimisht. Por ajo që ligji ka synuar të shquajë me mbiemrin të jashtëzakonshëm, është fakti që bindja e gjykatës për rehabilitimin dhe risocializimin e të dënuarve me burgim të përjetshëm duhet të formësohet nëpërmjet rrethanave të jashtëzakonshme që provojnë vërtetësinë e pretendimeve të të dënuarit dhe riaftësimin e tij për t'u risocializuar. Kjo do të thotë se, ligji penal ka paragjykuar dhe ka prezumuar se autorë të veprave penale të tilla dhe me rrezikshmëri kaq të madhe rehabilitohen si raste të jashtëzakonshme, ndryshe nga kategoria e të dënuarve me burgim sipas nenit 64 të Kodit Penal.

Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se, çdo rrethanë që paraqitet në vendim për të justifikuar lirimin me kusht, do të duhet të instrumentalizohet si argument prove për të formësuar bindjen e gjykatës për riaftësimin social të të dënuarit dhe se ato nuk kanë rëndësi në vetvete. Kjo do të thotë se sado rrethana të ketë, nëse ato nuk kanë lidhje me një të dhënë të caktuar apo konkluzion që provon faktin e riaftësimit social, ato nuk mundet të mbështesin kërkesën për lirim me kusht. Në këtë mënyrë, çdo rrethanë që përmendet në vendim duhet të shoqërohet nga rrëfimi i detajuar dhe i arsyetuar i gjyqtarit se pse ajo tregon, ndihmon apo bind, për riedukimin e kërkuesit.

5.3.2. Kushtet ndaluese për lirimin me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm

Sikurse u përmend edhe më lart dhe sikurse në pjesën hyrëse të këtij studimi mundet të konstatohet nga kronologjia e ndërhyrjeve në dispozitat e Kodit Penal që normojnë lirimin me kusht, ndalesa kategorike për zbatimin e këtij dënimi alternativ në Shqipëri për herë të parë është prezantuar nga Ligji nr. 144/2013, me të cilin ndër të tjera u amendua edhe paragrafi i tretë i nenit 64 të Kodit Penal.

Më tej ky rregull u përsërit edhe në paragrafin e fundit të nenit 65 të Kodit Penal, nga ndërhyrjet ligjore të viti 2017. Kësaj radhe konfirmimi i

normimit penal erdhi si pasojë e një prej gjetjeve të analizës dhe studimit që parapriu reformën në sistemin e drejtësisë në vitin 2015, nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë i mandatuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar i Reformës në Sistemin e Drejtësisë.[217]

Sot neni 65 i Kodit Penal në paragrafin e fundit parashikon se nga mundësia për lirimin me kusht nuk mundet të përfitojnë të dënuarit me burgim të përjetshëm të cilët janë të dënuar për veprat penale si më poshtë:

i) Neni 78/a i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "Vrasja për gjakmarrje"[218];
ii) Neni 79/a i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Vrajses së funksionarëve publikë*"[219];
iii) Neni 79/b i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit*"[220];
iv) Neni 79/c i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare*"[221];
v) Neni 100, paragrafi i tretë i Kodit Penal, konkretisht vepra penale e titulluar "*Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur*"[222].

Nga leximi i nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal kuptohet se legjislatorit nuk i ka mjaftuar ndryshimi i paragrafit të tretë të nenit 64 në vitin 2013, ku për herë të parë në historinë e ligjit penal shqiptar u parashikuan kufizime kategorike dhe aprioristike të lirimit me kusht. Kështu legjislatori ka dashur ta rregullojë, jo vetëm në mënyrë të përgjithshme por edhe në mënyrë të

[217] Shih "*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*", Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qershor 2015, faqe 158.

[218] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[219] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[220] Kjo dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[221Kjo] dispozitë parashikon se: "*Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

[222] Ky paragrafi i dispozitës parashikon se: "*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*".

posaçme, përjashtimin aprori dhe kategorik të të gjithë të dënuarve me burgim të përjetshëm për veprat penale të renditura më lart.

Vlerësojmë se kjo teknikë legjislative që ka përdorur ligjvënësi është e gabuar në rastin më të keq, dhe e metë në rastin më të mirë. Sjellim në vëmendje se neni 64 i Kodit Penal është njëkohësisht edhe dispozitë e përgjithshme për lirimin para kohe me kusht në përgjithësi, dhe dispozitë e posaçme për rregullimin e lirimit me kusht në veçanti për të dënuarit me burgim, si një nga llojet e dënimeve kryesore që Kodi Penal njeh. Për rrjedhojë nuk ka vend për të përsëritur në mënyrë të posaçme një rregull i cili është tashmë i vendosur si rregull i përgjithshëm, konkretisht në paragrafin e tretë të nenit 64 të Kodit Penal.

Ajo që është krejt e gabuar në këtë teknikë të paekonomizuar dhe të përsëritur në mënyrë të panevojshme legjislative, është fakti se paragrafi i tretë nuk është marrë i gjithi nga neni 64 i Kodit Penal për t'u përsëritur njëlloj në nenin 65 të tij, por është marrë në mënyrë të pjesshme, duke lënë pa marrë si shkak ndalimi kategorik dhe subjektiv rrethanën e autorit recidivist për krime të kryera me dashje.[223] Interpretuar sipas mënyrës dhe logjikës së ligjvënësit në teknikën legjislative të përdorur në ndërhyrjen në nenin 65 të Kodit Penal, ky ometim i paragrafit të fundit të nenit 65 do të duhet të çonte në konkluzionin se, për personat e dënuar për krime me dashje të cilët dënohen me burgim të përjetshëm për vepra penale që nuk përfshihen në mënyrë eksplicite të individualizuar nga kjo dispozitë, është i mundur lirimi me kusht. Por sigurisht një konkluzion i tillë do të ishte i papranueshëm, pasi paragrafi i tretë i nenit 64 i Kodit Penal është një parashikim ligjor që vepron universalisht për çdo të dënuar me burgim, qoftë i dënuar me burgim apo me burgim të përjetshëm.

Për rrjedhojë konkludojmë se janë të përjashtuar apriori dhe kategorikisht nga zbatimi i dënimit alternativ të lirimit me kusht, të gjithë të dënuarit me burgim të përjetshëm që më parë kanë kryer krime me dashje dhe janë dënuar për to me vendime gjyqësore të formës së prerë, edhe kur dënimi me burgim të përjetshëm nuk është dhënë për veprat penale të parashikuara nga neni 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, dhe paragrafi i tretë i nenit 100 të Kodit Penal. Gjithashtu janë të përjashtuar apriori dhe kategorikisht nga zbatimi i lirimit me kusht si dënim alternativ, të gjithë të dënuarit me burgim të

[223] Konstatim i bërë edhe nga Njazi Jaho, "*Për burgimin e përjetshëm dhe dënimet fikse*", Revista Avokatia Nr. 32, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Shih në web: http://avokatia.al/revista/18-avokatia-32/65-harmonizime-32.

përjetshëm për veprat penale të parashikuara nga neni 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, dhe paragrafi i tretë i nenit 100 të Kodit Penal.

5.4. Periudha e kohëzgjatjes së kushtit

Ometimi ligjor më i madh që ka pasur që nga hyrja në fuqi Kodi Penal i vitit 1995, lidhur me rregullimet e lirimit me kusht si dënim alternativ, është mungesa e një dispozite eksplicite që të rregullojë qartë kufijtë e kohëzgjatjes së kushtit, qoftë kufirin minimal dhe atë maksimal. Ndryshe ka ndodhur me dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit penal dhe vënien e të dënuarit në provë, sipas nenit 59 të Kodit Penal. Në këto raste ligji është i qartë dhe ka qenë i tillë nga fillimi lidhur me periudhen e kohëzgjatjes së këtij dënimi alternativ penal.

Interesant është fakti se historia e Shtetit Shqiptar ka njohur 5 Kode Penale ndër vite, sikurse janë parashtruar në pjesën e parë të këtij studimi. Vetëm njëri prej tyre, konkretisht Kodi Penal i vitit 1948, ka pasur një dispozitë eksplicite që rregullonte në mënyrë të posaçme kohëzgjatjen e kushtit në dënimin alternativ të lirimit me kusht. Kështu pika 3 e nenit 85 të Kodit Penal të vitit 1948 parashikonte se:

"*(3) Lirimi kondicional vazhdon gjer në mbarimin e kohës për të cilën është dhënë dënimi dhe në rastin e dënimit me privim të lirisë për jetë me punë të detyruar, dhjet vjet pas lirimit nga vuajtja e këtij dënimi.*".

Që prej këtij parashikimi ligjor në ligjin penal shqiptar, konkretisht në tre kodet pasuese përfshirë edhe Kodin Penal në fuqi, nuk ka pasur një dispozitë eksplicite që të përcaktojë marzhet minimale dhe maksimale të kohëzgjatjes së kushtit.

Në kushtet e një boshllëku të tillë ligjor, në praktikën gjyqësore janë shfaqur disa interpretime. Referuesit e njërës ide mendojnë se koha e kushtit duhet të jetë sa pjesa e pavuajtur e dënimit për të cilën i dënuari lirohet me vendim gjykate. Pra, përgjithësisht kohëzgjatja e kushtit për këta përkrahës, nisur nga kriteri përcaktues që ata përdorin, është një kohë relativisht e vogël. Përkrahësit e idesë së dytë mendojnë dhe mbështesin idenë se koha e kushtit duhet të jetë sa koha (afati) i vënies në provë të personit, duke referuar sakaq me analogji tek neni 59 i Kodit Penal. Gjithashtu rezulton se ekziston dhe një qëndrim tjetër jo shumë i përhapur sipas të cilit koha e kushtit duhet të jetë sa afati i parashkrimit i veprës penale për të cilën është dënuar shtetasi. Duke qenë se kjo ide i vë të gjithë të dënuarit e liruar me

kusht në pozita jo të favorshme, ajo nuk ka gjetur mbështetje në praktikën gjyqësore.[224]

Në literaturën juridike shqiptare mbi dënimet alternative është analizuar se ligjvënësi në nenin 64 të Kodit Penal përdor në formulim termin "gjatë kohës së kushtit", duke vlerësuar se duke qenë një parashkrim i tillë, kjo kohë nuk mund të njehsohet me kohën e provës, por do jetë një kohë tjetër. Ky argument përforcohet më tepër edhe nga fakti se dispozita ka pasur ndryshime kohët e fundit dhe nëse ligjvënësi do kishte si qëllim që kjo kohë të ishte e njëjtë me kohën e provës, nuk do të kishte asnjë pengesë që ta parashikonte shprehimisht tek kjo dispozitë. Pra, qëllimi i ligjvënësit ka qenë për një kohë tjetër kushti, të ndryshme nga ajo e provës. Ajo që ligjvënësi nuk ka zgjidhur është pikërisht afati i kësaj kohe kushti. Megjithatë, në këtë situatë faktike për oportunitet ligjor, koha e provës do ishte një afat kohe i përshtatshëm që mund të shërbente edhe si afat kushti, deri në një rregullim ligjor të dispozitës.[225]

Në vitin 2015, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh se në praktikën gjyqësore ka pasur praktika gjyqësore të ndryshme, vendosën ta unifikojnë këtë ometim të ligjvënësit. Ato shtruan për zgjidhje çështjen si më poshtë:

Në rastin kur pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, a duhet gjykata të caktojë gjithashtu një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë? Nëse po, sa duhet të jetë ky afat i mbajtjes në provë?

Prokuroria e Përgjithshme dhe mbrojtja e të gjykuarit mbajtën qëndrimin se kohëzgjatja e kushtit tek dënimi alternativ i lirimit me kusht do të jetë e barabartë me pjesën e mbetur të dënimit që pezullohet. Pikërisht këtë qëndrim ndau edhe shumica e gjyqtarëve në këtë vendim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësuan se, ndryshe nga neni 59 i Kodit Penal (Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë) - i cili ndonëse është një institut i ndryshëm nga ai i lirimit me kusht, përmban gjithsesi elemente të përbashkët me të, – neni 64 i Kodit Penal nuk shprehet në lidhje me mundësinë e caktimit, në rast pranimi të kërkesës nga ana e gjykatës, të një periudhe prove ku i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Kolegjet sollën në vëmendje se, po kjo

[224] Shih "*Manual mbi aplikimin e alternativave të dënimit me burgim*", OSBE 2010, Arta Mandro Balili, Marsida Xhaferllari, Gerd Hoxha, Admir Belishta, faqe 73 – 74.

[225] Shih "*Manual mbi aplikimin e alternativave të dënimit me burgim*", OSBE 2010, Arta Mandro Balili, Marsida Xhaferllari, Gerd Hoxha, Admir Belishta, faqe 73 – 74.

dispozitë ka parashikuar indirekt se në të vërtetë ka një periudhë prove nën të cilën i dënuari vëzhgohet dhe detyrohet të plotësojë detyrimet që gjykata i ka caktuar.

Kolegjet e Bashkuara sollën në vëmendje se, në lidhje me kohën e provës, as neni 64 i Kodit Penal, dhe as ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 "*Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale*", nuk jep ndonjë afat minimal apo maksimal të periudhës së kushtit. Në këtë kuptim, Kolegjet vërejnë se në disa raste praktike gjyqësore, gjykatat kanë zgjedhur për analogji, kohën e caktuar nga neni 59 i Kodit Penal, që varion nga 18 muaj deri në 5 vjet. Kolegjet e Bashkuara nuk ndajnë këtë qëndrim.

Kolegjet e Bashkuara arsyetuan se, *së pari*, në rastin e nenit 59 të Kodit Penal, i dënuari nuk vuan dënimin në një IEVP dhe vihet në provë, ndërkohë që në rastin e të liruarit me kusht, i dënuari ka vuajtur një pjesë të konsiderueshme të masës së dënimit; është riedukuar; ndërkohë që qëllimi i mbajtjes së kontaktit me Shërbimin e Provës është vetëm kapërcimi i vështirësive për riintegrimin social të të dënuarit. Kolegjet kanë arsyetuar se, për më tepër, kohëzgjatja e tepërt e periudhës së provës nuk është e justifikuar pasi "benefiti" për të liruarin me kusht është shumë herë më i vogël se në krahasim me të dënuarin që i pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim.

Gjithashtu Kolegjet e Bashkuara mbajtën parasysh se, për sa kohë që ligjvënësi nuk ka përcaktuar qartë periudhën e kushtit, nuk mundet që gjykatat të marrin përsipër rolin e ligjvënësit duke caktuar në mënyrë arbitrare periudhën e kushtit për personin që lirohet me kusht. Në këtë kuptim, Kolegjet vlerësojnë se në mungesë të një rregullimi ligjor mbi periudhën e kushtit dhe referim të qëllimit të institutit të lirimit me kusht, kjo kohë nuk mund të jetë më e shkurtër se koha që i mbetet për t'u vuajtur të dënuarit. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, ky interpretim mbështetet edhe në argumentin se ndërkohë që çdo caktim i periudhës së kushtit përtej kohës së mbetur të dënimit do të konsiderohej si i pambështetur në ligj, rasti i kundërt, pra caktimi i një periudhe kohe më të shkurtër se koha e mbetur e dënimit, do të shkonte kundër qëllimit të institutit të lirimit me kusht si dhe do të ulte efektivisht masën e dënimit të dhënë nga gjykata me vendim të formës së prerë.

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në qëndrimin unifikues si më poshtë:

"*Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.*".

Në këtë vendim unifikues ka edhe qëndrime në pakicë të gjyqtarëve. Oponenca është bërë duke konkluduar se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk mundet të ndryshojnë apo të amendojnë ligjin por vetëm ta interpretojnë atë. Sipas këtij qëndrimi, në kushtet kur ligji hesht, do të duhet të zbatohet si afat i kohëzgjatjes së kushtit, neni 59 i Kodit Penal.[226] Megjithatë është i pashpjegueshëm fakti se ndryshe kanë arsyetuar, ndryshe kanë unifikuar praktikën gjyqësore dhe ndryshe e kanë zgjidhur çështjen në këtë rast Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi kanë lënë ndër të tjera në fuqi pikën e dispozitivit të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilën ishte caktuar kohëzgjatja e kushtit më e madhe se periudha e mbetur e dënimit me burgim, duke zbatuar sakaq me analogji nenin 59 të Kodit Penal.[227]

---

[226] Pakica e parë në Vendimin Unifikues nr. 2/2015 ka arsyetuar se:
"*Edhe në pikën e dytë të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse ato kanë dalë jashtë funksionit të tyre kushtetues, duke caktuar vetë afate, pra në këtë pikë të vendimit, Kolegjet e Bashkuara kanë bërë të kundërtën e asaj që kanë bërë në pikën e parë unifikuese të vendimit, ku kanë shfuqizuar pjesërisht ligjin (në pikën e dytë unifikuese ato kanë bërë ligj të ri).*
Neni 64 i Kodit Penal dhe ligji nr.8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale" nuk parashikojnë ndonjë afat minimal apo maksimal të periudhës së kushtit. Në disa raste gjykatat kanë zgjedhur për analogji, kohën e caktuar nga neni 59 i Kodit Penal, që varion nga 18 muaj deri në 5 vjet. Shumica është kundër këtij qëndrimi që ka mbajtur praktika gjyqësore, duke arritur në qëndrimin unifikues se: Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim, për të dënuarin që lirohet me kusht.
Jam i mendimit se në rastin konkret nuk janë gjykatat më të ulëta ato që kanë marrë rolin e ligjvënësit (ashtu siç arsyeton shumica), pasi ato i janë referuar një afati që është i parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal, i cili nuk i përket lirimit para kohe me kusht, por dënimit me kusht. Duhet theksuar se këto dy institute të së drejtës penale janë të ngjashme me njëri-tjetrin, prandaj rolin e ligjvënësit e kanë marrë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë caktuar afate të reja (që janë të ndryshme për të dënuar të ndryshëm). Meqenëse për këtë moment ka boshllëk ligjor, pakica pajtohet plotësisht me qëndrimin që ka mbajtur deri tani praktika gjyqësore, që në lirimin para kohe me kusht si afat duhet të zbatohet ai i parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, sepse kështu gjykatat i bëjnë një interpretim të zgjeruar ligjit, duke e ruajtur funksionin e tyre, dhe jo të caktohen afate të reja nga gjykata, që në fakt nuk është gjë tjetër veçse bërja e një ligji të ri, gjë e cila e nxjerrë Gjykatën e Lartë jashtë funksionit të saj kushtetues.".
Ndërkohë në qëndrimin e dytë dhe të tretë të gjyqtarëve në pakicë nuk ka vlerësime të kundërta lidhur me konkluzionin unifikues mbi afatin e kohëzgjatjes së lirimit me kusht si dënim alternativ.

[227] Ajo që bën përshtypje është se edhe vetë shumica e gjyqtarëve që kanë unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me kohëzgjatjen e kushtit, në kuptim të nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, nuk e kanë zbatuar sentencën nomofilatike të sapo vendosur pikërisht në këtë vendim. Qëndrimi i dytë i gjyqtarëve në pakicë ka arsyetuar ndër të tjera se:
"*Gjithashtu vendimmarrja e shumicës është kontradiktore me qëndrimin njësues të arritur prej saj, pasi ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër i cili ka vendosur: "Pranimin e kërkesës së kërkuesit Aleksandër Prenga.*
Urdhërohet lirimi me kusht i të dënuarit Aleksandër Prenga për pjesën e pavuajtur të dhënë me vendimin nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, i lënë në fuqi me vendimin nr.824, datë 17.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë duke urdhëruar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh".

Interpretuar *a contrario*, sentence nomofilatike e fundit në pjesën e dytë të Vendimit Unifikues nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë do të thotë se:

- për kundravajtjet penale kohëzgjatja e dënimit alternativ të lirimit me kusht do të jetë maksimalisht jo më pak se gjysma e dënimit me burgim të dhënë;
- për krimet për të cilat masat e dënimit janë individualizuar deri në pesë vjet, kohëzgjatja e dënimit alternativ të lirimit me kusht do të jetë maksimalisht një e treta e dënimit me burgim të dhënë;
- për krimet për të cilat masa e dënimit e individualizuar është mbi pesë vjet deri 35 vjet, kohëzgjatja e dënimit alternativ të lirimit me kusht do të jetë maksimalisht një e katërta e dënimit me burgim të dhënë;
- për krimet për të cilat është dhënë burgim i përjetshëm - dhe lejohet lirimi me kusht si përjashtim nga rregulli, – afati i kohëzgjatjes së dënimit alternativ i lirimit me kusht do të jetë gjithmonë i përjetshëm.

Gjithsesi kuptohet se konkluzionet e arritura më lart nga interpretimi *a contrario* i sentencës nomofilatike kanë karakter teorik dhe se ato nuk do të korrespondojnë në praktikën gjyqësore rast pas rasti me dispozitivin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo apelit, duke qenë se përllogaritja e periudhës së mbetur të dënimit do të duhet të bëhet nga gjykatat në raport me datën e shpalljes së vendimit dhe se masa e dënimit të mbetur me burgim do të mund të individualizohet vetëm në këtë moment. Për rrjedhojë, vetëm ky do të jetë momenti që do të individualizojë edhe masën e dënimit alternativ të lirimit me kusht.

Nga ky rregull i lartsqaruar bën përjashtim kohëzgjatja e lirimit me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm, pasi në çdo rast, dënimin

Gjykata e Apelit Shkodër ka urdhëruar vënien në provë të të dënuarit Aleksandër Prenga për një periudhë prej 18 muajsh ndërkohë që nga aktet e dosjes gjyqësore, ka rezultuar se kërkuesit deri në datën e dhënies së vendimit në apel i kanë mbetur pa vuajtur edhe 3 muaj e 13 ditë burgim.
Kolegjet e Bashkuara, në kundërshtim me qëndrimin e arritur prej tyre, e shtrijnë periudhën e provës, edhe për periudhën pas përfundimit plotësisht të dënimit prej kërkuesit Aleksandër Prenga.". Në këtë mënyrë, edhe pse Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se kohëzgjatja e periudhës së kushtit do të jetë pjesa e mbetur e dënimit me burgim që pezullohet, kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit në të cilin periudha e kushtit ishte caktuar 18 muaj, duke caktuar sakaq një kohëzgjatje kushti me 14 muaj dhe 17 ditë më të madhe se sa pjesa e mbetur e dënimit. Sigurisht që pjesa nomofilatike dhe arsyetuese e këtij vendimi është në kontradiktë të hapur me pjesën dispozitive.

alternativ të lirimit me kusht ato e kanë fiks, konkretisht pjesa e mbetur e jetës.

Megjithatë në praktikën gjyqësore janë vënë re raste ku kjo sentencë nomofilatike e Vendimit Unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk është zbatuar. Në këto raste, në vendimet përfundimtare të gjykatave nuk arsyetohet se pse nuk zbatohet Vendimi Unifikues nr. 2/2015.

Ka raste kur për dënimin me burgim të përjetshëm kohëzgjatja e kushtit caktohet pesë vjet[228], pa dhënë asnjë arsyetim se pse për një dënim me burgim të përjetshëm të pezulluar, periudha e kohëzgjatjes së kushtit duhet të jetë pesë vjet. Ka edhe raste kur, nuk arsyetohet se pse përcaktohet një periudhë kushti më e madhe se vetë pjesa e dënimit të mbetur. Megjithatë kuptohet se gjykatat e shkallës së parë në të dy këto raste me analogji zbatojnë nenin 59 të Kodit Penal.[229]

Vlerësojmë se kjo mënyrë e zbatimit të ligjit për të përcaktuar kohëzgjatjen e kushtit përbën zbatim të ligjit penal me analogji, gjë që vjen ndesh me nenin 3 të Kodit Penal, nenin 29 të Kushtetutës dhe me nenin 7 të KEDNJ. Vlerësojmë se, për sa kohë Vendimi Unifikues nr. 2/2015 është në fuqi ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar, në bazë dhe për zbatim të nenit 141 të Kushtetutës dhe se të gjykuarit kanë pritshmëri se e drejta e zbatueshme në kuptimin material për sa i përket kësaj çështje, është pikërisht kjo bazë juridike e unifikimit të praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë, vendimmarrjet e gjykatave për sa i përket kësaj çështje duhet të jenë të njësuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për këtë pjesë të disponimit të gjykatave, në të cilat periudha e kohëzgjatjes së kushtit përcaktohet më e madhe se sa periudha e dënimit me burgim që është pezulluar nga zbatimi i lirimit me kusht, konstatohet se shkelet edhe një nga standardet e detyrueshme të Rekomandimit kuadër mbi lirimin me kusht të Këshillit të Evropës.[230] Lidhur me kohëzgjatjen e kushtit, pika 10 e Rekomandimit parashikon se ajo nuk mundet të jetë proporcionalisht më e madhe se sa pjesa e mbetur dhe e pezulluar e dënimit me burgim.

---

[228] Shih Vendimin nr. 34-2020-50, datë 24.01.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

[229] Shih Vendimin nr. 39, datë 16.01.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimin nr. 64, datë 06.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimin nr. 142, datë 09.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimin nr. 1484/58, datë 10.09.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

[230] Shih në web: https://rm.coe.int/16800ccb5d.

5.5. Detyrimet gjatë kohëzgjatjes së kushtit

Në praktikën gjyqësore shqiptare ka pasur debate mbi mënyrën se si duhet që gjykata të caktonte detyrimet e të dënuarit të liruar me kusht gjatë kohëzgjatjes së këtij dënimi alternativ.[231] Këto problematika lindnin për arsye se Kodi Penal dhe ligjet që normonin fazën e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, ishin shunmë të kursyera në rregullimin e kësaj çështjeje.

Nisur nga këto problematika të praktikës gjyqësore dhe ometimit të nenit 64 të Kodit Penal, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shtroi për njësimin e praktikës gjyqësore në Kolegje të Bashkuara, të pyetjes:

"Në rastin kur pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, a duhet gjykata të caktojë gjithashtu një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë?".

Në Vendimin Unifikues nr. 2/2015, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konstatuar se, ndryshe nga neni 59 i Kodit Penal (Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë), - i cili është ndonëse është një institut i ndryshëm nga ai i lirimit me kusht, përmban gjithsesi elemente të përbashkët me të, – neni 64 i Kodit Penal nuk shprehet në lidhje me mundësinë e caktimit, në rast pranimi të kërkesës nga ana e gjykatës, të një periudhe prove ku i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, duke parashikuar se i vetmi detyrim i të dënuarit të liruar me kusht lidhet vetëm me moskryerjen e një vepre penale tjetër me dashje.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara e kanë interpretuar Kodin Penal në këtë pjesë në mënyrë komplementare me parashikimet e ligjeve të posaçme që normojnë fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Ato kanë konstatuar sakaq në vendim, se Ligji nr. 8331/1998, në nenin 31/6 ka parashikuar se personi i liruar me kusht duhet t'i raportojë rregullisht sSërbimit të Provës gjatë kohës së lirimit me kusht dhe se Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe ato të Policisë së Shtetit, apo se Shërbimi i Provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato.

Për rrjedhojë, Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se, ndonëse nuk e ka pasqyruar edhe në tekstin e nenit 64 të Kodit Penal, ligjvënësi jo vetëm

[231] Shih "*Manual mbi aplikimin e alternativave të dënimit me burgim*", OSBE 2010, Arta Mandro Balili, Marsida Xhaferllari, Gerd Hoxha, Admir Belishta, faqe 74 – 75.

që ka parashikuar mbajtjen e kontakteve me Shërbimin e Provës si dhe mbikëqyrjen e saj të vendimit të lirimit me kusht, por edhe ka nënkuptuar dhënien nga ana e gjykatës, të një ose te disa detyrimeve personit të liruar me kusht. Qëllimi për mbajtjen e kontakteve dhe dhënia e një ose disa detyrimeve nga ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, ka të bëjë natyrisht me nevojën për të bërë sa më lehtë për të dënuarin kalimin e periudhës tranzitore të kalimit nga gjendja e burgimit në atë të lirisë, duke mundësuar rikthimin e suksesshëm të të dënuarit në shoqëri. Për këtë arsye, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se në rast pranimi të kërkesës për lirim me kusht, gjykata duhet të caktojë një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

Për më tepër Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se, në rast se i dënuari nuk mban lidhje me Shërbimin e Provës apo nuk përmbush detyrimet e vëna nga gjykata (me përjashtim të rastit kur nuk është në gjendje t'i përmbushë ato), gjykatat mund të vendosin ndryshimin apo revokimin e lirimit me kusht në bazë të nenit 31/10 i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "*Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale*", nen i cili, në interpretim të Kolegjeve, jo pa qëllim shmang referimin e një instituti të veçantë, duke iu referuar në përgjithësi, një "dënimi alternativ", të parashikuar nga Kodi Penal. Duke pasur në konsideratë se Kodi Penal e liston institutin e lirimit me kusht si një nga Alternativat e Dënimit me Burgim (Kreu VII), atëherë sipas Kolegjeve të Bashkuara, edhe neni 31/10 i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "*Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale*", duhet të konsiderohet si baza ligjore për të vepruar në rast të mosmbajtjes së kontakteve me Shërbimin e Provës dhe mospërmbushjeve me dashje të detyrimeve të dhëna nga gjykata.

Për rrjedhojë të këtij arsyetimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në qëndrimin unifikues si më poshtë:

"*Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale" ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal.*".

Megjithëse në këtë vendim ka tre qëndrime gjyqtarësh të mbetur në pakicë, asnjë prej këtyre qëndrimeve nuk ka dhënë argumente kundër këtij konkluzioni nomofilatik. Përkundrazi edhe qëndrimi i parë në pakicë arsyeton se për të komplementuar ometimin ligjor të nenit 64 të Kodit Penal,

do të duhet që gjykatat të zbatojnë me analogji nenin 59 dhe 60 të Kodit Penal. Në këtë pjesë të arsyetimit të pakicës është e paqartë se pse gjyqtari del në pakicë kur bashkohet në arsyetim dhe në konkluzionin nomofilatik të dytë të arritur në Vendimin Unifikues nr. 2/2015.

Megjithatë me Ligjin nr. 36/2017, konkretisht ndërhyrjen e fundit dhe të pestë të ligjvënësit në pjesën e rregullimeve ligjore të lirimit me kusht në Kodin Penal, e zgjidhi këtë çështje përfundimisht, duke parashikuar një rregullim ligjor eksplicit që konfirmohej edhe me arsyetimin dhe konkluzionin nomofilatik të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nenit 64 të Kodit Penal iu shtua paragrafi i pesë me këtë përmbajtje:

"*5. Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirimin para kohe me kusht.*".

Në këtë mënyrë, legjislatori i vitit 2017, nëpërmjet një dispozite bankete, e plotësoi ometimin historik të nenit 64 të Kodit Penal me përmbajtjen e nenit 60 të po këtij Kodi. Neni 60 i Kodit Penal nën titullin "*Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë*", parashikon se:

"*I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:*

1. *Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.*
2. *Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.*
3. *Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.*
4. *Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.*
5. *Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.*
6. *Të mos frekuentojë vende të caktuara.*
7. *Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.*
8. *Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.*
9. *Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.*

10. *Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.*
11. *Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.*
12. *T'i nënshtrohet një trajtimi, apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike.*

Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre. Detyrimet e parashikuara në pikat 11 dhe 12, të paragrafit 1, të këtij neni, caktohen vetëm me pëlqimin e të dënuarit.

Periudha për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet nga gjykata brenda periudhës të caktuar të provës.".

Është e rëndësishme të sillen në vëmendje edhe parimet apo standardet e Këshillit të Evropës mbi masat që duhet të shoqërojnë mbikëqyrjen e të dënuarit të liruar gjatë kohës së kushtit. Kështu, Pjesa e V e Rekomandimit mbi lirimin me kusht[232] rregullon vendosjen e kushteve apo masave që i dënuari do të jetë i detyruar të respektojë gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Në pikën 25 parashikohet se, në vlerësimin e kritereve ligjore të lirimit me kusht për autoritetin kompetent vendimmarrës duhet të jenë të disponueshëm çdo relacion apo raport që ka dokumentuar sjelljen e të dënuarit me perspektivën e lirimit të tij. Autoriteti vendimmarrës duhet të sigurohet se i dënuari i kupton kushtet e vendosura në vendimin e lirimit me kusht dhe se duhet t'i tregojë atij se çfarë pasojash do të ketë në rast se detyrimet nuk përmbushen gjatë kohës së kushtit.

Duhet të pranohet se praktika gjyqësore në këtë drejtim ka ecur në mënyrë konstante dhe unisone pas vendimmarrjes nomofilatike të Gjykatës së Lartë dhe për më tepër ndryshimet ligjore të vitit 2017 vetëm sa kanë saktësuar rregullimin ligjor, duke mos pasur ndryshim apo ndikim thelbësor në praktikën gjyqësore. Ajo që vihet re më së shumti në detyrimet që gjykatat caktojnë për të dënuarit të liruar me kusht janë përgjithësisht detyrimi i tij që të mos kryejë vepra të tjera penale, detyrimi të mos shoqërohet me të dënuar, detyrimin e tij të mos mbajë armë, detyrimi të mbajë kontakte me organin kompetent të Shërbimin e Provës, apo edhe detyrimin e tij që gjatë

[232] Shih në web: https://rm.coe.int/16800ccb5d.

kohëzgjatjes së kushtit të kryejë veprimtari profesionale. Vihet re se masat e tjera të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal nuk përdoren dhe nuk caktohen nga gjykatat.

Premisa e parë e nevojshme dhe e domosdoshme e ekzekutimit me sukses të lirimit me kusht si një dënim alternativ, është që gjykata para marrjes së vendimit t'i marrë një adresë vendbanimi apo vendqëndrimi të personit të dënuar, duke i bërë me dije atij se për çdo komunikim do të përdoret kjo adresë dhe se për çdo ndryshim të mëvonshëm do të duhet të përditësohet informacioni për vendndodhjen e re në organet e Shërbimit të Provës. Kjo do të mundësonte përcaktimin e kompetencës tokësore edhe të zyrës së Shërbimit të Provës që do të ndjekë në vijim rastin dhe do të krijojë sakaq premisat për një komunikim të vazhdueshëm në vijim të të dënuarit dhe organeve shtetërore dhe për një kontroll praktikisht më të lehtë të të liruarit me kusht.

Vlerësojmë se është e nevojshme që, kur gjykata vendos detyrimin e personit të liruar me kusht që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës nuk duhet të mjaftohet vetëm me një fjali të përgjithshme në dispozitivin e saj, në të cilin në çdo rast të konstatuar vetëm urdhërohet personi të mbajë kontakt, duke mos u përcaktuar sakaq asnjë modalitet se si do të realizohet mbajtja e kontaktit. Sjellim në vëmendje se edhe masat e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal janë pjesë përbërëse e strukturës juridike të dënimit të lirimit me kusht si dënim alternativ. Si e tillë nuk mundet dhe nuk duhet që kjo pikë e disponimit gjyqësor të ketë natyrë bankete, për ta lënë më tej në diskrecionin e Shërbimit të Provës se si do të ekzekutohet mbajtja e kontakteve.

Vlerësojmë se kjo pikë e dispozitivit të vendimit të gjykatës duhet të përcaktojë modalitetet e ekzekutimit të këtij urdhërimi gjyqësor, duke përcaktuar ditën apo orën se kur i liruari me kusht duhet të paraqitet detyrimisht para Shërbimit të Provës. Sigurisht kjo nuk do të mbyllte mundësinë që ai të kishte detyrimin ligjor të paraqitej para këtij institucioni edhe kur institucioni ka nevojë të kryejë verifikime të caktuara sipas rrethanave.

Tek identifikimi i veprimtarisë profesionale dhe i punës që i dënuari detyrohet gjyqësisht të kryejë gjatë kohës së kushtit, vihen re mënyra formulimi të ndryshme të diapozitivit të vendimit nga një trupë gjyqësore në një tjetër. Kështu ka trupa gjyqësore që urdhërojnë kryerjen e veprimtarisë profesionale sipas kontratës apo premtim-kontratës së punës të administruar

si provë në gjykim, por paralelisht me të parashikojnë të hapur mundësinë që kërkuesi të mundet të ndryshojë punëdhënësin apo edhe llojin e veprimtarisë profesionale.[233] Nga ana tjetër ka edhe trupa gjykues që janë të ngurtë në mënyrën se si e formulojnë këtë detyrim ligjor, duke parashikuar se gjatë kohëzgjatjes së kushtit i dënuari duhet të punojë sipas të dhënave të kontratës së punës që është paraqitur si provë në gjykim.[234]

Vlerësojmë se sigurisht që është e rëndësishme që në vendimin përfundimtar të pranimit të kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit me burgim, të disponohet se një ndër detyrimet që i dënuari i lirë do të ketë gjatë kohëzgjatjes së kushtit do të jetë ushtrimi i një veprimtarie profesionale, sikurse është treguar gjatë gjykimit kur si provë është sjellë një kontratë pune apo një premtim për lidhje kontratë pune. Megjithatë individualizimi në dispozitiv i veprimtarisë profesionale që do të ushtrohet, i kontratës së punës apo edhe i punëdhënësit ku i dënuari i lirë do të punojë, mundet të pasjellë vështirësi faktike dhe juridike për të në kuptim të plotësimit të detyrimeve.

Kontrata e punës mundet të zgjidhet në mënyrë të njëanshme apo me konsensus dhe i dënuari mundet të vendosë të ndryshojë lirisht veprimtarinë e tij profesionale, kur nuk ka kufizime të tjera ligjore dhe të arsyeshme, por kjo mundet të rezultojë, edhe pse pa qëllim, e pamundur nga urdhërimi gjyqësor në dispozitiv, për arsye se detyrimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor janë aq të detyrueshme për të sa që mosplotësimi i tyre sipas modaliteteve do të mundet të jetë shkak edhe për revokimin e vetë dënimit alternativ. Në këtë kuptim, do të ishte e sugjerueshme që dispozitivi i vendimit të gjykatës në këtë pjesë të mjaftohet me një formulim të përgjithshëm mbi detyrimin e të dënuarit për të ushtruar veprimtari profesionale.

Duhet të sjellim në vëmendje se gjatë hulumtimit në praktikën gjyqësore dhe nga kontaktet me punonjës të Shërbimit të Provës vihet re se detyrimi i personit të liruar me kusht për të ushtruar veprimtari profesionale është praktikisht i pakontrollueshëm dhe i pamatshëm gjatë fazës së ekzekutimit të këtij dënimi alternativ, për të konkluduar në mënyrë efektive nëse përmbushet apo jo. Sjellja në vëmendje në mënyrë eksplicite në Vendimin Unifikues nr. 2/2015, si një ndër rrethanat që favorizonin lirimin me kusht

[233] Shih Vendimin nr. 142 Akti, datë 09.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë apo Vendimin nr. 39, datë 16.01.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

[234] Shih për shembull Vendimin nr. 64 Akti, datë 06.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

të ekzistencës së kontratës së punës, ka bërë që në çdo gjykim të tillë një ndër provat të jetë një premtim lidhje kontratë pune, si deklarim i njëanshëm i punëdhënësit, apo edhe kontratë e perfeksionuar pune.

Por në të vërtetë, duke pasur parasysh se nuk ka verifikime të mëtejshme paraprake mbi vërtetësinë e tyre, duke pasur parasysh se nuk ka verifikime efektive të mënyrës se si ato jetësohen pas lirimit me kusht, dhe duke mos pasur asnjë rast ku gjykatat të kenë ndryshuar masat gjatë kushtit apo të kenë revokuar lirimin me kusht për shkak të këtij detyrimi, na jep indice dhe të dhëna të rëndësishme të vlerësojmë se një pjesë e mirë e këtyre kontratave janë fiktive dhe të simuluara, me qëllim që të plotësohet në dukje dhe formalisht një ndër kriteret për përfitimin e lirimit me kusht. Duke qenë të tilla kontratat, kuptohet se si pasojë e një efekti domino i tillë mbetet edhe urdhërimi gjyqësor në vendimin e gjykatës, kur detyrohet i dënuari me kusht që të ndjekë një veprimtari të caktuar profesionale.

Duhet pasur parasysh nga gjykatat se, kur urdhërohet detyrimi i të dënuarit të shlyejë dënim civil të caktuar, ky urdhërim gjyqësor në pjesën dispozitive nuk mundet të jetë abstrakt, sikurse formulohet në nenin 60 të Kodit Penal. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se kjo pjesë e diapozitivit duhet detyrimisht të shoqërohet më parë me pjesën arsyetuese të vendimit. Kjo do të thotë se, gjykata do të duhet të ketë qartësuar në pjesën arsyetuese se kush është dëmi civil, sa është ai, pse është shkaktuar dhe kush është kreditori. Më tej në pjesën dispozitive të saktësohet kreditori dhe sasia e dënimit civil, duke përcaktuar veprimin konkret që i liruari me kusht duhet të realizojë, shoqëruar nga modalitetet e përmbushjes së tij në afat.

E vështirë të perceptohet edhe zbatimi efektiv i masës që gjykata mundet të urdhërojë, për të detyruar personin e liruar me kusht që të mos shoqërohet me persona të dënuar. Praktika e Shërbimit të Provës për ekzekutimin e kësaj mase është komunikimi shkresor me komisariatin e policisë që mbulon zonën rezidenciale të të liruarit me kusht, me anën e së cilës i kërkohet informacion nëse i liruari me kusht shoqërohet apo jo me persona të dënuar. Kjo do të thotë se, kontrolli i zbatimit të kësaj masa ligjore, që gjykata urdhëron, është rastësor dhe jo efektiv.

Ajo që vihet re në këtë drejtim të rregullimit ligjor të lirimit me kusht dhe të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë, është fakti se legjislatori ka përdorur dy standarde të rregullimit përsa i përket teknikës legjislative. Kështu, lirimi me kusht ka një rregullim minimal normativ në krahasim me rregullimin e dënimit

alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë. Për më tepër, neni 64 i Kodit Penal përfaqëson në vetvete një dispozitë blankete të pjesshme, pasi përvetëson për efektet e rregullimit normativ të lirimit me kusht, vetëm rregullimin e nenit 60 të Kodit Penal.

Por paralelisht me këtë rregullim komplementar, dënimi alternativ i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia e të dënuarit në provë ka si rregullim edhe nenin 60/a dhe 61 të Kodit Penal, dispozita të cilat rregullojnë disa aspekte që në parim duhet të jenë njëlloj të zbatueshme edhe për lirimin me kusht si dënim alternativ. Kështu për shembull, neni 60/a i Kodit Penal nën titullin "*Detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës*", parashikon se:

"*Gjykata, ndaj të dënuarit të vënë në provë, i cili është në kushtet e varësisë kronike ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike, vendos detyrimin për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës.*

Trajtimi mjekësor për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës bëhet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, në bazë të kërkesës së shërbimit të provës.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimin e vendosur sipas parashikimeve të nenit 60 të këtij Kodi.".

Nga ana tjetër neni 61 i Kodit Penal nën titullin "*Detyrimet e të dënuarit gjatë kohës së provës*", parashikon se:

"*Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar:*

a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.".

Vlerësojmë se për të dy këto rregullime ka nevojë edhe mirërregullimi dhe plotësimi i institutit të lirimit me kusht dhe se legjislatori nuk duhet të kishte referuar në mënyrë bankete vetëm tek neni 60 i Kodit Penal, por duhet të kishte parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 64 të Kodit Penal, se të gjitha rregullimet e dënimit alternativ të pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies së të dënuarit në provë zbatohen *mutatis mutandis*

edhe për lirimin me kusht. Nga ky rregullim do të mundet të kërkonte një rregullim të posaçëm vetëm kohëzgjatja e kushtit, e cila duhet të përshtatet posaçërisht me karakteristikat e dënimit alternativ të lirimit me kusht.

Për të ndrequr këtë problematikë juridike që shfaq rregullimi i dispozitës blankete në nenin 64 të Kodit Penal, mund të bëhet një interpretim pajtues, me anën e të cilit do të duhej të konkludohej se edhe neni 60/a dhe 61 i Kodit Penal janë *mutatis mutandis* të zbatueshëm për lirimin me kusht. Zbatimi *mutatis mutandin* i nenit 61 të Kodit Penal nuk shfaq problematikën kushtetuese dhe ligjore të mos interpretimit të ligjit penal me analogji, pasi analogji në këtë mënyrë interpretimi nuk ka, për sa kohë vetë paragrafi i 5 i nenit 64 të Kodit Penal dhe rregullimet e posaçme të Ligjit nr. 8331/1998, e nënkuptojnë detyrimin e të dënuarit të liruar me kusht që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të përditësojë informacionet mbi lëvizjet dhe ndryshimin e rezidencës pranë këtij institucioni.

Ajo që mund të hapë debatin e interpretimit me analogji të ligjit material penal, është pikërisht zbatimi *mutatis mutandis* i nenit 60/a të Kodit Penal për lirimin me kusht. Problemi qëndron në faktin se neni 60/a i Kodit Penal përmban detyrime të dhëna nga gjykata pa pëlqimin e të dënuarit, me qëllim që ai të ndjekë terapi apo trajtim mjekësor për eliminimin e varësisë nga alkooli apo droga. Ndërkohë, këto masa përmenden edhe në nenin 60 të Kodit Penal, si mundësi për gjykatën për t'i caktuar në vendimin përfundimtar të lirimit me kusht, por se paragrafi i parafundit të kësaj dispozite e kushtëzon dhënien e tyre nga gjykata me pëlqimin e të dënuarit. Ndaj sipërfaqësisht dhe menjëherë konkludohet se, neni 60/a i Kodit Penal nuk mundet të zbatohet me analogji për të dënuarin e liruar me kusht.

Sigurisht që për ta zgjidhur pa asnjë diskutim këtë debat, duhet që ligji të ndryshojë. Por vlerësojmë se edhe në kushtet kur ligji penal nuk ndryshon, neni 18 i Kushtetutës na detyron që ligjin ta interpretojmë në atë mënyrë që të garantojë barazinë në mënyrën se si ligji penal zbatohet. Për rrjedhojë konkludojmë se, neni 60/a i Kodit Penal zbatohet nga gjykata edhe si detyrim i të dënuarit me burgim të liruar me kusht, pasi nevoja për trajtim e tij është identike me nevojën për trajtim të të dënuarit me burgim, për të cilin ekzekutimi i dënimit është pezulluar sipas nenit 59 të Kodit Penal. Në të dy këto raste, marrja e kësaj mase nga gjykata përtej pëlqimit të të dënuarit, justifikohet njëlloj dhe në mënyrë identike nga varësia kronike e tyre ndaj alkoolit apo drogës.

5.6. Ndryshimi i kushtit dhe revokimi i lirimit me kusht

Sigurisht që vendimi përfundimtar i gjykatës për lirimin me kusht merr formë të prerë dhe është menjëherë i ekzekutueshëm. Porse, ndryshe nga koncepti klasik i marrjes formës të prerë të një vendimi përfundimtar penal, gjë që nënkupton edhe aspektin formal të prekluzivitetit të ankimeve dhe aspektin material të detyrueshmërisë për zbatim dhe të pandryshueshmërisë së tij, vendimet e gjykatës për lirim me kusht marrin formë të prerë vetëm në kuptimin formal. Kjo do të thotë se, gjatë ekzekutimit të këtij dënimi alternativ ato janë të ndryshueshme, në varësi të rrethanave që diktojnë nevojën për ndryshim.

Kjo do të thotë se ligji ka paraparë se, konkluzioni që gjykata arrin në këto rasti mbi pendimin apo jo të të dënuarit apo mbi risocializimin e tij apo jo, nuk është përfundimtar. Përkundrazi, fakti që lirimi me kusht zgjat për pjesën e mbetur të dënimit, është caktuar pikërisht nga ligji që nëpërmjet kontrollit të lirisë së kushtëzuar të të dënuarit, në këtë kohë gjykata të bindet plotësisht nëse ai është penduar apo risocializuar apo jo.[235] Kjo do të thotë se afati i kushtit në lirinë me kusht shërben që të konkludohet përfundimisht mbi vërtetësinë e pendimit dhe të risocializimit të të dënuarit. Për rrjedhojë, vendimi gjyqësor i lirimit me kusht nuk merr formë të prerë në kuptimin material.

Neni 64 i Kodit Penal ka parashikuar në paragrafin e katërt e të pestë, dy mundësi për ndryshueshmërinë e vendimit të gjykatës për lirimin me kusht. Fillimisht janë parashikuar rrethanat e revokimit të vendimit të lirimit me kusht dhe më tej edhe rrethanat të cilat, megjithëse nuk revokojnë vendimin e lirimit me kusht, mundet të ndryshojnë vetë përmbajtjen e vendimit.

Kështu paragrafi i katërt i nenit 64 të Kodit Penal, parashikon se:

"*Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.*".

Ndërkohë paragrafi i pestë i nenit 65 të Kodit Penal parashikon se:

"*Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin*

[235] Shih Vendimin nr. 343, datë 19.03.1999, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirimin para kohe me kusht.".

Jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë i ka bërë një ndarje llojit të shkaqeve të cilat pasjellin ndryshimin e vendimit gjyqësor të lirimit me kusht. Kjo jurisprudencë thekson se tek shkaqet që pasjellin revokimin e lirimit me kusht, duhet të dallojmë shkaqet me karakter automatik dhe shkaqet me karakter diskreciar.[236]

Shkaqet me karakter automatik janë ato që nuk lënë hapësirë për diskrecion tek gjykata, që do të thotë mjafton të vërtetohen se ekzistojnë dhe kaq mjafton për të ushtruar në mënyrë të urdhëruar nga ligji, kompetencën e revokimit të lirisë me kusht. Këto shkaqe janë kryerja e veprave penale po aq të rënda apo edhe më të rënda. Sigurisht ky është një sanksion penal që priret të rëndojë pozitën e recidivistëve të posaçëm apo atyre që shtojnë dhe rëndojnë aktivitetin kriminal pas veprës penale për të cilën ata janë tashmë të dënuar.

Nga ana tjetër ligji parashikon edhe shkaqe diskreciare të revokimit të lirimit me kusht, që do të thotë se në këtë rast do të duhet që gjykata të vlerësojë rëndësinë e shkeljes në raport me pajtueshmërinë apo jo të kohëzgjatjes së lirimit me kusht të të dënuarit. Të tilla rrethana janë kryerja e veprave të tjera penale më të lehta apo mos plotësimi i detyrimeve ligjore apo gjyqësore nga ana e të dënuarit gjatë kohëzgjatjes së lirimit me kusht.

Vlerësojmë se kjo jurisprudencë mundet të vlejë dhe është e përdorshme të interpretojë *ratio*-n e parashikimit të paragrafit të katërt dhe të pestë, të nenit 64 të Kodit Penal. Sikurse lehtësisht mundet të konkludohet, vlerësojmë se kryerja e një vepre tjetër penale me dashje gjatë kohës së kushtit përbën një shkak automatik ligjor për revokimin e vendimit të lirimit me kusht. Automatik nuk do të thotë se revokimi është ex lege i zbatueshëm nga organet shtetërore, por se Shërbimi i Provës e ka të detyrueshme t'i kërkojë prokurorit revokimin e lirimit me kusht, prokurori e ka të detyrueshme t'i kërkojë gjykatës revokimin e lirimit me kusht dhe më në fund gjykata e ka të detyrueshme të vendosë revokimin e lirmit me kusht, duke vendosur bashkimin e dënimeve dhe kthimin e personit të dënuar në institucionin e vuajtjes së dënimit penal.

[236] Shih Vendimin nr. 7184, datë 19.02.1998, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë. Shih gjithashtu edhe Vendimin nr. 436, datë 14.02.1997, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

Ajo që përbën një rregullim defektoz të kësaj dispozite është hipoteza e normës, konkretisht se kujt të dënuari të liruar me kusht, nëse gjatë kohës së kryerjes së kushtit kryen një vepër penale me dashje, i revokohet vendimi i lirimit me kusht. Paragrafi i katërt i nenit 64 të Kodit Penal, kërkon që t'i revokohet dënimi vetëm të dënuarit për vepër penale me dashje që është liruar me kusht. Interpretuar *a contrario* kjo dispozitë nxjerr defektin, që do të thotë se i dënuari me burgim për vepra penale të kryera me pakujdesi dhe që është liruar me kusht, nëse gjatë kohëzgjatjes së kushtit kryen vepër penale me dashje nuk do t'i revokohet në mënyrë automatike lirimi me kusht. Vlerësojmë se ky rregullim defektoz ngre dyshime për mosrespektimin e nenit 17 dhe 18 të Kushtetutës, në pjesën që të njëjtën rrethanë e njeh si shkak automatik revokimi të lirimit me kusht vetëm për të dënuarit e liruar me kusht për vepra penale të kryera me dashje.

Nga ana tjetër, në paragrafin e pestë të nenit 64 të Kodit Penal, parashikohen rrethana të cilat pasjellin revokimin diskrecionar të vendimit gjyqësor të lirimit me kusht. Në këto raste Shërbimi i Provës, prokurori dhe gjykata kanë hapësirë diskrecionare vlerësimi, qoftë për të ushtruar kërkesën apo për të marrë vendimin e revokimit të lirimit me kusht, dhe se ky vlerësim duhet të jetë si nevojë e rrethanave konkrete të shkeljes së konstatuar gjatë kohëzgjatjes së kushtit.

Para se të merret në analizë parashikimi ligjor shqiptar respektiv, vlerësojmë se është e nevojshme të sillen në vëmendje parimet dhe standardet e Këshillit të Evropës mbi këtë çështje.[237] Në këtë mënyrë Pjesa VI e Rekomandimit mbi lirimin me kusht, parashikon parimet që duhet të ndiqen gjatë ekzekutimit të vendimit të lirimit me kusht, ku përcaktohet se duhet të ekzistojë një organ mbikëqyrës dhe duhet të respektohen Rregullat evropiane mbi masat dhe sanksionet komunitare. Qëllimi i mbikëqyrjes duhet të jetë asistenca ndaj të dënuarit, orientimi i tij drejt risocializimit dhe rehabilitimit të plotë dhe parandalimi i rikthimit të tij në aktivitet të paligjshëm.

Më tej, Pjesa VII e Rekomandimit parashikon rregullime të përgjithshme mbi masat që duhet të merren kur konkludohet se i dënuari nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Në pikën 30 parashikohet se shkeljet e lehta të detyrimeve nga ana e të dënuarit duhet të marrin përgjigje me anë të këshillimit apo të paralajmërimeve nga organet që zhvillojnë mbikëqyrjen e të dënuarit. Ndërsa shkeljet e serioze të detyrimeve, duhet

[237] Shih në web: https://rm.coe.int/16800ccb5d.

të raportohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme tek autoritetet kompetente, të cilat duhet të ndërmarrin masat respektive kundër të dënuarit proporcionalisht me rëndësinë e shkeljes, deri në revokimin e lirimit me kusht.

Në përputhje me këto standarde ndërkombëtare, paragrafi i pestë i nenit 64 të Kodit Penal, ka parashikuar se kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirimin para kohe me kusht.

Sigurisht që revokimi i dënimit alternativ të lirimit me kusht përbën një akt juridik me karakter *ultima ratio*, që do të thotë se, vetëm nëse asnjë masë tjetër ndryshuese e përmbajtjes së detyrimeve të vendimit të lirimit me kusht nuk është e përshtatshme, do të mundet të revokohet vendimi i lirimit me kusht. Pikërisht në këtë pjesë shfaqet karakteri diskrecional i këtyre rrethanave që shërbejnë për revokim.

Është shumë interesante të sjellim në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Italisë mbi karakterin diskrecionar të revokimit të lirimit me kusht si kompetencë vendimmarrëse e gjykatës. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se nuk është në përputhje me Kushtetutën parashikimi ligjor se, vetëm kryerja e veprave penale me natyrë të njëjtë përbën shkak për revokimin e lirisë me kusht. Kjo jurisprudencë ka arsyetuar se liria me kusht duhet të revokohet në çdo rast kur, sjellja e mëpasshme e të dënuarit duket e papajtueshme me vazhdimin e mbajtjes së këtij përfitimit të mundësuar teorikisht nga ligji penal dhe praktikisht nga gjykata.[238] Në këtë mënyrë kjo jurisprudencë kushtetuese hap mundësinë ligjore që lirimi me kusht të mundet të revokohet për çdo shkak që të çon në konkluzionin se pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim nuk është i justifikuar nga sjellja e mëpasshme e përfituesit nga ky dënim alternativ.

Për rrjedhojë do të konkludonim se, do të ishte më e përshtatshme për paragrafin e fundit të nenit 64 të Kodit Penal, që të linte të hapur formulimin dhe përkufizimin e rrethanave me karakter diskrecionar që shërbejnë për të ndryshuar apo për të revokuar lirimin me kusht. Kjo do të jepte mundësi rast pas rasti për gjykatën, që të zgjidhte sipas parimit të proporcionalitetit çdo çështje.

[238] *Shih Vendimin nr. 418, datë 23.12.1998, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.*

Ajo që mungon si parashikim në këtë paragraf të nenit 64 të Kodit Penal është pjesa e mbetur e parregulluar në paragrafin e katërt, që do të thotë se në të nuk parashikohet se çfarë do të ndodhë kur i dënuari, megjithëse plotëson detyrimet e nenit 60 të Kodit Penale të urdhëruara nga gjykata në diapozitiv dhe megjithëse mban kontakte me Shërbimin e Provës rregullisht, kryen gjatë kohës së provës kundravajtje penale apo krime me pakujdesi. Interpretuar literalisht, formalisht dhe ngushtë, paragrafi i pestë i nenit 64 të Kodit Penal nuk i njeh si shkak revokimi apo ndryshimi të lirimit me kusht këto fakte, megjithëse për shkak të natyrës së tyre duhet t'i njohë detyrimisht. Në këtë rregullim të teknikës legjislative krijohet paradoksi ku masat që s'përbëjnë vepra penale përbëjnë shkak potencial ndryshimi apo revokimi për lirimin me kusht, dhe njëkohësisht veprime apo mosveprime që përbëjnë vepra penale nuk njihen si shkak për ndryshim apo revokim të lirimit me kusht. Sigurisht që kjo është e papranueshme sipas standardeve të arsyeshmërisë që vendosin neni 17 dhe 18 i Kushtetutës.

Ndaj do të sugjeronim që teknika legjislative e paragrafit të pestë të nenit 64 të Kodit Penal të ishte formuluar ndryshe, duke lënë hapësirë interpretimi për prokurorin dhe gjykatën që rast pas rasti të vlerësonin nëse një rrethanë përbën apo jo shkak për ndryshimin apo revokimin e lirimit me kusht. Ndaj vlerësojmë se neni 64 i Kodit Penal do të duhet të ishte plotësuar në ometimet e tij rast pas rasti nga rregullimet analoge të dënimit alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë. Në këtë drejtim, neni 62 i Kodit Penal bën një rregullim më të saktë, duke parashikuar se shkak për ndryshimin apo revokimin e vendimit pezullues të ekzekutimit të dënimit me burgim është kryerja e çdo vepre penale dhe jo vetëm veprat penale me dashje.

Në këtë drejtim vlen të diskutohet edhe nëse përbën detyrim sipas nenit 60 të Kodit Penal, ai që gjykatat e përdorin në çdo dispozitiv të lirimit me kusht, konkretisht detyrimi i të dënuarit të mos kryejë vepra penale. Kjo përgjigje do të mundet të gjente një zgjidhje për eventualitetin e mëlartëm, për të konkluduar se kryerja e veprës penale nga pakujdesia e të dënuarit me burgim i liruar me kusht dhe gjatë kohës së kushtit është apo jo shkak që mundet të legjitimojë ndryshimin apo revokimin e lirimit me kusht, sipas paragrafit të 5 të nenit 64 të Kodit Penal.

Për qëllimet e vendimmarrjes së revokimit të lirisë me kusht, jurisprudenca kasacionale italiane ka vlerësuar se shkaku i revokimit duhet të ndodhë brenda kohës së kushtit dhe se nuk kërkohet që detyrimisht të

ndodhë edhe deklarimi fajtor me vendim të formës së prerë gjatë këtij afati kohor.[239] Kjo do të thotë se vendimi i formës së prerë i deklarimit fajtor nuk ka lidhje me faktorët që determinojnë premisën juridike të revokimit të lirimit me kusht.

Vlerësojmë se ky standard jurisprudencial duhet të jetë i zbatueshëm edhe në mënyrën se si duhet të interpretohet kjo çështje, në rastin e zbatimit të paragrafit të katërt apo të pestë të nenit 64 të Kodit Penal. Kjo do të thotë se vërtetimi i njërës nga rrethanat që passjell revokimin e vendimit të lirimit me kusht, aq më tepër një nga rrethanat që passjell revokimin automatik të lirimit me kusht, ndalon juridikisht ecjen në mënyrë të vlefshme të afatit të kohëzgjatjes së kushtit. Për rrjedhojë, edhe pse vendimi i deklarimit fajtor për një vepër penale merret jashtë kohës fizike të kushtit, dhe pse ky vendim merr formë të prerë apo merr cilësinë e gjësë së gjykuar[240] jashtë kohës fizike të kushtit, juridikisht do të duhet që lirimi me kusht të revokohet dhe të bashkohet dënimi i pezulluar për shkak të lirimit me kusht dhe dënimi për veprën penale të kryer gjatë kohës së kushtit.

Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor i fajësisë, i formës së prerë apo gjësë e gjykuar, nuk ka efekt konstitutiv për rrethanën e revokimit të lirimit me kusht, por ka efekt deklarativ, që çertifikon me fuqi prapavepruese se fakti penal ka ndodhur gjatë kohës fizike dhe juridike të kushtit. Ndaj për qëllimet e zbatimit të paragrafit të katërt dhe të pestë të nenit 64 të Kodit Penal, duhet të dallojmë kohën fizike dhe kohës juridike të periudhës së kushtit. Dënimi alternativ i lirimit me kusht do të jetë në gjendje të shuajë dënimin me burgim, vetëm në kushtet kur koha juridike e periudhës së kushtit ecën dhe përllogaritet në mënyrë të vlefshme.

Pas revokimit të lirimit me kusht mbetet të vuhet pjesa e mbetur e dënimit, pa llogaritur në të kohën e kaluar nën lirinë e kushtëzuar të kësaj mase të dhënë nga gjykata.[241] Kjo do të thotë se vërtetimi i faktit të kryerjes së një vepre tjetër penale gjatë kohës së kushtit apo shkelja e të drejtave dhe detyrimeve të lëna me vendim gjykate për të dënuarin nihilizojnë dhe zerojnë kohën e kaluar nën kusht për efektet e vuajtjes së dënimit me burgim.

---

[239] *Shih Vendimin nr. 7184, datë 19.02.1998, të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.*

[240] *Shih për më tepër konkluzionet nomofilatike të Vendimit Unifikues nr. 2/2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

[241] *Shih Vendimin nr. 282, datë 25.051989, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.*

Ndaj pranohet se akordimi me vendim gjykate i lirimit me kusht pezullon dënimin me burgim në momentin e dhënies[242], duke mos lejuar që ai të llogaritet deri në momentin kur vërtetohet se koha e kushtit plotësohet me sukses, që do të thotë se nëse ndodhin fakte që revokojnë lirimin me kusht, pjesa e mbetur e dënimit penal të pezulluar fillon të ekzekutohet në të njëjtën masë të mbetur në momentin e pezullimit. Ndërkohë akordimi i lirimit me kusht nuk shuan dhe nuk prek efektet e tjera penale të dënimit dhe gjithashtu edhe dënimet plotësuese.

E njëjta logjikë interpretimi e ligjit do të duhet të ndiqet edhe në rastet kur pas dhënies së vendimit të lirimit me kusht nga gjykata e shkallës së parë është ushtruar ankim nga prokurori apo viktima e mitur nga vepra penale dhe se ndërkohë, sipas nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale, i dënuari e ka fituar lirinë dhe për rrjedhojë ka nisur të ecë afati i ekzekutimit të dënimit alternativ të lirimit me kusht. I njëjti problem do të shtrohet në rastet kur - gjatë kohës që pritet nga gjykata e apelit të shqyrtohet çështja, – ka kaluar pjesa e mbetur e dënimit me burgim të pezulluar, kohë e cila është edhe kohëzgjatje e periudhës së kushtit. Në këto raste, duke qenë se vendimi i lirimit me kusht nuk ka marrë formë të prerë dhe se pritet të shqyrtohet nga gjykata e apelit, nuk mundet të konstatohet shuarja dhe ekzekutimi i dënimit alternativ të lirimit me kusht. Përkundrazi, nëse gjykata e apelit ndryshon vendimin, i dënuari do të arrestohet dhe do të nisë vuajtja e pjesës tjetër të dënimit që ishte pezulluar nga zbatimi i lirimit me kusht.

Rast pas rasti, për rrethanat me karakter diskrecionar ligji ka parashikuar se gjykata, kur konkludon se ka shkelje, mundet të vendosë zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes apo revokimin e lirimit me kusht. Vlerësojmë se këto tre lloje vendimmarrjesh ndiqen nga një logjikë që determinohet nga rëndësia e shkeljes. Kjo do të thotë se ka një hierarki rëndësie dhe graviteti në të tre vendimmarrjet që gjykata mundet të disponojë, pasi shtimi i detyrimeve gjatë kohës së provës do të merret për shkelje më të lehta se sa zgjatja e afatit të mbikëqyrjes, dhe nga ana tjetër revokimi i lirimit me kusht përbën disponimin *ultima ratio* të gjykatës. Këto disponime gjithnjë duhet të justifikohen sipas parimit të proporiconalitetit.

---

[242] *Luigi Delpino (magistrate di cassazione), "Diritto Penale", II Edizione, Studi Superiori, Universita e Specializzazioni, Edizioni Giuridiche Simone, Gruppo Editoriale Esselibri – Simone, Mapoli, 2010, faqe 1024. Shih gjithashtu N. Bartone, L. Delpino, "Diritto Penale, Parte Generale", X Edizione, Serie Manuali Giuridici nr. 3, Edizioni Simone, 1994, faqe 468 – 470.*

5.6.1. Refleksione mbi paragrafin e fundit të nenit 64 të Kodit Penal

Paragrafi i pestë i nenit 64 të Kodit Penal, nga ligjvënësi i vitit 2017, është marrë si model nga mënyra se si i njëjti ligjvënës ka rregulluar paragrafin e nenit 59 të Kodit Penal. Ky i fundit parashikon se:

"*5. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.*".

Por kjo mënyrë formulimi shfaq defekte serioze të teknikës legjislative të nenit 64 të Kodit Penal, deri në masën e pamundësisë për ta zbatuar ndryshimin ligjor të vitit 2017. Nëse parashikimi ligjor i mëlartëm ka kuptim për dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit penal dhe vënien e të dënuarit në provë, nuk ka kuptim dhe nuk mundet të zbatohet për dy arsye për dënimin alternativ të lirimit me kusht. Të dy arsyet kanë të bëjnë me veçanësitë që të dy këto dënime alternative kanë.

Fillimisht sjellim në vëmendje se rregullimi ligjor "*vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër*", nuk ka kuptim dhe është i pazbatueshëm, pasi po të zbatohet do të ishte jokushtetues sepse do të vinte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe vetë institutin kushtetues dhe ligjor të gjësë së gjykuar. Lirimi me kusht si dënim të parë ka dënimin me burgim dhe se assesi nuk mundet gjykata, pavarësisht se çfarë ka bërë i dënuari gjatë kohës së kushtit, që të zëvendësojë dënimin me burgim me një burgim tjetër më të madh në lloj apo në sasi, pasi në këtë mënyrë do të kishin dënim pa ligj dhe do të shkelej neni 3 i Kodit Penal, neni 7 i KEDNJ dhe neni 29 i Kushtetutës.

Nga ana tjetër, nëse i dënuari ka kryer shkelje gjatë kohës së kushtit nuk ka mundësi se si dënimi i dënimit me burgim të zëvendësohet me një dënim tjetër kryesor apo alternativ, pasi në kushtet kur atij duhet t'i rëndohet pozita, ligji nuk mundet të synojë lehtësimin e saj. Megjithatë ka gjasa që me anë të këtij formulimi krejtësisht defektoz, ligjvënësi të ketë dashur të kërkojë nga gjykata që të ndryshojë masat që ajo ka urdhëruar për të zbatuar gjatë periudhës së kushtit. Thënë ndryshe, atë që i njëjti legjislator ka parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 31/9 të ligjit nr. 8331/1998, në pjesën ku parashikohet se:

"*Kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, shërbimi i provës paraqet raport para prokurorit, i cili përmban*

informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga i dënuari, vlerësimin e punonjësit të shërbimit të provës dhe propozimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë, për të zgjatur afatin e mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimet për ekzekutimin e dënimit.".

Për rrjedhojë vlerësojmë se, vetëm ky interpretim do të mundet të pajtonte me Kushtetutën defektin e formulimit në paragrafit të pestë, të nenit 64 të Kodit Penal.

Problemi i dytë i paragrafit të pestë të nenit 64 të Kodit Penal, shfaqet tek formulimi "*zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës*". Nëse ky formulim do të jetë i zbatueshëm krejt normalisht në rastin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, ai është apriori i pazbatueshëm në rastin e lirimit me kusht. Vendimi Unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka sanksionuar në sentencën e dytë nomofilatike se pjesa e mbetur e dënimit me burgim në çdo rast do të jetë periudha e kohëzgjatjes së kushtit. Për më tepër Rekomandimi i Këshillit të Evropës për lirimin me kusht në pjesën e dytë, konkretisht në pikën 10, ka parashikuar se kohëzgjatja e kushtit nuk mundet të jetë proporcionalisht më e madhe sesa pjesa e mbetur dhe e pezulluar e dënimit me burgim.

Kjo do të thotë se, nëse zbatohet paragrafi i pestë i nenit 64 të Kodit Penal, në pjesën që formulohet se "*zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës*", do të thotë se gjykata mundet të zgjasë dënimin alternativ mbi masën e dënimit kryesor dhe se indirekt kjo do të thotë se po zgjatet vetë periudha e dënimit kryesor. Për rrjedhojë konkludojmë se, nëse kjo pjesë e dispozitës do të zbatohet, vendimi gjyqësor do të pasjellë një dënim penal pa ligj dhe si i tillë në kundërshtim me Vendimin Unfikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me nenin 3 të Kodit Penal, në kundërshtim me nenin 7 të KEDNJ dhe në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës.

Për rrjedhojë sugjerojmë që të dyja këto pjesë të paragrafit të pestë të nenit 64 të Kodit Penal, të jenë objekt rishikimi nga ndërhyrjet më të radhës së ligjvënësit në Kodin Penal.

5.7. Periudha e sigurisë

Në vitin 2012, legjislatori prezantoi për herë të parë në historinë e ligjit penal shqiptar, periudhën e sigurisë në dënimin alternativ të lirimit me

kusht. Në Kodin Penal u shtua neni 65/a, i titulluar "*Periudha e sigurisë*", i cili parashikon se:

"*Gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:*

a) vepra penale, masa e dënimit të së cilës është mbi pesë vjet;
b) kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
c) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
ç) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
d) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

Periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.".

Kjo dispozitë përfaqëson momentin unik të rregullimit të institutit të lirimit me kusht, pasi të gjitha rregullimet e tjera, qoftë materiale apo procedurale, janë të tilla që lidhen ekskluzivisht me fazën e ekzekutimit të vendimit penal dhe për më tepër me fazën e vonshme të ekzekutimit, e cila nis nga momenti kur plotësohet periudha minimale dhe e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim. Deri në vitin 2012, të gjitha parashikimet dhe kufizimet aprioristike, qoftë kushte apo kritere subjektive apo objektive, mbi lirimin me kusht kishin si emërues të përbashkët faktin se parashikoheshin drejtpërdrejtë nga ligji dhe si të tilla ishin formulime me karakter normativ.

Përkundrazi, nga viti 2012 legjislatori parashikoi mundësinë që gjykata në vendimin përfundimtar të dënimit të vendosë kufizime aprioristike të natyrës objektive mbi periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e zbatimit të dënimit alternativ të lirimit me kusht. Apriori mund të konkludohet se kjo dispozitë nuk gjen zbatim dhe nuk ka lidhje me dënimet me burgim apo me dënimet me burgim të përjetshme, për të cilat nuk zbatohet lirimi para kohe me kusht, në kuptim të nenit 64, paragrafi i tretë dhe nenit 65, paragrafi i katërt.

Nga ky rregullim arrijmë të konkludojmë se, periudha e sigurisë nuk vepron mbi dënimet me burgim për kundravajtjet penale apo mbi dënimet

me burgim për krimet për të cilat dënimi me vendim përfundimtar të gjykatës është individualizuar deri në pesë vjet burgim. Ky konkluzion vjen fillimisht nga parashikimi i shkronjës "a" dhe përmbyllet nga paragrafi i fundit i nenit 65/a të Kodit Penal, pasi parashikohet se periudha e sigurisë shtrihet nga masa tre të katërtat e dënimit, deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.

Për rrjedhojë arrijmë të konkludojmë se, periudha e sigurisë është një parashikim ligjor i cili fushën e zbatimit e ka të kufizuar, konkretisht, ose tek krimet të cilat janë dënuar nga gjykata me burgim mbi pesë vjet deri në 35 vjet, apo për krimet për të cilat gjykata ka dhënë burgim të përjetshëm, me kushtin që për secilin nga këto të dënuar, subjektivisht apo objektivisht, ligji të mos ketë ndalesa kategorike të ndalimit të zbatimit të lirimit me kusht. Kjo mundësi e dhënë nga ligji për gjykatën, përfaqëson një dënim të shtuar penal mbi periudhën e detyrueshme dhe minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, qoftë mbi periudhën prej tre të kartëtat të dënimit me burgim për krime, dhe qoftë mbi periudhën mbi 35 vjet për dënimet me burgim të përjetshëm.

Kjo do të thotë se, zbatimi i periudhës së sigurisë në vendimin përfundimtar të dënimit penal përbën një vlerësim aprioristik të gjykatës së themelit të gjykimit mbi të ardhmen e ekzekutimit të vendimit penal, duke shtuar sakaq elementin ndëshkues dhe parandalues të përgjithshëm apo të posaçëm mbi këtë dënim të individualizuar dhe duke pakësuar njëkohësisht qëllimin rehabilitues dhe risocializues të tij. Nëpërmjet këtij disponimi gjyqësor në vendimin përfundimtar të dënimit me burgim gjykata, pasi konstaton se plotësohen kriteret subjektive dhe objektive për zbatimin e nenit 65/a të Kodit Penal, vendos apriori se periudha e ndëshkimit dhe prezumimi i mosrehabilitimit të të dënuarit do të duhet të jetë më e gjatë për shkak të rëndësisë së faktit penal dhe autorit.

Sikurse konstatohet nga dispozita, ka dy elementë të kushtëzojnë zbatimin e periudhës së sigurisë dhe se të dy elementët ligjorë kanë natyrë objektive. Kështu, sikurse u konkludua më lart, kërkohet detyrimisht që vepra penale të jetë krim dhe dënimi i individualizuar në vendimin përfundimtar të jetë mbi pesë vjet apo burgim i përjetshëm. Së dyti, kërkohet që në veprën penale të gjendet detyrimisht një nga elementët e mëposhtëm:

a) kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
b) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;

c) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
ç) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

Jo pa qëllim nuk e përfshimë shkronjën "a", në listën e përsëritur më lart. Vlerësojmë se teknika legjislative e formulimit të dispozitës është defektoze. Në nenin 65/a të Kodit Penal nuk do të duhet të kishte vend për parashikimin e shkronjës "a", pasi kjo krijon përshtypjen se do të mjaftonte edhe vetëm shkronja "a", që gjykata rast pas rasti të vendoste të caktonte si dënim të shtuar penal edhe periudhën e sigurisë kundrejt lirimit me kusht. Në të vërtetë nuk është kështu. Shkronja "a" ose do të duhej të përfshihej në pjesën e parë të paragrafit të parë të dispozitës,[243] ose nuk do të duhej të përfshihej fare, pasi rolin e saj do ta luante parashikimi dhe interpretimi i paragrafit të dytë edhe në kushtet kur shkronja "a" nuk do të ishte.

Elementët e nxjerrë në vëmendje më lart kanë natyrë kumulative, që do të thotë se premisa ligjore e zbatimit të periudhës së sigurisë ekziston vetëm kur të vërtetohet bashkekzistenca e tyre. Megjithatë vlerësojmë se zbatimi i periudhës së sigurisë nga gjykata nuk duhet të interpretohet dhe të konkludohet se është automatik dhe i detyrueshëm në çdo rast kur bashkekzistojnë në mënyrë kumulative edhe masa apo lloji i dënimit me burgim dhe rrethana e posaçme e kryerjes së veprës penale. Përkundrazi, legjislatori të paktën ka qenë i kujdesshëm në hartimin e kësaj dispozite dhe ka përdorur foljen "*mund*" që, pavarësisht kufizimeve të interpretimit gjuhësor, interpretimi juridik dhe kushtetues autonom i kësaj folje, përgjithësisht për të drejtën penale por jo vetëm, do të thotë më shumë diskrecion tek autoriteti vendimmarrës gjyqësor. Kjo do të thotë se, gjykata rast pas rasti do të duhet të vlerësojë, sipas diskrecionit të saj në mënyrën se si e cakton dënimin sipas nenit 47 të Kodit Penal, nëse rrethanat objektive dhe subjektive të rastit për gjykim dhe të autorit e justifikojnë rëndimin e periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim apo jo për qëllimet e lirimit me kusht. Në këtë vlerësim dhe konkluzion

[243] Në këtë eventualitet pjesa e parë e paragrafit të parë të nenit 65/a të Kodit Penal do të formulohej si më poshtë: *"Gjykata, në dhënien e vendimit, për dënimet me burgim mbi pesë vjet apo me burgim të përjetshëm për të cilat lejohet lirimi me kusht, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:".*

gjykata duhet të udhëhiqet më së shumti nga balanca kushtetuese dhe ligjore e secilit prej qëllimeve që dënimi penal është destinuar të ndjekë në rendin juridik dhe shoqëror.

6. ASPEKTET PROCEDURALE TË GJYKIMIT TË KËRKESËS PËR LIRIM ME KUSHT

6.1. Kodi i Procedurës Penale

6.1.1. Legjitimiteti i kërkuesit

Lirimi me kusht, ndryshe nga dënimet e tjera alternative, nuk zbatohet krahas caktimit të dënimit kryesor, apo në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar të dënimit të gjykatës. Lirimi me kusht është një dënim alternativ, që rishtazi zbatohet gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit me burgim. Për rrjedhojë, rregullat procedurale për kompetencën e gjykatës, për mënyrën se si ushtrohet kërkesa, rregullat mbi ritin e gjykimit dhe vendimmarrjen nga ana procedurale, përcaktohen në rregullimet ligjore që normojnë pjesën fundore të procesit penal, konkretisht atë të ekzekutimit të vendimeve penale.

Përgjithësisht kuadri ligjor procedural në këtë drejtim përbëhet nga rregullimet e Kodit të Procedurës Penale mbi ekzekutimin e vendimeve penale të dënimit dhe Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*", i ndryshuar (në vijim Ligji nr. 8331/1998). Megjithatë burim normativ për regjimin e caktimit apo ekzekutimit të dënimit alternativ në lirimit me kusht janë edhe ligje të tjera, konkretisht Ligji nr. 9328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" apo edhe Ligji nr. 10494, datë 22.12.2011 "*Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor*".

Nga rregullimi në tërësi i lirimit me kusht vihet re se, legjislatori nuk ka qenë koherent me ndarjen e natyrës juridike të normave dhe sistemin e tyre sipas ndarjes në të drejtë materiale dhe në të drejtë procedurale. Edhe dispozitat e Kodit Penal, që përbëjnë korpusin kryesor ligjor material të rregullimit normativ penal, në aspekte të posaçme të rregullimit të tyre, përmbajnë norma me karakter procedural, si për shembull paragrafi i fundit i nenit 64. Nga ana tjetër, Ligji nr. 9331/1998 përmban norma që kanë natyrë materiale të rregullimit, sikurse është rasti i nenit 31/10, në të

cilin identifikohen rastet se kur lirimi me kusht mundet të revokohet apo ndryshohet si dënim alternativ, apo edhe neni 31/11, në të cilin në paragrafin e dytë rregullohen rastet se kur ky dënim penal mundet të përfundojë para mbarimit të afatit ligjor që gjykata ka caktuar në dizpozitiv.

Fillimisht duhet të sillet në vëmendje se lirimi para kohe me kusht është një e drejtë e të dënuarit me burgim dhe se si e tillë të dy këto ligje procedurale, sikurse edhe vetë rregullimi ligjor material i Kodit Penal, parashikojnë se iniciativa për ushtrimin e një kërkese të tillë dhe për rrjedhojë edhe iniciativa për zhvillimin e një gjykimi të tillë, i përket vetë të dënuarit me burgim. Kjo do të thotë se kuadri ligjor shqiptar nuk parashikon një kontroll automatik të dënimit me burgim të mbetur për t'u vuajtur për të dënuarit.

Të njëjtin rregullim ka bërë edhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ku pavarësisht rolit aktiv të institucionit të ekzekutimit të vendimit penal apo organit të Shërbimit të Provës, qoftë për paraqitjen rishtazi të kërkesës apo qoftë për të ushtruar periodikisht me çdo tre muaj rikontroll gjyqësor mbi mundësinë e lirimit me kusht, ky ligj parashikon se do të jetë vetë i mituri, nëpërmjet avokatit apo përfaqësuesit të tij, që do të vërë në lëvizje gjykatën. Kështu neni 130 pika 1, nga rregullimi që bën mbi vendimin e pranimit apo refuzimit të lirimit me kusht të të miturit, le të kuptohet se në çdo rast gjykata disponon mbi kërkesën që i mituri ka bërë, që do të thotë se gjykata nuk është investuar vetë apo nga prokurori, as nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal, apo nga organi i Shërbimit të Provës, por nga kërkesa e të miturit. Gjithashtu në nenin 132 pika 1, të këtij Kodi parashikohet se rishikimi i mundësisë për lirim me kusht të të miturit shqyrtohet çdo tre muaj nga gjykata me kërkesë të të miturit të dënuar.

Neni 31/6, i Ligjit nr. 8331/1998, ka parashikuar se kërkesa për lirim para kohe me kusht ushtrohet nga i dënuari me burgim, duke kufizuar sakaq rrethin e subjekteve të legjitimuar aktivisht për të dorëzuar një kërkesë të tillë. Në praktikën gjyqësore dhe tradicionalisht rezulton të jetë zbatuar neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998, pasi në çdo rast është paraqitur kërkesa për caktimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht nga i dënuari me burgim dhe në asnjë rast nuk është ushtruar një kërkesë e tillë nga prokurori.

Vlerësojmë se ky konkluzion është i gabuar dhe se duhet të ndryshojë në të ardhmen, dhe në praktikën gjyqësore do të duhet që neni 31/6, i Ligjit nr. 8331/1998, dhe pika 1 e Kodit të Procedurës Penale të interpretohen sipas parimeve të përgjithshme dhe *ratio*-s që parashikohen në Rekomandimin Rec (2003) 22 të Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht. Kjo do të thotë

se dënimi alternativ i lirimit me kusht, përveç se duhet të konceptohet si përfitim dhe e drejtë subjektive e të dënuarit, duhet të konceptohet edhe si çështje e interesit publik për miradministrimin e drejtësisë penale dhe sistemit penitenciar dhe risocializimin e të dënuarve me burgim për kthimin e tyre si anëtarë të shoqërisë ku ligji respektohet.

6.1.2. Papranueshmëria e kërkesës për lirim me kusht

Pika 5 e nenit 471, të Kodit të Procedurës Penale, ndër të tjera rregullon se nëse kërkuesi nuk paraqitet në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse ka dijeni rregullisht për datën dhe orën e saj, heq dorë nga kërkesa, ose ndryshon objektin e saj, gjykata e deklaron atë të papranueshme. Në këto raste gjykata merr vendim, i cili u njoftohet palëve edhe mbrojtësve dhe se kundër vendimit mund të bëhet ankim, por ai nuk e pezullon ekzekutimin, përveçse kur gjykata që e ka dhënë, vendos ndryshe.

Neni 471 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 2 ka parashikuar edhe shkaqe të tjera të papranueshmërisë së kërkesës, duke parashikuar se kur kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkese të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe, gjykata, pasi dëgjon prokurorin e deklaron atë të papranueshme me vendim, i cili i njoftohet brenda pesë ditëve të interesuarit. Kundër vendimit mund të bëhet ankim.

Lidhur me konceptin ligjor të kërkesës së përsëritur, pika 2 e nenit 477 të Kodit të Procedurës Penale, ka normuar një rregullim të posaçëm për lirimin me kusht, duke parashikuar se kërkesa për lirim me kusht nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë. Kjo do të thotë se, në këto raste gjykata vendos mospranimin e kërkesës për lirim me kusht, duke mos e shqyrtuar atë në themel. Në këto raste mospranimi apo papranueshmëria e kërkesës realizohet nëpërmjet një vendimi jopërfundimtar të gjykatës, i cili konstaton një shkak paprocedueshmërie në gjykim dhe procesi gjyqësor për këtë arsye shuhet.

Sikurse është vënë re në pjesën e parë të këtij projekti, konkretisht në pjesën e studimit të praktikës gjyqësore të gjykatave të faktit dhe të apelit objekt hulumtimi, janë konstatuar raste kur terminologjia e disponimeve përfundimtare të gjykatave të shkallës së parë, nuk ka qenë e njëjtë në rastet kur i është dhënë fund procesit për shkaqe paprocedueshmërie. Kështu, ka pasur gjykata që kanë vendosur pushimin e gjykimit, apo disa të tjera që shprehen mbi papranueshmërinë e kërkesës. Vlerësojmë se, për hir të kuptimit më të mirë dhe harmonisë apo uniformitetit të zbatimit

të të njëjtit rregullim ligjor, do të ishte e përshtatshme që të respektohet terminologjia që neni 471 i Kodit të Procedurës Penale përdor, konkretisht papranueshmërinë e kërkesës. Megjithatë duhet të pranohet se të dy llojet e formulimeve të disponimeve të vendimit të gjykatës, passjellin të njëjtat pasoja juridike.

Gjithashtu është vënë re se, gjykatat e shkallës së parë disponojnë me vendime jopërfundimtare papranueshmërie, edhe kur shkaqet që ato identifikojnë në pjesën arsyetuese të vendimit kanë të bëjnë me themelin e kërkesës për lirim me kusht. Vlerësojmë se disponimet gjyqësore mbi lirimin me kusht duhet të jenë të unifikuara në të gjitha gjykatat, duke pasur parasysh parashikimet ligjore materiale dhe procedurale. Në tërësi ka dy lloje vendimmarrjeje; ose vendimmarrje përfundimtare ose vendimmarrje jopërfundimtare. Vendimmarrjet përfundimtare janë dy llojesh; ose rrëzimi i kërkesës për lirim me kusht ose pranimi i saj.

Në rast se kërkesa rrëzohet, kjo do të thotë se gjykata ka vlerësuar meritat ligjore të saj, qoftë të pabazueshmërisë në ligj dhe qoftë të pabazueshmërisë në fakt. Nga ana tjetër, pranimi i kërkesës presupozon të kundërtën e këtij vlerësimi. Ndërkohë vendimmarrja jopërfundimtare e gjykatës mbi gjykimin e kërkesave të lirimit me kusht është e parashikuar në nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale, që do të thotë se kur i dënuari kërkues nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme në kushtet kur ka dijeni, kur ai heq dorë nga kërkesa apo kur kërkesa është haptazi e pabazuar në ligj, atëherë gjykata vendos papranueshmërinë e kërkesës. Shkaqet e papranueshmërisë së kërkesës për arsye se ajo është haptazi e pabazuar, nuk mundet të kenë lidhje me aspektin material dhe meritor të saj, por janë kurdoherë të lidhura ekskluzivisht me shkaqe procedurale që passjellin gjendjen e paprocedueshmërisë.

6.1.3. Refleksione mbi nenin 477 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale

Në praktikën gjyqësore është vënë re vazhdimisht se ky parashikim ligjor nxit në mënyrë fiktive heqjet dorë nga kërkesa për lirim me kusht nga ana e të dënuarve me burgim, duke qenë se ato, apo nën këshillimin e mbrojtësit të tyre, kur kuptojnë perspektivën negative të kërkesës së tyre vendosin të heqin dorë apo të braktisin procesin edhe në kushtet e dijenisë së plotë për seancën. Qëllimi i tyre në këto raste është mospasja e pengesës ligjore të ekzistencës së një vendimi gjyqësor përfundimtar që ka rrëzuar kërkesën brenda afatit gjashtë mujor.[244]

[244] Shih "*Manual për aplikimin e alternativave me burgim*", OSBE, viti 2010, faqe 77. Shih gjithashtu

E vlerësojmë të drejtë dhe të domosdoshme praktikën gjyqësore që është krijuar ndërmjet gjykatave, të cilat kërkesat në çështjet e vendosura me vendime jopërfundimtare dhe të paraqitura sërisht i adresojnë menjëherë, pa ia nënshtruar shortit elektronik, gjyqtarit që ka vendosur papranueshmërinë e kërkesës.[245] Ky mekanizëm procedural i krijuar nga praktika gjyqësore parandalon që nëpërmjet kërkesave dhe veprimeve abuzime të dënuarit me burgim apo avokatët e tyre të përjashtojnë nga gjykimi gjyqtarë të caktuar dhe të kërkojnë caktimin në çështjet e tyre të gjyqtarëve të caktuar.

6.1.4. Lirimi me kusht për dënimet e huaja me burgim

Një çështje juridike që mundet të shtrohet për debat është kompetenca e gjykatave të ekzekutimit të juridiksionit të shtetit shqiptar për të gjykuar kërkesën për lirim para kohe me kusht të të dënuarve të huaj apo vendas, por të dënuar nga gjykata penale të shteteve të huaja dhe që, pas procedurës së njohjes së vlefshmërisë së tyre nga gjykatat shqiptare, po ekzekutohen në Shqipëri. Pyetja që shtrohet për diskutim është nëse, rregullimi i nenit 470, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile rregullon mënyrën e atribuimit të kompetencës gjyqësore në fazën e ekzekutimit të dënimit penal vetëm për çështje gjyqësore me karakter kombëtar, apo kjo normë rregullon edhe juridiksionin e gjykatave shqiptare përballë juridiksionit të gjykatave të huaja.

Pavarësisht se *prima facie* kjo dispozitë duket se përmban një rregullim me karakter kombëtar të gjykatës kompetente në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, ky rregull në të drejtën procedurale penale ndërkombëtarisht të pranuar, rregullon edhe atribuimin e juridiksionit gjyqësor ndërkombëtar. Kjo do të thotë se, neni 470, pika 1, i Kodit të Procedurës Penale sanksionon një parim të përbotshëm të mënyrës se si shtetet e ushtrojnë sovranitetin shtetëror mbi ekzekutimin e vendimeve penale kombëtare dhe të huaja.

Kështu në Konventën e Këshillit të Evropës[246] për transferimin e të dënuarve, në nenin 9 parashikohet se në këto raste shteti zbatues i dënimit konverton dënimin sipas ligjit të tij, dhe më tej pika 3 e kësaj dispozite

në web: https://www.osce.org/sq/albania/72037?download=true. Ndër të tjera në këtë botim pasqyrohet se: "*Në praktikën gjyqësore është konstatuar fakti se të dënuarit bazuar në të drejtat e tyre, çmojnë se nuk përmbushin për momentin ndonjë kriter ligjor nga ato të nenit 64 të Kodit Penal apo për të ushtruar të drejtën e tyre për të hequr dorë nga gjykimi i kërkesës, duke kërkuar pushimin e gjykimit dhe më pas për ta ushtruar këtë të drejtë në një moment tjetër. Kështu për vitin 2009, vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, janë pushuar për shkak të heqjes dorë nga gjykimi, 49 kërkesa me objekt lirimin me kusht.*"

[245] Shih "*Manual për aplikimin e alternativave me burgim*", OSBE, viti 2010, faqe 77. Shih gjithashtu në web: https://www.osce.org/sq/albania/72037?download=true.

[246] Shih Ligjin ratifikues nr. 8499, datë 10.06.1999, FLetore Zyrtare nr. 22, viti 1999.

parashikon se ekzekutimi i dënimit rregullohet ekskluzivisht sipas ligjit të shtetit zbatues, dhe se vetëm ky shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse lidhur me administrimin e ekzekutimit të vendimit penal të dënimit. Më tej në nenin 10, tregohet se si realizohet konvertimi dhe se kush janë limitet e mundësisë së shtetit konvertues për njohjen dhe ekzekutimin e dënimit të shtetit të huaj.

I njëjti rregull parashikohet edhe nga Konventa e Këshillit të Evropës për mbikëqyrjen e personave të dënuar apo të liruar me kusht[247]. Neni 11 parashikon se ekzekutimi i mbikëqyrjes së personave të dënuar apo të liruar me kusht nga shtetet e huaja, bëhen sipas ligjit të shtetit ekzekutues.

Konventa e Këshillit të Evropës mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale, ka parashikuar të njëjtin rregullim dhe akoma në mënyrë më eksplicite përsa i përket lirimit me kusht. Kështu, neni 10, pika 1, parashikohet rregulli se ekzekutimi do të rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar dhe vetëm ky shtet do të jetë kompetent për marrjen e vendimeve të duhura që përfshijnë lirimin me kusht.

Në këtë mënyrë konkludojmë se, pika 1 e nenit 470 të Kodit të Procedurës Penale, do të duhet të interpretohet se rregullon edhe mënyrën se si atribuohet kompetenca tokësore e gjykatës për kërkesat gjatë fazës së ekzekutimit të një dënimi penal shqiptar. Gjithashtu kjo normë përfaqëson në rendin juridik, edhe rregullin ndërkombëtar të ushtrimit të sovranitetit shtetëror, nëpërmjet të cilit parashikohet se ekzekutimi i çdo vendimi të huaj do të regjohet nga ligji i shtetit ekzekutues dhe nga gjykata e atij shteti. Në të njëjtën logjikë duhet të interpretohen edhe dy dispozitat derivative të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penale në ligjet e posaçme, konkretisht neni 71, i Ligjit nr. 8328/1998 dhe neni 31/6, i Ligjit nr. 8331/1998.

6.1.5. Kompozimi i trupit gjykues

Lidhur me kompozimin e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht apo të revokimit të këtij dënimi alternativ, neni 13, pika 2, shkronja "dh" e Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar përbërje monokratike të çdo gjykimi në fazën e ekzekutimit të dënimit penal. Kjo do të thotë se trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës për lirimin me kusht, ndryshimin e masave gjatë kohës së kushtit, shuarjen e dënimit me kusht apo revokimin e lirimit me kusht do të jetë me një gjyqtar, pavarësisht sanksionit të dhënë nga gjykata në vendimin e dënimit me burgim.

[247] Shih Ligjin ratifikues nr. 8724, datë 26.12.2000, Fletore Zyrtare nr. 50, viti 2000.

Gjithashtu, neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998, ka parashikuar se kërkesën për lirim para kohe me kusht e shqyrton gjykata e vendit të ekzekutimit të dënimit me burgim, duke parashikuar se kjo kërkesë shqyrtohet nga një gjyqtar i ndryshëm nga gjyqtari që ka dhënë vendimin e themelit të gjykimit. Ky rregullim synon të përcaktojë edhe kompetencën tokësore dhe funksionale për gjykimin e kërkesës për lirim para kohe me kusht. Njëkohësisht dispozita kujdeset që të shmangë nga faza e ekzekutimit të vendimit të dënimit penal përfundimtar, gjyqtarin apo trupën gjykuese që ka dhënë dënimin me burgim.

Mbetet të diskutohet nëse mundet të shqyrtohet apeli ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit, nga gjyqtar apo trupa gjykuese që ka shqyrtuar apelin apo rekursin e vendimit të themelit të dënimit me burgim. Vlerësojmë se kjo papajtueshmëri e vlerësuar apriori nga vetë ligji, logjikisht do të duhet të vlejë edhe për trupën gjykuese në gjykatën e apelit dhe për trupën gjykuese në Gjykatën e Lartë, sigurisht me dallimet respektive që diktohen nga natyra kushtetuese dhe ligjore e juridiksionit rishikues që këto dy shkallë gjykimi gëzojnë.

Fillimisht duhet të sillet në vëmendje se gjykata e apelit mundet, dhe si rregull, duhet ta shqyrtojë çështjen në themel. Gjykatat e apelit sipas Kushtetutës dhe ligjit janë të pajisura me juridiksion të plotë rishikues mbi faktin dhe mbi ligjin. Kjo do të thotë se gjykata e apelit gjithmonë do të disponojë mbi zgjidhjen në themel të vendimit të dënimit me burgim të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, qoftë duke e lënë vendimin në fuqi, apo qoftë duke ndryshuar atë në masën e dënimit. Në këtë kuptim vlerësojmë se, ndalesa e pjesëmarrjes së trupës gjykuese të gjykatës së apelit, që ka zgjidhur në themel çështjen e dënimit me burgim, në trupën gjykuese që shqyrton apelin e prokurorit apo të të dënuarit mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi kërkesën për lirim para kohe me kusht, do të duhet të zbatohet edhe për gjykatën e apelit. Kjo do të thotë se trupa e gjyqtarëve duhet të jetë e ndryshme nga trupa e gjyqtarëve që kanë shqyrtuar apelin ndaj vendimit të zgjidhjes në themel të çështjes.

Nga ana tjetër konkludohet se, nëse trupa gjyqësore e apelit në çështjen e themelit nuk ka dhënë zgjidhje në themel të çështjes mbi dënimin me burgim, atëhere nuk është e papajtueshme sipas ligjit për të shqyrtuar apelin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi kërkesën për lirim me kusht. Kjo do të thotë se, vendimi i mospranimit të ankimit apo disponimet mbi kompetencën, nuk do të mundet të krijojnë

këtë rrethanë papajtueshmërie tek gjyqtarët e gjykatës së apelit, sipas nenit 31/6 të Ligjit nr. 8331/1998.

Ndërkohë gjykimi në Gjykatën e Lartë ka më shumë specifika se sa gjykimi në apel, pasi juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë është ekskluzivisht ligjor, sipas nenit 141 të Kushtetutës dhe nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, vlerësojmë se logjika do të mbetet e njëjtë edhe në këtë shkallë gjykimi. Kjo do të thotë se, rast pas rasti, duhet të shikohet lloji i vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë mbi çështjen e themelit, nëse ka qenë vendim jopërfundimtar i mospranimit të rekursit, vendim i ndërmjetëm në raport me gjykimin sepse vendimi i rekursuar është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim, apo ka diskonim mbi kompetencën lëndore të gjykatës, apo ka vendim përfundimtar të zgjidhjes së çështjes në themelin e saj, qoftë duke u lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit apo qoftë kur ai prishet dhe lihet në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Kjo do të thotë se në tre rastet e para, trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë nuk ka asnjë shkak papajtueshmërie sikurse vendos neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998. Ndërkohë në dy zgjidhjet me disponimet përfundimtare të Gjykatës së Lartë, do të arrijmë në konkluzionin se trupa gjyqësore e tyre është e papajtueshme për shqyrtimin e rekursit mbi lirimin me kusht.

Gjithsesi, për shkak të specifikave kushtetuese dhe ligjore të Gjykatës së Lartë, do të duhet të vlerësojmë ndryshe kur ka iniciativa të trupës gjykuese të dhomës së këshillimit apo edhe të seancës për njësimin, zhvillimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore. Vlerësojmë se për shkak të natyrës së gjykimit nomofilatik dhe rregullimit kushtetues të nenit 141 të Kushtetutës mbi trupën gjyqësore, nuk mundet që Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë t'i hiqen tre gjyqtarët që kanë zgjidhur çështjen e dënimit me burgim në themel. I njëjti konkluzion duhet të ndjekë edhe kompozimin e trupës gjykuese prej pesë gjyqtarësh të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur që të njësojë apo zhvillojë praktikën gjyqësore mbi çështje të ligjit material apo procedural mbi gjykimin e kërkesës së lirimit para kohe me kusht. Pranimi i një konkluzioni të ndryshëm do të çonte në konsumimin e organikës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Përkundrazi, trupa gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara apo e Kolegjit Penal do të duhet të perfeksionohet sipas organikës së Gjykatës së Lartë apo parashikimit ligjor konkret, përveç eventualiteteve të ndalesave të tjera ligjore për pjesëmarrjen e gjyqtarëve në gjykim. Kjo do të thotë se neni 31/6, i Ligjit nr. 8311/1998 nuk mundet të zbatohet asnjëherë në mënyrën se si

do të kompozohet trupa gjykuese e seancës gjyqësore të Gjykatës së Lartë në gjykimet nomofilatike, qoftë kur çështja është kaluar në seancë gjyqësore për njësimin, zhvillimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore.

6.1.6. Riti i gjykimit

Lidhur me ritin e gjykimit neni 471 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar se, kur nuk ka shkaqe paprocedueshmërie, gjykata i shqyrton kërkesat për lirim para kohe me kusht apo revokimin e këtij dënimi alternativ nëpërmjet ritit plenar të gjykimit, duke caktuar seancën gjyqësore dhe duke lajmëruar për këtë qëllim palët dhe mbrojtësit, të paktën dhjetë ditë para seancës. Pika 4 e kësaj dispozite ka parashikuar se seanca gjyqësore zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi. I njëjti rregull mbi ritin plenar të gjykimit do të zbatohet edhe kur objekt gjykimi është kërkesa e prokurorit apo e të dënuarit për ndryshimin e masave gjatë kohëzgjatjes së kushtit, për shuarjen e lirimit me kusht para afatit apo kërkesa e prokurorit për revokimin e lirimit me kusht.

Në këtë mënyrë, regjimi juridik i ligjit procedural penal konformohet me kërkesat që ka parashikuar Pjesa VIII e Rekomandimit kuadër të Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht, ku janë rregulluar në mënyrë të përgjithshme garancitë procedurale për shqyrtimin e kërkesave për lirim me kusht. Konkretisht, në pikën 32 të këtij akti parashikohet se vendimet e pranimit, shtyrjes apo të revokimit të lirimit me kusht, duhet të merren nga organet kompetente të parashikuara me ligj, sikurse edhe vendimet për shtimin e detyrimeve ndaj të dënuarit, duke ofruar gjatë shqyrtimit të kërkesave disa garanci procedurale si:

- Garantimi i së drejtës për t'u dëgjuar personalisht për të dënuarit me burgim apo për t'u përfaqësuar sipas ligjit;
- Vlerësim dhe arsyetim i kujdesshëm i çdo rrethane që ndikon në vendimmarrjen mbi lirimin me kusht;
- Garantimin e aksesit të përshtatshëm mbi dosjen gjyqësore;
- Vendimet duhet të arsyetohen dhe të njoftohen;

Neni 31/10 i Ligjit nr. 8331/1998 ka parashikuar edhe rregulla procedurale për gjykimin e kërkesës së prokurorit për revokimin e lirimit me kusht. Kështu gjykata, pasi dëgjon prokurorin, të dënuarin, mbrojtësin

e tij dhe provat e kërkuara prej tyre, merr vendim brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit. Vendimi i njoftohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, Shërbimit të Provës dhe prokurorit. Ndaj vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Vihet re se ka një dallim ndërmjet mënyrës se si ligji procedural penal rregullon fazën që paraprin depozitimin e kërkesës dhe shqyrtimin e çështjes, në raport me rregullimet që bën Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur. Pika 12 e Rekomandimit kuadër të Këshillit të Evropës për lirimin me kusht parashikon se, punonjësit e institucionit të vuajtjes së dënimit dhe ato të mbikëqyrjes së post-lirimit duhet të bashkëpunojnë ngushtë dhe se ato duhet të konkludojnë mbi të dënuarin para mbarimit të periudhës minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim dhe para periudhës së kohëzgjatjes së kushtit. Për përgatitjen e të dënuarve për lirim me kusht, pika 13 dhe 14 parashikon se mundet të zbatohet ndaj tyre regjimi i gjysmë-lirisë apo pjesëmarrja në trajnime për edukim, duke krijuar kushtet për mbajtjen e kontakteve me familjen apo të afërmit dhe duke promovuar mbajtjen e kontakteve me organizatat jofitimprurëse, duke ofruar mundësinë e dhënies së formave të ndryshme të lejeve nga burgu.

Ndërkohë që ligji procedural penal dhe ligji për ekzekutimin e dënimit me burgim nuk ka procedura apo detyrime për organet që të luajnë një rol aktiv në investimin e gjykatës për të mundësuar rishqyrtimin gjyqësor periodik të dënimit të mbetur, Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur ka detajuar dhe ofruar garanci që konfirmohen me parimet e Rekomandimit të Këshillit të Evropës. Kështu, në nenin 129 të këtij Kodi parashikohet detyrimi i institucionit të ekzekutimit të dënimeve penale për të bashkëpunuar me Shërbimin e Provës tre muaj para se të arrijë periudha e detyrueshme dhe minimale e vuajtjes së dënimit me burgim për të miturin, në mënyrë që të përgatitet studimi dhe opinioni që do t'i paraqitet gjykatës dhe mundet të ndikojnë në vlerësimin e saj. Ky Kod, në nenin 132 ka parashikuar edhe procedurën e rishikimit periodik të lirimit me kusht nga gjykata dhe detyrimin e saj, në rast të rrëzimit të kërkesës, që të tregojë në vendim masat që duhet të merren në të ardhmen nga i mituri, administrata e institucionit të ekzekutimit të dënimeve penale dhe nga ana e Shërbimit të Provës në mënyrë që të plotësohen kushtet për akordimin e lirimit me kusht[248].

[248] Shih nenin 129 pika 6 të Kodit të Drejtësisë për të Miturit.

Vlerësojmë se megjithëse këto parashikime ligjore nuk bëhen në Kodin e Procedurës Penale apo në Ligjin nr. 8331/1998, është e udhës dhe në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtarisht të pranuara, që të ekzistojë një bashkëpunim i tillë konstruktiv kaq i ngushtë ndërmjet aktorëve kryesorë shtetërorë dhe të dënuarit, me qëllim që të mundësohet rishqyrtimi efektiv i dënimit me burgim dhe rifitimi i lirisë për të dënuarin.

Neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998 ka parashikuar se, pas paraqitjes së kërkesës për lirimin me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të dhe se kjo e fundit duhet ta administrojë këtë dokumentacion në fashikullin e gjykimit. Në këtë raport duhet të përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjithashtu kjo dispozitë ka vendosur detyrimin e gjykatës t'i kërkojë Shërbimit të Provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit. Në këtë mënyrë ligji ka dashur të tipizojë provat në procesin gjyqësor të shqyrtimit të kërkesës së lirimit me kusht për t'i standardizuar sakaq ato.

Vlerësojmë se për analogji duhet të mbahet parasysh edhe rregullimi i posaçëm për natyrën e gjykimit që bën neni 72 i Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, për shqyrtimin e kërkesave në gjykatë gjatë fazës së ekzekutimit të dënimeve penale. Sipas këtij rregullimi, gjyqtari shqyrton çështjen dhe merr vendime vetëm për sa është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore, me pjesëmarrje të detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij.

Kur çështja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e të dënuarit, seanca zhvillohet në mjedise të përshtatshme të institucionit ku ndodhet. Në shqyrtimin e çështjes merr pjesë edhe avokati i kërkuar nga i dënuari ose i caktuar kryesisht për të dënuarit e mitur, ata që kanë shqetësime psikike, gratë me barrë ose fëmijë në gji, si dhe të dënuarit me shtetësi të huaj.

Gjithashtu vlerësojmë të nevojshme që, rast pas rasti institucioni i ekzekutimit të dënimit me burgim apo organi kompetent i Shërbimit të Provës në çdo rast, për të përditësuar standardet më të mira në veprimtarinë

e tyre, duhet të ndjekin për analogji edhe përcaktimet dhe rregullimet e posaçme që ka bërë për lirimin me kusht Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, konkretisht dispozitat nga neni 129 – 135. Megjithëse këto dispozita janë të zbatueshme për subjekte të posaçëm për shkak të moshës së të dënuarve, vlerësojmë se ka ndër këto rregullime të posaçme standarde të cilat duhet të zbatohen universalisht për çdo të dënuar.

Neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998 ka parashikuar se, pas paraqitjes së kërkesës për lirimin me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. Lidhur me përmbajtjen e raportit ligji është kujdesur që t'i japë një formë dhe përmbajtje të paracaktuar dhe të standardizuar, në mënyrë që në të të jepet detyrimisht informacioni i nevojshëm që do t'i shërbejë gjykatës për shqyrtimin e kërkesës dhe vendimmarrje.

Kështu në raport duhet të përcaktohen:

- natyra e veprës penale të kryer;
- qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës;
- ekzistenca e ndonjë vepre të mëparshme penale, e kryer prej tij;
- gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar;
- dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kjo dispozitë parashikon detyrimin e gjykatës që të kërkojë nga Shërbimi i Provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit. Ky akt procedural do të mundësojë që t'i ofrohet gjykatës një panoramë më e plotë për perspektivën eventuale të lirisë me kusht të të dënuarit. Përshkrimet dhe të dhënat që pasqyrohen në këtë akt narrativ dhe analitik, janë me rëndësi të madhe dhe si të tilla nuk duhet të jenë formuluar me terma apo konsiderata të përgjithshme, por të jenë dhe të gjejnë konkretizim në të dhënat e vëzhgimeve, analizës dhe dokumentave që disponohen nga institucioni administrativ i specializuar për këtë qëllim.

Pjesa e V e Rekomandimit kuadër të Këshillit të Evropës, rregullon vendosjen e kushteve apo masave që i dënuari do të jetë i detyruar të respektojë gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Në pikën 25 parashikohet se, në

vlerësimin e kritereve ligjore të lirimit me kusht për autoritetin kompetent vendimmarrës duhet të jenë të disponueshme, çdo relacion apo raport që ka dokumentuar sjelljen e të dënuarit me perspektivën e lirimit të tij. Autoriteti vendimmarrës duhet të sigurohet se i dënuari i kupton kushtet e vendosura në vendimin e lirimit me kusht dhe se duhet t'i tregojë atij se çfarë pasojash do të ketë në rast se detyrimet nuk përmbushen gjatë kohës së kushtit.

Lidhur me raportin e Shërbimit të Provës dhe përmbajtjen e tij duhet të mbahet parasysh edhe neni 31/8 i Ligjit nr. 8331/1998, megjithëse kjo dispozitë nuk rregullon posaçërisht përmbajtjen e raportit që duhet të merret në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht. Gjithsesi për një interpretim sa më të plotë dhe teleologjik, vetë Shërbimi i Provës dhe gjykata duhet ta mbajnë parasysh edhe këtë parashikim ligjor. Kështu, në këtë dispozitë parashikohet se raporti i vlerësimit duhet të përmbajë të dhëna dhe vlerësim të rrethanave shoqërore, duke u shoqëruar me informacion dhe të dhëna për personalitetin e shkelësit të ligjit, punësimin e mëparshëm, sjelljen e nivelin arsimor dhe faktorët që ndikojnë apo mund të ndikojnë në sjelljen e tij, me qëllim që të ndihmojë gjykatën në vlerësimin e duhur të dënimit alternativ.

Ajo çka është shumë e rëndësishme, sikurse u konkludua më lart, duhet të mbahet parasysh se raporti i Shërbimit të Provës duhet të mbështetet në fakte, duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv, si dhe të dërgohet brenda kohës së caktuar nga gjykata. Gjithashtu, raporti i Shërbimit të Provës duhet të përmbajë edhe rekomandimin e këtij institucioni për dënimin e përshtatshëm alternativ për personin, për integrimin e tij në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

6.1.7. Disponimet gjyqësore

Nga rregullimet e Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit nr. 8331/1998, del se gjykata e ekzekutimit mundet të disponojë nëpërmjet tre lloje vendimmarrjesh, mbi kërkesat për lirimin me kusht apo revokimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Në çdo rast tipizimi i vendimmarrjeve eventuale gjyqësore janë dy llojesh; konkretisht vendimmarrjet përfundimtare ku disponohet dhe gjykohet mbi meritat e kërkesës dhe themelsinë e saj. Nga ana tjetër, janë edhe vendimmarrjet jopërfundimtare, të cilat i japin fund gjykimit për një nga shkaqet e paprocedueshmërisë, por nuk gjykojnë dhe nuk disponojnë mbi meritat e kërkesës. E njëjta logjikë do të vegjojë edhe kërkesat për revokim, ndryshim apo shuarje të dënimit alternativ të lirimit me kusht.

Kështu, në rast se kërkesa është e bazuar në ligj, lirimi me kusht pranohet, duke u vendosur kohëzgjatja e kushtit apo kohëzgjatja e vënies në provë të të dënuarit dhe më tej duke përcaktuar se kush do të jenë detyrimet konkrete që i dënuari do të duhet të zbatojë, sipas nenit 60 të Kodit Penal. Lidhur me kohëzgjatjen e kushtit, sikurse është vënë re më lart në këtë punim, konkretisht në pjesën respektive të trajtimit, ligji penal shqiptar, përveç Kodit Penal të vitit 1948, nuk ka pasur të parashikuar asnjëherë në mënyrë eksplicite afatin minimum dhe maksimum të kohëzgjatjes së periudhës së kushtit për dënimin alternativ të lirimit me kusht. Megjithatë, duke interpretuar implicitetin e rregullimeve të Kodit Penal në fuqi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 2/2015, kanë konkluduar në sentencën nomofilatike se në çdo rast periudha e kohëzgjatjes së kushtit do të jetë pjesa e mbetur e dënimit.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave të studiuara për qëllimet e këtij studimi, është vënë re se përgjithësisht ato konfirmohen me sentencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbi kohëzgjatjen e kushtit. Në këto vendime nuk arsyetohet se pse nuk zbatohet Vendimi Unifikues nr. 2/2015 dhe se nga kush parashikim merren afatet më të mëdha se sa dënimi i mbetur i kohëzgjatjes së kushtit. Megjithatë, në të njëjtën kohë kuptohet se për ta bërë këtë, gjyqtarët zbatojnë me analogji nenin 59 të Kodit Penal.

Vlerësojmë se kjo mënyrë e zbatimit të ligjit për të përcaktuar kohëzgjatjen e kushtit, përbën zbatim të ligjit penal me analogji, gjë që vjen ndesh me nenin 3 të Kodit Penal, nenin 29 të Kushtetutës dhe me nenin 7 të KEDNJ. Vlerësojmë se për sa kohë Vendimi Unifikues nr. 2/2015 është në fuqi, ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar, në bazë dhe për zbatim të nenit 141 të Kushtetutës dhe se të gjykuarit kanë pritshmëri se e drejta e zbatueshme në kuptimin material për sa i përket kësaj çështje, është pikërisht kjo bazë juridike e unifikimit të praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë vendimmarrjet e gjykatave për sa i përket kësaj çështje, duhet të jenë të njësuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga ana tjetër gjykata mundet të vlerësojë të bazuar në ligj, kërkesën e prokurorit për revokimin e lirimit me kusht. Gjykata, pasi e pranon atë, urdhëron revokimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht dhe urdhëron vuajtjen e pjesës së pezulluar të dënimit me burgim. Bashkimi i dënimit me burgim, i cili është pezulluar për shkak të lirimit me kusht, do të jetë i mundur gjithmonë atëherë kur, edhe dënimi tjetër i ekzekutueshëm është me burgim. Kjo do të thotë se, në rastet kur i dënuari është dënuar me

burgim për vepër tjetër penale, gjykata duhet të bëjë bashkimin e dënimeve dhe të caktojë dënimin përfundimtar për të vuajtur, sipas nenit 475 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 55 të Kodit Penal. Në këto raste vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe si i tillë e zgjidh çështjen në themel.

Nga ana tjetër gjykata, kur vlerëson se kërkesa për lirim para kohe me kusht është e pabazuar në ligj, pasi nuk plotësohen kushtet ligjore materiale të kërkuara nga Kodi Penal për zbatimin e lirimit me kusht si dënim alternativ, vendos rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj. Disponimi në themel i rrëzimit të kërkesës së lirimit me kusht, del indirekt edhe nga rregullimi i pikës 2 të nenit 477 të Kodit të Procedurës Penale.

Në këtë mënyrë disponohet edhe kur gjykata vlerëson se kërkesa e prokurorit për revokim të lirimit me kusht si dënim alternativ, nuk është e bazuar në ligjin material penal apo në prova. Edhe në këto raste vendimi i gjykatës është përfundimtar, pasi zgjidhja e çështjes është meritore dhe ka disponuar mbi themelin e saj.

Nga ana tjetër, neni 471 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe një lloj disponimi procedural dhe jopërfundimtar të gjykatës mbi kërkesën e lirimit me kusht apo për revokimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Kështu kur hiqet dorë nga kërkesa, kur kërkuesi nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, kur kërkesa është përsëritje brenda 6 muajve e një kërkese të zgjidhur gjyqësish në themel, apo kur ajo është haptazi e pabazuar në ligj, gjykata duhet të vendosë papranueshmërinë e kërkesës. Duke qenë se këto janë shkaqe paprocedueshmërie, vendimet gjyqësore që disponojnë mbi to nuk zgjidhin çështjen në themel po mjaftohen vetëm me dhënien fund të procesit gjyqësor.

6.1.8. Ekzekutueshmëria e disponimeve të lirimit me kusht

Lidhur me ekzekutueshmërinë e disponimeve gjyqësore mbi kërkesën për lirim me kusht duhet të konkludohet se pranimi i një kërkese të tillë passjell rifitimin e lirisë personale të të dënuarit përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kushtit. Duke qenë kështu, bazuar në nenin 417 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, konkludohet se vendimet gjyqësore përfundimtare që disponojnë pranimin e caktimit të lirisë me kusht si dënim alternativ janë menjëherë të ekzekutueshme, pasi ankimi ndaj tyre nuk passjell pezullimin e disponimit të lirimit të menjëhershëm të të dënuarit. Lidhur me këtë çështje, në praktikën gjyqësore të studiuar nuk është gjetur asnjë problematikë apo praktikë e dyzuar gjyqësore.

Në të njëjtën logjikë është rregulluar ekzekutimi i vendimit gjyqësor në nenin 21 të Ligjit nr. 8331/1998. Kjo dispozitë ka parashikuar se ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit, të gjitha vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurimi me arrest për shkak tjetër, si dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë.

Më tej pika 2 e kësaj dispozite parashikon se, për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit. Prokurori nxjerr urdhrin e lirimit të menjëhershëm, i cili vihet në ekzekutim nga organet përgjegjëse, pasi të kenë verifikuar më parë që ndaj të njëjtit person ose së njëjtës pasuri, nuk janë në fuqi vendime të tjera penale që legjitimojnë vazhdimin e mbajtjes së personit nën arrest, ndalim, paraburgim ose burgim, apo mbajtjes së pasurisë nën sekuestro ose konfiskim.

Kjo do të thotë se, universalisht të gjitha vendimet e gjykatës penale që disponojnë urdhërimin e lirimit nga masat penale që kufizojnë lirinë personale të të pandehurit apo të dënuarit, edhe pse nuk kanë marrë formë të prerë, janë menjëherë të ekzekutueshme. Në këtë mënyrë ankimi eventual ndaj tyre nuk mundet të pezullojë apo të prekë ekzekutueshmërinë e menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë të tyre.

Nga ana tjetër, kur gjykata vendos pranimin e kërkesës së prokurorit për revokimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht, vendimi gjyqësor që urdhëron revokimin dhe vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burgim deri më parë të pezulluar, nuk ekzekutohet menjëherë. Në të njëjtën mënyrë nuk mundet të ekzekutohet menjëherë edhe vendimi eventual i gjykatës, që pasi ka revokuar lirinë me kusht, bashkon dënimet për veprat penale sipas nenit 55 të Kodit Penal.

Përkundrazi, që këto vendime gjyqësore të jenë të ekzekutueshme, do të duhet që të marrin formë të prerë sipas rregullave të zakonshme ligjore, konkretisht sipas nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se, në bazë dhe për zbatim të pikës 1 të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale, ankimi i vendimit të revokimit të lirimit me kusht pezullon ekzekutimin e tij deri në marrjen formë të prerë të vendimit.

7. EKZEKUTIMI I DËNIMIT ALTERNATIV TË LIRIMIT ME KUSHT

7.1. Subjektet procedurale gjatë ekzekutimit të lirimit me kusht

Ligji penal material dhe procedural kanë parashikuar se për ekzekutimin e lirimit me kusht si një nga dënimet alterantive, do të marrin pjesë disa institucione, ku ndër të tjerë, ndër më protagonistët është edhe Shërbimi i Provës. Shërbimi i Provës si institucion dhe gjithashtu edhe si kuadër ligjor në Shqipëri është relativisht i ri, në raport me disiplinat e tjera të së drejtës. Shërbimi i provës rregullohet me Ligji nr. 8331, datë 1998 "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*", i ndryshuar me Ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008 dhe me Ligj nr. 80/2018 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", të ndryshuar*".

Ky ligj ka rregullime organike, materiale dhe procedurale normative të fazës së ekzekutimit të vendimit penal, duke u parashikuar ndër të tjera të drejta dhe detyrime për organet administrative, prokurorin, gjykatën dhe personin e dënuar. Lirimi para kohe me kusht rregullohet nga neni 31/6 – 31/10. Më poshtë, për lehtësi referimi, ligjit do t'i referohemi si Ligji nr. 8331/1998.

Neni 31/7 i Ligjit nr. 8331/1998 e ka përkufizuar Shërbimin e Provës si organin shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Kjo dispozitë ka mundësuar bazën ligjore të nevojshme që organet e Shërbimit të Provës të bashkëpunojnë formalisht apo joformalisht me organet shtetërore qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore, apo edhe me organizatat jofitimprurëse, për të mundësuar sakaq që këto subjekte ndihmëse t'i japin Shërbimit të Provës ndihmën e nevojshme për përmbushjen e detyrave ligjore.

Gjithashtu Shërbimi i Provës duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucione të tjera të drejtësisë penale gjatë pranimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të rrezikshmërisë dhe nevojave të të dënuarve me dënime alternative me burgim. Nga ligji, ky institucion është vlerësuar se duhet të ndihmojë personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social, duke vendosur kontakte me familjen

dhe mjedisin shoqëror të të dënuarit, me organizatat jofitimprurëse dhe individët.

Pjesa VI e Rekomandimit kuadër të Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht, parashikon parimet që duhet të ndiqen gjatë ekzekutimit të vendimit të lirimit me kusht, ku përcaktohet se duhet të ekzistojë një organ mbikëqyrës dhe duhet të respektohen Rregullat evropiane mbi masat dhe sanksionet komunitare. Qëllimi i mbikëqyrjes duhet të jetë asistenca ndaj të dënuarit, orientimi i tij drejt risocializimit dhe rehabilitimit të plotë dhe parandalimi i rikthimit të tij në aktivitet të paligjshëm. Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale është kujdesur që nëpërmjet parashikimeve dhe detajimeve teknike të përditësojë dhe të mundësojë arritjen e këtyre standardeve.

Neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998 ka përcaktuar se kur gjykata vendos lirimin me kusht të personit të dënuar, ia dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari pas lirimit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal. Personi i liruar me kusht ka detyrimin ligjor t'i raportojë rregullisht Shërbimit të Provës gjatë kohës së lirimit me kusht.

Ligji ka dashur që të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme informacion mbi vendndodhjen dhe aktivitetin e të dënuarit gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Për rrjedhojë është parashikuar se, kur ai kërkon të ndryshojë vendbanimin duhet të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës, duke paraqitur dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin e vendbanimit. Nga ky moment ligji ka parashikuar se do të duhet të ndryshojë, sikurse vendbanimi i të dënuarit, edhe zyra përkatëse ndjekëse e Shërbimit të Provës.

Zyra vendore e Shërbimit të Provës, e cila ka mbikëqyrur deri në atë moment të dënuarin, duhet t'ia përcjellë praktikën e ekzekutimit për të dënuarin zyrës përkatëse vendore të Shërbimit të Provës, ku i dënuari ka vendbanimin e ri dhe ky i fundit duhet të mbajë kontaktet me zyrën e re të bërë kompetente për shkak të vendbanimit të ri. Në rastet e ndryshimit të vendbanimit të të dënuarit, Shërbimi i Provës njofton për këtë fakt organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, në mënyrë që edhe ato të jenë në dijeni mbi vendndodhjen dhe aktivitetin e të dënuarit gjatë kohëzgjatjes së kushtit.

Shërbimi i Provës rezulton se merr rolin kryesor pas dhënies së vendimit gjyqësor të lirimit me kusht, pasi është ky institucion që mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ato të Policisë së Shtetit.

Zyra përkatëse detyrohet të informojë me shkrim sa më parë prokurorin kur i dënuari i vënë në provë nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës, ose nuk përmbush rregullisht detyrimet e përcaktuara në vendimin e gjykatës. Gjithashtu, Shërbimi i Provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato.

Në ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe mbi të gjitha në vlerësimin e rëndësisë së devijimeve eventuale apo shkeljeve të detyrimeve nga i dënuari gjatë kohëzgjatjes së provës, duhet të mbahen parasysh edhe standardet e Rekomandimit kuadër të Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht. Pjesa VII e Rekomandimit parashikon rregullime të përgjithshme mbi masat që duhet të merren, kur konkludohet se i dënuari nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë kohëzgjatjes së kushtit. Në pikën 30 parashikohet se shkeljet e lehta të detyrimeve nga ana e të dënuarit duhet të marrin përgjigje me anë të kështillimit, apo të paralajmërimeve nga organet që zhvillojnë mbikëqyrjen e të dënuarit. Ndërsa shkeljet serioze të detyrimeve duhet të raportohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme tek autoritetet kompetente, të cilat duhet të ndërmarrin masat respektive kundër të dënuarit, proporcionalisht me rëndësinë e shkeljes, deri në revokimin e lirimit me kusht.

Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale përgjithësisht është konfirmuar me standardet e kërkuara nga Këshilli i Evropës. Më tej, ligji ka parashikuar se Shërbimi i Provës, prokurori dhe më tej gjykata vlerëson nëse duhet të shtohen apo të ndryshohen detyrimet gjatë kohëzgjatjes së kushtit apo provës, apo të procedohet me revokimin e vendimit të lirimit me kusht, duke proceduar me arrestimin e personit dhe kthimin e tij në institucionin e ekzekutimit të dënimit penal me burgim për të proceduar me vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit deri në atë moment të pezulluar. Për të realizuar këtë vlerësim, që nga propozimi i Shërbimit të Provës tek prokurori, më tej tek kërkesa e prokurorit drejtuar gjykatës dhe tek shqyrtimi dhe vendimmarrja e gjykatës duhet të procedohet sipas parashikimeve të paragrafit të fundit të nenit 64 të ndryshuar të Kodit Penal.

Në nenin 31/9 të Ligjin nr. 8331/1998, parashikohet se në të gjitha rastet kur gjykata vendos aplikimin e një dënimi alternativ, i dërgon menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit për ekzekutimin e dënimit alternativ. Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata ia dërgon një kopje të vendimit edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale, ku mbahet i dënuari, për lirimin e tij.

Kjo dispozitë është kujdesur edhe të përcaktojë se kur do të nisë afati i ekzekutimit të dënimit alternativ, duke parashikuar se në rastin kur i dënuari nuk paraqitet të nesërmen e shpalljes së vendimit, afati i ekzekutimit të dënimit alternativ fillon në momentin e kontaktit të parë të personit të vendosur në provë me Shërbimin e Provës. Kështu është parashikuar detyrimi i gjykatës që të përcaktojë në vendim edhe kohëzgjatjen e kohës së provës në vendimin penal që pranon kërkesën për lirim me kusht.

Duke pasur parasysh konkluzionet nomofilatike të Vendimit Unfikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kuptohet se në çdo dënim me burgim, të ndryshëm nga dënimi me burgim të përjetshëm, koha e provës do të jetë pjesa e mbetur e dënimit me burgim, apo thënë ndryshe pjesa e pezulluar e dënimit me burgim të pakonsumuar. Nga ana tjetër, mbetet që në eventualitetin e lirimit para kohe me kusht të të dënuarve me burgim të përjetshëm, gjykata të përcaktojë se sa do të jetë koha e kushtit apo thënë ndryshe sa do të jetë koha e provës. Nga interpretimi i konkluzioneve nomofilatike të Vendimit Unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, megjithëse nuk është unifikuar praktika gjyqësore në mënyrë eksplicite kështu, konkludohet se koha e kushtit dhe e provës për të dënuarit me burgim të përjetshëm do të jetë pjesa e mbetur e dënimit të pezulluar, që do të thotë pjesa e mbetur e jetës.

Në këtë mënyrë ka ecur edhe praktika gjyqësore, edhe në ato pak raste që ka pasur.[249] Magjithatë ka edhe raste kur praktika gjyqësore, edhe pse pa shpjeguar se pse, zbaton me analogji nenin 59 të Kodit Penal, duke caktuar afatin maksimal prej 5 vjetësh për kohëzgjatjen e kushtit dhe duke shmangur zbatimin e Vendimit Unifikues nr. 2/2015.[250]

7.2. Pamundësia e ekzekutimit të lirimit me kusht

Kjo dispozitë ka parashikuar edhe eventualitetin e vendimmarrjes së gjykatës në rast se rezulton se, për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit, dënimi alternativ i lirimit me kusht nuk ekzekutohet. Në këto raste Shërbimi i Provës informon pa vonesë prokurorin për pamundësinë e ekzekutimit për shkaqe objektive. Më tej, me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë shtyrjen e fillimit e ekzekutimit të dënimit alternativ, deri në zhdukjen e pengesës objektive.

[249] *Shih një disponim të tillë në Vendimin nr. 86000-01447-41-2018 (1/54 DA), datë regjistrimi 24.07.2018, nr. 41-2019-642 (1-54 DA), datë 14.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*

[250] *Shih Vendimin nr. 34-2020-50, datë 24.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.*

Si shkak pamundësie për ekzekutimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht, është kualifikuar në ligj edhe rasti kur ndaj të dënuarit caktohet një masë sigurimi personal. Në këto raste gjykata mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të dënimit alternativ të lirimit me kusht.

Si masa e sigurimit me karakter personal, edhe shkaqet e pamundësisë jashtë vullnetit të të dënuarit, thënë ndryshe janë fakte juridike që shkaktojnë pezullimin e dënimit alternativ, e bashkë me të pezullohet ecja e kohës së kushtit apo e provës. Pasi rrethana objektive e pamundësisë do të shuhet, do të nisë të ekzekutohet normalisht dënimi alternativ i lirimit me kusht, duke ecur dhe duke u llogaritur koha e kushtit apo e provës së caktuar me vendimin e gjykatës.

7.3. Ndryshimi i kushtit apo detyrimeve gjatë provës

Neni 31/9 i Ligjit nr. 8331/1998 ka parashikuar mundësinë e ndryshimit të kushteve dhe detyrimeve gjatë kohës së provës për të dënuarin me lirim para kohe me kusht. Kështu ligji parashikon se Shërbimi i Provës mund t'i propozojë prokurorit për të ndryshuar, sipas ligjit, kushtet dhe detyrimet për të dënuarin, pasi verifikon faktet dhe rrethanat e mospërmbushjes së tyre nga i dënuari. Për ta ushtruar më së miri këtë funksion, Shërbimi i Provës përgjatë ekzekutimit të dënimit alternativ mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në integrimin social të tij.

Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, Shërbimi i Provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe të programit të mbikëqyrjes. Në raport duhet të pasqyrohet informacioni për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga i dënuari, vlerësimin e punonjësit të Shërbimit të Provës dhe propozimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë apo për të ndryshuar kushtet e detyrimet për ekzekutimin e dënimit.

Neni 31/9 i Ligjit nr. 8331/1998, ka parashikuar mundësinë e gjykatës për të ndryshuar edhe kohën e kushtit apo të provës gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ. Kështu, kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës paraqet raport para prokurorit, i cili, nën përmbajtjen e lart-treguar, pasqyron edhe vlerësimin dhe propozimin konkret, së bashku me arsyet përkatëse, për të zgjatur afatin e mbikëqyrjes.

Megjithatë duhet të mbahet parasysh se kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet dhe të analizohet e vetme. Ajo do të duhet të interpretohet në mënyrë të harmonizuar dhe komplementare me paragrafin e fundit të nenit 64 të Kodit Penal, pasi të dyja rregullojnë të njëjtën gjë. Kjo pjesë e dispozitës parashikon se gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimin për lirimin para kohe me kusht.

Në praktikën gjyqësore janë vënë re raste kur gjykatat vendosin që të thërrasin specialistët e Shërbimit të Provës me cilësinë procedurale të dëshmitarit në gjykimet e lirimit me kusht. Në parim, specialistët e Shërbimit të Provës apo edhe të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, nuk mundet të përjashtohen nga thirrja me cilësinë procedurale të dëshmitarit, pasi potencialisht ato që kanë plotësuar raportet respektive i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë të tillë.

Megjithatë vlerësojmë se Shërbimi i Provës dhe institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale janë institucione *quasi* subjekte procedurale në këto gjykime, pasi ato janë protagonistë gjatë gjithë fazës fundore të ekzekutimit të dënimit penal që ndodh jashtë gjykimit. Si të tillë, ato kanë disa detyra ligjore për të kryer dhe ato marrin pjesë aktive në të gjithë këtë fazë të procesit penal. Atyre ligji i ka ngarkuar realizimin e dy akteve të rëndësishme mbi vlerësimin e të dënuarve kërkues të lirimit me kusht, në të cilat ato vlerësojnë zhvillimin e personalitetit dhe rrethanave sociale të të dënuarit dhe perspektivën rehabilituese të tyre. Të dy aktet që ato bëjnë, janë prova tipike procedurale që ligji i parashikon në gjykimet e lirimit me kusht. Analizuar në këtë aspekt, vlerësojmë se thërritja si dëshmitar i specialistëve të këtyre institucioneve nga gjykata, nuk mundet të bëhet si rregull, por si përjashtim nga rregulli, dhe vetëm atëherë kur nuk del i qartë një nga informacionet që përmendet në raport.

Duhet të sillet në vëmendje se ka edhe modele ligjore procedurale, të cilat nuk i japin rol protagonist prokurorit të ekzekutimit gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal që ka caktuar një dënim alternativ i cili ekzekutohet nëpërmjet Shërbimit të Provës. Në këto shtete prokuroria

është suprimuar dhe shmangur si hallkë, duke krijuar një mekanizëm të drejtpërdrejtë aksesi në gjykatë të Shërbimit të Provës, në rastet kur del se i dënuari nuk përmbush detyrimet ligjore.

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë së fundmi ka propozuar në Kuvend që kjo zgjidhje të adoptohet edhe në ligjin procedural penal shqiptar. Ajo ka ndarë në Kuvend shqetësimin se, referuar praktikës së akumuluar gjatë aplikimit të masave alternative në vendin tonë, rezulton se në raste të shumta raportimi i rasteve pranë prokurorisë mbetet pa veprim të mëtejshëm dhe se mosveprimi procedural passjell mos zbatimin e vendimeve të gjykatës dhe besueshmëri më të ulët në aplikimin e drejtësisë penale.

Në lidhje me problematikën e paraqitur në rastet e shkeljes, mospërmbushjes së kushteve nga ana e të dënuarve gjatë ekzekutimit të alternativës së dënimit, janë shqyrtuar praktikat e ndjekura në vende të tjera evropiane të cilat krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë mes Shërbimit të Provës dhe gjykatës, në rastet kur këto mospërmbushje konstatohen. Në vijim po paraqesim disa prej praktikave të ndjekura në vende të tjera, ku komunikimi mes Shërbimit të Provës dhe gjykatës është i drejtpërdrejtë.

Një shembull i tillë është rasti i Bullgarisë.[251] Këshilli i Shërbimit te Provës në Bullgari dërgon raport për mospërmbushjen e detyrimeve drejt gjykatës, e cila mund të ndryshoje masën e dhënë, ta zgjasë apo ta zëvendësojë në mënyrë të plotë apo të pjesshme me burgim (neni 43/a i Kodit Penal të Bullgarisë).

Një rast i ngjashëm është Rumania[252]. Në Rumani, Shërbimi i Provës komunikon me gjykatën në rast shkeljeje të detyrimeve, e cila nga ana e saj pas raportimit të Shërbimit të Provës mund të vendosë ndryshimin e masës alternative apo te zgjasë, zëvendësojë dhe revokojë dënimin alternativ.

Gjithashtu edhe në Austri[253] prokurori është shmangur gjatë fazës së ekzekutimit të një dënimi alternativ, pasi ai nuk mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve pas vendimit të marrë nga gjykata.

Edhe Anglia dhe Uellsi[254] ka të njëjtën mënyrë konceptimi të fazës së ekzekutimit të dënimit alternativ. Prokurori nuk ka asnjë rol në përforcimin e dënimeve. Nëse, për shembull, detyrimet e lirimit me kusht ose të një dënimi me shërbim në komunitet (punë në interes publik) shkelen, vendimi

[251] Procedura përshkruhet ne mënyrë te detajuar ne nenin 451 dhe 452 te Kodit te Procedurës Penale te Bullgarisë.

[252] Shih në web: http://www.euprobationproject.eu/national_detail.php?c=RO.

[253] Shih në web: http://www.euro-justice.com/member_states/austria/country_report/2865/.

[254] Shih në web: http://www.euro-justice.com/member_states/england_wales/country_report/452/.

nëse shkelësi i ligjit duhet sjellë ose jo para gjykatës, merret nga specialisti mbikëqyrës i Shërbimit të Provës.

Ndërkohë në Estoni, detyra e punonjësit të Shërbimit të Provës është të monitorojë shërbimin në komunitet dhe të ushtrojë mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve dhe kërkesave të përcaktuara në vendimin gjyqësor[255]. Nëse një i dënuar i shmanget shërbimit në komunitet, nuk shkon në përputhje me detyrimet e mbikëqyrjes apo për të kryer detyrimet të cilat i janë përcaktuar, gjykata mundet, në saje të raportit të përgatitur nga specialisti i Shërbimit të Provës, të revokojë vendimin dhe ta rikthejë atë në burg[256]. Në rast të dënimit të pezulluar, punonjësi i Shërbimit të Provës njofton gjykatën për shkeljen e detyrimeve dhe kjo e fundit ndryshon kushtet apo detyrimet, ose mundet edhe të disponojë për revokimin e dënimit alternativ[257].[258]

7.4. Mbikëqyrja elektronike e të liruarve me kusht

Mbikëqyrja elektronike për të dënuarit me dënime alternative, për subjektet kundër të cilëve është dhënë një urdhër mbrojtje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtje, apo edhe për subjektet ndaj të cilëve është caktuar masë sigurimi dhe është përcaktuar që masa të ekzekutohet sipas kësaj mënyre, është rregulluar për herë të parë në Shqipëri me Ligjin nr. 10 494, datë 22.12.2011 "*Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor*". Qëllimi i krijimit të këtij mekanizmi ligjor dhe praktik ka qenë rritja e sigurisë publike dhe kontrolli i zbatimit me efektivitet i urdhërimeve gjyqësore në të tre fushat e zbatimit të këtij mekanizmi, sikurse u individualizuan më lart.

Në shkronjën "b" të nenit 4 të këtij ligji, është përcaktuar se mbikëqyrja elektronike do të zbatohet edhe ndaj të dënuarve të cilët lirohen me kusht. Mbikëqyrja elektronike është një nga masat se si gjykata mundet të urdhërojë të realizohet ekzekutimi i dënimit alternativ të lirimit me kusht. Kjo mundet të vendoset ose me kërkesë të prokurorit apo të vetë të dënuarit, mbrojtësit të tij apo e të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës apo prindërve ose kujdestarit të të miturit apo edhe kryesisht nga vetë gjykata[259].

[255] Shih Nenin 419, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Estonisë.

[256] Shih Seksionin 69, nënseksioni 6 i Kodit Penal të Republikës së Estonisë.

[257] Shih Nenin 74, pika 4 të Kodit Penal të Republikës së Estonisë.

[258] Shih Relacionin për projektligjin "*Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar*". Marrë nga web: www.drejtësia.gov.al.

[259] Shih nenin 6 të ligjit.

Gjykata, përpara caktimit të lirimit me kusht si dënim alternativ, pyet subjektin nëse jep pëlqimin për përdorimin e pajisjes së mbikëqyrjes elektronike dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj. Sigurisht që nuk ka vend për të marrë pëlqimin nga ana e gjykatës, kur kjo kërkesë është parashtruar nga vetë i dënuari në kërkesën për zbatimin e lirimit para kohe me kusht si dënim alternativ. Ligji parashikon se përdorimi i pajisjes së mbikëqyrjes elektronike vendoset vetëm me pëlqimin e subjektit, dhe pasi gjykata sigurohet se ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj, duke parashikuar gjithashtu se pëlqimi i subjektit për përdorimin e pajisjes së mbikëqyrjes elektronike jepet me shkrim ose nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore. Në rastin e subjekteve të mitura, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor.

Nëse subjekti nuk jep pëlqimin, gjykata nuk mund të urdhërojë përdorimin e pajisjes së mbikëqyrjes elektronike, por ky fakt mbahet në konsideratë prej saj, së bashku me rrethanat e tjera të çështjes, në konkluzionin nëse duhet të pranohet apo jo kërkesa për lirimin para kohe me kusht. Në këto raste, duhet të vlerësohet nëse është i mundur apo jo kontrolli efektiv i të dënuarit në drejtim të zbatimit të detyrimeve gjyqësore dhe ligjore gjatë kohës së provës apo jo. Sigurisht një përgjigje negative në këtë drejtim do ta bënte kërkesën për lirim me kusht të papranueshme, pasi nuk do të garantohej as zbatimi efektiv i vendimit gjyqësor dhe as siguria publike.

Kur është e mundur, subjekti përcakton edhe një person të tij të afërt, i cili ndihmon në zbatimin e vendimit për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike. Nëse jep pëlqimin të caktohet si i tillë, personi i afërt ka detyrimin të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon mbikëqyrjen elektronike, adresën e tij të saktë dhe numra telefoni kontakti, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë.

Para marrjes së vendimit për vendosjen e mbikëqyrjes elektronike, gjykata duhet t'i kërkojë Shërbimit të Provës një raport vlerësimi lidhur me nevojën e zbatimit të kësaj mase gjatë ekzekutimit të lirimit para kohe me kusht. Nëse një masë e tillë caktohet, mundet të jetë me afat apo edhe pa afat, sipas mënyrës që ka disponuar gjykata. Në rast se kjo masë është urdhëruar nga gjykata pa përcaktuar edhe afatin e kohëzgjatjes, atëherë ligji në nenin 9 ka përcaktuar se maksimumi i kohëzgjatjes së mbikëqyrjes elektronike do të jetë e barabartë me kohëzgjatjen e vetë periudhës së provës në lirimin me kusht.

Në vendimin e gjykatës që urdhëron zbatimin e kësaj mase mbikëqyrjeje, duhet të pasqyrohet fakti se i dënuari ka dhënë pëlqimin. Më tej duhet të individualizohen qartë zonat e ndaluara për të lëvizur të subjektit, apo të përcaktohet zona e lejuar e lëvizjes së tij. Vendimi i njoftohet menjëherë sallës operative, Shërbimit të Provës dhe të dënuarit.

I dënuari i vënë në mbikëqyrje elektronike, gjatë kohëzgjatjes së lirimit me kusht duhet të zbatojë kushtet e përcaktuara në vendimin gjyqësor; të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon ME-në, adresën e saktë të banimit dhe të punës, si dhe numra telefonikë kontakti, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë; të kthehet brenda zonës së lejuar të lëvizjes ose të largohet nga zona e ndaluar, brenda 30 minutave nga çasti kur është kontaktuar nga salla operative; të mos dëmtojë ose heqë në asnjë rast pajisjen; të njoftojë menjëherë organin që realizon mbikëqyrjen elektronike për çdo dëmtim aksidental të pajisjes ose funksionimin në kushte jonormale të saj.

Nëse konstatohet se i dënuari gjatë kohës së provës nuk respekton detyrimet e mbikëqyrjes elektronike të vendosura me vendim të gjykatës, atëherë shërbimet e Policisë së Shtetit apo Shërbimi i Provës ka për detyrë të njoftojnë prokurorin menjëherë sapo marrin njoftim. Neni 19 i këtij ligji ka parashikuar se nëse prokurori vlerëson se detyrimet ligjore të mbikëqyrjes elektronike janë shkelur qëllimisht apo në mënyrë të përsëritur, atëherë hartohet një raport për gjykatën e ekzekutimit, trupë gjykuese e cila duhet të jetë po ajo që ka dhënë dënimin alternativ të lirimit me kusht.

Ky raport duhet të shoqërohet edhe me rekomandimin e Shërbimit të Provës lidhur me ngjarjet që kanë passjellë shkeljen e detyrime ligjore të mbikëqyrjes elektronike të të dënuarit dhe nevojën që ka për të marrë masa parandaluese eventuale, mbi ndryshimin e masave, kohëzgjatjes apo edhe revokimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Raporti i prokurorit dhe rekomandimi i Shërbimit të Provës, duhet të paraqiten brenda 48 orëve nga marrja e informacionit. Megjithëse nuk ka një afat për gjykatën, vlerësojmë se është e përshtatshme të konkludohet se edhe gjykata duhet ta shqyrtojë menjëherë raportin dhe të caktojë menjëherë seancën gjyqësore, për të cilën duhet të njoftohet për t'u dëgjuar prokurori, përfaqësuesi i Shërbimit të Provës dhe të dënuarin e liruar me kusht.

Pasi gjykata të ketë vlerësuar të gjitha rrethanat dhe të ketë dëgjuar palët, vendos nëse duhet të ndryshohen masat apo të revokohet lirimi me kusht. Sigurisht edhe ky vendim ndjek rregullat e përgjithshme të

ankimit, qoftë për apelin në gjykatën e apelit dhe qoftë për rekursin në Gjykatën e Lartë.

Ky ligj ka nisur të zbatohet fillimisht vetëm në çështjet, gjykimi i të cilave kanë qenë në kompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke u lënë që në rrethe të tjera gjyqësore të zbatohet pasi të përgatitet logjistika e nevojshme. Ligji ka hyrë në fuqi, sipas nenit 22 të tij, me datë 1 prill 2012.

Vendimi nr. 377, datë 06.06.2012 i Këshillit të Ministrave "*Për kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, rregullat për përzgjedhjen dhe të drejtat dhe detyrimet e tij*", ka përcaktuar se organi përgjegjës për të kontrolluar mënyrën se si zbatohet mbikëqyrja elektronike është institucioni i Shërbimit të Provës dhe Ministria e Drejtësisë që është organi epror i tij. Më tej, në Aleksin I që i bashkëlidhet këtij akti nënligjor normativ, parashikohen edhe kriteret teknike që duhet të përmbushin pajisjet teknike nëpërmjet të cilave arrihet të realizohet mbikëqyrja elektronike, duke përshkruar në të karakteristikat teknike dhe fizike që garantojnë një kontroll efektiv të të dënuarit me dënim alternativ lirim me kusht.

Gjithashtu në këtë akt nënligjor normativ parashikohen edhe mënyra se si salla operative, që mban kontakt të drejtpërdrejtë kontrolli të pajisjeve, duhet të organizohet dhe se si ky kontroll kryhet në kohë reale. Kështu salla operative përbëhet prej pajisjeve fizike (*hardëare*), programeve kompjuterike (*softëare*) dhe pajisjeve që janë receptorë dhe analizues të sinjaleve që dërgohen nga pajisjet e identifikimit personal dhe njësitë e mbikëqyrjes. Programi kompjuterik (*softëare*) menaxhon mbikëqyrjen e përgjithshme të subjekteve. Vendndodhja dhe çdo informacion tjetër, si mesazhet dhe alarmet në tërësinë e sistemit, përfshirë këtu edhe alarmet që shkaktohen kur personi i mbikëqyrur nuk është brenda zonës së kontrollit në kohën e paracaktuar, ose po vepron në mënyrë të paautorizuar mbi pajisjet, pasqyrohen në programin kompjuterik (*softëare*) në mënyrë të vazhdueshme.

Fillimi i zbatimit të mbikëqyrjes elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë është shënuar me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 406, datë 18.6.2014 "*Për shtrirjen e mbikëqyrjes elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë*"[260]. Për ekzekutimin e këtij vendimi është ngarkuar Shërbimi i Provës dhe Ministria e Drejtësisë.

[260] Vendimi ka hyrë në fuqi me datë 27.06.2014. Ai është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98, datë 27.06.2014.

7.5. Ndryshimi ose revokimi i dënimit alternativ

Neni 31/10 i Ligjit nr. 8331/1998 ka parashikuar edhe procedura që duhet të ndiqen nga Shërbimi i Provës, prokurori apo gjykata në rastet kur vërtetohen fakte juridike që bëjnë të detyrueshëm ndryshimin apo revokimin e lirimit me kusht si dënim alternativ të dhënë. Kështu gjykata, me kërkesë të prokurorit, shqyrton shkeljen e kushteve të dënimit alternativ apo mospërmbushjen e detyrimit të dhënë dhe mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e pjesshëm a të plotë të dënimit alternativ. Prokurorin, mundet dhe duhet ta vënë në dijeni, shërbimet e policisë apo edhe Shërbimi i Provës.

Tek praktika e Shërbimit të Provës, për sa i përket njoftimit të prokurorit për shkeljet e detyrimeve që i dënuari mund të bëjë gjatë kohëzgjatjes së kushtit, u vu re një problem. Në referimet që ky institucion i bënte prokurorit u pa që në secilën praktikë kërkohej njëherazi, ndryshimi, zëvendësimi apo zgjatja dhe revokimi i lirimit me kusht, duke mos u kryer një analizë e mëparshme e rëndësisë së shkeljes dhe duke mos u individualizuar sakaq edhe kërkimi apo opinioni i Shërbimit të Provës lidhur me njërën prej masave që duhet të merret në ato rrethana sipas parimit të proporcionalitetit. Vlerësojmë se kjo praktikë e zbatimit të ligjit është e pabazuar në ligj dhe në parimet e përgjithshme të Rekomandimit të Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht, ku kërkohet detyrimisht që të zhvillohet një vlerësim konkret i rrethanave, nevojës së sigurimit dhe si rezultat i këtij vlerësimi të konkudohet lidhur me një nga masat për të cilën do të duhet t'i drejtohet praktika respektive prokurorit.

Në këto raste, kur vlerësohet se është e nevojshme për shkak të rrethanave, gjykata e ekzekutimit që shqyrton kërkesën për revokimin e dënimit alternativ mundet të vendosë, me kërkesë të prokurorit apo kryesisht, që të pezullohet ekzekutimi i lirimit me kusht, duke urdhëruar që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Pezullimi i lirimit para kohe me kusht në këtë rast është një masë siguruese, me qëllim që të parandalohet rreziku që liria e të dënuarit mundet të shkaktojë.

Megjithëse në këtë pjesë ligji ometon për të përcaktuar kritere vlerësuese, vlerësojmë se për analogji duhet që gjykata të vlerësojë pikërisht *mutatis mutandis* zbatimin e kritereve të caktimit të masave të sigurisë në përgjithësi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Ajo që kjo dispozitë vendos shprehimisht është se, në mënyrë që gjykata të vlerësojë nëse duhet apo jo të revokohet lirimi me kusht, ajo është e detyruar të marrë parasysh

mënyrën dhe shkallën e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari.

Neni 31/10 i Ligjit nr. 8331/1998 ka parashikuar edhe rregulla procedurale për gjykimin e kërkesës së prokurorit për revokimin e lirimit me kusht. Kështu gjykata, pasi dëgjon prokurorin, të dënuarin, mbrojtësin e tij dhe provat e kërkuara prej tyre, merr vendim brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit. Vendimi i njoftohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, Shërbimit të Provës dhe prokurorit. Ndaj vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Kjo do të thotë se, vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës për revokimin e lirimit me kusht mundet ta apelojë prokurori, duke i kërkuar gjykatës së apelit të ushtrojë juridiksion rishikues të plotë mbi faktin dhe ligjin. Njëlloj mundet ta ankimojë vendimin për revokimin e lirimit me kusht, edhe i dënuari. Respektivisht të dy palët e procesit penal mundet të aktivizojnë juridiksionin penal rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, sipas njërit prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

7.6. Mbarimi i dënimit alternativ të lirimit me kusht

Neni 31/11 i Ligjit nr. 8331/1998, ka parashikuar edhe procedurën për konstatimin se dënimi alternativ i lirimit me kusht ka mbaruar. Kështu, kur i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë, Shërbimi i Provës paraqet përpara prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Ligji ka paraparë se mënyra e parë e mbarimit të lirimit para kohe me kusht është mënyra natyrale, apo thënë ndryshe mbarimi i kohës së provës. Në këto raste, ligji nuk ka vendosur që në këtë konstatim të marrë pjesë gjykata, duke u mjaftuar me rregullimin dhe urdhërimin për prokurorin që të nxjerrë vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ.

Nga ana tjetër, kjo dispozitë ka parashikuar se lirimi para kohe me kusht mundet të mbarojë edhe para ezaurimit natyral të afatit të provës. Kështu gjykata mund të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ, me propozimin e prokurorit, në të cilin vërtetohet se i dënuari ka kryer detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Në këto raste kërkesa e prokurorit për përfundimin para afatit, përmban të dhëna për precedentët

penalë të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit e progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit dhe arsyet e paraqitjes së kërkesës, informacione këto që prokurorit i ofrohen nga Shërbimi i Provës apo aktorë të tjerë që kanë informacione relevante. Për të deklaruar të mbyllur para afatit lirimin para kohe me kusht, do të duhet që kërkesa për përfundimin para afatit të dënimit alternativ, të paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, për rendin publik apo palët e treta.

Në këto raste, ndërhyrja e gjykatës është e detyrueshme. Efektet e vendimit të gjykatës kanë karakter konstitutiv, ndryshe nga vendimmarrja e prokurorit në rastin e mbarimit natyral të dënimit alternativ, i cili ka efekt konstatues dhe deklarativ.

Në prakltikën gjyqësore të hulumtuar dhe nga intervista e kryer me punonjës të Shërbimit të Provës rezultoi se, nuk ka asnjë rast në praktikën gjyqësore ku të jetë zbatuar mbarimi para kohe i dënimit alternativ të lirimit me kusht. Vlerësojmë se praktika gjyqësore dhe më së shumti avokatia, duhet të krijojnë mekanizma stimulimi të përdorimit edhe të kësaj mundësie ligjore në mënyrën se si ekzekutohet lirimi me kusht, në mënyrë që ky mekanizëm ligjor për shuarjen e dënimit penal të mos mbesë vetëm teorik dhe si i tillë edhe iluzor.

8. KONKLUZIONE MBI PRAKTIKËN GJYQËSORE TË LIRIMIT ME KUSHT

Nga analiza e praktikës gjyqësore të vendimmarrjes mbi kërkesat me objekt lirimi me kusht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitet 2018 dhe 2019, konstatojmë dhe konkludojmë se:

1) Gjykatat përllogarisin afatin minimum të vuajtjes së dënimit me burgim, për efekte të zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal, në mënyrë të përditësuar, duke mos mbajtur parasysh dënimin e vuajtur në momentin e paraqitjes së kërkesës, por dënimin që ka mbetur për t'u vuajtur deri në momentin e shqyrtimit gjyqësor kur kjo përllogaritje

bëhet. Vlerësojmë se një qasje interpretative strikte e kësaj çështje juridike, sikurse ka kërkuar organi i akuzës, nuk do të ishte konstruktive, pasi nuk i përgjigjet qëllimit ligjor të këtij dënimi alternativ. Kriteri i përmbushjes së afatit minimal të vuajtjes së dënimit në momentin e depozitimit të kërkesës, nuk mundet të prevalojë kurrsesi mbi kriterin e përmbushjes materialisht të kushteve që shërbejnë për të liruar me kusht një të dënuar me burgim. Për më tepër duhet të mbahet parasysh se përllogaritja e përditësuar e vuajtjes së dënimit me burgim është detyrë për gjykatën edhe në funksion të zbatimit të sentencës nomofilatike të Vendimit Unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilën është arritur në konkluzionin se në çdo rast kohëzgjatja e kushtit në dhënien e dënimit alternativ të lirimit me kusht, do të jetë në çdo rast pjesa e mbetur e dënimit me burgim e cila pezullohet. Kjo do të thotë se, gjykatës i del detyrë që në çdo çështje të përllogarisë sasinë e dënimit me burgim të vuajtur deri në momentin e dhënies së vendimit, pasi në këtë mënyrë ajo do të jetë në gjendje të përcaktojë se sa do të jetë kohëzgjatja e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Ndaj konkludojmë se, afati minimal i dënimit me burgim, si kusht për t'u vuajtur në mënyrë që të lindë e drejta për të kërkuar lirim me kusht, duhet të bëhet nga gjykata në mënyrë të përditësuar. Përditësimi duhet të ketë si limit momentin e vendimmarrjes së gjykatës. Në këtë drejtim, do të sugjeronim që kjo qasje interpretative të mbahej parasysh në çdo rast nga gjykatat, në funksion të shqyrtimit të kërkesave për lirim me kusht.

2) Rrezikshmëria e veprës penale dhe rrezikshmëria e autorit janë shkaqe të cilat shërbejnë në mënyrë determinante në momentin e caktimit të llojit dhe masës së dënimit. Ato nuk mundet të shërbejnë si shkaqe për të rrëzuar kërkesën për caktimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Rrezikshmëria e veprës penale dhe e autorit në gjykimin e kërkesës për lirim me kusht, shërbejnë për të maturuar shqyrtimin gjyqësor të gjykatës dhe për të përcaktuar thellësinë e ushtrimit të tij. Për t'u pranuar apo jo kërkesa për lirim me kusht materialisht, kur ndalesat ligjore nuk ekzistojnë, duhet të jetë e kushtëzuar vetëm nga shkaqet subjektive që i përkasin të dënuarit. Kjo do të thotë se gjykatave i del detyrë që të konkludojnë vetëm nëse i dënuari është risocializuar, riedukuar dhe nëse mundet të riintegrohet në shoqëri apo jo. Çdo qëndrim tjetër, mbi vlerësimin apo interpretimin e nenit 64 të Kodit

Penal, do ta bënte të pamundur zbatimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht dhe vetë aksesin e të dënuarve në të.

3) Është i gabuar vlerësimi i përgjithshëm dhe jo konkret i gjykatave mbi rrezikshmërinë shoqërore të një vepre penale, vetëm duke u bazuar teorikisht nga marzhet ligjore të dënimit në rastet e shqyrtimit të kërkesave për caktimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Gjykata që shqyrton kërkesën për lirimin me kusht, tashmë e ka të individualizuar dënimin nga një vendim gjykate jo vetëm i formës së prerë, por edhe gjësë të gjykuar, dhe se për rrjedhojë çdo shtim i rrezikshmërisë së veprës tej atij dënimi të caktuar sipas nenit 47 të Kodit Penal, do të jetë vlerësim i gabuar.
4) Lirimi para kohe me kusht, duke pasur parasysh se pas konkluzionit të mosekzistencës së ndalesave ligjore varet vetëm tek konkluzioni nëse i dënuari është apo jo gati për t'u rintegruar në shoqëri, bën që të dallohen edhe në kohë dy qëllimet e mëdha ligjore të vetë dënimit. Fillimisht, dënimi me burgim i caktuar nga gjykata sipas nenit 47 të Kodit Penal duhet të vuhet detyrimisht dhe minimalisht deri në kufijtë e nenit 64, 65 apo 65/a të Kodit Penal, dhe më tej pjesa e mbetur e dënimit mundet të pezullohet, duke i akorduar lirinë të dënuarit. Kjo do të thotë se pjesa e parë e dënimit penal me burgim, konkretisht pjesa që parashikohet nga neni 64, 65 dhe 65/a i Kodit Penal, ndjek posaçërisht qëllimin ndëshkues të ligjit ndaj të dënuarit. Më tej, pjesa e mbetur e dënimit duhet t'i kushtohet riintegrimit social të të dënuarit me burgim. Për rrjedhojë, gjykatat nuk mundet të rrëzojnë kërkesat për lirim me kusht për arsye të tjera veç riintegrimit social të të dënuarit, kur kushtet ndaluese ligjore janë vërtetuar se nuk ekzistojnë.
5) Disponimet gjyqësore mbi lirimin me kusht duhet të jenë të unifikuara në të gjitha gjykatat, duke pasur parasysh parashikimet ligjore materiale dhe procedurale. Në tërësi ka dy lloje vendimmarrjeje; ose vendimmarrje përfundimtare ose vendimmarrje jopërfundimtare. Vendimmarrjet përfundimtare janë dy llojesh; ose rrëzimi i kërkesës për lirim me kusht, ose pranimi i saj. Në rast se kërkesa rrëzohet, kjo do të thotë se gjykata ka vlerësuar meritat ligjore të saj, qoftë të pabazueshmërisë në ligj dhe qoftë të pabazueshmërisë në fakt. Nga ana tjetër, pranimi i kërkesës presupozon të kundërtën e këtij vlerësimi. Ndërkohë, vendimmarrja jopërfundimtare e gjykatës mbi gjykimin kërkesave të lirimit me kusht është e parashikuar në nenin 471 të Kodit të Procedurës Penale, që do të

thotë se kur i dënuari kërkues nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme në kushtet kur ka dijeni, kur ai heq dorë nga kërkesa apo kur kërkesa është haptazi e pabazuar në ligj, atëherë gjykata vendos papranueshmërinë e kërkesës. Shkaqet e papranueshmërisë së kërkesës, për arsye se ajo është haptazi e pabazuar, nuk mundet të kenë lidhje me aspektin material dhe meritor të saj, por janë kurdoherë të lidhura ekskluzivisht me shkaqe procedurale që passjellin gjendjen e paprocedueshmërisë.

6) Në çdo rast gjykatat duhet të konkludojnë mbi mjetin juridik që i ka investuar ato në gjykim,jo nga emërtimi i aktit por nga përmbajtja e tij. Kjo do të thotë se, apeli ndaj një vendimi gjykate që ka rrëzuar kërkesën për lirim me kusht, edhe pse e quajtur kërkesë, nuk mundet të trajtohet si e tillë dhe sakaq të konstituojë çështje të juridiksionit fillestar. Ajo duhet të kualifikohet si apel apo rekurs sikurse përmbajtja e saj tregon, për të mos i cenuar aksesin në juridiksionin rishikues palës ankuese. Në këto raste nuk ka vend që gjykata të disponojë proceduralisht apo materialisht mbi kërkesën, por ajo vendos dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën kompetente për të shqyrtuar atë mjet ankimi.
7) Në të gjitha rastet kur konkludohet nga gjykata se një kërkesë për lirim me kusht është e papranueshme për shkak se ajo është paraqitur dhe rrëzuar më parë, sipas parashikimit të nenit 477 të Kodit të Procedurës Penale, në vendimin që e deklaron kërkesën të papranueshme duhet të individualizohet vendimi i mëparshëm, identiteti i kërkesës, koha e vendimmarrjes dhe shkaqet e vendimmarrjes.
8) Masat disiplinore të marra nga i dënuari në sistemin penitenciar sigurisht që duhet të mbahen parasysh nga gjykata si të dhëna për të vlerësuar rrugëtimin riedukues dhe riintegrues të të dënuarit që ka kërkuar të lirohet me kusht. Në çdo rast gjykata duhet të vlerësojë peshën faktike dhe juridike që ky fakt mundet të ketë në konkluzionin e riedukimit apo riintegrimit të të dënuarit, duke pasur parasysh ngjarjen për të cilën kjo masë është dhënë. Megjithatë vlerësojmë se masa disiplinore e dhënë nga sistemi penitenciar nuk mundet të jetë më e rëndësishme se sa shkaqet të cilat, edhe pse janë shkelje ligjore të detyrimeve të të dënuarit gjatë kohëzgjatjes së provës, nuk lejojnë sipas parimit të proporcionalitetit të revokojnë dënimin alternativ të lirimit me kusht sipas paragrafit të fundit të nenit 64 të Kodit Penal. Për rrjedhojë vlerësojmë se gjykata, në vlerësimin e masave disiplinore të dhëna nga sistemi penitenciar ndaj të dënuarit apo të shkaqeve të tjera që formojnë bindjen e saj mbi

riintegrimin apo risocializimin e të dënuarit, duhet të mbajë parasysh parimin e proporcionalitetit dhe të përdorë të njëjtën mënyrë vlerësimi sikurse ajo që normohet në paragrafin e fundit të nenit 64, për të konkluduar nëse lirimi me kusht duhet të akordohet apo jo.

9) Sigurisht është e rëndësishme që, në vendimin përfundimtar të pranimit të kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit me burgim të disponohet se një ndër detyrimet që i dënuari i lirë do të ketë gjatë kohëzgjatjes së kushtit, do të jetë ushtrimi i një veprimtarie profesionale, sikurse është treguar gjatë gjykimit kur si provë është sjellë një kontratë pune apo një premtim për lidhje kontratë pune. Megjithatë, individualizimi në dispozitiv i veprimtarisë profesionale që do të ushtrohet, i kontratës së punës apo edhe i punëdhënësit ku i dënuari i lirë do të punojë, mundet të passjellë vështirësi faktike dhe juridike për të, në kuptim të plotësimit të detyrimeve. Kontrata e punës mundet të zgjidhet në mënyrë të njëanshme apo me konsensus dhe se i dënuari mundet të vendosë të ndryshojë lirisht veprimtarinë e tij profesionale, kur nuk ka kufizime të tjera ligjore dhe të arsyeshme, por kjo mundet të rezultojë, edhe pse pa qëllim, e pamundur nga urdhërimi gjyqësor në dispozitiv, për arsye sepse detyrimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor janë aq të detyrueshme për të sa që mosplotësimi i tyre sipas modaliteteve, do të mundet të jetë shkak edhe për revokimin e vetë dënimit alternativ. Në këtë kuptim do të ishte e sugjerueshme që dispozitivi i vendimit të gjykatës në këtë pjesë, të mjaftohet me një formulim të përgjithshëm mbi detyrimin e të dënuarit për të ushtruar veprimtari profesionale.

10) Vendimi Unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në seancën e dytë nomofilatike ka vendosur se në rastet e dhënies së dënimit alternativ të lirimit me kusht, kohëzgjatja e kushtit do të jetë pjesa e mbetur e dënimit në momentin e shpalljes së vendimit të lirimit me kusht. Edhe ndryshimet ligjore të vitit 2017 në Kodin Penal nuk e mbushën ometimin ligjor të Kodit Penal, që zgjat që prej vitit 1995 të miratimit të tij. Kjo do të thotë se, Vendimi Unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është akoma në fuqi.

11) Megjithatë, jo të gjitha gjykatat e zbatojnë këtë vendim unifikues. Ka trupa gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që përcaktojnë afate për kohëzgjatjen e kushtit më shumë sesa afati i dënimit të mbetur me burgim. Në këto vendime nuk arsyetohet se pse nuk zbatohet Vendimi Unifikues nr. 2/2015 dhe se nga kush parashikim merren afatet

më të mëdha sesa dënimi i mbetur i kohëzgjatjes së kushtit, megjithëse kuptohet se për ta bërë këtë gjyqtarët zbatojnë me analogji nenin 59 të Kodit Penal. Vlerësojmë se kjo mënyrë e zbatimit të ligjit për të përcaktuar kohëzgjatjen e kushtit, përbën zbatim të ligjit penal me analogji, gjë që vjen ndesh me nenin 3 të Kodit Penal, nenin 29 të Kushtetutës dhe me nenin 7 të KEDNJ. Vlerësojmë se për sa kohë Vendimi Unifikues nr. 2/2015 është në fuqi, ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar, në bazë dhe për zbatim të nenit 141 të Kushtetutës dhe se të gjykuarit kanë pritshmëri se e drejta e zbatueshme në kuptimin material për sa i përket kësaj çështje, është pikërisht kjo bazë juridike e unifikimit të praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë, vendimmarrjet e gjykatave për sa i përket kësaj çështje, duhet të jenë të njësuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

12) Nga të gjitha rastet e praktikës gjyqësore të studiuara, nuk është konstatuar asnjë gjykim me objekt lirim para kohe me kusht, të ardhur me iniciativën e prokurorit. Vlerësojmë se, përtej parashikimit të nenit 31/6 të Ligjit nr. 8331/1998 dhe nenit 471 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, më shumë kërkesat për lirim me kusht konceptohen në ndërgjegjen profesionale të kujtdo praktikanti të ligjit vetëm si e drejtë ekskluzive e të dënuarit me burgim, e cila ushtrohet vetëm sipas parimit të disponibilitetit. Megjithatë, vlerësojmë se ky konkluzion është i gabuar dhe se duhet të ndryshojë në të ardhmen dhe në praktikën gjyqësore do të duhet që neni 31/6 i Ligjit nr. 8331/1998 dhe pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, të interpretohen sipas parimeve të përgjithshme dhe *ratio*-s që parashikohen në Rekomandimin Rec (2003) 22 e Këshillit të Evropës mbi lirimin me kusht. Kjo do të thotë se dënimi alternativ i lirimit me kusht, përveç se duhet të konceptohet si përfitim dhe e drejtë subjektive e të dënuarit, duhet të konceptohet edhe si çështje e interesit publik për miradministrimin e drejtësisë penale dhe sistemit penitenciar dhe risocializimin e të dënuarve me burgim, për kthimin e tyre si anëtarë të shoqërisë ku ligji respektohet.

13) Gjykata nuk mund të mjaftohet vetëm me administrimin e provave nga institucionet shtetërore apo nga subjekte të tjera, për të krijuar bindjen e saj mbi plotësimin e kushteve dhe kritereve subjektive dhe objektive të lirimit me kusht. Përkundrazi, ajo duhet të verifikojë, qoftë edhe kryesisht, plotësimin e secilit prej kushteve dhe kritereve ligjore dhe vetëm pas këtyre konkluzioneve të provuara të mund të disponojë mbi lirimin me kusht.

9. KONKLUZIONE DHE SUGJERIME MBI RREGULLIMIN LIGJOR TË LIRIMIT ME KUSHT

Nga gjithçka u hulumtua mbi legjislacionin e brendshëm të rregullimit të lirimit me kusht në Shqipëri dhe nga standardet ndërkombëtare të detyrueshme për Shqipërinë, qoftë të karakterit normativ apo jurisprudencial, konkludojmë dhe sugjerojmë, si më poshtë:

1) Ndryshe nga dënimet e tjera alternative, lirimi me kusht jepet gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit dhe se nuk gjen fushë zbatimi në të gjitha llojet e dënimeve kryesore por vetëm dy të tilla, konkretisht dënimin me burgim dhe dënimin me burgim të përjetshëm.
2) Jo të gjitha konstatimet e nxjerra nga analiza e sistemit të drejtësisë për qëllimet e reformës mbi sistemin penitenciar dhe për lirimin me kusht, janë konkretizuar me ndryshime në ligj. Gjithashtu, jo të gjitha konstatimet në këtë dokument rezultojnë të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.
3) Standardet e detyrueshme ndërkombëtare për Republikën e Shqipërisë, normative apo jurisprudenciale, kërkojnë që në Kodin Penal të mos ketë kufizime absolute për aksesin e të dënuarve në dënimin alternativ të lirimit me kusht, pavarësisht llojit të dënimit dhe pavarësisht veprës penale të kryer. Gjithashtu, këto standarde të gjithëpranuara nuk pajtohen me kufizime ligjore të atilla në afate të periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, sa që të vështirësohet aksesi në mekanizmin ligjor të rifitimit të lirisë nëpërmjet lirimit me kusht.
4) Standardet e detyrueshme ndërkombëtare për Republikën e Shqipërisë, normative apo jurisprudenciale, kërkojnë që kriteret e vetme ligjore që mundësojnë rifitimin e lirisë nëpërmjet lirimit me kusht, duhet të jenë të lidhura funksionalisht dhe integralisht me qëllimet penalogjike të dënimit, sjelljen e të dënuarit, nevojën për siguri të komunitetit dhe respektimin e të drejtave të viktimës së veprës penale.
5) Shqipëria duhet të sigurojë garancinë e aksesueshme të një mekanizmi rikontrolli periodik dhe të vazhdueshëm mbi dënimet afatgjata apo dënimet me burgim të përjetshëm, qoftë edhe vetëm mbi bazën e kërkesës së të dënuarit, në mënyrë që gjyqësisht të rikontrollohet sjellja e të dënuarit, zhvillimi i personalitetit të tij dhe legjitimiteti i pjesës së mbetur të dënimit. Pas ezaurimit të periudhës minimale të vuajtjes

së dënimit me burgim, theksi dhe objektivi kryesor i qëllimeve të dënimit penal është riaftësimi social i të dënuarit. Ekuilibri i nevojës për ndëshkim dhe risocializimit, nuk mundet të prezumohet se mbetet i pandryshueshëm përgjatë gjithë periudhës së dënimit.

6) Legjislatori shqiptar duhet të diversifikojë fushën e zbatimit të dënimit alternativ të lirimit me kusht, për sa i përket dënimeve kryesore ndaj të cilave ai mund të zbatohet, sikurse ka bërë Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.
7) Një nga çështjet për të cilat historikisht është ometuar në Kodin Penal në fuqi, është afati i kohëzgjatjes së periudhës së kushtit. Vlerësojmë se, vetëm Vendimi Unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk mjafton, megjithëse logjika dhe filozofia e konkluzioneve nomofilatike është e drejtë. Kodi Penal duhet ta rregullojë nëpërmjet një dispozite eksplicite, periudhën minimale dhe maksimale të kohëzgjatjes së kushtit dhe kohës së provës. Ky rregullim do të shmangte natyrën fikse dhe të pandryshueshme të dënimit alternativ penal të lirimit me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm, dënim i cili është krijuar jo me ligj por me vendim unifikues, që nga viti 2015 e në vijim. Në këtë mënyrë edhe të dënuarit me burgim të përjetshëm, do të mund të përfitonin lirinë e pakushtëzuar në të gjallë të tyre dhe gjithashtu do të mund të përfitonin nga parashikimi ligjor i mbarimit para kohe të lirimit me kusht, sikurse të gjithë të dënuarit e tjerë me këtë dënim alternativ.
8) Është e nevojshme që normat ligjore të parashikuara në ligjin e ekzekutimin e dënimeve penale, të cilat kanë karakter material, të përfshihen në Kodin Penal për të qenë objekt rregullimi sipas parimit kushtetues të kodifikimit dhe gjithashtu të një shumice parlamentare, sikurse parashikon neni 81 i Kushtetutës.
9) Ligjvënësi duhet të rregullojë në ligj konkretisht, se si mund të zëvendësohet lirimi me kusht me një dënim tjetër apo se si mund të ndodhë zgjatja e afatit të lirimit me kusht. Neni 64 i Kodit Penal në paragrafin e fundit, në këto dy hipoteza është praktikisht i pazbatueshëm.
10) Dënimi me burgim të përjetshëm në Shqipëri, sikurse në të gjithë shtetet e Këshillit të Evropës, nuk mundet të vlerësohet dhe konsiderohet apriori se bie në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ, që do të thotë se nuk është në vetvete as dënim mizor, as çnjerëzor, as degradues dhe as poshtërues. Megjithatë, ndryshe nga të gjitha shtetet e Këshillit të

Evropës dhe standardet ndërkombëtare mbi këtë çështje, dënimi me burgim të përjetshëm në Shqipëri, për veprat penale të parashikuara nga neni 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, 100, paragrafi i tretë, i Kodit Penal dhe nga ato autorë që janë recidivë të dënuar për krime të kryera me dashje, është i pandryshueshëm *de facto* dhe *de jure* dhe si i tillë i papajtueshëm me nenin 3 të KEDNJ dhe me nenin 17, 25 dhe 28 pika 5 të Kushtetutës.

11) Nenit 65 të Kodit Penal i mungon një rregullim i posaçëm, pasi nuk ka rregullim të posaçëm të afatit të periudhës minimale dhe të detyrueshme të kohëzgjatjes së vuajtjes së dënimit me burgim, për qëllimet e rifitimit të së drejtës për lirim me kusht për të gjithë kategorinë e të moshuarve që vuajnë dënimet me burgim të përjetshëm. Vlerësojmë të domosdoshme që një ndërhyrje e radhës ligjore në Kodin Penal, do të mundësonte një parashikim të veçantë dhe të pakushtëzuar me periudhën minimale të vuajtjes së dënimit për të moshuarit deri në një moshë të caktuar, duke mbetur si shkak për akordimin e lirimit me kusht vetëm kriteret me natyrë subjektive. Kjo do të ofronte perspektivë jo vetëm teorike, por edhe praktike për të dënuarit e moshuar.
12) Duke mbajtur parasysh këto konkluzione, afërmendsh kuptohet se neni 64 dhe 65 i Kodit Penal do të jenë pengesë reale për suksesin e Shqipërisë në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, qoftë në rastet e transferimit të të dënuarve, ekstradimit, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale që përmbajnë dënime alternative, apo edhe lidhur me zbatimin e ardhshëm të Urdhrit të Arrestit Evropian.
13) Sugjerojmë që fillimisht duhet të hiqet ndalimi kategorik i zbatimit të lirimit para kohe me kusht për recidivistët e veprave penale të kryera me dashje, pasi asnjë ndalim kategorik i aksesit në riedukim dhe risocializimin e individit të dënuar penalisht, nuk mundet të jetë e pranueshme për standardet e gjithëpranuara ndërkombëtare. Më tej duhet të shfuqizohen ndalesat kategorike të ligjit për mundësinë e rifitimit të lirisë nëpërmjet zbatimit alternativ të lirimit me kusht, të parashikuara në nenin 64 dhe 65 të Kodit Penal. Në parim, nuk mundet të ketë asnjë vendim penal të kufizimit të lirisë personale të pandryshueshëm dhe të parashikueshëm në raport me rrugëtimin edukativ apo risocializues që ndjek gjatë vuajtjes së dënimit i dënuari.
14) Gjithashtu legjislatorit shqiptar i duhet të rishikojë periudhën e detyrueshme të dënimit me burgim të përjetshëm, sipas nenit 65 të Kodit Penal, e cila duhet të jetë proporcionale dhe pse jo e njëjtë me

standardet ndërkombëtare të detyrueshme. Masa 35 vjet burgim e dënimit të detyrueshëm për të vuajtur me qëllim që të kërkohet lirimi me kusht, është ndjeshëm shumë i lartë dhe në raste të caktuara mundet të rezultojë i paaksesueshëm objektivisht për shkak të moshës së të dënuarit. Një shembull për një periudhë standard dhe të gjithëpranuar, mundet të merret edhe afati 20 vjeçar sikurse paraqitet në nenin 5 pika 2 të Urdhrit të Arrestit Evropian.

15) Nga ana tjetër ligji, konkretisht neni 471 pika 1 i Kodit të Procedurës Penale do të duhet të interpretohet dhe të zbatohet në atë mënyrë që të lejojë ushtrimin e rishqyrtimit të dënimit me burgim të përjetshëm pas kalimit të afatit minimal dhe të detyrueshëm të burgimit, që ligji parashikon edhe kur nga i dënuari nuk ka kërkesë. Në këtë mënyrë do të plotësohet detyrimi ligjor ndërkombëtar si standard i kërkuar nga dispozita e mëlartme e Urdhrit të Arrestit Evropian dhe nga standardet e gjithëpranuara dhe të detyrueshme jurisprudenciale të GJEDNJ.
16) Vlerësojmë se ndryshimet ligjore në nenet 64 – 65/a të Kodit Penal, apo ndërhyrja eventuale e Gjykatës Kushtetuese si legjislator negativ, sikurse është konkluduar më lart, do të ndihmonte thellësisht edhe në zhvillimin e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë Shqipërisë, veçse në respektimin e detyrimeve ndërkombëtare dhe të drejtave themelore të njeriut.
17) Ndryshimet e mëlartme ligjore do të munden t'i japin kuptim edhe pjesës së legjislacionit në fuqi me anën e të cilës rregullohen të drejtat dhe trajtimi i të dënuarve me burgim të përjetshëm. Sot kjo pjesë e legjislacionit nuk bën kuptim dhe është iluzore, në kushtet e këtij rregullimi ligjor të nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal. Mbi këtë çështje ka një qëndrim paradoksal të legjislatorit, ku qëllimi i vendosur në vitin 1998 është pamundësuar të arrihet në vitin 2017.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Manual mbi dënimet alternative në Republikën e Shqipërisë / Daniela Sulaj, Edlira Petri, Florjan Kalaja, Ornela Naqellari, Romeo Merruko ;
red. Suela Mino. – Tiranë : UET Press, 2021
354 f. ; 16.5 x 23.5 cm. – (Acta Scientiarum ; 27)
ISBN 978-9928-320-40-7
1.E drejta penale 2.Dënimi 3.Manuale 4.Shqipëri
343.263(496.5) (035)

MANUAL MBI DËNIMET ALTERNATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Daniela Sulaj, Edlira Petri, Florjan Kalaja, Ornela Naqellari, Romeo Merruko

Manuali për Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë ofron një trajtim shumë të arritë të institucionit të dënimeve alternative. Ai reflekton dijen dhe përvojën e profesionistëve që kanë marrë pjesë në studimin dhe paraqitjen e problematikës lidhur me dënimet alternative. Për afro 25 vjet, eksperienca e fituar nga gjykatat e vendit për zbatimin e dënimeve alternative përbën një taban të sigurt për të nxjerrë konkluzione, edhe të karakterit shkencor, për mënyrën se si janë zbatuar në praktikë dënimet alternative dhe si vlerësohet efektiviteti i tyre përkundrejt dënimit kryesor që përmban ligji penal, burgimit.

Ky Manual është një instrument për të ndihmuar aktorët e përfshirë në proces në kuptimin, aplikimin dhe zbatimin më të drejtë të dënimeve alternative, duke pasqyruar problematikat dhe praktikat më të mira. Manuali ndahet në pesë kapituj, një për secilin nga dënimet alternative: (i) gjysmëlirinë, (ii) pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, (iii) qëndrimin në shtëpi, (iv) pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, dhe (v) lirimin para kohe me kusht.

Manuali i bën një trajtim të veçantë dhe të hollësishëm secilit lloj të dënimit alternativ duke ndjekur të njëjtën linjë.

* * *

Manuali për alternativat e dënimit me burgim është hartuar nga një grup autorësh, në dy faza. Faza e parë ka qenë analiza e praktikës gjyqësore në katër gjykata të Rrethit Gjyqësor dhe në tre gjykata Apeli, gjatë një harku kohor prej 2 vitesh. Në këtë mënyrë është analizuar vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Gjykata e Apelit Korçë, Tiranë dhe Shkodër, për vitet 2018 dhe 2019. Gjithashtu janë kryer takime me aktorë ligjorë, të përfshirë në ekzekutimin e dënimeve alternative të dhëna në vendimet gjyqësore. Konstatimet e fazës së parë janë përpunuar dhe kanë shërbyer si lënda e parë për fazën e dytë të hartimit të këtij Manuali, konkretisht të draftimit të tij.

Manuali është konceptuar në pesë kapituj, ku secili prej tyre i korrespondon një prej llojeve të dënimeve alternative që Kodi Penal njeh dhe regullon. Kështu, Kapitulli I trajton Nenin 58 të Kodit Penal, konkretisht dënimin alternativ të gjysmëlirisë. Kapitulli II trajton dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e të dënuarit, konkretisht nenit 59 e vijues të Kodit Penal. Kapitulli III trajton dënimin alternativ të qëndrimit në shtëpi, konkretisht nenin 59/a të Kodit Penal. Kapitulli IV i kushtohet dënimit alternativ të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimit të të dënuarit për kryerjen e një pune në interes publik, të regulluar nga neni 63 i Kodit Penal. Kapitulli V trajton dënimin alternativ të lirimit me kusht, i regulluar nga neni 64 e vijues i Kodit Penal.

UETPRESS

ISBN 978-9928-320-40-7